



THE AIRE CENTRE
Advice on Individual Rights in Europe



**CIVIL
RIGHTS
DEFENDERS**

Mbrojtja e të Drejtave të Njeriut në Kohë Emergjencash

Analizë e jurisprudencës përkatëse të
Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut
nën prizmin e pandemisë Covid-19





THE AIRE CENTRE

Advice on Individual Rights in Europe



**CIVIL
RIGHTS
DEFENDERS**

Mbrojtja e të Drejtave të Njeriut në Kohë Emergjencash

Analizë e jurisprudencës përkatëse të
Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut
nën prizmin e pandemisë Covid-19

Redaktorë

Biljana Braithwaite, Drejtoreshë e Programit për

Ballkanin Perëndimor, Qendra AIRE

Catharina Harby, Konsulente e Lartë Ligjore, Qendra AIRE

Goran Miletić, Drejtor për Evropë dhe Lindjen e Mesme & Afrikën (MENA), Mbrojtësit e Të Drejtave Civile

Kontribuesit kryesorë

Ledi Bianku, ish-Gjyqtar i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të

Njeriut dhe Profesor i Asociuar, Universiteti i Strasburgut

Hannah Smith, Avokate dhe Menaxhere e Projekteve Ligjore, Qendra AIRE

U jemi shumë mirënjohës/e **Nuala Mole**, Themeluese dhe Juriste

e Lartë, Qendra AIRE, si dhe **Klara Slater**, **Emma Gilbert** dhe

Naomi Sirrs për kontributin e tyre në këtë publikim.

© 2022 AIRE Centre

Printuar

100

Ky version origjinal në anglisht është përkthyer në gjuhët boshnjake/kroate/malazeze/serbe, shqipe dhe maqedone.

Dizajnuar nga

Kliker Dizajn

Shtypur nga

Kuća Štampe Plus

Parathënie

Situatat emergjente, si pandemia Covid-19, ngrenë çështje komplekse për sa i përket mënyrës se si autoritetet shtetërore mund dhe duhet të ekuilibrojnë përgjegjësinë e tyre për të reaguar me shpejtësi dhe efektivitet në kushtet e emergjencës, duke vazhduar të mbrojnë gamën e të drejtave dhe lirive që mund të preken nga reagimi ndaj emergjencës. Ashpërsia e kërcënimit ndaj shëndetit që paraqiti pandemia Covid-19, natyra e saj e paparashikueshme dhe gjithnjë në zhvillim e sipër, si dhe mungesa fillestare e njohurive lidhur me mënyrat më të mira për të parandaluar përhapjen e virusit, sollën sfida pa precedent. Nga njëra anë, Shteteve iu desh të vepronin me shpejtësi për të marrë masa për përmbajtjen e përhapjes së virusit dhe për të mbrojtur jetën dhe shëndetin e qytetarëve të tyre. Nga ana tjetër, masat e marra për të mbrojtur shëndetin patën pasoja mbi gëzimin e të drejtave dhe lirive të shumta.

Kur Shtetet duhet të veprojnë me shpejtësi në një situatë serioze dhe komplekse emergjence, është e qartë se këqyrja parlamentare rigoroze e masave të emergjencës dhe pajtueshmëria e tyre me të drejtat e njeriut mund të mos jetë gjithmonë e mundur. Në këtë kontekst, këqyrja gjyqësore efektive dhe e pavarur e masave emergjente bëhet edhe më thelbësore për llogaridhënien e qeverive në kuadër të mbrojtjes së të drejtave themelore. Masat e jashtëzakonshme që merren për të mbrojtur jetën dhe shëndetin e një kombi duhet të jenë gjithnjë në përputhje me parimet e rëndësishme të Konventës për ligjshmërinë dhe proporcionalitetin. Gjykatat, si dhe ombudspersonat e pavarur, kanë rol jetik në monitorimin e respektimit të këtyre parimeve. Ato duhet të përpiqen të sigurojnë që të drejtat e njeriut të mbeten në vazhdimësi konsideratë qenësore në çdo reagim ndaj emergjencave, që masat emergjente t'i shërbejnë qëllimit për të cilin janë marrë dhe që ato të mos ndërhyjnë tek të drejtat e Konventës përtej një shkalle absolutisht të nevojshme në kontekstin e emergjencës.

Në vitin 2020, në mes të pandemisë Covid-19, Qendra AIRE dhe Mbrojtësit e të Drejtave Civile publikuan Udhërrëfyesin tonë për Covid-19 dhe Të Drejtat e Njeriut, i cili analizonte të drejtat e Konventës që kishin më shumë gjasa të ndikoheshin nga pandemia dhe nga veprimet e ndërmarra nga qeveritë për ta përmbajtur atë. Sot, rreth dy vjet më pas, ky publikim i Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut në Kohë Emergjencash përfshin jurisprudencën përkatëse kyçe evropiane dhe vendase të zhvilluar që nga marsi 2020, në lidhje me reagimet e Shteteve

ndaj pandemisë Covid-19. Prandaj, publikimi ofron udhërrëfim praktik se si t'u qasemi problematikave të reja që dolën në pah gjatë pandemisë. Për shembull, si të balancohen të drejtat e ndryshme që angazhohen në kontekste që shkojnë nga vaksinimi i detyrueshëm e deri tek imponimi i mbylljes brenda në shtëpi. Parimet e përgjithshme të aplikuara në këto raste dhe të analizuar në këtë publikim, megjithatë, janë të aplikueshme më gjerësisht në situata emergjencash, dhe në fakt në çdo situatë në të cilën është e nevojshme të balancohen të drejtat që duken si konkurruese.

Teksa jemi duke dalë nga pandemia, ky publikim gjithashtu shërben si instrument për të theksuar mësimet kyçe të nxjerra gjatë kësaj kohe pa precedent në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të njeriut në kohë emergjencash. Këtu përfshihen faktorët kyç që duhet të merren në konsideratë kur balancohen të drejtat dhe interesat konkurruese në kontekstin e emergjencës dhe mënyrat se si parimet siç janë proporcionaliteti dhe subsidiariteti janë përdorur dhe duhet të përdoren në këtë kontekst. Ai gjithashtu përfshin këshilla në lidhje me rolin e gjyqësorit në këqyrjen e masave emergjente, pikërisht çka përbën këqyrje gjyqësore efektive dhe të pavarur në kohë emergjencash, dhe si mund të adaptohen gjykatat me qëllim që të funksionojnë në përputhje me Konventën gjatë kohërave të emergjencës. Përderisa Shtetet në Evropë vazhdojnë të përballen me sfida dhe emergjenca të reja, përfshirë luftën në Ukrainë dhe krizat klimatike dhe të energjisë, është thelbësore të kuptohen këto çështje për të garantuar mbrojtjen e ardhshme të të drejtave të njeriut karshi këtyre kohërave kaq të turbullta dhe të paparashikueshme.

Publikimi është pjesë e projektit më të gjerë të Platformës së Shtetit të së Drejtës,^[1] një platformë rajonale online rreth zhvillimeve të shtetit të së drejtës, në mënyrë të veçantë jurisprudencën më të fundit nga GjEDNj, në gjuhët shqipe, boshnjake/kroate/malazeze/serbe, maqedone dhe angleze. Gjithashtu, ai ofron kornizën për diskutimin e temës "Të Drejtat e Njeriut në Kohë Emergjencash – Roli i Gjyqësorit sipas Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut" në Forumin e Nëntë Vjetor Rajonal të Shtetit të së Drejtës për Evropën Juglindore në nëntor 2022. Që nga viti 2014, ky Forum ka bashkuar përfaqësues të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, të gjykatave supreme e kushtetuese, kryetarë të këshillave gjyqësore, ombudspersona, drejtorë të akademive dhe institucioneve të kualifikimit gjyqësor, agjentë të qeverive para Gjykatës së Strasburgut, përfaqësues të OJQ-ve, dhe ekspertë të njohur ligjorë nga tërë rajoni për të diskutuar çështjet

[1] <https://www.rolplatform.org/rule-of-law/>

më të rëndësishme në kuadër të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut për juridiksionin e Strasburgut dhe juridiksionet kombëtare pjesëmarrëse në Forum.

Shpresojmë që ky publikim të jetë burim i dobishëm për gjykatat që vazhdojnë të marrin vendime në çështje që kanë dalë në kontekstin e pandemisë Covid-19, si dhe për juristët dhe organizatat jo-qeveritare që punojnë me individë të drejtat dhe liritë e të cilëve janë shkelur gjatë pandemisë. Njëkohësisht, shpresojmë që ai do të përforcojë idenë që të drejtat e njeriut nuk duhet të shihen si pengesë për të reaguar në mënyrë efektive ndaj një emergjence ose situatë të krizës, e as si koncepte që mund të injorohen ose të lihen anash përkohësisht gjatë përballjes me emergjencën. Përkundrazi, parimet e ligjshmërisë dhe proporcionalitetit, dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut, mund dhe duhet të jenë në qendër të çdo reagimi në kushtet e emergjencës. Në situata kur këqyrja legjislative mund të jetë e kufizuar, është e domosdoshme që gjykatat dhe ombudspersonat të vazhdojnë të funksionojnë dhe të inspektojnë masat e emergjencës. Kjo mund të kërkojë njëfarë shkalle të kreativitetit dhe fleksibilitetit. Megjithatë, pandemia Covid-19 ka vërtetuar se një gjë e tillë mund të bëhet, dhe na ka dhënë mësim të rëndësishme se si të sigurohet funksionimi efektiv i gjyqësorit gjatë periudhave të emergjencës prej tani e tutje.

Biljana Braithwaite,

Drejtoreshë e Programit për Ballkanin
Perëndimor, Qendra AIRE

Goran Miletić,

Drejtor për Evropë dhe Lindjen
e Mesme & Afrikën (MENA),
Mbrojtësit e Të Drejtave Civile

Contents

Lista e shkurtesave	16
PJESA 1 - Hyrje	17
Kapitulli I – Të drejtat e angazhuara nga pandemia e Covid-19 dhe reagimet e Shteteve ndaj pandemisë	25
1. Neni 2 – E drejta e jetës	27
a. Detyrimet pozitive për të mbrojtur jetën	27
b. Detyrat procedurale hetimore	45
2. Neni 3 – Mbrojtja nga trajtimi çnjerëzor dhe poshtërues.....	50
a. Detyrimet pozitive për të mbrojtur individët nga trajtimi çnjerëzor dhe degradues	51
b. Detyrimet procedurale hetimore.....	68
3. Neni 8 - E drejta për respekt ndaj jetës private dhe familjare.....	69
a. Fushëveprimi i Nenit 8	70
b. Kufizimet	87
4. Neni 5 - E drejta për liri	99
a. Fushëveprimi i Nenit 5	99
b. Përfshirjet e lejuara.....	105
c. Mbrojtjet sipas Nenit 5.....	107
5. Neni 2 i Protokollit Nr. 4 - E drejta për lirinë e lëvizjes, përfshirë të drejtën për të hyrë dhe dalë nga vendi i vet	115
a. Liria e lëvizjes	115
b. E drejta për të hyrë në vendin e vet.....	121
6. Neni 6 - E drejta për seancë dëgjimore të drejtë	124
a. Drejtësia e tërësishme dhe pjesëmarrja efektive në procedura	127
b. Seanca publike	131

c. Brenda një kohe të arsyeshme.....	133
d. Të drejtat e mbrojtjes për të pasur ndihmë ligjore të menjëhershme, praktike dhe efektive	135
7. Neni 9 – E drejta e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë	139
a. Fushëveprimi i Nenit 9	139
b. Ndërhyrjet e lejuara tek e drejta e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë	142
8. Neni 10 - E drejta për lirinë e shprehjes	145
a. Fushëveprimi i Nenit 10	146
b. Çfarë përbën ndërhyrje në të drejtën e lirisë së shprehjes?	148
c. Ndërhyrjet e lejuara në të drejtën e lirisë së shprehjes	153
9. Neni 11 - E drejta për lirinë e tubimit dhe organizimit	159
a. Fushëveprimi i Nenit 11	159
c. Ndërhyrjet e lejuara tek e drejta për lirinë e tubimit dhe organizimit	160
10. Neni 3 i Protokollit Nr.1 - E drejta për të votuar	168
a. Fushëveprimi i Nenit 3 të Protokollit Nr. 1.....	168
b. Ndërhyrjet e lejuara në të drejtën për të votuar	169
c. E drejta për të marrë pjesë në fushatë zgjedhore	172
d. Mbajtja e zgjedhjeve gjatë pandemisë	173
11. Neni 2 i Protokollit Nr. 1 - E drejta për arsimim.....	175
a. Fushëveprimi i Neni 2 të Protokollit Nr. 1	175
b. Ndërhyrjet e lejuara në të drejtën për arsimim	176
c. Diskriminimi dhe lidhja mes Nenit 14 dhe Neni 2 të Protokollit Nr. 1.....	178
12. Neni 1 i Protokollit Nr.1 - E drejta e pronës.....	182
a. Gëzimi paqësor i pasurive	183
b. Natyra e ndërhyrjes	183
c. Ligjshmëria	186
d. Testi i interesit publik	186
e. Proporcionaliteti.....	187

13. Neni 14 dhe Neni 1 i Protokollit Nr. 12 - Liria nga diskriminimi	190
a. Shëndeti.....	191
b. Abuzimi shtëpiak.....	195
c. Zbatimi i kufizimeve të lëvizjes dhe tubimit	196
Kapitulli II - Derogimet	198
1. Sfondi	198
2. Si operon KEDNj në rastet e derogimit?	202
a. Kriteret substanciale.....	202
b. Kriteret procedurale.....	210
c. Të derogohet apo të mos derogohet gjatë situatës së pandemisë Covid-19?	211
Kapitulli III - Garancitë institucionale dhe procedurale gjatë situatës së krizës	220
1. Kriteret kundër abuzimit.....	224
a. Ligjshmëria	225
b. Proporcionaliteti	227
2. Garancitë kundër abuzimit	230
a. Kontrolli parlamentar	230
b. Kontrolli gjyqësor	234
c. Kontrolli ndërqeveritar dhe ombudspersoni(at) e pavarur	238
Kapitulli IV - Përfundime	240
PJESA 2 - Përmbledhjet e çështjeve	242
I. Derogimi dhe masat e pazakonta.....	242
1. VENDIMI I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN A. DHE TË TJERË K. MBRETËRISË SË BASHKUAR	242
2. VENDIMI NË ÇËSHTJEN AKSOY K. TURQISË.....	249
3. VENDIMI NË ÇËSHTJEN BRANNIGAN DHE MCBRIDE K. MBRETËRISË SË BASHKUAR	254

4. VENDIMI NË ÇËSHTJEN KOUFAKI DHE ADEDY k. GREQISË258
5. VENDIMI NË ÇËSHTJEN LAWLESS k. IRLANDËS (Nr. 3) 261
6. VENDIMI NË ÇËSHTJEN ŞAHIN ALPAY k. TURQISË.....263

II. Detyrimet pozitive për të mbrojtur jetën dhe shëndetin përfshirë në ambientet e paraburgimit.....270

7. VENDIMI NË ÇËSHTJEN BUDAYEVA DHE TË TJERË k. RUSISË270
8. VENDIMI NË ÇËSHTJEN CALVELLI & CIGLIO k. ITALISË.....274
9. VENDIMI I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN
E QENDRËS PËR BURIME LIGJORE NË EMËR
TË VALENTIN CÂMPEANU k. RUMANISË..... 277
10. VENDIMI NË ÇËSHTJEN CORDELLA DHE TË TJERË k. ITALISË 281
11. VENDIMI NË ÇËSHTJEN EUGENIA LAŽAR k. RUMANISË285
12. VENDIMI NË ÇËSHTJEN FEILAZOO k. MALTËS..... 289
13. VENDIMI PËR PRANUESHMËRINË DHE
THEMELIN NË ÇËSHTJEN FENECH k. MALTËS294
14. VENDIMI NË ÇËSHTJEN GHAVTADZE k. GJEOGJISË 301
15. VENDIMI NË ÇËSHTJEN KHUODOBIN k. RUSISË 304
16. VENDIMI NË ÇËSHTJEN LE MAILLOUX k. FRANCËS 309
17. VENDIMI I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN
LOPES DE SOUSA FERNANDES k. PORTUGALISË 312
18. VENDIMI NË ÇËSHTJEN MOUISEL k. FRANCËS 316
19. VENDIMI NË ÇËSHTJEN NENCHEVA
DHE TË TJERË k. BULLGARISË 319
20. VENDIMI I DHOMËS SË MADHE NË
ÇËSHTJEN ÖNERIYILDIZ k. TURQISË324
21. VENDIMI I DHOMËS NË ÇËSHTJEN OPUZ k. TURQISË329
22. VENDIMI NË ÇËSHTJEN OSMAN k. MBRETËRISË SË BASHKUAR... 334
23. VENDIMI NË ÇËSHTJEN OYAL k. TURQISË 340
24. VENDIMI NË LIDHJE ME PRANUESHMËRINË
E SHELLY k. MBRETËRISË SË BASHKUAR..... 344
25. VENDIMI I DHOMËS SË MADHE
NË ÇËSHTJEN ŞILIH k. SLLOVENISË 347
26. VENDIMI NË ÇËSHTJEN STRAZIMIRI k. SHQIPËRISË350

III. Përjashtimi dhe ekstradimi.....355

27. VENDIMI I DHOMËS SË MADHE NË
ÇËSHTJEN PAPOSHVILI k. BELGJIKËS355

IV. Masat kufizuese dhe paraburgimi.....	359
28. VENDIMI I DHOMËS SË MADHE PËR ÇËSHTJEN AUSTIN DHE TË TJERËT k. MBRETËRISË SË BASHKUAR.....	359
29. VENDIMI I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN BUZADJI k. REPUBLIKËS SË MOLDAVISË	362
30. VENDIMI I DHOMËS SË MADHE PËR ÇËSHTJEN DE TOMMASO k. ITALISË	366
31. VENDIMI PËR ÇËSHTJEN ENHORN k. SUEDISË	371
32. VENDIMI NË ÇËSHTJEN EPPLE k. GJERMANISË	375
33. GUZZARDI k. ITALISË	378
34. VENDIMI I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN NADA k. ZVICRËS	382
35. VENDIMI NË ÇËSHTJEN TERHEŞ k. RUMANISË	387
V. Procedurat gjyqësore dhe garancitë.....	390
36. VENDIMI NË ÇËSHTJEN BAJIĆ k. KROACISË	390
37. VENDIMI NË ÇËSHTJEN BOGUMIL k. PORTUGALISË.....	394
38. VENDIMI NË ÇËSHTJEN KHLEBIK k. UKRAINËS	398
39. VENDIMI NË ÇËSHTJEN OTGON k. REPUBLIKËS SË MOLDAVISË..	402
40. VENDIMI NË ÇËSHTJEN Q DHE R k. SLOVENISË.....	404
41. VENDIMI I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN SAKHNOVSKIY k. RUSISË	409
VI. Jeta private/shqyrtimi mjekësor, trajtimi & hulumtimet.....	413
42. VENDIMI NË ÇËSHTJEN BATALINY k. RUSISË.....	413
43. VENDIMI NË ÇËSHTJEN GLASS k. MBRETËRISË SË BASHKUAR.....	417
44. VENDIMI NË ÇËSHTJEN HRISTOZOV DHE TË TJERË k. BULLGARISË	421
45. DËSHMITARËT E JEHOVAIT DHE TË TJERË k. RUSISË.....	425
46. VENDIMI NË ÇËSHTJEN E M.A.K dhe R.K. kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR	429
47. VENDIMI NË ÇËSHTJEN NITECKI k. POLONISË	433
48. VENDIMI NË ÇËSHTJEN PANTELEYENKO k. UKRAINËS	435
49. VENDIMI NË ÇËSHTJEN PENTIACOVA DHE TË TJERË k. MOLDAVISË	439
50. VENDIMI NË ÇËSHTJEN R.S. k. HUNGARISË	443
51. VENDIMI NË ÇËSHTJEN SOLOMAKHIN k. UKRAINËS	446
52. VENDIMI I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN VAVŘIČKA DHE TË TJERË k. REPUBLIKËS ÇEKE	449

VII. Pëlqimi i informuar	454
53. VENDIMI NË ÇËSHTJEN ALTUĞ DHE TË TJERË k. TURQISË	454
54. VENDIMI NË ÇSHTJEN DVOŮÁČEK k. REPUBLIKËS ÇEKE	457
55. VENDIMI NË ÇËSHTJEN ELBERTE k. LETONISË	461
VIII. Ruajtja e të dhënave përfshirë gjurmimin	464
56. VENDIMI NË ÇËSHTJEN AVILKINA DHE TË TJERË k. RUSISË	464
57. VENDIMI NË ÇËSHTJEN L.H. kundër LETONISË	467
58. VENDIMI NË ÇËSHTJEN RADU k. REPUBLIKËS SË MOLDAVISË	470
59. VENDIMI I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN ROMAN ZAKHAROV k. RUSISË	473
60. VENDIMI I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN S. DHE MARPER k. MBRETËRISË SË BASHKUAR	479
61. VENDIMI NË ÇËSHTJEN Y.Y. k. RUSISË	482
IX. Jeta familjare	485
62. VENDIMI NË ÇËSHTJEN KUIMOV k. RUSISË	485
63. VENDIMI NË ÇËSHTJEN SABANCHIYEVA DHE TË TJERË k. RUSISË	489
X. Liria e shprehjes/e drejta për informacione	494
64. VENDIMI I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN GUERRA DHE TË TJERË k. ITALISË	494
65. VENDIMI I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN MAGYAR HELSINKI BIZOTTSÁG k. HUNGARISË	497
66. VENDIMI NË ÇËSHTJEN SALLUSTI k. ITALISË	501
67. WOMEN ON WAVES DHE TË TJERË k. PORTUGALISË	504
68. VENDIMI NË ÇËSHTJEN E INICIATIVËS RINORE PËR TË DREJTAT E NJERIUT k. SERBISË	507
XI. Liria e tubimit	510
69. VENDIMI NË ÇËSHTJEN CISSE k. FRANCËS	510
70. VENDIMI NË ÇËSHTJEN COMMUNAUTÉ GENEVOISE D’ACTION SYNDICALE (CGAS) k. ZVICRËS	513

XII. Liria e lëvizjes përfshirë të drejtën për t'u larguar nga një vend dhe për të hyrë në vendin e vet.....	518
71. VENDIMI NË RASTIN A.E. k. POLONISË	518
72. VENDIMI NË ÇËSHTJEN ANTONENKOV DHE TË TJERË k. UKRAINËS.....	521
73. GJYKIMET NË ÇËSHTJET	524
74. (1) OLIVIEIRA k. HOLANDËS.....	524
75. (2) LANDVREUGD k. HOLANDËS	524
76. VENDIMI NË ÇËSHTJEN MILEN KOSTOV k. BULLGARISË	527
77. VENDIMI NË ÇËSHTJEN OUDRHIRI k. FRANCËS.....	530
XIII. Diskriminimi	532
78. VENDIMI NË ÇËSHTJEN KIYUTIN k. RUSISË	532

Lista e shkurtesave

Tabela e mëposhtme përshkruan domethënien e shkurtimeve dhe shkurtesave të ndryshme të përdorura gjatë tërë doracakut.

Shkurtesa	Emri / Titulli i plotë
KEDNJ / Konventa	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
Gjykata / GjEDNJ	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
Shteti(et) / Shteti(et) Kontraktues	Shteti(et) Kontraktuese të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut
Shtetet e Ballkanit Perëndimor	Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Serbia
GjND	Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë
(ang.) ICCPR; (shq.) PNDCP	Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike
Konventa e Stambollit	Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunën shtëpiake
Konventa e Lanzarotes	Konventa e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Fëmijëve kundër Shfrytëzimit Seksual dhe Abuzimit Seksual
(ang.) CPT; (shq.) KPT	Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Degradues
Deklarata e Parimeve e CPT-së	Deklarata e Parimeve të CPT-së në lidhje me trajtimin e personave të privuar nga liria në kontekstin e pandemisë së Covid-19
(ang.) PPE; (shq.) PPM	Pajisje Personale të Mbrojtjes

Shënime mbi citimet, shënimet në fund të faqes dhe përmbledhjet e çështjeve

Për çështjet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, referencat paraqesin emrin e çështjes me shkronja të pjerrëta, datën e vendimit për pranueshmërinë ose vendimit përfundimtar, dhe numrin e kërkesës. Gjithashtu, për çështjet e përmendura në tekst ka një shënim që tregon se cila është e përfshirë si përmbledhje në Pjesën 2 të këtij Udhërrëfyese.

Referencat mbi Nenet dhe Protokollet

Të gjitha referencat ndaj Neneve dhe Protokolleve janë në lidhje me Nenet dhe Protokollet e KEDNJ-së, nëse nuk shënohet ndryshe.

PJESA 1

Hyrje

Ashtu si publikimet e mëparshme, Udhërrëfytyesi i këtij viti për Të Drejtat e Njeriut në Kohë Emergjencash është i ndarë në dy pjesë. Pjesa 1 përmban narrativin dhe Pjesa 2 përmban përmbledhje të vendimeve përfundimtare të zgjedhura dhe vendimeve për pranueshmërinë të marra nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (prej këtu Gjykata ose GjEDNJ).

Narrativi në Pjesën 1 analizon jurisprudencën e GjEDNJ-së në lidhje me situatat e emergjencës nën prizmin e pandemisë Covid-19. Në shumë aspekte, pandemia Covid-19 ishte një formë unike dhe pa precedent e emergjencës publike. Fillimisht krejt i paparashikueshëm, impakti i menjëhershëm dhe i ashpër i pandemisë Covid-19 i zuri Shtetet në befasi, dhe autoriteteve iu desh të reagonin me shpejtësi pa pasur njohuritë ose përvojën për ta kuptuar se si të parandalohej më së miri përhapja e virusit. Sidoqoftë, gjatësia, fushëveprimi dhe natyra ndryshuese e pandemisë Covid-19 gjithashtu nënkuptojnë që kjo është mundësi e paçmueshme për të reflektuar në lidhje me reagimet e Shteteve ndaj emergjencës, si dhe praktikën gjyqësore vendase dhe evropiane të zhvilluar gjatë kësaj kohe, për ta kuptuar më mirë se si të veprohet në përputhje me Konventën në situata të ardhshme emergjencash.

Fushëveprimi i të drejtave të angazhuara nga pandemia dhe reagimet e Shteteve ndaj saj, numri i Shteteve të prekura, dhe gama e ndryshme e masave të marra për të mbrojtur shëndetin dhe për të siguruar funksionimin e vazhdueshëm të organeve legjislative dhe gjyqësore, të gjitha këto nënkuptojnë që ka shumë aspekte të pandemisë prej të cilave mund të nxirren mësimet të vlefshme. Përveç kësaj, praktika gjyqësore e Gjykatës në lidhje me situatat që u shfaqën gjatë pandemisë nxori dhe zhvilloi parime të përgjithshme të aplikimit më të gjerë përtej pandemisë.

Pas kësaj hyrjeje, Kapitulli I i Pjesës 1 të Udhërrëfytyesit analizon të drejtat e prekura nga pandemia Covid-19 dhe të drejtat e Shteteve për t'iu kundërpërgjigjur

pandemisë sipas KEDNJ-së. Një version i mëhershëm i këtij Udhërrëfyesi^[2] analizon të drejtat e Konventës që kanë më shumë gjasa të ndikohen nga pandemia Covid-19 dhe nga reagimet e qeverive ndaj saj. Narrativi është bazuar mbi dispozitat e KEDNJ-së, vendimet përfundimtare dhe vendimet për pranueshmërinë të cilat duket se ishin më relevante për çështjet ligjore të ngritura nga pandemia, dhe është përpjekur të aplikojë praktikën gjyqësore ekzistuese të Gjykatës së Strasburgut në faktet e reja me të cilat u përballëm. Kapitulli I i këtij Udhërrëfyesi tani merr në konsideratë praktikën gjyqësore vendase dhe evropiane, instrumentet udhërrëfyese dhe instrumente të tjera ligjore të publikuara gjatë pandemisë.

Nën-seksionet e Kapitullit I janë të ndara në Nenet e veçanta të KEDNJ-së të cilat janë prekur gjatë pandemisë, qoftë për shkak të kërcënimit ndaj shëndetit si pasojë e pandemisë Covid-19, qoftë si pasojë e ndërhyrjeve të Shteteve në përpjekje për të përmbajtur përhapjen e Covid-19. Ai analizon shkurtimisht se si janë angazhuar të drejtat e identifikuara të Konventës dhe sugjeron detyrimet pozitive që pandemia Covid-19 krijoi për Shtetet. Ai gjithashtu shqyrton se si, në disa rrethana, efektet e pandemisë dhe masat e marra për t'iu kundërpërgjigjur asaj kanë ndikuar në mënyrë joproporcionale mbi disa grupe të caktuara, dhe sugjeron disa prej detyrimeve që mund të kenë dalë për të bërë rregullime të arsyeshme me qëllim të akomodimit të dallimeve në mesin e popullsisë që masat synonin të mbronin.

Siç shpjegohet në Kapitullin I të Pjesës 1 të Udhërrëfyesis, jo të gjitha të drejtat e Konventës angazhohen në të njëjtën mënyrë në situata emergjente. Për shembull, egërsia dhe përhapja e Covid-19 kërcënoi mirëqenien e individëve, duke ngritur çështje në lidhje me të drejtën për trajtim mjekësor, siç interpretohet në kuadër të së drejtës së jetës, të drejtën për të mos iu nënshtuar keqtrajtimit ose trajtimit poshtërues, të drejtën e jetës private etj. Kapitulli I shpjegon se Konventa, siç interpretohet nga Gjykata, u kërkon Shteteve që të ndërmarrin masa pozitive për të parandaluar përhapjen e Covid-19 me qëllim që t'i vënë kufi përhapjes së infektiveve në mesin e popullatës, dhe t'u ofrojnë trajtimin e duhur mjekësor të infektuarve^[3]. Këto detyrime mund të jenë më të qarta në rastin e personave për

[2] <https://www.rolplatform.org/covid-19-and-the-impact-on-human-rights> "Covid-19 dhe Impakti mbi të Drejtat e Njeriut: Shikim i përgjithshëm i jurisprudencës përkatëse të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut", Qendra AIRE dhe Mbrojtësit e të Drejtave Civile, shtator 2020.

[3] Shih zhvillimin e praktikës gjyqësore nga *L.C.B. k. Mbretërisë së bashkuar*, vendimi i 9 qershorit 1998, Nr. 23413/94, dhe *Osman k. Mbretërisë së bashkuar*, vendimi i Dhomës së Madhe i 28 tetorit 1998, Nr. 23452/94 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim), në *Lopes de Sousa Fernandes k. Portugalisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 19 dhjetorit 2017, Nr. 56080/13 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim), si dhe *Feilazoo k. Maltës*,

të cilët përgjegjësinë e merr Shteti ose në lidhje me ata/ato që janë veçanërisht të cenueshëm^[4].

Nga ana tjetër, në përpjekje për të vepruar në përputhje me këto detyrime, Shtetet Anëtare zbatuan masa pa precedent siç ishin mbylljet brenda në shtëpi, karantinat, distancimin e detyruar social dhe mburoja, të cilat nga ana e tyre ndërhyjnë tek të drejta të tjera të Konventës^[5]. Këto terma përmenden rregullisht gjatë tërë këtij Udhërrëfyesi, dhe më poshtë jepen përkufizimet e secilës prej tyre.

“Mbyllja brenda (në shtëpi)” është term i marrë nga praktikat e burgjeve amerikane. Ajo përshkruan situatën ku të burgosurit janë të privuar nga liritë e tyre normale si aktivitetet rekreative dhe shoqërimi për shkak të një emergjence të përkohshme brenda burgut. Në kontekstin e Covid-19, termi përdoret si analogji për të përshkruar kufizimet mbi lirinë e lëvizjes dhe kontakteve brenda dhe jashtë familjeve dhe grupeve të cilat imponohen si masa të përgjithshme ndaj popullatës së gjerë me qëllim të kufizimit të përhapjes së virusit. Këto masa i aplikohen secilit/ës pavarësisht nëse identifikohen si bartës të dyshuar të virusit apo si viktime të tij. Ka përjashtime nga aplikimi i masave të cilat specifikohen në ligjet dhe rregulloret përkatëse ose në udhërrëfyesit e qeverisë. Pra, mbyllja brenda është zakonisht kufizim i lirisë dhe gëzimit të jetës familjare, sociale dhe ekonomike.

“Karantinë” është termi që përdoret për të përshkruar masat e marra ndaj individëve të caktuar ose anëtarëve të grupeve të caktuara të cilët janë identifikuar si të tillë që vuajnë nga virusi ose të cilët dyshohen të jenë bartës faktikë ose të dyshuar të tij. Njerëzit në karantinë zakonisht kufizohen në brendi të një lokacioni të specifikuar, dhe nuk lejohen të largohen prej aty për asnjë arsye deri sa të kalojë rreziku që ata përbëjnë për të tjerët. Karantina zakonisht shkon përtej kufizimeve të “mbylljes brenda” dhe mund të përbëjë privim ose kufizim të lirisë në varësi të shumë faktorëve.^[6]

vendimi i 11 qershorit 2021, Nr. 56080/19 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim). Shih gjithashtu <https://www.ejiltalk.org/part-iii-due-diligence-and-covid-19-states-duties-to-prevent-and-halt-the-coronavirus-outbreak> “Zelli i Duhur dhe Covid-19: Detyrat e Shteteve për të parandaluar dhe për t'i dhënë fund shpërthimit të koronavirusit”, Antonio Coco, Talita de Souza Dias, 24-25 mars 2020, Pjesët I, II dhe III.

- [4] Shih *Qendra për Burime Ligjore në emër të Valentin Câmpeanu k. Rumanisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 17 korrikut 2004, Nr. 47848/08 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).
- [5] Për një analizë të gamës së gjerë të çështjeve që dolën nga kriza e pandemisë shih “*Shteti i së drejtës, shteti i përjashtimit dhe lirive publike*” (“État de droit, état d’exception et libertés publiques”), Françoise Tulken dhe Saba Parsa, Anthemis, 2022.
- [6] Gama e faktorëve të përfshirë në marrjen e vendimit nëse një masë përbën privim të lirisë ose kufizim të lirisë së

“**Mburoja**” (ose mbrojtja) është term që përdoret për të përshkruar praktikën e mbrojtjes së individëve klinikisht të prekshëm nga Covid-19, të cilët, nëse infektohen, rrezikojnë të sëmuren rëndë. Këta individë këshillohen nga qeveria të ‘mbrojnë’ veten prej pjesës tjetër të popullatës për të evituar rrezikun e infektimit. Varësisht nga niveli i rrezikut që i atribuohet atij individ, kjo thjesht mund të përfshijë respektimin strikt të udhëzimeve për distancim social ose ‘mbrojtje totale’ duke shmangur krejtësisht supermarketet, grumbullimet dhe kontaktet jashtë shtëpisë. Kështu, individëve të prekshëm u kërkohet të ndjekin disa rregulla më të kujdesshme sesa pjesa tjetër e popullatës. Megjithatë, ndryshe nga masat e distancimit social, mbylles brenda dhe karantinës, mburoja (mbrojtja) përgjithësisht bëhet për mbrojtje personale individuale.

“**Distancimi social**” është një term që përshkruan udhëzimet që synojnë të minimizojnë kontaktet (normalisht me ata jashtë ‘shtëpisë’ së individit) e rrjedhimisht rrezikun e transmetimit përmes kontaktit. Organizata Botërore e Shëndetësisë rekomandon një distancë prej së paku një metër mes individëve në shtëpi. Kështu, udhëzimet për distancim social në Evropë dallojnë mes Shteteve prej një metër deri në dy metra. Individët dhe bizneset mund të marrin gjoba për dështimin e respektimit të udhëzimeve për distancim social.

Përveç kësaj, ndërkohë që u zhvilluan vaksinimi dhe ambientet e testimit, po kështu u zhvilluan edhe politika të reja të vaksinimit, ku për të udhëtuar, për t’u tubuar, për të hyrë në ambiente publike dhe private, dhe në disa raste edhe për të ushtruar profesionin, u bë kusht statusi i vaksinimit dhe/ose paraqitja e testit negativ të Covid-19^[7]. Ka pasur ndërhyrje tek shumë të drejta të Konventës si rezultat i miratimit të masave për mbrojtjen e shëndetit, përfshirë ato që u përmendën më lart. Për shembull, e drejta e jetës private dhe familjare, e drejta për të lëvizur lirshëm në vendin e vet dhe për të protestuar. Shkollat, objektet e kultit fetar dhe bizneset u mbyllën, duke ngritur çështje në lidhje me të drejtën e arsimit, të drejtën e adhurimit të fesë, të drejtën e lirisë së shprehjes dhe të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë. Më tej, qasja në gjykata u kufizua dhe koha e procedurave civile dhe penale u zgjat.

lëvizjes diskutohet me hollësi në seksionin mbi Nenin 5 (E drejta e lirisë) në Kapitullin I të këtij publikimi.

[7] Shih, për shembull, kronologjinë e masave të marra nga Komisioni Evropian në reagimin ndaj pandemisë Covid-19, përfshirë mbështetjen për shtrirjen e vaksinimeve në tërë Evropën: https://ec.europa.eu/info/live-work-travel-eu/coronavirus-response/timeline-eu-action_en.

Megjithatë, analiza në Kapitullin I nuk kufizohet me pyetjet dhe situatat e reja që dolën në pah veçanërisht gjatë pandemisë. Ai gjithashtu thekson dhe shpjegon parimet e përgjithshme të aplikuara nga Gjykata në praktikën gjyqësore relevante, të cilat janë të aplikueshme në çdo situatë emergjente si dhe në çdo situatë në të cilën Shtetet duhet të balancojnë shumë të drejta të cilat duken si në konkurrencë me njëra-tjetrën.

Pas miratimit të ligjeve kombëtare të emergjencës, disa Shtete gjithashtu zgjedhën të bënin derogim nga Konventa mbi bazën e Nenit 15, duke nxitur reagimin e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës (prej këtu Sekretari i Përgjithshëm)^[8]. Pandemia përfaqëson herën e parë në historinë e Konventës ku Shtetet reagues ndaj të njëjtës situatë emergjente dhe problemeve shumë të ngjashme në mënyra kaq të ndryshme. Dallimet në qasjet e ndërmarra nga Shtetet për sa i përket derogimit sipas nenit 15 të KEDNj-së, deklarimi i gjendjes së emergjencës kombëtare dhe procedurat e përdorura për të futur masat e emergjencës, ofrojnë një studim të dobishëm krahasues mbi rëndësinë dhe dobinë e derogimit nga KEDNj-ja. Prandaj, Kapitulli II i Pjesës 1 të këtij Udhërrëfyese merr në shqyrtim vendimet e marra për të deroguar ose për të mos deroguar nga Konventa gjatë pandemisë, dhe shpjegon procedurën dhe kushtet e derogimit sipas KEDNj-së gjatë periudhave të emergjencës më përgjithësisht.

Edhe kur Shtetet nuk deklaruan gjendjen e emergjencës, pandemia Covid-19 i nxiti shumë prej tyre që të miratonin masa të reja legjislative dhe administrative, dhe në shumë raste Shtetet i dhanë fuqi të pazakonta ekzekutivit për të hartuar dhe zbatuar masa të cilat zakonisht janë jashtë fushës së tyre të kompetencës. Përrjashtimisht, operimi i institucioneve të zgjedhura në mënyrë demokratike dhe gjyqësorit ose u ndërpre ose u kufizua për pak javë, dhe në disa raste për më gjatë. Kjo u vu re në mënyrë të veçantë në vendet e Ballkanit Perëndimor. U ngritën shqetësime rreth faktit nëse kjo situatë mund të rrezikonte shtetin e së drejtës dhe demokracinë, dy parime të Konventës pa të cilat do të ishte thuajse e pamundur të mbrohen të drejtat e njeriut^[9]. Në shumë Shtete u ndërmorën

[8] [https://rm.coe.int/sg-inf-2020-11-respecting-democracy-rule-of-law-and-human-rights-in-th/16809e1f40_SG/Inf\(2020\)11_7_prill_2020](https://rm.coe.int/sg-inf-2020-11-respecting-democracy-rule-of-law-and-human-rights-in-th/16809e1f40_SG/Inf(2020)11_7_prill_2020), "Respektimi i demokracisë, shtetit të së drejtës dhe të drejtave të njeriut në kuadër të krizës sanitare të Covid-19 – Paketë instrumentesh për Shtetet Anëtare".

[9] Shih "Testi i Stresit i Shtetit të së Drejtës – Reagimi i Shteteve Anëtare të BE-së ndaj Covid-19", Michael Meyer-Resende dhe Théo Fournier", Democracy Reporting International, maj 2020, në www.democracy-reporting.org dhe <https://democracy-reporting.org/en/office/EU/publications/emergency-measures-and-the-rule-of-law-in-the-age-of-covid-19> "Masat emergjente dhe shteti i së drejtës në kohërat e Covid-19, Jakub Jaraczewski, 31

qasje të ndryshme për të siguruar funksionimin e vazhdueshëm të legjislaturës dhe gjyqësorit, duke miratuar procedura të ndryshme për shqyrtimin e masave të future për t'iu kundërpërgjigjur pandemisë. Megjithatë, ka rëndësi të theksohet se, sipas Konventës, pavarësisht nga zgjedhja e supozuar e Shteteve Anëtare kur u përballën me pandeminë, me ose pa derogim, veprimet e tyre duhet të jenë gjithmonë në përputhje me fjalën, parimet dhe frymën e Konventës.

Për këtë arsye, Kapitulli III i Pjesës 1 i kushtohet garancive institucionale dhe procedurale gjatë situatave të krizës. Ky Kapitull thekson rëndësinë e gjyqësorit, parlamentit dhe formave të tjera të shqyrtimit të masave emergjente dhe nevojën që parimet e ligjshmërisë dhe proporcionalitetit të jenë qendrore në çdo reagim ndaj emergjencës. Këto parime përbëjnë themelet e sistemit të Konventës dhe aplikohen si në situata normale, ashtu edhe në ato të jashtëzakonshme. Ato janë relevante, në lidhje me situata emergjente, pavarësisht nëse Shtetet Anëtare kanë deroguar sipas Nenit 15 ose jo. Më tej, ky Kapitull analizon garancitë institucionale dhe rolin e tyre kritik në sigurimin që parimet e ligjshmërisë dhe proporcionalitetit të respektohen si duhet gjatë krizës së Covid-19. Këto parime, dhe mënyra se si institucionet monitorojnë aplikimin e tyre, janë tepër të rëndësishme për të vlerësuar pajtueshmërinë me Konventën të çdo mase të marrë nga qeveritë për t'iu përgjigjur emergjencës.

Pjesa 2 e Udhërrëfyesit, si gjithmonë, përfshin përmbledhje të vendimeve të Gjykatës të cilat konsiderohen relevante për temat e trajtuara. Në këtë rast, kjo përfshin çështje të cilat dolën gjatë pandemisë Covid-19, të lidhura direkt me masat e marra nga Shtetet për të reaguar ndaj pandemisë, përveç çështjeve që datojnë para pandemisë por të cilat kanë të bëjnë nga afër me shqetësimet për të drejtat e njeriut që dolën në pah gjatë pandemisë.

Një sërë vendimesh përfundimtare dhe vendimesh për pranueshmërinë në lidhje me pandeminë Covid-19 tani janë marrë nga GjEDNJ. Megjithatë, shumë kërkesa në lidhje me pandeminë Covid-19 ende mbeten në pritje para GjEDNJ-së dhe gjykatave të tjera^[10], dhe jurisprudenca e realizuar deri tani nuk e mbulon

mars 2020.

[10] Në juridiksione të tjera si Shtetet e Bashkuara, ka pasur rritje të padive grupore në lidhje me masat dhe kufizimet e Covid-19. Shih, për shembull, <https://www.pierceatwood.com/alerts/class-action-litigation-related-covid-19-filed-and-anticipated-cases-2020#Event%20Cancellation%20and%20Service%20Disruption>, "Paditë Grupore Lidhur me Covid-19: Çështje të depozituara dhe të pritura në vitin 2020", përditësimi i fundit më 9 mars 2021.

tërësinë e gamës së gjerë të çështjeve që kanë dalë në pah. Si rezultat, Pjesët 1 dhe 2 të Udhërrëfyesit gjithashtu diskutojnë në praktikën gjyqësore relevante ekzistuese të GJEDNJ-së, për shembull në lidhje me mbrojtjen e shëndetit të personave të cilët janë në paraburgim ose për të cilët shteti ka marrë përsipër përgjegjësinë, trajtimin mjekësor të personave të cenueshëm dhe të drejtat e personave që marrin trajtim mjekësor. Pjesa 1 po ashtu përfshin referenca ndaj shumë vendimeve të ndryshme të gjykatave vendase në lidhje me masat e marra nga qeveritë e tyre si reagim ndaj pandemisë.

Ndërkohë që situata është sigurisht pa precedent në historinë e Konventës, dhe shpërthimi i pandemisë Covid-19 nuk ishte i parashikuar, në këtë pikë duhet të shënohet gjithashtu që KEDNJ është hartuar duke qenë e vetëdijshme për impaktin e sëmundjeve ngjitëse si lija, kolera, poliomieliti dhe gripi (influenza). Hartuesit në fundin e viteve 1940 do të kishin përjetuar epideminë e "gripit spanjoll" të viteve 1918-1920 i cili shkaktoi vdekjen e prej 17 milionë deri në 50 milionë njerëz anembanë botës.^[11] Në atë kohë, karantina e detyrueshme dhe masat e ngjashme ishin në mesin e mekanizmave të vetme për të përmbajtur përhapjen e sëmundjeve të tilla, meqenëse vaksinat dhe trajtimet e tjera mjekësore ishin ende të proces të zhvillimit. Për shembull, vakcina e poliomielitit nuk u zhvillua deri në vitet 1950.^[12]

Hartuesit e Konventës pra ishin personalisht të vetëdijshëm për nevojën e instrumenteve për përmbajtjen e përhapjes së sëmundjeve ngjitëse, kështu që ata i futën mekanizma të tilla në tekstin e Konventës. Neni 5 § 1 (e) (lejimi i paraburgimit të ligjshëm të personave për parandalimin e përhapjes së sëmundjeve ngjitëse) dhe Neni 2 § 3 i Protokollit Nr. 4 (lejimi i kufizimeve në ushtrimin e të drejtave për lëvizjen e lirë për mbrojtjen e shëndetit) janë dy shembuj relevantë të kësaj.

Është e qartë se korniza e Konventës është hartuar për të siguruar që dispozitat e saj jo vetëm t'i rezistojnë situatave të krizës, por edhe të ndihmojnë në formulimin e regjimeve të Shteteve ndaj këtyre situatave^[13]. Përdorimi i saj nuk u mendua si pengesë për marrjen e masave për mbrojtjen e shëndetit, por si garanci që çdo

[11] <https://www.cdc.gov/flu/pandemic-resources/1918-pandemic-h1n1.html> "Pandemia e vitit 1918 (virusi H1N1 virus)", Qendrat e Kontrollit dhe Parandalimit të Sëmundjeve, faqja e rishikuar së fundi më 20 mars 2019.

[12] <https://www.historyofvaccines.org/timeline/all> "Historia e Vaksinave", Burim i Kolegjit të Mjekëve të Filadelfias.

[13] Shih "Implementimi i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në kohë krize ekonomike", Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, 2013, Seminar për të shënuar hapjen e vitit gjyqësor të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në Strasburg, 25 janar 2013.

masë e marrë të ishte 'e ligjshme' dhe proporcionale. Duhet thënë gjithashtu që Konventa është treguar e suksesshme në funksionimin e saj në shumë Shtete Anëtare gjatë emergjencave; në këto kushte të jashtëzakonshme, mbështetja e mbrojtjes së garantuar nga Konventa është më e rëndësishme se kurrë^[14].

Prandaj, shpresojmë se ky Udhërrëfyes do të jetë një instrument i dobishëm për të gjithë ata/ato që vazhdojnë të interpretojnë dhe zbatojnë të drejtat e Konventës në kontekstin e impaktit në vazhdim të krizës së Covid-19. Përveç kësaj, pandemia Covid-19 ofron një prizëm të dobishëm përmes të cilit të analizohet jurisprudenca e KEDNj-së në lidhje me situatat emergjente në përgjithësi, dhe ky Udhërrëfyes gjithashtu synon të përcaktojë parimet dhe procedurat e zhvilluara gjatë pandemisë, të cilat mund dhe duhet të aplikohen gjatë çdo situatë emergjente.

[14] Shih www.ejiltalk.org/the-myth-and-mayhem-of-build-back-better-human-rights-decision-making-as-the-human-dignity-imperative-in-covid-19, "The Myth and Mayhem of 'Build Back Better': Human Rights Decision-Making and Human Dignity Imperatives in COVID-19", Diane Desierto, 25 maj 2020.

Kapitulli I – Të drejtat e angazhuara nga pandemia e Covid-19 dhe reagimet e Shteteve ndaj pandemisë

Shtetet kanë një detyrim të përgjithshëm sipas KEDNJ-së për të marrë masat e duhura për të mbrojtur individët nga përhapja e Covid-19 dhe infektimi i shmangshëm dhe nga vuajtja e pasojave të tij. Këto detyrime dalin kryesisht nga Nenet 2 (E drejta e jetës), 3 (Mbrojtja nga trajtimi çnjerëzor dhe poshtëruës) dhe 8 (E drejta për respekt ndaj jetës private dhe familjare).

Ky Kapitull eksploron se kur mund të shfaqen situatat në të cilat dalin këto detyrime për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit, dhe fushëveprimin e saktë të detyrimeve pozitive që mund t'u vihen Shteteve sipas Konventës, në kontekstin e pandemisë Covid-19. Gjithashtu, ai shqyrton mënyrat se si janë ndikuar të drejtat e ndryshme të Konventës nga masat e marra prej Shteteve për të mbrojtur jetën dhe shëndetin, dhe përmban analiza lidhur me shkallën deri ku ndërhyrjet tek secila e drejtë mund të shihen si të justifikuar. Kjo analizë merr parasysh numrin e kufizuar të vendimeve rreth pranueshmërisë dhe vendimeve përfundimtare që ka marrë Gjykata që nga marsi 2020 të cilat kanë lidhje direkte me masat e marra gjatë pandemisë Covid-19, dhe njëkohësisht i referohet çështjeve të lidhura me pandeminë Covid-19 të cilat, në kohën e shkrimit, janë ende në proces para Gjykatës. Aty ku duhet, analiza merr për bazë vendimet relevante të gjykatave vendase në lidhje me masat e marra gjatë pandemisë dhe impaktin e tyre tek të drejtat e njeriut. Përndryshe, analiza mbështetet në parimet ekzistuese dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës të cilat mund të aplokohen përmes analogjisë me kontekstin e pandemisë Covid-19 dhe çdo situatë tjetër emergjente.

Çdo seksion i Kapitullit përqendrohet në një të drejtë të ndryshme të Konventës. Megjithatë, njihet fakti që të drejtat e Konventës nuk operojnë *in silo*, dhe që të

kuptuarit e ndërlidhshmërisë së tyre është pjesë jetike e garantimit të mbrojtjes efektive të tyre. Si të tilla, seksionet brenda këtij kapitulli përmbajnë shumë referenca të ndërthurura me pjesë të tjera të publikimit për të theksuar relevancën e të drejtave të tjera për analizën brenda seksionit, dhe për ta orientuar lexuesen/ in drejt diskutimit përkatës mbi këto të drejta në kuadër të këtij publikimi.

1. Neni 2 – E drejta e jetës

Neni 2, e drejta për jetën, është një prej dispozitave themelore në Konventë. Është e drejtë e paderogueshme në kohë paqeje, çka do të thotë se Shtetet nuk mund t'i pezullojnë detyrimet e tyre sipas kësaj dispozite gjatë pandemisë së Covid-19. Neni 2 parashikon:

“1. E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj. Askujt nuk mund t'i merret jeta qëllimisht, me përjashtim të rastit kur zbatohet një vendim gjyqësor me vdekje, pas dënimit për një krim për të cilin ky dënim është parashikuar me ligj.

2. Marrja e jetës nuk konsiderohet të jetë shkaktuar në kundërshtim me këtë nen në rastet kur ajo vjen si pasojë e përdorimit të forcës, që është jo më shumë se absolutisht e nevojshme: (a) në mbrojtje të çdo personi nga dhuna e paligjshme; (b) për të kryer një arrestim të ligjshëm ose për të parandaluar arratisjen e një personi të cilit i është hequr liria ligjërisht; (c) për të kundërshtuar, në përputhje me ligjin, një trazirë ose kryengritje.”

a. Detyrimet pozitive për të mbrojtur jetën

Neni 2 kërkon që Shtetet të përmbahen nga privimi i paligjshëm i jetës (detyrim negativ), dhe gjithashtu të marrin masa për të mbrojtur jetën e atyre që janë brenda juridiksionit të tyre (detyrim pozitiv). Detyrimet pozitive të Shteteve në këtë kontekst mund të marrin forma të ndryshme, përfshirë detyrimet rregulatore dhe detyrimet operacionale, siç analizohen shkurt më poshtë^[15].

[15] Shih Elizabeth Stubbins Bates “Simpoziumi Covid-19: Neni 2 I KEDNj-së, Detyrimet Pozitive – Si mundet e drejta e të drejtave të njeriut të informojë mbrojtjen e personelit shëndetësor dhe pacientëve të cenusëshëm në pandeminë Covid-19?” në <https://opiniojuris.org/2020/04/01/covid-19-symposium-article-2-echrs-positive-obligations-how-can-human-rights-law-inform-the-protection-of-health-care-personnel-and-vulnerable-patients-in-the-covid-19-pandemic/>; M. Baros “Reagimi i Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar ndaj Covid-19 dhe Neni 2 i KEDNj-së (Kreu I Dinjiteti; E drejta e jetës, Karta e të Drejtave Themelore e BE-së)”, 31 gusht 2020, DOI:10.3390/laws9030019Corpus ID: 225212350.

Detyrimet rregullatore

Neni 2 u kërkon Shteteve që të krijojnë një kornizë ligjesh dhe të jetësojnë korniza rregullatore për të mbrojtur jetën.^[16] Kurdo që një Shtet merr përsipër, organizon ose autorizon aktivitete të rrezikshme, ai duhet të sigurohet me anë të një sistemi rregullash dhe kontrollesh të mjaftueshme që rreziku që i kanoset jetës nga ndërmarrja e këtyre aktiviteteve të reduktohet në një minimum të arsyeshëm.^[17] Kjo përfshin rregullimin e licensimit, ngritjen, operimin, sigurimin dhe mbikqyrjen e aktiviteteve që vlerësohen të jenë në vetvete të rrezikshme, në një mënyrë që i përshtatet tipareve të veçanta të aktivitetit në fjalë.^[18] Shtetet duhet ta bëjnë të detyrueshme për të gjitha palët e përfshira që të marrin masa praktike për të siguruar mbrojtjen e qytetarëve jeta e të cilëve mund mund të rrezikohet nga rreziqet e ngërthyera në aktivitetet e ndërmarrja. Këto detyra, të cilat mund të jenë të vështira edhe në rrethana normale, mund të bëhen edhe më rraskapitëse kur autoritetet duhet të përpiqen edhe që të kontrollojnë sjelljen e qytetarëve gjatë periudhave të emergjencave. Për shembull kur kontrollohen lëvizjet e njerëzve, koha dhe kushtet në të cilat ata lejohen të dalin jashtë, dhe kufizimi i tubimeve masive dhe demonstratave, përfshirë demonstratat kundër masave të jashtëzakonshme. Në këto kushte, kërkohet kujdes i veçantë në marrjen e masave operacionale për t'u siguruar që të mos përdoret forcë e tepërt ose vdekjeprurëse me pretendimin e mbrojtjes së njerëzve nga përhapja e Covid-19 dhe për t'u siguruar që masat e zbatuara operacionale të jenë të humultuara mirë dhe të justifikuara nga kërkimet shkencore përkatëse^[19].

Aktivitetet e "organizuar" ose "autorizuar" nga Shteti, të cilat zakonisht vlerësohen të sigurt, gjatë pandemisë u bënë vetvetiu të rrezikshme thjesht për shkak se përfshijnë kontaktet me njerëz të tjerë e rrjedhimisht kërcënim për infektim me Covid-19. Kjo përfshinte, për shembull, shkuarjen në shkollë, punë,

[16] *Lopes de Sousa Fernandes k. Portugalisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 19 dhjetorit 2017, Nr. 56080/13, § 166 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim); *Lambert dhe të Tjerë k. Francës*, vendim i Dhomës së Madhe i 5 qershorit 2015, Nr. 46043/14, § 140; *Oyal k. Turqisë*, vendim i 23 marsit 2010, Nr. 4864/05, § 54 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[17] *Mučibabić k. Serbisë*, vendim i 12 korrikut 2016, Nr. 34661/07, § 126.

[18] *Cevrioğlu k. Turqisë*, vendim i 4 tetorit 2016, Nr. 69546/12, § 57.

[19] Shih për shembull *Abi Dymond dhe Neil Corney, "COVID-19, Pëlqimi dhe detyrimi: Udhërrëfyes i ri i OKB-së mbi armët më pak vdekjeprurëse të zbatimit të ligjit në kontesktin e koronavirusit"*, 22 maj 2020. Në <https://www.ejiltalk.org/covid-19-consent-and-coercion-new-united-nations-guidance-on-less-lethal-weapons-in-law-enforcement-in-the-context-of-the-coronavirus/>.

spitale, qendra argëtimi, biblioteka, muze, dyqane, dhe shfrytëzimi i transportit publik. Detyrimet rregullatore sipas Nenit 2 kërkojnë që qeveritë të jetësojnë korniza rregullatore për të siguruar udhërrëfimin e duhur për shëndetin dhe sigurinë, dhe në këto hapësira futen dhe ndiqen procedura për të parandaluar përhapjen e Covid-19.^[20] Për shembull, një udhërrëfyes dhe rregullore të tilla mund të ofrojnë këshillim se si të sigurohet distancimi social, të kërkojnë vendosjen e xhamave ndarës mes njerëzve kur janë afër njëri-tjetrit, ose detyrimi për mbajtjen e maskave të fytyrës në vende të caktuara, si në transportin publik. Përndryshe, varësisht nga shkalla e rrezikut të kanosur, mund të vlerësohet e nevojshme që të mbyllet ose të kufizohet qasja fizike ndaj këtyre vendeve/shërbimeve nëqoftëse nuk mund të ngrihen sisteme që ato të mund të rrinë hapur pa përbërë kërcënim për jetën.

Spitalet

Në kontekstin e shëndetit publik, Shteteve u kërkohet të miratojnë rregullore që detyrojnë spitalet, qofshin publike ose private, që të marrin masa për mbrojtjen e jetës së pacientëve dhe stafit.^[21] Detyrimet pozitive të një Shteti në këtë kontekst duhet të reagojnë ndaj konteksteve që ndryshojnë, sipas të dhënave dhe informatave në dispozicion. Për të siguruar një reagim ndaj Covid-19 në përputhje me Nenin 2, atëherë qeverive duhet t'iu kërkohet që të ndryshojnë dhe të përditësojnë rregulloret që qeverisin operimin e spitaleve brenda juridiksioneve të tyre në përpjekje për të mbrojtur jetën e pacientëve dhe stafit nga kërcënimi ndaj jetës prej Covid-19.

Detyrimet operacionale për të marrë masa parandaluese

Shtetet gjithashtu kanë detyrimin për të marrë masa operacionale parandaluese për të mbrojtur individët nga kërcënime të veçanta ndaj jetës që dalin nga 'situatat e rrezikshme',^[22] në kontekst të aktiviteteve private dhe publike,^[23] kur Shteti e ka ditur ose, me arsye, duhet ta ketë ditur për kërcënimin (testi Osman).^[24] Kjo detyrë

[20] *Vilnes dhe të Tjerë k. Norvegjisë*, vendim i 5 dhjetorit 2013, Nr. 52806/09, Nr. 22703/10.

[21] *Calvelli dhe Ciglio k. Italisë*, vendim i 17 janarit 2002, Nr. 32967/96 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[22] *Stoyanovi k. Bullgarisë*, vendim i 9 nëntorit 2010, Nr. 42980/04.

[23] *Oneriydiz k. Turqisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 30 nëntorit 2004, Nr. 48939/99 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[24] I ashtuquajturit testi Osman i elaboruar për herë të parë nga Dhoma e Madhe në çështjen *Osman k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i Dhomës së Madhe i 28 tetorit 1998, Nr. 23452/94, § 116 (i përfshirë si përmbledhje në këtë

shtrihet më tej duke parandaluar vdekjet që ndodhin nga fatkeqësitë industriale, mjedisore dhe natyrore.^[25] Praktika gjyqësore e Gjykatës në lidhje me sëmundjet ngjitëse është e kufizuar,^[26] dhe ende nuk është shqyrtuar nëse Covid-19 do të hynte brenda përkufizimit të një 'rreziku natyror' apo një kategorie tjetër.

Testi Osman

Testi Osman, i përmendur më lart, sugjeron që:

“Duhet të përcaktohet, në mënyrë bindëse (për Gjykatën), që autoritetet e kanë ditur, ose duhet ta kenë ditur në atë kohë ekzistencën e një rreziku real dhe të afërt ndaj jetës së një individi ose individëve të identifikuar nga aktet kriminale të një pale të tretë dhe që ato kanë dështuar në marrjen e masave brenda fushëveprimit të fuqive të tyre të cilat, nëse gjykohen në mënyrë të arsyeshme, mund të ketë qenë e pritshme që ta shmangnin atë rrezik.”

(i) A del detyrimi operacional për të marrë masa për parandalimin e vdekjeve nga Covid-19?

Mund të thuhet që Shtetet evropiane kanë qenë në dijeni të kërcënimit të kanosur nga Covid-19 dhe rrezikut të përhapjes së virusit drejt dhe brenda juridiksioneve të tyre qysh prej janarit 2020. Nëse është kështu, Covid-19 mund të vlerësohet se përbën kërcënim të veçantë për jetën për të cilin Shteti e ka ditur ose me arsye duhet ta ketë ditur, dhe kundër të cilit Shteti ka për detyrim të mbrojtë qytetarët e vet.

publikim).

[25] Për shembull, vdekjet si rezultat i një shpërthimi aksidental në një grupë hedhurinash afër një qyteze me baraka (*Öneryıldız k. Turqisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 30 nëntorit 2004, Nr. 48939/99 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim)); humbja e jetës me rastin e rrëshqitjes së parashikueshme të baltës për shkak të dështimit të autoriteteve për të vënë në jetë politika të planifikimit të tokës dhe të ndihmës në raste emergjencash (*Budayeva dhe të Tjerë k. Rusisë*, vendim i 20 marsit 2008, Nr. 15339/02, Nr. 21166/02, Nr. 20058/02, Nr. 11673/02 dhe Nr. 15343/02 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim)); dhe vdekja si rezultat i ekspozimit të gjatë ndaj asbestos në një kantier detar të administruar nga Qeveria (Brincat dhe të Tjerë kundër Maltës).

[26] *Shih Enhorn k. Suedisë*, vendim i 25 janarit 2005, Nr. 56529/00; *Oyal k. Turqisë*, vendim i 23 marsit 2010, Nr. 4864/05 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

Vështirësia me një pandemi si Covid-19 është që identifikimi i individit ose individëve jeta e të cilëve është në rrezik është pothuaj i pamundur, meqenëse e tërë popullata e një Shteti mund të infektohet. Ky faktor është i rëndësishëm deri në atë masë ku Neni 2 angazhohet në dy mënyra. Së pari, në mënyrë që një individ të mund të pretendojë të jetë "viktimë" e një shkeljeje të Konventës, brenda kuptimit të Nenit 34 (kërkesat individuale), individi në fjalë duhet:

- » Të tregojë se ai ose ajo është "prekur direkt" nga masa e ankimuar; dhe
- » Të paraqesë prova të arsyeshme dhe bindëse të gjasave që ai ose ajo do të preket (ose është prekur) personalisht nga një shkelje e Konventës.

Prandaj, një individ nuk mund të ankohet në kuptim abstrakt rreth pamjaftueshmërisë së masave të marra për të mbrojtur popullatën e gjerë nga efektet e pandemisë Covid-19 (për shembull, dështimi për të ofruar mbrojtjen e duhur me pajisje mbrojtëse personale për punonjësit e shëndetësisë, pacientët, dhe popullatën e gjerë, ose futja e kontrollit masiv për të gjithë). Ai ose ajo duhet të ofrojë informacion specifik rreth gjendjes së vet dhe mënyrës se si dështimet e pretenduara të autoriteteve për të reaguar si duhet ndaj pandemisë kanë ndikuar shëndetin e tij/saj ose jetën e tyre private^[27].

Kjo vështirësi ndikon mbi kriteret e tjera të testit Osman, kriteri për rrezik real dhe të afërt.^[28] Do të ishte e vështirë për cilindo Shtet që ta dijë se cili prej qytetarëve të vet përballet me rrezikun real dhe të afërt të infektimit me Covid-19. Më tej, ata që e kanë marrë Covid-19 e kanë përjetuar në mënyra të ndryshme, ndërkohë që për disa ka qenë virus kërcënues për jetën, të tjerë nuk kanë shfaqur fare simptoma. Prandaj, do të ishte edhe më e vështirë të identifikoheshin ata për të cilët Covid-19 paraqet rrezik real dhe të afërt për jetë, në mesin e atyre në rrezik real dhe të afërt të infektimit me Covid-19^[29]. Megjithatë, kjo vështirësi mund të

[27] *Shih Le Mailloux k. Francës*, vendimi i 5 nëntorit 2020, Nr. 18108/20 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[28] *Shih Talpis k. Italisë*, vendimi i 2 marsit 2017, Nr. 41237/14, dhe sidomos opinionet e ndara të gjyqtarëve Eicke dhe Spano

[29] Për shembull, në qershor 2021, Gjykata e Lartë e Anglisë dhe Uejllsit gjeti se nuk kishte një detyrim të përgjithshëm të Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar sipas Nenit 2 për të ofruar strehim për të gjithë azilkërkuarit e varfër të cilëve u refuzohet kërkesa për azil në vend, për t'i mbrojtur ata nga të jetuarit në ambiente të mbipopulluara ku rreziku i marrjes së Covid-19 ishte më i madh. Gjykata e Lartë rrezoi një vendim të gjykatave më të ulëta i cili kërkonte që qeveria të ofronte strehim për individin në fjalë sepse vendimi i gjykatës më të ulët u vlerësua se ishte bazuar tërësisht mbi rrezikun e përgjithshëm që u kanosej azilkërkuarve të varfër "si klasë" dhe "publikut të gjerë" nga infektimi prej anëtarëve të asaj klase. Gjykata mori parasysh faktin se rreziku i kanosur nga Covid-19 ndryshon

barazpeshohet me faktin që ka qenë e mundur të identifikohen grupe njerëzish të cilët janë më shumë 'në rrezik' të marrjes së Covid-19^[30] ose të cilët janë më të ndjeshëm ndaj efekteve të tij, për shembull të moshuarit ose ata me sëmundje paraekzistuese.^[31] Koha dhe natyra e ndërhyrjes nga autoritetet gjithashtu ka rëndësi. Nëqoftëse identifikohet një grup posaçërisht i ndjeshëm ose në rrezik, Shteteve mund t'u duhet që të marrin masa pozitive për të mbrojtur njerëzit në këtë grup para se të mund të bëhen ankesa individuale ose kërkesa për ndihmë. Një grup i tillë mund të përfshijë profesionistët e kujdesit shëndetësor të cilët kanë më shumë gjasa të jenë vazhdimisht të ekspozuar ndaj virusit^[32].

(ii) Fushëveprimi i detyrimit operacional

Nëse përcaktohet që Shteti nuk e ka detyrimin operacional për të marrë masa për të mbrojtur jetën nga Covid-19, është e paqartë tamam se çfarë do të ngërthente ajo detyrë. Shtetet zakonisht kanë hapësirë të gjerë vlerësimi në

nga personi në person varësisht nga një sërë faktorësh, përfshirë veçanërisht moshën. Meqenëse nuk kishte pasur vlerësim të individualizuar të rreziqit që i kanosej individit në fjalë, ai nuk kishte demonstruar një "rrezik real, të afërt dhe serioz ndaj jetës së tij" siç do të ishte kërkuar për t'i dhënë shkas detyrimit nga Neni 2. Shih: R (Sekretari i Shtetit për Departamentin e Punëve të Brendshme) k. Tribunalit të Shkallës së Parë (Dhoma e Përfitimeve Sociale (ang. Social Entitlement Chamber)), vendim i 21 qershorit 2021 [2021] EWHC 1690 (Admin).

[30] Për shembull, ata/ato që punojnë në profesione të caktuara ku kanë më shumë gjasa të kenë kontakt me njerëz të tjerë e rrjedhimisht të infektohen me Covid-19, siç janë profesionistët shëndetësorë. Shih <https://www.ons.gov.uk/employmentandlabourmarket/peopleinwork/employmentandemployeetypes/articles/whichoccupationshavethehighestpotentialexposuretothecoronaviruscovid19/2020-05-11> "Cilat profesione kanë më potencialin më të madh për t'u ekspozuar ndaj koronavirusit?", Zyra Kombëtare e Statistikave, 11 maj 2020.

[31] Shih <https://www.who.int/westernpacific/emergencies/covid-19/information/high-risk-groups> "COVID-19: grupet e prekshme dhe ato me rrezikshmëri të lartë", Organizata Botërore e Shëndetësisë, Rajoni i Paqësorit Perëndimor.

[32] Për shembull, në Spanjë, Dekreti Mbretëror 463/2020 i 14 marsit 2020, deklaroi gjendjen e jashtëzakonshme dhe vuri detyrimin që autoritetet shëndetësore të merrnin masa të menjëhershme dhe efektive për të mbrojtur profesionistët e shëndetësisë në tërë territorin kombëtar. Më 30 mars 2020, Konfederata Kombëtare e Sindikatave të Mjekësisë në Spanjë hapën çështje në Gjykatën Supreme të Spanjës në të cilën argumentuan se Ministria e Shëndetësisë i kishte shpërfillur këto detyrime duke dështuar në sigurimin e pajisjeve mbrojtëse të mjaftueshme për stafin e infermierëve/eve në fillim të pandemisë. Gjykata Supreme gjeti se, për shkak të mos-aktivitetit të Ministrisë së Shëndetësisë, profesionistve shëndetësorë u kishin munguar pajisjet e nevojshme për t'u mbrojtur nga Covid-19, çka përfaqëson rrezik serioz për shëndetin e tyre dhe të drejtat e tyre për integritet fizik dhe moral. Shih Tribunal Supremo, Sala de lo Contencioso-Administrativo, vendim i 08.10.2020, Nr. STS 3024/2020.

lidhje me metodat e zgjedhura për të përmbushur detyrat e veta operacionale. Autoriteteve nuk mund t'i ngarkohet një barrë e pamundur ose joproportionale, dhe duhen marrë në konsideratë edhe kufijtë e prioriteteve konkurruese dhe burimet e kufizuara.^[33]

Në vlerësimin e fushëveprimit të detyrimeve operacionale pozitive të Shtetit, dhe nëse Shteti ka vepruar në pajtim me to, Gjykata do të marrë në konsideratë rrethanat e veçanta të rastit, përfshirë ligjshmërinë vendase të veprimeve ose mosveprimeve të autoriteteve, procesin vendas të vendimmarrjes, përfshirë faktin nëse janë marrë apo jo parasysh hulumtimet dhe studimet përkatëse, kompleksitetin e çështjes, sidomos kur bëhet fjalë për përplasje mes interesave të Konventës, origjina e kërcënimit, shkalla deri ku rreziku mund të lehtësohet, dhe deri në ç'masë ky rrezik vjen nga një kërcënim i definuar qartë.^[34]

Këto janë disa prej faktorëve që lënë të kuptohet se me gjasë Shteteve do t'u lejohet hapësirë e gjerë vlerësimi në lidhje me masat operacionale që ato zgjedhin për të parandaluar vdekjet si rezultat i Covid-19. Shumë prej rasteve të mëparshme në të cilat është gjetur shkelje e detyrës operacionale sipas Nenit 2 kanë lidhje me ngjarje diskrete, rreth të cilave Shteti ka pasur dijeni të qartë dhe ka qenë i paralajmëruar. Fushëveprimi dhe natyra vazhdimisht e ndryshueshme e pandemisë Covid-19, që ka të bëjë me daljen e një virusi të ri, e bën më kompleks rrezikun ndaj të cilit duhet reaguar. Njohuritë shkencore dhe të kuptuarit e shkaqeve dhe impaktit të Covid-19 janë ende në zhvillim e sipër. Në fillim të pandemisë, kishte shumë pak studime relevante për t'u konsultuar gjatë procesit të vendimmarrjes se si t'i bëhej ballë situatës. Ato studime që ishin në dispozicion, ose ato që dolën në fillim të pandemisë, jo domosdoshmërisht identifikuan një reagim definitiv që mund të thuhet se Qeveritë duhet ta kishin ndërmarrë dhe i cili do t'i kishte vënë ato në pajtueshmëri me detyrimet nga Neni 2.

Arsyet e një Shteti për dështimin në sigurimin e këtyre pajisjeve ose marrjen e masave të caktuara do të ishin po ashtu konsideratë e rëndësishme^[35]. Për

[33] *Budayeva dhe të Tjerë k. Rusisë*, vendim i 20 marsit 2008, Nr. 15339/02, 21166/02, 20058/02, 11673/02 dhe 15343/02 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[34] *Budayeva dhe të Tjerë k. Rusisë*, vendim i 20 marsit 2008, Nr. 15339/02, 21166/02, 20058/02, 11673/02 dhe 15343/02, §§ 136-137 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim); *Kolyadenko dhe të Tjerë k. Rusisë*, vendim i 28 shkurtit 2012, Nr. 17423/05, 20534/05, 20678/05, 23263/05, 24283/05 dhe 35673/05, § 161.

[35] Për shembull, në çështjen spanjolle Tribunal Supremo, Sala de lo Contencioso-Administrativo, vendimi i 8 tetorit 2020, Nr. STS 3024/2020 (shih fn 36 lart), autoritetet spanjolle ishin zotuar të ofronin pajisje personale

shembull, mund të ketë kufizime praktike të burimeve si pasojë e kërkesës globale për pajisje të tilla.

Megjithatë, edhe në kontekstin e fatkeqësive mjedisore që Shtetet nuk i kontrollojnë dot, Gjykata ka vendosur që Shtetet kanë detyrimin që të marrin masa operacionale parandaluese për të fuqizuar kapacitetin e tyre për të trajtuar natyrën e papritur dhe të dhunshme të dukurive të tilla natyrore.^[36] Natyra e papritur dhe e paparashikueshme e pandemisë mund të nënkuptojë që Shtetet do të kishin hapësirë më të gjerë vlerësimi sa i përket mënyrës se si reagojnë ndaj saj, por nuk është arsye për të sugjeruar se ato nuk kanë fare detyrime operacionale sipas Nenit 2.

Më tej, gjatë vazhdës së pandemisë, u bë gjithnjë e më e qartë se disa faktorë të caktuar, si shmangia e kontaktit të afërt me të tjerët dhe mbajtja e pajisjeve mbrojtëse personale, ndihmonin në reduktimin e rrezikut të përhapjes së virusit. Prandaj detyrimet operacionale të nisura prej janarit 2020 e më tej mund të përfshijnë një detyrim për të porositur paraprakisht pajisje mbrojtëse personale (ang. PPE) dhe ventilatorë, për të siguruar pajisje mbrojtëse për punonjësit,^[37] ose për të imponuar mbylljet brenda apo masa të distancimit social, duke marrë parasysh këshillat shkencore të dhëna në atë kohë dhe duke vepruar në mënyrë të kohshme.

Gjykata gjithashtu ka njohur se programet e vaksinimit mund të jenë mjet legjitim i mbrojtjes kundër sëmundjeve të cilat mund të përbëjnë rrezik serioz për shëndetin. Kjo i referohet si atyre që i marrin vaksinat, ashtu edhe atyre që nuk mund të vaksinohen e që rrjedhimisht janë në kushte më të cënueshme, duke u mbështetur në arritjen e një niveli të lartë të vaksinimit të shoqërisë së gjerë për t'u mbrojtur kundër sëmundjeve ngjitëse në fjalë^[38]. Prandaj, zbatimi i programit të vaksinimit përkon me qëllimet e mbrojtjes së shëndetit dhe mbrojtjes së të

mbrojtëse si metodë e njohur dhe efektive për të ruajtur profesionistët shëndetësore, dhe dështimi i tyre për t'i ofruar këto pajisje u gjet se ishte për shkak të "mos-aktivitetit" të autoriteteve, dhe jo për shkak të mungesës së burimeve.

[36] *M. Özel dhe të Tjerë k. Turqisë*, vendim i 17 nëntorit 2005, Nr. 14350/05, 15245/05 dhe 16051/05, § 173.

[37] *Shih Brincat k. Maltës*, vendim i 24 korrikut 2014, Nr. 60908/11, 62110/11, 62129/11, 62312/11 dhe 62338/11, ku dështimi i autoriteteve malteze për të ofruar mbrojtjen e duhur punëtorëve detarë të ekspozuar ndaj asbestos, përfshirë pajisjet e duhura mbrojtëse (maska fytyre), ka shkelur Nenin 2.

[38] *Vavrička dhe të Tjerë k. Republikës Çeke*, vendim i 8 prillit 2021, nr. 47621/13 dhe 5 të tjerë, §272 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

drejtave të të tjerëve, dhe mund të jetë një mekanizëm që hyn brenda fushëveprimit të detyrimit operacional për të mbrojtur njerëzit nga rreziku (shih gjithashtu diskutimin rreth politikave të vaksinimit në seksionin e këtij Udhërrëfyeti: Neni 8: e drejta e jetës private dhe familjare).

(iii) Konstatimi i shkeljes së detyrimit operacional

Për të konstatuar shkelje të detyrimit pozitiv operacional sipas Nenit 2 po ashtu është e nevojshme të përcaktohet lidhja shkakësore mes dështimit të Shtetit për të marrë masa parandaluese dhe vdekjes së një personi. Mund të jetë e vështirë të identifikohet nëse de ku saktësisht një person është infektuar me Covid-19, e po ashtu nëse vdekja e tij/saj mund të ishte shmangur nëse Shteti do ta kishte marrë masën parandaluese të cilën ka dështuar ta marrë.

Detyrimet operationale në kontekst të kujdesit shëndetësor

Ndërkohë që veprimet ose mosveprimet e autoriteteve në fushën e politikave të kujdesit shëndetësor mund të angazhojnë përgjegjësinë si pjesë e detyrimeve rregulatore nga Neni 2,^[39] gabimet në gjykim ose 'thjesht' neglizhenca mjekësore nga ana e stafit mjekësor nuk përbëjnë shkelje të Nenit 2.^[40] Sipas Nenit 2, Shteti duhet të miratojë dispozitat e duhura për të siguruar standarde të larta profesionale për profesionistët shëndetësorë dhe mbrojtjen e jetës së pacientëve, por koordinimi i pakujdesshëm në trajtimin e një pacienti të dhënë përgjithësisht është i pamjaftueshëm për të qenë shkelje e Nenit 2.^[41] Gjykata megjithatë ka vendosur se mund të dalin çështje sipas Nenit 2 kur tregohet se autoritetet kanë vënë ë rrezik jetën e një individi duke i mohuar qasjen në kujdes shëndetësor, gjë që ato janë zotuar ta vënë në dispozicion për tërë popullatën.^[42]

Përndryshe, në kontekst të shëndetësisë, detyrimet operationale pozitive për të mbrojtur jetën dalin vetëm në rrethana të pazakonta:

- i) Kur jeta 'me dijeni vihet në rrezik përmes mohimit të qasjes në trajtim jetëshpëtues'; dhe

[39] *Byrzykowski k. Polonisë*, vendim i 27 qershorit 2006, Nr. 11562/05.

[40] *Powell k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi për pranueshmërinë i 4 majit 2000, Nr. 45305/99.

[41] *Lopes de Sousa Fernandes k. Portugalisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 19 dhjetorit 2017, Nr. 56080/13 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[42] *Cyprus k. Turqisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 10 majit 2000, Nr. 25781/94, § 219.

- ii) kur 'mos-funksionimi sistematik ose strukturor i shërbimeve spitalore rezulton me privimin e pacientit nga qasja në trajtim emergjent jetëshpëtues, dhe autoritetet e kanë ditur ose duhet ta kenë ditur që ekziston ky rrezik dhe kanë dështuar në marrjen e masave të nevojshme për të parandaluar konkretizimin e atij rreziku...'.^[43]

Prandaj, mund të ngrihen akuza potenciale kundër Shtetit për shkelje të Nenit 2 në një çështje individuale, në kontekstin e shëndetësisë, nëqoftëse një person vdes për shkak se nuk i është dhënë qasje në pajisje jetëshpëtuese;^[44] në kontekstin e Covid-19 kjo mund t'i referohet qasjes në ventilator, qasjes së drejtë dhe të barabartë në programin e vaksinimit^[45], ose qasjes së drejtë dhe të barabartë në masat e përgjithshme të mbrojtjes së shëndetit si testimi ose pajisjet mbrojtëse personale, sidomos për stafin shëndetësor që trajton pacientët më të dobët^[46]. Megjithatë, do të duhet të demonstronhet që mohimi ose vonesa e qasjes në këtë trajtim ka rezultuar ose nga neglizhenca e rëndë mjekësore^[47] ose nga një dështim më i gjerë sistematik ose strukturor nga ana e Shtetit për të ndërmarrë masat e nevojshme për të parandaluar konkretizimin e rrezikut.^[48]

[43] *Lopes De Sousa Fernandes k. Portugalisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 19 dhjetorit 2017, Nr. 56080/13, § 192 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[44] *Nitecki k. Polonisë*, vendimi për pranueshmërinë i 21 marsit 2002, Nr. 65653/ 01 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim); *Mehmet Senturk dhe Bekir Senturk k. Turqisë*, vendim i 9 prillit 2013, Nr. 13423/09; *Asiye Genc k. Turqisë*, vendim i 27 janarit 2015, Nr. 24109/07.

[45] Shih Sarah Casella, Profesor i të Drejtës Publike në Universitetin Man, "Qasja e barabartë në vaksinat kundër Covid-19 dhe e drejta ndërkombëtare: kufijtë e logjikës së përjashtimit të shëndetit publik" ("Accès équitable aux vaccins contre la Covid-19 et droit international: les limites de la logique de l'exception de santé publique") <https://blog.leclubdesjuristes.com/acces-equitable-aux-vaccins-contre-la-covid-19-et-droit-international-les-limites-de-la-logique-de-lexception-de-sante-publique-par-sarah-cassella/>.

[46] *Le Mailloux k. Francës*, vendimi i 5 nëntorit 2020, Nr. 18108/20 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim), ku Gjykata gjeti se nëqoftëse kërkuesit ishte mohuar ndihma ose kujdesi në kontekstin e masave të përgjithshme shëndetësore për të cilat ai u ankua (për shembull dështimi për të ofruar testime masive dhe qasja në pajisje mbrojtëse personale), ai do të kishte mundësi të kontestonte pajtueshmërinë e një refuzimi të tillë me Konventën në gjykatat vendase.

[47] Në *Lopes de Sousa Fernandes k. Portugalisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 19 dhjetorit 2017, Nr. 56080/13, § 194 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim) kjo përkufizohet si veprimet dhe mosveprimet e ofruesve të kujdesit shëndetësor të cilat shkojnë përtej thjesht gabimit ose neglizhencës mjekësore, ku ato ofruen të kujdesit shëndetësor, në shkelje të detyrimeve të tyre profesionale, i mohojnë një pacienti trajtimin mjekësor emergjent pavarësisht se janë në dijeni të plotë që jeta e personit vihet në rrezik nëse nuk jepet trajtimi.

[48] *Lopes de Sousa Fernandes k. Portugalisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 19 dhjetorit 2017, Nr. 56080/13, §195 (i

Qasja në trajtimin e sëmundjeve të tjera përveç Covid-19

Në kuadër të përpjekjeve për të maksimizuar qasjen në trajtim jetëshpëtues për Covid-19, dhe për të shtuar kapacitetet e punonjësve mjekësore dhe të tjerëve për të reaguar ndaj rritjes së numrit të pacientëve me Covid-19, Shtetet i kanë mbyllur shërbimet mjekësore që gjykohen si jo-esenciale dhe kanë shtyrë vizitat e planifikuara për sëmundje të tjera. Megjithatë, ka shqetësime që deprioritizimi i trajtimeve dhe emërimeve mjekësore që nuk kanë lidhje me Covid-19 mund t'i ketë mohuar njerëzve qasje në shërbime të kohshme dhe potencialisht jetëshpëtuese.^[49] Disa shembuj të kësaj përfshijnë:

- i) Diagnozat e humbura të kancerit, meqenëse raportet vlerësojnë se diagnozat me kancer kanë shënuar rënie gjatë pandemisë dhe që ristrukturimi dhe reduktimi i shërbimeve shëndetësore mund të çojë gjithashtu drejt rritjes së mortalitetit nga sëmundja në të ardhmen.^[50]
- ii) Rënie e qasjes në shërbimet shëndetësore të amësisë, abortit dhe kotraceutivëve për shkak të kufizimeve të lëvizjes dhe riemërimit të stafit që zakonisht punon në këto fusha, posaçërisht në vende ku shëndeti seksual dhe riprodhues i grave është vlerësuar 'jo esencial'.^[51]

Kur bëhen vlerësime dhe zbatohen politika për të mbrojtur njerëzit kundër kërcënimit të jetës që u kanoset nga Covid-19, Shtetet gjithashtu duhet të jenë të vetëdijshme për detyrimet e tyre sipas Nenit 2 për të ofruar qasje në trajtimin

përfshirë si përmblendje në këtë publikim).

[49] Shih [https://www.thelancet.com/journals/lancet/article/PIIS0140-6736\(20\)31679-2/fulltext](https://www.thelancet.com/journals/lancet/article/PIIS0140-6736(20)31679-2/fulltext) "Covid-19 ka efekt 'shkatërrues' tek vajzat dhe gratë", nga S.Cousins, The Lancet, Vëllimi 396, Numri 10247, p.301-302, 1 gusht 2020. Shih gjithashtu: https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2020-coronavirus-pandemic-eu-bulletin-november_en.pdf, "Pandemia e Koronavirusit në BE – Implikimet për të Drejtat e Njeriut: Të Drejtat Sociale në Fokus", Agjencia Evropiane për të Drejtat Thelemore, Buletini #6, 1 shtator deri më 31 tetor 2020, faqet 21-22.

[50] Shih <https://cancerworld.net/spotlight-on/unexpected-consequences-of-the-covid-19-pandemics-on-cancer-patients/>, "Pasojat e pandemisë COVID-19 tek pacientët me kancer" nga C. Ferrario, Cancer World, 21 maj 2020.

[51] Shih <https://www.coe.int/en/web/commissioner/-/covid-19-ensure-women-s-access-to-sexual-and-reproductive-health-and-rights> "COVID-19: Sigurimi i qasjes së grave në të drejtat seksuale dhe riprodhuese", Deklaratë e Këshillit të Evropës, 7 maj 2020. Shih gjithashtu [https://www.thelancet.com/journals/lancet/article/PIIS0140-6736\(20\)31679-2/fulltext](https://www.thelancet.com/journals/lancet/article/PIIS0140-6736(20)31679-2/fulltext) "Covid-19 ka efekt 'shkatërrues' tek vajzat dhe gratë", nga S.Cousins, The Lancet, Vëllimi 396, Numri 10247, p.301-302, 1 gusht 2020.

jetëshpëtues për sëmundje të tjera. Këto detyrime duhet të faktorizohen në procesin e vendimmarrjes rreth vendimeve se cilat shërbime shëndetësore duhet të qëndrojnë të hapura dhe cilat mund të shtyhen përkohësisht. Përkufizimi i 'kujdesit esencial' i përdorur nga Shtetet për të përcaktuar se cilat trajtime duhen vazhduar duhet të jetë mjaftueshëm i gjerë saqë të sigurojë veprime në përputhje me detyrimet sipas Nenet 2 të përkrahura më lart në lidhje me sëmundje të tjera që përbëjnë kërcënim për jetën.

Detyrimet përtë mbrojtur individët nga vetëlëndimi (detyrimet operacionale dhe rregullatore)

Janë duke u shtuar shqetësimet për shtimin e ideve për të lënduar veten ose për të bërë vetëvrasje gjatë pandemisë për shkak të faktorëve të tjerë si frika, izolimi, distancimi fizik, reduktimi i shërbimeve mbështetëse, humbja e të ardhurave, mbyllja e bizneseve, dhe ekspozimi i madh i të infektuarve me Covid-19 ndaj punonjësve në vijën e parë të frontit.^[52] Shqetësimet rreth përkeqësimit të përgjithshëm të shëndetit mendor gjatë pandemisë, dhe në mënyrë të veçantë në mesin e atyre që mbahen në izolim mjekësor, po ashtu diskutohen në seksionin 2 (Neni 3 - mbrojtja nga trajtimi çnjerëzor dhe poshtërues) dhe seksionin 3 (Neni 8 - e drejta për respekt të jetës private dhe familjare) të këtij publikimi. Këto shqetësime mund të bëhen më urgjente meqenëse pandemia ka efekte afatgjata mbi popullatën e gjerë, ekonominë, dhe grupet e ndjeshme.

Detyrimet rregullatore

Në përgjithësi, detyrimet rregullatore të Shtetit për të ngritur një kornizë ligjesh dhe rregullash për të mbrojtur jetën, që diskutohet më lart, duhet të shtojë masat për mbrojtjen e shëndetit mendor, duke marrë parasysh rrezikun e shtuar të ideve për vetëlëndim dhe vetëvrasje të shkaktuar nga përkeqësimi i shëndetit mendor gjatë pandemisë. Kjo mund të përfshijë përshtatjen e kornizës së ligjeve që rregullojnë qasjen në shërbime mbështetëse për shëndetin mendor për t'u siguruar që mbështetja të vazhdojë të jetë në dispozicion për ata që janë të izoluar ose në karantinë (për shembull përshtatja e shërbimeve në mënyrë që ato të ofronen përmes telefonit) dhe shërbimet mbështetëse të vihen në dispozicion të gjerë.

[52] Shih [https://www.thelancet.com/journals/lanpsy/article/PIIS2215-0366\(20\)30171-1/fulltext](https://www.thelancet.com/journals/lanpsy/article/PIIS2215-0366(20)30171-1/fulltext), "Rreziku dhe parandalimi i vetëvrasjes gjatë pandemisë COVID-19" D. Gunnell et al, The Lancet, Vëllimi 7, Numri 6, fq. 468-471, 1 qershor 2020.

Detyrimet operacionale

Në disa rrethana të caktuara, Neni 2 mund në nënkuptojë detyrimin pozitiv nga ana e autoriteteve për të marrë masa parandaluese për të mbrojtur individët nga vetvetja.^[53] Personat me paaftësi mendore konsiderohen se përbëjnë një grup posaçërisht të ndjeshëm që kërkon mbrojtje nga vetëlëndimi.^[54] Për të ekzistuar detyrimi operacional kur rreziku ndaj një personi rrjedh nga vetëlëndimi, duhet të konstatohet që:

- i) autoritetet e kanë ditur ose duhet ta kenë ditur në atë kohë për ekzistencën e një rreziku real dhe të afërt për jetën e individit të identifikuar; dhe
- ii) nëse po, ato kanë dështuar në marrjen e masave brenda fushëveprimit të fuqive të tyre të cilat, duke gjykuar me arsye, mund të jenë pritur që ta shmangin atë rrezik.^[55]

Detyrimi për të marrë masa operacionale parandaluese në këtë aspekt deri tani ka dalë në kontekstin e vetëvrasjeve në paraburgim paragjyqësor ose në burg, në shërbimin e detyrueshëm ushtarak^[56] ose në kujdesin psikiatrik të vullnetshëm/pavullnetshëm.^[57] Megjithatë, këto detyra po ashtu kanë dalë edhe jashtë ambienteve të mbajtjes ose ndalimit, dhe aplikohen në situata të tilla kur individit kërcënon të marrë jetën e vet para syve të agjentëve të Shtetit dhe kur ky kërcënim është reagim emocional i nxitur nga veprimet ose kërkesat e agjentëve të Shtetit, pavarësisht se sa i papritur mund të ketë qenë ai reagim.^[58]

Në kontekstin e pandemisë Covid-19, mund të dalë detyrimi sipas Nenet 2 për të ndërhyrë në masë të arsyeshme në përpjekje për të shmangur rrezikun e vetëlëndimit aty ku:

- i) autoritetet vihen në dijeni të përkeqësimit domethënës në shëndetin mendor të personit; dhe

[53] *Renolde k. Francës*, vendim i 16 tetorit 2008, Nr. 5608/05, § 81.

[54] *Renolde k. Francës*, vendim i 16 tetorit 2008, Nr. 5608/05, § 84.

[55] *Fernandes de Oliveira k. Portugalisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 31 janarit 2019, Nr. 78103/14, §110 - § 115.

[56] *Kılınç dhe të Tjerë k. Turqisë*, vendim i 28 marsit 2000, Nr. 22492/93.

[57] *Fernandes de Oliveira k. Portugalisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 31 janarit 2019, Nr. 78103/14.

[58] *Shih Mikayil Mammadov k. Azerbajxhanit*, vendim i 17 dhjetorit 2009, Nr. 4762/05, § 115, ku bashkëshortja e kërkuetit i ka vënë zjarrin vetes në shenjë proteste ndaj nxjerrjes jashtë banesës me forcë.

- ii) përkeqësimi shkaktohet nga masat e marra prej Shtetit për të luftuar përhapjen e Covid-19; dhe
- iii) ekziston kërcënimi real dhe i afërt i vetëlëndimit.

Dhuna shtëpiake (detyrimet operacionale dhe rregullatore)

Ekziston një trend i përgjithshëm, i dokumentuar, që dhuna shënon rritje në situata të natyrës humanitare, përfshirë ato që kanë të bëjnë me epidemi dhe pandemi.^[59] Gjatë pandemisë Covid-19, frustrimi për shkak të rreziqeve shëndetësore, humbjeve ekonomike, papunësisë, pasigurisë, mbylljeve brenda dhe kufizimit të lëvizjeve e kanë shtuar dhunën kundër grave.^[60] Për të reaguar ndaj pandemisë, shërbimet për mbrojtjen dhe parandalimin e dhunës shtëpiake siç janë strehimoret, shtëpitë e sigurta, qendrat e krizave për përdhunime, dhe shërbimet këshillimore janë detyruar të mbyllen ose të reduktojnë natyrën e shërbimeve që ofrojnë.

Probleme të ngjashme ekzistojnë edhe në kontekstin e keqtrajtimit të fëmijëve. Për fëmijë të cilët tashmë përjetojnë abuzim ose neglizhim nga anëtarët e familjes, kufizimi në shtëpi ka nënkuptuar ekspozim të zgjatuar ndaj lëndimeve potenciale. Përveç kësaj, fëmijët mund të marrin më pak mbrojtje brenda shtëpisë së tyre nëse prindërit janë të mbingarkuar dhe standardet e mbikqyrjes mund të kenë rënë; ato mund të jenë më të lëndueshëm (të ekspozuar ndaj ngacmimeve të mundshme) nëqoftëse ndihen të vetmuar ose ndiejnë që askush nuk po kujdeset për to; dhe pothuaj me siguri që do të kenë mbrojtje të reduktuar nga të rriturit e besueshëm jashtë shtëpisë.^[61]

[59] Shih <https://digitallibrary.un.org/record/822489?ln=en>, "Mbrojtja e Njerëzimit nga Krizat e Ardshme Shëndetësore", Raport i Panelit të Nivelit të Lartë të OKB-së për Reagimin Global ndaj Krizave Shëndetësore, 9 shkurt 2016.

[60] Shih https://www2.unwomen.org//media/field%20office%20eca/attachments/publications/2020/05/unw_covid-vaw_report_final.pdf?la=en&vs=5317 "Impakti i pandemisë Covid-19 mbi shërbimet specialiste për viktimat dhe të mbijetuarit në Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë", Kombet e Bashkuara për Gratë, maj 2020; <https://balkaninsight.com/2020/04/21/covid-19-and-domestic-abuse-when-home-is-not-the-safest-place/> "Covid-19 dhe Abuzimi Shtëpiake: Kur Shtëpia nuk Është Vendi më i Sigurt", X. Bami dhe të Tjerë, Balkan Insight, 21 prill 2020.

[61] Shih <https://learning.nspcc.org.uk/media/2246/isolated-and-struggling-social-isolation-risk-child-maltreatment-lockdown-and-beyond.pdf> "Izolimi dhe vështirësitë: izolimi social dhe rreziku i keqtrajtimit të fëmijëve të mbyllur brenda dhe jo vetëm", E.Romanou dhe E.Belton, Ekipi i NSPCC Evidence, qershor 2020.

Kur koha dhe burimet e policisë, shërbimeve sociale, dhe gjykatave ngushtohen nga përgjegjësi të tjera gjatë pandemisë, reagimi ndaj situatave të abuzimit shtëpiak është trajtuar si prioritet më i vogël.^[62] Fokusi mbi policimin e kufizimit të lëvizjeve ka bërë që autoritetet të de-prioritizojnë fusha të tjera të zbatimit të ligjit, dhe mbyllja e gjykatave ka shkaktuar vonesa në ndjekjen penale të çështjeve të cilat nuk vlerësohen urgjente, përfshirë rastet e dhunës së bazuar në gjini.^[63] Kjo ka sjellë në një situatë ku dhuna ka më shumë gjasa të ndodhë, por ku mundësitë për t'i ikur kësaj dhune dhe efikasiteti i raportimit të saj tek autoritetet janë reduktuar.

Dhuna shtëpiake ngre çështje sipas Neneve 2, 3, 8 dhe 14 të Konventës. Ky seksion i publikimit duhet të lexohet së bashku me seksionet e këtij publikimi që trajtojnë detyrimet sipas Neneve 3, 8 dhe 14 në lidhje me dhunën shtëpiake.

Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës kundër Grave dhe Dhunës Shtëpiake (Konventa e Stambollit) është një tjetër dokument kyç në këtë aspekt. Me ratifikimin e Konventës së Stambollit^[64], Shtetet e Ballkanit Perëndimor janë zotuar të marrin masa legjislative dhe masa të tjera të nevojshme për të ushtruar zellin e duhur për parandalimin, hetimin, ndëshkimin dhe ofrimin e zgjidhjeve për akte të dhunës që mbulohen nga fushëveprimi i Konventës të cilat kryhen nga aktorë jo-Shtetërorë. Gjykata ka filluar ta përdorë Konventën e Stambollit si instrument kyç për të interpretuar shkallën e detyrimeve pozitive karshi viktimave të dhunës shtëpiake dhe gjinore sipas Neneve 2, 3 dhe 8 të KEDNj-së.^[65]

[62] Shih për shembull rastin e një çështjeje ku të mbijetuarit kishin nevojë për ndihmë për të lëvizur, por policia nuk mundi t'u ofronte ndihmë sepse ishin tepër të zënë me krizën: <https://eca.unwomen.org/en/news/stories/2020/4/unpacking-the-impact-of-covid-19-on-women-and-girls-in-albania?fbclid=IwAR1sq-JRW4c4UUMgD8WtkRUB9YaoeCivHC7LULByvopNpyM4QrjjMVOCr0> "Impakti i Covid-19 te gratë dhe vajzat në Shqipëri", UN Women Albania, 28 prill 2020.

[63] Shih https://trialinternational.org/wp-content/uploads/2020/05/Justice-in-the-time-of-coronavirus_EN_final.pdf "Drejtësia në kohën e koronavirusit: Si ndikon pandemia globale tek viktimat e krimeve më të rënda", Raporti i Trial International, maj 2020.

[64] 34 vende e kanë ratifikuar Konventën e Stambollit deri tani, përfshirë Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Kroacia, Serbia dhe Maqedonia e Veriut.

[65] *Shih Bălșan k. Rumanisë*, vendim i 23 majit 2017, Nr. 49645/09 112 dhe *Talpis k. Italisë*, vendim i 2 marsit 2017, Nr. 41237/14

Detyrimet rregullatore

Detyrimet rregullatore për të mbrojtur jetën të përshkruara më lart përfshijnë detyrimin për të ngritur një kornizë ligjore e cila ndalon dhe parandalon marrjen e jetës njerëzore përmes akteve kriminale të një individi privat. Kjo përfshin ndalimin e dhunës shtëpiake duke miratuar ligjet e duhura, përfshirë kornizën ligjore për t'u siguruar që akuzat për dhunë shtëpiake të hetohen, të ndiqen penalisht dhe të ndëshkohen në mënyrë proporcionale me peshën e veprave të kryera.^[66]

Detyrimet operacionale

Detyrimet operacionale të përshkruara më lart gjithashtu përfshijnë detyrimin për të mbrojtur jetën nga aktet e një individi privat në situata të caktuara. Në kontekstin e dhunës shtëpiake, Shtetet janë të detyruara të parandalojnë shkaktimin e dhunës mbi viktimat dhe të hetojnë akuzat për dhunë shtëpiake në mënyrë të menjëhershme dhe efektive. Në një çështje të dhunës shtëpiake, Shteti do të shkelte Nenin 2 po qe se autoritetet do të dështonin në mbrojtjen e individit nga veprimet e një personi privat^[67] kur janë në dijeni të ekzistimit të një rreziku serioz.^[68]

Kërkesat për hetime të menjëhershme për akuzat e abuzimit si dhe hetimet efektive dhe ndjekja penale e incidenteve të dhunës shtëpiake janë posaçërisht relevante në kontekstin e pandemisë Covid-19, kur koha dhe burimet e policisë, shërbimeve sociale dhe gjykatave janë ngushtuar nga përgjegjësi të tjera dhe kur ka pasur vonesa në hetime penale, ndjekje penale dhe procedura gjyqësore. Shtetet do të shkelnin Nenin 2 nëse një situatë e dhunës shtëpiake vjen në vëmendje të tyre, por autoritetet dështojnë të reagojnë, dhe reagimi i tyre joefektiv ndaj akuzave shpie në vdekjen e një individi.^[69] Prandaj, Shtetet duhet të sigurohen

[66] *Kontrová k. Slovakisë*, vendim i 31 majit 2007, Nr. 7510/04; *Opuz k. Turqisë*, vendim i 9 qershorit 2009, Nr. 33401/02 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim); *Branko Tomašić dhe të Tjerë k. Kroacisë*, vendim i 15 janarit 2009, Nr. 46598/06

[67] *Osman k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i Dhomës së Madhe i 28 tetorit 1998, Nr. 23452/94 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim); *Kontrová k. Slovakisë*, vendim i 31 majit 2007, Nr. 7510/04; *Opuz k. Turqisë*, vendim i 9 qershorit 2009, Nr. 33401/02 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim); *Branko Tomašić dhe të Tjerë k. Kroacisë*, vendim i 15 janarit 2009, Nr. 46598/06, §50.

[68] *Valiulienė k. Lituanisë*, vendim i 26 marsit 2013, Nr. 33234/07.

[69] *Shih Talpis k. Italisë*, vendim i 2 marsit 2017, Nr. 41237/14, ku kërkesja bëri ankesë kundër bashkëshortit të saj abuziv dhe kërkoi urdhra mbrojtjeje kundër tij pas shumë episodeve të dhunës kundër saj dhe fëmijëve të tyre.

që hetimet mbi akuzat për dhunë shtëpiake të vazhdojnë të trajtohen si prioritet gjatë tërë pandemisë.

Mbështetja sociale

Duhet të vazhdojnë të alokohen burime për hetimet mbi rastet e abuzimit dhe ofrimin e mbështetjes për viktimat. Gjykata ka vendosur që, në rrethana të veçanta, Shteti ka për detyrë t'u ofrojë burime individëve për të parandaluar dhunimin e të drejtave të tyre^[70] por nuk i është adresuar specifikisht nevojshmërisë që Shteti të sigurohet që viktimave t'u ofrohet përkrahje përmes masave të mbështetjes sociale, siç janë akomodimi i refugjatëve dhe përkrahja financiale.

Megjithatë, Konventa e Stambollit u jep Shteteve detyrimin për t'u siguruar që të merren masat e nevojshme legislative, ose masa të tjera, për të ofruar ose për të organizuar, në shtrirjen e duhur gjeografike, shërbime specialiste të mbështetjes afatshkurtër dhe afatgjatë për çdo viktimë të akteve të dhunës që mbulohen nga fushëveprimi i Konventës së Stambollit. Gjithashtu, palëve u kërkohet që të 'marrin masat e nevojshme legislative ose të tjera për të ofruar ngritjen e strehimoreve të përshtatshme, të lehta për t'u gjetur, në numër të mjaftueshëm për të ofruar akomodim të sigurt dhe për të qenë proaktivë ndaj viktimave, posaçërisht grave dhe fëmijëve të tyre'.

Mbyllja e strehimoreve, shtëpive të sigurta dhe shërbimeve të tjera sociale mund të klasifikohet si masë për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit nga përhapja e Covid-19. Megjithatë, Shtetet duhet të vlerësojnë nëse për rrezikun që i kanoset jetës nga Covid-19 nevojitet një mbyllje e tërësishme e shërbimeve të tilla apo nëse ato mund të përshtaten në mënyrë që të rrinë të hapura, duke marrë parasysh faktin që këto shërbime po ashtu mund të shërbejnë për të mbrojtur jetën kur përdoren për të akomoduar një person që është në rrezik të përjetimit të situatës së dhunës shtëpiake që është kërcënuese për jetën.

Policia e mori në pyetje kërkuesen për herë të parë shtatë muaj pas ankesës së saj, dhe episodi vijues i dhunës rezultoi me vdekjen e djalit të tyre. Gjykata gjeti shkelje të Nenit 14 në lidhje me Nenin 2 dhe 3, duke konfirmuar që diskriminimi ndodh jo vetëm kur aktet e autoriteteve përbëjnë dështim për të reaguar ndaj episodeve të dhunës, por edhe kur Shteti ka treguar 'tolerancë të përsëritur' që 'pasqyron qasje diskriminuese karshi kërkueses si grua'

[70] *Airey k. Irlandës*, vendim i 9 tetorit 1979, Nr. 6289/73.

Detyrimet për të mbrojtur jetën e të paraburgosurve nga Shteti ose atyre që janë nën kujdesin e Shtetit (detyrimet operacionale dhe rregullatore)

Shteti gjithashtu e ka për detyrim të sigurohet që ata që janë të privuar nga liria, përfshirë ata që janë në burg, në qendra paraburgimi, në spitale psikiatrike dhe qendra të kujdesit social, të kenë ndihmën mjekësore të duhur në mënyrë që të sigurohet shëndeti dhe mirëqenia e personave.^[71] Autoritetet shtetërore duhet të sigurohen që trajtimi të jetë i mjaftueshëm, çka do të thotë që diagnozat dhe kujdesi të jenë të shpejta dhe të sakta, dhe që aty ku duhet mbikqyrja e një sëmundjeje të caktuar të jetë e rregullt, sistematike dhe të përfshijë një strategji terapeutike të tërësishme me qëllim të shërimit të sëmundjes së të ndaluarit ose parandalimit të përkeqësimit të saj.^[72]

Gjykata ka ndërmarrë një qasje të ngjashme në lidhje me trajtimin mjekësor të personave të dobët nën kujdesin e Shtetit kur autoritetet vendase, pavarësisht të qenit në dijeni të kushteve që kanë çuar në vdekjen e personave të vendosur në shtëpitë e kujdesit social ose në spitale, pavarësisht nga kjo kanë vënë jetën e këtyre personave në rrezik pa arsye.^[73] Kjo mund të jetë relevante për politikën e Qeverisë në lidhje me lëshimin e pacientëve nga spitali në shtëpitë e kujdesit, ose koha e marrjes së vendimeve për të mbyllur shtëpitë e kujdesit social, kur këto vendime ndiqeshin nga përhapja e Covid-19 në ato shtëpi mes të moshuarve, të cilët dihet se janë posaçërisht të prershëm nga virusi.^[74]

[71] *Salman k. Turqisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 27 qershorit 2000, Nr. 21986/93, § 99; *Slimani k. Francës*, vendimi i 27 korrikut 2004, Nr. 57671/00; *Tanli k. Turqisë*, vendimi i 10 prillit 2001, Nr. 26129/95, § 141; *Kişmir k. Turqisë*, vendimi i 31 majit 2005, Nr. 27306/95, § 105; *Mojsiejeë k. Polonisë*, vendimi i 24 marsit 2009, Nr.11818/02, § 65.

[72] Për kuptimin e përshtatshmërisë së trajtimit të personave nën kontrollin e autoriteteve shih mutatis mutandis, *Rooman k. Belgjikës*, vendimi Dhomës së Madhe i 31 janarit 2019, Nr. 18052/11, § 147.

[73] *Qendra për Burime Ligjore në emër të Valentin Câmpeanu k. Rumanisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 17 korrikut 2004, Nr. 47848/08, §§ 131 and 143-144 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim); *L.C.B. k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 9 qershorit 1998, §§ 36-41; G.N. dhe të Tjerë k. Italisë, vendimi i 1 dhjetorit 2009, Nr. 43134/05; *Hristozov dhe të Tjerë k. Bullgarisë*, vendimi i 3 nëntorit 2012, Nr. 47039/11 dhe 358/12 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim); *Oyal k. Turqisë*, vendimi i 23 marsit 2010, Nr. 4864/05 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[74] Shih për shembull në Mbretërinë e Bashkuar, ku lëshimi i shpejtë i pacientëve nga spitali në shtëpitë e kujdesit është gjetur të ketë pasojë tragjike: <https://www.adass.org.uk/media/7967/adass-coronavirus-survey-report-2020-no-embargo.pdf> "ADASS: Sondazh për koronavirusin", Shoqata e Drejtuesve të Shërbimeve Sociale për të Rritur, 2020; shih gjithashtu: <https://www.ecdc.europa.eu/en/publications-data/covid-19-care-homes-infographic> "Infographic: COVID-19 në shtëpitë e kujdesit", Qendra Evropiane për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve,

Shtetet gjithashtu kanë detyrimin pozitiv për të parandaluar përhapjen e sëmundjeve ngjithëse në qendrat e paraburgimit. Megjithatë, Konventa nuk mund të shihet si e tillë që parashtron detyrimin e përgjithshëm për të liruar të parabugosurit për arsye shëndetësore.^[75] Disa Shtete kanë shpallur politika për lirimin e të burgosurve herët ose përkohësisht, por një politikë e tillë nuk kërkohet sipas të drejtës ekzistuese. Megjithatë, mund të jetë e vetmja mënyrë për të mbrojtur jetën, krahas shmangies së shkeljes së Nenit 3, nëqoftëse alternativa tjetër për mbrojtjen e jetës është mbajtja e të burgosurve në izolim të vetmuar.^[76]

b. Detyrat procedurale hetimore

Neni 2 përmban një detyrim të dalluar procedural për të zhvilluar hetime efektive rreth vdekjes së një individi në rrethanat kur ekziston një shkelje e dyshuar e detyrimeve substanciale të Shtetit sipas Nenit 2. Shkelja e këtij detyrimi procedural mund të çojë në gjetjen e ndarë të një shkeljeje të Nenit 2 qoftë krahas ose pa nevojën e një shkeljeje të detyrimeve substanciale sipas Nenit 2. Detyrimet hetimore dalin në lidhje me shkeljen potenciale të të gjitha detyrimeve të diskutuara më lart, pra në kontekstin e vdekjeve të shkaktuara nga Covid-19, sëmundjeve të tjera, vetëlëndimit, dhunës shtëpiake, dhe vdekjeve të të parabugosurve nga Shteti ose atyre që janë nën kujdesin e Shtetit.

Qëllimi i detyrimit hetimor

Qëllimi i detyrimit hetimor është të sigurohet që ligjet vendase që mbrojnë të drejtën e jetës të zbatohen në mënyrë efektive dhe që autoritetet e Shtetit të japin llogari për vdekjet që ndodhin brenda përgjegjësisë së tyre.^[77] Duhet të nxirren mësim nga gabimet e mëparshme për të parandaluar vdekje të tjera në rrethana të ngjashme, për të lehtësuar shqetësimet publike, dhe për t'u ofruar atyre që mbajnë zi mundësinë për të kuptuar se si kanë vdekur të afërmit e tyre, që të paktën ta dinë se mësimet e nxjerra do t'i ulin gjasat për vdekje të tilla në të ardhmen.

19 maj 2020.

[75] *Dzieciak k. Polonisë*, vendim i 9 dhjetorit 2008, Nr. 77766/01.

[76] Për diskutime të mëtejshme rreth çështjeve që mund të dalin sipas Nenit 2 në qendrat e paraburgimit, shih seksionin mbi Nenin 3 (Mbrojtja nga trajtimi çnjerëzor dhe poshtëruar) në këtë publikim, në mënyrë të veçantë "Detyrimet për të mbrojtur shëndetin dhe mirëqenien e atyre për të cilët përgjegjësinë e ka marrë Shteti".

[77] *Al Skeini k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i Dhomës së Madhe i 7 korrikut 2011, Nr. 55721/07, §163.

Duke marrë parasysh diskutimin e mësipërm në lidhje me mënyrat se si reagueshet e Shteteve ndaj pandemisë mund të argumentohet se kanë shkelur detyrimet e tyre sipas Nenit 2, me gjasë detyrimi hetimor do të shkrehet në shumë Shtete evropiane për të siguruar që Qeveritë të japin llogari për vendimet e marra dhe politikatat e zbatuara për të mbrojtur jetën e qytetarëve nga kërcënimi i Covid-19.

Gjykata ka theksuar kriterin e shqyrtimit të menjëhershëm të çështjeve lidhur me vdekjet në ambientet e spitaleve, në mënyrë që faktet dhe gabimet e mundshme të kryera gjatë dhënies së kujdesit mjekësor të mund të konstatohen menjëherë dhe t'i shpërndahen stafit mjekësor për të parandaluar përsëritjen e gabimeve të ngjashme, duke kontribuar kështu në sigurinë e përdoruesve të të gjitha shërbimeve shëndetësore.^[78] Rreziku i 'valës së dytë' të virusit e shton nevojën për hetime efektive dhe zhvillimin e tyre të menjëhershëm për të siguruar që Qeveritë të jenë të përgatitura më mirë për të reaguar ndaj valëve të mundshme në të ardhmen.

Fushëveprimi i detyrimit hetimor

Natyrë dhe fushëveprimi i saktë i detyrimit hetimor varet nga rrethanat e rasteve të caktuara, por së paku hetimet duhet të jenë efektive, çka do të thotë se duhet të jenë në gjendje të konstatojnë faktet, të identifikojnë përgjegjësit dhe, aty ku duhet, të caktojnë ndëshkimin e duhur ose të ofrojnë njëfarë zgjidhjeje. Në thelb, ato duhet të arrijnë të përmbushin qëllimet e detyrimit të përshkruar më lart, meqenëse ky është detyrim që ka të bëjë me mënyrën e jo me rezultatin. Hetimet duhet të nisen nga autoritetet e Shtetit dhe Shteti duhet të marrë të gjitha masat e mundshme për të mbledhur provat relevante. Hetimet duhet të zhvillohen nga një organ i pavarur, të jenë në dispozicion për familjen e viktimës, të zhvillohen me shpejtësi të arsyeshme, dhe të kenë elemente të mjaftueshme të këqyrjes publike në hetime.^[79]

Zakonisht, detyrimi hetimor sipas Nenit 2 mund të përmbushet duke zhvilluar kërkime apo hulumtime publike ose duke hapur hetime civile ose penale rreth vdekjes së një personi, ku të gjitha këto mund të ndodhin në një gjykatë publike, për t'u siguruar që kriteret e këqyrjes dhe qasjes publike të përmbushen. Megjithatë, konteksti i Covid-19 paraqet sfida për mënyrat e zakonshme të kryerjes së këtyre

[78] *Byrzykowski k. Polonisë*, vendim i 27 qershorit 2006, Nr. 11562/05, §117.

[79] *Armani Da Silva k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i Dhomës së Madhe i 30 marsit 2016, Nr. 5878/08 tek §§232-237.

detyrave, dhe Shtetet mund të duhet të jenë më kreativë në qasjet e tyre për t'u siguruar që të plotësohen këto kritere procedurale minimale. Për shembull, gjatë pandemisë, pjesëmarrja e publikut, jurive dhe anëtarëve të familjes në seancat dëgjimore publike nuk ka qenë e mundur për shkak të mbylljes brenda nëpër shtëpi dhe kërkesës për distancim social; në vend të kësaj mund të jenë të nevojshme seancat dëgjimore përmes videolidhjes ose publikimi i raporteve.^[80]

Hetimet rreth shkëljes së mundshme të detyrimeve operacionale

Meqenëse Shteti mban përgjegjësi të drejtpërdrejtë për mirëqenien e personave të privuar nga liria, kur një person i tillë vdes si pasojë e problemeve shëndetësore Shteti duhet të japë shpjegim rreth shkakut të vdekjes dhe trajtimit që i është dhënë personit në fjalë para vdekjes.^[81] Ky detyrim normalisht mund të kryhet në varësi të secilit rast me kërkesë individuale. Megjithatë, në kontekst të Covid-19, vdekjet nën kujdesin shtetëror mund të jenë pazgjydhshmërisht të lidhura me gabime më të gjera sistemike operacionale dhe/ose rregullatore, siç është dështimi për të ofruar PPE të mjaftueshme stafit që punon me personat e paraburgosur, ose dështimi për të porositur pajisje të tilla me kohë. Për të qenë në pajtueshmëri me Nenin 2, çdo hetim(e) i nisur nuk duhet të injorjë ndonjë shkëlje potenciale të vendimeve më të gjera rreth politikave ose detyrave rregullatore të Shtetit, aty ku janë relevante.

Hetimet individuale mund të mos jenë të mjaftueshme për të plotësuar kriteret e Nenit 2, nëqoftëse kanë burime apo struktura të pamjaftueshme në dispozicion për të mundësuar marrjen si duhet në konsideratë të dështimeve sistemike ose rregullatore të cilat mund të kenë kontribuar në vdekjen e dikujt. Më tej, një numër i madh i vdekjeve që rezultojnë nga Covid-19 mund të mos referohen për shqyrtim individual gjatë hetimeve, nëse vdekja vlerësohet se ka rezultuar nga progresioni i natyrshëm i virusit, dhe nuk hyn në kategoritë e pazakonta të përshkuara më lart në të cilat mund të dalë ndonjë detyrim operacional.^[82] Prandaj Shtetet duhet

[80] Për një diskutim më të hollësishëm të çështjeve lidhur me mbajtjen e seancës dëgjimore gjatë pandemisë, shih seksionin 6 (E drejta për seancë dëgjimore të drejtë) në këtë publikim.

[81] *Slimani k. Francës*, vendim i 27 korrikut 2004, Nr. 57671/00, § 27; *Kats dhe të Tjerë k. Ukrainës*, vendim i 18 dhjetorit 2008, Nr. 29971/04, §104.

[82] Shih për shembull Udhërrëfyesin e Kryemjekut Ligjor në Mbretërinë e Bashkuar që këshillon që Hetimet e Mjekut Ligjor të mos marrin parasysh vendimet për politika më të gjera: <https://www.judiciary.uk/wp-content/uploads/2020/04/Chief-Coroners-Guidance-No-37-28.04.20.pdf> "Vdekjet nga Covid-19 dhe ekspozimi i mundshëm në vendin e punës", HHJ Mark Lucraft QC, Kryemjek Ligjor, 28 prill 2020; dhe përgjigjja nga avokatët

të sigurohen që të ekzistojë një forum me burimet e duhura në dispozicion ku të hetohen më gjërë gabimet nacionale rregullatore dhe strukturore.

Hetimet rreth shkeljeve të mundshme të detyrimeve rregullatore

Zhvillimi i hetimeve publike është metoda më e zakonshme përmes së cilës kryhen kërkimet rreth gabimeve më të gjera në aspektin e politikave dhe gabimeve strukturore. Megjithatë, nganjëherë ato zgjasin me muaj ose vite të tëra, dhe mund të fillojnë disa muaj pas ngjarjes relevante. Prandaj, mund të marrë kohë deri sa të mund të dalin konkluzionet e një hulumtimi të plotë publik (në formën e vet të zakonshme) i cili ndihmon për të kuptuar se çka saktësisht nuk ka shkuar ashtu siç duhej dhe ku kanë mundur të evitohen vdekjet.

Në qershor 2020 Franca u bë vendi i parë që shpalli se do të niste hetime publike në lidhje me reagimet e saj ndaj Covid-19 pasi u depozituan ankesa në lidhje me dështime të supozuara për të vendosur mbrojtje antivirus në vendin e punës, për të furnizuar me maska dhe për të bërë teste masive.^[83] Në një vend tjetër, në Mbretërinë e Bashkuar, Qeveria i rezistoi thirrjeve të vazhdueshme nga familjet në zi pas humbjes së të dashurve të tyre për të hapur hetime publike të menjëhershme, duke argumentuar se një proces i tillë do të ishte tepër i kushtueshëm dhe do të merrte shumë kohë, çka do të hutonte përpjekjet për të luftuar virusin.^[84] Vetëm në maj 2021 Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar shpalli se do të zhvillonte hetime publike në lidhje me mënyrën se si e kishte trajtuar pandeminë, dhe seancat e para publike nuk pritet të fillojnë para vitit 2023^[85]. Nëqoftëse hetimet publike në

dhe mjekët që shprehin shqetësim rreth pajtueshmërisë së këtyre këshillave me Nenin 2: <https://www.bmj.com/content/369/bmj.m1806> "COVID-19: Mjekligjorët nuk kanë nevojë të hetojnë dështimet e politikave PPE në vdekjet e stafit të NHS-së" nga C. Dyer, BMJ, 369:m1806, 4 maj 2020.

[83] Shih <https://www.thenational.ae/world/europe/coronavirus-france-sets-out-first-public-inquiry-into-handling-of-pandemic-1.1031304> "Koronavirusi: Franca nis hetimet e para rreth trajtimit të pandemisë", nga T.Harding, The National, 9 qershor 2020.

[84] Shih <https://www.theguardian.com/world/2020/jun/12/bereaved-relatives-call-for-immediate-inquiry-into-covid-19-crisis> "Të afërmit e hidhëruar kërkojnë hetime të menjëhershme për krizën e Covid-19" nga D.Conn, The Guardian, 12 qershor 2020. U argumentua që duhet të zhvillohen hetime për të hulumtuar çështje si: koha e mbylljes brenda në shtëpi në Mbretërinë e Bashkuar prej 23 marsit, që nodhi më vonë se pothuaj të gjitha vendet e Evropës; gjendja e inventarit që qeveria kishte në stokun e pajisjeve për mbrojtje personale dhe kapacitetet testuese; numri shproporcional i lartë i zezakëve dhe pakicave etnike që kanë vdekur nga Covid-19; dhe transferimi i pacientëve nga spitalet në shtëpitë e kujdesit.

[85] <https://covid19.public-inquiry.uk/> kushtet e referencës për pyetjet që do të trajtojnë hulumtimi mund të gjenden

shkallë të gjerë vlerësohen tepër të kushtueshme dhe kohë- konsumuese, ose nëse ato nuk do të plotësonin kriteret e shpejtshmërisë sipas Nenit 2, Shtetet duhet të gjejnë metoda alternative për të hulumtuar dështimet e mundshme operationale dhe rregullatore në reagimet e tyre ndaj Covid-19. Kjo mund të përfshijë përshtatjen ose adaptimin sa më të shpejtë të mënyrave se si zhvillohen zakonisht hetimet, dhe mësimet e nxjerra të inkorporohen në reagimet e vazhdueshme ndaj pandemisë.

këtu: <https://covid19.public-inquiry.uk/uk-covid-19-inquiry-terms-of-reference-2/>

2. Neni 3 – Mbrojtja nga trajtimi çnjerëzor dhe poshtëruës

Neni 3 i Konventës është absolut në ndalimin e torturës dhe trajtimit çnjerëzor ose poshtëruës, është e drejtë e paderogueshme, dhe nuk lejohen ndërhyrje te kjo e drejtë. Vuajtja dhe sëmundja mund të përbëjnë trajtim çnjerëzor dhe degradues brenda fushëveprimit të Nenet 3 të Konventës nëqoftëse ato arrijnë një nivel të caktuar rreptësie. Nuk ka rregulla strikte për të përkufizuar saktësisht se çfarë lloj trajtimi e përmbush këtë kriter të kërkuar rreptësie, dhe përcaktimi i kësaj çështjeje mund të varet nga të gjitha rrethanat e një rasti të dhënë dhe, në disa raste, nga seksi, moshja dhe gjendja shëndetësore e viktimës.^[86]

Megjithatë, në përgjithësi, trajtimi vlerësohet çnjerëzor nëse shkakton vuajtje fizike ose mendore, dhe vlerësohet degradues nëse provokon ndjenja frike, ankthi dhe inferioriteti të atilla që mund të poshtërojnë dhe të ulin një person, e mbase edhe të thyejnë rezistencën e tij/saj fizike apo morale.^[87] Neni 3 parashikon:

"Askush nuk do t'i nënshtrohet torturës ose trajtimit apo ndëshkimit çnjerëzor ose degradues."

Neni 3 nuk i imponon Shtetit detyrimin për të ofruar një nivel të përgjithshëm kujdesi mjekësor popullatës së përgjithshme për të parandaluar vuajtjet ndaj popullit, por kërkon që Shteti t'u ofrojë ndihmë mjekësore atyre për të cilët ai merr përgjegjësi, për shembull personat e privuar nga liria^[88]. Ekziston rreziku që ata që ndodhen në qendra të mbajtjes (siç janë burgjet dhe qendrat për largimin e

[86] *Soering k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 7 korrikut 1989, Nr. 14038/88; *Feilazoo k. Maltës*, vendimi i 11 qershorit 2021, Nr. 6865/19 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim), ku Gjykata gjeti shkelje të Nenet 3 duke u bazuar mbi të gjitha rrethanat e paraburgimit të kërkuarit, përfshirë faktin që ai ishte mbajtur në ambientet e njëjta me njerëz që mund të kishin pasur Covid-19, por gjithashtu duke marrë parasysh cenueshmërinë e tij si azilkërkuar, gjatësinë e paraburgimit të tij, shtrirjen e infektiveve me insekte në fjetore, vendosjen e tij në izolim për një periudhë pa dritë natyrale, ventilim ose ushtrime.

[87] *Ireland k. the Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 18 janarit 1978, Nr. 5310/71.

[88] *Kudla k. Polonisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 26 tetorit 2000, Nr. 30210/96, § 94. Shih gjithashtu rregullën 24.1 të Rregullave Standarde Minimale të OKB-së për Trajtimin e të Burgosurve (Rregullat e Nelson Mandelës).

imigrantëve) ose ata që jetojnë në institucione me shumë banorë (siç janë shtëpitë / azilet e pleqve dhe jetimoret, spitalet dhe shkollat me konvikt për fëmijët me nevoja të veçanta) mund të kenë më shumë gjasa të infektohen nga Covid-19, si rezultat i kushteve më të ngjeshura në të cilat ndodhen.

Ndërkohë që Shtetet janë të detyruara të parandalojnë përhapjen e sëmundjeve ngjitëse në qendra paraburgimi, ato po ashtu duhet të sigurohen që masat mbrojtëse që zbatohen për të parandaluar përhapjen e Covid-19 në vetvete të mos përbëjnë trajtim çnjerëzor dhe degradues. Për shembull, vënia në izolim e të burgosurve, mbyllja nga brenda e institucioneve siç janë shtëpitë e kujdesit (e rrjedhimisht ndalimi i vizitave) ose të kërkuarit që individët të karantinohen për periudha të gjata kohore mund t'i mbrojnë njerëzit nga Covid-19 por njëkohësisht mund të ndikojë edhe tek shëndeti i tyre mendor në shkallë të atillë që të angazhohet Neni 3 në këtë aspekt.

a. Detyrimet pozitive për të mbrojtur individët nga trajtimi çnjerëzor dhe degradues

Detyrimet për të mbrojtur shëndetin dhe mirëqenien e atyre për të cilët Shteti merr përgjegjësi

Neni 3 cakton detyrimin mbi Shtetin që të mbrojë në mënyrë të përshtatshme shëndetin dhe mirëqenien e njerëzve për të cilët Shteti merr përsipër përgjegjësinë.^[89] Kjo përfshin ata që mbahen në burgje, në qendra paraburgimi dhe në spitale psikiatrike, si dhe ata që banojnë në shtëpitë e kujdesit për të moshuarit^[90]. Në kontekst të pandemisë Covid-19, këtu po ashtu do të përfshiheshin edhe ata që u kërkohet të karantinohen ose të qëndrojnë të mbyllur brenda në shkallë të atillë që kufizimi i lëvizjeve të tyre të përbëjë privim të lirisë.^[91] Standardi i kujdesit ofruar atyre që ndodhen në paraburgim duhet të jetë në përputhje me dinjitetin njerëzor të të paraburgosurit. Kjo do të thotë ofrimi i trajtimit mjekësor dhe kushteve të paraburgimit të cilat janë të mjaftueshme, dhe

[89] *Khudobin k. Ruisë*, vendim i 26 tetorit 2006, Nr. 59896/00 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[90] Shih: [https://www.europarl.europa.eu/thinktank/en/document/EPRS_BRI\(2020\)651976](https://www.europarl.europa.eu/thinktank/en/document/EPRS_BRI(2020)651976) "Koronavirusi dhe të burgosurit në burgjet e Shteteve Anëtare të BE-së, masat për reduktimin e përhapjes së virusit", Carmen-Cristina Cîrlig, Katrien Luyten, Micaela del Monte, Sofija Voronova, Shërbimi Parlamentar Evropian për Kërkime 651.976 – June 2020.

[91] Për diskutimin se çfarë përbën privim të lirisë, shih seksionin mbi Nenin 5 (E drejta e lirisë) brenda këtij publikimi, në mënyrë të veçantë nën-seksionin (a) "Fushëveprimi".

të cilat përputhen me nevojat e veçanta të një të paraburgosuri, përfshirë natyrën e gjendjes shëndetësore, moshën, seksin, dhe çdo dobësi tjetër.^[92]

Vetëm fakti që një i paraburgosur është vizituar nga mjeku dhe i është dhënë receta për trajtim mjekësor nuk do të thotë domosdoshmërisht që kujdesi ka qenë i mjaftueshëm sipas Nenit 3.^[93] Autoritetet nacionale duhet të sigurohen që diagnoza dhe ambientet për të cilat ato janë përgjegjëse të jenë të menjëhershme, të sakta dhe të dizajnuara sipas natyrës së sëmundjes së personit. Për shembull, autoriteteve të Shtetit mund t'u kërkohej që të organizojnë kujdesin vijues sistematik, ose strategji terapeutike gjithëpërfshirëse me qëllim të shërimit të pacientit, ose të paktën të evitimit të përkeqësimit të sëmundjes së tij.^[94]

Trajtimi mjekësor i ofruar duhet të jetë në nivel të krahasueshëm me atë që autoritetet e Shtetit janë zotuar t'i ofrojnë popullatës në tërësi, dhe duhet të zhvillohen dhe monitorohen nga një staf i kualifikuar^[95]. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se çdo personi të ndaluar duhet t'i ofrohet niveli i trajtimit mjekësor që është në dispozicion në institucionet shëndetësore më të mira jashtë burgut. Gjykata ka rezervuar fleksibilitetin për të përcaktuar standardin e kujdesit shëndetësor të kërkuar sipas Nenit 3 me qasjen 'sipas rastit', duke marrë parasysh "kërkesat praktike të burgimit"^[96] dhe nevojën për të vlerësuar prioritetet konkurruese

[92] Në *Blokhin k. Ruisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 23 marsit 2016, Nr. 47152/06, § 137, Gjykata theksoi që "...mjaftueshmëria e ndihmës mjekësore mbetet elementi më i vështirë për t'u përcaktuar. Gjykata përsërit që thjesht fakti që i paraburgosuri është vizituar nga mjeku dhe i është dhënë një formë e caktuar trajtimi nuk shpie automatikisht në konkluzionin që ndihma mjekësore ka qenë e mjaftueshme ... Autoritetet duhet gjithashtu të sigurohen që të mbahet një regjistër i plotë lidhur me gjendjen shëndetësore të të paraburgosurit dhe të trajtimit të tij ose të saj gjatë kohës së paraburgimit ..., që diagnoza dhe kujdesi të jenë të menjëhershme dhe të sakta..., dhe që kur kërkohej nga natyra e sëmundjes mbikqyrja të jetë e rregullt dhe sistematike dhe të përfshijë strategji terapeutike të plotë me qëllim të trajtimit të duhur të problemeve shëndetësore të të paraburgosurit ose të parandalimit të keqësimit të gjendjes, në vend që të adresohen sipas simptomave ... Autoritetet gjithashtu duhet të tregojnë që janë krijuar kushtet e nevojshme që trajtimi i dhënë të vazhdojë me kujdesin vijues...". Shih gjithashtu *Strazimiri k. Shqipërisë*, vendim i 21 janarit 2020, Nr. 24602/16 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[93] *Blokhin k. Ruisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 23 marsit 2016, Nr. 47152/06; *Strazimiri k. Shqipërisë*, 2020, vendim i 21 janarit 2020, Nr. 24602/16 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[94] *Murray k. Holandës*, vendim i Dhomës së Madhe i 26 prillit 2016, Nr. 10511/10, § 106; *Pitalev k. Ruisë*, vendim i 30 korrikut 2009, Nr. 34393/03, § 54.

[95] *Bamouhammad k. Belgjikës*, 17 nëntor 2015, Nr. 47687/13.

[96] *Blokhin k. Ruisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 23 marsit 2016, Nr. 47152/06, § 137; *Aleksanyan k. Ruisë*, vendim i 22 dhjetorit 2008, Nr. 46468/06, §140; *Patranin k. Ruisë*, vendim i 23 korrikut 2015, Nr. 12983/14, § 69.

gjatë alokimit të burimeve të Shtetit.^[97] Gjykata po ashtu do të shqyrtojë nëse autoritetet kanë ndjekur këshillat dhe rekomandimet mjekësore që kanë pasur në dispozicion rreth mënyrës se si duhet përkujdesur për një të person të mbajtur,^[98] duke përfshirë transferimin e menjëhershëm nga një vend mbajtjeje në ambientet mjekësore, kur gjendja shëndetësore e të mbajturit e kërkon një gjë të tillë^[99].

Sëmundjet ngjitëse

Gjykata ka theksuar që përhapja e sëmundjeve të transmetueshme duhet të jetë shqetësim shëndetësor publik, sidomos në ambientet e burgut. Prandaj kërkesat ndaj Shteteve në lidhje me shëndetin e atyre për të cilët Shtetet marrin përgjegjësi mund të dallojnë varësisht nga fakti nëse kanë të bëjnë ose jo me një sëmundje që është e transmetueshme.^[100] Neni 3 u cakton Shteteve detyrimin për të ndërmarrë masa legjislative dhe administrative për të shfarosur ose parandaluar përhapjen e sëmundjeve ngjitëse në vendet ku mbahen njerëzit të ndaluar/burgosur, ku kërcënimi ndaj shëndetit që kanoset nga sëmundja do të shkaktonte një nivel vuajtjeje aq të rreptë sa të hyjë brenda fushëveprimit të Neneve 2 ose 3.^[101] Masat mund të përfshijnë futjen e një sistemi të kontrollimit (screening) para hyrjes në burg. Kërkesa për të siguruar diagnozën dhe qasjen në trajtim të menjëherëshëm po ashtu do të jetë më e madhe.^[102]

- [97] *Pentiacova dhe të Tjerë k. Moldavisë*, vendimi mbi pranueshmërinë i 4 janarit 2005, Nr. 14462/03 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).
- [98] *Vladimir Vasilyev k. Ruisë*, vendimi mbi pranueshmërinë i 1 korrikut 2010, Nr. 28370/05 §59; *Qendra për Burime Ligjore në emër të Valentin Câmpeanu k. Rumanisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 17 korrikut 2004, Nr. 47848/08 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).
- [99] *Raffay Taddei k. Francës*, 21 dhjetor 2010, Nr. 36435/07.
- [100] *Cătălin Eugen Micu k. Rumanisë*, vendim i 5 janarit 2016, Nr. 55104/13, § 56.
- [101] *Shih Poghosyan k. Gjeorgjisë*, vendim i 29 qershorit 2017, Nr. 33323/08; shih gjithashtu *Ghavitadze k. Gjeorgjisë*, vendim i 3 marsit 2009, Nr. 23204/07, ku Gjykata kërkoi që autoritetet gjeorgjiane të merrnin masat e nevojshme legjislative dhe administrative për të parandaluar përhapjen e sëmundjeve ngjitëse në burgje, si tuberkulozi dhe hepatiti (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim); shih gjithashtu *Shelley k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi mbi pranueshmërinë i 4 dhjetorit 2008, Nr. 23800/06 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).
- [102] *Shih Cătălin Eugen Micu k. Rumanisë*, vendim i 5 janarit 2016, Nr. 55104/13, § 56, ku Gjykata e konsideroi të dëshirueshme që, me pëlqimin e tyre, të burgosurit të kishin qasje, brenda një kohe të arsyeshme pas ardhjes së tyre në burg, në test falas kontrolli për hepatit dhe HIV/Aids; shih gjithashtu *Jeladze k. Gjeorgjisë*, vendim i 18 dhjetorit 2012, Nr. 1871/08, § 44, ku Gjykata vendosi që vonesa treditore para se kërkuesi të kontrollohej për hepatit C përbënte neglizhencë nga ana e Shtetit në lidhje me detyrimet e tij pozitive për të marrë masa efektive për parandalimin e transmetimit të hepatitit C ose sëmundjeve të tjera ngjitëse në burg.

Kërkesat në praktikën gjyqësore për të parandaluar përhapjen e sëmundjeve ngjitëse në vendet ku mbahen njerëzit e burgosur janë shtuar shumë në kontekst të parandalimit të përhapjes së virusit HIV, tuberkulozit dhe hepatitit^[103]. Megjithatë, detyrimet që kanë dalë më përpara theksohen në Deklaratën e parimeve të Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin Çnjerëzor ose Degradues (CPT) në lidhje me trajtimin e personave të privuar nga liria në kontekst të pandemisë Covid-19 (Deklarata e Parimeve e CPT-së).^[104] Deklarata e Parimeve e CPT-së rithekson nevojën për t'i kushtuar vëmendje të veçantë nevojave specifike të personave të ndaluar e posaçërisht grupeve të ndjeshme dhe/ose grupeve në rrezik, siç janë të moshuarit dhe personat me sëmundje ekzistuese. Autoritetet këshillohen të fusin kontrollimin (screening) për Covid-19 dhe të sigurojnë qasje në repartet e kujdesit intensiv ose transferim në spitalet ku lind nevoja.

Për të argumentuar që kushtet e paraburgimit shkelin, ose angazhojnë Nenin 3, është e nevojshme të tregohet se një i paraburgosur është në "rrezik specifik" të infektimit me Covid-19^[105]. Masat e marra nga autoritetet për të parandaluar përhapjen ose rrezikun e infektimit brenda një ambienti paraburgimi kanë rëndësi kur përcaktohet nëse Neni 3 angazhohet në këtë aspekt. Për shembull, kur dy të burgosur iu nënshtruan shtrirjes së detyruar në spital gjatë pandemisë, Gjykata mori parasysh marrjen e masave të mëposhtme për të gjetur që të burgosurit nuk i ishin nënshtruar rrezikut specifik të infektimit me Covid-19, që do të thotë se Neni 3 nuk u angazhua^[106]:

[103] Në kohën e këtij shkrimi, një numër çështjesh të mëtejshme janë në pritje para Gjykatës në lidhje me pajtueshmërinë me Nenin 3 të kushteve të paraburgimit gjatë pandemisë. Këtu përfshihen *Vlamis dhe të Tjerë k. Greqisë*, çështje e komunikuar më 16 prill 2021, Nr. 29655/20 dhe *Riela k. Italisë*, çështje e komunikuar më 5 maj 2021, Nr. 17378/20, të cilat ngrenë pyetjen nëse autoritetet kanë marrë masat të përshtatshme për të mbrojtur shëndetin e kërkuësve të cilët ishin në burg gjatë pandemisë, dhe *Rus k. Rumanisë*, çështje e komunikuar më 11 qershor 2021, Nr. 2621/21 e cila ngre pyetjen nëse fakti që kërkuesi u infektua me Covid-19 në burg shkelti të drejtat e tij të Nenin 3.

[104] Shih <https://rm.coe.int/16809cfa4b> "Deklarata e parimeve në lidhje me trajtimin e personave të privuar nga liria në kontekstin e pandemisë së sëmundjes së koronavirusit (Covid-19)", Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Degradues (CPT), Këshilli i Evropës CPT/Inf(2020)13, 20 mars 2020.

[105] *Ünsal dhe Timtik k. Turqisë*, vendim i 8 qershorit 2021, Nr. 36331/20, §38.

[106] *Ünsal dhe Timtik k. Turqisë*, vendim i 8 qershorit 2021, Nr. 36331/20. Kërkuetit, të cilët u shtruan me detyrim në spital pasi kishin qenë në grevë urie në burg, u ankuan se ishin mbajtur në paraburgim në spitale që përdorshin për të trajtuar pacientët me Covid-19, dhe e konsideruan veten veçanërisht të rrezikuar për shkak të gjendjes shëndetësore delikate si pasojë e grevës së urisë. Megjithatë, Gjykata e gjeti kërkesën e tyre të papranueshme, duke marrë parasysh natyrën e ndërtesave dhe dhomave në të cilat ata ishin mbajtur, dhe masat e marra nga autoritetet për të parandaluar infeksionet. Për shembull, të afërmit e kërkuësve dhe avokatët e tyre mund të

- » Kërkesa që zyrtarët, vizitorët dhe kushdo tjetër që kishte kontakt me një të burgosur të mbante maskë dhe doreza, dhe të mbante distancë fizike nga i burgosuri.
- » Zbatimi i procedurave të dezinfektimit për këdo që hynte në ambientet e paraburgimit.
- » Kërkesa për të paraqitur testin negativ të Covid-19 para hyrjes në ambientet e paraburgimit për të vizituar një të burgosur.
- » Natyra e ndërtesave dhe dhomave në të cilat mbahej i paraburgosuri. Paraburgimi në një dhomë private, me dritare dhe banjo private, ka më pak gjasa të angazhojë nenin 3 sesa paraburgimi në dhomë të përbashkët, për shembull.

Distancimi social, izolimi mjekësor dhe izolimi i vetmuar në burg

Burgosja e një kërkuesi që ka sëmundje të rëndë dhe tepër ngjitëse në një qeli bashkë me të tjerë ose në qeli plot me të tjerë gjithashtu mund të përbëjë shkelje të Nenit 3.^[107] Më tej, paraburgosja e një individi që nuk ka Covid-19 në të njëjtat ambiente me persona që mund ta kenë marrë Covid-19 gjithashtu mund të përbëjë shkelje të Nenit 3^[108]. Nëqoftëse nuk është e nevojshme që një person të vihet në karantinë, për shembull nëse dihet se ai person nuk ka Covid-19, fakti që ai mbahet në kontakt të afërt me persona që "mund" të përbëjnë rrezik për shëndetin e tij (për shembull, për shkak se ata nuk janë testuar për Covid-19) mund të jetë i mjaftueshëm për të përbërë shkelje të Nenit 3, meqenëse këto kushte nuk do të ishin në përputhje me kriteret sanitare dhe higjienike bazë të cilat janë relevante gjatë vlerësimit të përputhshmërisë me nenin 3^[109].

hynin në të njëjtën dhomë me kërkuesit vetëm pasi të kishin kaluar nëpër procedurën e kërkuar të dezinfektimit dhe duhet të mbanin distancë të caktuar, të mos kishin kontakte fizike dhe të bartnin maska dhe doreza. Më tej, spitali kishte kapacitet prej 695 shtretër dhe 139 shtretër të kujdesit intensiv në pesë ndërtesa, dhe vetëm njëra prej këtyre ndërtesave ishte e dedikuar për trajtimin e Covid-19.

[107] *Shih Kotsaftis k. Greqisë*, vendim i 12 qershorit 2008, Nr. 39780/06, §§ 51-61, ku Gjykata e gjeti 'të mjerueshëm' faktin që kërkuesi, i cili vuante nga një sëmundje e rëndë dhe tepër ngjitëse, ishte mbajtur në burg së bashku me dhjetë të burgosur të tjerë në një qeli të mbingarkuar.

[108] *Feilazoo k. Maltës*, vendim i 11 qershorit 2021, Nr. 6865/19 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim), ku kërkuesi u lëviz nga izolimi brenda qendrës së paraburgimit të imigracionit në karantinë për Covid-19 në ambientet ku jetonin të sapoardhurit që nuk ishin testuar për Covid-19. Gjykata gjeti shkelje të Nenit 3, dhe paraburgimi i tij për javë të tëra bashkë me njerëzit që nuk ishin testuar për Covid-19 dhe që mund të kishin paraqitur rrezik për shëndetin e tij u gjet se ishte në papajtueshmëri me "kërkesat sanitare bazë", shih § 92.

[109] *Feilazoo k. Maltës*, vendimi i 11 qershorit 2021, Nr. 6865/19, §92 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

Udhëzimet nga CPT lidhur me këtë çështje këshillojnë që është e domosdoshme që të bëhen përpjekje të harmonizuara nga të gjitha autoritetet relevante për të përdorur metoda alternative ndaj privimit të lirisë për të reedukuar stërbushjen e qendrave të mbajtjes dhe burgjeve. Deklarata e Parimeve e CPT-së sugjeron që shfrytëzimi më i madh i alternativave ndaj paraburgimit paragjyqësor, ulja e dënimeve, lirimi i hershëm dhe lirimi me kusht; rivlerësimi i nevojës për të vazhduar mbajtjen e pavullnetshme të pacientëve të psikiatrisë; lëshimi ose lirimi në kujdesin e komunitetit, ku është me vend, dhe përmbajtje në maksimum nga paraburgimi i migrantëve. Komisioneri për të Drejtat e Njeriut gjithashtu u ka bërë thirrje Shteteve që të lirojnë njerëzit nga paraburgimi i imigracionit në maksimumin e mundësive për të mbrojtur të drejtat e atyre që janë të privuar nga liria për shkak të përhapjes së Covid-19.^[110] Një numër i konsiderueshëm Shtetesh nuk kanë marrë masa për të reduktuar popullatën e burgjeve të tyre gjatë pandemisë, për shembull, në periudhën prej marsit e deri nga mesi i majit 2020, Francë reduktoi popullatën e burgjeve të saj me 13,082 persona më pak, dhe në Gjermani disa shtete i liruuan të burgosurit në fazat e fundit të dënimeve të tyre me burgim për vepra të kundërvajtjes^[111]. Në tërësi, në Evropë, dendësia e burgjeve ra më 5.3% prej janarit 2020 deri në janar 2021, përfshirë rënien me 24.4% në Mal të Zi dhe rënien me 9.7% në Shqipëri^[112]. Ky trend përgjatë Shteteve mund të ketë rëndësi për vlerësimin nëse burgimi i vazhduar i të burgosurve ishte i nevojshëm dhe/ose proporcional në Shtetet ku ata nuk u liruuan.

Kur lirimi nga paraburgimi nuk gjykohet i mundur ose i përshtatshëm, Shtetet duhet të sigurohen që të jetë e mundur që një person që del pozitiv me Covid-19 të izolohet larg të mbajturve/burgosurve të tjerë në kushte të pajtueshme me Nenin 3^[113]. Izolimi mjekësor, izolimi i vetmuar në birucë, ose ndalimi i kontaktit

[110] Shih <https://www.coe.int/en/web/commissioner/-/commissioner-calls-for-release-of-immigration-detainees-while-covid-19-crisis-continues> "Komisioneri kërkon lirimin e të imigrantëve të paraburgosur ndërkohë që kriza e Covid-19 vazhdon", Deklarata nga Komisioneri i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, Këshilli i Evropës, 26 mars 2020.

[111] Shih <https://www.coe.int/en/web/commissioner/-/commissioner-calls-for-release-of-immigration-detainees-while-covid-19-crisis-continues> "Komisioneri kërkon lirimin e të paraburgosurve të imigracionit për sa kohë që vazhdon kriza e Covid-19", Deklaratë e Komisionerit për të Drejtat e Njeriut, Këshilli i Evropës, 26 mars 2020.

[112] https://search.coe.int/directorate_of_communications/Pages/result_details.aspx?ObjectId=0900001680a60a50 "Pandemia Covid-19 ka ndihmuar në reduktimin e popullatës së burgjeve në Evropë: Dalin statistikat penale vjetore të Këshillit të Evropës", Komunikatë Shtypi nga Këshilli i Evropës, 5 prill 2022.

[113] Vini re, në kohën e këtij shkrimi, çështja *Faia k. Italisë*, e komunikuar më 5 maj 2021, Nr. 17378/20, është në

me të burgosurit e tjerë për arsye sigurie, disiplinore, ose mbrojtëse, nuk shkel automatikisht Nenin 3.^[114] Nëse këto masa hyjnë brenda kufijve të Nenit 3 varet nga kushtet e veçanta, rreptësia e masës, kohëzgjatja e saj, objektivi i synuar dhe efektet e saj mbi personin në fjalë.^[115]

Izolimi i plotë ndijmor, i kombinuar me izolimin total social, mund të shkatërrojë personalitetin e individit dhe përbën një formë të trajtimit çnjerëzor i cili nuk mund të justifikohet nga kriteret e sigurisë apo ndonjë arsye tjetër.^[116] Izolimi i vetmuar në birucë, edhe në rastet kur izolimi është vetëm relativ, duhet të bazohet mbi arsye të vërteta, të përdoret vetëm në raste të jashtëzakonshme pasi të shqyrtuar alternativat e tjera, dhe me mbrojtjet e nevojshme procedurale siç është rishikimi i rregullt.^[117] Vendosja në izolim të vetmuar në birucë duhet të marrë parasysh edhe gjendjen shëndetësore të personit në fjalë,^[118] përfshirë shëndetin e tij mendor^[119].

Mund të jetë legjitime që të burgosurit të transferohen në një krah të ndarë të burgut ose në spitalin e burgut në mënyrë që t'u ofrohet një shkallë më e lartë rehatie, ushqim më i mirë, periudha më të gjata ushtrimesh, qasje në kuzhinën dhe banjon e vet, mbikqyrje e rregullt e trajtimit të tyre mjekësor, dhe mbrojtje kundër sëmundjeve ngjitëse. Megjithatë, izolimi nuk duhet të imponohet si masë paraprake mbi ata që nuk dyshohen ta kenë marrë virusin^[120]. Kur Shtetet e pikasin

pritje para Gjykatës. Çështja ka të bëjë me faktin nëse masat e vendosura për të mbrojtur kërkuesin nga Covid-19 (përfshirë izolimin social) kanë shkelur të drejtat e tij të Nenit 3.

[114] *Ramirez Sanchez k. Francës*, vendim i Dhomës së Madhe i 4 July 2006, Nr. 59450/00, § 123.

[115] *Rohde k. Danimarkës*, vendim i 21 korrikut 2005 Nr.69332/01, § 93; *Rzakhanov k. Azerbajxhanit*, vendim i 4 korrikut 2013, Nr. 4242/07, § 64.

[116] *Messina k. Italisë (Nr. 2)*, vendim i 28 shtatorit 2000, Nr. 25498/94.

[117] *A.T. k. Estonisë (Nr. 2)*, vendim i 13 nëntorit 2018, Nr. 70465/14, § 73; *Csüllög k. Hungarisë*, vendim i 7 qershorit 2011, Nr. 30042/08 § 31.

[118] *Jeanty k. Belgjikës*, vendim i 31 marsit 2020, Nr. 82284/17, § 117.

[119] Shih në lidhje me këto çështje dhe debate të ndërlidhura, sidomos trajtimin e të burgosurve gjatë pandemisë, vendimi i Këshillit të Shtetit Francez të 8 tetorit 2020, Nr. N° 444741.

[120] *Feilazoo k. Maltës*, vendimi i 11 qershorit 2021, Nr. 6865/19 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim); shih gjithashtu *Martzaklis dhe të Tjerë k. Greqisë*, vendimi i 9 korrikut 2015, Nr. 20378/13, §§ 67-75, ku Gjykata gjeti shkelje të Nenit 3 vetëm dhe në lidhje me Nenin 14 kur të burgosurit që ishin HIV-pozitivë u vendosën në izolim por virusi HIV nuk ishte zhvilluar në AIDS dhe nuk kishte rrezik që ata t'ia transmetonin HIV të burgosurve të tjerë; dhe <https://www.justiceinitiative.org/uploads/7696dcfd-12e1-4ace-8f28-2a37f4a3c26b/brief-access-to-health-care-in-prisons-07082020.pdf> "E Drejta e Kujdesit Shëndetësor në Burg gjatë Pandemisë Covid-19",

që ka raste në të cilat përdorimi i izolimit në qendra burgimi është i nevojshëm për arsye mjekësore, për të garantuar pajtueshmërinë me Nenin 3, Shtetet duhet:

- i) Të kufizojnë izolimin për arsye mjekësore të të burgosurve që janë të infektuar ose që dyshohet se janë infektuar me Covid-19 për të parandaluar që ta përhapin tek të tjerët.
- ii) Ta përdorin izolimin mjekësor vetëm si zgjidhje të fundit pasi të kenë marrë në konsideratë nëse janë me vend alternativa të tjera, siç është lirimi.
- iii) Të rishqyrtojnë rregullisht nevojshmërinë e vazhduar të izolimit, duke marrë parasysh impaktin në shëndetin mendor të personit dhe nëse ai/ajo vazhdon të dalë pozitiv në testin për Covid-19.
- iv) Të kompensojnë kufizimet e kontakteve me botën e jashtme, përfshirë vizitat, duke shtuar qasjen në mënyrat alternative të komunikimit (si komunikimet telefonike ose përmes VoIP [protokoll-me-zë-përmes-internetit]).
- v) Në rastet e izolimit ose vendosjes në karantinë të një personi të mbajtur i cili është i infektuar ose dyshohet se është infektuar nga virusi, personi në fjalë duhet të ketë kontakte njerëzore kuptimplote çdo ditë.
- vi) Të ofrohet mbështetje e shtuar psikologjike.^[121]

Zbatimi i këtyre parimeve tek popullata e gjerë

Siç shënohet më lart, dhe në seksionin mbi Nenin 5 - E Drejta për Liri, poshtë - ata që ndodhen në izolim ose karantinë në shtëpitë e tyre mund të konsiderohen po ashtu të jenë të 'privuar nga liria e tyre' nga Shteti. Si të tillë, parimet e cekura lart në lidhje me personat e mbajtur në burgje ose ata që jetojnë në institucione të administruara nga Shteti i aplikohen njësoj atyre që janë të izoluar në shtëpitë e veta.

Raportet tregojnë që ka pasur përkeqësim të përgjithshëm të shëndetit mendor gjatë periudhave të mbylljes brenda në shtëpi,^[122] për të cilat izolimi i shtuar dhe

letër informuese nga Iniciativa e Drejtësisë nga Shoqëria e Hapur, korrik 2020.

[121] Shih Deklaratën e CPT-së të Parimeve dhe *Khudobin k. Rusicë*, vendim i 26 tetorit 2006, Nr. 59896/00 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim), ku ndjenja e fortë e pasigurisë dhe frikës e kombinuar me vuajtjet fizike kanë përbërë trajtim brenda kuptimit të Nenit 3.

[122] Shis <https://unicr.org/en/concerns-are-raised-over-the-threat-of-covid-19-to-mental-health-in-europe/> "Shqetësimet e ngritura rreth kërcënimit të Covid-19 për shëndetin mendor në Evropë", Kombet e Bashkuara, 5

reduktimi në qasjen e shërbimeve të shëndetit mendor shihen si shkaktarët kyç.^[123] Prandaj Shtetet duhet të sigurohen që masat e karantinës dhe mbylljes brenda të merren vetëm si zgjidhje e fundit, dhe për një periudhë sa më të shkurtër që të jetë e mundur. Ndërkohë që masa të tilla ekzistojnë, Shtetet duhet të përshtaten dhe të shtojnë ofrimin e shërbimeve të shëndetit mendor dhe format e komunikimit me të tjerët për t'iu kundërvënë impaktit negativ që mund të ketë izolimi tek shëndeti mendor i njeriut, sidomos në situata ku impakti mbi shëndetin mendor mund të jetë aq i rëndë sa të arrijë nivelet që angazhojnë Nenin 3.

Trajtimi i sëmundjeve dhe gjendjeve shëndetësore të tjera përveç Covid-19

Siç u tha më lart në seksionin 2 (Neni 2 - E drejta e jetës), në mënyrë të veçantë nëntitulli "Qasja në trajtimin e sëmundjeve të tjera përveç Covid-19", masat e marra nga Shtetet për të mbrojtur jetën dhe shëndetin kanë pasur efekt mbi qasjen në kujdes shëndetësor për trajtimin e sëmundjeve të tjera ose gjendjeve të tjera shëndetësore. Në këtë aspekt, mund të angazhohet Neni 3 gjithashtu kur një diagnozë e metë ose dështimi për të trajtuar një sëmundje bën që një person të përjetojë sëmundje ose vuajtje që përbëjnë trajtim çnjerësor ose degradues. Shtetet duhet të marrin parasysh natyrën joderoguese të detyrimeve të tyre sipas Neni 3 kur përcaktojnë se cilat shërbime shëndetësore duhet të vazhdojnë të ofrohen gjatë pandemisë. Kujdesi ose trajtimi i sëmundjeve ose gjendjeve shëndetësore që mund të çojnë drejt vuajtjes brenda fushëveprimit të Neni 3 duhet të përkufizohen si shërbime 'esenciale' gjatë pandemisë dhe të vazhdojnë të operojnë brenda mundësive.

Dhuna shtëpiake

Shqetësimet rreth niveleve më të larta të abuzimit kundër grave dhe fëmijëve gjatë pandemisë janë renditur në seksionin mbi Nenin 2 - E drejta e jetës - lart. Ky seksion lidhur me detyrimet sipas Neni 3 të Konventës duhet të lexohet në lidhje me seksionet mbi abuzimin shtëpiak brenda seksioneve në Nenet 2, 8 dhe 14 në kuadër të këtij publikimi.

maj 2020; <https://www.theguardian.com/society/2020/jun/30/uks-mental-health-has-deteriorated-during-lockdown-says-mind> "Shëndeti mendor i Mbretërisë së Bashkuar është përkeqësuar gjatë mbylljes brenda, thotë Mind" nga N. Davis, The Guardian, 30 qershor 2020.

[123] Shih <https://www.health.org.uk/news-and-comment/blogs/emerging-evidence-on-covid-19s-impact-on-mental-health-and-health> "Prova të reja rreth impaktit të Covid-19 mbi pabarazitë në lidhje me shëndetin mendor dhe shëndetin" nga L. Marshall, J. Bibby and I. Abbs, The Health Foundation, 18 qershor 2020.

Neni 3 cakton detyrimet pozitive të Shteteve për t'u siguruar që individët brenda juridiksionit të tyre të jenë të mbrojtur kundër të gjitha formave të keqtrajtimit të ndaluara sipas këtij Neni, përfshirë rastet kur trajtimi ndodh në duart e individëve privatë. Ashtu si tek Neni 2, detyrat procedurale, rregullatore dhe operacionale dalin në pah tek Neni 3 në kontekstin e dhunës shtëpiake. Shtetet kanë detyrimin të parandalojnë abuzimin shtëpiak që të mos ndodhë, dhe të hetojnë, të ndjekin penalisht dhe të ndëshkojnë menjëherë incidentet e dhunës shtëpiake.

Gjykata gjithashtu ka përdorur fjalët e Konventës së Stambollit për të theksuar natyrën specifike të dhunës shtëpiake dhe zellin e posaçëm që nevojitet për të trajtuar rastet e dhunës shtëpiake, duke cekur që ajo imponon një detyrë mbi shtetet që të hetojnë format e dhunës që mbulohen nga Konventa e Stambollit pa vonesa të paduhura dhe të marrë parasysh të drejtat e viktimës gjatë të gjitha fazave të procedurave penale.^[124]

Fëmijët

Shqetësimet në lidhje me keqtrajtimin e fëmijëve gjatë pandemisë që u ngritën në seksionin mbi Nenin 2 lart, njëkohësisht mund të ngrenë çështje sipas Nenit 3, goftë i marrë në lidhje me Nenin 2, 8 dhe 14 apo i vetëm si Neni 3 (për shembull kur Neni 2 nuk është relevant sepse nuk ka kërcënim për jetën).

Për të vlerësuar rreptësinë e trajtimit të kryer kundër një individi, dhe nëse ai hyn brenda fushëveprimit të Nenit 3, duhet të merren në konsideratë 'natyra dhe konteksti i trajtimit, kohëzgjatja e tij, efektet e tij fizike dhe mendore dhe, në disa raste, seksi, mosha dhe gjendja shëndetësore e viktimës'.^[125] Si të tilla, ka më shumë gjasa që keqtrajtimi, i cili nuk është i mjaftueshëm për të angazhuar Nenin 3 në lidhje me të rriturit, do të angazhojë Nenin 3 në lidhje me një fëmijë ose individ tjetër të dobët.

Konventa e Stambollit

Nenin 3§f dhe 2§2 të Konventës së Stambollit i shtrijnë dispozitat brenda Konventës së Stambollit edhe tek fëmijët, edhe si viktima edhe si dëshmitarë të dhunës shtëpiake. Sipas Konventës së Stambollit, është detyra e Shtetit të ngrisë

[124] *Talpis k. Italisë*, vendim i 2 marsit 2017, Nr. 41237/14.

[125] *Opuz k. Turqisë*, vendim i 9 qershorit 2009, Nr. 33401/02 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim); *Costello-Roberts k. the Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 25 marsit 1993, Nr. 13134/87.

vetëdijen mbi pasojat e dhunës (Neni 13) dhe të marrë në konsideratë 'nevojat e veçanta' të dëshmitarëve të dhunës (Neni 56), të cilat mund të përfshijnë 'këshillimin psikologjik' (Neni 26.2). Neni 18 i Konventës së Stambollit riafirmon detyrimin e Shtetit për të ngritur mekanizma preventive dhe për t'u siguruar që të miratohet legjislacioni i duhur për t'i bërë mbrojtjet efektive.

Nën dritën e kriterëve të Konventës së Stambollit, Gjykata gjithashtu ka afirmuar që ndëshkimi i përgjegjësve të dhunës kundër fëmijëve ose në prani të fëmijëve duhet të jetë aq i rreptë sa të veprojë si pengues.^[126]

Konventa e Lanzarotes

Konventa e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Fëmijëve kundër Shfrytëzimit Seksual dhe Abuzimit Seksual (Konventa e Lanzarotes) gjithashtu është relevante në këtë aspekt. Konventa e Lanzarotes kërkon kriminalizimin e të gjitha llojeve të veprave seksuale kundër fëmijëve, dhe përcakton që shtetet në Evropë dhe më gjerë duhet të miratojnë legjislacion të veçantë dhe të marrin masa për të parandaluar dhunën seksuale, për të mbrojtur viktimat fëmijë, dhe për të ndjekur penalisht kryesit. Kjo përfshin detyrimin që procedurat të zhvillohen pa 'vonesë të pajustificuar' për të shmangur vazhdimin e paarsyeshëm të shqetësimit shkaktuar fëmijës.

Fushëveprimi i Nenit 3 në lidhje me abuzimin e fëmijëve

Gjykata ka gjetur shkelje të Nenit 3 në një sërë rrethanash ku abuzimi ose neglizhimi i fëmijëve është gjetur të jetë aq i rreptë sa që përbënte trajtim çnjerëzor dhe degradues, dhe ku autoritetet janë lajmëruar për një trajtim të tillë ose për rrezikun e një trajtimi të tillë, por kanë dështuar në marrjen e veprimeve të arsyeshme për ta parandaluar atë. Lista këtu poshtë jep shembuj të situatave të cilat janë gjetur se përbëjnë shkelje të Nenit 3:

- i) Dështimi për të ofruar mbrojtje të mjaftueshme kundër abuzimit fizik, përfshirë ndëshkimin.^[127]

[126] *D.M.D. k. Rumanisë*, vendim i 3 tetorit 2017, Nr. 23022/13.

[127] *A. k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 23 shtatorit 1998, Nr. 100/1997/884/1096; ku rrahjet e përsëritura të një djali 9-vjeçar me shkop nga njerku i tij u vlerësuan se kishin arritur 'niveлин minimal të rreptësisë' i nevojshëm për të nxitur aplikimin e Nenit 3.

- ii) Dështimi për të parandaluar abuzimin e zgjatur të një djali me paaftësi fizike dhe mendore në duart e një grupi fëmijësh, ku abuzimi ka shkaktuar lëndime fizike.^[128]
- iii) Dështimi për t'i futur fëmijët e neglizhuar në Regjistrin e Mbrojtjes së Fëmijëve ose vonesa në vendosjen nën kujdes të fëmijëve të neglizhuar.^[129]
- iv) Dështimi në parandalimin e fëmijëve nga të qenit dëshmitarë të dhunës shtëpiake të kryer kundër të afërmve.^[130]
- v) Vonesë në hetimet rreth abuzimit fizik dhe emocional, dhe dështimi për të ofruar kompensim viktimës për vonesën ose për abuzimin.^[131]

Të gjithë shembujt e renditur lart janë situata të cilat mund të bëhen më të shpeshta në kontekstin e pandemisë, për shkak të ekspozimit të shtuar të lëndimeve mes fëmijëve të cilët janë të detyruar të qëndrojnë në shtëpi, dhe reduktimin e kapacitetit për të adresuar, parandaluar, ndjekur penalisht dhe ndëshkuar lëndime të tilla. Kur Shtetet lajmërohen për kërcënimet për trajtim çnjerëzor dhe degradues kundër fëmijëve, ato duhet të marrin masa për të ndërhyrë dhe për të parandaluar shkeljen e Nenet 3. Ndërkohë që burimet mund të jenë ngushtuar dhe shërbimet mund të jenë reduktuar për shkak të pandemisë, kjo nuk mund të përdoret si shfajësim për t'i injoruar këto probleme dhe për të vonuar zgjidhjen e tyre, ku një mosveprim i tillë rrezikon shkeljen e Nenet 3.

[128] *Dordevic k. Kroacisë*, vendim i 24 korrikut 2012, Nr. 41526/10, ku Gjykata gjeti shkelje të Neneve 3, 8 dhe 13 për shkak të dështimit të autoriteteve për të vepruar, pavarësisht nga fakti që nëna e kishte sjelle abuzimin në vëmendje të autoriteteve.

[129] *Z dhe të Tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 10 majit 2001, Nr. 29392/95, ku fëmijët iu nënshtruan abuzimit emocional dhe neglizhimit të rëndë fizik nga prindërit e tyre që rezultuan në lëndime fizike dhe psikologjike. Trajtimi i fëmijëve përbëri trajtim çnjerëzor dhe degradues sipas Nenet 3 dhe, meqenëse autoritetet lokale ishin vënë në dijeni të situatës por fëmijët u çuan në emergjencë katër vjet e gjysmë më vonë, Shteti kishte dështuar në detyrimet e tij pozitive sipas nenet 3.

[130] *E.S. dhe të Tjerë k. Sllovakisë*, vendim i 15 shtatorit 2009, Nr. 8227/04.

[131] *Shih D.M.D. k. Rumanisë*, vendim i 3 tetorit 2017, Nr. 23022/13, ku u gjet shkelje e detyrimit procedural sipas Nenet 3 kur hetimet për abuzimin nga babai i kërkuesit zgjatën tre vjet e gjashtë muaj, gjykatat vendase nuk i ofruan kompensim viktimës për vonesën ose për abuzimin e pësuar prej tij, dhe procedurat dështuan në mbrojtjen e dinjitetit të fëmijës përmes dhënies së mbrojtjes kundër keqtrajtimit, në shkelje të Nenet 3 të Konventës.

Azilkërkuesit dhe migrantët

Rreziku që disa prej masave të miratuara nga Shtetet në emër të mbrojtjes së shëndetit mund të shkelin Nenin 3 ka qenë veçanërisht akut në kontekstin e masave të marra në lidhje me personat në tranzit, për shembull migrantët dhe azilkërkuesit. Përpjekjet për të kërkuar azil janë penguar nga mbyllja e qendrave përpunuese të këtyre kërkesave, dhe disa Shtete kanë jetësuar masa për mbajtje masive për të parandaluar lëvizjen e hyrjeve dhe daljeve nga territori i tyre^[132]. Covid-19 po ashtu ngre çështje të reja sipas Nenet 3 në kontekstin e ekstradimit dhe dëbimit^[133].

Qendrat për pritjen, identifikimin ose regjistrimin e migrantëve

Shtetet Kontraktuese kanë të drejtën, e ngulitur tashmë në të drejtën ndërkombëtare dhe në përputhje me detyrimet e tyre sipas traktatit, përfshirë Konventën, për të kontrolluar hyrjen, qëndrimin (rezidencën) dhe dëbimit të të huajve.^[134] Për shumë dekada, Shtetet kanë mbajtur njerëz që kanë hyrë të territoret e tyre në qendra paraburgimi të krijuara me qëllim të ushtrimit të një kontrolli të tillë. Masat e futura për të kufizuar lëvizjen si reagim ndaj pandemisë Covid-19 kanë përfshirë gjithashtu mbajtjen masive të njerëzve në tranzit nëpër qendra mbajtëse të përkohshme. Siç u diskutua në seksionin 2 (Neni 5 - E drejta e lirisë) mbajtja masive pa leje për t'u larguar nga këto qendra mund të përbëjë privim të lirisë sipas Nenet 5 të KEDNj-së^[135]. Kur ndodh kjo, detyrimet e Shteteve për të mbrojtur shëndetin dhe sigurinë e personave të privuar nga liria (diskutuar në seksionin 2 (Neni 3 - Mbrojtja nga trajtimi çnjerëzor dhe degradues) e veçanërisht nëseksioni (a) (Kujdesi shëndetësor i të paraburgosurve dhe kushtet e paraburgimit)) shtrihen edhe tek personat e mbajtur në qendra të tilla.

[132] Shih dekretin e 7 prillit 2020 nga Qeveria Italiane ku portet italiane deklarohen të pasigurta dhe synohet mbrojtja e funksionalitetit të strukturave shëndetësore kombëtare dhe përmbajtja e përhapjes së koronavirusit.

[133] Shih Giulia Borgna, "Covid-19: Paraburgimi parakujdesor në fazën ekzekutive të ekstradimit", 2 korrik 2020, ku komentohet vendimi i Gjykatës Supreme të Kasacionit në Itali më 26 qershor 2020 në lidhje me impaktin e pandemisë Covid-19 në zbatimin e urdhrave të ekstradimit. Në <https://www.extradando.com/people#giulia-borgna>. Shih gjithashtu Suzanne Lambert "COVID-19 and Immigration Detention", 30 prill 2020. Në <https://ukhumanrightsblog.com/2020/04/30/covid-19-and-immigration-detention/>

[134] *Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 28 majit 1985, Nr. 9214/80, 9473/81 dhe 9474/81, Seria A Nr. 94, § 67; *Ilias dhe Ahmed k. Hungarisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 21 nëntorit 2019, Nr. 47287/15, § 125.

[135] Rrjeti i OKB-së për Migracionin, "Covid-19 & Paraburgimi i Imigracionit: Çfarë Mund të Bëjnë Qeveritë dhe Aktorët e Tjerë?", prill 2020, mund të gjendet në: <https://www.refworld.org/docid/5eac26514.html>

Më tej, edhe kur azilkërkuesit nuk mbahen në kushte të cilat përbëjnë privim të lirisë, mund të dalin çështje sipas Nenit 3 nëqoftëse atyre nuk u ofrohet akomodim dhe kushte të mjaftueshme pritjeje.^[136] Mbjajtja e azilkërkuesve në kushte të pista, të mbingarkuara, pa qasje në ujë, sapun, sende tualeti ose pajisje të tjera sanitare mund të përbëjë trajtim çnjerëzor dhe degradues, në shkelje të Nenit 3.^[137] Azilkërkuesit bëjnë pjesë në një popullatë posaçërisht të prekshme dhe të paprivilegjuar, në nevojë për mbrojtje të veçantë, dhe Gjykata duhet të marrë parasysh standardet e cekura në Direktivën e Kushteve të Pritjes^[138] gjatë vlerësimit të kushteve në të cilat po mbahen ata.^[139]

Janë ngritur shqetësime rreth kushteve në të cilat janë mbajtur të kufizuar azilkërkuesit në rajonet kufitare të Ballkanit Perëndimor dhe Greqisë gjatë pandemisë, përfshirë raporte për turma të stërmbushura, mungesë qasjeje në kujdes shëndetësor, ushqim, higjienë, ujë dhe pajisje sanitare, dhe pengimi i punonjësve humanitarë ose atyre mbështetës nga hyrja nëpër qendra për të ofruar ndihmë dhe përkrahje.^[140]

Gjykata e adresoi këtë çështje kur mori një masë të përkohshme ku i kërkohet autoriteteve greke që të transferonin një individ, ose së paku të garantonin për të, në ambiente akomodimi në kushte pritjeje të përputhshme me Nenin 3, duke marrë parasysh moshën e tij dhe detyrimin për të ofruar kujdes shëndetësor dhe ndihmëse të mjaftueshme për të, në përputhje me gjendjen e shëndetit të tij.^[141] Gjykata i njohu vështirësitë me të cilat përballet qeveria greke në përpjekje për të mbrojtur popullatën e vet nga përhapja e Covid-19. Megjithatë, vendimi i përkohshëm thoshte që Shtetet ende duhet të merrnin të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur personat në qendrat e pritjes nga infektimi me Covid-19, përfshirë qasjen e përshtatshme dhe të kohshme në konsultime mjekësore, kujdesin dhe mbështetjen e mjaftueshme mjekësore, plotësimin e nevojave bazike si ushqim,

[136] *N.T.P. dhe të Tjerë k. Francës*, vendim i 24 majit 2018, Nr. 68862/13.

[137] *N.T.P. dhe të Tjerë k. Francës*, vendim i 24 majit 2018, Nr. 68862/13; A.A. k. Greqisë, vendim i 22 korrikut 2010, Nr. 12186/08, §§ 57-65.

[138] Shih <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32013L0033&from=EN> "Direktiva për Kushtet e Pritjes", Direktiva 2013/33/EU e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, 26 qershor 2013.

[139] *M.S.S. k. Belgjikës dhe Greqisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 21 janarit 2011, Nr. 30696/09, § 251.

[140] Shih <https://committees.parliament.uk/writtenevidence/4655/html/> "Raporti Special mbi Covid-19 dhe Dhunën Kufitare nëpër Udhët Ballkanike" Raport i Rrjetit Monitorues për Dhunën Kufitare, 8 prill 2020.

[141] Shih *M. A. k. Greqisë*, vendim i përkohshëm i 7 prillit 2020, Nr.15782/20; https://c7db895f-7823-4bab-aca6-270af12c4d6b.usrfiles.com/ugd/c7db89_b689018d5b144e4fb261cff12f8e77ac.pdf.

ujë dhe sapun, dhe garantimi që individët të jenë në gjendje të veprojnë në pajtim me kërkesat e higjienës personale.

Aplikimet për azil

Refuzimi për t'u lejuar azilkërkuesve mundësinë e aplikimit për azil kur hyjnë në një territor po ashtu mund të përbëjë shkelje të Nenit 3.^[142] Mund të dalin çështje nga Neni 13 në lidhje me Nenin 3, kur një person i pranishëm në një territor nuk mundet të bëjë aplikim për azil^[143] ose kur një aplikim i tillë nuk shqyrtohet seriozisht.^[144] Shtetet janë të detyruara sipas Nenit 4 të Protokollit Nr. 4 që të ofrojnë qasje të vërtetë dhe efektive ndaj instrumenteve për hyrjen e ligjshme, në veçanti procedurat kufitare, për të lejuar të gjithë personat që përballen me persekutim që të bëjnë aplikim për mbrojtje, duke u bazuar posaçërisht mbi Nenin 3, në kushte të cilat sigurojnë që aplikimi të procesohet në një mënyrë të përputhshme me normat ndërkombëtare përfshirë Konventën.^[145]

Mbyllja e pikave të kalimit kufitar, qendrave të aplikimit për azil dhe institucioneve ose gjykatave përgjegjëse për procesimin e dosjeve të azilit ka penguar kapacitetin e azilkërkuesve për të aplikuar për azil, dhe ka ndikuar në shkallën e shqyrtimit të duhur të kërkesave për azil gjatë pandemisë.^[146] Gjithashtu ka pasur raportime që Shtetet kanë përdorur rrethanat e pazakonta për të "justifikuar" shtyrjet e transferimet masive të grupeve të migrantëve dhe azilkërkuesve nëpër kufij në emër të mbrojtjes së shëndetit të atyre në territorin e Shtetit nga rreziku i përhapjes së sëmundjes nga ata që janë në tranzit.^[147] Ndërkohë që mund të duhen masa të reja për të procesuar aplikimet për azil në mënyrë të sigurtë, pandemia nuk duhet të përdoret për të justifikuar refuzimin për

[142] *Sharifi dhe të Tjerë k. Italisë dhe Greqisë*, vendim i 21 tetorit 2014, Nr. 16643/09.

[143] *A.E.A. k. Greqisë*, vendim i 15 marsit 2018, Nr. 39034/12.

[144] *M.S.S. k. Belgjikës dhe Greqisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 21 janarit 2011, Nr. 30696/09, §§ 265-322.

[145] *N.D. dhe N.T. k. Spanjës*, vendim i Dhomës së Madhe i 13 shkurtit 2020, Nr. 8675/15 dhe 8697/15.

[146] Shih për shembull vendimin e autoriteteve franceze për të ndaluar krejtësisht procesimin e dosjeve të azilit, për shkak të mbylljes së shërbimeve përkatëse dhe mungesës së stafit. Më 30 maj, Këshilli i Shtetit urdhëroi Ministrinë e Brendshme të rifillonte regjistrimin e kërkesave për azil, duke theksuar se emergjenca shëndetësore nuk duhet t'i privonte azilkërkuesit nga kjo e drejtë themelore: https://www.liberation.fr/direct/element/le-conseil-detat-ordonne-la-reprise-de-lenregistrement-des-demandes-dasile-en-ile-de-france_113019/ "Këshilli i Shtetit urdhëron rifillimin e regjistrimit të kërkesave për azil në Ile-de-France", lajm nga Liberation, 1 maj 2020.

[147] Shih <https://www.borderviolence.eu/nees-from-trieste-covid-19-and-pushbacks/> "Lajme nga Trieste: Covid-19 dhe zmbarsjet", Raport i Rrjetit Monitorues për Dhunën në Kufij, 5 qershor 2020.

t'i privuar ata që mund të kërkojnë azil nga kjo mundësi, dhe shtyrjet e paligjshme nuk duhet të përdoren në asnjë rrethanë.^[148]

Procedurat e largimit dhe ekstradimit

Përveç problemeve në lidhje me mbajtjen e imigrantëve, Neni 3 gjithashtu ka të bëjë edhe me vendimet për të larguar ose ekstraduar persona drejt një vendi ku ekziston rreziku që ata do t'u nënshtrohen kushteve që shkelin Nenin 3.

Ekstradimi

Neni 3 u vë Shteteve detyrimin për të mos ekstraduar një person drejt një vendi ku janë treguar baza substanciale për të besuar se personi në fjalë, po të ekstradohet, do të përballë me rrezikun real të trajtimit në kundërshtim me Nenin 3 në vendin pritës.^[149] Për shembull, kur ka baza substanciale për të besuar se personi do t'i nënshtrohet dënimit me vdekje,^[150] dënimit me burgim të përjetshëm pa mundësi lirimi, ose kushteve të paraburgimit që janë në shkelje të kriterëve të përcaktuara në seksionin (a) lart, përfshirë kushtet e paraburgimit që janë të papërshtatshme për dobësitë specifike të individit në fjalë.^[151]

Gjykata vendosi për impaktin e pandemisë Covid-19 mbi çështjen nëse do të ekzistonte rreziku real i shkeljes së Nenit 3 për shkak të kushteve të paraburgimit me të cilat do të përballë një individ po të ekstradohej në Shtetet e Bashkuara, në një çështje ekstradimi para Gjykatës në lidhje me një burrë gjashtëdhjetëvjeçar me "disa sëmundje", përfshirë diabet dhe azma.^[152] Vendimi i Gjykatës në këtë çështje

[148] Shih <https://www.coe.int/en/web/commissioner/-/pushbacks-and-border-violence-against-refugees-must-end> "Shtyrjet prapa dhe dhuna në kufij kundër refugjatëve duhet të marrë fund", Deklaratë e Këshillit të Evropës, 19 qershor 2020.

[149] *Soering k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 7 korrikut 1989, Nr. 14038/88, §§ 88-91.

[150] *Soering k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 7 korrikut 1989, Nr. 14038/88; *Rrapo k. Shqipërisë*, vendim i 25 shtatorit 2012, Nr. 58555/10.

[151] *Shih Aswat k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 16 prillit 2013, Nr. 17299/12, në lidhje me ekstradimin e një individi mendërisht të sëmurë.

[152] *Shih Hafeez k. Mbretërisë së Bashkuar*, i komunikuar më 24 mars 2020, Nr. 0. Në komunikimin e çështjes, përveç pyetjes rreth dënimit me burgim të përjetshëm pa mundësi lirimi, Gjykata shtoi një pyetje specifike lidhur me rreziqet e Covid-19 me këtë formulim: "2. Duke pasur parasysh në mënyrë të veçantë pandeminë në vazhdim të Covid-19, nëse kërkuesi do të ekstradohej a do të kishte rrezik real për shkelje të Nenit 3 të Konventës për shkak të kushteve të paraburgimit me të cilat do të përballë pas mbërritjes?"

do të ketë implikime në lidhje e impaktin e Covid-19 mbi kushtet e parburgimit në sistemet e burgut përtej kontekstit të ekstradimit, meqenëse vlerësimi nëse është plotësuar kriteri i nivelit minimal të rreptësisë për qëllime të Neni 3 është i njëjti pavarësisht nëse konteksti është vendas apo ekstraterritorial.^[153]

Largimi

Në raste shumë të pazakonta, Neni 3 gjithashtu i ndalon Shtetet nga largimi i një personi të sëmurë rëndë nga territori kur ka baza substanciale për të besuar se ai do të përballet me rrezikun real, për shkak të mungesës së trajtimit të përshtatshëm në vendin pritës, të ekspozimit ndaj një rënieje serioze, të shpejtë dhe të pakthyeshme të gjendjes shëndetësore, që do të rezultojë me vuajtje të mëdha ose reduktim domethënës të jetëgjatësisë së pritshme.^[154] Shtetet duhet të marrin në konsideratë: (a) nëse kujdesi i përgjithshëm në dispozicion në Shtetin pritës është "i mjaftueshëm dhe i përshtatshëm në praktikë për trajtimin e sëmundjes së kërkuesit në mënyrë që të ndalojë që ai të ekspozohet ndaj trajtimit në kundërshtim me Nenin 3"; dhe (b) shkalla deri ku individ faktikisht do të kishte qasje në një kujdes të tillë në Shtetin pritës (kostot e atij kujdesi, ekzistenca e rrjetit social dhe familjar, dhe distanca që duhet udhëtuar për të marrë kujdesin e kërkuar, ku të gjitha janë relevante në këtë pikë).

Është e paqartë nëse mund të aplikohet ky detyrim për t'i ndaluar Shtetet nga largimi i një personi që po vuan nga Covid-19 drejt një vendi tjetër. Megjithatë, është e mundur që kjo situatë të dalë, nëse impakti i Covid-19 mbi individin në fjalë vlerësohet se mund të ketë impakt të rëndë mbi shëndetin e personit dhe nëse ai potencialisht hiqet prej aty për t'u dërguar drejt një vendi pa qasje në pajisje të mjaftueshme mjekësore për t'u trajtuar, për shembull, një vend i cili ka mungesë të ventilatorëve.

Në situatën e pazakontë të pandemisë globale është e pasigurt se si do të interpretohet nocioni themelor i "rrezikut" nga Gjykata në të gjitha rastet e largimit, pavarësisht a bëhet fjalë për ekstradim apo për azil. Situata është edhe më komplekse, e pasigurt dhe ndryshon vazhdimisht në krahasim me situatat që ka trajtuar më parë Gjykata në praktikën e saj gjyqësore në lidhje me këtë

[153] *Babar Ahmad dhe të Tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 10 prillit 2012, Nr. 24027/07, 11949/08, 36742/08, 66911/09 dhe 67354/09, §172.

[154] *Paposhvili k. Belgjikës*, vendim i Dhomës së Madhe i 13 dhjetorit 2016, Nr. 41738/10, §183 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

temë.^[155] Në lidhje me vështirësitë me të cilat përballen Shtetet evropiane sa u përket standardeve ekonomike dhe mjekësore, ndërkohë që shume vende evropiane kanë pasur mungesa në pajisje mjekësore dhe kanë pasur vështirësi me kapacitetet e tyre për të trajtuar Covid-19, mund të jetë e vështirë të thuhet se largimi i dikujt drejt një vendi tjetër e vë një person në rrezik të infektimit ose të mos qenit në gjendje të marrë trajtimin e duhur mjekësor.

b. Detyrimet procedurale hetimore

Ashtu si Neni 2, edhe Neni 3 përmban detyrimin e spikatur procedural të zhvillimit të hetimeve efektive rreth shkeljet e supozuara të Nenit. Shtetet kanë detyrimin e parandalimit dhe ofrimit të zgjidhjeve për tortura dhe forma të tjera të keqtrajtimit, dhe Neni 3 kërkon që të ketë hetime efektive zyrtare rreth pretendimeve të argumentueshme për tortura ose keqtrajtime. Shih seksionin 1 (Neni 2 - e drejta e jetës) lart, në mënyrë të veçantë nënseksioni (b) Detyrimet procedurale hetimore, dhe seksionin 3 (Neni 6 - e drejta për seancë dëgjimore të drejtë) poshtë, për të parë diskutimin e plotë mbi mënyrat se si pandemia Covid-19 krijon pengesa për plotësimin e këtij detyrimi procedural dhe mënyrat se si mund të tejkalohen probleme të tilla në mënyrë të pajtueshme me Konventën.

[155] *Shih N. k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i Dhomës së Madhe i 27 majit 2008, Nr. 26565/05; *D. k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 2 majit 1997, Nr. 30240/96; ose më së fundi në *Paposhvili k. Belgjikës*, vendim i Dhomës së Madhe i 13 dhjetorit 2016, Nr. 41738/10 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

3. Neni 8 - E drejta për respekt ndaj jetës private dhe familjare

E drejta për respekt ndaj jetës private dhe familjare sipas Nenit 8 është e gjerë nga fushëveprimi. Ajo u cakton Shteteve detyrimin për t'u siguruar qytetarëve të vet të drejtën e respektit efektiv të integritetit të tyre fizik dhe psikologjik.^[156] Kjo përfshin detyrimet për të mbrojtur shëndetin aty ku lëndimet apo sëmundja në fjalë nuk e ka arritur nivelin e rreptësisë që kërkohet për të nxitur detyrimet për të mbrojtur jetën ose shëndetin sipas Neneve 2 ose 3, por sidoqoftë kualifikohet si e tillë që mbrohet nga Neni 8.

Aspekte të shumta të reagimeve qeveritare ndaj Covid-19 për të mbrojtur shëndetin gjithashtu prekin aspekte të tjera të të drejtave të mbrojtura nga Neni 8. Për shembull, kufizimet në kohën e shpenzuar me familjarët, kufizimet në mënyrat se si lejohen të kryhen varrimet, dhe kufizimet në lëvizje të shoqëruara nga përdorimi i vëzhgimit. Neni 8 parashikon:

"1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij.

2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve."

Seksioni (a) sipër përshkruan disa prej mënyrave të shumta se si angazhohet Neni 8 nga reagimet e Qeverive ndaj pandemisë, duke theksuar situatat kur dalin në pah detyrimet pozitive, ose në të cilat ka ndërhyrje në Nenin 8. Sadoqë ndërhyrjet në Nenin 8 nuk përbëjnë domosdoshmërisht shkelje të Nenit, Neni 8 § 2 vë në dukje disa situata në të cilat ndërhyrja mund të justifikohet. Kështu, seksioni (b) poshtë diskuton kushtet në të cilat ndërhyrjet tek Neni 8 të diskutuara në seksionin (a) mund të lejohen sipas Nenit 8 § 2.

[156] *Nitecki k. Polonisë*, vendimi për pranueshmërinë i 21 marsit 2002, Nr. 65 653/01 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

a. Fushëveprimi i Nenit 8

Kujdesi dhe trajtimi shëndetësor

Neni 8 përfshin detyrimin e Shtetit për të pasur rregullore që obligojnë si spitalet publike ashtu edhe ato private që të miratojnë masat e duhura për mbrojtjen e integritetit fizik të pacientëve dhe t'u ofrojnë viktimave të neglizhencës mjekësore qasje në procedura në të cilat, në rastet e përshtatshme, ata mund të marrin kompensim për dëmin e pësuar.^[157] Parimet që aplikohen sipas Neneve 2 dhe 3 në këtë kontekst^[158] gjithashtu aplikohen edhe sipas Nenit 8 në rast lëndimi që nuk arrin të kërcënojë të drejtën e jetës siç garantohet nga Neni 8 ose i cili nuk arrin nivelin e kërkuar të rreptësisë për të përbërë trajtim çnjerëzor dhe degradues sipas Nenit 3.^[159]

Covid-19 ka pasur një sërë efektesh të ndryshme në shëndetin e njerëzve të ndryshëm. Në disa raste, ai ka shkaktuar vuajtje të jashtëzakonshme dhe ka përbërë kërcënim për jetë (duke angazhuar kështu detyrimet për të mbrojtur jetën dhe shëndetin sipas Neneve 2 dhe 3), në raste të tjera simptomat kanë qenë më të buta. Në këto raste, simptomat ende mund të prekin integritetin e personit, për shembull nëse ai ka temperaturë të lartë, kollë të vazhdueshme ose humbjen e shqisës së të shijuarit dhe të nuhaturit, duke angazhuar kështu Nenin 8. Prandaj, mund të ekzistojë detyrimi sipas Nenit 8 që Shtetet të obligojnë si spitalet publike ashtu edhe ato private që të marrin masat e duhura për mbrojtjen e pacientëve të tyre nga Covid-19 në të gjitha rastet kur Covid-19 prek integritetin fizik të personit.

Ekzistojnë dy aspekte kyçe të detyrimit të Shteteve për të ofruar trajtim kundër Covid-19 për individët brenda juridiksionit të tyre^[160]:

[157] *Vasileva k. Bullgarisë*, vendim i 17 marsit 2016, 23796/10, § 63; *Jurica k. Kroacisë*, vendim i 2 majit 2017, Nr. 30376/13 § 84; *Mehmet Ulusoy dhe të Tjerë k. Turqisë*, vendim i 3 majit 2007, Nr. 34797/03, § 82.

[158] Për diskutimin e plotë të këtyre parimeve shih seksionet 1 (e drejta e jetës) dhe 2 (mbrojtja nga trajtimi çnjerëzor dhe degradues) të Kapitullit II të këtij publikimi.

[159] *Ibrahim Keskin k. Turqisë*, vendim i 27 marsit 2018, Nr. 10491/12, § 61.

[160] Shih gjithashtu Komentin e Përgjithshëm Nr. 14 „E drejta për standardin më të lartë të arritshëm shëndetësor“ të Komitetit të OKB-së për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, 11 gusht 2000 (E/C.12/2000/4), ku shënohet:

“[Neni 12.2 (c). E drejta për parandalimin, trajtimin dhe kontrollimin e sëmundjeve]

16. ... Kontrollimi i sëmundjeve i referohet ... zbatimit ose intensifikimit të programeve të imunizimit dhe strategjive të tjera për kontrollimin e sëmundjeve infektive.

- i) Masat parandaluese, që kanë të bëjnë veçanërisht me politikat e vaksinimit dhe testimet masive të popullatës në përpjekje për të kufizuar përhapjen e virusit; dhe
- ii) Trajtimin mjekësor të njerëzve të infektuar me Covid-19.

Parandalimi i infektimit me Covid-19

Tri prej strategjive kryesore të miratuara nga qeveritë me qëllim që të mbrojnë popullatën e tyre nga infektimi me Covid-19 përfshijnë: vendimin për mbylljen brenda dhe masat e distancimit social (që diskutohen më hollësisht në seksionet Neni 5 (E drejta e lirisë) dhe Neni 2 i Protokollit Nr. 4 (E drejta e lirisë së lëvizjes) në këtë publikim; zbatimin e programeve të vaksinimit; dhe futja e testeve masive të popullatës. Dy masat e fundit kanë impakt të drejtpërdrejtë mbi të drejtat e garantuara nga Neni 8, siç diskutohet më poshtë.

Vaksinimi

Gjatë pandemisë, përpjekjet për të kufizuar përhapjen dhe impaktin e saj u fokusuan gjithnjë e më shumë në përpunimin, prodhimin dhe nxjerrjen e një vaksine kundër Covid-19. Autoritetet e Shteteve dhe organet publike dhe private ndërkombëtare në tërë globin morën masa legjislative, administrative dhe organizative për të realizuar zbatimin e suksesshëm të programeve të vaksinimit^[161].

...

Shtetet duhet të sigurojnë ofrimin e kujdesit shëndetësor, përfshirë programet e imunizimit kundër sëmundjeve infektive kryesore ...

44. Komiteti gjithashtu konfirmon që pikat e mëposhtme janë detyrime me prioritet të krahasueshëm:

...

(b) Të ofrohet imunizimi kundër sëmundjeve infektive kryesore që shfaqen në komunitet;

(c) Të merren masa për të parandaluar, trajtuar dhe kontrolluar sëmundjet epidemike dhe endemike."

[161] Për shembull, në nivel të BE-së, më 17 qershor 2020, Komisioni Evropian miratoi një strategji evropiane për përshejtimin e zhvillimit, prodhimin dhe shpërndarjes së vaksinave kundër Covid-19 në tërë Evropën, duke njohur nevojën urgjente për përpunimin e një vaksine për të luftuar pandeminë (shih: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?qid=1597339415327&uri=CELEX:52020DC0245>, Komunikimet nga Komisioni, Strategjia e BE-së për vaksinat e Covid-19, Bruksel, 17.06.2020, COM (2020) 245 finale). Më 24 mars 2021, u prezantua një Program për aksionin e Bashkimit Evropian në fushën e shëndetësisë ('EU4Health Programme') për periudhën 2021-2027 (shih: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32021R0522>, Rregullorja (EU) 2021/522 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 24 mars 2021). Programi inkurajon marrjen e masave të koordinuara në nivel të Unionit, përfshirë dispozitat e informimit për të adresuar hezitimet lidhur me

Zbatimi i programeve të vaksinimit mund të analizohet nga së paku dy këndvështrime sipas Konventës. Së pari, siç diskutohet në seksionin mbi Nenin 2 (E drejta e jetës) në këtë publikim, Shtetet mund të konsiderohet se kanë një detyrim sipas Konventës që të ofrojnë qasje në vaksinim si mënyrë efektive për të bërë imunizimin, për të mbrojtur shëndetin e popullatës së tyre dhe potencialisht edhe të drejtën e tyre të jetës. Nga ana tjetër, miratimi i politikave të vaksinimit, e posaçërisht politika e vaksinimit të detyrueshëm, ngre çështje të shumta politike, sociale dhe ligjore^[162] dhe rrezikon të ndërhyjë tek të drejtat e garantuara në Nenin 8. Më tej, kur qasja në hapësira të caktuara jepet varësisht nga statusi i vaksinimit, vaksinimi i detyrueshëm gjithashtu mund të ndërhyjë tek e drejta e një personi për edukim, punësim, lëvizje të lirë, besim fetar dhe tubim.

Skemat vullnetare të vaksinimit, të cilat janë dizajnuar për të mbrojtur shëndetin e shoqërisë, dhe të cilat i nënshtrohen një sistemi të fortë kontrolli për të minimizuar rreziqet e mundshme, nuk përbëjnë ndërhyrje tek e drejta për respekt të jetës private sipas Neni 8^[163]. Kur vendoset skema e vaksinimit vullnetar, nuk ka detyrim nga Neni 8 që një Shtet të japë informacione specifike apo teknike në lidhje me kundër-indikacionet ose rreziqet e asociuara me vakcina të caktuara. Është legjitime që Shteti të mbajë pikëpamjen se ekziston dijenia e përgjithshme që skemat e vaksinimit përfshijnë disa rreziqe të caktuara, por që vlerësimi teknik i kundër-indikacioneve është çështje e cila më mirë të lihet në dorën e gjyqimeve klinike sesa, për shembull, në dorën e prindërve të fëmijës që vaksinohet^[164].

Megjithatë, është më pak e qartë nëse vaksinimi i detyrueshëm kundër Covid-19 do të përbënte ndërhyrje tek Neni 8 dhe, po të ishte kështu, nëse detyrimi për të

vaksinën dhe promovimin e kërkimeve rreth zhvillimit të vaksinave, parashtrimin e procedurave të Komunitetit për autorizimin dhe mbikqyrjen e produkteve medicinale dhe ngritjen e një Agjencie Mjekësore Evropiane. Shih gjithashtu në lidhje me masat organizative në nivel të BE-së aktivitetin e Qendrës Evropiane për Parandalimin dhe Kontrollimin e Sëmundjeve, në <https://www.ecdc.europa.eu/en/covid-19>.

[162] Për shembull, në çështjen *Vavříčka k. Republikës Çeke*, vendimi i Dhomës së Madhe i 8 prillit 2021, Nr. 47621/13 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim), duke pasur parasysh vështirësinë dhe kompleksitetin e problemit, Dhoma së cilës i ishin caktuar këto çështje ia dorëzoi juridiksionin Dhomës së Madhe. Shih gjithashtu: <https://www.ejiltalk.org/some-vaccination-questions-ethical-and-legal/>, "Pyetje rreth Vaksinimit, Aspekte Etike dhe Ligjore", Marko Milanovic, 3 shkurt 2021, për diskutime mbi një sërë pyetjesh të ngritura, përfshirë faktin se cilat Shtete (nëse ka) janë të detyruara të vaksinojnë popullatat e rajoneve të kontestuara dhe nëse e si Shtetet do të duhej t'u jepnin përparësi vaksinimi grupeve të caktuara.

[163] *Shoqata X. k Mbretërisë së Bashkuar*, Vendimi i Komisionit Evropian i 12 korrikut 1978, Nr.7154/75.

[164] *Shoqata X. k Mbretërisë së Bashkuar*, Vendimi i Komisionit Evropian i 12 korrikut 1978, Nr.7154/75

ofruar imunizim ndaj virusit do të kishte peshë më të madhe sesa e drejta për të zgjedhur vaksinimin ose jo-vaksinimin.

Vaksinimi i detyrueshëm

Gjatë vazhdës së pandemisë, Shtetet kanë ndërmarrë qasje të ndryshme për të inkurajuar marrjen e vaksinave. Disa shembuj përfshijnë:

- » Austria ka futur vaksinimin e detyrueshëm për të gjithë personat mbi moshën 18 vjeç, me dënime deri në 3,600 Euro për ata/ ato që e refuzojnë vaksinën (nëqoftëse nuk janë shtatzënë ose të sëmurë rëndë). Megjithatë, ligji u suspendua një muaj pas miratimit dhe u anulua katër muaj pas hyrjes në fuqi.
- » Shumë Shtete, përfshirë Franca, Greqia, Hungaria, Italia dhe Letonia, futën vaksinimin e detyrueshëm për profesione të caktuara, si punonjësit e shëndetësisë dhe punonjësit e institucioneve shëndetësore.
- » Shtete të tjera futën instrumentin e 'letërnjoftimit vaksinues' ose certifikatës së vaksinimit, që e kushtëzonte udhëtimin ose hyrjen në ambiente të caktuara si restorante, ambiente argëtimi dhe dyqane me provën e vaksinimit.

Vaksinimi i detyrueshëm, si ndërhyrje mjekësore e pavullnetshme, vërtet përbën ndërhyrje tek e drejta e respektit për jetën private sipas Nenit 8^[165]. Gjykata e njuh faktin që vaksinimi i detyrueshëm ndikon tek gëzimi nga një individ i të drejtave të tij më intime^[166] dhe ngre çështje të ndjeshme morale dhe etike^[167].

[165] *Solomachin k. Ukrainës*, vendimi i 15 marsit 2012, nr. 24429/03, § 33 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim), dhe *Vavříčka k. Republikës Çeke*, vendimi i Dhomës së madhe i 8 prillit 2021, Nr. 47621/13, § 263 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim). Çështja e fundit kishte të bënte me vaksinimin e detyrueshëm kundër poliomiellitit, hepatitit B, dhe sëmundjeve të tjera (pa përfshirë Covid-19), dhe refuzimin e prindërve për t'i lejuar fëmijët e tyre që të vaksinohen. Megjithatë, seanca e Dhomës së madhe në këtë çështje u zhvillua më 1 korrik 2020, në mes të debateve rreth vaksinimit kundër Covid-19. Numri i ndërhyrjeve të palëve të treta në seancë, disa prej të cilave iu referuan direkt pandemisë Covid-19, tregon rëndësinë e çështjes për situatën në Evropë gjatë pandemisë (për shembull, ndërhyrja e palës së tretë nga Qeveria e Francës, e përmbledhur në §§ 120-125 të vendimit).

[166] *Vavříčka k. Republikës Çeke*, vendimi i Dhomës së Madhe i 8 prillit 2021, Nr. 47621/13, § 276 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim) dhe referencat që jepen aty për *Solomachin k. Ukrainës*, vendimi i 15 marsit 2012, Nr. 24429/03 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[167] *Vavříčka k. Republikës Çeke*, vendimi i Dhomës së Madhe i 8 prillit 2021, Nr. 47621/13, § 276 (i përfshirë si

Megjithatë, kur një skemë e vaksinimit të detyrueshëm hyn në fuqi me qëllim të mbrojtjes kundër sëmundjeve të cilat paraqesin rrezik serioz për shëndetin, ajo mund të vlerësohet se i shërben 'qëllimeve legjitime' sipas Nenit 8 të mbrojtjes së shëndetit dhe mbrojtjes së të drejtave të të tjerëve, nëse rrit shkallën e marrjes së vaksinave. Gjykata njeh se vaksinat mund të jenë të rëndësishme jetike për mbrojtjen e shëndetit të personave të vaksinuar, e njëkohësisht edhe mbrojtjen e shëndetit të atyre që nuk mund të vaksinohen e që rrjedhimisht janë në kushte të cenueshme dhe mbështeten në arritjen e shkallës së lartë të vaksinimit brenda shoqërisë për mbrojtje kundër sëmundjes ngjitëse në fjalë^[168].

Qasja në vaksinim

Siç diskutohet në seksionin rreth Nenit 2 (E drejta e jetës) të këtij publikimi^[169], zbatimi i një programi të vaksinimit përpunet me qëllimet e mbrojtjes së shëndetit dhe mbrojtjes së jetës së të tjerëve, dhe mund të jetë një mekanizëm përmes të cilit Shtetet përmbushin detyrimet e tyre pozitive sipas Neneve 2, 3 dhe 8, për të mbrojtur jetën dhe shëndetin e qytetarëve të tyre. Gjykata^[170] dhe shumë prej Shteteve^[171] i janë referuar faktit që një politikë efektive vaksinimi është pjesë e detyrës pozitive të autoriteteve për të mbrojtur shëndetin.

Megjithatë, si pasojë e zhvillimit të papritur dhe të shpejtë të pandemisë Covid-19, institucionet shëndetësore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar nuk qenë në gjendje të krijonin, prodhonin dhe shpërndanin menjëherë sasi të mjaftueshme vaksinash për të kufizuar ose ndaluar përhapjen e virusit në mënyrë efektive. Ndërkohë që lindi nevoja jetike për prodhimin e shpejtë të një

përmbledhje në këtë publikim).

[168] *Vavříčka k. Republikës Çeke*, vendimi i Dhomës së Madhe i 8 prillit 2021, Nr. 47621/13, § 276 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[169] Shih analizën e detyrimeve pozitive për të mbrojtur jetën në seksionin e këtij Udhërrëfyesi: Neni 2 – E drejta e jetës, duke iu referuar në mënyrë të veçantë *Lopes de Sousa Fernandes k. Portugalisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 19 dhjetorit 2017, Nr. 56080/13, § 166.

[170] *Vavříčka k. Republikës Çeke*, vendimi i Dhomës së Madhe i 8 prillit 2021, Nr. 47621/13, § 282 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim). Shih gjithashtu opinionin pjesërisht pajtues e pjesërisht mospajtues të Gjyqarit Lemmens, në §2, ku ai deklaron qartë: "Siç e bën të qartë vendimi, detyra e vaksinimit është një prej mënyrave që autoritetet zgjedhën për të përmbushur detyrimin e tyre pozitiv për të mbrojtur të drejtën e shëndetit"

[171] *Vavříčka dhe të tjerë k. Republikës Çeke*, vendimi i Dhomës së Madhe i 8 prillit 2021, Nr. 47621/13 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim). Shih qëndrimet e Qeverisë së Republikës Çeke tek § 197, Qeverisë së Francës tek §212, Qeverisë së Gjermanisë tek § 220 dhe Qeverisë së Sllovakisë tek § 229.

vaksine kundër Covid-19, çdo vaksinë e tillë gjithashtu duhet të ishte e sigurt dhe efektive^[172]. Në këto kushte, nuk qe e mundur që autoritetet të ofronin një vaksinë kundër virusit për çdo individ. Sidomos në fillim të pandemisë, Shtetet u desh të kishin prioritet se cilat grupe do ta merrnin vaksinën e Covid-19, kur furnizimet me vakcina ishin të pakta^[173]. Shumë Shtete hartuan politika vaksinimi të cilat fillimisht i dhanë përparësi vaksinimit të moshave të caktuara ose kategorive të cenueshme me qëllim të shtrirjes së vaksinimit tek të gjithë individët në një fazë të mëvonshme.

Për të përmbushur plotësisht detyrimet e Neneve 2, 3, 8 dhe 14, çdo politikë vaksinimi duhet të jetë në dispozicion dhe efektive. Kjo do të thotë që përpunimi dhe shpërndarja e vaksinave duhet të jetë në përputhje me ligjet dhe procedurat përkatëse që qeverisin autorizimin e vaksinimit. Më tej, kriteret e përdorura për të përcaktuar se kush e merr vaksinën, dhe kur, duhet të jenë objektive, të bazuara në rekomandime shkencore, dhe duhet të jenë në pajtueshmëri me parimet e transparencës dhe mos-diskriminimit. Për shembull, parimet e Institutit të së Drejtës Evropiane në lidhje me shpërndarjen e barabartë të vaksinave rekomandojnë që rendi i përparësisë, gjatë ngritjes graduale të kapaciteteve vaksinuese, duhet të vlerësohet përgjithësisht sipas katër kritereve^[174]:

- i) cenueshmëria për shkak të efekteve akute të Covid-19 dhe varianteve të tij;
- ii) rreziku më i lartë për shkak të mungesës së kujdesit shëndetësor;
- iii) rreziku domosdoshmërisht më i madh i faktorit të përhapjes dhe shumimit dhe/ose kontaktit sistematik me persona të sëmurë dhe të dobët, deri në atë masë sa që vaksinimi i pengon personat e vaksinuar nga përhapja e virusit; dhe

[172] Për shembull, para Gjykatës së Përgjithshme të BE-së doli një çështje e ngritur nga 775 kërkues kundër Komisionit Evropian (çështja numër T-695/21) për dështimin e këtij të fundit për të përfshirë testimin e karcinogjenitetit dhe gjenotoksicitetit në fazën paraklinike për teknologjinë e vaksinave mRNA, siç ishte për luftimin e Covid-19, para autorizimit.

[173] Shih: <https://gh.bmj.com/content/6/2/e004462>: "Një qasje e ndërthurur e të drejtave të njeriut në priorizimin e vaksinave të Covid-1", Sekalala S, Pehudoff K, Parker M, et al. BMJ Global Health, 24 shkurt 2021.

[174] https://www.europeanlawinstitute.eu/fileadmin/user_upload/p_eli/Publications/2021_Supplement_to_the_ELI_Principles_for_the_COVID-19_Crisis.pdf "Parimet ELI për Krizën Covid-19", Suplementi i vitit 2021. Shih gjithashtu <https://rm.coe.int/dh-bio-statement-vaccines-e/1680a12785> "COVID-19 dhe vaksinat: Sigurimi i qasjes së barabartë ndaj vaksinimit gjatë pandemisë aktuale dhe pandemive të ardhshme", Komiteti i Këshillit të Evropës për Bioetikë (DH-BIO), 22 janar 2021.

- iv) kontakti sistematik me persona të sëmurë dhe të dobët, si dhe me individë kyç për funksionimin e Shtetit Publik.

Politikat e vaksinimit po ashtu duhet të përfshijnë masa për të vënë në shënjestër çështjen e shpërndarjes së vaksinave të rreme për të shmangur praktika të cilat mund të vënë në rrezik shëndetin e njeriut^[175].

Testimi për Covid-19

Marrja e mostrave të gjakut ose e strishove të hundës është një ndërhyrje mjekësore e cila, edhe pse e rëndësishë së vogël, përbën ndërhyrje tek e drejta e respektit për jetën private^[176]. Strishot janë një metodë e testimit për Covid-19. Ndërkohë që ato përbëjnë ndërhyrje tek të drejtat e Nenit 8, Gjykata njëkohësisht ka afirmuar se marrja e strishos është veprim me kohëzgjatje të shkurtër, zakonisht nuk shkakton lëndime trupore ose vuajtje fizike apo mendore, dhe përgjithësisht justifikohet kur bëhet në përputhje me ligjin për një qëllim legjitim^[177].

Bartja e maskës

Detyrimi për të bartur maskën në publik dhe në ambiente private si dyqane, barnatore, ose gjatë udhëtimit, po ashtu mund të ngrejë çështje nga Neni 8. Zgjedhjet personale lidhur me paraqitjen e individit, pavarësisht nga ambientet publike apo private, kanë të bëjnë me shprehjen e personalitetit të individit e rrjedhimisht hyjnë brenda nocionit të jetës private. Nocioni i jetës private gjithashtu mbron të drejtën e identitetit dhe zhvillimit të marrëdhënieve me qenie të tjera njerëzore si dhe botën e jashtme. Prandaj, ekziston një zonë ndërveprimi e një personi me të tjerët, edhe në kontekst publik, e cila mund të hyjë brenda fushëveprimit të "jetës private" dhe e cila mund të ndikohet nga detyrimi për të bartur maskë^[178].

[175] Shih „*Këshilla mbi aplikimin e Konventës së MEDICRIME në kontekstin e Covid-19*“, dhënë nga Komiteti i Palëve në Konventën e MEDICRIME, Strasburg, 8 prill 2020, për të luftuar dukurinë e vaksinave të kontrabanduara ose të falsifikuara të Covid-19.

[176] *Schmidt k. Gjermanisë*, vendimi për pranueshmërinë i 5 janarit 2006, Nr. 32352/02; *Caruana k. Maltës*, vendimi për pranueshmërinë i 15 majit 2018, Nr. 41079/16.

[177] *Caruana k. Maltës*, vendimi për pranueshmërinë i 15 majit 2018, Nr. 41079/16.

[178] Shih *S.A.S. k. Francës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 1 korrikut 2014, Nr. 43835/11, §§ 106-107, *Gough k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 28 tetorit 2014, Nr. 49327/11, §§ 182-184.

Ndërhyrjet te ky aspekt i të drejtës së jetës private përgjithësisht janë gjetur se janë të justifikuar kur një Shtet arrin të identifikojë qartë se si ndërhyrja në fjalë i ka shërbyer një qëllimi legjitim të identifikuar si duhet. Në kontekstin e bartjes së maskës, kjo me gjasë nënkupton që të dhënat dhe rekomandimet shkencore justifikojnë bartjen e maskës, marrjen parasysh të rrezikut të infektimit në hapësira të caktuara dhe potencialin që ka bartja e maskës për ta luftuar atë rrezik^[179].

Trajtimi mjekësor i njerëzve të infektuar me Covid-19

Neni 8 gjithashtu angazhohet në kontekstin e trajtimit të Covid-19. Shtetet kanë detyrimin pozitiv për të marrë të gjitha masat legjislative, operacionale dhe institucionale që mund të ndërmerren me arsye, për të ofruar trajtimin e nevojshëm për njerëzit e infektuar me virus^[180]. Në këtë kontekst, strategjitë për trajtimin e përshtatshëm janë diskutuar dhe dakorduar në nivel evropian^[181]. Ky detyrim përfshin detyrën për të shmangur trajtimin i cili mund të jetë i rrezikshëm për shëndetin e njeriut, ose dukshëm joefektiv^[182].

[179] Krahaso *Gough k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 28 tetorit 2014, Nr. 49327/11, §155 me *Biržietis k. Lituanië*, vendimi i 14 qershorit 2016, Nr. 49304/09, §§ 53-58; në këtë të fundit pati shkelje të Nenit 8 kur Qeveria nuk kishte qenë në gjendje të identifikonte qartë ose të jepte shembuj të qartë se si lënia e mjekrës mund të çonte drejt trazirave ose krimeve. Shih gjithashtu urdhrin e Tribunalit Administrativ të Strasburgut të 20 majit 2020 për të pezulluar një dekret të Qytetit të Strasburgut që detyronte të gjithë personat 11 vjeç e sipër që të bartnin maska gjatë kohës që dilnin nëpër qytet: <http://strasbourg.tribunal-administratif.fr/content/download/171091/1705849/version/1/file/2003058-1.pdf> (Ordonnance n°2003058 du 25 Mai 2020, Tribunal Administratif de Strasbourg). Tribunali iu referua Nenit 8 të KEDNJ-së dhe parimeve të qëllimit legjitim dhe proporcionalitetit, duke gjetur se masa nuk ishte e justifikuar nga një arsye bindëse e lidhur me rrethanat në Strasburg. Mbi bazën e të njëjtave parime, më 2 shtator 2020 Tribunali e anuloi dekretin dhe ftoi autoritetet vendase që ta ndryshonin atë.

[180] *Vavříčka dhe të Tjerë k. Republikës Çeke*, vendimi i Dhomës së Madhe i 8 prillit 2021, Nr. 47621/13, § 282, *Ibrahim Keskin k. Turqisë*, vendimi i 27 marsit 2018, Nr. 10491/12, §§ 61-70; *Mehmet Hasan Altan k. Turqisë*, vendimi i 20 marsit 2018, Nr. 13237/17, §§ 82-90, etj.

[181] Komunikimi nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian për Strategjinë e Rajoneve të BE-së mbi Terapinë e Covid-19 (COM/2021/355 final/2), 6 May 2021.

[182] Për shembull, trajtimi i Covid-19 me remdesivir. Shih: <https://www.who.int/news-room/feature-stories/detail/who-recommends-against-the-use-of-remdesivir-in-covid-19-patients>, Shënimi i publikuar më 20 nëntor 2020 nga Organizata Botërore e Shëndetësisë ku këshillohet kundër përdorimit të remdesivir për trajtimin e Covid-19.

Përveç kësaj, çështjet që kanë të bëjnë me prioritizimin dhe qasjen e barabartë në trajtim mjekësor (të diskutuara lart në kontekstin e politikave të vaksinimit) gjithashtu i aplikohen detyrimet për të ofruar trajtim mjekësor gjatë pandemisë Covid-19, sipas Neneve 2, 3 dhe 8 të marrë ndaras ose në lidhje me Nenin 14. Numri dhe pesha e rasteve të infektimit me Covid-19 nënkuptoi që autoritetet u detyruan të bënin zgjedhje të vështira gjatë miratimit të politikave prioritare për trajtimin mjekësor të njerëzve të infektuar me Covid-19, duke pasur parasysh presionin ekstrem mbi sistemet e tyre shëndetësore^[183]. Çdo vendim për t'u dhënë prioritet grupeve ose individëve të caktuar para të tjerëve duhet të merret mbi bazën e kritereve të qarta dhe politikave shëndetësore objektive të justifikuar. Më tej, siç diskutohet në seksionin mbi Nenin 2 (E drejta e jetës) në këtë publikim, ku diskutohen detyrimet procedurale në lidhje me neglizhencën mjekësore, Shtetet janë gjithashtu të detyruara sipas Nenit 8 që të ngrenë mekanizma për të identifikuar si duhet dhe për të korrigjuar mangësitë sistematike në ofrimin e trajtimit mjekësor kundër Covid-19^[184].

Qasja në informacionet lidhur me shëndetin

E drejta për qasje efektive në informacione rreth shëndetit po ashtu hyn në fushëveprimin e të drejtës private dhe familjare.^[185] Shtetit mund t'i kërkohet të japë informata thellore për rreziqet që i kanosen shëndetit të njerëzve në mënyrë të kohshme,^[186] për shembull kur Shteti zhvillon aktivitete me rrezikshmëri të cilat mund të kenë pasojë të fshehura të pafavorshme për shëndetin e personave të përfshirë në këto aktivitete. Në situata të tilla, Shteti duhet të ketë procedura efektive dhe të lehta për t'u qasur të cilat t'u mundësojnë këtyre personave të kërkojnë informacionet relevante dhe të përshtatshme.^[187] Ky detyrim mund të aplikohet në kontekstin e pandemisë, ku njerëzve iu kërkua të shkojnë në punë në ambiente ku ka rrezik të marrjes së virusit Covid-19.

[183] Shih: <https://oecd.org/coronavirus/policy-responses/beyond-containment-health-systems-responses-to-covid-19-in-the-oecd-6ab740c0/> "Përtej përmbajtjes: Reagimet e sistemeve shëndetësore ndaj Covid-19 në OECD", 16 prill 2020. Shih gjithashtu Komunikatën nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetin e Rajoneve të BE-së për Strategjinë e Terapisë së Covid-19 (COM/2021/355 final/2), 6 maj 2021.

[184] *Ibrahim Keskin k. Turqise*, vendimi i 27 marsit 2018, Nr. 10491/12, §§ 61-68.

[185] *K.H. dhe të Tjerë k. Sllovakisë*, vendimi i 28 prillit 2009, Nr. 32881/04, § 44.

[186] *Guerra dhe të Tjerë k. Italisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 19 shkurtit 1998, Nr. 14967/89 §§ 58 dhe 60 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[187] *McGinley dhe Egan k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 9 qershorit 1998, Nr. 23414/94, 21825/93; §§ 97 dhe 101; *Roche k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i Dhomës së Madhe i 19 tetorit 2005, Nr. 32555/96, § 167

Shëndeti mendor

Shëndeti mendor është aspekt thelbësor i integritetit moral, dhe hyn brenda fushveprimit të Nenit 8. Ruajtja e stabilitetit mendor shihet nga Gjykata si parakusht i domosdoshëm për gëzimin efektiv të të drejtës për respekt të jetës private.^[188] Siç u diskutua në seksionet mbi Nenet 2 dhe 3 të këtij publikimi, ka pasur përkeqësim të shëndetit mendor gjatë pandemisë.^[189]

Detyrimet rregullatore dhe operacionale të Shteteve sipas Neneve 2 dhe 3 mund të hyjnë në lojë për të mbrojtur njerëzit nga impakti i masave të mbylljes në shtëpi kur impakti është kaq i madh sa që përbën trajtim çnjerëzor dhe degradues ose përbën kërcënim për jetën e tyre nga vetëlëndimi. Detyrimet pozitive për të marrë masa për të mbrojtur shëndetin mendor të popullatës së prekur nga masat e marra si reagim ndaj pandemisë mund të dalin edhe sipas Nenit 8. Këtu mund të përfshihen detyrimet për të përshtatur dhe shtuar qasjen në shërbimet e mbështetjes për shëndetin mendor, siç u diskutua në seksionet mbi Nenet 2 dhe 3. Po ashtu, mund të përfshijë mbrojtjen e të drejtës për jetë familjare kur mungesa e mundësisë për kontakte fizike ose mbështetje emocionale personale do të dëmtonte seriozisht ekuilibrin emocional dhe psikologjik të personit.^[190] Shtetet duhet të ekuilibrojnë nevojën për të mbrojtur shëndetin nga Covid-19 kundër impaktit që mund të ketë izolimi mbi shëndetin mendor të njeriut, kur formulojnë politikat mbi distancimin social dhe rregulloret për vizitat familjare.

Dhuna shtëpiake

Siç u shënuar në seksionet mbi Nenet 2, 3 dhe 14 në këtë publikim, ka tregues që abuzimet shtëpiake kundër grave dhe fëmijëve janë shtuar, dhe që ka pasur

[188] *Bensaid k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 6 shkurtit 2001, Nr. 44599/98, § 47.

[189] Shih seksionet 1 (E drejta e jetës) dhe 2 (Mbrojtja nga trajtimi çnjerëzor dhe degradues) të Kapitullit II të këtij publikimi.

[190] *Shih Sommerfeld k. Gjermanisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 8 korrikut 2003, Nr. 31871/96, §§ 64-65; *Buscemi k. Italisë*, vendim i 16 shtatorit 1999, Nr. 29569/95, § 55, ku një vajzë 13-vjeçare kishte shprehur dëshirën e qartë për të mos e takuar më babain e saj, dhe kështu kishte bërë për vite me radhë, dhe ku të detyruarit e saj për ta takuar atë do të shqetësonte së tepërmi ekuilibrin e saj emocional dhe psikologjik, vendimi për të refuzuar kontaktet me babain u mor të ishte në interesin më të mirë të fëmijës. Mund të jetë, në të kundërt, që aty ku mungesa e kontaktit/mundësisë për të kontaktuar me anëtarët e familjes mund të kishte efekt trazues në ekuilibrin psikologjik të një personi, angazhohet po ashtu edhe Neni 8.

rritje në dobësitë e fëmijëve dhe të rinjve gjatë pandemisë.^[191] Siç u diskutua në seksionet mbi Nenet 2 dhe 3, në disa situata, Shtetet janë të detyruara të marrin masa për të ndaluar, parandaluar, hetuar, ndjekur penalisht, dhe ndëshkuar aktet e dhunës të kryera nga individë privatë. Detyrimet për të ndaluar, parandaluar, hetuar, ndjekur penalisht, dhe ndëshkuar që mund të dalin nga Nenet 2 dhe 3^[192] mund të dalin po ashtu edhe nga Neni 8 kur aktet mes individëve nuk janë mjaft të rrepta sa të angazhojnë Nenet 2 ose 3, por kur ato shkelin integritetin moral, fizik ose personal të personit.^[193]

Sipas Neni 8 Shtetet kanë për detyrë të mbrojnë integritetin fizik dhe moral të një individi nga shkelja e tij prej personave privatë. Kjo detyrë pozitive shfaqet veçanërisht kur bëhet fjalë për mbrojtjen e individëve të dobët, dhe përfshin mbrojtjen e grave dhe fëmijëve kundër abuzimit shtëpiak.^[194] Format e abuzimit ose lëndimit të cilat mund të nxisin mbrojtjen e Neni 8 përfshijnë akte që dhunojnë integritetin personal të cilat nuk ngërthejnë dhunë fizike ose kërcënim për jetën.^[195] Shtetet kanë detyrime pozitive për të konstatuar dhe zbatuar në mënyrë efektive një sistem që ndëshkon të gjitha format e dhunës shtëpiake^[196] dhe abuzimin kundër individëve të dobët që mund të ketë impakt mbi integritetin e tyre fizik, moral ose personal. Kjo mund të përfshijë lëndueshmërinë (ekspozimin ndaj ngacmimeve të mundshme), neglizhimin, shfrytëzimin ose abuzimin emocional, si dhe dhunën fizike.

[191] Shih seksionin lart dhe <https://learning.nspcc.org.uk/media/2246/isolated-and-struggling-social-isolation-risk-child-maltreatment-lockdown-and-beyond.pdf> "Të izoluar dhe duke u përpjekur: izolimi social dhe rreziku i keqtrajtimit të fëmijëve, në mbyllje brenda dhe përtej", E. Romanou dhe E. Belton, NSPCC Evidence team, qershor 2020.

[192] Për diskutimin e plotë rreth kritereve për ndaljen në pah të këtij detyrimi dhe fushëveprimin e detyrimeve, shih seksionet 1 (E drejta e jetës) dhe 2 (Mbrojtja nga trajtimi çnjerëzor dhe degradues) të Kapitullit II të këtij publikimi.

[193] *Bevacqua dhe S. k. Bullgarisë*, vendim i 12 qershorit 2008, Nr. 71127/01.

[194] *Shih X dhe Y k. Holandës*, vendim i 26 marsit 1985, Nr. 8978/80, ku Gjykata vërejtë që Shtetet kanë detyrimin pozitiv të ofrojnë mbrojtje dedikuar fëmijëve dhe individëve të tjerë të prekshëm përmes masave të 'pengimit efektiv kundër shkeljeve të rënda të integritetit personal'.

[195] *Shih Söderman k. Suedisë*, vendim i 12 nëntorit 2013, Nr. 5786/08, ku Gjykata gjeti që Shteti kishte dështuar në pajtueshmërinë me Nenin 8 për të pasur një kornizë ligjore për t'i ofruar kërkueses mbrojtje kundër veprimeve konkrete të njerkut të saj dhe për t'i ofruar asaj zgjidhje për shkeljet vijuese të integritetit të saj persona kur ai ishte përpjekur ta filmonte atë fshehurazi në banjo kur ajo kishte qenë 14 vjeçe. Akti në këtë çështje nuk përfshinte dhunë fizike, por Gjykata konkludoi që në ligjet suedeze nuk ekzistonte asnjë zgjidhje penale e as zgjidhje civile që mund t'i mundësonte kërkueses të merrte mbrojtje efektive kundër dhunimit të integritetit të saj personal.

[196] *Opuz k. Turqisë*, vendim i 9 qershorit 2009, Nr. 33401/02 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

Dhuna shtëpiake mund të ndikojë në mirëqenien fizike dhe mendore të fëmijëve, jo vetëm si pasojë e të qenit viktima të praktikave të tilla, por edhe indirekt kur detyrohen të bëhen dëshmitarë të akteve të dhunës fizike kundër motrës ose vëllait apo prindërve. Të dëshmuarit e dhunës mund të përbëjë trajtim çnjerëzor dhe degradues në shkelje të Nenit 3.^[197] Megjithatë, Gjykata është marrë gjithashtu me impaktin e dëshmimit të dhunës në mirëqenien psikologjike të fëmijës sipas Nenit 8, dhe ka gjetur shkelje të Nenit 8 kur mirëqenia psikologjike e fëmijëve kërkues është prekur negativisht nga të qenit viktima të abuzimit verbal si dhe të qenit dëshmitarë të dhunës së babait kundër nënës, dhe pak ose aspak është bërë për të parandaluar përsëritjen e sjelljeve të tilla.^[198]

Privatësia, mbledhja dhe ruajtja e të dhënave

Ruajtja e informatave mbi jetën private të individit përbën ndërhyrje në Nenin 8. Se çka nënkupton informata mbi jetën private të individit varet nga konteksti specifik në të cilin është regjistruar dhe ruajtur informata, natyra e regjistrimit, mënyra se si është përdorur dhe procesuar regjistrimi, dhe rezultatet që mund të jenë arritur.^[199] Gjykata ka gjetur që kërkesa që një person të japë informacion të plotë rreth vendndodhjes dhe aktiviteteve të veta përbën ndërhyrje në të drejtën për jetë private.^[200] Masat e marra për të gjurmuar vendndodhjen e personave që janë objekt i masave të karantinës siç është përdorimi i lokacionit të celularit të tyre ose trafikun e të dhënave^[201] po ashtu me gjasë përbëjnë ndërhyrje në Nenin 8.

[197] Shih seksionin mbi Nenin 3 (Mbrojtja nga trajtimi çnjerëzor dhe degradues) i Kapitullit II të këtij publikimi.

[198] *Eremia dhe të Tjerë k. Republikës së Moldavisë*, vendim i 28 majit 2013, Nr. 3564/11.

[199] *S. dhe Harper k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i Dhomës së Madhe i 4 dhjetorit 2008, Nr. 30562/04 dhe 30566/04, § 67 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[200] *Shih Federata Kombëtare e Shoqatave të Unioneve të Sportistëve (FNASS) dhe të Tjerë kundër Francës*, vendim i 18 janarit 2018, Nr. 48151/11 dhe 77769/13, §§ 155-159, ku Shteti u kërkoi sportistëve të nivelit të lartë që të jepnin, në intervale tremujore, informacione të plota rreth vendndodhjes së tyre dhe aktiviteteve të tyre ditore, përfshirë në fundjava, dhe t'i përditësonin ato informacione, si pjesë e përpjekjeve kundër dopingut në sport; shih gjithashtu *Uzun k. Gjermanisë*, vendim i 2 shtatorit 2010, Nr. 35623/05, §§ 51-53, ku mbledhja përmes një pajisjeje GPS të vendosur në makinën e një personi dhe ruajtja e të dhënave lidhur me vendndodhjen e atij personi dhe lëvizjet e tij në sferën publike u gjet se përbënin ndërhyrje në jetën private.

[201] Shih për shembull deklaratën e presidentit serb që Shteti po gjurmonte telefonat celularë të njerëzve që hynin në vend për të monitoruar lëvizjet e tyre: <https://mondo.rs/Info/Drustvo/a1298105/Aleksandar-Vucic-policija-telefonski-brojevi-policijski-sat-upozorenje-krecu-se.html> "Vučić: Mos i lini telefonat, nuk na mashtron! E DIMË që po lëvizni!", Izvor, Mondo, 19 mars 2020.

Mbrojtja e të dhënave personale ka rëndësi themelore në mënyrë që një person të gëzojë të drejtën e vet për jetë private,^[202] dhe mbledhja dhe ruajtja e të dhënave personale, përdorimi, zbulimi, publikimi dhe mbajtja e mëtejshme e të dhënave personale gjithashtu hyjnë brenda fushëveprimit të Nenit 8. Respektimi i konfidencialitetit të të dhënave shëndetësore është parim jetik për të siguruar respektin ndaj privatësisë së pacientit, por njëkohësisht ndihmon vazhdimësinë e besimit të pacientëve në profesionin mjekësor dhe shërbimet shëndetësore. Shkelja e këtij besimi do t'i pengonte ata që kanë nevojë për ndihmë mjekësore nga dhënia e informatave personale dhe intime nëse ato janë të nevojshme në mënyrë që ata të marrin trajtimin e duhur, e madje edhe mund t'i pengojë ata nga marrja e ndihmës për fare, çka do të rrezikonte vetë shëndetin e tyre dhe, në rastin e sëmundjeve të transmetueshme, shëndetin e komunitetit.^[203] Mbledhja e të dhënave mjekësore nga institucionet përgjegjëse për monitorimin e cilësisë së kujdesit mjekësor^[204] dhe zbulimi i informacioneve mjekësore pa pëlqimin e personit tek gazetarët, prokurorët,^[205] departamente të tjera qeveritare ose shërbyes civilë,^[206] punëdhënësi i një personi^[207] ose vetë familjarët e tyre^[208] të gjitha përbëjnë ndërhyrje në Nenin 8^[209].

Masat e marra nga Shtetet për të luftuar Covid-19, për shembull futja e aplikacioneve mobile për gjurmimin e kontakteve dhe ndarja e të dhënave shëndetësore me Shtetet e tjera për hulumtime mjekësore, përfshijnë mbledhjen

[202] *Satakunnan Markkinapörssi Oy dhe Satamedia Oy k. Finlandës*, vendim i Dhomës së Madhe i 27 qershorit 2017, Nr. 931/13, § 133.

[203] *L.H. k. Letonisë*, vendim i 29 prillit 2014, Nr. 52019/07 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[204] *L.H. k. Letonisë*, vendim i 29 prillit 2014, Nr. 52019/07 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[205] *Avilkina dhe të Tjerë k. Rusisë*, vendim i 6 qershorit 2013, Nr. 1585/09, § 54.

[206] *M.S. k. Suedisë*, vendim i 27 gushtit 1997, Nr. 20837/92, § 35.

[207] *Radu k. Moldavisë*, vendim i 15 prillit 2014, Nr. 50073/07 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[208] *Mockutė k. Lituanisë*, vendim i 27 shkurtit 2018, Nr. 66490/09.

[209] Për shembull, për sa u përket të dhënave të pacientëve me Covid-19, Gjykata Kushtetuese e Bullgarisë ka vendosur në lidhje me kushtetutshmërinë e disa dispozitave të së drejtës bullgare për mediat elektronike të 24 marsit 2020, duke lejuar qasje në të dhënat e trafikut. Gjykata Kushtetuese vendosi që mundësia e Ministrisë së Brendshme për të pasur qasje në këto të dhëna, të mbledhura në mënyrë të përgjithshme e jo selektive, për një periudhë prej gjashtë muajsh dhe jo të kufizuar brenda kohëzgjatjes së gjendjes së jashtëzakonshme, për të gjurmuar vendndodhjen e personave të sëmurë, ishte e paligjshme dhe joproporcionale. Gjykata Kushtetuese lejoi qasje vetëm në të dhënat e personave që uanin nga sëmundje të transmetueshme dhe kundërshtoi izolimin e tyre ose trajtimin e detyrueshëm, vetëm deri në shërimin e tyre ose në përfundimin e izolimit të tyre, dhe vetëm me pëlqimin e personit të interesuar (Конституционен съд, vendimi Nr. 15 datë 17.11.2020, 15/2020 (BG)).

masive të të dhënave dhe ndërhyjnë tek e drejta për privatësi sipas Nenit 8. Më tej, në kuadër të strategjive të vaksinimit për Covid-19, Shtetet gjithashtu duhet të krijojnë sisteme për të garantuar që të dhënat personale të mbledhura gjatë zbatimit të atyre strategjive, përfshirë të dhënat mbi lëshimin dhe rregullimin e certifikatave të vaksinimit, të jenë të mbrojtura mirë nga abuzimet^[210]. Gjykata ka gjetur më parë, në kontekstin e një çështjeje lidhur me konfidencialitetin e informacionit mbi HIV, që e drejta për privatësi duhet të përfitojë nga mbrojtja më e madhe kur zbulimi i informacionit mund të ketë pasoja serioze për jetën private dhe familjare të një individi dhe situatën e tij sociale dhe profesionale, përfshirë ekspozimin ndaj sigmës dhe përjashtimit të mundshëm.^[211] Duke pasur parasysh pasojat që mund të vijnë nga një diagnozë me Covid-19, përfshirë masat e karantinës të cilat prekin jetën sociale, familjare dhe profesionale të një personi, si dhe stigmën, ka gjasa që Shtetet do të duhet të vendosin mbrojtje të rrepta për të dhënat shëndetësore të lidhura me Covid-19 për t'iu përmbajtur Nenit 8^[212].

Ndërkohë që zgjidhjet dixhitale janë vlerësuar të jenë me rëndësi qenësore për luftimin e pandemisë Covid-19, duke pasur parasysh natyrën privatësi-ndërhyrëse të teknologjisë siç janë aplikacionet për gjurmimin e kontakteve, Shtetet gjithashtu duhet të jenë në gjendje të demonstrojnë se një teknologji e tillë e ka kapacitetin për të arritur qëllimin e mbrojtjes së shëndetit^[213].

[210] <https://rm.coe.int/t-pd-bur-2021-6rev2-statement/1680a25713> Deklarata e Këshillit të Evropës për Vaksinimin e Covid-19, vërtetimet dhe mbrojtja e të dhënave, Strasburg, 3 maj 2021.

[211] *Z.k. Finlandës*, vendim i 25 shkurtit 1997, Nr. 22009/93, § 96; *C.C.k. Spanjës*, vendim i 6 tetorit 2010, Nr. 1425/06, § 33; *Y.k. Turqisë*, vendimi për pranueshmërinë i 17 shkurtit 2015, Nr. 648/10, § 68.

[212] Shih vendimin e Këshillit të Shtetit Francez të 13 tetorit 2020, Nr. 444937, *Association le Conseil National du Logiciel Libre et autres*. Shih gjithashtu, për analizë krahasuese, kontributet në konferencën elektronike mbi „Problemet me Mbrojtjen e Të Dhënave dhe Covid-19: Perspektiva Krahasuese”, tek <https://blogdroiteuropeen.com/2020/07/02/covid-19-and-data-protection-in-portugal-by-ru-i-t-lanceiro/>.

[213] https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2020-coronavirus-pandemic-eu-bulletin-may_en.pdf „Pandemia e Koronavirusit në BE – Implikimet për Të Drejtat Themelore: Me Fokus tek Aplikacionet për Gjurmimin e Kontakteve”, Buletini FRA, 21 mars deri më 30 prill 2020, ku thuhet: politikanët, autoritetet e mbrojtjes së të dhënave, OJQ-të dhe ekspertët në tërë BE-në kanë theksuar nevojën për mbrojtje, siç është ndalimi i përdorimit të mëtejshëm të të dhënave të mbledhura për qëllime të tjera. Aktorë të ndryshëm gjithashtu kanë vënë në pyetje efikasitetin e aplikacioneve mobile. Disa i referohen kësaj qasjeje teknologjike ndaj Covid-19 si 'eksperimentim dixhital me shëndetin publik'. Një studim i Universitetit të Oksfordit, për shembull, thekson se afro 60% e popullsisë duhet të përdorë një aplikacion për gjurmimin e kontakteve në mënyrë që ai të ketë impakt të vërtetë. Megjithatë, një muaj pas daljes së një aplikacioni në Singapor, vetëm një e pesta e popullsisë ishin duke e përdorur. Të tjerë tërheqin vëmendjen se aplikacionet për gjurmimin e kontakteve ofrojnë një sens të

Vëzhgimi

Vëzhgimi i lëvizjeve të një personi, për shembull gjurmimi i vendndodhjes së tij duke përdorur të dhënat e gjurmimit me GPS, gjithashtu përbën ndërhyrje në të drejtën e tij për respekt ndaj jetës private. Thjesht ekzistenca e masave të vëzhgimit sekret ose legjislacionit që i lejon këto masa mund të përbëjë shkelje të Nenit 8. Një kërkues mund të pretendojë se është "viktimë" e një shkeljeje të Nenit 8 pa pasur nevojë të vërtetojë që masat sekrete të vëzhgimit janë përdorur direkt mbi të, në rastet e mëposhtme:

- i) nëse ato hyjnë brenda fushëveprimit të legjislacionit që lejon masat e vëzhgimit sekret (qoftë sepse i përkasin një grupi njerëzish të vënë në shënjestër nga legjislacioni, qoftë sepse legjislacioni i prek të gjithë direkt); ose
- ii) nëse nuk ka zgjidhje në dispozicion për të kontestuar operacionin e vëzhgimit sekret.^[214]

Vizitimi dhe shpenzimi i kohës me familjarë dhe miq

Kufizimet e lëvizjes në reagim ndaj Covid-19 kanë ndërhyrë në të drejtën për të vizituar, dhe në disa raste edhe për të jetuar me anëtarë të tjerë të familjes, duke ndakuar kontaktet fizike mes atyre që nuk jetojnë në të njëjtën shtëpi, përfshirë për shembull mes prindërve dhe fëmijëve kur prindërit kanë kujdestari të përbashkët të fëmijëve të tyre, ose mes fëmijëve dhe prindërve kur njëri prind ndodhet në burg.

Jeta familjare

Pjesë esenciale e të drejtës për respekt të jetës familjare është e drejta e anëtarëve të familjes për të jetuar së bashku dhe për të vizituar njëri-tjetrin në mënyrë që të mund të zhvillohen marrëdhëniet familjare^[215] dhe në mënyrë që

rremë sigurie, meqenëse telefonat celularë dhe sensorët e tyre janë duke gjurmuar ekspozimin ndaj koronavirusit. Shumica e ekspertëve pajtohen që aplikacionet duhet t'i plotësojnë masat e tjera, si metodat e vendosura epidemiologjike për gjurmimin e kontakteve, për të përmbytur transmetimin e virusit.

[214] *Roman Zakharov k. Rusisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 4 dhjetorit 2015, Nr. 47143/06 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[215] *Marckx k. Belgjikës*, vendim i 13 qershorit 1979, Nr. 6833/74, § 31.

anëtarët e familjes të mund të gëzojnë shoqërinë e njëri-tjetrit.^[216] Çështja nëse ekziston “jeta familjare” është çështje fakti që varet nga ekzistenca e lidhjeve të afërta personale.^[217] Koncepti i jetës familjare mbulon marrëdhënien mes prindit dhe fëmijës, vëllait e motrës, axhëve/dajëve dhe mbesave/nipave, dhe fëmijëve dhe gjyshërve.^[218] Gëzimi i ndërsjellë nga prindërit dhe fëmijët i shoqërisë së njëri-tjetrit përbën element themelor të jetës familjare brenda kuptimit të Nenit 8, edhe nëqoftëse marrëdhënia mes prindërve është shkëputur. Masat shtëpiake që pengojnë gëzimin e marrëdhënieve të tilla përbëjnë ndërhyrje në Nenin 8.^[219] Marrëdhëniet mes të rriturve dhe prindërve të tyre dhe motrave/vëllezërve mbrohen sipas Nenit 8, edhe kur ata/ato nuk jetojnë bashkë dhe kanë dalë në shtëpitë e veta dhe kanë formuar familjen e vet.^[220] Megjithatë, lidhjet familjare mes të rriturve dhe prindërve të tyre apo vëllezërve/motrave të tyre tërheqin më pak mbrojtje sesa lidhjet e fëmijëve me prindërit ose vëllezërit/motrar, nëse nuk ka prova të elementeve të tjera të varësisë, që përfshijnë më shumë sesa lidhjet e zakonshme emocionale.^[221] E drejta për respekt të jetës familjare të gjyshërve/gjysheve në lidhje me nipat/mbesat e tyre kryesisht ngërthen të drejtën për të ruajtur një marrëdhënie normale gjysh-nip/gjyshe-mbesë me anë të kontakteve mes tyre, megjithëse mbrojtja e lidhjeve familjare në këtë kontekst përsëri është më e vogël sesa mbrojtja për marrëdhënien prind-fëmijë.^[222]

[216] *Olsson k. Suedisë (Nr. 1)*, vendim i 24 marsit 1988, Nr. 10465/83, § 59.

[217] *Paradiso dhe Campanelli k. Italisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 24 janarit 2017, Nr. 25358/12, § 140.

[218] *Motrat dhe vëllezërit: Moustaqim k. Belgjikës*, vendim i 18 shkurtit 1991, Nr. 12313/86, § 36; *Mustafa dhe Armağan Akin k. Turqisë*, vendim i 6 prillit 2010, Nr. 4694/03, § 19; axhat/dajat dhe mbesat/nipat: *Boyle k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 27 prillit 1988, Nr. 9659/82 dhe 9658/82, §§ 41-47; dhe gjyshërit: *Kruškić k. Kroacisë*, vendimi për pranueshmërinë i 25 nëntorit 2014, Nr. 10140/13, § 111; *Mitovi k. Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, vendim i 16 prillit 2015, Nr. 53565/13, § 58.

[219] *Monory k. Rumanisë dhe Hungarisë*, vendim i 5 prillit 2005, Nr. 71099/01, § 70; *Zorica Jovanović k. Serbisë*, vendim i 26 marsit 2013, Nr. 21794/08, § 68; *Kutzner k. Gjermanisë*, vendim i 26 shkurtit 2002, Nr. 46544/99, § 58; *Elsholz k. Gjermanisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 13 korrikut 2000, Nr. 25735/94, § 43; *K. dhe T. k. Finlandës*, vendim i Dhomës së Madhe i 12 korrikut 2001, Nr. 25702/94, § 151.

[220] *Boughanemi k. Francës*, vendim i 24 prillit 1996, Nr. 22070/93, § 35; *Moustaqim k. Belgjikës*, vendim i 18 shkurtit 1991, Nr. 12313/86, §§ 35 dhe 45-46.

[221] *Benheba k. Francës*, vendim i 10 korrikut 2003, Nr. 53441/99, § 36; *Mokrani k. Francës*, vendim i 15 korrikut 2003, Nr. 52206/99, § 33; *Onur k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 17 shkurtit 2009, Nr. 27319/07, § 45; *Slivenko k. Letonisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 9 tetorit 2003, Nr. 48321/99, § 97; *A.H. Khan k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 20 dhjetorit 2011, Nr. 6222/10, § 32.

[222] *Kruškić k. Kroacisë*, vendimi për pranueshmërinë i 25 nëntorit 2014, Nr. 10140/13, § 111; *Mitovi k. Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, vendim i 16 prillit 2015, Nr. 53565/13, § 58.

Fëmijët e të burgosurve

Siç u diskutua në seksionin mbi Nenin 3 - mbrojtja nga trajtimi çnjerëzor dhe degradues - në këtë publikim, shumë Shtete kanë dekretuar ndalimin e përkohshëm të vizitave në burg, për të parandaluar përhapjen e Covid-19. Kur një prind mbahet në burg, atëherë angazhohen si e drejta e prindit ashtu edhe e drejta e fëmijës për jetë familjare. Shteti ka detyrime pozitive sipas Nenit 8 për të mundësuar dhe ndihmuar të burgosurit që të mbajnë lidhje me familjarët e ngushtë, dhe kufizimet e panevojshme ose joproporcionale të të drejtave të vizitimit mund të shkelin Nenin 8.^[223]

Jeta private

Marrëdhënie të tjera të ngushta që nuk përfshihen brenda fushëveprimit të "jetës familjare" mund të mbrohen sipas të drejtës për respekt të jetës private.^[224] E drejta për respekt të jetës private sipas Nenit 8 përfshin të drejtën e zhvillimit personal, dhe të drejtën për të krijuar dhe zhvilluar marrëdhënie me qenie të tjera njerëzore dhe botën përreth.^[225] Megjithatë, ajo nuk mbulon çdo aktivitet publik që një person synon të zhvillojë me qenie të tjera njerëzore, dhe jo çdo lloj marrëdhënieje hyn brenda sferës së jetës private. Për shembull, Neni 8 nuk mbron marrëdhëniet personale të një fushëveprimi aq të gjerë e të pacaktuar sa që nuk mund të ketë lidhje të konceptueshme mes veprimit ose mosveprimit të Shtetit dhe jetës private të personit.^[226]

Funeralet

E drejta për të marrë pjesë në funeralin e një anëtarit të familjes, e drejta për t'u informuar për vdekjen e një anëtarit të familjes para se të mbahet funerali, mënyra se si trajtohet trupi i një anëtarit të vdekur të familjes, dhe nëse trupi i kthehet

[223] *Horych k. Polonisë*, vendim i 17 prillit 2012, Nr. 13621/08.

[224] *Znamenskaya k. Rusisë*, vendim i 2 qershorit 2005, Nr. 77785/01, § 27 dhe referencat e cituara aty.

[225] *Niemietz k. Gjermanisë*, vendim i 16 dhjetorit 1992, Nr. 13710/88, § 29; *Pretty k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 29 prillit 2002, Nr. 2346/02, §§ 61 dhe 67.

[226] *Friend dhe të Tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 24 nëntorit 2009, Nr. 16072/06 and 27809/08, ku Gjykata gjeti që, pavarësisht nga sensi i qartë i gëzimit dhe vetpërbushjes që kërkuesit kishin nga gjahu dhe marrëdhëniet personale që kishin krijuar gjatë gjuetisë, gjuetia ishte shumë e largët nga autonomia personale e kërkuesve, dhe marrëdhëniet personale mbi të cilat ata bazoheshin ishin tepër të gjera dhe të papërcaktuara në fushëveprim në mënyrë që ndalimet e gjuetisë të përbënin ndërhyrje në të drejtat e tyre sipas Nenit 8.

familjes së të ndjerit të gjitha hyjnë brenda hapësirës së Nenit 8.^[227] Pandemia Covid-19 bëri që Shtetet të rregullojnë mënyrën se si zhvilloheshin funeralet dhe të kufizojnë numrin e njerëzve që u lejuan të merrnin pjesë.^[228] Masat përfshijnë shkurtimin e kohës së funeraleve, varrosjen e të ndjerit në arkivole të kyçura prej metali në vend të drurit, moslejimi që shërbimet mortore të kryhen në kishë ose kapelë, vetëm lejimi i një numri të kufizuar të familjarëve 'të afërt' për të marrë pjesë, dhe moslejimi që trupi i të ndjerit të sillet në shtëpi të gjitha me gjasë përbëjnë ndërhyrje në Nenin 8.

b. Kufizimet

Ashtu si Nenet 9-11 të Konventës, ndërhyrjet në Nenin 8 janë të lejueshme nëse ato synojnë një qëllim legjitim, janë në përputhje me ligjet dhe proporcionale me qëllimin legjitim të synuar. Neni 8 § 2 lejon ndërhyrjen në të drejtën e respektit për jetën private dhe familjare për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë publike, dhe ky vlerësohet si qëllim legjitim. Konsideratat rreth kriterëve të ligjshmërisë dhe proporcionalitetit pasojnë më poshtë.

Ligjshmëria

Çdo ndërhyrje në të drejtat e mbrojtura sipas Nenit 8 duhet të jetë në përputhje me të drejtën vendase, dhe e drejta përkatëse vendase duhet të jetë në përputhje me kriteret e sundimit të ligjit, që do të thotë se duhet të jetë e qartë dhe në dispozicion dhe pasojat e saj duhet të jenë të parashikueshme. Përgjithësisht, kriteri i parashikueshmërisë nënkupton që individët duhet të jenë në gjendje të parashikojnë se cilat veprime të tyre mund të shkelin ligjin, dhe çfarë pasojash mund të ketë kjo. Këto kriterë aplikohen në secilin prej konteksteve të përshkuara më lart, megjithatë ato modifikohen pakëz në kontekstin specifik të vëzhgimit. Prandaj, kriteret e ligjshmërisë në kontekstin e vëzhgimit po i përshkruajmë me hollësi më poshtë.

Për shkak të natyrës së vëzhgimeve, kriteri i "parashikueshmërisë" nuk nënkupton gjithmonë që individët duhet të jenë në gjendje të parashikojnë se

[227] *Sabanchiyeva dhe të Tjerë k. Rusisë*, vendim i 6 qershorit 2013, Nr. 38450/05 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim); *Solska dhe Rybicka k. Polonisë*, vendim i 20 shtatorit 2018, Nr. 30491/17 dhe 31083/17, §§ 104-108 dhe referencat e cituara aty.

[228] Shih <https://balkaninsight.com/2020/04/20/pandemic-wreaks-havoc-with-ancient-balkan-funeral-traditions/> "Pandemia Bën Namin në Traditat e Vjetra Ballkanike të Varrimeve", *Balkan Insight*, 20 prill 2020.

kur ka gjasë që autoritetet t'i përgjojnë komunikimet e tyre në mënyrë që ata të përshtasin sjelljen e tyre.^[229] Ky do të ishte kusht i pamundur duke marrë parasysh natyrën e vëzhgimeve.

Më konkretisht, në kontekstin e vëzhgimeve, ligji duhet të jetë i qartë mjaftueshëm për t'iu treguar qytetarëve në mënyrë të përshtatshme rreth rrethanave dhe kushteve në të cilat autoritetet publike kanë fuqinë për të përdorur masa të tilla sekrete.^[230] Gjithashtu, ai duhet të tregojë kohëzgjatjen e masës, procedurën që ndiqet për shqyrtimin, përdorimin dhe ruajtjen e të dhënave të përftuara, masat paraprake që duhen marrë kur të dhënat iu komunikohen palëve të tjera, rrethanat në të cilat të dhënat mund ose duhet të asgjësohen, dhe organizimin e mbikqyrjes së zbatimit të masave.^[231]

Kur Shtetet e gjykojnë të nevojshme futjen e masave të vëzhgimit, ose kur ato fillojnë të mbledhin të dhëna shëndetësore për të luftuar përhapjen e Covid-19, futja në të drejtën vendase e masave të tilla atëherë tregon me qartësi të mjaftueshme fushëveprimin dhe mënyrën e ushtrimit të diskrecionit dhënë autoriteteve vendase për të mbledhur dhe ruajtur informacione mbi shëndetin dhe lëvizjet e njerëzve, dhe duhet të caktojë qartë mbrojtje minimale kundër abuzimit.

Proporcionaliteti

Çdo masë që ndërhyt në të drejtat e mbrojtura sipas Nenit 8 duhet të jetë mënyra më pak shtrënguese e arritjes së qëllimit të synuar.

Është e qartë se ndërhyrjet në Nenin 8 të përshkruara më lart mund të përbëjnë shkelle të Nenit 8, por kjo varet nga një sërë faktorësh. Për t'u konsideruar proporcionale, çdo ndërhyrje tek Neni 8 duhet të vazhdojë të qëndrojnë për sa kohë që është e nevojshme për të parandaluar përhapjen e Covid-19. Përveç kësaj, vendimet për të shtrënguar ose reduktuar shkallën e kufizimeve që ndërhyjnë në Nenin 8 duhet të informohen me anë të referencave nga provat dhe këshillat shkencore. Në kontekstin e kufizimeve të vizitave familjare, formati i festave

[229] *Weber dhe Saravia k. Gjermanisë*, vendim i 29 qershorit 2006, Nr. 54934/00, § 93.

[230] *Roman Zakharov k. Rusisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 4 dhjetorit 2015, Nr. 47143/06, §§ 231 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[231] *Roman Zakharov k. Rusisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 4 dhjetorit 2015, Nr. 47143/06 §§ 231 dhe 238-301 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

familjare dhe impakti rezultues mbi shëndetin mendor, kohëzgjatja e kufizimeve, niveli i varësisë dhe/ose afërsia e marrëdhënies në fjalë dhe nëse janë të mundura mënyra alternative të mbajtjes së kontaktit gjatë kohës që nuk lejohen kontaktet fizike, të gjitha janë faktorë relevantë. Në kontekstin e kujdesit shëndetësor, shkalla deri ku një detyrim i tillë do të kërkonte alokimin e burimeve shtetërore është çështje kyçe. Në kontekstin e administrimit të detyrueshëm të trajtimit mjekësor ose vaksinimit, me rëndësi do të jetë mundësia për të shqyrtuar vendimin për të administruar një trajtim të tillë, dhe shkalla deri ku trajtimi i përgjigjet situatës emergjente.

Disa shembuj më specifikë të konsideratave që mund të dalin në pah gjatë vlerësimit të proporcionalitetit sipas Nenit 8 diskutohen më poshtë.

Vaksinimi

Si pikënisje, çështjet e politikave shëndetësore hyjnë brenda hapësirës së vlerësimit të autoriteteve kombëtare^[232]. Gjatë vlerësimit të proporcionalitetit të skemave të vaksinimit, Shteteve në përgjithësi u lejohen një hapësirë e gjerë vlerësimi, duke pasur parasysh konsensusin e përgjithshëm në Evropë, i mbështetur fuqimisht nga organe të specializuara ndërkombëtare, që vaksinimi është një prej intervenimeve më të suksesshme dhe me kosto efektive. Gjykata njihet se përgjithësisht pranohet që Shtetet duhet të synojnë nivelin më të lartë të mundshëm të vaksinimit brenda popullatave të tyre^[233]. Hapësira e vlerësimit në lidhje me mënyrën e zbatimit të programit të vaksinimit gjithashtu është e gjerë kur nuk ka konsensus evropian ose ndërkombëtar në lidhje me modelin ose politikën më efektive se si të bëhet vaksinimi. Për shembull, në kontekstin e vaksinimit të fëmijëve, kur ekziston një spektër i tërë i qasjeve ndaj vaksinimit nëpër Evropë, duke nisur nga ato që bazohen krejtësisht në rekomandime, e deri tek ato që bëjnë një ose dy vakcina të detyrueshme ose e bëjnë detyrim ligjor për të siguruar vaksinimin e plotë të fëmijëve^[234].

[232] *Vavříčka k. Republikës Çeke*, vendimi i Dhomës së Madhe i 8 prillit 2021, Nr. 47621/13 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim), § 280.

[233] *Vavříčka k. Republikës Çeke*, vendimi i Dhomës së Madhe i 8 prillit 2021, Nr. 47621/13 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim), § 277.

[234] *Vavříčka k. Republikës Çeke*, vendimi i Dhomës së Madhe i 8 prillit 2021, Nr. 47621/13 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim), § 278.

Më tej, kur ekziston një politikë vaksinimi për të mbrojtur popullatën kundër një sëmundjeje e cila mund të ketë efekte të rënda mbi shëndetin individual, dhe kur shpërthimet e gjera të sëmundjes mund të shkaktojnë trazira në shoqëri, politika e vaksinimit me gjasë do të vlerësohet si nevojë sociale urgjente (posaçërisht kur ekspertët specialistë në atë juridiksion e kanë rekomanduar politikën e vaksinimit ose kanë përcaktuar që ajo është e nevojshme). Siç diskutohet në seksionet për Nenin 2 (E drejta e jetës) dhe Nenin 3 (Mbrojtja nga trajtimi çnjerëzor dhe poshtëruues) të këtij publikimi, Gjykata e pranon që zbatimi i një politike të vaksinimit mund të përbëjë mjet për përmbushjen e detyrimeve pozitive të Shteteve sipas Neneve 2, 3 dhe 8 për të marrë masat e përshtatshme për të mbrojtur jetën dhe shëndetin e njerëzve brenda juridiksioneve të tyre^[235].

Një analizë e thellë e proporcionalitetit të politikave të vaksinimit është thelbësore për vlerësimin e pajtueshmërisë së tyre me KEDNJ-në, duke pasur parasysh faktorët specifikë të secilit vend dhe qasja ndaj vaksinave brenda juridiksioneve përkatëse. Këtu poshtë jepen disa shembuj të faktorëve që kanë rëndësi gjatë vlerësimit të proporcionalitetit të një skeme të detyrueshme të vaksinimit ose masave të futura për të inkurajuar marrjen e vaksinave (për shembull, bërja e statusit të vaksinimit kriter për të hyrë në vende të caktuara ose për të udhëtuar).

- i) Pikëpamjet e ekspertëve, në mënyrë të veçantë të autoriteteve mjekësore, dhe ekzistenca e një konsensusi shkencor që rekomandon politikën e vaksinimit^[236].
- ii) Interesin më të mirë të fëmijës dhe nevojën për të siguruar që çdo fëmijë të jetë i mbrojtur kundër sëmundjeve të rënda, gjë e cila në shumicën e rasteve arrihet kur fëmijët janë plotësisht të vaksinuar gjatë viteve të fëmijërisë së hershme^[237].

[235] *Vavrička k. Republikës Çeke*, vendimi i Dhomës së Madhe i 8 prillit 2021, Nr. 47621/13; *Budayeva dhe të Tjerë k. Rusisë*, vendimi i 20 marsit 2008, Nr. 15339/02, 21166/02, 20058/02, 11673/02 dhe 15343/02, §§ 128-130 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim); *Hristozov dhe të Tjerë k. Bullgarisë*, vendimi i 3 nëntorit 2012, Nr. 47039/11 dhe 358/12, §§ 106 dhe 116; *Ibrahim Keskin k. Turqisë*, vendimi i 27 marsit 2018, Nr. 10491/12, § 62; dhe *Kotilainen dhe të Tjerë k. Finlandës*, vendimi i 17 shtatorit 2020, Nr. 62439/12, §78.

[236] *Vavrička k. Republikës Çeke*, vendimi i Dhomës së Madhe i 8 prillit 2021, Nr. 47621/13 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim), ku ishte relevante që detyra e vaksinimit në fjalë kishte të bënte me nëntë sëmundje kundër të cilave vaksinimi konsiderohej efektiv dhe i sigurt nga komuniteti shkencor (§ 290) dhe ku Gjykata theksoi se çështja kishte të bënte me „vaksinimin standard dhe rutinor të fëmijëve kundër sëmundjeve që njihen mirë nga shkencat mjekësore“ (§158).

[237] *Vavrička k. Republikës Çeke*, vendimi i Dhomës së Madhe i 8 prillit 2021, Nr. 47621/13 (i përfshirë si përmbledhje

- iii) Ekzistenca e metodave alternative për arritjen e qëllimit të rritjes së vaksinimeve dhe mbrojtjes së shëndetit, për shembull programet e vaksinimit vullnetar të shoqëruara me fushata efektive të informimit^[238].
- iv) Natyra e kriterit, pavarësisht nëse është absolute apo nëse ka përjashtime nga rregulli i përgjithshëm, për shembull, përjashtimet mbi baza fetare ose mjekësore^[239].
- v) Metodatat e detyrimit dhe sanksioneve për mos-respektim të detyrimit për t'u vaksinuar, për shembull nëse qëllimi i sanksioneve është mbrojtja e shëndetit e jo ndëshkimi, nëse një vaksinë mund të jepet me forcë, niveli i gjobave për mos-respektim dhe, kur një personi nuk i lejohej hyrja diku ose shërbimi si pasojë e mos-pasjes së vaksinës, nëse ky kufizim mund të vihet për një periudhë të kufizuar kohe^[240].

në këtë publikim), § 288.

[238] *Vavříčka k. Republikës Çeke*, vendimi i Dhomës së Madhe i 8 prillit 2021, Nr. 47621/13 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim), § 288. Gjykata gjeti se nëqoftëse një politikë e vaksinimit vullnetar nuk është e mjaftueshme për të arritur dhe mbajtur imunitetin e tufës, ose imuniteti i tufës nuk është relevant për shkak të natyrës së sëmundjes (p.sh. tetanozi), autoritetet vendase me arsye mund të miratojnë politikën e vaksinimit të detyrueshëm me qëllim që të arrihet niveli i duhur i mbrojtjes kundër sëmundjes së rëndë. Gjykata theksoi se mund të jetë e udhës që të ndërmerret një qasje më preskriptive kur Shtetet mund të vërejnë rënien e vaksinimit vullnetar dhe rënien rezultuese të imunitetit të tufës. Shih gjithashtu: <https://www.ecdc.europa.eu/sites/default/files/documents/COVID-19-vaccination-strategies-and-deployment-plans-Nov-2021.pdf>: „Shikim i përgjithshëm mbi zbatimin e strategjive të vaksinimit të Covid-19 dhe zhvillimit të planeve në BE/EEA”, raporti teknik nga Qendra Evropiane për Parandalimin dhe Kontrollimin e Sëmundjeve, 11 nëntor 2021 (në mënyrë të veçantë faqet 20-21), i cili jep një përmbledhje të strategjive dhe masave alternative të marra në tërë Evropën për të ngritur pranimin dhe marrjen e vaksinave, përfshirë iniciativat e shtrirjes në partneritet me komunitetin ose me udhëheqësit fetarë.

[239] *Vavříčka k. Republikës Çeke*, vendimi i Dhomës së Madhe i 8 prillit 2021, Nr. 47621/13 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim), § 291. Gjykata e pa të udhës të theksonte se modeli çek nuk impononte një detyrë absolute, meqenëse përjashtimi nga detyra ishte i lejuar në lidhje me fëmijët me me kundëringdikacione të përhershme ndaj vaksinimit. Përjashtimi gjithashtu mund të lejohej mbi bazën e të drejtës për "kundërshtim shekullar të ndërgjegjës" (§292).

[240] *Vavříčka k. Republikës Çeke*, vendimi i Dhomës së Madhe i 8 prillit 2021, Nr. 47621/13 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim), ku ishte relevante që respektimi i detyrës së vaksinimit nuk mund të imponohej direkt, në kuptimin që nuk kishte dispozita që lejonin që vaksinat të jepeshin me forcë. Detyra zbatohet indirekt përmes gjobave administrative që mund të jepeshin një herë. Gjykata e konsideroi gjobën (maksimumi 10,000 korona çeke, të barasvlershme me afro 400 euro) si relativisht e moderuar dhe nuk e konsideroi të rreptë apo të ashpër pa nevojë (§ 293). Në çështje, refuzimi i kërkuesve për të lejuar që fëmijët e tyre të vaksinoheshin gjithashtu rezultoi me faktin që fëmijët e tyre nuk u pranuan në parashkollë. Gjykata pranoi që përjashtimi i kërkuesve nga parashkollorja nënkuptoi humbjen e një mundësie të rëndësishme për fëmijët që të zhvillonin personalitetet e tyre

- vi) Mbrojtjet procedurale dhe institucionale, për shembull, kriteret e rrepta dhe testimi rigoroz para regjistrimit të një vaksine, ekzistenca e monitorimit të vazhdueshëm të sigurisë dhe efekteve anësore të vaksinës^[241], ekzistenca e procedurave efektive administrative dhe/ose gjyqësore për të kontestuar pasojat e mos-respektimit të detyrimit për t'u vaksinuar^[242] dhe vënia në dispozicion e kompensimit në rast dëmi ndaj shëndetit si efekt anësor i vaksinës^[243].
- vii) Niveli i transparencës, pjesëmarrjes publike dhe diskutimit publik rreth politikës së vaksinimit^[244].

Në përgjithësi, përdorimi i politikave të vaksinimit për të mbrojtur jetën dhe shëndetin vlerësohet si justifikim shumë me peshë, që me gjasë justifikon ndërhyrjen tek Neni 8 në këtë kontekst^[245]. Kjo përforcohet në mënyrë të veçantë kur merret parasysh hapësira e gjerë e vlerësimit që u jepet Shteteve në këtë fushë dhe theksi që Gjykata vë mbi efikasitetin e vaksinimit si mjet për të mbrojtur jo vetëm ata/ato që janë vaksinuar por edhe ata/ato që nuk janë vaksinuar, të

dhe të fillonin të fitonin shkathtësi të rëndësishme sociale dhe të të nxënit. Megjithatë, ajo u gjet të ishte pasojë e drejtpërdrejtë e zgjedhjes së prindërve të tyre respektivë për të mos vepruar në përputhje me një detyrë ligjore. Njëkohësisht ishte me rëndësi që efektet mbi kërkuesit fëmijë ishin të përkohshme meqenëse, pasi të arrinin moshën e vijimit të detyrueshëm të shkollës, pranimi i tyre në shkollë fillore nuk do të ndikohej nga statusi i tyre i vaksinimit.

[241] *Vavříčka k. Republikës Çeke*, vendimi i Dhomës së Madhe i 8 prillit 2021, Nr. 47621/13 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim), § 301.

[242] *Vavříčka k. Republikës Çeke*, vendimi i Dhomës së Madhe i 8 prillit 2021, Nr. 47621/13 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim), § 295.

[243] *Vavříčka k. Republikës Çeke*, vendimi i Dhomës së Madhe i 8 prillit 2021, Nr. 47621/13 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim), § 302.

[244] *Vavříčka k. Republikës Çeke*, vendimi i Dhomës së Madhe i 8 prillit 2021, Nr. 47621/13 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim), § 298, ku Gjykata vlerësoi se ishte arritur një shkallë e mjaftueshme transparence me publikimin e procesverbaleve të takimeve të Komisionit Kombëtar të Imunizimit në uebfaqen e Ministrisë së Shëndetësisë, dhe ishte arritur pjesëmarrje e mjaftueshme publike me krijimin e një Komisioni Punë për Vaksinim për të ofruar një platformë të gjerë për diskutime mes ekspertëve dhe publikut në lidhje me strategjinë e vaksinimit në Republikën Çeke.

[245] Shih për shembull çështjen e Mbretërisë së Bashkuar, *Peters, Findlay & Fairburn k. Sekretarit të Shtetit për Shëndetësi dhe Kujdes Social dhe Komitetit të Përbashkët për Vaksinim dhe Imunizim*, [2021] EWHC 3182 (Admin), ku gjyqtari i Gjykatës së Lartë gjeti se tërë qëllimi i masës në pyetje (mandati i vaksinimit për punonjësit thelbësorë) ishte mbrojtja e jetës, pra jetët (e rrjedhimisht të drejtat e Neni 2) e banorëve të moshuar të shtëpive të kujdesit për të moshuarit, kjo u vlerësua se ishte "justifikim shumë me peshë" për ndërhyrje tek Neni 8.

cilët do të përfitonin nga nivelet e larta të imunizimit të popullatës. Gjykata konsideron se nuk është joproporcionale që një Shtet t'u kërkojë atyre për të cilët vaksinimi përbën rrezik të largët ndaj shëndetit që të pranohet një masë mbrojtëse universalisht të pranuar, si çështje detyrimi ligjor dhe në emër të solidaritetit social, për hir të numrit të vogël të fëmijëve të cenueshëm të cilët nuk është e mundur të përfitojnë nga vaksinimi^[246].

Gjithashtu, duket se ekzistenca e mekanizmave efektive të shqyrtimit që sfidojnë zbatimin e vaksinimit të detyrueshëm kur njerëzit besojnë se një rregull i tërësishëm nuk duhet t'u aplikohet atyre, mund të jetë faktor kyç gjatë përcaktimit nëse administrimi i vaksinimit të detyrueshëm për Covid-19 shkel Nenin 8^[247].

Janë disa faktorë specifikë të pandemisë Covid-19 të cilët do të duhet të merreshin parasysh gjatë shqyrtimit të proporcionalitetit të një politike të vaksinimit për Covid-19.

Siç u diskutua më lart, nuk ka pasur një qasje të përbashkët në lidhje me vaksinimin kundër Covid-19 në Shtetet e Evropës, faktor i cili me gjasë do të bëjë që Shteteve t'u jepet një hapësirë e gjerë vlerësimi në lidhje me politikat e tyre të vaksinimit për Covid-19. Vetëm Austria e bëri vaksinimin të detyrueshëm për të gjithë personat e rritur. Shtetet e tjera vendosën vaksinimin e detyrueshëm për grupmosha të caktuara, dhe disa e bënë të detyrueshme për kategori të caktuara të punonjësve, p.sh. në shëndetësi ose në shërbime publike, që të vaksinohen në mënyrë që të mund të vazhdonin të ushtronin aktivitetet e tyre profesionale, ose lejuan punëdhënësit që ta bënin vaksinimin e detyrueshëm për punonjësit e tyre. Në disa Shtete të tjera, hyrja në hapësira të caktuara publike iu lejua vetëm personave që ishin vaksinuar plotësisht kundër Covid-19^[248].

[246] *Vavříčka k. Republikës Çeke*, vendimi i Dhomës së Madhe i 8 prillit 2021, Nr. 47621/13, §306 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[247] *Glass k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 9 marsit 2004, Nr. 61827/00 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim), ku u deklarua që vendimi i një mjeku për të trajtuar një fëmijë me të meta të rënda në kundërshtim me dëshirat e shprehura të prindit, dhe pa mundësinë për shqyrtim gjyqësor të vendimit, shkeli Nenin 8.

[248] [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2022/729309/EPRS_BRI\(2022\)729309_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2022/729309/EPRS_BRI(2022)729309_EN.pdf)
"Çështjet ligjore rreth vaksinimit të detyrueshëm për Covid-19", Raportim i Parlamentit Evropian, mars 2022.

Politikat e vaksinimit që vunë në shënjestër grupe të caktuara, qoftë mbi bazën e moshës^[249] ose profesionit^[250], mund t'u jepnin shkas çështjeve të diskriminimit dhe arbitraritetit, nëqoftëse vendimi për të shënjestruar ato grupe ishte objektivisht i justifikuar.

Niveli i njohurive shkencore dhe konsensusi rreth politikave të vaksinimit po ashtu ka rëndësi. Zhvillimi krejtësisht i ri dhe i papritur i Covid-19 i dallon politikat e vaksinimit të Covid-19 nga ato të mëparshme që janë shqyrtuar nga Gjykata, për sa u përket vaksinimeve rutinore që kanë shumë vite që përdoren në Shtete. Për shembull, në shkurt të vitit 2021, Organizata Botërore e Shëndetësisë kujtoi që kishte ende shumë pasiguri shkencore në lidhje me kohëzgjatjen e imunitetit dhe mundësisë së vaksinave të Covid-19 për të kufizuar transmetimin^[251]. Peshë e ndryshueshme e efekteve të varianteve të ndryshme të virusit gjatë pandemisë gjithashtu do të ishte faktor i rëndësishëm. Për shembull, politika e vaksinimit të detyrueshëm në Austri u fut kur varianti 'Delta' ishte dominues në shoqëri. Megjithatë, ai u suspendua kur varianti mbizotërues u bë 'Omicron', efektet e të cilit u vlerësuan të ishin më të buta dhe në lidhje me të cilin vaksinat u duk se ishin më pak efektive në parandalimin e infeksionit. Do të ishte më e vështirë të justifikohej një ndërhyrje tek Neni 8 në një kontekst të tillë.

Për sa u përket 'certifikatave të vaksinimit' ose 'lejekalimeve shëndetësore', ku statusi i vaksinimit është kusht për të hyrë në hapësira publike ose për të marrë shërbime publike, Gjykata nuk e sheh kriterin e paraqitjes së certifikatës së vaksinimit për të pasur qasje në hapësira të caktuara publike si ekuivalent i

[249] Për shembull, mandatet për vaksinim që synonin vetëm personat mbi një moshë të caktuar janë kritikuar se kanë dështuar të justifikojnë përse pikërisht personat e një moshe të caktuar, e jo personat me sëmundje të tjera shoqërore në rrezik më të madh nga Covid-19 që përballen me gjobë në rast mos-vaksinimi: [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2022/729309/EPRS_BRI\(2022\)729309_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2022/729309/EPRS_BRI(2022)729309_EN.pdf) "Çështjet ligjore të vaksinimit të detyrueshëm për Covid-19", Raportimi në Parlamentin Evropian, mars 2022.

[250] Çështja *Thevenon k. Francës*, vendimi i 13 shtatorit 2022, Nr. 46061/21, kishte të bënte me pyetjen nëse imponimi i vaksinimit të detyrueshëm mbi bazën e profesionit të kërkuesit si zjarrfikës profesionist shkeli të drejtat e tij të Neneve 8 dhe 14. Megjithatë, çështja u hodh poshtë për shkak të dështimit të shterimit të zgjidhjeve vendase, kështu që kjo pyetje substanciale nuk u mor në konsideratë.

[251] <https://www.who.int/news-room/articles-detail/interim-position-paper-considerations-regarding-proof-of-COVID-19-vaccination-for-international-travellers> "Shkresë e pozicionit të përkohshëm: konsideratat lidhur me provat e vaksinimit të Covid-19 për udhëtarët ndërkombëtarë", Organizata Botërore e Shëndetësisë, 5 shkurt 2021.

imponimit të një detyrimi të përgjithshëm për t'u vaksinuar^[252]. Kohëzgjatja e periudhës gjatë së cilës ato imponohen, lloji i hapësirave për të cilat kërkohet vërtetimi i vaksinimit për të hyrë, dhe ofrimi i përjashtimeve nga kriteret janë relevante për çdo vlerësim proporcionaliteti. Për shembull, nëse është ose jo e mundur që të paraqiten prova alternative, siç është prova e statusit negativ me Covid-19 për të hyrë në këto vende^[253].

Në fund, është e nevojshme të merret në konsideratë nëse politika e vaksinimit faktikisht i ka shërbyer qëllimit për të cilin është krijuar, pra për të ngritur nivelin e marrjes së vaksinës. Në disa Shtete, ka pasur korrelacion mes futjes së lejekalimeve të vaksinimit dhe regjistrimeve për vaksinën e Covid-19^[254]. Megjithatë, në Austri studimet treguan se ata që tashmë ishin skeptikë në lidhje me vaksinën nuk ishin bindur që të regjistroheshin për vaksinim për shkak të kërcënimit me gjobë^[255].

[252] *Zambrano k. Francës*, vendimi i 7 tetorit 2021, Nr. 41994/21. Gjykata Kushtetuese e Francës (Conseil constitutionnel) në vendimin e saj për ligjin që krijonte 'pass vaccinal' (Vendimi 2022-835 DC i 2 janarit 2022), mbështeti kushtetutshmërinë e ligjit dhe bëri dallimin mes situatës së publikut të gjerë dhe situatës së profesionistëve që punonin në ambientet e prekura nga masat që kërkonin kriterin e vaksinimit si kusht për vazhdimin e punësimit. Për të parën, masa nuk përbënte mandat vaksinimi, duke pasur parasysh natyrën e ambienteve ku kërkohet 'pass vaccinal'. Nga ana tjetër, masa mund të konsiderohej e barabartë me vaksinimin e detyrueshëm për grupin e dytë, meqenëse marrëdhënia e tyre e punës mund të pezullohej nëqoftëse ata/ato nuk e kishin 'pass vaccinal'. Sidoqoftë, Gjykata e mbështeti masën, sepse ajo synonte një qëllim legjitim, pra mbrojtjen e shëndetit, dhe nuk ishte dukshëm e papërshtatshme për arritjen e qëllimit të synuar, duke pasur parasysh provat shkencore në dispozicion. Conseil e kuptoi që masa nuk shkelte të drejtat e njohura në Kushtetutën franceze (liria e lëvizjes, tubimit, dhe e drejta për të punuar), meqenëse ajo ishte e përkohshme, e lidhur me situatën pandemike, e vendosur në lidhje me vende dhe aktivitete me rrezikshmëri të lartë infektimi, dhe jo e aplikueshme për ata/ato që nuk mund të vaksinoheshin për arsye mjekësore, që ishin shëruar ose që paraqisnin kundërvendime mjekësore.

[253] <https://rm.coe.int/dh-bio-2021-7-final-statement-vaccines-e/1680a259dd> "Deklaratë mbi Konsideratat e Të Drejtave të Njeriut Relevante për 'lejekalimin e vaksinimit' dhe Dokumente të Ngjashme", Komiteti i Këshillit të Evropës për Bioetikën (DH-BIO), 4 maj 2021, ku thuhet: duhet të kërkohet që të merren parasysh ato individë të cilët, për arsye mjekësore ose të tjera, nuk mund të vaksinohen, dhe të kihet parasysh që rezultatet e testeve (dhe në rastin e udhëtimit edhe karantina) ofrojnë mënyra alternative për certifikatat e vaksinimit kur konsiderohet tërheqja e disa masave të shëndetit publik.

[254] Për shembull, në Francë, më shumë se një milionë njerëz caktuan takimin për të marrë vaksinën gjatë 24 orëve të para pas lajmërimit që së shpejti do të kërkohet lejekalimi i shëndetit për ambiente publike. Pothuajse 10 milionë njerëz morën dozën e parë gjatë muajit në vijim: <https://www.france24.com/en/europe/20211014-macron-s-covid-health-pass-a-success-in-overcoming-france-s-vaccine-scepticism>

[255] <https://www.theguardian.com/world/2022/jun/23/austria-scraps-compulsory-covid-vaccine-mandate>

Në fakt, Organizata Botërore e Shëndetësisë ka paralajmëruar se gjilpërat e detyrueshme duhet të përdoren vetëm si zgjidhje e fundit dhe se skema të tilla kanë potencialin për të dhënë efektin e kundërt, duke zvogëluar kështu besimin publik në politikat qeveritare dhe në vaksinim^[256].

Mbledhja dhe ruajtja e të dhënave dhe vëzhgimi

Në kontekstin e mbledhjes dhe ruajtjes së të dhënave dhe vëzhgimit, mbledhja e të dhënave duhet të shënjestrohet duke vlerësuar fillimisht nëse të dhënat e mbledhura do të ishin “potencialisht vendimtare”, “relevante” ose “me rëndësi”, e jo të mblidhen kuturu pa dallim.^[257] Mbrojtja efektive e të dhënave të ruajtura po ashtu është faktor vendimtar për të përcaktuar nëse ruajtja është proporcionale, dhe e drejta vendase duhet të ngrejë mbrojtjet e duhura për të parandaluar komunikimin ose zbulimin e të dhënave personale shëndetësore të cilat nuk janë marrë duke ndjekur qëllimet legjitime.^[258] Kohëzgjatja e ruajtjes së të dhënave është një tjetër faktor relevant; kur të dhënat ruhen për shumë vite ose për një kohë më të gjatë se duhet për t'i shërbyer qëllimit për të cilin janë mbledhur, ndërhyrja në Nenin 8 ka më shumë gjasa të jetë joproporcionale.^[259]

[256] <https://www.politico.eu/article/who-cautions-against-mandatory-vaccination/> Trust deficit stalls vaccinations in Eastern Europe, driving new COVID surge – POLITICO Hezitimi për t'u vaksinuar është lidhur me mosbesimin në qeverinë dhe është gjetur se është më i përhapur në komunitetet me historik diskriminimi nga shteti, marginalizimi, apo neglizhimi, siç janë pakicat etnike e fetare (shih Chaudhuri, K., Chakrabarti, A., Chandan, J.S. et al. Covid-19 hezitimi për t'u vaksinuar në Mbretërinë e Bashkuar: studim ndër-sektorial i njësive familjare përgjatë kohës, BMC Public Health 22, 104 (2022)). Për të adresuar këtë mosbesim, grupet e ekspertëve mbështesin idenë që angazhimi konstruktiv me këto komunitete do të ishte efektiv në rritjen e vaksinimit (shih Përgjigjen e BMA-së ndaj Covid-19: udhërrëfyesi i vaksinimit të detyrueshëm: <https://www.bma.org.uk/advice-and-support/covid-19/vaccines/covid-19-mandatory-vaccine-guidance>; Qëndrimi i Kolegjit Mbretëror të Infermierisë mbi Covid-19 dhe vaksinat e detyrueshme: <https://www.rcn.org.uk/get-help/rcn-advice/covid-19-and-mandatory-vaccination>). Nga ana tjetër, vaksinimi i detyrueshëm rrezikon dëmtimin e mëtejshëm të besimit publik. Masat alternative mund të përfshijnë programet edukative në komunitet dhe programet për kompensimin financiar të atyre që mungojnë në punë për shkak të efekteve anësore të vaksinës (Covid-19 dhe vaksinimi i detyrueshëm: Konsideratat etike dhe kushtet, Raport i Politikave të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, 13 prill 2021).

[257] *L.H. k. Letonisë*, vendim i 29 prillit 2014, Nr. 52019/07 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[258] *Z k. Finlandës*, vendim i 25 shkurtit 1997, Nr. 22009/93, § 96; *Y k. Turqisë*, vendimi për pranueshmërinë i 17 shkurtit 2015, Nr. 648/10, § 78.

[259] *Surikov k. Ukrainës*, vendim i 26 janarit 2017, Nr. 42788/06, §§ 70 dhe 78.

Kështu, çdo teknologji e gjurmimit që futet në përdorim për të kufizuar përhapjen e Covid-19 duhet të përfshijë mbrojtje të mjaftueshme të konfidencialitetit të të dhënave të mbledhura, dhe të dhënat duhet të ruhen vetëm për sa kohë që është e nevojshme.

Vizitat familjare

Gjykata më parë ka gjetur që kufizimet që e ndaluan një individ nga vizitimi i vajzës së tij të adoptuar në një shtëpi kujdestarie, kur shtëpia ishte në karantinë për shkak të shpërthimit të gripit, nuk ka shkelur të drejtat e tij sipas Nenit 8.^[260] Gjykata gjeti që kufizimet synonin qëllimin legjitim të mbrojtjes së shëndetit, dhe konkludoi që periudha dymujore gjatë së cilës vazhuan kufizimet nuk ishte e gjatë pa arsye. Gjykata gjithashtu mori në konsideratë faktin që kërkuesi kishte pasur mundësi ta shihte vajzën e tij përmes dritares çdo ditë dhe që ai kishte mundur ta vizitonte atë sapo ishte hequr karantina e gripit.

Megjithatë, në të njëjtën çështje pati shkelje të të drejtave të kërkuesit sipas Nenit 8 kur ai nuk u lejua të kontaktonte me vajzën e tij të adoptuar gjatë një periudhe mbi njëvjeçare, kur ajo ndodhej në repartin e kujdesit intensiv në spital. Gjatësia dhe rreptësia e kufizimit të kontaktit për këtë periudhë u gjet se ishte joproporcionale. Ngjashëm, kufizimi i një individi brenda një eklave italiane për gjashtë vjet rresht, duke ia pamundësuar atij vizitat dhe mbajtjen e kontakteve me familjen dhe miqtë e tij që jetonin jashtë enklavës, po ashtu u gjet se përbënte shkelje të Nenit 8. Ndërkohë që kufizimet e lëvizjes në këtë çështjen e fundit u gjet se synonin qëllimin legjitim të mbrojtjes së sigurisë publike, u gjet se ato mund të ishin hequr më përpara siur autoritetet italiane të kishin komunikuar më efektivisht.^[261]

Vizitat në burg

Ndalimet e tërësishme të vizitave në burg janë në kundërshtim me Nenin 8, dhe Shtetet duhet të sigurohen që kufizimet e të drejtave vizituese të jenë të justifikuara në secilin rast individual.^[262] Prandaj, duhet të eksplorohej metoda të

[260] *Kuimov k. Ruisë*, vendim i 8 janarit 2009, Nr. 32147/04 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[261] *Nada k. Zvicrës*, vendim i Dhomës së Madhe i 12 shtatorit 2012, Nr. 10593/08 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[262] *Khoroshenko k. Ruisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 30 qershorit 2015, Nr. 41418/04. Në kohën e këtij shkrimi, çështja *Deltuva k. Lituanisë*, komunikuar më 28 shtator 2021, Nr. 38144/20, është në pritje para Gjykatës. Çështja

sigurta në mënyrë që vizitat të vazhdojnë ose takimet fizike të ndodhin përpara se të mendohet opsioni i kufizimit të vizitave fizike mes personave. Për shembull, aty ku është e mundur, disa të burgosur (siç janë ata që i janë afruar fundit të dënimit) mund të lirohen ose mund të organizohen takime socialisht të distancuara në burg, të kombinuara me testim, dhe mund të ofrohen PPE të përshtatshme. Kur ndalohen vizitat, Shtetet duhet të sigurohen që të futen metoda alternative komunikimi, për shembull videothirrjet. Megjithatë komunikimi dixhital nuk duhet të shihet si zëvendësues i përshtatshëm apo afatgjatë i komunikimit personal mes njerëzve.^[263]

ka të bëjë me faktin nëse ka pasur ose jo shkelje të së drejtës së kërkuesit për respekt të jetës së tij familjare, në kundërshtim me Nenin 8 të Konventës, duke pasur parasysh refuzimin për t'i lejuar familjes së tij ta vizitonte atë në burg gjatë pandemisë.

- [263] Shih https://www.nuffieldfjo.org.uk/app/nuffield/files-module/local/documents/nfjo_digital_contact_evidence_review_briefing%20paper_20200520-2-.pdf "Efektet e kontakteve dixhitale në mirëqenien e fëmijëve: prova nga kontekstet ligjore publike dhe private", Raport informativ mbi shqyrtimin e provave të shpejta, Iyer et al., Observatori i Familjes Nuffield, maj 2020.

4. Neni 5 - E drejta për liri

Karantina, mbylljet brenda në shtëpi dhe/ose masat e distancimit social që u futën për të parandaluar përhapjen e Covid-19 zakonisht kishin të bënin me kufizimin e lirisë së lëvizjes (e mbrojtur nga Neni 2 i Protokollit Nr. 4). Impakti i këtyre masave mbi të drejtën e lirisë së lëvizjes diskutohet në seksionin 5 (Neni 2 i Protokollit Nr. 4 - E drejta për lirinë e lëvizjes, përfshirë lirinë për të hyrë dhe dalë nga vendi i vet) të këtij Kapitulli. Varësisht nga natyra, rreptësia dhe kohëzgjatja e këtyre masave, ato gjithashtu mund të përbëjnë ndërhyrje në të drejtën e lirisë, që mbrohet nga Neni 5. Pjesa e parë e Nenit 5 parashikon:

"1. Secili ka të drejtën e lirisë dhe sigurisë së personit."

a. Fushëveprimi i Nenit 5

Neni 5 ngërthen të drejtën për lirinë dhe sigurinë e personit. Megjithatë, në praktikë koncepti i "sigurisë së personit" nuk ka ekzistencë reale të pavarur në kontekstin e këtij Neni.^[264] Në vend të kësaj, ruajtja dhe siguria fizike janë të mbrojtura sipas Neneve 3 dhe 8.^[265]

Mbrojtjet sipas Nenit 5 aplikohen vetëm në rastet kur ka privim të lirisë, e jo ndonjë shkelje më të vogël të lirisë ose kufizim të lirisë së lëvizjes.^[266] Privimi i lirisë është koncept që ka përkufizim autonom sipas Konventës pavarësisht nga mënyra se si karakterizohet situata në të drejtën nacionale.^[267] Ajo nuk është e përkufizuar nga konteksti ligjor në të cilin ndodh, e as nuk kufizohet me paraburgimin pas arrestimit apo shpalljes fajtor. Privimi i lirisë mund të marrë forma të ndryshme,

[264] *Bozano k. France*, vendim i 18 dhjetorit 1986, Nr. 9990/82, §54.

[265] Për diskutimin mbi ndalimin e torturës dhe trajtimit çnjerëzor ose degradues sipas Nenit 3, dhe si kjo e drejtë përfshin mbrojtjen e sigurimit dhe sigurisë së personit, shih seksionin 2 (Mbrojtja nga trajtimi çnjerëzor dhe degradues), veçanërisht në seksionin (1) (Kujdesi shëndetësor i të paraburgosurve dhe kushtet e paraburgimit) të Kapitullit II të këtij publikimi. Kur trajtimi që kërcënon sigurimin ose sigurinë e personit nuk e arrin nivelin minimal të rreptësisë që kërkohet për të angazhuar Nenin 3, shih diskutimin mbi të drejtën e respektit për jetën private sipas Nenit 8 në seksionin 3 (E drejta për respekt ndaj jetës private dhe familjare).

[266] Për diskutimin e plotë të impaktit të këtyre masave mbi të drejtën e lirisë së lëvizjes, shih seksionin 5 (E drejta për lirinë e lëvizjes, përfshirë hyrjen dhe daljen nga vendi i vet) të Kapitullit II të këtij publikimi.

[267] *Creangă k. Rumanisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 23 shkurtit 2012, Nr. 29226/03, §91.

për shembull vendosja e individëve në shtëpi të kujdesit social;^[268] arresti shtëpiak;^[269] masat për kontrollimin e turmave që merren nga policia për arsye të rendit publik;^[270] ose kufizimet në zona tranziti.^[271]

Se çfarë saktësisht përbën 'privimi të lirisë' varet nga faktet dhe konteksti specifik i një çështjeje të dhënë. Privimi i lirisë përmban si elemente objektive, ashtu edhe subjektive. Si test i përgjithshëm, objektivisht personi duhet të ketë qenë i kufizuar brenda një hapësire të mbyllur për një periudhë kohore që nuk mund të shpërfillet, dhe subjektivisht personi duhet të mos e ketë dhënë pëlqimin ose të mos ketë pasur mundësi të japë pëlqimin për këtë kufizim.^[272] Megjithatë, ky test i përgjithshëm nuk funksionon gjithmonë, dhe Gjykata ka vënë re që në disa raste ekstreme dallimi mes kufizimit të lirisë së lëvizjes dhe privimit të lirisë është thjesht çështje opinionioni.^[273]

Dallimi mes kufizimeve të lëvizjes dhe privimeve të lirisë

Dallimi mes kufizimit të lëvizjes dhe privimit të lirisë është dallim në aspektin e shkallës dhe intensitetit, e jo dallim në aspektin e natyrës dhe substancës, sa i përket masës së marrë në rastin e një kërkuesi të dhënë.^[274] Faktorët relevantë në këtë vlerësim përfshijnë kohëzgjatjen, llojin dhe efektet e masës.^[275] Konteksti në të cilin janë marrë masat gjithashtu ka rëndësi meqenëse ka situata të shpeshta në shoqërinë moderne ku publiku mund të pritettë derojë kufizime të lirisë së lëvizjes ose lirisë së vet, e madje edhe privime të lirisë për një qëllim publik më të

[268] *Hadžimejlić dhe të Tjerë k. Bosnje-Hercegovinës*, vendim i 3 nëntorit 2015, Nr. 3427/13, 74569/13 dhe 7157/14.

[269] *Buzadji k. Republikës së Moldavisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 5 korrikut 2016, Nr. 23755/07 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[270] *Austin dhe të Tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i Dhomës së Madhe i 15 marsit 2012, Nr. 39692/09, 40713/09 dhe 41008/09 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[271] *Amuur k. Francës*, vendim i 25 qershorit 1996, Nr. 19776/92, *Ilias dhe Ahmed k. Hungarisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 21 nëntorit 2019, Nr. 47287/15, §248 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim), *Z.A. dhe të Tjerë k. Rusisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 21 nëntorit 2019, Nr. 61411/15, 61420/15, 61427/15 dhe 3028/16, §248

[272] *Stanev k. Bullgarisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 17 janarit 2012, Nr. 36760/06, §117

[273] *Z.A. dhe të Tjerë k. Rusisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 21 nëntorit 2019, Nr. 61411/15, 61420/15, 61427/15 dhe 3028/16, §133

[274] *Guzzardi k. Italisë*, vendim i 6 nëntorit 1980, Nr. 7367/76, §92 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[275] *Shih De Tommaso k. Italisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 23 shkurtit 2017, Nr. 43395/09, §§ 74-90 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

gjerë.^[276] Pandemia e Covid-19 ka sjellë para së gjithash pyetjen se ku duhet vënë kufiri mes kufizimeve të lëvizjes dhe privimit të lirisë.

Të gjitha masat që detyrojnë njerëzit të qëndrojnë në shtëpi (siç janë mbylljet brenda në shtëpi, karantina etj.) mund të përbëjnë privim lirie më shumë sesa kufizim i lirisë së lëvizjes. Edhe masat që hartohen për të garantuar sigurinë ose mbrojtjen e personave liria e të cilëve është e kufizuar, mund të vazhdojnë të përbëjnë privim të lirisë.^[277] Megjithatë, ky vlerësim varet nga një sërë faktorësh të cilët duhet të shqyrtohen sipas veçorive të secilit rast një nga një.

Gjykata ka përsëritur vazhdimisht që kufizimi në arrest shtëpiak përbën privim të lirisë.^[278] Kufizimi në shtëpinë e vet në karantinë ose në kushte të mbrojtura, ku personi nuk lejohet të largohet në asnjë rrethanë pra me gjasë është privim i lirisë. Nga ana tjetër, Gjykata ka gjetur që kufizimi në shtëpinë e vet, përveç rasteve të nevojshmërisë, mes orës 10 të darkës dhe 6 të mëngjesit nuk përbënte privim të lirisë,^[279] e po kështu as shtetrrëthimi ditor 12-orësh gjatë ditëve të javës për 16 muaj.^[280]

Kështu, masat e 'mbylljes në shtëpi', të cilat imponojnë shtetrrëthime ose i kufizojnë njerëzit në shtëpitë e tyre vetëm gjatë kohëve të caktuara të ditës ka më pak gjasë të përbëjë privim të lirisë. Megjithatë, është e pamundur të nxirret një konkluzion i qartë mbi këtë çështje në abstrakt pa marrë në konsideratë të plotë faktet e veçanta të çështjes.^[281] Faktorët relevantë përfshijnë:

[276] *Austin dhe të Tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i Dhomës së Madhe i 15 marsit 2012, Nr. 39692/09, 40713/09 dhe 41008/09, §59 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[277] *Khlaifja dhe të Tjerë k. Italisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 15 dhjetorit 2016, 16483/12, § 71.

[278] *Shih Buzadjik. Republikës së Moldavisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 5 korrikut 2016, Nr. 23755/07 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim), arresti shtëpiak 24-orësh u gjet se përbëntë privim të lirisë. Shih gjithashtu: *Lavents k. Letonisë*, vendim i 28 nëntorit 2002, Nr. 58442/00, § 63; *Nikolova k. Bullgarisë* (Nr. 2), vendim i 30 shtatorit 2004, Nr. 40896/98, § 60; *Delijorgji k. Shqipërisë*, vendim i 28 prillit 2015, Nr. 6858/11, § 75; dhe deklaratën e grupit ekspert të OKB- së për paraburgimin arbitrar, ku deklarohet: "Imponimi i karantinës së detyrueshme, prej së cilës personi nuk mund të largohet për asnjë arsye, në kontekstin e emergjencës shëndetësore është privim de facto i lirisë" <https://www.ohchr.org/EN/NewsEvents/Pages/DisplayNews.aspx?NewsID=25876&LangID=E> "COVID-19 nuk është justifikim për privimin e paligjshëm të lirisë", grupi ekspert i OKB-së mbi paraburgimin arbitrar, Zyra e Komisionerit të Lartë të OKB-së për të Drejtat e Njeriut, 8 May 2020.

[279] *De Tommaso k. Italisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 23 shkurtit 2017, Nr. 43395/09 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[280] *Trijonis k. Lituanisë*, vendimi për pranueshmërinë i 15 dhjetorit 2005, Nr. 2333/02.

[281] *Terheç k. Rumanisë*, vendimi i 13 prillit 2021, Nr. 49933/20, §41 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim), ku

- i) qëllimin e kufizimeve dhe kontekstin në të cilin ato vendosen^[282];
- ii) periudhën kohore gjatë së cilës vendosen kufizimet^[283];
- iii) ekzistencën e përjashtimeve prej rregullës së përgjithshme që një person duhet të qëndrojë në shtëpi, dhe fushëveprimi i arsyeve për të cilat një person lejohet të largohet nga shtëpia e vet^[284];
- iv) shkalla deri në të cilën kufizimi e lejon personin që ruajë njëfarë ngjashmërie me jetën që ka pasur jashtë mbylljes në shtëpi;
- v) nëse ndalimi për të pranuar vizitorë është absolut^[285];
- vi) shkalla deri ku personi lejohet të ketë kontakte sociale^[286];
- vii) përgjithësimi i kufizimeve – nëse ato synojnë individin, apo nëse i aplikohen njësoj secilit/ës^[287];

Gjykata gjeti që, për të vlerësuar nëse masa e mbylljes brenda për të cilën u bë ankesa përbënte privim të lirisë, ishte e nevojshme të analizoheshin faktet e situatës nën prizmin e natyrës, efekteve, intensitetit dhe modaliteteve të ekzekutimit të kufizimeve.

- [282] *Terheş k. Rumanisë*, vendimi i 13 prillit 2021, Nr. 49933/20, §41 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim), ku Gjykata mori parasysh faktin që masat e kontestuara u vendosën në kontekstin e veçantë të pandemisë Covid-19, e cila paraqiste rreziqe shumë serioze ndaj shëndetit, ekonomisë dhe funksionimit të shoqërisë, pas shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme në Rumani, dhe se qëllimi i masave ishte parandalimi i përhapjes së infeksionit dhe mbrojtja e të drejtave të jetës dhe shëndetit të popullatës.
- [283] *Terheş k. Rumanisë*, vendimi i 13 prillit 2021, Nr. 49933/20, §41 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim), ku Gjykata theksoi se masa e ankimuar zgjati për një periudhë prej 52 ditësh. *Terheş v. Romania*, decision of 13 April 2021, no. 49933/20, §41 (included as a summary in this publication), where the Court noted that the measure complained of lasted for a limited period of 52 days.
- [284] *Terheş k. Rumanisë*, vendimi i 13 prillit 2021, Nr. 49933/20, §41 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim), ku qytetarët u ndaluan të dilnin nga shtëpitë e tyre përveç një numri shumë të vogël rastesh të renditura. Çdo person që dilte nga shtëpia duhet të kishte me vete një dokument që vërtetonte arsye valide për daljen. Arsyet valide përfshinin: blerja e gjërave esenciale, vizita mjekësore, kujdesi për fëmijët ose të rriturit që kishin nevojë për kujdes, periudha të shkurtra të aktivitetit fizik, si dhe aktivitetet bujqësore dhe profesionale.
- [285] *Guzzardi k. Italisë*, vendim i Gjykatës plenare i 6 nëntorit 1980, Nr. 7367/76; *Nada k. Zvicrës*, vendim i Dhomës së Madhe i 12 shtatorit 2012, Nr. 10593/08 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).
- [286] *Terheş k. Rumanisë*, vendimi i 13 prillit 2021, Nr. 49933/20, §41 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim), ku ishte me rëndësi që nuk ishte e pamundur që kërkuesi të mbante kontakte sociale.
- [287] *Terheş k. Rumanisë*, vendimi i 13 prillit 2021, Nr. 49933/20, §41 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim), ku Gjykata theksoi se kufizimet nuk synonin një individ por u vendosën për të gjithë/a.

- viii) shkalla e mbikqyrjes në të cilën zbatohen kushtet, për shembull, nëse respektimi nga një individ i kufizimeve monitorohet me anë të vëzhgimit ose mbikqyrjes^[288]; dhe
- ix) rreptësia e ndëshkimeve të caktuara në rast shkeljeje.

Konteksti i pandemisë Covid-19, në të cilin Shtetet vunë kufizime për daljen nga shtëpia të njerëzve për të mbrojtur jetën, shëndetin, ekonominë dhe funksionimin e shoqërisë, është relevant për vlerësimin e tërësishëm të faktit nëse masat e mbylljes brenda përbëjnë privim të lirisë. Në këtë kontekst, kufizimet e mbylljes brenda shihen si masa mbrojtëse, e jo ndëshkuese. Prandaj, imponimi i masave të përgjithshme, për të kufizuar lëvizjet dhe ndërveprimet sociale të tërë popullatës, ka më pak gjasa të përbëjë privim të lirisë sesa, për shembull, masat e shënjestruara që i vihen një individ, respektimi i rregullave nga ana e të cilit është nën vëzhgim ose mbikqyrje.

Në këtë kontekst, për të treguar se një individ është privuar nga liria, ai duhet të paraqesë prova konkrete se si masa të tilla të përgjithshme mbrojtëse kanë pasur impakt tek ai. Kërkesa e përgjithshme për të qëndruar në shtëpi e cila përfshin përjashtime, për shembull lejimi i njerëzve që të dalin nga shtëpia për të blerë gjërat esenciale, për të vizituar familjen (qoftë edhe duke mbajtur distancimin social) dhe për të bërë ushtrime/gjymnastikë, nuk përbën privim të lirisë, kur një person mund të mbështetet në këto supozime për të dalë nga shtëpia e vet në cilëndo kohë të ditës. Megjithatë, nëqoftëse një individ nuk përfiton nga përjashtimet e rregullës që kërkojnë që ai të qëndrojë në shtëpi, dhe në fakt është i detyruar të rrijë i kufizuar në shtëpi gjatë tërë periudhës së mbylljes brenda, kjo mund të përbente privim të lirisë^[289].

[288] *Terheş k. Rumanisë*, vendimi i 13 prillit 2021, Nr. 49933/20, §41 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim), ku ishte me rëndësi që kërkuesi nuk iu nënshtrua vëzhgimit individual, në krahasim me, për shembull, *Guzzardi k. Italisë*, vendimi i 6 nëntorit 1980, Nr. 7367/76 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim) ku kërkuesi iu nënshtrua vëzhgimit thuajse të përhershëm.

[289] *Terheş k. Rumanisë*, vendimi i 13 prillit 2021, Nr. 49933/20, §41 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim), ku Gjykata i vuri rëndësi faktit që kërkuesi nuk e kishte shpjeguar konkretisht se si masat e mbylljes brenda në shtëpi kishin ndikuar në gjendjen e tij personale. U gjet se ai në fakt kishte qenë i lirë për të dalë nga shtëpia e tij kurdoherë, sipas cilitdo prej përjashtimeve të lejuara. Situata e tij mund të konsiderohej e kundërt me situatën e dikujt që ishte detyruar të qëndronte brenda gjatë tërë periudhës së mbylljes.

Më tej, kur njerëzit lejohen të largohen nga shtëpia vetëm një orë në ditë, për shembull, kjo është qartazi më kufizuese se shtetrrrethimi natën, i cili është gjetur të jetë kufizimi i lëvizjes e jo privimi i lirisë.^[290]

Qendrat e pritjes, identifikimit ose regjistrimit të migrantëve

Masat e futura për të kufizuar lëvizjen si reagim ndaj pandemisë së Covid-19 gjithashtu sollën edhe kufizimin masiv të njerëzve në qendrat e përkohshme të mbajtjes, duke i penguar ata nga largimi prej këtyre hapësirave.^[291] Më parë Gjykata ka gjetur që kufizimi i gjatë në zonat tranzit në aeroporte gjatë pritjes së rezultateve të aplikimeve për azil ka përbërë privim të lirisë brenda kuptimit të Nenit 5,^[292] ndërsa qëndrimi në zonat tranzit nëpër kufijtë tokësorë nuk ka përbërë privim të lirisë sepse aplikantët e kishin mundësinë që të largoheshin.^[293] Prandaj kufizimi në qendrat e pritjes, identifikimit ose regjistrimit të migrantëve përbën privim të lirisë nëqoftëse

[290] *Shih De Tommaso k. Italisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 23 shkurtit 2017, Nr. 43395/09 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim) dhe shih gjithashtu diskutimin rreth kësaj çështjeje në seksionin mbi të drejtën për lirinë e lëvizjes, përfshirë hyrjen dhe daljen nga vendi i vet, në Kapitullin II të këtij publikimi.

[291] Shih "Impakti i masave të Covid-19 mbi të drejtat e njeriut të migrantëve dhe refugjatëve në BE", raport i Komisionit Ndërkombëtar të Juristëve, 26 qershor 2020. Shih gjithashtu, për shembull, në Bosnje, më 16 mars 2020, "një kufizim i plotë i lëvizjes së migrantëve jashtë qendrave të përkohshme" u urdhërua nga Stafi i Krizës i Ministrisë së Una Sana Canton (USK) për Politika Shëndetësore, të Punës dhe Çështjeve Sociale, shih: <https://balkaninsight.com/2020/04/09/movement-ban-worsens-migrants- plight-in-serbia-bosnia/> "Ndalimi i Lëvizjes Përkeqëson Cjendjen e Vështirë të Migrantëve në Serbi, Bosnje", nga I. Jeremic, M. Stojanovic dhe A. Vladislavljovic, *Balkan Insight*, 9 prill 2020; në Serbi vendosja e gjendjes së emergjencës përfshiu faktin që refugjatët dhe migrantët nuk u lejuan të dilnin jashtë qendrave të tranzitit dhe azilit përveç se për të marrë ndihmë mjekësore, ose me leje të veçantë. Shih gjithashtu: <https://www.srbija.gov.rs/vest/en/154373/preventive-measures-in-migrant-camps-yield-results.php> "Masat parandaluese në kampet e migrantëve japin rezultate", përditësim nga Qeveria e Republikës së Serbisë, 16 prill 2020. Ndalimi funksionon nga të dy anët, kështu që shumica e stafit nga organizatat dhe OJQ-të e të drejtave të njeriut nuk mund të hyjnë në ato objekte po ashtu. Në rast se ndonjë person i caktuar arrin të largohet nga kampi pa leje, ekziston rreziku i përgjegjësisë për keqëri ose përgjegjësisë kriminale. Shih: https://www.a11initiative.org/ep-content/uploads/2020/04/Li%C5%A1enje-slobode-izbeglica-tra%C5%BEilaca-azila-i-migranata-u-Republici-Srbiji-u-vreme-vanrednog-stanja_final.pdf "Privimi i lirisë së refugjatëve, azilkërkuesve dhe migrantëve në Republikën e Serbisë me anë të masave të kufizimit dhe masave të derogimit nga të drejtat e njeriut dhe të pakicave të miratuara në kushtet e gjendjes së emergjencës", nga N. Kovačević, Iniciativa A11.

[292] *Z.A. dhe të Tjerë k. Rusisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 21 nëntorit 2019, Nr. 61411/15, 61420/15, 61427/15 and 3028/16.

[293] *Ilias dhe Ahmed k. Hungarisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 21 nëntorit 2019, Nr. 47287/15.

nuk ka mundësi të largimit prej qendrës.^[294] Një kufizim i tillë gjithashtu mund të ngrejë çështje sipas Nenit 3, siç u diskutua në seksionin (4) (Neni 3 - Mbrojtja nga trajtimi çnjerëzor dhe degradues (migrantët dhe azilkerkuesit)) poshtë, në veçanti nënseksioni a. Kushtet e Pritjes dhe Qendrat e Mbjatjes.

b. Përjashtimet e lejuara

Pjesa e dytë e Nenit 5 § 1 parashikon:

Askujt nuk mund t'i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijojnë dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj:

(a) kur burgoset ligjërisht pas një dënimi të dhënë nga një gjykatë kompetente;

(b) kur arrestohet ose ndalohet ligjërisht për moszbatim të një urdhri të dhënë nga gjykata në përputhje me ligjin ose për të garantuar përmbushjen e një detyrimi të parashikuar nga ligji;

(c) kur arrestohet ose ndalohet ligjërisht për t'u çuar përpara autoritetit gjyqësor kompetent pas dyshimit të arsyeshëm se ka kryer një veprë penale ose kur çmohet në mënyrë të arsyeshme e nevojshme për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj;

(d) kur një i mitur ndalohet ligjërisht për qëllim edukimi të mbikqyrrur ose për ndalimin e tij të ligjshëm me qëllim që të çohet përpara autoritetit kompetent ligjor;

(e) kur ndalohet ligjërisht për të parandaluar përhapjen e sëmundjeve ngjitëse, të personave të sëmurë mendërisht, alkoolistëve, narkomanëve ose endacakëve;

[294] *Shih J.R. dhe të Tjerë k. Greqisë*, vendim i 25 janarit 2018, Nr. 22696/16, në lidhje me kërkesit e vendosur në objektin "hotspot" Vial (qendër për pritjen, identifikimin dhe regjistrimin e migrantëve). Pas një muaji, objekti u bë gjysmë i hapur dhe kërkesit u lejuan të dilnin gjatë ditës. Gjykata konsideroi që kërkesit ishin privuar nga liria e tyre në kuptim të Nenit 5 gjatë muajit të parë të qëndrimit në atë objekt, por që ata kishin pasur vetëm kufizim të lëvizjeve, e jo privim të lirisë, pasi që objekti ishte bërë gjysmë i hapur; *Z.A. dhe të Tjerë k. Rusisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 21 nëntorit 2019, Nr. 61411/15, 61420/15, 61427/15 dhe 3028/16.

(f) kur arrestohet ose ndalohet ligjërisht me qëllim që të ndalohet hyrja e tij e paautorizuar në atë vend, ose nëse kundër tij është duke u kryer një procedurë dëbimi ose ekstradimi.

Për të qenë në pajtim me Nenin 5, paraburgimi i një personi duhet të hyjë brenda njërit prej përjashtimeve të cekura lart. Gjykata ka theksuar në mënyrë të përsëritur që lista e përjashtimeve nga prezumimi i lirisë që përmendet në Nenin 5 § 1 është tërësisht shteruese.^[295] Përjashtimet e lejuara interpretohen në mënyrë strikte, që do të thotë se Neni 5 nuk lejon një gamë të gjerë justifikimesh që mund të lejohen sipas Neneve 8-11. Neni 5 § 1 (e) është përjashtimi më relevant në kontekstin e pandemisë së Covid-19.

Paraburgimi i ligjshëm i personave për parandalimin e përhapjes së sëmundjeve ngjitëse

Neni 5 § 1 (e) autorizon "paraburgimin e ligjshëm të personave për parandalimin e përhapjes së sëmundjeve ngjitëse". Këto individë mund të paraqesin rrezik për sigurinë publike, por mund të jenë interesat e tyre ato që kërkojnë paraburgim.^[296] Megjithatë, paraburgimi lejohet sipas kësaj dispozite vetëm si zgjidhje e fundit, kur masat më pak të rrepta për parandalimin e përhapjes së sëmundjes janë marrë në konsideratë dhe janë gjetur të jenë të pamjaftueshme për të mbrojtur interesat publike.^[297]

Covid-19 është vërtetuar të jetë sëmundje ngjitëse, e cila është e rrezikshme për shëndetin dhe sigurinë publike, që do të thotë se mund të jetë e ligjshme sipas Nenit 5 § 1 (e) që Shtetet të caktojnë privime të lirisë për të penguar përhapjen e tij. Megjithatë, Shtetet njëkohësisht duhet të jenë në gjendje të demonstrojnë që masa të tilla janë marrë si zgjidhje e fundit, pasi janë konsideruar opsione të tjera dhe është arritur në përfundimin që përhapja e Covid-19 nuk mund të ishte kontrolluar në kushte më pak kufizuese. Për shembull, nëqoftëse njerëzit vihen në kushte karantine pa u lejuar të largohen nga shtëpia e tyre në asnjë rrethanë, Shtetet duhet të arrijnë të paraqesin prova se përse ata nuk janë lejuar të dalin nga shtëpia e tyre për një periudhë të caktuar çdo ditë, me kushte të caktuara,

[295] *Frroku k. Shqipërisë*, vendim i 18 shtatorit 2018, Nr. 47403/15, §52 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim); shih gjithashtu: *Rooman k. Belgjikës*, vendim i Dhomës së Madhe i 31 janarit 2019, Nr. 18052/11, § 190, dhe referencat aty

[296] *Enhorn k. Suedisë*, vendim i 25 janarit 2005, Nr. 56529/00, §43 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[297] *Enhorn k. Suedisë*, vendim i 25 janarit 2005, Nr. 56529/00, §44 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

p.sh. vendosja e maskës dhe qëndrimi në distancë prej të tjerëve. Mbase zgjidhjet e tjera nuk janë vlerësuar të realizueshme, por Shtetet së paku duhet të jenë në gjendje të paraqesin arsye dhe prova përse është vepruar ashtu.

Ky kriter është posaçërisht i rëndësishëm dhe relevant në kontekstin e trajtimit të migrantëve dhe të burgosurve. Disa Shtete kanë parashikuar dënime të zgjatura me burg në notat e tyre deroguese drejtuar Këshillit të Evropës në reagimin ndaj pandemisë Covid-19. Zgjatje të tilla do të duhej të ishin të justifikuara sipas Nenit 5 § 1 (e) e jo sipas Nenit 5 § 1 (a) (paraburgimi i ligjshëm i një personi pas shpalljes fajtor nga një gjykatë kompetente) meqenëse ata nuk do të kishin lidhje me dënimin fillestar. Nëse një i burgosur nuk teston pozitiv për Covid-19, është e vështirë të shihet se si zgjatja e dënimit të tij mund të argumentohet të jetë mënyra më pak kufizuese e parandalimit të përhapjes së Covid-19. Më tej, janë ngritur shqetësime në lidhje me përdorimin e paraburgimit si përgjigje shabllon ndaj infeksioneve në mesin e komuniteteve të migrantëve dhe refugjatëve, e jo si masë e fundit, për shembull kur migrantët raportojnë se janë vendosur në karantinë nëpër qendrat e mbajtjes për shkak të shqetësimeve rreth 'vetë-disiplinës' së tyre për të vepruar në pajtueshmëri me kushtet e vetizolimit.^[298] Kjo rrezikon të ekspozojë më shumë njerëz ndaj dëmeve të tjera dhe nuk mbron shëndetin e tyre.

c. Mbrojtjet sipas Nenit 5

Edhe nëqoftëse privimi i lirisë gjendet se është i autorizuar sipas Nenit Article 5 § 1 (e), ai gjithsesi duhet të jetë në përputhje me mbrojtjet e cekura në Nenin 5. Sipas Nenit 5 § 1, privimi i lirisë duhet të jetë në përputhje me procedurën e përshkruar në ligj, dhe vetë paraburgimi duhet të jetë i ligjshëm. Për të qenë "në përputhje me procedurën e përshkruar në ligj" çdo privim i lirisë duhet të jetë në përputhje me të drejtën nacionale^[299] dhe me standardet e tjera ligjore ndërkombëtare të aplikueshme^[300], dhe e drejta nacionale vetë duhet të jetë në pajtueshmëri me Konventën, përfshirë parimet e përgjithshme që janë të shprehura ose të nënkuptuara aty.^[301] Këto parime përfshijnë sundimin e ligjit, sigurinë ligjore dhe mbrojtjen kundër arbitraritetit. Masat kufizuese që hyjnë

[298] Shih <https://www.borderviolence.eu/wp-content/uploads/COVID-19-Report.pdf> "Raport special: Covid-19 dhe dhuna kufitare nëpër udhët ballkanike", Rrjeti Monitorues për Dhunën Kufitare, Rajoni i Ballkanit, prill 2020.

[299] *Mooren k. Gjermanisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 9 korrikut 2009, Nr. 11364/03, § 72

[300] *Mitrović k. Serbisë*, vendim i 21 marsit 2017, Nr. 52142/12, §40

[301] *Bigović k. Malit të Zi*, vendim i 5 marsit 2019, Nr. 48343/16, §§181-182; *Šaranović k. Malit të Zi*, vendim i 19 marsit 2019, Nr. 31775/16, §69.

brenda Nenit 5 të miratuara si reagim ndaj pandemisë Covid-19 atëherë duhet të autorizohen dhe të zbatohen përmes një procesi i cili është në pajtueshmëri me normat ligjore nacionale të aplikueshme dhe me ligjet ose rregulloret e miratuara si duhet^[302].

Siguria ligjore

Është thelbësore që kushtet për privimin e lirisë sipas të drejtës nacionale të jenë qartë të definuara dhe që ligjet të jenë të parashikueshme në zbatimin e tyre. Ligji duhet të jetë mjaft i saktë për t'i lejuar individit, nëse duhet me anë të këshillimit, që të parashikojë deri në një shkallë të caktuar që është e arsyeshme sipas rrethanave pasojat që mund të ngërthejë një veprim i caktuar.^[303] Për shembull, duhet të ketë kushte të qarta dhe afate të qarta kohore që tregojnë se kur një person duhet të futet në karantinë dhe për sa kohë, në mënyrë që personi të jetë plotësisht i vetëdijshëm për rrethanat në të cilat atij mund t'i kërkohet të qëndrojë në shtëpi, kur do të mundet të dalë nga shtëpia, nëse ka arsye për të cilat kushtet e kufizimit të lirisë së tij mund të vazhdojnë dhe, nëse po, për sa kohë.

Jo arbitraritet

Asnjë paraburgim që është arbitrar nuk mund të jetë në pajtueshmëri me Nenin 5 § 1. Nocioni i "arbitraritetit" në Nenin 5 § 1 shtrihet përtej mungesës së pajtueshmërisë me të drejtën nacionale, kështu që privimi i lirisë mund të jetë i ligjshëm sa i përket të drejtës vendase por prapë se prapë është arbitrar e rrjedhimisht në kundërshtim me Konventën.^[304] Paraburgimi konsiderohet arbitrar kur nuk ka marrëdhënie mes arsyes për privimin e lirisë dhe vendit e kushteve të paraburgimit^[305] dhe, në lidhje me Nenin 5 § 1 (b), (d) dhe (e), aty ku paraburgimi nuk është i nevojshëm për të arritur qëllimin e deklaruar.^[306] Në

[302] Për shembull, më 29 janar 2021, Conseil constitutionnel francez, me vendimin n° 2020-878/879 QPC, gjeti se urdhri i Qeverisë (Neni 16 i urdhërësës së 25 marsit 2020) që lejonte zgjatjen automatike të paraburgimit paragjyqësor ishte në mospërputhje me Nenin 66 të Kushtetutës (ndalimi i paraburgimit arbitrar) dhe e prishi urdhrin me efekt të menjëhershëm.

[303] *Dragin k. Kroacisë*, vendimi i 24 korrikut 2014, Nr. 75068/12, § 90.

[304] *Creangă k. Rumanisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 23 shkurtit 2012, Nr. 29226/03, § 84; *Sebalj k. Kroacisë*, vendim i 28 qershorit 2011, Nr. 4429/09, §188.

[305] *Hadžić dhe Suljić k. Bosnje-Hercegovinës*, vendim i 7 qershorit 2011, r. 39446/06 dhe 33849/08, §41

[306] *Hadžimejić dhe të Tjerë k. Bosnje-Hercegovinës*, vendim i 3 nëntorit 2015, Nr. 3427/13, 74569/13 dhe 7157/14,

mënyrë që privimet e lirisë të mund të vendosen si reagim ndaj pandemisë për të qenë në pajtueshmëri me këtë kusht, duhet të jepen prova që ato ndihmojnë në parandalimin e përhapjes së Covid-19.

Arsyet

Mospasja ose mungesa e arsytimit është një prej elementeve që merr parasysh Gjykata gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së paraburgimit.^[307] Neni 5 § 2 gjithashtu përmban mbrojtjen elementare që çdo person i arrestuar duhet të dijë përse po privohet nga liria. Personi duhet të informohet rreth fakteve kryesore dhe bazave ligjore për privimin e lirisë së tij, në një gjuhë jo-teknike që ai/ajo e kupton.^[308] Kërkesat për përkthim duhet të formulohen me kujdes dhe saktësi nga autoritetet.^[309] Prandaj Shtetet duhet të marrin masa për t'u siguruar që t'i komunikojnë përditësimet të qarta dhe të rregullta publikut të gjerë lidhur me ata që duhet të karantinohen ose të mbrohen dhe përse duhet ta bëjnë këtë. Këto mund të bëhen përmes transmetimeve televizive ose radiofonike, ose duke dërguar letra dhe broshura (të përkthyer në gjuhët e folura në zonat ku dërgohen).^[310]

Shqyrtimi i ligjshmërisë së paraburgimit

Neni 5 § 3

Neni 5 § 3 parashikon:

“Çdo person i arrestuar ose i paraburgosur në rrethanat e parashikuara në paragrafin 1/c të këtij neni duhet të çohet menjëherë para një gjyqtari

§§52-59.

[307] *S., V. Dhe A. k. Danimarkës*, vendim i Dhomës së Madhe i 22 tetorit 2018, Nr. 35553/12, 36678/12 dhe 36711/12, §92 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[308] *Velinov k. Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, vendim i 19 shtatorit 2013, Nr. 16880/08, §63 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[309] *Shamayev dhe të Tjerë k. Gjeorgjisë dhe Rusisë*, vendim i 12 prillit 2005, Nr. 36378/02, §425.

[310] Shih krijimin nga BBC Asian Network e një serie me video në shtatë gjuhë të ndryshme të Azisë Jugore, të cilat shpëgojnë se çfarë është Covid-19 dhe si mund të mbrohen njerëzit për të luftuar përhapjen e dezinformatave gjatë krizës së koronavirusit dhe për të ndihmuar që mesazhet shëndetësore të shtrihen drejt një publiku sa më të gjerë të mundshëm: <https://www.bbc.co.uk/mediacentre/latestnews/2020/asian-network-advice-videos> “BBC Asian Network publikon këshilla për koronavirus në gjuhët e Azisë Jugore për të ndihmuar ata që nuk e kanë anglishten gjuhë të parë”, BBC Media Centre, 30 prill 2020.

ose një zyrtari tjetër të autorizuar me ligj për të ushtruar funksione gjyqësore dhe ka të drejtë të gjykohet brenda një afati të arsyeshëm ose të lirohet në gjykim e sipër. Lirimi mund të kushtëzohet me dhënien e garancive për t'u paraqitur në procesin gjyqësor."

Neni 5 § 3 mbron të drejtat e të arrestuarve ose të paraburgosurve për dyshime të kryerjes së një vepre penale. Ai garanton të drejtën për shqyrtim të menjëhershëm dhe automatik të ligjshmërisë së paraburgimit të tyre. Një shqyrtim i tillë duhet të analizojë nëse ekziston dyshimi i arsyeshëm që personi i arrestuar ka kryer vepër, në mënyrë që të përcaktojë nëse paraburgimi i tij është i justifikuar sipas Nenit 5 § 1 (c)^[311].

Në rrethanat e pazakonta të pandemisë, Këshilli Konsultativ i Prokurorëve Evropianë gjithashtu rekomandon që prokurorët dhe shërbimet prokuroriale duhet të përpiqen në mënyrë të veçantë që të eksplorojnë mundësinë e shfrytëzimit të alternativave gjatë ndjekjes penale në përgjithësi dhe në fazën e paraburgimit paragjyqësor në veçanti^[312].

Shpejtësia e menjëhershme

Neni 5 § 3 nuk parashikon përjashtime nga kriteri që një person të sillet menjëherë para një gjyqtari ose një zyrtari tjetër gjyqësor pas arrestimit ose paraburgimit të tij/saj. Kriteri i menjëhershëm është strikt, me shumë pak hapësirë për t'u lakuar gjatë interpretimit të tij. Në përgjithësi, katër ditë është maksimumi i periudhës kohore gjatë së cilës një person mund të mbahet në paraburgim pa kontroll gjyqësor^[313]. Edhe periudha më të shkurtra mund të shkelin kriterin e shpejtësisë së menjëhershme nëqoftëse nuk ka vështirësi të caktuara ose rrethana të pazakonta që i pengojnë autoritetet nga sjellja e personit të arrestuar më shpejt para gjyqtarit^[314].

[311] *McKay k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i Dhomës së madhe i 3 tetorit 2006, Nr. 543/03, § 40.

[312] Opinioni Nr. 15 (2020) i Këshillit Konsultativ të Prokurorëve Evropianë pranë Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës: Roli i prokurorëve në situatat e emergjencës, posaçërisht gjatë përballjes me një pandemi, 19 nëntor 2020, § 40.

[313] *McKay k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i Dhomës së Madhe i 3 tetorit 2006, Nr. 543/03, § 33.

[314] Për shembull, *İpek dhe të Tjerë k. Turqisë*, vendimi i 3 shkurtit 2009, Nr. 17019/02 dhe 30070/02.

E drejta për gjyq brenda një kohe të arsyeshme

Çështja nëse një periudhë kohore e kaluar në paraburgim paragjyqësor është e arsyeshme duhet të vlerësohet nën dritën e fakteve dhe rrethanave specifike të secilit rast. Paraburgimi i vazhduar mund të jetë i justifikuar vetëm kur ekzistojnë indikacione specifike të një kriteri real të interesit publik i cili, pavarësisht nga prezumimi i pafajësisë, peshon më shumë sesa e drejta e respektit për lirinë individuale nga Neni 5. Megjithatë, kriteri i qëllimit nga Neni 5 § 1 (c) (pra, që qëllimi i paraburgimit duhet të jetë sjellja e kërkuesit para një autoriteti ligjor kompetent) mund të interpretohet dhe aplikohet me njëfarë fleksibiliteti kur qëllimi që dikur ekzistonte për të "sjellë kërkuesin para një autoriteti ligjor kompetent" nuk materializohet për një arsye ose një tjetër^[315].

Minimumi, është me rëndësi thelbësore që, gjatë tërë kohës së paraburgimit, të vazhdojë të ekzistojë dyshimi i arsyeshëm që personi e ka kryer veprën në fjalë. Ekzistenca e këtij dyshimi të arsyeshëm fillimisht duhet të vlerësohet "menjëherë" (shih lart). Megjithatë, pas njëfarë kohe, thjesht ekzistenca e një dyshimi të arsyeshëm nuk mjafton më për të justifikuar paraburgimin paragjyqësor. Gjykata atëherë duhet të përcaktojë: (i) nëse baza të tjera të cituara nga autoritetet gjyqësore vazhdojnë të justifikojnë privimin e lirisë (p.sh. rreziku i fshehjes ose rreziku i përsëritjes së veprës); dhe (ii), kur ka baza "relevante" dhe "të mjaftueshme" për të justifikuar paraburgimin, nëse autoritetet kombëtare kanë treguar "zell të veçantë" gjatë zhvillimit të procedurave penale^[316]. Zgjatja thujse-automatike e paraburgimit është në kundërshtim me garancitë e cekura në Nenin 5 § 3^[317].

Në kontekstin e pandemisë Covid-19, suspendimi i përkohshëm i procedurave penale për një periudhë prej afro tre muajsh për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme të pandemisë nuk e shkelti detyrën e zellit të veçantë. Kështu ndodhi në rastet kur procedurat ishin ndjekur aktivisht si përpara ashtu edhe pas vendosjes së masave emergjente që suspenduan procedurat (dhe nuk pati ankesa

[315] S., V. dhe A. k. Danimarkës, vendimi i Dhomës së Madhe i 22 tetorit 2018, Nr. 35553/12, § 118.

[316] Buzadji k. Republikës së Moldavisë, vendimi i Dhomës së Madhe i 5 korrikut 2016, Nr. 23755/07, §§ 87-91.

[317] Tase k. Rumanisë, vendimi i 10 qershorit 2008, Nr. 29761/02, § 40. Shih gjithashtu vendimin e Conseil constitutionnel francez (vendimi n° 2020-878/879 QPC i 29 janarit 2021), në të cilin Conseil constitutionnel prishi një urdhër të qeverisë, ose "ordonnance", i miratuar gjatë pandemisë, i cili parashikonte zgjatjen automatike të paraburgimit paragjyqësor, duke thënë se paraburgimi paragjyqësor mund të zgjatej pas vendimit të një gjyqtari.

për dështime, vonesa ose mosveprime nga ana e autoriteteve, gjatë asaj kohe) dhe kur Gjykata gjeti se, edhe gjatë tre muajve të suspendimit të procedurave penale, paraburgimi mund të vazhonte të vlerësohej se ishte për qëllimet e sjelljes para autoriteteve kompetente^[318].

Neni 5 § 4

Neni 5 § 4 parashikon:

“Çdo person, të cilit i është hequr liria me arrestim ose me burgim, ka të drejtë të bëjë ankim në gjykatë me qëllim që kjo e fundit të vendosë, brenda një afati të shkurtër, për ligjshmërinë e burgimit të tij dhe të urdhërojë lirimin, në qoftë se burgimi është i paligjshëm.”

Sipas Nenit 5 § 4, njerëzit që ndodhen në paraburgim kanë të drejtën të kërkojnë në mënyrë aktive shqyrtimin e paraburgimit të tyre, pavarësisht nga arsyeja për të cilën po mbahen në paraburgim sipas Nenit 5 § 1 (a) – (f)^[319].

Shqyrtimi efektiv

Neni 5 § 4 kërkon që procedura e shqyrtimit të ketë “karakter gjyqësor”. Format e shqyrtimit gjyqësor që përmbushin kriteret e Nenit 5 § 4 mund të variojnë nga njëri kontekst tek tjetri dhe varen nga lloji i privimit të lirisë në fjalë, si dhe nga natyra e veçantë e rrethanave në të cilat zhvillohen procedurat. Procedurat sipas Nenit 5 § 4 nuk kanë nevojë të përmbajnë gjithmonë të njëjtat garanci si ato që përmbahen në Nenin 6 § 1 për çështje gjyqësore civile ose penale. Megjithatë, minimumi, është thelbësore që personi në fjalë të ketë qasje në gjykatë dhe mundësinë për t’u dëgjuar qoftë personalisht, qoftë me anë të njëfarë forme përfaqësimi^[320].

Në kontekstin unik të pandemisë Covid-19, Gjykata e pranon që gjykatat dhe qendrat e seancave dëgjimore janë përballur me probleme të vështira e të papritura praktike, dhe qenë tepër të papërgatitura për të trajtuar distancimin social që kërkohej për të mbrojtur shëndetin e atyre që ishin të përfshirë në

[318] *Fenech k. Maltës*, vendimi i 23 marsit 2021, Nr. 19090/20, §§ 92 dhe 96 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[319] *Čović k. Bosnjë dhe Hercegovinës*, vendimi i 3 tetorit 2017, Nr. 61287/12, § 29.

[320] *Stanev k. Bullgarisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 17 janarit 2012, nr. 36760/06, § 171.

procedurat gjyqësore^[321]. Në këto rrethana, nuk është në shpërputhje me Nenin 5 § 4 që të shqyrtohet paraburgimi i një individi pa siguruar prezencën e tij në seancë personalisht ose përmes videolidhjes (sidomos duke pasur parasysh faktin që neni 5 § 4 nuk ka të njëjtat kritere të rrepta për seancat si Neni 6 sipas titullit të tij civil ose penal). Përkundrazi, mjafton të veprohet në përputhje me Nenin 5 § 4 nëqoftëse një person përfiton nga procedurat e kontradiktorialitetit, gjatë të cilave ai asistohet dhe përfaqësohet nga një avokat, edhe nëqoftëse seanca zhvillohet me telefon dhe/ose nëqoftëse avokati i tij është prezent në seancë por vetë personi nuk është^[322]. Në një skenar të tillë, individi duhet të ketë kontakte të mjaftueshme me avokatin e tij, për t'i mundësuar avokatit që ta prezantojë qëndrimin dhe pikëpamjet e tij në mënyrë efektive në emër të tij^[323].

Shqyrtimi i shpejtë

Faktorët e përdorur për të përcaktuar nëse një vendim është i shpejtë ose jo përfshijnë: kompleksitetin e procedurave; sjelljen e autoriteteve dhe të individit; atë çfarë rrezikon të humbasë individi; dhe specifikat e procedurës vendase. Mund të dalin çështje të veçanta sipas kësaj dispozite në kontekstin e paraburgimit paragyqësor, meqenëse pandemia e Covid-19 ka shkaktuar vonesa dhe ndërprerje në procedurat e rregullta gjyqësore të cilat mund ta shkelin këtë dispozitë^[324].

[321] *Bah k. Holandës*, vendimi i 22 qershorit 2021, nr. 35751/20, §§ 41 – 44, ku seanca e kërkuarit (i paraburgosur imigracioni) u zhvillua në javët e para të mbylljes brenda për shkak të pandemisë Covid-19, periudhë në të cilën qendrat e paraburgimit ishin tejet të papërgatitura për të respektuar distancën 1.5 metra në sallat e tele- dhe video-konferencave. Kërkuarit, seanca e të cilit u zhvillua më 19 mars 2020, nuk iu ofrua video-seancë për shkak të mungesës së sallës me pajisjet e duhura për tele- dhe video-konferenca në qendrën e paraburgimit ku mbahej ai në atë kohë.

[322] *Bah k. Holandës*, vendimi i 22 qershorit 2021, Nr. 35751/20, §§40, ku qe e rëndësishme që gjykata kishte bërë përpjekje konkrete për të mundësuar prezencën e kërkuarit në seancën e tij, dhe kishte shpjeguar me hollësi përse kishte qenë e pamundur që ai të dëgjohej personalisht ose përmes video-konferencës.

[323] *Bah k. Holandës*, vendimi i 22 qershorit 2021, nr. 35751/20, §44.

[324] Në kohën e këtij shkrimi, çështja *Khokhlov k. Qipros*, e komunikuar më 10 shkurt 2021, Nr. 53114/20, është momentalisht në pritje para Gjykatës. Kërkuari është paraburgosur qysh më 22 tetor 2018 me qëllim të ekstradimit të tij për në Rusi për t'u gjykuar. Më 30 tetor 2020 ai u informua që, për shkak të masave restriktive lidhur me Covid-19 si në Qipro ashtu edhe në Rusi, dy shtetet kishin vendosur të suspendonin ekstradimin e tij. Çështja ka të bëjë me faktin nëse ai pati një procedurë efektive përmes së cilës ai mund të kontestonte ligjshmërinë e paraburgimit të tij, siç kërkohet nga Neni 5 § 4, dhe në mënyrë të veçantë nëse gjatësia e procedurave të apelit përmes të cilave ai kërkoi të kontestonte ligjshmërinë e paraburgimit të tij, ishte në përputhje me kriterin e "shpejtësisë" në Nenin 5 § 4.

Çështjet e diskutuara më lart diskutohen më tej në seksionin rreth Nenit 6 (E drejta e seancës dëgjimore të drejtë) brenda këtij publikimi.

5. Neni 2 i Protokollit Nr. 4 - E drejta për lirinë e lëvizjes, përfshirë të drejtën për të hyrë dhe dalë nga vendi i vet

Ndalim-udhëtimet, mbylljet brenda në shtëpi dhe shtetrrëthime u vunë në funksion nëpër Evropë si reagim ndaj pandemisë së Covid-19. Seksioni 4 lart përmban një diskutim në lidhje me, dhe kur, masa të tilla mund të përbëjnë privim të lirisë sipas Nenit 5. Në situata kur këto masa nuk përbëjnë privim të lirisë, është e qartë se ato nuk përfaqësojnë ndërhyrje në të drejtën për lirinë e lëvizjes sipas KEDNj-së, çka përfshin të drejtën për t'u larguar nga një vend i Këshillit të Evropës, për të hyrë në vendin e vet, dhe për të lëvizur lirisht nëpër territorin e një vendi në të cilin personi ka hyrë ligjërisht^[325].

a. Liria e lëvizjes

Neni 2 i Protokollit Nr. 4 (shkurt ang. A2P4) të Konventës mbron të drejtën e lirisë së lëvizjes brenda një Shteti dhe të drejtën për t'u larguar nga një Shtet. Ai parashikon:

"1. Kushdo që ndodhet në mënyrë të ligjshme në territorin e një Shteti ka të drejtë, brenda këtij territori, të lëvizë lirisht në të dhe të zgjedhë lirisht vendbanimin e tij.

2. Çdo person është i lirë të largohet nga çdo vend, duke përfshirë të tijin.

[325] Një kërkesë për vendim paraprak është drejtuar në GjDBE nga Gjykata e Shkallës së Parë në Bruksel në çështjen *NORDIC INFO k. Shtetit Belg (C-128/22)* ku kërkohet sqarim për faktin nëse masat të cilat, në parim, vendosin mbi shtetasit belgë, qytetarët e Unionit dhe familjarët e tyre që banojnë në territorin belg një ndalesë daljeje për udhëtime jo-esenciale nga Belgjika drejt vendeve brenda BE-së dhe Zonës Shengen që janë të ngjyrosura me të kuqe në përputhje me kodin e ngjyrave të hartuar mbi bazën e të dhënave epidemiologjike, dhe e cila gjithashtu vendos kufizime hyrjeje për shtetasit jo-belgë të Unionit dhe familjarët e tyre (si karantina dhe testet) për udhëtime jo-esenciale nga vendet brenda BE-së dhe Zonës Shengen për të Belgjikë të cilat janë të ngjyrosura me të kuqe në përputhje me kodin e ngjyrave të hartuar mbi bazën e të dhënave epidemiologjike, janë në pajtueshmëri me dispozitat e lëvizjes së lirë që përmban Direktiva e Shtetësisë 2004/38.

3. *Ushtrimi i këtyre të drejtave nuk mund të bëhet objekt i kufizimeve të tjera nga ato të parashikuara në ligj dhe të domosdoshme në një shoqëri demokratike për sigurimin kombëtar ose sigurinë publike, ruajtjen e rendit publik, parandalimin e veprave penale, mbrojtjen e shëndetit apo të moralit, ose mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve.*

4. *Të drejtat e parashtruara në paragrafin 1, në disa fusha të caktuara, mund t'u nënshtrohen disa kufizimeve të vendosura në përputhje me ligjin dhe të justifikuara nga interesi publik në një shoqëri demokratike."*

Fushëveprimi

Gjykata ka gjetur ndërhyrje në të drejtën e lirisë së lëvizjes sipas A2P4 kur individëve u është dashur të kërkojnë leje nga gjykata para se të largohen nga vendbanimi i tyre (vendi i rezidencës) për të shkuar diku tjetër,^[326] janë ndaluar nga kalimi i kufijve të brendshëm brenda vendit ku banojnë,^[327] janë ndaluar nga hyrja në zona të caktuara të një qyteti,^[328] dhe janë ndaluar që të largohen nga Shteti.^[329]

Masat e marra për të kufizuar lëvizjen me qëllim të parandalimit të përhapjes së Covid-19 po ashtu qartazi do të përbënin ndërhyrje në të drejtat e mbrojtura sipas A2P4. Për shembull, caktimi i mbylljes në shtëpi në një vend të dhënë, ndalimi i njerëzve nga dalja prej shtëpive të tyre në ditë të caktuara, ose në orare të caktuara gjatë ditës përmes vënies në funksion të shtetrrethimeve ditore, kufizimi i qasjes në sistemin e transport publik përveç shfrytëzimit të udhëtimit për arsye të caktuara të specifikuara, kufizimi i udhëtimit lokal dhe ndërkombëtar përveç se kur është 'i nevojshëm', dhe ndalimi i udhëtimeve për të hyrë dhe dalë nga qytete ose rajone të caktuara të një vendi ku rreziku i kanosur nga Covid-19 është në kulm dhe ai rajon është mbyllur komplet përbrenda ('lockdown').

[326] *Antonenkov dhe të Tjerë k. Ukrainës*, vendim i 22 nëntorit 2005, Nr. 14183/02 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[327] *Timishev k. Rusisë*, vendim i 13 dhjetorit 2005, Nr. 55762/00, 55974/00.

[328] *Landvreugd dhe Oliveira k. Holandës*, vendimet ef 4 qershorit 2002, Nr. 37331/97, 33129/96 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[329] *Milen Kostov k. Bullgarisë*, vendim i 3 shtatorit 2013, Nr. 40026/07 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

Kufizimet

Neni 2 § 3 i A2P4 parashikon që mbrojtjet sipas A2P4 mund t'i nënshtrohen kufizimeve për mbrojtjen e shëndetit. Ashtu si Nenet 8-11 të Konventës, çdo kufizim për këtë qëllim duhet të jetë në përputhje me ligjin dhe të jetë i nevojshëm në një shoqëri demokratike.^[330]

Në përputhje me ligjin

Kur një ligj ose rregullore ka impakt domethënës mbi të drejtën për lirinë e lëvizjes, është posaçërisht me rëndësi që efektet e ligjit ose rregulloreve të jenë në dispozicion dhe të jenë të parashikueshme.^[331] Ky kriter për qartësi dhe parashikueshmëri është posaçërisht relevant në kontekstin e pandemisë Covid-19, ku mbyllet brenda në shtëpi, shtetrrëthimi dhe kufizimet e udhëtimit kanë pasur 'impakt shumë domethënës' mbi lirinë e lëvizjes dhe lirinë për të udhëtuar, dhe ku Shtetet kanë vënë në funksion fuqi të reja për të zbatuar këto kufizime. Ligjet që i qeverisin këto fuqi u desh të hartoheshin dhe të zbatoheshin me shpejtësi dhe të përditësoheshin rregullisht për t'iu përgjigjur niveleve të ndryshueshme të rrezikut, çka në disa raste ka shkaktuar konfuzion sa i përket fushëveprimit dhe efekteve.^[332]

[330] *Timishev k. Rusisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 19 tetorit 2005, Nr. 55762/00 dhe 55974/00.

[331] *De Tommaso k. Italisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 23 shkurtit 2017, Nr. 43395/09, §111 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim). Shih gjithashtu vendimin e Conseil constitutionnel francez n° 2020-846/847/848 QPC, 26 qershor 2020, në të cilin Conseil constitutionnel gjeti se masat e vendosura në Francë për kufizimin e lirisë së lëvizjes nuk ishin në pajtueshmëri me parimin e ligjshmërisë, sepse legjislacioni relevant e përkufizonte me saktësi dhe qartësi të mjaftueshme fushëveprimin e kufizimeve të lëvizjes, përjashtimet nga kufizimet e përgjithshme dhe kushtet në të cilat shkeljet e këtyre kushteve do të përbënin vepër.

[332] Shih konfuzionin në Mbretërinë e Bashkuar rreth faktit nëse këshilltari politik Dominic Cummings ka shkelur rregulloret e mbylles brenda në shtëpi apo jo: <https://www.instituteforgovernment.org.uk/blog/government-handling-dominic-cummings-loss-public-trust> "Trajtimi i lëvizjeve të Dominic Cummings nga qeveria ka çuar në humbjen e besimit publik", nga C.Haddon, Instituti për Qeveri, 26 maj 2020. Shih gjithashtu refuzimin e Gjykatës Superiore të Drejtësisë në Madrid për të ratifikuar masat që kufizonin hyrjet dhe daljet mes qyteteve, miratuar me dekret të qeverisë rajonale më 1 tetor 2020, Tribunal Superior de Justicia de Madrid, Sala de lo Contencioso, urdhri i datës 8.10.2020, Nr. 128/2020). Ai rikujtoi jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese në lidhje me Nenet 53 dhe 81 të Kushtetutës, sipas të cilëve të drejtat themelore mund të kufizohen vetëm me anë të një ligji, organik apo i zakonshëm, duke respektuar kushtet e sigurisë ligjore dhe parashikueshmërinë e ligjit. Gjykata Superiore shqyrtoi Nenin 65 të ligjit të përmendur si bazë ligjore për masat, dhe arriti në përfundimin që ai nuk i përmbushte këto kushte dhe që, për këtë arsye, nuk përbënte bazë ligjore valide për futjen e kufizimeve mbi të

Më parë Gjykata ka gjetur shkelje të A2P4 kur u mor një urdhër dyvjeçar për rezidencë të detyrueshme kundër një kërkuesi i cili vlerësohej i rrezikshëm për shkak të 'tendencave kriminale' të tij. Dispozita vendase që kufizonte lirinë e tij të lëvizjes nuk ishte "në përputhje me ligjin" sepse ajo nuk përmbante dispozita me hollësi të qarta që shpjegojnë se cilat lloje të sjelljeve konsideroheshin si të tilla që përbënin rrezik për shoqërinë, dhe nuk tregonte me qartësi të mjaftueshme fushëveprimin ose mënyrën e ushtrimit të diskrecionit shumë të gjerë që kishin gjykatat vendase.^[333]

Ky arsyetim mund të aplikohet përmes analogjisë me kufizimet e lëvizjes për të ngushtuar 'rrezikun' ose riskun ndaj shëndetit nga Covid-19. Për të qenë në pajtueshmëri me A2P4, këto dispozita duhet t'ua bënin të qartë njerëzve se kur ishin të lejuar të dilnin nga shtëpia, ku ishin të lejuar të shkonin, arsyet për të cilat ishin të lejuar të udhëtonin ose të dilnin nga shtëpia, cila do të ishin pasojat për shkeljen e këtyre kufizimeve dhe në çfarë situatash do të zbatoheshin ato. Për shembull, kufizimet e udhëtimit përveç se kur është 'i nevojshëm' rrezikojnë të shkaktojnë konfuzion sa i përket asaj se çfarë përbën 'nevojshmërinë' dhe duhet të shoqërohen nga udhërrëfyes të qartë dhe shembuj rreth asaj çka nënkupton ky term në kontekstin e pandemisë, për të shmangur dhënien e diskrecionit të tepërt atyre që i zbatojnë këto kufizime.

E nevojshme në një shoqëri demokratike

Kur vlerëson nëse një kufizim i lëvizjes është i nevojshëm në një shoqëri demokratike, Gjykata merr në konsideratë kohëzgjatjen e kufizimit, nëse ai është zbatuar në mënyrë automatike dhe pa dallim apo duke marrë parasysh rrethanat individuale, dhe nëse kufizimi faktikisht i ka shërbyer qëllimit për të cilin është vendosur.

Edhe kur kufizimi i lirisë së lëvizjes së një individi është fillimisht i justifikuar, sa më shumë që zgjat kufizimi aq më shumë ka gjasa që ai të bëhet joproporcional.^[334] Gjykata nuk konsideroi që kufizimi i qasjes së një individi në një zonë të caktuar në një qytet që zgjati 14 ditë ishte joproporcional, sepse ai u caktua në përgjigje ndaj

drejtat themelore.

[333] *De Tommaso k. Italisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 23 shkurtit 2017, Nr. 43395/09 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[334] *A.E. k. Polonisë*, vendim i 31 marsit 2009, Nr. 14480/04 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

një situatë emergjente të përdorimit të drogave dhe trafikimit.^[335] Megjithatë, ndalim-udhëtimi që fillimisht shihej si i justifikuar nga Gjykata, u gjet të ishte joproporcional pasi që ai zgjati tetë vjet dhe nevojshmëria e vazhdimet të tij u shqyrtua vetëm një herë.^[336] Kur masat që kufizojnë lëvizjen imponohen prej faktorëve të cilët ndryshojnë gjatë kohës, i takon Shtetit që të shqyrtojë në mënyrë periodike nëse ende ekzistojnë bazat për kufizimet e lirisë së lëvizjes.^[337] Prandaj, Shtetet duhet të rishikojnë rregullisht nevojën për ndalim-udhëtime dhe kufizime të lëvizjes duke marrë parasysh shkallën e rrezikut që Covid-19 mund të përhapet për shkak të këtyre lëvizjeve. Sa më shumë që zgjasin këto kufizime, aq më jetike bëhen rishikimet e rregullta.

Rishikimi i këtyre masave gjithashtu është i nevojshëm për t'u siguruar që kufizimi i lëvizjes t'i shërbejë qëllimit për të cilin është vendosur dhe ky të jetë mjeti më pak kufizues i arritjes së atij qëllimi. Kur kufizimet e lëvizjes caktohen ndaj një popullate të caktuar, për shembull për shkak të moshës ose gjendjes shëndetësore, duhet të jetë e qartë se ekziston një rrezik më i madh ndaj shëndetit të popullatave të tilla i cili kërkon kufizimin e tyre në një nivel më të lartë sesa të tjerëve.^[338] Më tej, janë ngritur shqetësime që imponimi i disa kufizimeve të caktuara të lëvizjes mund të shkaktojë shtimin e llojeve të tjera të lëvizjeve, dhe që masat si mbyllja brenda mund të kenë efektin e kundërt prej qëllimit të synuar të parandalimit të përhapjes së Covid-19. Për shembull, shpallja që një pjesë e vendit do të mbyllet brenda nëpër shtëpi mund të çojë në udhëtime masive drejt një pjese tjetër të vendit, dhe shpallja që do të mbyllet dyqane ose restorante të caktuara apo disa pjesë të qytetit mund të çojë në stërmbushjen dhe mbingarkimin

[335] *Landvreugd dhe Oliveira k. Holandës*, vendimet e 4 qershorit 2002, Nr. 37331/97 dhe 33129/96 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[336] *De Tommaso k. Italisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 23 shkurtit 2017, Nr. 43395/09 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[337] *Shih Villa k. Italisë*, vendim i 20 prillit 2010, Nr. 19675/06, ku kufizimi u imponua mbi një individ për shkak të rrezikut që paraqiste ai për shoqërinë, dhe që e nevojshme për të shqyrtuar vazhdimisht shkallën e rrezikut që paraqiste ai.

[338] Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Bosnjës që ndalimi i të miturve dhe njerëzve mbi 65 vjeç për të dalë nga shtëpia ka shkelur të drejtën e tyre për lirinë e lëvizjes. Masa u gjet të ishte joproporcionale sepse autoritetet nuk e kishin bërë të qartë përse kishin vlerësuar që këto grupmosha përbënin rrezik më të madh për t'u infektuar ose për ta transmetuar sëmundjen: <https://www.sarajevotimes.com/constitutional-court-ban-on-the-movement-of-persons-under-the-age-of-18-and-over-65-is-violation-of-human-rights/> "Gjykata Kushtetuese: Ndalimi i Lëvizjes së Personave nën Moshën 18 Vjeç dhe mbi 65 Vjeç është Shkelje e të Drejtave të Njeriut", Sarajevo Times, 22 prill 2020.

e supermarketeve të cilat mbeten të hapura.^[339] Pasojat e caktimit të kufizimeve të lëvizjes pra duhet të faktorizohen në vendimet që merren për t'i caktuar ato, për t'u siguruar që ato janë në gjendje t'i shërbejnë qëllimit për të cilin merren.

Gjykata po ashtu ka më shumë gjasa të gjejë që kufizimi i lëvizjes është joproporcional kur ai aplikohet në mënyrë gjithëpërfshirëse, automatike, pa marrë në konsideratë rrethanat individuale^[340]. Shumë reagime ndaj Covid-19 kanë përfshirë kufizime gjithëpërfshirëse të lëvizjeve nëpër tërë Shtetet dhe kanë prekur tërë popullsinë. Masa të tilla pa dallim mund të shkaktojnë shqetësim kur nuk marrin parasysh individët që mund të preken ndryshe nga një kufizim gjithëpërfshirës. Për shembull, personat me paaftësi mendore ose fizike të cilët kanë nevojë të kalojnë më shumë kohë jashtë sesa të tjerët^[341] dhe ata që kanë nevojë të dalin nga shtëpia për të blerë sende esenciale ose për të bërë pagesa të sigurimeve shoqërore^[342]. Nëqoftëse kufizimet e lëvizjes nuk lejojnë përjashtime

- [339] Shih: <https://blogs.lse.ac.uk/europpblog/2020/03/26/ beating-covid-19-the-problem-with-national-lockdowns/> "Mundja e Covid-19: Problemi i mbylljeve brenda në shkallë kombi" nga M.J.Bull, LSE Blogs, 26 mars 2020, dhe shembulli i rreth 25,000 italianëve që u larguan nga Lombardia kur ajo u mbyll për udhëtime në pjesë të tjera të vendit, duke bërë që Qeveria të mbyllte tërë vendin. Shih gjithashtu: <https://www.reuters.com/article/us-health-coronavirus-serbia/serbia-imposes-night-curfew-orders-elderly-indoors-idUSKBN2143XR> "Serbia imponon shtetrrëthim natën, urdhëron të moshuarit të rrinë brenda", A.Vasovic, Reuters, 17 mars 2020, ku shpallja e gjendjes së emergjencës në Serbi bëri që pensionistët të 'nguteshin për të marrë pensionet dhe për të kryer punët', duke nxitur autoritetet që të vinin shtrëngime më të ashpra.
- [340] Për shembull, Gjykata Superiore e Drejtësisë në Castile e Leon gjeti të paligjshme një masë, e miratuar nga qeveria rajonale, e cila i ndalonte të gjithë banorët e shtëpive të të moshuarve që të dilnin jashtë ndërtesave të tyre dhe të prisnin vizita, pavarësisht nga shkalla e infektimit në qendër (Urdhri i datës 6.11.2020, 297/2020). Kjo masë u gjet se nuk i përmbushte kriteret e nevojshmërisë, përshtatshmërisë dhe proporcionalitetit.
- [341] Shih sfidën që doli në Mbretërinë e Bashkuar, e cila bëri që Qeveria të ndryshonte udhërrëfyesin për largimin nga shtëpia për ta bërë të qartë se ata me sëmundje për të cilat duhet të dilnin nga shtëpia më shumë se një herë në ditë, dhe të udhëtonin përtej zonës së tyre lokale, lejohen shprehimisht që ta bëjnë këtë. <https://www.gov.uk/government/publications/coronavirus-outbreak-faqs-what-you-can-and-cant-do/coronavirus-outbreak-faqs-what-you-can-and-cant-do> "Pyetje të shpeshta rreth shpërthimit të koronavirusit: çfarë mund dhe nuk mund të bësh", Këshilla nga Zyra e Kabinetit, 26 gusht 2020; shih gjithashtu <https://www.bindmans.com/news/government-guidance-changed-to-permit-people-with-specific-health-needs-to-exercise-outside-more-than-once-a-day-and-to-travel-to-do-so-where-necessary> "Këshillat e qeverisë ndryshohen për t'u lejuar personave me nevoja të veçanta shëndetësore që të ushtrorjnë jashtë më shumë se një herë në ditë dhe të udhëtojnë për këto qëllime kurdo që nevojitet", Bindmans LLP, 8 prill 2020.
- [342] Shih Landvreugd dhe *Oliveira k. Holandës*, vendimet e 4 qershorit 2002, Nr. 37331/97 dhe 33129/96 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim), ku fakti që ishte mundësuar që kërkuesi të hynte në zonën relevante pa u

në raste të tilla, Shtetet duhet të arrijnë të demonstrojnë që ato kanë marrë në konsideratë edhe caktimin e masave më pak kufizuese^[343] por kanë arritur në konkluzionin që rreziku që i kanoset shëndetit publik nga përhapja e Covid-19 duke plotësuar kërkesat e individëve në rrethana të tilla është më i madh sesa rreziku i vënies së kufizimit gjithëpërfshirës të lëvizjes^[344].

b. E drejta për të hyrë në vendin e vet

Neni 3 § 2 i Protokollit Nr. 4 (A3P4) të Konventës mbron të drejtën e secilit për të hyrë në vendin e vet. Ai parashikon që:

“Askujt nuk mund t’i hiqet e drejta për të hyrë në territorin e Shtetit, shtetas i të cilit ai është.”

Në praktikë, interpretimi i kësaj dispozite është marrë parasysh në shumë pak raste. Shumë nga kufizimet e vendosura nga Shtetet si përgjigje ndaj pandemisë i janë aplikuar josthetasve ose jorezidentëve të Shtetit, ndërsa qytetarët e Shtetit kanë vazhduar të lejohen që të hyjnë në ‘vendin e vet’. Edhe në situata kur është vendosur ndalimi i tërësishëm i fluturimeve komerciale, aeroportet kanë vazhduar të funksionojnë me qëllim të riatdhesimit,^[345] dhe disa Shtete kanë organizuar

ndëshkuar për të marrë sigurimet sociale dhe postën e tij që relevante për gjetjen e Gjykatës që nuk kishte shkelje të A2P4; shih gjithashtu në Bosnje amendamentet e rregullës që ndalon ata mbi 65 vjeç të dalin nga shtëpia, gjë që u lejoi pensionistëve të dilnin nga shtëpia për katër orë gjatë ditëve të javës për të marrë pensionet dhe për të blerë hapat: shih <https://balkaninsight.com/2020/04/14/bosnias-constitutional-court-to-rule-on-movement-restrictions/> “Gjykata Kushtetuese e Bosnjës Vendos për Kufizimin e Lëvizjes”, nga E.Dizdarevic dhe N. Dervisbegovic, Balkan Insight, 14 prill 2020.

[343] Shih *Landvreugd dhe Oliveira k. Holandës*, vendimet e 4 qershorit 2002, Nr. 37331/97 dhe 33129/96 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim), ku Gjykata gjeti që urdhri 14-ditor që kufizonte hyrjen në një pjesë të qytetit ishte proporcional pjesërisht sepse kërkuesve u ishin lëshuar më parë disa urdhra ndalimi 8-orëshe, por ata ishin kthyer prapë se prapë çdo herë në zonën e ndaluar për t’u përfshirë në aktivitete me droga të forta në publik, dhe ku ata ishin paralajmëruar që edhe një përsëritje do të rezultonte në urdhër ndalimi 14-ditor.

[344] Shih për shembull: vendimin e Këshillit të Shtetit të Blegjikës (Raad van State, vendimi i datës 30.10.2020, Nr. 248.81), në të cilin Këshilli i Shtetit i Belgjikës hodhi poshtë një kërkesë për pezullim të dekretëve ministrorë që caktonin shtetdrethimin prej mesnatës deri në ora 5 të mëngjesit, mbi bazën e një shkeljeje të lirisë për të shkuar e për të ardhur dhe të drejtës për respekt të jetës private. Sipas Këshillit të Shtetit, shtetdrethimi synonte një objektiv legjitim (kufizimin e kontakteve sociale) në mënyrë që të mbronte sistemin e shëndetësisë; një qëllim i cili nuk mund të arrihej me anë të një mase më pak kufizuese si ndalimi i tubimit.

[345] Shih për shembull në Shqipëri ku të gjitha fluturimet komerciale u anuluan më 22 mars 2020, por Aeroporti

fluturime çarter për të siguruar që shtetasit të vazhdonin të hynin në vendet e tyre respektive. Meqenëse mbrojtjet sipas A3P4 iu aplikohen shtetasve të vendit ku ata kërkojnë të hyjnë, duket se nuk ka gjasa që ndalim-udhëtimet që kufizojnë hyrjen në Shtete të caktuara të ngrenë probleme sipas A3P4.

Megjithatë, në fund të marsit u paraqit një situatë e pazakontë në kufirin shqiptaro-grek. Shtetasve shqiptarë që udhëtonin për në shtëpi nga Greqia fqinje iu refuzua hyrja në territorin e Shtetit të tyre dhe u mbajtën në zonën tranzit pa asnjë ndihmesë ose sqarim rreth situatës së tyre.^[346] Vetëm pasi mori kritikave të ashpra publike Qeveria ua lejoi hyrjen për në Shqipëri dhe i karantinoi nëpër hotele. Mënyra se si u zbatua ndalimi i hyrjes mund të ngrejë çështje jo vetëm sipas A3P4, por edhe sipas Neneve 3 dhe 5 të Konventës.^[347]

Më tej, ndërkohë që ndalim-udhëtimet janë hequr gradualisht, Shtetet kanë filluar të fusin parakushte për hyrjen në territorin e tyre, siç është paraqitja e rezultateve të testit molekular negativ (PCR) për Covid-19 i kryer para hyrjes në Shtet, ose plotësimi i një formulari online para udhëtimit. Në disa raste, këto kushte iu aplikohen njësoj shtetasve dhe joshtetasve të Shtetit.^[348]

Ndërkohë që këto parakushte nuk përbëjnë privim të plotë të së drejtës për të hyrë në një vend, ato mund të ngrenë çështje sipas A3P4 nëse vënë pengesa ndaj hyrjes në praktikë. Për shembull, nëse një person nuk ka qasje në teknologjinë që duhet për të plotësuar formularin para hyrjes, ai nuk mund ta bëjë testin me kohë,

Ndërkombëtar i Tiranës (TIA) qëndroi i hapur për trajtimin e fluturimeve humanitare, riatdhesuese dhe të mallrave: <https://uk.reuters.com/article/health-coronavirus-albania-flights/albania-suspends-all-commercial-flights-out-of-tirana-idUKL8N2BF078> "Shqipëria pezullon të gjitha fluturimet komerciale nga Tirana", nga D.Goodman, 22 mars 2020.

[346] Shih <https://www.albaniandailynews.com/index.php?idm=41148&mod=2> "Rreth 40 shqiptarë të ngecur në kufirin me Greqinë", nga E. Halili, Albanian Daily News, 7 prill 2020.

[347] Për diskutimin rreth çështjeve që mund të dalin nga Nenet 5 dhe 3 në kontekstin e paraburgimit të personave në tranzit në zonat kufitare, shih seksionin 4 (E drejta e lirisë), në veçanti nënseksionin 'Qendrat e pritjes, identifikimit dhe regjistrimit të migrantëve' dhe seksionin 2 (Mbrojtja nga trajtimi çnjerëzor dhe degradues (migrantët dhe azilkerkuesit)) të Kapitullit II të këtij publikimi.

[348] Shih Protokollin për Arritjet në Greqi të futura më 1 korrik 2020 i cili kërkonte që të gjithë udhëtarët të plotësonin një Formular Lokacioni të Pasagjerit ditën para hyrjes në vend, dhe ky formular i mundëson të marrin një kod me email për të konfirmuar parashtrën dhe u kërkon udhëtarëve nga vende të caktuara të kenë rezultatet e një testi molekular (PCR) për Covid-19, të kryer 72 orë para hyrjes së tyre në Greqi. Këto kërkesa i aplikohen shtetasve grekë dhe rezidentëve të përhershëm të Greqisë: <https://travel.gok.gr/#/>

ose nëse testohet pozitiv për Covid-19^[349]. Në situata të tilla, një shtetas i një Shteti anëtar mund të privohet nga hyrja në Shtetin ku ai është nënshtruar. Kjo mund të justifikohet se synon qëllimin e mbrojtjes së shëndetit nëse një person testohet pozitiv për Covid-19. Megjithatë, nuk ka gjasa që të jetë i justifikuar nëse arsyeja pse një person nuk mund të hyjë është sepse ai nuk ka arritur të plotësojë formularin e kërkuar, dhe Shteti nuk ka ofruar mënyra alternative për plotësimin e këtyre formularëve.

Po ashtu, mund të dalin çështje edhe kur kontestohen të drejtat e rezidencës ose nacionalitetit të personit^[350]. Prandaj ka rëndësi që të vazhdojë të ketë mënyra efektive për të pohuar të drejtat sipas A3P4 gjatë tërë pandemisë kur Shtetet kanë fuqi më të gjera për të refuzuar hyrjen e joshtruarve. Çdo refuzim hyrjeje të një personi i cili besoj se duhet të pranohet për shkak të të drejtave të tij të rezidencës duhet të jetë i kontestueshëm.

[349] *Shih Kiyutin k. Ruisë*, vendimi i 10 marsit 2011, Nr. 2700/10 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim), ku Gjykata pranoi se kufizimet e udhëtimit mund të jenë thelbësore për mbrojtjen e shëndetit publik, por theksoi se kjo aplikohet vetëm në rastet e sëmundjeve tepër infektive me periudha të shkurtra inkubacioni, si kolera, fruthi, SARS dhe „gripi i shpendëve“ (H5N1), meqenëse individët, thjesht duke qenë prezent në një vend, mund t'i transmetojnë këto sëmundje përmes kontakteve rastësore ose përmes ajrit.

[350] *Oudrhiri k. Francës*, vendimi për pranueshmërinë i 31 marsit 1993, Nr. 19554/92 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

6. Neni 6 - E drejta për seancë dëgjimore të drejtë

Qëllimi kryesor i Nenit 6 të KEDNJ-së është të sigurojë drejtësinë e tërësishme të procedurave civile dhe penale. Neni 6 § 1 parashikon:

“1. Gjatë përcaktimit të të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të ndonjë akuze penale kundër tij, secili ka të drejtën për seancë dëgjimore të drejtë dhe publike brenda një kohe të arsyeshme nga një tribunal i pavarur dhe i paanshëm i ngritur sipas ligjit. VENDIMI do të shpallet publikisht por shtypi dhe publiku mund të përjashtohen nga krejt gjyqi ose një pjesë e tij në interes të moralit, rendit publik ose sigurisë publike në një shoqëri demokratike, ku interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve e kërkojnë një gjë të tillë, ose deri në masën që është rreptësisht e nevojshme sipas opinionit të gjykatës në rrethana të caktuara kur publiciteti do të paragjykonte interesat e drejtësisë.”

Mbrojtjet në Nenin 6 § 1, përfshirë drejtësinë e tërësishme dhe pjesëmarrjen efektive në procedura si dhe të drejtën për seancë dëgjimore publike brenda një kohe të arsyeshme, që diskutohen në nënseksionet (a) – (c) poshtë, aplikohen si në kontekstin e procedurave civile ashtu edhe në ato penale. Kriteret e Nenit 6 § 3, që diskutohen në nënseksionin (d) poshtë, aplikohen vetëm në kontekstin e procedurave penale.

Gjatë tërë pandemisë së Covid-19, Shtetet futën një sërë masash për të përshtatur operimin e gjyqësorëve të tyre, shumë prej të cilëve kufizuan qasjen fizike në gjykata^[351]. Disa Shtete futën kategori të reja të çështjeve prioritare, dhe u siguruan që disa seanca me prani fizike të vazhdonin të mbaheshin kur vlerësohej urgjente^[352]. Përndryshe, nëpër gjykatat e Evropës (përfshirë dy Gjykata Rajonale

[351] Për një listë të masave të marra në tërë Evropën shih <https://www.coe.int/en/web/cepej/compilation-comments> “Menaxhimi i gjyqësorit – hartimi i komenteve dhe komenteve sipas vendeve”, harta interaktive Këshillit të Evropës.

[352] <https://experts-institute.eu/europe-de-la-justice/cepej/la-cepej-la-covid-19-rend-possible-limpossible/> “CEPEJ: Covid-19 mundëson të pamundurën”, Alain Nuée, 17 korrik 2020.

evropiane, GjDBE dhe GjEDNj^[353]) seancat u shtynë, u zhvilluan në distancë përmes telefonit ose videolidhjes, ose u vendosën në letër duke u bazuar mbi parashtrësit me shkrim, pa seanca dëgjimore me gojë^[354]. Në disa Shtete, rregullat dhe afatet procedurale u relaksuan ose u suspenduan përkohësisht, për shembull duke lejuar që çështja të dëgjohej nga një gjyqtar në vend të një trupi gjykues. Masa të tilla çuan, në disa raste, drejt zgjatjes së paraburgimit paragjyqësor^[355].

Situata pa precedent e pandemisë Covid-19 ngriti çështje të vështira për gjykatat në tërë Evropën^[356]. Në përgjithësi, Shtetet që tashmë e kishin futur në përdorim videolidhjen dhe lloje të tjera të teknologjisë në procedurat gjyqësore, ose ato që tashmë ishin mbështetur më shumë në procedurat me shkrim, iu përshtatën më shpejt dhe më efektivisht sfidave që solli pandemia^[357].

Pavarësisht nga pengesat e dala, Shtetet vazhduan të kishin përgjegjësi gjatë tërë pandemisë për të siguruar respektimin e kritereve të nenit 6^[358]. Kjo kërkonte shqyrtim të rrethanave individuale të secilës çështje për të përcaktuar mënyrën më efektive për të proceduar ndërkohë që qasja fizike në gjykata ishte

[353] Në lidhje me KEDNJ-në, shih: "Funkcionimi i Gjykatës gjatë periudhës së kufizimeve", Kumtesë për shtyp KEDNJ 111 (2020) 15 prill 2020. Në lidhje me GjDBE, shih: Kumtesa për shtyp Nr. 46/2020 of 3 prill 2020.

[354] <https://experts-institute.eu/europe-de-la-justice/cepej/la-cepej-la-covid-19-rend-possible-limpossible/> "CEPEJ: Covid-19 mundëson të pamundurën", Alain Nuée, 17 korrik 2020.

[355] Shih: <https://www.dalloz-actualite.fr/flash/covid-19-adaptation-des-regles-applicables-en-matiere-penale> "Covid-19: adaptimi i rregullave të aplikueshme në çështje penale", Dorothee Goetz, 24 nëntor 2020; <https://www.vie-publique.fr/en-bref/274047-adaptation-des-procedures-penales-face-au-covid-19> "Drejtësia: cilat adaptime të rregullave të procedurës penale?" 6 prill 2020.

[356] Për shembull, në çështjen *XX k. OO, (C-220/20)*, një gjykatë italiane bëri kërkesë për një vendim paraprak nga GjDBE në lidhje me gjendjen e masave të jashtëzakonshme, përfshirë pezullimin e aktiviteteve administrative, civile dhe penale të gjykatës, përfshirë seancat dëgjimore dhe afatet e ndryshme, me përjashtim të rasteve urgjente. Gjykata referuese pyeti nëse disa dispozita të caktuara të Traktateve dhe Kartës që ngërthejnë vlerat e BE-së dhe të drejtat themelore përjashtojnë masat në situata emergjente, duke pasur parasysh në mënyrë të veçantë (por jo vetëm) qasjen tek të drejtat e drejtësisë që kanë të bëjnë me: dëmtimin e pavarësisë gjyqësore, impakti mbi funksionimin gjyqësor, shkeljen e parimit të duhur dhe barazisë para ligjit, dhe 'paralizën e tërësishtme të drejtësisë civile dhe penale'. GjDBE e deklaroi kërkesën dukshëm të papranueshme.

[357] <https://experts-institute.eu/europe-de-la-justice/cepej/la-cepej-la-covid-19-rend-possible-limpossible/> "CEPEJ: Covid-19 mundëson të pamundurën", Alain Nuée, 17 korrik 2020.

[358] <https://rm.coe.int/declaration-en/16809ea1e2> "Deklaratë e CEPEJ: Mësimet e nxjerra dhe sfidat e përballuara nga gjyqësori gjatë dhe pas pandemisë Covid-19" Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ), CEPEJ (2020)8rev, 10 qershor 2020.

e kufizuar^[359]. Duhet të gjendet një ekuilibër i drejtë mes aspekteve të ndryshme të Nenit 6,^[360] për shembull kriteri për të mbajtur seancën dëgjimore brenda një kohe të arsyeshme mund të duhet të balancohet me përshtatshmërinë e mbajtjes së seancës në distancë e cila mund të zhvillohet më shpejt por e cila mund të ndikojë në drejtësinë e procedurave në një mënyrë të ndryshme, varësisht nga natyra e çështjes dhe palët e përfshira^[361].

Në shumë raste, në rregullat procedurale që qeverisin procedurat gjyqësore u futën ndryshime si masa të përkohshme, por ato vazhduan të zgjatëshin teksa pandemia vazhdoi të ndikonte në procedura më gjatë sesa ishte menduar kur u futën masat e para të emergjencës^[362]. Përveç kësaj, disa nga masat e reja të miratuara në reagim ndaj pandemisë Covid-19 me gjasë do të vazhdojnë të përdoren edhe pasi të jenë lehtësuar kufizimet e distancimit social dhe të mbylljes në shtëpi, për të ndihmuar lehtësimin e sasive të konsiderueshme të çështjeve të mbetura prapa për shkak të pandemisë. Masa të tilla po ashtu kanë potencialin që të përmirësojnë qasjen në drejtësi kur qasja e kufizuar në transport dhe pengesa të tjera tashmë janë duke e penguar qasjen në gjykata, gjë që vazhdon^[363]. Për shembull, CEPEJ (Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë) rekomandon që, pas pandemisë, shumë aspekte të funksionimit tradicional të gjykatës duhet të

[359] Shih Deklaratën e Kryetarit të Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë (CCJE), "*Roli i gjyqtarëve gjatë dhe pas pandemisë Covid-19: mësimet dhe sfida*", CCJE(2020)2, Strasburg, 24 qershor 2020.

[360] *Boddaert k. Belgjikës*, vendim i 12 tetorit 1992, Nr. 12919/87, § 39.

[361] Shih "*Video-konferencat e imponuara në çështje penale gjatë gjendjes së emergjencës sanitare: kujdes me të drejtat e mbrojtjes*", Dorothee Goetzle, 16 shkurt 2021, Këshilli i Shtetit Francez (Conseil d'Etat) më 12 shkurt 2021 gjeti se dispozitat e urdhëresës së 18 nëntorit 2020, që autorizonte përdorimin e video-konferencave, pa pëlqimin e palëve, seiozisht dhe dukshëm dëmtuan të drejtat e mbrojtjes. Shih gjithashtu urdhrin e 25 nëntorit 2020, nga Gjykata Rajonale e Šiauliai, në Lituani, e cila vendosi, duke marrë parasysh rëndësinë e të drejtës themelore për qasje në drejtësi dhe kontesktin e veçantë të çështjes, se nuk ishte e pranueshme që formalitetet e depozitimit të kërkesës para gjykatës së shkallës së parë nuk ishin respektuar, pavarësisht nga argumentet që ky dështim ishte për shkak të kufizimeve të vëna si pasojë e pandemisë (Šiaulij apygardos teismas, Civilinė byla, urdhri i datës 25.11.2020, Nr. e2S-802-368/2020).

[362] Shih: <https://www.dalloz-actualite.fr/flash/covid-19-adaptation-des-regles-applicables-en-matiere-penale>, Dorothee Goetz, 24 nëntor 2020, ku diskutohen, për shembull, urdhrat e qeverisë në francë që modifikuan procedurat gjyqësore, të cilët fillimisht hynë në fuqi deri në fund të vitit 2020, por më pas u zgjatën deri më 31 dhjetor 2021.

[363] Shih https://peacekeeping.un.org/sites/default/files/rch_final.pdf "*Seancat Gjyqësore në Distancë dhe Proceset Gjyqësore në Kushtet e Covid-19 në Misionet dhe Vende të Tjera të Ndeshme*", raport i Shërbimit të Drejtësisë dhe Korrektimit të OKB-së, 29 prill 2020.

rishqyrtohen, përfshirë marrëdhëniet me media, niveli i përdorimit të teknologjive dhe shfrytëzimi më i madh i zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve, në mënyrë të veçantë ndërmjetësimi^[364].

Ndërkohë që masa të tilla duket se po bëhen më shumë elemente të rregullta në administrimin e drejtësisë, mbetet me rëndësi të sigurohet që çdo sistem i ri apo masë e re e miratuar në kontekstin e pandemisë të jenë të mjaftueshme për të mbrojtur të drejtën e gjyqit të drejtë.

a. Drejtësia e tërësishme dhe pjesëmarrja efektive në procedura

Ndërkohë që seancat në distancë kishin hyrë tashmë në shumë juridiksione në Evropë, pandemia Covid-19 e përshpejtoi me ritme të larta përdorimin e tyre në një shkallë të paparë deri atëherë, duke ndihmuar ofrimin e qasjes në drejtësi gjatë tërë pandemisë^[365].

Në kontekstin e seancave të mbajtura në distancë, kriteret e Nenit 6 vazhdojnë të aplikohen. Kjo përfshin të drejtën e të akuzuarit ose paditësit për të marrë pjesë në mënyrë efektive në një seancë dëgjimore ose gjyq,^[366] çka do të thotë jo vetëm e drejta për të qenë i pranishëm por edhe për të dëgjuar dhe ndjekur procedurat. Kriteret e seancave dëgjimore sipas Nenit 6 janë më të rrepta sesa ato të Nenit 5. Kështu, mund të kishte qenë e pranueshme sipas Nenit 5 që një kërkues të përfaqësohet nga avokati i tij, e jo të marrë pjesë vetë në seancë, gjatë pandemisë. Megjithatë, një situatë e tillë nuk ka gjasa të jetë në përputhje me mbrojtjet më të rrepta të Nenit 6 për sa u përket procedurave civile dhe penale^[367].

[364] <https://rm.coe.int/declaration-en/16809ea1e2> "Deklaratë e CEPEJ: Mësimet e nxjerra dhe sfidat e përballuara nga gjyqësori gjatë dhe pas pandemisë Covid-19", Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ), CEPEJ (2020)8rev, 10 qershor 2020.

[365] <https://doi.org/10.36745/ijca.379> "Video-Seancat në Evropë Para, Gjatë dhe Pas Pandemisë COVID-19", Anne Sanders, 6 maj 2021, Gazeta Ndërkombëtare për Administratën e Gjykatave.

[366] *Murtazaliyeva k. Rusisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 18 dhjetorit 2018, 36658/05, § 91.

[367] *Bah k. Holandës*, vendimi i 22 qershorit 2021, Nr. 35751/20, § 44, ku u gjet se nuk ishte në pajtueshmëri me Nenin 5 § 4 që të vlerësohej urdhri për paraburgimin e kërkuesit pa u siguruar prania e tij në seancë, por ku Gjykata theksoi se duhet të kihet parasysh që Neni 5 § 4 nuk cakton të njëjtat kritere strikte si Neni 6 në titullin e tij civil ose penal.

Zërimi i dobët dhe vështirësitë e të dëgjuarit në sallën e gjyqit mund të ngrenë çështje sipas Nenit 6^[368], dhe kjo aplikohet edhe në kontekstin e seancave në distancë gjithashtu. Gjykata e ka pranuar që marrja në pyetje përmes videolidhjes mund të sigurojë pjesëmarrjen efektive në procedura,^[369] dhe ka gjetur që përdorimi i videokonferencave nuk është as problem e as avantazh sipas Nenit 6, për sa kohë që shfrytëzimi i tyre i shërben arritjes së qëllimit të garantimit të drejtësisë së tërësishme të procedurave^[370]. Prandaj cilësia e teknologjisë së përdorur është faktor kyç për të garantuar që e drejta për gjyq të drejtë është e siguruar meqenëse pjesëmarrësit përmes videolidhjes duhet të jenë në gjendje të ndjekin procedurat dhe të dëgjohen pa pengesa teknike.^[371] Njëkohësisht, duhet të ofrohet edhe komunikimi efektiv dhe konfidencial me një avokat.^[372]

Vendimet nëse do të përdoret teknologjia për të zhvilluar seanca dëgjimore në distancë do të merren sipas rastit, duke marrë parasysh të gjitha implikimet e mundshme që mund të dalin nga përdorimi i teknologjisë, përfshirë cilësinë

[368] *Stanford k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 23 shkurtit 1994, Nr.16757/90, § 29.

[369] *Bivolaru k. Rumanisë*, vendimi i 2 tetorit 2018, Nr. 66580/12.

[370] *Sakhnovski k. Rusisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 2 nëntorit 2010, Nr. 21272/03 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim); shih gjithashtu qëndrimet e ndryshme të Gjykatës Franceze të Kasacionit dhe Këshillit Kushtetues Francez në lidhje me urdhëresën që adapton rregullat e procedurës penale për të trajtuar pandeminë Covid-19, duke përfshirë mundësinë e përdorimit të telekomunikimeve audio-vizive pa marrë pëlqimin e palëve. Gjykata e Kasacionit, me vendimin e saj të datës 6.10.2020, Nr. 20-84.171, konsideroi se përdorimi i telekomunikimeve audio-vizuale, në kontekstin e zgjatjes së paraburgimit paragjyqësor, nuk ishte në kundërshtim me Nenin 5 të KEDNJ-së kur gjyqtarëve u kërkohet në këtë kontekst të zhvillojnë procedura në mënyrë të atillë që garantohet respektimi i të drejtave të mbrojtjes dhe natyra kontradiktoriale e procedurave. Megjithatë, me një vendim të 15 janarit 2021, Nr. 2020-872 QPC, Këshilli Kushtetues e shpalli këtë dispozitë jokushtetuese. Duke pasur parasysh rëndësinë e garancisë që i jepet prezantimit fizik të një personi para një gjykatë penale, dhe duke marrë në konsideratë faktin që përdorimi i telekomunikimeve audio-vizuale nuk i nënshtrohej ndonjë kushti apo përjashtimi ligjor, ose kërkesës së pëlqimit të palëve, ajo doli në përfundimin se dispozita shkelte të drejtat e mbrojtjes në një mënyrë që nuk mund të justifikohet nga konteksti i emergjencës shëndetësore.

[371] Shih <https://www.judiciary.uk/wp-content/uploads/2020/06/CJC-Rapid-Review-Final-Report-f.pdf> "Impakti i masave Covid-19 mbi sistemin e drejtësisë civile", nga Dr. N. Byrom, S. Beardon dhe Dr. A. Kendrick, raporti i Këshillit të Drejtësisë Civile dhe Fondacionit për Arsimit Ligjor, maj 2020. Raporti gjeti nën-investime në objekte, teknologji dhe staf në nivel të Gjykatës Krahinore, dhe mungesë të platformave apostafat për video-seanca, që shkaktonin probleme për përdoruesit e gjykatës. Rreth gjysma e të gjitha seancave në mostrën e tyre kishin vështirësi teknike, me pak ose aspak mbështetje për zgjidhjen e problemeve.

[372] *Yaroslav Belousov k. Rusisë*, vendim i 4 tetorit 2016, Nr. 2653/13 dhe 60980/14; *Sakhnovskiy k. Rusisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 2 nëntorit 2010, Nr. 21272/03, § 98.

teknike dhe kufizimet e teknologjive që mund të përdoren.^[373] Faktorë të tjerë që duhen marrë parasysh përfshijnë dobësitë e ndonjë dëshmitari/eje, nëse ai/ajo ka vështirësi mësimi ose paaftësi të cilat mund të vështirësojnë komunikimin përmes videolidhjes, nëse ai/ajo ka hapësira private ku mund të flasin e të japin informacione private dhe nganjëherë traumatike, dhe nëse besueshmëria e tyre është problematike.

Raportet tregojnë që të pandehurit dhe dëshmitarët mund t'i gjejnë këto procedura më çorientuese, të tilla që shkaktojnë konfuzion dhe stresuese, pa një person fizik të pranishëm që vepron në emër të tyre, dhe si avokatët ashtu edhe dëshmitarët kanë raportuar se kanë vështirësi për të kuptuar qëndrimet e gjyqtarëve dhe jurive pa vizibilitetin e sinjaleve joverbale ndaj të cilave ato reagojnë dhe iu përshtaten në sallat e gjyqit. Në seanca dëgjimore në distancë nuancat mund mos pikasen, dhe keqkuptimet mund të ndodhin pa u kuptuar, dhe gjyqtarët kanë raportuar që të pandehurit mund të duken të largët dhe të pavëmendshëm në ekran.^[374] Problemet teknike, jehonat dhe ndërprerjet e acarojnë edhe më tej këtë problem. Kështu që mbetet e preferueshme që kur bëhet fjalë për besueshmërinë e dëshmitarit seancat dëgjimore të zhvillohen me palët fizikisht të pranishme.^[375]

Impakti i vonimit të një seance dëgjimore është faktor që mund të peshojë në favor të mbajtjes së një seance dëgjimore në distancë. Për shembull, nëse vonesa nënkupton që i pandehuri do t'i nënshtrohet një periudhe më të gjatë paraburgimi paragyqësor pa seancë dëgjimore dhe gjykohet se nuk është e sigurt të mbahet seanca në praninë fizike të palëve. Natyra dhe kompleksiteti i çështjes po ashtu janë të rëndësishëm, videokonferencat mund të jenë më të përshtatshme për

[373] *Yevdokimov dhe të Tjerë k. Ruisë*, vendim i 16 shkurtit 2016, Nr. 27236/05, 44223/05, 53304/07, 40232/11, 60052/11, 76438/11, 14919/12, 19929/12, 42389/12, 57043/12 dhe 67481/12, ku Gjykata gjeti shkelje të Nenit 6 sepse gjykatat vendase nuk u duk se kishin zhvilluar analizën e duhur substanciale, duke publikuar arsyet, mbi faktin nëse prania fizike ishte e nevojshme për drejtësinë e procedurave, dhe se cilat opsione dhe masa kompensuese ekzistonin nëqoftëse nuk kërkohet prania fizike.

[374] Shih <http://spccweb.thco.co.uk/media/4807/university-of-surrey-video-enabled-justice-final-report-ver-11.pdf> "Video Mundëson Vlerësimin e Drejtësisë", Nga Prof. N. Fielding, Prof. S.Braun dhe Dr G.Hieke, Komisioneri për Polici dhe Krime dhe Universiteti i Surrey, mars 2020, që gjejnë se të akuzuarit kanë më shumë gjasa për t'u dënuar me burg në seancat në distancë.

[375] Shih https://peacekeeping.un.org/sites/default/files/rch_final.pdf "Seancat në Distancë të Gjykatës dhe Proceset Gjyqësore në Përgjigje ndaj Covid-19 në Misione dhe Ambiente të tjera Delikate", dokument i Shërbimit të Drejtësisë dhe Korrektimit të OKB-së, 29 prill 2020.

çështje të shkurtra dhe të thjeshta, e jo për çështje komplekse ku ka palë dhe dëshmitarë të shumtë dhe ku mund të vihen në diskutim çështje të faktit.

Mbrojtjet për të siguruar drejtësinë e seancave dëgjimore në distancë

Kur ka justifikime të forta për të urdhëruar përdorimin e procedurave të drejtësisë në distancë, seancat dëgjimore në distancë duhet të zhvillohen vetëm nëse ekzistojnë mbrojtjet e duhura për të adresuar kërcënimet e mundshme ndaj të drejtës për gjyq të drejtë. Mbrojtjet mund të përfshijnë masat e mëposhtme:

- i) Kur përdorimi i teknologjisë auditive në distancë varet nga pëlqimi i palëve, të sigurohet që pëlqimi të jepet lirisht dhe me informim të plotë, duke marrë parasysh cenueshmëritë e palëve, dhe nëse ato janë në një situatë ku mund të detyrohen apo të manipulohen për të dhënë pëlqimin^[376].
- ii) Të sigurohet që videolidhja të paraqesë me vërtetësi sallën e gjyqit sa më shumë që të jetë teknikisht e mundur, në përpjekje për të siguruar që secili pjesëmarrës të mund t'i shohë të gjitha palët e përfshira.
- iii) Vënia në dispozicion e mbështetjes teknike për çdo palë që ka probleme teknike.
- iv) Të sigurohet që të pandehurit, paditësit dhe/ose dëshmitarët të kenë opsionin për t'u konsultuar ose për t'i dhënë udhëzime avokatit në mënyrë konfidenciale gjatë procedurave.
- v) Mbrojtja e sigurisë së informacionit. Në disa juridiksione janë përdorur Skype dhe WhatsApp për të zhvilluar seancat, por niveli i sigurisë së këtyre platformave të komunikimit është i paqartë.^[377]
- vi) Futja e gjyqtarëve në kurse trajnimi për t'u mësuar ekspertizën teknike të menaxhimit të një seance në distancë, përfshirë pjesëmarrjen e vet dhe të tjerëve.^[378]

[376] https://www.unodc.org/res/ji/import/guide/icj_videoconferencing/icj_videoconferencing.pdf "Video-konferencat, Gjykatat dhe Covid-19, Rekomandime mbi Bazën e Standardeve Ndërkombëtare", Komisioni Ndërkombëtar i Juristëve, nëntor 2020.

[377] Shih <https://www.coe.int/en/web/cepej/compilation-comments> "Menaxhimi i gjyqësorit - përmbledhje e komenteve sipas vendeve", harta interaktive e Këshillit të Evropës.

[378] Shih <https://rm.coe.int/declaration-en/16809ea1e2> "Delarata e CEPEJ-së: Mësimet e nxjerra dhe sfidat e hasura nga gjyqësori pas pandemisë Covid-19", Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ), CEPEJ (2020)8rev, 10 qershor 2020.

- vii) Simulimin e seancave gjyqësore para seancës së plotë për të lehtësuar tranzicionin drejt seancave në distancë, dhe për t'u siguruar që çdo vështirësi teknike të rregullohet përpara.
- viii) Përditësimi i rregullave procedurale dhe lëshimi i udhërrëfyesve se si të vendoset nëse një seancë në distancë është e përshtatshme për t'u mbajtur, dhe i afateve të reja kohore ose procedurave të reja që vendosen.
- ix) Informimi paraprak i të pandehurve, paditësve dhe/ose dëshmitarëve se çfarë mund të pritët, si do të zhvillohet seanca, kërkesat teknike për ta, dhe si mund të kërkojnë ndihmë, p.sh. përkthim ose ndihmë teknike.

Në të njëjtën mënyrë si integriteti i sistemit gjyqësor, përfshirë kompetencat, pavarësinë dhe paanshmërinë, e drejta për qasje në gjykatë dhe për zgjidhje efektive duhet të ruhet me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të njeriut në situata emergjente, integriteti i shërbimit prokurorial dhe organizimit të tij gjithashtu duhet të mbrohet, duke zbatuar të njëjtin arsyetim racional, si e vetmja mënyrë për të garantuar funksionimin e sistemit të drejtësisë gjatë një situatë emergjente. Në situata emergjente, e veçanërisht gjatë një pandemie, shërbimet prokuroriale dhe prokurorët duhet ta zbatojnë ligjin pa rënë poshtë standardeve të pritshme, me respekt të palëkundur për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore. Funksionimi i shërbimeve prokuroriale, ashtu si ato të gjykatave, duhet t'u përshtatet rrethanave të imponuara nga situata e emergjencës për të siguruar që përgatitja para-seancave dhe hetimet të vazhdojnë të zhvillohen. Kjo përfshin miratimin e përdorimit të teknologjive të reja, siç janë procedurat online për të komunikuar çështjet, për të mundësuar pjesëmarrjen e viktimave, ekspertëve dhe dëshmitarëve në procedura paragjyqësore përmes videolidhjes, njohjen ligjore të provave elektronike ose provave të paraqitura në formë elektronike, ngritjen e sistemit të databazës elektronike të çështjeve dhe menaxhimit të provave^[379].

b. Seanca publike

Karakteri publik i procedurave është pjesë e rëndësishme e garantimit të drejtësisë. Administrimi i drejtësisë duhet të jetë i dukshëm në mënyrë që të jetë i hapur ndaj këqyrjes publike. Gjyqi i përmbahet kriterit të publicitetit nëse publiku mund të marrë informacione në lidhje me datën dhe vendin, dhe nëse ky vend është kollaj për të shkuar.^[380] Kjo i mundëson pjesëtarëve të publikut, dhe çka

[379] Opinioni i CCPE Nr. 15 (2020): Roli i prokurorëve në situata emergjente, posaçërisht gjatë përballjes me një pandemi, 19 nëntor 2020.

[380] *Riepan k. Austrisë*, vendim i 14 nëntorit 2000, Nr.35115/97, §§ 27-29.

është me rëndësi gazetarëve, që të marrin pjesë në gjyq, t'i raportojnë një publiku më të gjerë në lidhje me ato që ndodhin, dhe mbase të paraqesin një perspektivë të ndryshme të çështjes prej asaj që mund të paraqesë Shteti.^[381] Transmetimi i seancave gjyqësore në internet (ang. webcasting) mund të shërbejë për të arritur tek një publik më i gjerë dhe për të inkurajuar interes më të madh në aspektet e jetës publike me të cilat merren gjykatat. Në kontekstin e pandemisë, dhe në çdo situatë emergjente, transmetimi në internet mund të shihet si diçka edhe më e justifikuar, jo vetëm për angazhimin civil, por edhe me qëllimqë të demonstrojë shprehimisht që drejtësia është duke u zhvilluar hapur dhe në mënyrë publike^[382].

Gjatë pandemisë, qasja fizike në disa gjykata u kufizua, duke ndaluar ose duke e bërë të vështirë që gazetarët të marrin pjesë në gjykata.^[383] Në rastet kur seancat dëgjimore janë mbajtur në distancë, informacionet nuk kanë qenë gjithmonë të mjaftueshme për t'u mundësuar publikut ose gazetarëve që të merrnin vesh se kur do të mbahen seancat, për çka bëhet fjalë në gjyq, ose se si të regjistrohen për ta ndjekur online. Kur gazetarët kanë arritur të regjistrohen për të parë seancat nga distanca, disa kanë shprehur shqetësimin se lidhja e tyre është ndërprerë ose është shkëputur komplet. Sidomos në procedura penale pritet publiciteti i madh, megjithëse Gjykata ka pranuar që në disa raste mund të lindë nevoja sipas Nenit 6 për të kufizuar natyrën e hapur dhe publike të procedurave në mënyrë që, për shembull, të mbrohet siguria dhe privatësia e dëshmitarëve.^[384] Megjithatë rastet kur shqetësimet e sigurisë justifikojnë përjashtimin e publikut nga gjyqi janë të rralla.^[385] Çdo masë sigurie duhet të përputhet ngushtë dhe të ndjekë parimin e nevojshmërisë, pasi të jenë shqyrtuar të gjitha alternativat e tjera të mundshme për të garantuar sigurimin dhe sigurinë në sallën e gjyqit.^[386]

[381] Shih <https://insights.doughtystreet.co.uk/post/102g6r7/open-justice-during-lockdown> "Drejtësia e Hapur Gjatë Mbylljes Brenda", nga C. Gallagher QC, Doughty Street Insights, 7 maj 2020.

[382] Opinioni i CCPE Nr. 15 (2020): Roli i prokurorëve në situata emergjente, veçanërisht gjatë përballjes me një pandemi, 19 nëntor 2020.

[383] Shih ndryshimet në Hungari: https://www.helsinki.hu/wp-content/uploads/HHC_changes_in_Hun_crim_proc_COVID-19_08052020.pdf "Ndryshimet në Procedurën Penale Hungareze për Shkak të Pandemisë Covid-19", Komiteti i Helsinkit i Hungarisë, 8 maj 2020. Shih gjithashtu, për shembull, vendimin e Gjykatës Supreme Administrative të Polonisë që e drejta për seancë publike nuk është absolute dhe mund të kufizohet me ligj në mënyrë që të mbrohet shëndeti publik. Duke qenë se qëllimi i ligjit në fjalë ishte mbrojtja e jetës dhe shëndetit njerëzor kundrejt Covid-19, ajo mund të aplikohet nga gjyqtarët për të kufizuar të drejtën për seancë publike (Naczelny Sąd Administracyjny, vendim i datës 30.11.2020, II OPS 6/19).

[384] *B. dhe P. k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 24 prillit 2001, Nr. 36337/97 dhe 35974/97, § 37.

[385] *Riepan k. Austrisë*, vendim i 14 nëntorit 2000, Nr.35115/97, § 34.

[386] *Krestovskiy k. Rusisë*, vendim i 28 tetorit 2010, Nr. 14040/03, § 29.

Në kontekstin e pandemisë, ndërkohë që ka pasur shqetësime rreth sigurisë së njerëzve që marrin pjesë fizikisht në sallën e gjyqit, ka pasur shqetësime edhe për sigurinë e pranimit të publikut në seancat dëgjimore online, për shkak të mundësisë së shkaktimit të ndërprerjeve në seancë dhe nevojës për të mbrojtur konfidencialitetin^[387]. Këto shqetësime duhet të trajtohen në një mënyrë e cila maksimizon këqyrjen publike të seancës, duke u siguruar që seanca të shkojë mirë e qetë, dhe që informacionet konfidenciale dhe privatësia e pjesëmarrësve të jenë të mbrojtura. Këto faktorë nuk mund të menaxhohen pa përjashtimin total të publikut nga seancat në distancë, për shembull duke u siguruar që ata që menaxhojnë seancën të kenë udhërrëfyes dhe ekspertizë të mjaftueshme teknike për të ulur në fund zërin dhe/ose për të përjashtuar pjesëmarrësit që shkaktojnë probleme, në mënyrë që kjo masë të zbatohet në mënyrë konsistente dhe vetëm kur është e nevojshme. Përveç kësaj, kur nuk është i mundur transmetimi i drejtpërdrejtë (ang. live streaming), regjistrimet e procedurave mund të vihen në dispozicion të publikut, në disa raste pasi të jenë redaktuar duke hequr informacionet private ose konfidenciale.

c. Brenda një kohe të arsyeshme

Ndërkohë që u futën masa emergjente për të siguruar që administrimi i drejtësisë të vazhdonte gjatë pandemisë, në shumë juridiksione, seancat dëgjimore të vlerësuara 'jo urgjente' thjesht u shtynë. Vonesat në procedura si rezultat i pandemisë vetëm sa e shtuan numrin e çështjeve të mbetura prapa në Shtetet evropiane, duke përbërë kërcënim për elementin e Nenet 6 i cili kërkon që seancat të zhvillohen pas një vlerësimi të tërësishëm të rrethanave të çështjes^[388], për shembull çka rrezikojnë palët dhe nëse i pandehuri është duke u mbajtur në paraburgim paragjyqësor^[389], kompleksiteti i çështjes, sjellja e individit dhe sjellja e autoriteteve.^[390]

[387] "Udhërrëfyesi i CCBE mbi përdorimin e instrumenteve për punë në distancë nga avokatët në procedura gjyqësore në distancë", 27 nëntor 2020, at www.ccbe.eu.

[388] *Boddaert k. Belgjikës*, vendim i 12 tetorit 1992, Nr. 12919/87, § 36.

[389] *Abdoella k. Holandës*, vendimi i 25 nëntorit 1992, Nr. 12728/87, § 24; *Starokadomskiy k. Rusisë (Nr. 2)*, vendimi i 13 marsit 2014, Nr. 27455/06, §§ 70-71; disa gjykata vendase gjithashtu kanë sugjeruar që impakti i një periudhe në burg gjatë pandemisë me gjasë është më i ashpër, për shembull, sepse ata që mbahen në burg janë të kufizuar brenda qelive të tyre për periudha më të gjata kohore dhe nuk kanë mundësi të presin vizita familjare (shih *Manning, R. v (Rev 1) [2020] EWCA Crim 592 (30 prill 2020)*).

[390] *Fenech k. Maltës*, vendimi i 23 marsit 2021, Nr. 19090/20, § 111 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

Shtetet nuk mbajnë përgjegjësi për vonesat në procedura të shkaktuara nga ngecja e përkohshme e punës kur ato ndërmarrin veprime rekuperuese me shpejtësinë e duhur për të trajtuar situatën e jashtëzakonshme të çështjeve të mbetura mbrapa.^[391] Megjithatë, Gjykata rrallë i jep shumë peshë argumenteve që vonesat në procedura janë shkaktuar nga ngarkesa e madhe e punës.^[392] Një numër shumë i madh i çështjeve nuk janë proceduar gjatë pandemisë, dhe dosjet e mbetura mbrapa nga shtyrjet e bëra gjatë pandemisë me gjasë do të kenë impakt mbi qasjen në drejtësi për disa vjet me radhë.^[393] Pezullimi i procedurave për një periudhë prej tre muajsh për shkak të impaktit të masave emergjente të marra gjatë pandemisë nuk përbën vonesë të paarsyeshme, për sa kohë që procedurat vazhdojnë në mënyrë aktive para dhe pas një pezullimi të shkurtër e të përkohshëm, i nevojshëm për shkak të një situatë emergjente^[394].

Për të siguruar pajtueshmërinë me këtë aspekt të drejtësisë sipas Nenit 6, Shtetet duhet të marrin menjëherë të gjitha masat që mundën për ta trajtuar këtë sasi dosjesh të mbetura të cilat kanë rezultuar nga pandemia.^[395] Kjo mund të përfshijë vazhdimin e seancave në distancë, mbajtja e seancave gjatë pushimeve verore, dhe rritjen e buxhetit dhe burimeve për sistemin gjyqësor.

[391] *Milasi k. Italisë*, vendim i 25 qershorit 1987, Nr. 10527/83 § 18; *Baggetta k. Italisë*, vendim i 25 qershorit 1987 § 23, Nr. 10256/83.

[392] *Eckle k. Gjermanisë*, vendim i 15 korrikut 1982, Nr. 8130/78, § 92.

[393] Shih <https://www.fairtrials.org/news/short-update-trials-uk-could-face-delays-five-years-because-pandemic> "Përditësim i Shkurtër: Gjyqet në Mbretërinë e Bashkuar mund të përballen me vonesa deri në pesë vjet për shkak të pandemisë", nga Fair Trials Admin, 22 qershor 2020.

[394] *Fenech k. Maltës*, vendimi i 23 marsit 2021, Nr. 19090/20, §113 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim) ku procedurat kishin zgjatur gjatëmbëdhjetë muaj. Gjykata gjeti se, duke pasur parasysh kompleksitetin e çështjes, kjo periudhë kohore nuk mund të konsiderohej e paarsyeshme, në mënyrë të veçantë për shkak se kërkuesi nuk kishte përmendur ndonjë dështim, vonesë ose mosveprim nga ana e autoriteteve, përveç faktit që procedurat ishin suspenduar për shkak të masave të emergjencës. Prandaj, autoritetet nuk mund të qortoreshin për sjelljen e tyre. Fakti që nuk ishin mbajtur seanca gjatë procedurave paraprake për një periudhë prej tre muajsh – gjatë të cilëve puna e gjykatës ishte stopuar për shkak të pandemisë botërore – nuk e ndryshoi përfundimin. As nuk mund të thuhet që si rezultat i masave emergjente, thelbi i të drejtës së kërkuesit për qasje në gjykatë ishte dëmtuar.

[395] Shih <https://www.fairtrials.org/news/short-update-covid-19-court-delays-may-lead-more-children-and-young-people-being-convicted> "Përditësim i Shkurtër: Vonasat në gjykatë nga Covid-19 mund të bëjnë që më shumë fëmijë dhe të rinj/të reja të dënohen si të rritur në Angli dhe Wales", nga Fair Trials Admin, 24 qershor 2020.

d. Të drejtat e mbrojtjes për të pasur ndihmë ligjore të menjëhershme, praktike dhe efektive

Neni 6 § 3 jep garanci specifike për të garantuar drejtësinë e tërësishme të procedurave penale, duke parashtruar se kushdo që akuzohet për vepër penale të ketë të drejtat minimale të mëposhtme:

“a. të informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishme, për natyrën dhe për shkakun e akuzës që ngrihet ndaj tij;

b. t'i jepet koha dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes;

c. të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij, ose në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t'i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë;

d. të pyesë ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës;

e. të ndihmohet falas nga një përkthyes në qoftë se nuk kupton ose nuk flet gjuhën e përdorur në gjyq.”

Të drejtat e diskutuara poshtë nuk aplikohen në kontekstin e procedurave civile.

E drejta për ndihmë ligjore konkrete dhe efektive

Sipas Neneve 6 § 3 (b) dhe 6 § 3 (c) avokati duhet të jetë në gjendje t'i ofrojë ndihmë konkrete dhe efektive^[396] të akuzuarit gjatë tërë procedurës, duke i mundësuar të akuzuarit që të ketë tërë gamën e shërbimeve që ndërlidhen pikërisht me ndihmën ligjore, përfshirë përgatitjen për marrje në pyetje, mbështetjen e të akuzuarit kur është i shqetësuar, dhe kontrollimin e kushteve të paraburgimit.

[396] AT k. Luksemburgut, vendim i 9 prillit 2015, Nr. 30460/13.

Ata që akuzohen se kanë kryer një krim kanë të drejtën për qasje të menjëhershme në avokat prej momentit që ndalohen në fillim dhe merren në pyetje gjatë mbajtjes në polici. Gjykata ka njohur faktin që konsultimet efektive ligjore para dhe gjatë marrjes në pyetje në polici janë mbrojtje esenciale sipas Nenit 6, meqenëse marrja në pyetje nga policia mund të jetë fazë kritike e procedurës penale, ku deklaratat e marra gjatë kësaj marrjeje në pyetje mund të përdoren në gjyq më vonë. E drejta për t'u asistuar nga një avokat përfshin jo vetëm të drejtën për të pasur avokatin të pranishëm gjatë marrjes në pyetje, por edhe për të lejuar avokatin që ta ndihmojë të dyshuarin në mënyrë aktive gjatë marrjes në pyetje nga policia dhe për të ndërhyrë për të garantuar respektimin e të drejtave të të dyshuarit.

E drejta për komunikim privat me avokatin

Një prej elementeve bazë themelore të së drejtës për gjyq të drejtë është e drejta për komunikim privat me avokatin, pa rrezikun e të dëgjuarit nga palë të treta.^[397] Shtetet janë të detyruara të ofrojnë pajisje që mundësojnë komunikimin konfidencial, të drejtpërdrejtë dhe kuptimplotë mes avokatit dhe klientit. Masat e mbyllja brenda dhe distancimit social si reagim ndaj pandemisë e kanë bërë më të vështirë sigurimin e të drejtës për komunikim praktik dhe efektiv mes klientit dhe avokatit.^[398] Ndërkohë që vizitat në qendrat e paraburgimit u kufizuan dhe seancat dëgjimore zhvilloheshin në distancë, shumë avokatë nuk patën mundësi të shkonin në stacionet e policisë për t'u asistuar klientëve të ndaluar para dhe gjatë marrjes në pyetje nga policia, dhe e patën të pamundur të merrnin udhëzime dhe deklarata të dëshmitarëve nga klientët personalisht. Në vend të kësaj, avokatët dhe klientët po varen gjithnjë e më shumë nga thirrjet telefonike, videolidhjet, dhe forma të tjera të komunikimit në distancë.^[399]

[397] *Shih Castravet k. Moldavisë*, vendim i 13 marsit 2007, Nr. 23393/05, § 49.

[398] Shih për shembull sondazhin e zhvilluar nga Fair Trials International i cili gjeti një konsensus të madh mes respondentëve që cilësia e ndihmës ligjore në Angli dhe Wales kishte pësuar në mënyrë të konsiderueshme për shkak të kufizimeve nga Covid-19 dhe që komunikimet në distancë ishin një zëvendësim i dobët për ndihmën ligjore personale: <https://www.fairtrials.org/sites/default/files/Justice%20Under%20Lockdown%20survey%20-%20Fair%20Trials.pdf> "Drejhtësia në kushtet e mbylljes në shtëpi: Sondazh për sistemin e drejtësisë penale në Angli dhe Wales mes marsit dhe majit 2020", Raport i Fair Trials International, 25 qershor 2020.

[399] Për shembull, në Holandë avokatët u lejuan të takoheshin me klientët e tyre në paraburgim vetëm në lidhje me çështje urgjente, dhe iu kërkua të bënin kërkesë të arsyetuar për vizitë; në Spanjë ndihma ligjore përmes videokonferencës u inkurajua por nuk u zbatua për shkak të mungesës së pajisjeve; në Francë, këshilli i avokatisë në Paris ndaloi emërimet e avokatëve për ndihmë ligjore për shkak të mungesës së pajisjeve mbrojtëse, çka do të thoshte se të pandehurit mund të mos kenë pasur përfaqësim në disa raste: <https://www.fairtrials.org/>

Kjo mund të dëmtojë cilësinë dhe efektivitetin e ndihmës së dhënë nga avokatët, ku metoda të tilla komunikimi e bëjnë më të vështirë krijimin e raportit ose marrëdhënies së besimit me klientin.^[400] Kushtet e mbylljes brenda në shtëpi gjithashtu penguan qasjen në këshillim të menjëhershëm dhe/ose të rregullt kur të dyshuarit mund të mos kenë pasur qasje të rregullt në telefona dhe kohëzgjatja e thirrjeve të tyre mund të jetë shkurtuar nëse një numër i vogël telefonash është dashur të ndahen mes një numri të madh të burgosurish dhe kur ata detyrohen të paguajnë për të bërë telefonata. Shumë burgje mund të mos kenë teknologjinë e duhur për të mundësuar videothirrjet mes klientit dhe avokatit, por edhe kur e kanë këtë mundësi videolidhja ose linja telefonike mund të mos jetë e sigurt. Po ashtu, ka shqetësime lidhur me privatësinë e komunikimeve klient-avokat meqenëse si klienti ashtu edhe avokati mund të mos kenë një hapësirë private për të folur në telefon ose me videolidhje pa u dëgjuar për shembull nga të burgosurit e tjerë ose stafi i burgut.^[401]

Gjykata ka sugjeruar më parë që ofrimi i një linje telefonike të sigurt mund të jetë një metodë përmes së cilës një Shtet mund të përmbushë detyrimet e tij për të marrë masa për ofrimin e komunikimeve të rregullta, të sigurta, private dhe efektive mes klientit dhe avokatit kur vizitat fizike personale nuk janë të mundura.^[402] Duke pasur parasysh kufizimet e kontakteve fizike mes personave në kontekstin e pandemisë, mund të nevojiten masa më të gjera për të siguruar plotësimin e kriterëve të Nenit 6 § 3. Kjo mund të përfshijë shtimin e numrit të telefonave në dispozicion të të burgosurve, instalimi i teknologjive të videolidhjes në qendrat e paraburgimit,^[403] mundësimi i telefonatave falas ose

[sites/default/files/2_FT_COVID19_Access%20to%20Lawyer_Template%20arguments_2_Effective%20Access%20to%20a%20Lawyer.pdf](https://www.fairtrials.org/sites/default/files/2_FT_COVID19_Access%20to%20Lawyer_Template%20arguments_2_Effective%20Access%20to%20a%20Lawyer.pdf) "Mbrojtja e të drejtës për gjyq të drejtë gjatë pandemisë së koronavirusit: qasja në avokat", Raporti i Fair Trials, 3 prill 2020.

[400] https://www.fairtrials.org/sites/default/files/2_FT_COVID-19_Access%20to%20Lawyer_Template%20arguments_2_Effective%20Access%20to%20a%20Lawyer.pdf "Mbrojtja e të drejtës për gjyq të drejtë gjatë pandemisë së koronavirusit: qasja në avokat", Raporti i Fair Trials, 3 prill 2020" dhe <https://www.fairtrials.org/sites/default/files/Justice%20Under%20Lockdown%20survey%20-%20Fair%20Trials.pdf> "Drejtesia në kushtet e mbylljes në shtëpi: Sondazh i sistemit të drejtësisë penale në Angli dhe Wales mes marsit dhe majit 2020", Raport i Fair Trials International, 25 qershor 2020.

[401] *Shih Rybacki k. Polonisë*, vendim i 13 janarit 2009, Nr. 52479/99, § 58, ku Gjykata gjeti shkelje të Nenit 6 kur prokurorët dhe ekzekutori ishin të pranishëm në të njëjtën sallë si avokati dhe klienti i tij kur këto të fundit ishin duke biseduar.

[402] *Marcello Viola k. Italisë*, vendim i 5 tetorit 2006, Nr. 45106/04, §§ 41 dhe 75.

[403] Kjo qasje ishte e suksesshme, për shembull, në Irlandën e Veriut, kur një avokat kërkoi shqyrtimin gjyqësor

ofrimi i mundësive të shtuara për thirrje të lira, reduktimi ose heqja e kufizimit të kohëzgjatjes së thirrjeve me avokatin dhe krijimi i dhomave ose hapësirave private ku klientët të mund të komunikojnë pa i dëgjuar askush. Kur të krijohen kushtet e përshtatshme për vizitat fizike mes personave, duhet të ofrohen pajisje mbrojtëse për t'u siguruar që ato të zhvillohen në mënyra të sigurta.^[404]

të vendimit të autoritetit policor për të vendosur "një formë të mekanizmit dixhital si Skype apo Zoom" për intervistë për të mundësuar pjesëmarrjen efektive të avokatit të personit: <https://www.irishlegal.com/article/solicitor-acts-remotely-for-client-in-police-interview-in-northern-ireland-first> "Avokati vepron në distancë për klientin në intervistën e policisë në Irlandën e Veriut së pari", nga C. Beaton, Irish Legal News, 16 prill 2020.

[404] Për shembull, Shoqata e Avokatisë së Bukureshtit shpërndau pajisje mbrojtëse (doreza dhe maska) për avokatët. Shih <https://www.legalmarketing.ro/baroul-bucuresti-anunt-avocati-masti-si-manusi-de-protectie/> "BARO-UL BUCUREȘTI Anunț avocați – măști și mănuși de protecție", Legal Marketing, 25 mars 2020.

7. Neni 9 – E drejta e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë

Masat e marra për të luftuar pandeminë Covid-19 ndërhyjnë tek e drejta për lirinë e fesë në dy aspekte kryesore. Së pari, masat përfshirë mbylljet brenda dhe kufizimet e tubimeve publike gjithashtu përfshinë pezullimin e tubimeve fetare, duke ndikuar kështu tek e drejta për të shfaqur fenë ose besimin në publik ose në komunitet me të tjerë^[405]. Së dyti, sadoqë Shtetet kanë detyrimin për të ofruar trajtim dhe mbrojtje kundër Covid-19, individët njëkohësisht mund të kenë të drejtën për të refuzuar trajtimin mjekësor mbi bazën e besimeve të tyre fetare.

Neni 9 i KEDNj-së parashikon:

1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së mendimit, të ndërgjegjes e të fesë; kjo e drejtë nënkupton lirinë për të ndryshuar fenë ose besimin dhe lirinë, qoftë individualisht ose kolektivisht, publikisht ose privatisht nëpërmjet kultit, mësimdhënies, praktikave dhe kryerjes së riteve.

2. Liria e shfaqjes së fesë ose besimeve të dikujt nuk mund t'i nënshtrohet kufizimeve të tjera, përveç atyre të parashikuara nga ligji dhe që përbëjnë masa të nevojshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, të shëndetit ose të moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve.

a. Fushëveprimi i Nenet 9

E drejta për të shfaqur fenë ose besimin fetar

Neni 9 mbron të drejtën për të shfaqur fenë, jo vetëm vetëm dhe në ambiente private, por edhe në komunitet me të tjerë, në publik, krahas atyre që mbajnë të

[405] Në kohën e këtij shkrimi, çështjet e *Spînu k. Rumanisë*, komunikuar më 1 tetor 2020, Nr. 29443/20 dhe *Association d'obédience ecclésiastique orthodoxe k. Greqisë*, komunikuar më 25 shkurt 2021, Nr. 52104/20, janë në pritje para Gjykatës. E para ka të bëjë me refuzimin e autoriteteve rumune për të lejuar kërkuesin, anëtar i paraburgosur i Kishës Adventiste të Ditës së Shtatë, që të shkojë në një kishë në Bukuresht për të shënuar Sabinin. E dyta ka të bëjë me ndalesën e lutjeve kolektive mes 16 marsit dhe 16 majit 2020, përfshirë periudhën e Pashkëve.

njëjtin besim. Kjo do të thotë që Neni 9 mbron të drejtën e besimtarëve për t'u takuar në mënyrë paqësore me të tjerë për t'u lutur/falur në mënyrën e përshtuar nga feja e vet. Meqenëse komunitetet fetare tradicionalisht ekzistojnë në formën e strukturave të organizuara, Neni 9 duhet të interpretohet nën dritën e Nenit 11 të Konventës, i cili mbron të drejtën e lirisë së organizimit. Pra, Neni 9 mbron të drejtat e besimtarëve për t'u tubuar lirisht, pa ndërhyrjen arbitrare të Shtetit^[406]. Edhe nëqoftëse një individ e ka mundësinë për ta shfaqur fenë i vetmuar, ose në shoqërinë e të tjerëve, kufizimet e lirisë së tyre të lëvizjes përbëjnë ndërhyrje tek e drejta e tyre për të ndjekur besimet e tyre fetare, nëqoftë se kufizime të tilla i ndalojnë ata/ato nga shkuarja në ambientet e lutjes/faljes ose nga pjesëmarrja në ceremoni fetare^[407].

Megjithatë, Neni 9 nuk dhuron të drejtën e gjerësishme që individët të tubohen për të shfaqur besimet e tyre fetare kurdo që dëshirojnë^[408]. Kufizimet lidhur me vendet se ku një person mund të shfaqë fenë ose besimin e tij/saj kanë më pak gjasa të përbëjnë ndërhyrje tek ose shkelje e Neni 9 kur është e mundur që një person të praktikojë besimin e vet fetar në mënyrë të ngjashme diku tjetër^[409].

Liria e fesë dhe trajtimit mjekësor

Liria për të pranuar ose refuzuar trajtime të caktuara mjekësore, ose për të zgjedhur forma alternative të trajtimit, është thelbësore për parimet e vetvendosjes dhe të drejtën e autonomisë personale në sferën e besimeve fetare. Një pacient i rritur kompetent është i lirë për të vendosur, për shembull nëse të hyjë në operacion apo jo, nëse ta marrë mjekimin apo jo, nëse të bëjë transfuzion gjaku apo jo, kur refuzimi i këtyre trajtimeve përputhet me besimin e tij fetar. Në mënyrë që një liri e tillë të ketë kuptim, pacientët duhet të kenë të drejtën për të bërë zgjedhje në pajtim me pikëpamjet e tyre, me vlerat dhe me fenë e tyre, pavarësisht se sa joracionale, të pazgjuara ose të pakujdesshme që këto zgjedhje mund t'u duken të tjerëve^[410].

Megjithatë, refuzimi i trajtimit siç është transfuzioni i gjakut, i cili ndikon vetëm në shëndetin e individit, dallon nga refuzimi për t'u vaksinuar gjatë një epidemie,

[406] *Dëshmitarët e Jehovahit të Moskës dhe të Tjerë k. Ruisë*, vendimi i 10 qershorit 2010, Nr. 302/02 § 99.

[407] *Qipro k. Turqisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 10 majit 2001, Nr. 25781/94.

[408] *Pavliades dhe Georgakis k. Turqisë*, vendimi i 2 korrikut 2013, Nr. 9130/09 dhe 9143/09, § 29.

[409] *Josephides k. Turqisë*, vendimi i 24 gushtit 1999, Nr. 21887/93.

[410] *Dëshmitarët e Jehovahit të Moskës dhe të Tjerë k. Ruisë*, vendimi i 10 qershorit 2010, Nr.302/02 § 134.

i cili mund të ndikojë edhe tek shëndeti i të tjerëve. Detyrimi i Shteteve për të abstenuar nga ndërhyrja në lirinë individuale të zgjedhjes në sferën e kujdesit shëndetësor aplikohet kur nuk ka tregues se ekziston nevoja për të mbrojtur palët e treta^[411]. Gjykata nuk ka përcaktuar formalisht nëse garancitë e Nenit 9 i aplikohen apo jo refuzimit për t'u vaksinuar ose refuzimit për të vaksinuar fëmijët e vet mbi bazën e qëndrimit kritik ndaj vaksinimit. Çështja është adresuar shkurtimisht në praktikën e vjetër gjyqësore, ku është gjetur se detyrimi për t'u vaksinuar që i aplikohet të gjithëve, pavarësisht nga feja, nuk ka ndërhyrë tek Neni 9^[412].

Gjykata po ashtu ka gjetur se opinioni kritik për vaksinimin nuk përbën domosdoshmërisht një bindje ose besim i cili është aq i qëndrueshëm, serioz, koheziv dhe i rëndësishëm sa të hyjë brenda kuadrit të Nenit 9. Për të argumentuar që vaksinimi i detyrueshëm ndërhyr tek Neni 9, do të ishte e nevojshme që argumenti të vërtetohej me arsye të qarta, të përqendruara dhe specifike rreth mënyrës se si besimet fetare ose filozofike të një personi në lidhje me vaksinimin preken ose janë në kundërshtim me vaksinimin^[413].

Statusi i viktimës

Një individ mund të pretendojë të jetë „viktimë“ e një ndërhyrjeje të Nenit 9, brenda kuptimit të Nenit 34 të KEDNJ-së, nëqoftëse atij i kërkohet të modifikojë

[411] *Dëshmitarët e Jehovahit të Moskës dhe të Tjerë k. Ruisë*, vendimi i 10 qershorit 2010, Nr.302/02 § 136, ku Gjykata citoi nga vendimet e Gjykatës Supreme të Kanadasë dhe Gjykatës së Apeleve të Nju Jorkut, për të gjetur që Shteti duhet të abstenojë nga ndërhyrja tek liria individuale e zgjedhjes në sferën e kujdesit shëndetësor në situata ku nuk ka nevojë të mbrohen palët e treta, duke cituar specifikisht shembullin e vaksinimit të detyrueshëm gjatë një epidemie si rast kur mund të lindë nevoja për ndërhyrjen e Shtetit.

[412] *Boffa dhe të Tjerë k. San Marinos*, vendimi i Komisionit i 15 janarit 1998, Nr. 26536/95.

[413] *Krahaso Vavrička dhe të Tjerë k. Republikës Çeke*, vendimi i 8 prillit 2021, Nr. 47621/13 dhe 5 të tjerë, § 272 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim) me *Dëshmitarët e Jehovahit të Moskës dhe të Tjerë k. Ruisë*, vendimi i 10 qershorit 2010, Nr. 302/02. Në rastin e parë, pikëpamjet kritike të kërkuesit për vaksinimin nuk u gjetën se angazhonin Nenin 9, sepse ato nuk u gjet se ishin të qëndrueshme apo të besueshme, sepse ai kishte deklaruar se kundërshtimi i tij për vaksinimin kishte të bënte kryesisht me shëndetin, aspektet filozofike ose fetare ishin dytësore, dhe për shkak se ai kishte dështuar të paraqiste argumente konkrete në lidhje me besimet e tij dhe intensitetin e ndërhyrjes së shkaktuar tek ato nga vaksinimi. Në rastin e dytë, Neni 9 u angazhua kur u gjet se ishte përgjithësisht e ditur që Dëshmitarët e Jehovahit besojnë se Bibla e ndalon marrjen e gjakut, i cili është i shenjtë për Zotin, dhe se ky ndalim përfshin transfuzionin e gjakut ose të komponentëve të gjakut që nuk janë të vetë pacientit. Ishte gjithashtu relevante që ndalimi fetar nuk lejon përjashtime dhe është i aplikueshëm edhe në rastet kur transfuzioni i gjakut vlerësohet të jetë i nevojshëm sipas gjykimit më të mirë klinik.

sjelljen e tij ose të rrezikojë ndjekjen penale nëse nuk e modifikon sjelljen, ose neqoftëse ai është anëtar i një kategorie të njerëzve që rrezikojnë të preken direkt nga legjislacioni duke prekur anëtarët e fesë së tyre. Kur ligjet emergjente të Covid-19 i ndaluan tubimet fetare, pra, një individ mund të pretendonte të ishte viktimë e ndërhyrjes tek e drejta e tij nga Neni 9, thjesht për shkak se ai po përballet me zgjedhjen mes respektimit të ndalimit (dhe kufizimi nga pjesëmarrja në praktikën ose ceremonitë fetare), ose refuzimit të ndalimit dhe përballja me rrezikun e ndjekjes penale / ndëshkimit^[414].

b. Ndërhyrjet e lejuara tek e drejta e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë

Sipas Nenit 9 § 2, qëllimet legjitime të cilat mund të justifikojnë ndërhyrjen tek shfaqja nga një individ i fesë ose besimit të tij përfshin sigurinë publike, mbrojtjen e rendit publik, shëndetit dhe moralit, dhe mbrojtja e të drejtave dhe lirive të të tjerëve. Kjo renditje e qëllimeve legjitime është rreptësisht shteruese dhe përkufizimi i qëllimeve është domosdoshmërisht kufizues për të pasqyruar rëndësinë themelore të pluralizmit fetar si „një nga themelet e një shoqërie demokratike“^[415]. Prandaj, kufizimet e vëna mbi lirinë e shfaqjes së fesë për të parandaluar përhapjen e Covid-19 me gjasë përbëjnë qëllim 'legjitim' në synim të të cilit Shtetet lejohen të ndërhyjnë tek liria e fesë, neqoftëse një ndërhyrje e tillë vlerësohet e nevojshme dhe proporcionale.

Proporcionaliteti

Çdo ndërhyrje tek të drejtat e mbrojtura nga Neni 9 duhet të jetë e justifikuar, e nevojshme dhe proporcionale, dhe duhet të përputhet me një „nevojë sociale urgjente“. Duhet të mos ketë asnjë mënyrë tjetër për të arritur të njëjtin qëllim e cila mund të ndërhynte në mënyrë më pak të rëndë tek të drejtat themelore të mbrojtura nga Neni 9, ku autoritetet kanë barrën të tregojnë se asnjë masë tjetër nuk ka mundësi të arrijë qëllimin legjitim të synuar^[416].

[414] Shih *S.A.S. k. Francës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 1 korrikut 2014, Nr. 43835/11, ku Gjykata njohu se një grua myslimane që dëshiron të mbajë mbulesën e plotë të kokës që mbulon edhe fytyrën në publik për arsye fetare mund të pretendojë të jetë "viktimë" thjesht për shkak se një sjellje e tillë ishte e ndëshkueshme me ligj, me anë të një gjobe të shoqëruar ose zëvendësuar me një kurs të detyrueshëm shtetësie.

[415] *Nolan dhe K k. Ruisë*, vendimi i 12 shkurtit 2009, Nr. 2512/04, § 61.

[416] *Qendra Biblike e Republikës Chuvash k. Ruisë*, vendimi i 12 qershorit 2014, Nr. 33202/08, § 58.

Sfondi historik dhe tiparet e veçanta të fesë në fjalë, përfshirë dogmën, ndjekjen e ritualeve dhe organizimin, janë të rëndësishme për të vlerësuar konformitetin e një mase në vend me Nenin 9 § 2 të Konventës^[417]. Prandaj, gjatë vlerësimit të proporcionalitetit të kufizimit të tubimeve fetare gjatë pandemisë, mund të jetë relevante për t'u marrë parasysh rëndësia e lutjes kolektive, ceremonive ose ritualeve për fenë në fjalë, ose të merret parasysh fakti nëse kufizimet kanë qenë në fuqi në kohën e ngjarjeve veçanërisht të rëndësishme në kalendarin fetar përkatës si Krishtlindjet ose Pashkët^[418]. Ngjashëm, do të ishte relevante të merren parasysh mësimet ose tekstet specifike fetare të cilat u referohen vaksinimit, ose përdorimit dhe futjes në trup të përbërësve të vaksinave të Covid-19, kur vlerësohet nëse politikat e vaksinimit ndërhyjnë tek Neni 9^[419]. Në rrethana të caktuara, Neni 9 po ashtu mund të shkelet kur Shtetet dështojnë të trajtojnë ndryshe personat situatat e të cilëve janë të ndryshme në masë domethënëse^[420]. Këtu mund të përfshihen, për shembull, mos-përgjashtimi i ndalesës së përgjithshme për tubime, kur mësimet ose besimet e tyre fetare i vënë disa anëtarë të caktuar të një feje në pozicion shumë më të ndryshëm sesa të tjerët, për shkak të rëndësisë së lutjes/faljes kolektive ose një ceremonie të caktuar në atë fe^[421]. Kur Shtetet vendosën ndalimin e plotë të tubimeve ose mbledhjeve fetare gjatë pandemisë, ato u desh të tregonin se nuk kishte mënyra të tjera praktike dhe efektive për të mbrojtur shëndetin dhe për të parandaluar përhapjen e Covid-19 gjatë pandemisë^[422].

[417] *Cha'are Shalom Ve Tsedek k. Francës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 27 qershorit 2000, Nr. 27417/95, §§ 13-19.

[418] Në kohën e këtij shkrimi, çështja *Association d'obédience ecclésiastique orthodoxe k. Greqisë*, komunikuar më 25 shkurt 2021, Nr. 52104/20, është në pritje para Gjykatës. Çështja ka të bëjë me ndalesën e lutjeve kolektive mes 16 marsit dhe 16 majit 2020, përfshirë gjatë periudhës së Pashkëve, e cila konsiderohet një prej festave më të rëndësishme në kalendarin Ortodoks Grek.

[419] *Fränklin-Beentjes dhe CEFLU-Luz da Floresta k. Holandës*, vendimi i 6 majit 2014, Nr. 28167/07, ku Gjykata mori parasysh përmbajtjen e riteve të shoqatës kërkuese gjatë përcaktimit nëse kishte ndërhyrje të argumentueshme tek Neni 9 dhe shkelje të Nenit 9.

[420] *Thlimmenos k. Greqisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 6 prillit 2000, § 44.

[421] Për shembull, Këshilli i Shtetit Belg gjeti, në vendimin e tij të 8 dhjetorit 2020, Nr. 249.177, se ndalesa e përgjithshme e qeverisë belge për lutjet kolektive, e vënë në tetor 2020 për t'i vënë kufi përhapjes së Covid-19, ishte shproporcionale, përderisa nuk ofronte mundësinë për ushtrimin e lutjeve të paktën në raste të caktuara, përjashtimisht dhe në kushte të caktuara, po të ishte e nevojshme, me kërkesë dhe autorizim paraprak ku tregohet vendi dhe koha.

[422] Shih për shembull *Chappell k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i Komisionit i 14 korrikut 1987, Nr. 12587/86, i cili kishte të bënte me vendimin e autoriteteve të Mbretërisë së Bashkuar për të mos lejuar një grup Druids që të shënonin ceremoninë e tyre të solsticit në Stonehenge. Komisioni konsideroi se masa kishte synuar mbrojtjen e sigurisë publike dhe ishte e justifikuar brenda kuptimit të Nenit 9 § 2, veçanërisht për shkak se autoritetet më

Për shembull, nëse ceremonitë ose shërbesat me distancim social mund të zhvilloheshin në hapësirat e faltoreve të cilat janë aq të mëdha sa të akomodojnë të pranishmit në formatin e distancimit social^[423].

përpara kishin bërë përpjekje të konsiderueshme për të pëmbushur interesat e individëve dhe organizatave të interesuara në Stonehenge dhe përfundimisht gjeti se nuk kishte alternativë tjetër praktikë pos mbylljes së zonës. Shih gjithashtu vendimet e Këshillit Francez të Shtetit të 18 majit 2020, Nr. 440361 and 440511, i cili gjeti që ndalesa e përgjithshme dhe absolute e organizimit të ceremonive fetare gjatë pandemisë, për një periudhë të pacaktuar, nuk ishte e nevojshme ose proporcionale.

[423] Për shembull, Këshilli Francez i Shtetit, më 29 nëntor 2020, urdhëroi qeverinë franceze të shqyrtonte një rregull që kufizonte numrin e njerëzve që lejoheshin të ishin në kisha gjatë shërbesave fetare deri në 30, pasi organizatat katolike e kontestuan këtë kufi, duke argumentuar se kishat dhe katedralet kanë më shumë hapësirë sesa, për shembull, dyqanet me pakicë, ku kufiri i caktuar ishte një person për 8 metra katrorë.

8. Neni 10 - E drejta për lirinë e shprehjes

Ofrimi i informacionit të kohshëm dhe të saktë për rreziqet ndaj shëndetit publik, dhe masat e marra nga Qeveritë për t'iu kundërvënë këtyre rreziqeve, ishte pjesë esenciale e trajtimit të pandemisë Covid-19.^[424] Megjithatë, pandemia solli atë që Organizata Botërore e Shëndetësisë e përshkruan si “infodemia” e keqinformimit dhe dezinformimit, ku shkalla e informacionit të pasaktë ose çorientues në qarkullim paraqiti rreziqe serioze për shëndetin publik dhe aksionin publik.^[425] Si reagim ndaj kësaj, shumë Shtete kanë marrë masa për të luftuar përhapjen e dezinformatave. Ndërkohë që këto masa mund t'i kenë shërbyer një qëllimi legjitim, ato gjithashtu kanë rrezikuar të shkelin mbi funksionet esenciale që kryen media, gazetarët, dhe organizata të tjera për të siguruar llogaridhënien e qeverisë dhe lehtësimin e shkëmbimit të informacionit të dobishëm gjatë një emergjence të shëndetit publik. Në disa raste, kapaciteti i tyre për të kryer këto funksione po ashtu është penguar nga mungesa e qasjes efektive në informacione dhe kufizimin e lëvizjeve dhe grumbullimit të tyre.

Pandemia gjithashtu e rriti rolin e platformave dixhitale dhe kompanive të medias sociale në shpërndarjen e informacioneve, që do të thotë se përpjekjet e kompanive private, si dhe të autoriteteve shtetërore, u bënë gjithnjë e më thelbësore për të luftuar keqinformimin^[426].

[424] Shih <https://www.coe.int/en/web/freedom-expression/freedom-of-expression-and-information-in-times-of-crisis> “Liria e shprehjes dhe informacionit në kohë krizash”, Deklarata e Këshillit të Evropës, 21 mars 2020.

[425] Shih <https://www.who.int/docs/default-source/coronavirus/situation-reports/20200202-sitrep-13-ncov-v3.pdf> “Novel Coronavirus (2019-nCov) Situation Report -13”, Raporti i WHO, 2 shkurt 2020.

[426] Kodi i Praktikës rreth Dezinformimit i Komisionit të BE-së hyri në fuqi në tetor 2018 dhe nënshkruet e tij janë platforma të mëdha online në BE si dhe në shoqatat kryesore tregtare që përfaqësojnë sektorin evropian të marketingut. Pas publikimit të “Komunikata e Përbashkët për Luftimin e Dezinformatave të Covid-19 – Si t'i marrim faktet drejt”, më 10 qershor 2020, nënshkruet e Kodit të Praktikës iu nënshtruan kriterëve të raportimit mujor si pjesë e programit të monitorimit dhe raportimit për Covid-19 me qëllim të kufizimit të dezinformatave online lidhur me Covid-19. Më 16 qershor 2022, Komisioni publikoi një Kod të ri të Fuqizuar të Praktikës për Dezinformimin, pjesërisht si reagim ndaj shqyrtimit të fuqive dhe dobësive të Kodit në reagimet ndaj infodemisë së shkaktuar nga pandemia Covid-19: <https://digital-strategy.ec.europa.eu/en/library/2022-strengthened-code-practice-disinformation>.

Prandaj, reagimet e Shteteve ndaj pandemisë kanë prekur një sërë aspektesh të së drejtës për lirinë e shprehjes të mbrojtura sipas Neni 10 të KEDNj-së. Neni 10 parashikon:

"1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që t'u kërkojnë ndërmarrjeve të transmetimit audioviziv, televiziv ose kinematografik të pajisen me liçencë.

2. Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t'u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor."

a. Fushëveprimi i Neni 10

Liria e shtypit dhe diversitetit të medias

E drejta për lirinë e shprehjes përfshin të drejtën për të shënë informata dhe ide. Ndërkohë që Neni 10 nuk cek shprehimisht lirinë e gazetarisë, shtypit apo medias, Gjykata ka njohur në mënyrë të përsëritur interesin e një shoqërie demokratike për të siguruar dhe ruajtur shtypin e lirë dhe ka theksuar rëndësinë e medias në fuqizimin e debatit publik, duke i ofruar publikut informacione të interesit publik dhe duke ekspozuar mungesën e kompetencës dhe keqbërjet zyrtare duke vepruar si 'rojtat publik'.^[427] Gjykata i jep mbrojtje të shtuar sipas Neni 10 shprehjes së shtypit/medias dhe ka gjetur që Neni 10 përfshin detyrimet pozitive të Shteteve për të mbrojtur ata që ushtrojnë liritë e gazetarisë prej sulmeve ose frikësimeve që i pengojnë ata nga kryerja e rolit të tyre.^[428]

[427] *Lingens k. Austrisë*, vendim i 8 korrikut 1986, Nr. 9815/82.

[428] *Özgür Gündem k. Turqisë*, vendim i 16 marsit 2000, Nr. 23144/93.

Neni 10 gjithashtu ngërthen një detyrim për ata që kryejnë rolin e 'rojtarit publik' për ta bërë këtë me përgjegjësi. Gjykata ka nxjerrë nga Neni 10 të drejtën e publikut për të pasur qasje në media të sakta dhe të informuara, dhe shtypi duhet t'i përçojë idetë në një mënyrë që përputhet me detyrimet dhe përgjegjësitë e tij.^[429] Prandaj, shprehja e medias përgjithësisht mbrohet sipas Nenit 10 vetëm nëse vjen prej gazetarëve që veprojnë në mirëbesim për të ofruar informacione të sakta dhe të besueshme në përputhje me etikën e gazetarisë. Përndryshe, qëllimi i mbrojtjes së lirisë së shtypit do të dëmtohej po qe se këto liri do të përdroreshin për të shpërndarë me vetëdije informacione çorientuese nga burime çorientuese.

Gjithashtu, Shtetet kanë detyrimin sipas Nenit 10 që të garantojnë diversitetin e medias, për t'u siguruar që publiku të ketë qasje në përmbajtje të cilat pasqyrojnë sa më shumë që është e mundur larinë e opinionëve të hasura në shoqërinë së cilës i drejtohen programet.^[430] Liria e shtypit duhet të jetë e rrënjësor në parimin e pluralizmit për të siguruar që publiku të ketë qasje në një sërë informacionesh dhe idesh. Një situatë në të cilën njëri grup dominon përmbajtjen e shtypit ose të medias audio-vizuale në një vend, ose ku transmetuesi publik ka monopol mbi frekuencat në vend, nuk mund të justifikohet sipas Nenit 10 nëqoftëse nuk mund të tregohet se ka pasur nevojë urgjente për të.^[431]

Qasja në informacion

Neni 10 gjithashtu përfshin të drejtën e qasjes në informacion. E drejta për qasje në informacion mund të dalë po ashtu sipas Nenit 8, për shembull kur informacioni i kërkuar ka të bëjë me një situatë e cila mund të çojë në shkelje të Nenit 8.^[432] Seksioni i Nenit 8 (E drejta për respekt ndaj jetës private dhe familjare) brenda këtij publikimi përshkruan situata në të cilat e drejta për qasje në informacionin lidhur me shëndetin mund të mbrohet sipas Nenit 8. Një kërkesë për informacion mund të mbrohet sipas Nenit 10 kur:

[429] *Bladet Tromsø dhe Stensaas k. Norvegjisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 20 majit 1999, Nr. 21980/93, §§ 59 dhe 62.

[430] *Informationsverein Lentia dhe të Tjerë k. Austrisë*, vendim i 23 nëntorit 1993, Nr. 13914/88, 15041/89 15717/89, 15779/89 dhe 17207/90.

[431] *Di Stefano k. Italisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 7 qershorit 2012, Nr. 38433/09.

[432] *Guerra dhe të Tjerë k. Italisë*, vendim i 19 shkurtit 1998, Nr. 14967/89 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim), ku Gjykata gjeti shkelje të Nenit 8 sepse Shteti italian kishte dështuar të merrte hapa për të ofruar informata rreth rreziqeve nga emisionet toksike nga një fabrikë kemikatesh dhe si të veprohej në rast të një aksidenti madhor, duke pasur parasysh që ndotja e rëndë e mjedisit mund të prekte mirëqenien e individëve dhe t'i pengonte ata nga gëzimi i shtëpive të tyre në mënyrë të atillë që të ndikonte në jetën e tyre private dhe familjare negativisht.

- i) Zbulimi i informacionit është imponuar nga një urdhër gjyqësor; ose
- ii) Qasja në informacion është e dobishme për ushtrimin nga individit të së drejtës së tij/saj për lirinë e shprehjes, posaçërisht "liria për të marrë e dhënë informata".^[433] Për shembull, kur qasja në informacion kërkohet si hap përgatitor esencial për të shkruar një artikull ose për të shpërndarë informatat e kërkuara tek të tjerët për të krijuar një forum për debat publik.

Për të tërhequr mbrojtjen e Nenit 10 në lidhje me situatën (ii) të përshkruar më lart, informacionet, të dhënat ose dokumentet ndaj të cilave kërkohet qasja gjithashtu duhet që, në përgjithësi, të kalojë një test të interesit publik. Kjo përfshin, për shembull, rastet kur informacioni ka të bëjë me çështje të interesit publik ose kur zbulimi do të ofronte transparencë rreth mënyrës së zhvillimit të çështjeve publike, duke mundësuar kështu pjesëmarrjen e publikut të gjerë në qeverisjen publike.^[434]

Mbrojtja e të drejtës së informacionit aplikohet njësoj edhe tek gazetarët dhe organizatat joqeveritare apo grupe të tjera, për sa kohë që aktivitetet e grupit formojnë element thelbësor të debatit publik të informuar, dhe ato bëjnë kërkesë për informacion me qëllim të ushtrimit të këqyrjes së veprimeve publike ose të theksimit të çështjeve të interesit publik.^[435] Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare në këtë kontekst duhet të trajtohen menjëherë dhe refuzimet duhet t'i nënshtrohen një urdhri të gjykatës ose një procedure tjetër shqyrtimi të pavarur.^[436]

b. Çfarë përbën ndërhyrje në të drejtën e lirisë së shprehjes?

Gjykata e interpreton konceptin e ndërhyrjes gjerësisht në kontekstin e lirisë së shprehjes për të mbuluar çdo aktivitet që ka efektin, direkt ose indirekt, e kufizimit, pengimit ose vënies barrë të një aktiviteti ekspresiv. Shembuj të kufizimeve mbi shprehjen të cilat janë gjetur se përbëjnë ndërhyrje të kjo e drejtë

[433] *Magyar Helsinki Bizottság k. Hungarisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 8 nëntorit 2016, Nr. 18030/11 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[434] *Magyar Helsinki Bizottság k. Hungarisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 8 nëntorit 2016, Nr. 18030/11 §61 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[435] *Magyar Helsinki Bizottság k. Hungarisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 8 nëntorit 2016, Nr. 18030/11 §61 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[436] *Kenedi k. Hungarisë*, vendim i 26 majit 2009, Nr. 31475/05, § 48.

përfshijnë: caktimi i një sanksioni penal (gjobë ose burgim)^[437] ose urdhër për të paguar dëmshpërblim civil si reagim ndaj shprehjes,^[438] një vendim gjyqësor ose ndalim i publikimit,^[439] refuzimi për të dhënë licencën e transmetimit,^[440] ndalimi i ushtrimit të profesionit të gazetarisë, një dënim disiplinor ose heqje nga puna e një punonjësi,^[441] urdhra për të zbuluar burimet gazetareske dhe/ose vënia e sanksioneve nëse kjo nuk bëhet,^[442] deklarimi nga një kryetar/e shteti që një shërbyes civil nuk do të emërohet në një post publik pas një deklarate në publik nga shërbyesi civil,^[443] refuzimi për të lejuar një anije proteste në ujëra territoriale,^[444] dhe dështimi për t'i mundësuar një gazetari/eje qasjen në Davos gjatë Forumit Ekonomik Botëror.^[445]

Edhe gjobat relativisht të vogla janë konsideruar nga Gjykata se përbëjnë censurim të qartë sepse, megjithëse një gjobë e vogël mund të mos e ndalojë gazetarin/en nga shprehja e mendimeve të veta lidhur me një çështje të caktuar, ajo mund ta dekurajojë atë nga bërja e kritikave në të ardhmen. Ndërhyrjet në të drejtën e lirisë së shprehjes mund të dalin jo vetëm nga sanksionet e vëna në realitet, por edhe nga frika e sanksioneve, dhe Gjykata ka gjetur që liria e shprehjes ndikohet së tepërmi nga klima më e gjerë ligjore për gazetarët dhe mediat dhe rreziku i efektit rrënqethës kur ekzistojnë sanksione për shprehje të caktuara.^[446]

[437] *Lingens k. Austrisë*, vendim i 8 korrikut 1986, Nr. 9815/82.

[438] *Muller dhe të Tjerë k. Zvicrës*, vendim i 24 majit 1988, Nr. 10737/84.

[439] *The Sunday Times k. Mbretërisë së Bashkuar (Nr. 2)*, vendim i 26 nëntorit 1991, Nr. 13166/87; *Observer dhe Guardian k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 26 nëntorit 1991, Nr. 13585/88.

[440] *Autronic AG k. Zvicrës*, vendim i 22 majit 1990, Nr. 12726/87.

[441] *Wojtas-Kaletka k. Polonisë*, vendim i 16 korrikut 2009, Nr. 20436/02; *Frankoëicz k. Polonisë*, vendim i 16 dhjetorit 2008, Nr. 53025/99.

[442] *Goodwin k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i Dhomës së Madhe i 27 mars 1996, Nr. 17488/90.

[443] *Wille k. Lihtenshajnit*, vendim i Dhomës së Madhe i 28 tetorit 1999, Nr. 28396/95.

[444] *Women on Waves k. Portugalisë*, vendim i 3 shkurtit 2009, Nr. 31276/05 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[445] *Gsell k. Zvicrës*, vendim i 8 tetorit 2009, Nr. 12675/05.

[446] *Sallusti k. Italisë*, vendim i 7 marsit 2019, Nr. 22350/13, § 62 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim); *Kapsis dhe Danikas k. Greqisë*, vendim i 19 janarit 2017, Nr. 52137/12, § 40.

Ndërhyrjet në të drejtën e shprehjes së lirë të shkaktuara nga masat e marra si reagim ndaj pandemisë Covid-19

Kështu, ka mënyra të shumta se si masat e marra në reagim ndaj pandemisë kanë ndërhyrë në të drejtën për lirinë e shprehjes^[447]. Masat që kërkonin raportim brenda kontureve të paracaktuara, ndalonin kritikimin e veprimeve të qeverisë ndaj pandemisë, ndalonin publikimin e informacioneve 'të rreme' ose 'të dëmshme'^[448], ose ndalonin publikimin e informacioneve që mund të shkaktonin panik dhe trazira sociale, të gjitha ndërhyjnë në lirinë e shtypit dhe kapacitetin e saj për të përmbushur funksionin e rojtarit publik.^[449]

[447] Për një shikim më të detajuar të disa prej kufizimeve mbi lirinë e shprehjes që u fut gjatë pandemisë, shih: <https://edoc.coe.int/fr/intelligence-artificielle/9284-covid-and-free-speech-the-impact-of-covid-19-and-ensuing-measures-on-freedom-of-expression-in-council-of-europe-member-states.html#> "COVID DHE FJALA E LIRË – Impakti i Covid-19 dhe sigurimi i masave për lirinë e shprehjes në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës", Peter Noorlander, Raport Paraparak, Konferenca Ministrore e Këshillit të Evropës, Qipro, 2020.

[448] Në kohën e këtij shkrimi, çështja *Avagyan k. Ruisë*, e komunikuar më 4 nëntor 2020, Nr. 36911/20, është në pritje apara Gjykatës. Çështja ka të bëjë me një kërkuese që u gjet fajtoare për veprën administrative të 'shpërndarjes së informacioneve të pavërteta' dhe u gjobot me 30,000 rubla ruse (afro 390 euro në ditën e vendimit) sepse komentoi në një post në Instagram, duke pretenduar se nuk kishte raste me Covid-19 në Rajonin Krasnodar. Para pandemisë, në vitin 2019, Kodi Rus i Veprave Administrative u ndryshua për të krijuar një veprë të re të "shpërndarjes së qëllimshme të informacioneve të pavërteta nën maskën e raporteve të besueshme që krijonte rrezikun (mes të tjerash) e shkakimit të dëmit ndaj jetës ose shëndetit". Kërkesja argumenton se nuk mund të thuhet se deklarata e saj 'dihej se ishte e pavërtetë' sepse prezenca e infektiveve me koronavirus në Rajonin Krasnodar nuk ishte konfirmuar as mohuar zyrtarisht. Ajo gjithashtu argumenton se gjykata ruse e kishte zhvendosur hequr barrën e provës sepse nuk i kishte kërkuar policisë të paraqiste ndonjë material që tregonte se pretendimet e saj ishin të pavërteta. Së treti, ajo argumenton se deklarata e saj nuk kishte krijuar rrezik për jetën apo shëndetin e askujt.

[449] Për shembull, Qeveria e Republika Srpska lëshoi një dekret që ndalonte shkaktimin e "panikut dhe trazirave" duke publikuar ose transmetuar lajme të rreme gjatë gjendjes së emergjencës. Individët që gjendeshin që kishin shkelur dekretin mund të gjobiteshin mes 1,000 dhe 3,000 marka boshnjake (rreth 500 – 1,500 Euro). Organizatat përballëshin me gjoba mes 3,000 deri në 9,000 marka (1,500 - 4,500 Euro). Shih <https://balkaninsight.com/2020/03/19/bosnias-republika-srpska-imposes-fines-for-coronavirus-fake-news/> "Republika Srpska e Bosnjës Kaktun Gjoba për 'Lajmet e Rreme' mbi Koronavirusin", D. Kovacevic dhe B. Luka, Balkan Insight, 19 mars, 2020; Qeveria maqedonase i dha Ministrisë së vet të Brendshme mandatin për të ndërmarrë "masat e duhura" kundër personave që shpërndanin dezinformata në media sociale në lidhje me Covid-19, dhe kundër platformave të mediave që i shpërndanin ato informacione më tej. Shih <https://vlada.mk/node/20464> "Филипче: Двајца нови позитивни пациенти на коронавирус, Владата одржа седница и донесе дополнителни мерки и активности за превенција од ширење на корона вирусот" Deklaratë e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë

Qeveritë kanë sjellë fuqi të reja për të censuruar materialet online, që nga heqja e informacioneve lidhur me Covid-19 prej faqeve të caktuara të internetit, e deri tek bllokimi i këtyre faqeve krejtësisht, nganjëherë pa asnjë mundësi shqyrtimi gjyqësor^[450]. Raportimi i pasaktë i numrit të vdekjeve dhe infektimeve^[451], dhe detyrimi për të publikuar vetëm 'informacione zyrtare' ose informacione që përputhen me burimet zyrtare gjithashtu pengojnë pluralizmin e shtypit dhe të drejtën e publikut për të pasur qasje në informacione dhe në një gamë të gjerë idesh.^[452]

Kufizimet e qasjes fizike në konferenca shtypi, dhe rregulloret strikte mbi gamën e pyetjeve të lejuara në konferenca shtypi të mbajtura përmes teknologjisë së videokonferencave kanë ndërhyrë në të drejtën e lirisë së shprehjes duke kufizuar të drejtën për qasje në informacion.^[453] Përveç kësaj, morën më shumë kohë për

së Veriut, 11 mars 2020.

[450] Shih për shembull në Armeni, ku disa gazeta dhe faqe interneti u desh të fshinin disa informata, pas miratimit të rregullave strikte që ndalonin publikimin e informacioneve të natyrës mjekësore dhe epidemiologjike rreth shpërthimit të virusit të cilat nuk përputhen plotësisht me burimet zyrtare. <https://eurasianet.org/armenia-takes-hard-line-against-media-reporting-on-covid-19> "Armenia mban qëndrim të patundur kundër raportimeve në media rreth Covid-19", A. Mejlymyan, Eurasianet, 23 mars 2020.

[451] <https://balkaninsight.com/2020/06/22/serbia-under-reported-covid-19-deaths-and-infections-data-shoës/> "Serbia Ka Raportuar Më Pak Vdekje dhe Infektime me Covid-19 Sesa Ishin, Tregojnë Të Dhënat", Natalija Jovanovic, 22 qershor 2020, gjq që ngre shqetësime për nën-raportim si dhe përgjigje të vonuara ndaj kërkesave për lirinë e informimit.

[452] Për shembull, Dekretin që decentralizoi shpërndarjen e informacioneve rreth koronavirusit në Serbi, i cili parashikonte që Shtabi i Krizës i udhëhequr nga Kryeministri ishte i vetmi burim informatash rreth pandemisë, dhe që informacionet nga burimet e paautorizuara nuk duhet të konsideroheshin të sakta ose të verifikuara. Urdhri gjithashtu parashikonte pasojë ligjore për shpërndarjen e dezinformatave rreth gjendjes së emergjencës. Pas arrestimit të së paku një gazetareje për raportimin rreth pandemisë, Kryeministri deklaroi që dekreti do të tërhiqej, më pak se një javë pas miratimit të dekretit. Shih <http://www.pravno-informacioni-sistem.rs/SlGlasnikPortal/eli/rep/sgrs/vlada/zakljucak/2020/48/1/reg> "Закључак (Владе о информисању становништва о стању и последицама заразне болести COVID-19 изазване вирусом SARS-CoV-2) : 48/2020-8", Dekret i Qeverisë së Serbisë, 31 mars 2020.

[453] Për shembull, kritikata e Shoqatës së Gazetarëve të Bosnje-Hercegovinës për atë që përshkruhet si sistem restriktiv për gazetaret që duan t'i bëjnë pyetje ministrave dhe organeve shëndetësore: <https://www.bljesak.info/vijesti/flash/bh-novinari-upozoravaju-ovakvi-postupci-vlasti-vode-ka-cenzuri/307122> "BH novinari upozoravaju: Ovakvi postupci vlasti vode ka cenzuri" Vijesti, bljesak.info, mars 31, 2020; në Serbi, ka shembuj të gazetarëve që u ndaluan nga pjesëmarrja në konferencat e shtypit prej qeverisë. Mediat mundën vetëm të dërgonin pyetje me email e jo me videohirre, ku nuk u lejuan pyetjet vijuese. Shih <https://balkaninsight.com/2020/03/16/>

t'iu përgjigjur kërkesave për liri shprehjeje gjatë pandemisë,^[454] gazetarët u bënë objekt i fushatave të njollosjes pas depozitimit të kërkesave për informacione mbi masat e marra nga Qeveria në reagim ndaj pandemisë dhe i janë nënshtruar ngacmimeve gjatë përpjekjeve për të raportuar në lidhje me problemet e këtyre reagimeve.^[455] Kufizimet e udhëtimit dhe kufizimet e grumbullimit gjithashtu i kanë penguar gazetarët nga raportimi prej 'vijës së parë', për shembull reportazhet për protesta ose demonstrata.^[456]

coronavirus-live-updates/#1927 "Ministri Serb i Shëndetësisë Fajëson 'Koronën në Dhomën e Lajmeve' për Ndalimin e Konferencave të Shtypit" M. Stojanovic, Balkan, 11 prill 2020. Gazetarë të tjerë kanë kritikuar mungesën e qasjes në informacione nga ministrat dhe zyrtarët e shëndetësisë. Shih <https://www.juznevesti.com/Drushtvo/Informacije-o-korona-virusu-ubuduće-samo-od-Kriznog-staba-novinari-ukazuju-na-prikrivenu-cenzuru.sr.html> "Informacije o korona virusu ubuduće samo od Kriznog štaba, novinari ukazuju na prikrivenu cenzuru" J. Adamović, južne vesti neës, 1 prill 2020. Një deklaratë nga Shoqata e Pavarur e Gazetarëve të Vojvodinës argumentoi që gazetarëve i ishte mohuar e drejta për të marrë informacione rreth përhapjes së infeksionit dhe prandaj nuk mund të bënin punën e tyre në përputhje me standardet profesionale; që databazat publike nuk ofronin të dhëna të përditësuara; dhe që gazetarët nuk merrnin përgjigje me kohë për pyetjet të rëndësishme publike. Shih <https://balkaninsight.com/2020/04/08/bosnia-trying-to-censor-information-about-pandemic-journalists-say/> "Bosnja Përpjetet të Censurojë Informacionet rreth Pandemisë, Thonë Gazetarët" D. Kovacevik dhe B. Luka, Balkan Insight, 8 prill 2020.

- [454] Shih, për shembull, në Serbi ku afatet e FOI u pezulluan gjatë gjendjes së emergjencës. Shih <https://balkaninsight.com/2020/04/06/central-and-eastern-europe-freedom-of-information-rights-postponed/> "Shtypshënjestër të Drejtat e Lirisë së Informacionit në Evropën Qendrore dhe Lindore" I. Nikolic, M. Barberá, S. Kajosevic dhe M. Necsutu, Balkan Insight, 6 prill 2020.
- [455] Në Slloveni, një gazetar që bëri kërkesë për informacione rreth masave të miratuara nga qeveria për të përballuar pandeminë u vu në shënjestër të një fushate njollosjeje nga mediat. Më 23 mars Kryeministri i Shqipërisë u dërgoi qytetarëve një mesazh me zë ku i këshillonte njerëzit të lanin duart kundër koronavirusit dhe të mbronin veten nga mediat, dhe gazetari i Ora News, Elio Laze, u kërcënua në mënyrë agresive nga një punëtor i një kompanie ndërtimi sepse filmoi punën në shkelje të shtettrrethimit në vend për shkak të koronavirusit. Shih <https://balkaninsight.com/2020/03/13/albania-premier-urges-citizens-to-protect-themselves-from-the-media/> "Rama e Çon Luftën me Mediat në Telefonat e Shqiptarëve" G. Erebara, Balkan Insight, 13 mars 2020; <https://exit.al/en/2020/03/24/ora-news-journalist-threatened-by-salillari-employee-after-possible-curfew-violation/> "Gazetari i Ora News Kërcënohet nga Punëtori i Salillarit Pas Shkeljes së Mundshme të Shtettrrethimit", Exit staff, Exit News, 24 mars 2020.
- [456] Për një shikim mbi çështjet e tjera lidhur me Covid-19 dhe të drejtën e shprehjes, shih <https://ipi.media/media-freedom-violations-in-the-eu-under-covid-19/> "Shkeljet e lirisë së medias në BE në kushtet e Covid-19", International Press Institute, 20 prill 2020; për një shikim global, shih <https://ipi.media/covid19-media-freedom-monitoring/> "Covid-19: Numri i Shkeljeve të Lirisë së Shtypit sipas Rajoneve", International Press Institute (IPI) Tracker.

c. Ndërhyrjet e lejuara në të drejtën e lirisë së shprehjes

Qëllimet legjitime

Neni 10 § 2 lejon kufizimin e të drejtës për lirinë e shprehjes për të mbrojtur shëndetin dhe për të parandaluar trazirat. Megjithatë, Gjykata e ka theksuar shpesh nevojën për t'i interpretuar ngusht ato përjashtime, dhe kur kufizimet e shprehjes janë lejuar për mbrojtjen e shëndetit Gjykata është mbështetur mbi konsensusin e gjerë mes opinionëve të Shteteve në favor të lejimit të kufizimit.^[457]

Emergjencat shëndetësore globale si pandemia Covid-19 gjenerojnë thashetheme, keqinformata dhe dezinformata të cilat mund t'i shkaktojnë dëm rendit publik, shëndetit dhe sigurisë publike, mund të çojnë në mungesën e besimit tek Qeveria dhe mund të bëjnë që njerëzit të mos ndjekin rregullat dhe këshillat e dhëna për të mbrojtur shëndetin dhe sigurinë e tyre.^[458] Kështu, luftimi i përhapjes së dezinformatave për të mbrojtur shëndetin dhe rendin publik do të përbënte qëllim legjitim, në vijim të të cilit liria e shprehjes mund të kufizohet. Për shembull, rrethanat e pazakonta të pandemisë mund t'i detyrojnë gazetarët që të mos zbulojnë informacione të qeverisë të cilat janë për përdorim të kufizuar – si për shembull informacione mbi masat e ardhshme për të implementuar politikë më të rreptë izolimi, kur kjo kërkohet për të garantuar implementimin më të sigurt dhe më efektiv të politikës.^[459] Shtetet gjithashtu u inkurajuan që të punonin nga afër me platformat online për të bashkëpunuar në luftimin e dezinformatave online, për shembull duke futur rregulla dhe procedura për të pezulluar llogaritë në media sociale ose për të kufizuar të shprehurit e atyre që përhapnin dezinformata rreth vaksinave dhe pandemisë më gjerë.^[460] Përveç kësaj, është konsideratë relevante

[457] *Shih Société de conception de presse et d'édition et Ponson k. Francés*, vendim i 5 marsit 2009, Nr. 26935/05, § 53, ku Gjykata lejoi kufizimin e reklamës së produkteve të duhanit.

[458] Shih, për shembull, <https://rm.coe.int/09000016809eca31> "Qasja në informacione si kusht thelbësor për llogaridhënie dhe pjesëmarrjen në publik", Prezantim i Këshillit të Evropës, 23 qershor 2020.

[459] Shih, për shembull, <https://rm.coe.int/09000016809eca31> "Qasja në informacione si kusht thelbësor për llogaridhënie dhe pjesëmarrjen në publik", Prezantim i Këshillit të Evropës, 23 qershor 2020.

[460] Shih raportin mujor të hartuar si pjesë e programit të Komisionit të BE-së për monitorimin e dezinformatave, që mund të gjendet këtu: <https://digital-strategy.ec.europa.eu/en/policies/covid-19-disinformation-monitoring> për shembull, në nëntor 2020, Facebook raportoi se kishte përditësuar politikën e reklamave duke refuzuar reklamat që i dekurajonin njerëzit nga marrja e vaksinës, dhe në nëntor 2021 raportoi se 110,000 artikuj me përmbajtje ishin hequr nga Facebook dhe Instagram në BE për shkelje të politikave të dezinformimit për Covid-19.

që publikimi i informacionit rreth personave që infektohen nga Covid-19 ose trajtohen për Covid-19 mund të ndërhyjë në të drejtat e tyre private ose familjare, të mbrojtura nga Neni 8 i Konventës.^[461]

Megjithatë, të gjitha masat për kufizimin e shprehjes që sillen për këto qëllime duhet të jenë të pazakonta, proporcionale dhe të sillen në përputhje me ligjin.

Ligjshmëria

Kufizimet mbi shprehjen dhe informacionin duhet të jenë të qarta dhe të parashikueshme dhe të përmbajnë kushte të definuara qartë për të shmangur keqpërdorimin e shqetësimeve të shëndetit publik dhe frikën e trazirave si pretekst për të ndjekur penalisht profesionistët e medias ose për të heshtur zërat kritikë^[462]. Cilësia e ligjit, si dhe kërcënimi i sanksionimit të rregullimit të shprehjes mund të kufizojë shprehjen e lirë. Ka shqetësime që masat e marra për të parandaluar përhapjen e dezinformatave në kontekstin e pandemisë mund të përdoren për të etiketuar dhe sanksionuar çdo shprehje që kritikon qeveritë si "informatë e rreme" ose "informatë që mund të shkaktojnë panik", duke pasur parasysh gjerësinë dhe dykuptimësinë e këtyre termave.^[463] Formulimet e mjegullta dhe të përgjithshme, si "lajme të rreme" ose "që shkaktojnë panik", e ulin cilësinë e ligjit duke i hapur derën abuzimeve potenciale dhe ndërhyrjeve joproporcionale. Shtetet duhet të shmangin masat të cilat janë të shprehura me fjalë të përgjithshme dhe të mjegullta, u mungon parashikueshmëria dhe/ose me gjasë mund të çojnë drejt kriminalizimit të tepruar. Masat për të luftuar dezinformacionin po ashtu duhet të kontrollohen nga parlamentet, të monitorohen nga institucionet nacionale të të

[461] Shih *Armonas k. Lituanië dhe Biriuk k. Lituanië*, vendim i 25 nëntorit 2008, Nr. 23373/03.

[462] Ndërkohë që gjithnjë e më shumë zhvillohen debate publike në platformat e mediave sociale, dhe kompanitë privatë janë gjithnjë e më shumë përgjegjëse për rregullimin e shpesh kufizimin e shprehjes në platformat e tyre, mund të lindë nevoja që edhe Shtetet të punojnë së afërmi me këto platforma për të rregulluar kapacitetin e tyre për të kufizuar të shprehurit, dhe për të futur ligje që qeverisin kapacitetin e tyre për ta bërë një gjë të tillë, për t'u siguruar që të gjitha kufizimet e tilla të jenë në përputhje me ligjin. Shih, për shembull, suspendimin nga Facebook të llogarive të mohuesve të Covid-19 në Gjermani, gjë që u realizua në pajtueshmëri me Standardet e Komunitetit të vetë Facebook, dhe ngre pyetje lidhur me shkallën deri ku Shtetet duhet t'i mbrojnë individët nga shtypja e shprehjes nga kompanitë private: <https://verfassungsblog.de/querdenker-suspension-fb/> "Facebook suspendon llogaritë e mohuesve gjermanë të Covid-19", Amélie Heldt, 28 shtator 2021.

[463] Shih <https://rm.coe.int/16809ef1c7> "Impakti i krizës sanitare mbi lirinë e shprehjes dhe informacionit në media", Raport i Këshillit të Evropës, 7 korrik 2020.

drejtave të njeriut, dhe t'i nënshtrohen shqyrtimit nga gjykatat kushtetuese ose gjykata të tjera kompetente.^[464]

Proporcionaliteti

Gjatë vlerësimit nëse një ndërhyrje në të drejtën e lirisë së shprehjes është proporcionale, faktorët relevantë përfshijnë përmbajtjen e shprehjes, qëllimin e saj, si dhe llojin dhe rreptësinë e çdo sanksioni ose kufizimi të imponuar.

Përmbajtja dhe qëllimi i shprehjes

Gjykata ka theksuar në mënyrë konsistente që shprehja e cila ka të bëjë me çështje të interesit publik duhet të përfitojë mbrojtje më të madhe. Shteteve u jepet hapësirë e ngushtë vlerësimi në këtë kontekst, dhe çdo kufizim në shprehje lidhur me çështje të interesit publik duhet të ketë justifikim të veçantë. Shprehja që ka të bëjë me çështje të shëndetit publik,^[465] çështje lidhur me mbrojtjen e shëndetit dhe këqyrjen e sasisë së informacionit të dhënë nga autoritetet mbi rreziqet ndaj shëndetit publik të gjitha janë gjetur nga Gjykata se përbëjnë çështje të interesit publik të cilat do të duhej të përfitonin nga një shkallë më e lartë e mbrojtjes.^[466] Andaj të gjitha kufizimet ndaj këtyre formave të shprehjes duhet t'i nënshtrohen këqyrje rigoroze.

Këshilli i Evropës ka riafirmuar rëndësinë e mbrojtjes së të drejtës për lirinë e shprehjes si element thelbësor i luftimit të përhapjes së Covid-19.^[467] Shkëmbimi i lirë i informacioneve të sakta është jetik për t'u mundësuar njerëzve të kuptojnë situatën e shëndetësisë publike dhe çfarë masash duhen marrë për të mbrojtur

[464] *Incal k. Turqisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 9 qershorit 1998, Nr. 22678/93; *Sahin Alpay k. Turqisë*, vendim i 20 marsit 2018, Nr. 16538/17, §§ 172-184 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim); *Gözel dhe Özer k. Turqisë*, vendim i 6 korrikut 2010, Nr. 43453/04 dhe 31098/05; shih gjithashtu https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectID=09000016805ae60e "Udhërrëfyes për mbrojtjen e lirisë së shprehjes dhe informacionit në kohë krize", § 19, Udhërrëfyes i Këshillit të Evropës, 26 shtator 2007.

[465] *Hertel k. Zvicrës*, vendim i 25 gushtit 1998, Nr. 25181/94, § 47.

[466] *Mamere k. Francës*, vendim i 7 nëntorit 2006, Nr. 12697/03, ku u ofrua nivel i lartë mbrojtjeje për të shprehurit që gjendej se ishte pjesë e një debati publik tepër të rëndësishëm të fokusuar posaçërisht rreth informacionit të pamjaftueshëm që autoritetet i jepnin popullatës në lidhje me nivelet e kontaminimit ndaj të cilave ajo kishte qenë e ekspozuar dhe pasojat e shëndetit publik të atij ekspozimi.

[467] Shih <https://rm.coe.int/09000016809eca31> "Qasja në informacione si kusht thelbësor për llogaridhënien dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në publik", Prezantim i Këshillit të Evropës, 23 qershor 2020.

shëndetin e vetes dhe të tjerëve. Qasja në informacione dhe këqyrja publike në media dhe nga organizata të tjera kanë rëndësi të veçantë për të garantuar llogaridhënie publike gjatë një emergjence shëndetësore publike, meqenëse kjo përbën kontroll thelbësor mbi fuqitë ekzekutive, ndërkohë që kontrollet dhe bilancet e tjera mbi veprimet e qeverisë hiqen ose fshihen për shkak të situatës së emergjencës.^[468]

Mbrojtja e shtuar e lirisë së shprehjes e cila ndihmon të luajnë rolin e 'rojtarit publik' gjendet shpesh në çështjet që kanë të bëjnë me media, por jo vetëm në këto çështje, dhe shtrihet për shembull edhe në rastet e grupeve të vogla dhe informale që bëjnë fushata.^[469] Gjykata gjithashtu ka njohur që burimet online të informacionit kontribuojnë në mënyrë domethënëse për rritjen e qasjes publike në lajme dhe informacione, që do të thotë se edhe blogerët dhe përdoruesit e famshëm të mediave sociale mund të karakterizohen si 'rojtare publike' dhe mund të përfitojnë nga mbrojtje të shtuara për çdo shprehje që ka të bëjë me njerëz ose që paraqet kritika për çështje të interesit publik.^[470]

Ndërkohë që Gjykata e ka pranuar që besimi publik tek autoritetet është faktor i rëndësishëm në menaxhimin e suksesshëm të krizave, ky faktor nuk është më i rëndësishëm se garantimi i shprehjes së lirë të çështjeve dhe kritikave ndaj reagimeve të qeverisë në krizën shëndetësore. Në fakt, Gjykata ka gjetur se ata që janë përgjegjës për reagimin në situata krize duhet ta fitojnë vetë besimin publik, pa u mbështetur tek kufizimet e shprehjes për ta arritur këtë.^[471]

Lloji i kufizimit

Kur liria e shprehjes kufizohet për qëllime legjitime, kufizimi duhet të jetë mjete më pak kufizues për arritjen e atij qëllimi.^[472] Për shembull, gjatë pandemisë,

[468] Shih <https://rm.coe.int/respect-for-democracy-human-rights-and-rule-of-law-during-states-of-emergency/16809e82c0> "Respekt për Demokracinë, të Drejtat e Njeriut dhe Sundimin e Ligjit gjatë Gjendjes së Emergjencës – Reflektime: kufizimi i lirisë së shprehjes në kontekste të emergjencave do të privonte publikun nga kontrolli thelbësor mbi pushtetet ekzekutive", Raport i Komisionit të Venecias, 26 maj 2020.

[469] *Steel dhe Morris k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 15 shkurtit 2005, Nr. 68416/01.

[470] *Magyar Helsinki Bizottság k. Hungarisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 8 nëntorit 2016, Nr. 18030/11, § 168 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[471] *Mamere k. Francës*, vendim i 7 nëntorit 2006, Nr. 12697/03.

[472] *Women on Waves k. Portugalisë*, vendim i 3 shkurtit 2009, Nr. 31276/05, § 41 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

mund të ketë qenë e nevojshme të kufizohej qasja fizike në konferenca shtypi për të mbrojtur shëndetin e pjesëmarrësve të mundshëm. Megjithatë, prapë se prapë u bë i mundur angazhimi aktiv me mediat duke ruajtur distancën fizike gjatë konferencave të shtypit ose duke mbajtur videokonferenca.^[473] Qëllimi i mbrojtjes së shëndetit, për shembull, nuk do të kërkonte kufizime të plota të qasjes në konferenca shtypi, ose kufizime ndaj pyetjeve vijuese që bëhen nëpër konferenca. Kufizimi i qasjes në informacion mund të zvogëlojë besimin publik, konfidencën dhe bashkëpunimin me reagimin e qeverisë ndaj pandemisë, duke penguar kështu, në vend që të avancojë, qëllimin e mbrojtjes së shëndetit.

Më tej, ndalimi i llojeve të caktuara të shprehjes mund të mos jetë mjeti më kufizues i parandalimit të shpërndarjes së dezinformatave. Këtij qëllimi mund t'i shërbejnë fushatat qeveritare të informacionit, komunikimet e hapura me publikun për të promovuar besimin dhe bashkëpunimin, dhe bashkëpunimi me platformat dhe mediat online për të parandaluar manipulimin e opinionit publik dhe për t'u dhënë përparësi burimeve të besueshme të lajmeve dhe informacioneve, në mënyrë të veçantë atyre të komunikuar nga autoritetet e shëndetit publik. Gazetaria etike dhe e përgjegjshme po ashtu është gjetur të jetë kundërhelm efikas kundër keqinformimit dhe dezinformatave.^[474]

Nëse vlerësohet e nevojshme të vihen sanksione për shpërndarjen e dezinformatave të cilat janë të dëmshme për përpjekjet për të luftuar Covid-19, sanksionet kanë më shumë gjasa të gjenden proporcionale nëse ato vendosen ex post facto, dhe nëse shënjestrojnë një mënyrë të caktuar të shprehuri. Gjykata nuk ka gjasa të gjejë që censurimi mëhershëm i temave të caktuara, ose bllokimi direkt i qasjes në platforma ose faqe të tëra interneti është i justifikuar. Kufizimet e mëhershme mbi publikimet i nënshtrohen një kontrolli të rreptë, dhe detyrimi gjatë pandemisë për të publikuar vetëm informacione 'zyrtare', për shembull, me gjasë do të vlerësohet si ndërhyrje e tepërt në të drejtën për lirinë e shprehjes.^[475]

[473] Shih <https://europeanjournalists.org/blog/2020/04/15/good-practices-for-press-conferences-during-pandemic/> "Praktikat e mira për konferencat e shtypit gjatë pandemisë Covid-19", Federata Evropiane e Gazetarëve, 15 prill 2020.

[474] *Bédat k. Zvicerës*, vendim i Dhomës së Madhe i 29 marsit 2016, Nr. 56925/08, § 58; *Magyar Jeti Zrt k. Hungarisë*, vendim i 4 dhjetorit 2018, Nr. 11257/16, § 64.

[475] *RTBF k. Belgjikës*, vendim i 29 marsit 2011, Nr. 50084/06, § 114; *The Sunday Times k. Mbretërisë së Bashkuar* (Nr. 2), vendim i 26 nëntorit 1991, Nr. 13166/87, § 51; *Observer dhe Guardian k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 26 nëntorit 1991, Nr. 13585/88, ku u gjet që vonesa në publikim, qoftë edhe për një periudhë të shkurtër, mund ta privojë informacionin nga krejt vlera e tij dhe interesi për të.

Në mesin e kufizimeve post-ekspresive të shprehjes, caktimi i sanksioneve penale rrallë gjendet të jetë proporcional. Gjykata konsideron që caktimi i një dënimi me mbajtje, përfshirë dënimin me kusht, për një vepër lidhur me median, është në përputhje me Nenin 10 vetëm në rrethana të pazakonta kur janë dëmtuar seriozisht të drejta të tjera themelore si, për shembull, në rastet e gjuhës së urrejtjes ose nxitjes së dhunës.^[476] Një sanksion i tillë vlerësohet se ka efekt rrënoqethës mbi shprehjen dhe shihet si veçanërisht i rrezikshëm në rastet e fjalimeve politike dhe debateve me interes publik.^[477] Edhe në rastet kur shprehja shpie në dezinformatë, dhe gazetari/ ja ka dështuar në respektimin e etikës së gazetarisë duke raportuar informata pa kontrolluar më parë vërtetësinë e tyre, Gjykata ka gjetur që imponimi i një dënimi mbajtës me kusht ka qenë joproporcional.^[478] Procedurat disiplinore të cilat kanë rezultuar me ndalimin e çdo shprehjeje kritike në profesionin mjekësor po ashtu kanë shkelur Nenin 10, siç e ka shkelur edhe një qortim disiplinor i një mjeku, çka ka ngritur shqetësim publik në lidhje me vendimet e marra nga mbikqyrësi i tyre dhe cilësia e kujdesit mjekësor për pacientët.^[479]

Gjykata ka konstatuar që emergjencat publike nuk duhet të shërbejnë si pretekst për kufizimin e lirisë së debatit politik.^[480] Duke pasur parasysh theksin e vënë nga Gjykata mbi rëndësinë e diskutimit të lirë dhe këqyrjes publike mbi çështje të shëndetit publik, për të qenë në përputhje me Nenin 10 çdo kufizim i shprehjes gjatë pandemisë duhet të evitojë vënien e sanksioneve penale dhe të zbatohet vetëm si zgjidhje e fundit pasi mjetet e tjera më pak ndërhyrëse për luftimin e dezinformacionit të jenë gjetur joefektive.

[476] *Mahmudov dhe Agazade k. Azerbajxhanit*, vendim i 18 dhjetorit 2008, Nr. 35877/04, § 50.

[477] *Lewandowska-Malec k. Polonisë*, vendim i 18 shtatorit 2012, Nr. 39660/07, § 70.

[478] *Sallusti k. Italisë*, vendim i 7 marsit 2019, Nr. 22350/13 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[479] *Frankowicz k. Polonisë*, vendim i 16 dhjetorit 2008, Nr. 53025/99, § 51; *Sosinowska k. Polonisë*, vendim i 18 tetorit 2011, Nr. 10247/09.

[480] *Sahin Alpay k. Turqisë*, vendim i 20 marsit 2018, Nr. 16538/17, §§ 172-184 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

9. Neni 11 - E drejta për lirinë e tubimit dhe organizimit

Neni 11 ECHR parashikon:

“1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së tubimit paqësor dhe të organizimit me të tjerët, duke përfshirë të drejtën e themelimit me të tjerë të sindikatave dhe të pjesëmarrjes në to për mbrojtjen e interesave të tij.

2. Ushtrimi i këtyre të drejtave nuk mund t'u nënshtrohet kufizimeve të tjera përveç atyre që parashikohen me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për ruajtjen e shëndetit ose të moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve.”

a. Fushëveprimi i Nenit 11

Neni 11 mbron të drejtat e njerëzve për t'u grumbulluar në vende publike dhe private, kur qëllimi i tyre është të tubohen në mënyrë paqësore. Organizimi dhe pjesëmarrja në protesta, marshime, demonstrata, kundër-demonstrata, konferenca shtypi dhe takime të gjitha hyjnë brenda fushëveprimit të Nenit 11. Kjo e drejtë, megjithatë, nuk mbron demonstratat ose grumbullimet qëllimisht të dhunshme.

Gjykata e sheh të drejtën për lirinë e tubimit si një prej të drejtave themelore dhe si një prej themeleve të një shoqërie demokratike, dhe njih faktin që pjesëmarrja në procese demokratike, në masë të madhe, arrihet duke i përkurur organizimeve në të cilat qytetarët mund të integrohen me njëri-tjetrin dhe të ndjekin objektiva të përbashkëta në mënyrë kolektive.^[481] Prandaj, Gjykata ka deklaruar që Neni 11 nuk duhet të interpretohet në mënyrë restriktive.^[482]

[481] *Moscow Branch of the Salvation Army k. Rusisë*, vendim i 5 tetorit 2006, Nr. 72881/01, § 61.

[482] *Djavit An k. Turqisë*, vendim i 20 shkurtit 2003, Nr. 20652/92, § 56; *Kudrevičius dhe të Tjerë k. Lituaniës*, vendim i Dhomës së Madhe i 15 tetorit 2015, Nr. 37553/05, § 91.

Qëllimet e Nenit 11 përfshijnë mbrojtjen e lirisë për të formuar dhe shprehur opinione dhe për të siguruar një forum publik për debat, shprehje dhe protesta. Prandaj, e drejta e tubimit është e lidhur ngusht me të drejtën e lirisë së shprehjes sipas Nenit 10. Megjithatë, ndërkohë që Neni 10 mbulon të drejtën për të shprehur opinione, Neni 11 njuh fuqinë e shprehjes së opinioneve të tilla në mënyrë kolektive. Gjykata i ka dhënë rëndësi faktit që ata që marrin pjesë në tubime nuk kërkojnë vetëm të shprehin opinionin e tyre, por edhe ta shprehin atë së bashku me të tjerë.^[483]

Fushëveprimi i Nenit 11 gjithashtu shtrihet përtej të drejtës për të shprehur opinione politike. Ai mbron tubimet e natyrës sociale në thelb, si dhe grumbullimet fetare, kulturore dhe shpirtërore. Gjykata ka afirmuar që, përveç partive politike, tubimet dhe organizimet që synojnë të mbrojnë trashëgiminë kulturore ose shpirtërore, që ndjekin qëllime socio-ekonomike, të shpallin ose të mësojnë fenë, që synojnë identitetin etnik ose promovojnë ndërgjegjen e një minoriteti po ashtu janë të rëndësishme për funksionimin e duhur të demokracisë. Andaj Neni 11 është gjithashtu i lidhur ngusht edhe me Nenin 9, liria e fesë, meqenëse ai mbron të drejtën e besimit kolektiv.

Është gjithashtu e mundur, në rrethana të pazakonta, që një individ ose shoqatë të pretendojë se është viktimë e ndërhyrjes tek e drejta e tij/saj nga Neni 11 kur ai/ajo duhet të anulohet ose të përmbahet nga organizimi i një proteste ose demonstrate publike me qëllim që t'i shmangët sanksioneve, edhe kur këto sanksione nuk janë vendosur^[484].

c. Ndërhyrjet e lejuara tek e drejta për lirinë e tubimit dhe organizimit

Masat e marra nga Shtetet për t'iu përgjigjur pandemisë së Covid-19 qartazi ndërhyjnë tek e drejta për tubim, organizim dhe manifestim që mbrohet sipas Nenit 11^[485]. Aspektet thelbësore të reagimeve të Qeverisë ndaj pandemisë përfshinë

[483] *Primov dhe të Tjerë k. Ruisë*, vendim i 12 qershorit 2014, Nr. 17391/06, § 91.

[484] *Communauté genevoise d'action syndicale (CGAS) k. Zvicrës*, vendimi i 15 marsit 2022, Nr. 21881/20, § 42 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim). Megjithatë, kjo çështje iu referua Dhomës së Madhe më 5 shtator 2022, që do të thotë se ky vendim i seksionit të tretë të Gjykatës nuk është përfundimtar dhe një vendim i ri përfundimtar i Dhomës së Madhe do të merret në lidhje me këtë çështje.

[485] *Communauté genevoise d'action syndicale (CGAS) k. Zvicrës*, vendimi i 15 marsit 2022, Nr. 21881/20, § 42 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim). Megjithatë, kjo çështje iu referua Dhomës së Madhe më 5 shtator

ndalimin e njerëzve nga takimi me këdo jashtë shtëpisë së tyre, kufizimi i numrit të njerëzve që mund të mbledhen së bashku në të njëjtën kohë^[486] dhe mbyllja e hapësirave publike dhe private ku mund të ishin mbajtur takimet. Ngjarjet kulturore, fetare dhe politike nëpër Evropë u anuluan, dhe mbledhitë sociale ose u ndaluan krejtësisht ose u kufizuan në madhësinë e tyre. Shumë njerëz kanë filluar të përdorin mënyra alternative komunikimi dhe të shprehuri, kryesisht online, por është elementi kolektiv në thelb të Nenit 11 me anë të të cilit njerëzit kërkojnë të veprojnë dhe të shprehen së bashku ai që është prekur më ashpër nga mbylljet brenda dhe masat e distancimit social.

Shkalla deri ku mund të justifikohen kufizimet për të drejtën e tubimit u vu në fokus të veçantë kur, pas vdekjes së Xhorxh Floyd (George Floyd) më 25 maj 2020 në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, u zhvilluan protesta për Black Lives Matter nëpër Evropë dhe në botë, duke përfshirë mijëra pjesëmarrës dhe në disa raste shkelje të rregullave të distancimit social dhe kufizimeve për grumbullimet e mëdha.

Neni 11 lejon kufizimet e të drejtës së tubimit për mbrojtjen e shëndetit publik dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve, dhe Shtetet mund të argumentojnë qartë se kufizimet që kanë vënë për grumbullimet si reagim ndaj pandemisë hyjnë brenda fushëveprimit të këtyre përjashtimeve^[487]. Megjithatë, këto kufizime shkelin Nenin 11 nëqoftëse nuk janë të parashikuara nga ligji dhe përfaqësojnë një mjet të nevojshëm për të mbrojtur shëndetin publik. Si fushëveprimi i kufizimeve, ashtu edhe zbatimi i tyre duhet të mbeten proporcionale me qëllimin e mbrojtjes së shëndetit publik.

2022, që do të thotë se ky vendim i seksionit të tretë të Gjykatës nuk është përfundimtar dhe një vendim i ri përfundimtar i Dhomës së Madhe do të merret në lidhje me këtë çështje. Sidoqoftë, nuk u vu në diskutim nga asnjëra palë që ndalimi i takimeve publike përbëri ndërhyrje tek e drejta e lirisë së tubimit.

[486] Për shembull, vendimi i 13 marsit 2020 nga kryeministri francez për të ndaluar grumbullimet e më shumë se 100 personave <https://www.gouvernement.fr/info-coronavirus/les-actions-du-gouvernement> "Les actions du Gouvernement", Deklarata e Qeverisë Franceze, 28 maj 2020.

[487] *Communauté genevoise d'action syndicale (CGAS) k. Zvicrës*, vendimi i 15 marsit 2022, Nr. 21881/20, § 42 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim). Megjithatë, kjo çështje iu referua Dhomës së Madhe më 5 shtator 2022, që do të thotë se ky vendim i seksionit të tretë të Gjykatës nuk është përfundimtar dhe një vendim i ri përfundimtar i Dhomës së Madhe do të merret në lidhje me këtë çështje. Sidoqoftë, nuk u vu në diskutim nga asnjëra palë që ndalimi i takimeve publike gjatë pandemisë synoi qëllimin legjitim të mbrojtjes së shëndetit dhe të drejtave e lirive të të tjerëve.

Parashikuar me ligj

Për të qenë në përputhje me Nenin 11, masat duhet të kenë bazë ligjore në të drejtën vendase dhe duhet të jenë të formuluar me fjalë mjaft të qarta dhe të kuptueshme për të mbrojtur individët kundër ndërhyrjeve arbitrare tek e drejta e tyre për tubim. Shumë prej masave të mbylljes brenda dhe distancimit social të marra nga Qeveritë specifikonin që individët nuk duhet të takohen me asnjë person jashtë shtëpisë së tyre, dhe që duhet të mbanin distancë, zakonisht 1-2 metra larg të tjerëve në hapësira publike. Megjithatë, që kur masat e mbylljes brenda filluan të lehtësoheshin, fushëveprimi i saktë i kufizimeve nuk ka qenë gjithmonë i qartë.

Gjykata ka pranuar që qartësia absolute lidhur me pasojat e veprimeve të njerëzve mund të jetë e pamundur të arrihet, meqenëse ligjet duhet të ruajnë një shkallë fleksibiliteti për të lënë vend për ndryshimin e rrethanave.^[488] Megjithatë, diskrecioni ligjor nuk duhet të jepet në formën e fuqisë së shpenguar, dhe ligji duhet të tregojë me qartësi të mjaftueshme fushëveprimin e çdo diskrecioni dhe mënyrën e ushtrimit të tij. Kur kufizimet për tubime fshihen pas formulimeve të mjegullta dhe të gjera, ato mund të mos e përmbushin këtë standard të ligjshmërisë. Disa shembuj përfshijnë:

- i) Në Kroaci u ndaluan tubimet në vende publike ku mund të takohen 'një numër i madh njerëzish', por nuk u definua më tej 'një numër i madh'.^[489]
- ii) Në Irlandë u ndaluan ngjarjet ku, për shkak të natyrës, formatit, lokacionit ose ambientit të ngjarjeve, ato 'me arsye mund të konsideroheshin se përbënin rrezik për infektimin me Covid-19 të personave që merrnin pjesë në ngjarje'.^[490]
- iii) Raporti i Observatorit të Lirive Publike të Parisit mbi implementimin e masave të përmbajtjes i miratuar nga autoritetet franceze kritikoi mungesën e saktësisë në kornizën ligjore për misionet

[488] *Ezelin k. Francës*, vendim i 26 prillit 1991, Nr. 11800/85, § 45.

[489] Shih <https://www.koronavirus.hr/odluka-o-mjeri-strogog-ogranicavanja-zadrzavanja-na-ulicama-i-drugim-javnim-mjestima/260> "Odluka o mjeri strogog ogranicavanja zadržavanja na ulicama i drugim javnim mjestima", Report of Koronavirus.hr, 26 gusht 2020.

[490] Shih <http://www.irishstatutebook.ie/eli/2020/act/1/section/10/enacted/en/html> "Akti për Shëndetin (Ruajtja dhe Mbrojtja dhe Masa të Tjera Emergjente me Interes Publik) i vitit 2020", Legjislacioni i Statutit Irlandez.

monitoruese të forcave policore, duke theksuar se kjo kishte çuar në vendime arbitrare dhe zbatimin arbitrar të rregulloreve.^[491]

Dispozita të tilla rrezikojnë ndërhyrje arbitrare në të drejtën e tubimit ku policia dhe publiku shumë lehtë mund t'i interpretojnë dispozitat ndryshe nga njëri-tjetri. Për të garantuar pajtueshmërinë me Nenin 11, çdo kufizim i vendosur i tubimeve duhet të formulohet me terma sa më të qarta të mundshme brenda rrethanave, për shembull duke specifikuar numrin e saktë të njerëzve që lejohet të takohen në të njëjtën kohë, për të zvogëluar rrezikun e ndërhyrjes arbitrare në të drejtën e organizimit.

E nevojshme në një shoqëri demokratike

Masat të cilat ndërhyjnë tek e drejta për lirinë e tubimit paqësor shkelin Nenin 11 nëqoftëse nuk janë "të nevojshme në një shoqëri demokratike". Kjo do të thotë se ato duhet të përmbushin një nevojë shoqërore urgjente, të jenë mjet proporcional i reagimit ndaj asaj nevoje urgjente (për shembull, mjet proporcional për arritjen e qëllimit të mbrojtjes së shëndetit publik) dhe arsyet e cekura për të justifikuar masën duhet të jenë "relevante dhe të mjaftueshme".

Gjykata më parë ka mbështetur kufizime domethënëse mbi grumbullimet publike (për shembull kufizim të lokacioneve ose numrit të pjesëmarrësve) ku qëllimi ishte mbrojtja e sigurisë publike ose ruajtja e rendit publik^[492] dhe Gjykata nuk gjeti shkelje të Nenit 11 kur grumbullimi u shpërnda për të mbrojtur shëndetin dhe sigurië në pjesëmarrësve.^[493] Megjithatë, këto kufizime nuk kishin lidhje me ndalimet e përgjithshme për grumbullimet, ato kishin për qëllim përmbajtjen e rrezikut të veçatë që vinte nga demonstratat në fjalë.

Natyra e kufizimit të tubimit

Gjykata përgjithësisht u jep Shteteve një hapësirë më të ngushtë vlerësimi kur ato kërkojnë të vendosin ndalime të përgjithshme e pa dallim mbi demonstratat^[494].

[491] Shih <https://www.ldh-france.org/wp-content/uploads/2019/04/Obs-paris-Point-droit-confinement.pdf> "Point droit - confinement", Dokument nga L'Observatoire parisien des libertés publiques, 25 mars 2020.

[492] Shih *Chappell k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi për pranueshmërinë i 14 korrikut 1987, Nr. 12587/86; *Rai, Allmond dhe "Negotiate Noë" k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi për pranueshmërinë i 6 prillit 1995, Nr. 25522/94.

[493] *Cisse k. Francës*, vendim i 9 prillit 2002, Nr. 51346/99 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[494] *Communauté genevoise d'action syndicale (CGAS) k. Zvicrës*, vendimi i 15 marsit 2022, Nr. 21881/20, § 42 (i

Për të justifikuar një ndalim të përgjithshëm, Shteti duhet të demonstrojë që ekziston një rrezik real i cili nuk mund të parandalohet përmes masave të tjera më pak shtrënguese^[495]. Ai duhet të marrë parasysh efektin e ndalimit dhe të konkludojë që disavantazhet e shkaktuara nga ndalimi kanë qartazi më shumë peshë se konsideratat e sigurisë, dhe që nuk ka mënyra të tjera të mundshme për të shmangur këto efekte të padëshirueshme, për shembull duke reduktuar fushëveprimin ose kohëzgjatjen e ndalimit.^[496] Kohëzgjatja e ndalimit gjithashtu, më përgjithësisht, është faktor relevant për çdo ushtrim proporcionaliteti^[497].

Jo çdo Shtet ka gjetur që ndalimi i përgjithshëm e pa dallim i grumbullimeve është i nevojshëm në kontekstin e luftimit të pandemisë Covid-19. Për shembull:

- i) Në Danimarkë ligji i miratuar për të caktuar kufirin e numrit të njerëzve që lejohen të takohen përmbante një përjashtim për organizimet që kanë të bëjnë me formësimin e opinionëve, përfshirë demonstratat dhe takimet politike.
- ii) Në Gjermani, Gjykata Kushtetuese vendosi që kufizimet lidhur me Covid-19 nuk duhet të peshojnë automatikisht më shumë se e drejta për lirinë e tubimit. Në vend të kësaj, ajo deklaroi që zyrtarët duhet të shqyrtojnë kërkesat për të zhvilluar demonstrata sipas secilit rast specifik, duke marrë parasysh nëse organizatorët mund të pajtoheshin për një numër më të vogël pjesëmarrësish kombinuar

përfshirë si përmbledhje në këtë publikim). Megjithatë, kjo çështje iu referua Dhomës së Madhe më 5 shtator 2022, që do të thotë se ky vendim i seksionit të tretë të Gjykatës nuk është përfundimtar dhe një vendim i ri përfundimtar i Dhomës së Madhe do të merrret në lidhje me këtë çështje.

[495] Shih për shembull urdhrin e Këshillit Francez të Shtetit të datës 13 qershor 2020, Nr. 440846, 440856, 441015, i cili suspendoi operimin e një neni të një dekreti që ndalonte tubimet publike me më shumë se 10 persona. Këshilli i Shtetit gjeti që, duke pasur parasysh rëndësinë e të drejtës për të protestuar, duhet të ketë një përjashtim në këtë dispozitë të përgjithshme në rastin e demonstratave ose protestave publike, kur mund të ndiqen masa të tjera mbrojtëse, si bartja e maskës dhe distancimi social, dhe kur demonstrata nuk mbledh më shumë se 5,000 njerëz.

[496] *Christians against Racism and Fascism k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi për pranueshmërinë i 16 korrikut 1980, Nr. 8440/78.

[497] *Communauté genevoise d'action syndicale (CGAS) k. Zvicrës*, vendimi i 15 marsit 2022, Nr. 21881/20, § 42 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim). Megjithatë, kjo çështje iu referua Dhomës së Madhe më 5 shtator 2022, që do të thotë se ky vendim i seksionit të tretë të Gjykatës nuk është përfundimtar dhe një vendim i ri përfundimtar i Dhomës së Madhe do të merrret në lidhje me këtë çështje. Seksioni i tretë i Gjykatës gjeti, në këtë rast, se një ndalim i përgjithshëm i tubimeve për mbi dy muaj mes marsit dhe majit 2020 ishte me gjatësi kohore të konsiderueshme.

me hapësirat fizike për mbajtjen e demonstratave në lokacione dhe kohë të cilat nuk përbënin rrezik substancial për shëndetin.^[498]

Impakti i pandemisë dhe burimet në dispozicion për të policuar demonstratat dhe për të siguruar që zyrtarë të mjaftueshëm mjekësorë të jenë të pranishëm ndryshojnë nga Shteti në Shtet. Qasja e ndërmarrë në Gjermani dhe Danimarkë, për shembull, mund të mos jetë e mundur në Shtete të tjera. Megjithatë, këto shembuj tregojnë se ekzistojnë qasje alternative. Për të evituar shkeljen e Nenit 11, Shtetet që vendosën ndalim të tërësishëm të demonstratave duhet të jenë në gjendje të tregojnë përse nuk ka qenë e mundur asnjë formë tjetër më pak strikte e rregullimit të demonstratave, për shembull përse nuk kanë ofruar opsionin që demonstruesit të kërkojnë leje për përjashtimin nga ndalimet e përgjithshme, për shembull opsioni për mbajtjen e demonstratave socialisht të distancuara, me pjesëmarrës të kufizuar^[499].

Mënyrat alternative të tubimit dhe organizimit

Një faktor tjetër relevant për vlerësimin e proporcionalitetit të kufizimit të tubimit është nëse ka mënyra alternative me anë të të cilave mund të përhapet mesazhi i një demonstrate, ose përmes të cilave një shoqatë mund të zhvillojë aktivitetet që do të zhvillonte po të mblidheshin bashkë, për shembull duke mbajtur takime online. Gjatë pandemisë, qytetarët zhvilluan forma alternative të tubimit dhe protestës, për shembull në Kroaci dhe në Kosovë protestuesit përplasën tenxhere dhe fëltere nga ballkonet e tyre duke protestuar kundër qeverisë, në Hungari një protestë online kundër reagimit të Qeverisë ndaj pandemisë u organizua nga një platformë dixhitale organizatore dhe u pa prej 40,000 njerëzve^[500] dhe në Gjermani aktivistët pikturuan gjurmët e shputave të këmbëve mbi institucione të ndryshme shtetërore në shenjë solidariteti me migrantët dhe refugjatët nëpër kampet e Evropës.^[501]

[498] Shih <https://www.dw.com/en/germanys-top-court-overturns-stuttgarts-protest-ban/a-53175992> "Gjykata më e lartë e Gjermanisë përmbys ndalimin e protestave në Shtuttgart", DË, 18 prill 2020.

[499] *Communauté genevoise d'action syndicale (CGAS) k. Zvicrës*, vendimi i 15 marsit 2022, Nr. 21881/20, § 42 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim). Megjithatë, kjo çështje iu referua Dhomës së Madhe më 5 shtator 2022, që do të thotë se ky vendim i seksionit të tretë të Gjykatës nuk është përfundimtar dhe një vendim i ri përfundimtar i Dhomës së Madhe do të merret në lidhje me këtë çështje.

[500] Shih <https://civitates-eu.org/the-covid-19-crisis-shows-the-need-for-civil-society-to-be-stronger-than-ever-not-only-in-hungary/> "Kriza e Covid-19 tregon nevojën për një shoqëri civile më të fortë se kurrë, jo vetëm në Hungari", Civitates, 4 prill 2020.

[501] Shih <https://www.infomigrants.net/en/post/23906/leave-no-one-behind-protests-for-migrants-in-times->

Mundësia e formave alternative të protestimit mund të ndihmojë për të justifikuar ndalimet e përkohshme të tubimeve, por sa më shumë që zgjat kufizimi i tubimit aq më pak peshë marrin këto forma alternative të protestës. Neni 11 e njuh rëndësinë e shprehjes së një mesazhi së bashku. Shikimi i videove online dhe protestimi nga dritarja e apartamentit nuk e zëvendësojnë atë krejtësisht. Kufizimet më afatgjata të së drejtës për tubim do të jenë sidomos të vështira për t'u justifikuar kur format alternative të protestës të jenë kryesisht online, dhe kur mungesa e njohurive për shfrytëzimin e teknologjisë informative apo mungesa e lidhjeve të mjaftueshme të internetit mund të pengojnë pjesëmarrjen e atyre që përndryshe do t'i bashkoheshin demonstratës.

Qëllimi i tubimit ose organizimit

Ndërkohë që protestat duhet të ndalohen rralë për shkak të substancës së mesazhit që pjesëmarrësit dëshirojnë të përçojnë, qëllimi i një demonstrate mund të jetë po ashtu relevant me vlerësimin e proporcionalitetit. Protestat e Black Lives Matter gjatë pandemisë janë shembulltyrë e kësaj në dy aspekte. Së pari, detyrimi pozitiv për të siguruar gëzimin efektiv të lirisë së tubimit ka rëndësi të veçantë për personat që u përkasin minoriteteve, të cilët janë më të prekshëm nga viktimizimi.^[502]

Qëllimi i këtyre protestave ishte ngritja e zërit të minoriteteve etnike të prekshme nga viktimizimi dhe diskriminimi si rezultat i statusit të tyre si minoritet. Më tej, për të kufizuar një demonstratë, Shtetet duhet të konsiderojnë dëmet e shkaktuara nga moslejimi i mbajtjes së demonstratës dhe të konkludojnë që përfitimet e kufizimit të tubimit peshojnë më shumë se këto dëme. Kufizimet e protestave lidhur me kërcënimet ndaj jetës dhe rrezikut të trajtimit çnjerëzor dhe degradues të shkaktuar nga diskriminimi racor mund të kërkojë justifikim më të madh sepse protestat kanë të bëjnë me shkelje të mundshme të të drejtave të tjera të Konventës, përfshirë Nenet 2, 3 dhe 14. Disa protestues argumentuan, për shembull, që përmbajtja nga veprimet dhe tubimet përbënte më shumë rrezik për të drejtën e tyre për jetën dhe mbrojtjen nga trajtimi çnjerëzor dhe degradues sesa rreziku nga përhapja e Covid-19.

of-coronavirus "'Mos ta lëmë askënd prapa': Protestat për migrantët në kohën e koronavirusit", E. Wallis, Info Migrants, 6 prill 2020.

[502] *Bączkowski dhe të Tjerë k. Polonisë*, vendim i 3 majit 2007, Nr. 1543/06, § 64.

Zbatimi i kufizimit

Proporcionaliteti i zbatimit të masave dhe natyra dhe rreptësia e sanksioneve për pjesëmarrjen në një grumbullim ose demonstratë po ashtu duhet të merren parasysh gjatë vlerësimit të proporcionalitetit. Një demonstratë paqësore, në parim, nuk duhet të bëhet objekt i një sanksioni penal.^[503] Megjithatë, një gjobë prej 3 Euro për pjesëmarrje në demonstratë pa kërkuar autorizim është gjetur nga Gjykata që përbën dënim proporcional,^[504] e po ashtu edhe një gjobë e barasvlershme me 500 Euro për organizimin e një tubimi të paligjshëm në një zonë të ndjeshme të sigurisë.^[505] Megjithatë, gjobat ekstreme kërkojnë justifikim më të madh. Për shembull, futja nga Shqipëria e një gjobe të barasvlershme me 40,000 Euro për shkeljen e ndalimit për grumbullimet shoqërore, kulturore ose politike u kritikua nga organizatat e të drejtave të njeriut të cilat argumentojnë që dënimet janë joproporcionale.^[506] Për të justifikuar gjoba kaq të mëdha, Qeveritë do të kenë nevojë të tregojnë që masat më pak ndëshkuese nuk mund ta kishin përmbushur qëllimin e mbrojtjes së shëndetit aq efektivisht.

- [503] *Akgöl dhe Göl k. Turkey*, vendim i 17 majit 2011, Nr. 28495/06 and 28516/06, § 43; *Communauté genevoise d'action syndicale (CGAS) k. Zvicrës*, vendimi i 15 marsit 2022, Nr. 21881/20, § 91 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim). Megjithatë, kjo çështje iu referua Dhomës së Madhe më 5 shtator 2022, që do të thotë se ky vendim i këtij seksioni të Gjykatës nuk është përfundimtar dhe një vendim i ri përfundimtar i Dhomës së Madhe do të merret në lidhje me çështjen. Çdo person që shkeli me dashje ndalimin e tubimit në këtë rast mund të merret dënim me burg jo më shumë se tre vjet ose gjobë. Këto u vlerësuan të ishin dënime shumë të rrepta, të cilat me gjasë do të kishin efekt pengues tek pjesëmarrësit potencialë ose grupet që donin të organizonin ngjarje të tilla.
- [504] *Ziliberg k. Moldavisë*, vendimi për pranueshmërinë i 4 majit 2004, Nr. 61821/00.
- [505] *Rai dhe Evans k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi për pranueshmërinë i 17 nëntorit 2009, Nr. 26258/07 dhe 26255/07.
- [506] Shih <https://balkaninsight.com/2020/03/16/albania-mounts-millionaire-fines-against-covid-19/> "Shqipëria Miraton Gjoba Ndëshkuese për Shkelje të Kufizimeve të Koronavirusit", G. Erebara, Balkan Insight, 16 mars 2020.

10. Neni 3 i Protokollit Nr.1 - E drejta për të votuar

Kufizimet e caktuara mbi lëvizjen dhe tubimin e lirë gjatë pandemisë ndikuan tek mundësia e Shtetit për të mbajtur zgjedhje, dhe tek kapaciteti i kandidatëve për të zhvilluar fushata. Zgjedhjet u shtynë në tërë globin, përfshirë zgjedhje të përgjithshme, presidenciale, dhe lokale si dhe referendume nacionale.^[507] Neni 3 i Protokollit Nr. 1 (ang. A3P1) të Konventës mbron të drejtën për të votuar dhe të drejtën për të mbështetur zgjedhjet,^[508] ku parashikon:

"Palët e Larta Kontraktuese marrin përsipër të organizojnë në intervale të arsyeshme kohore, zgjedhje të lira me votim të fshehtë, në kushte që sigurojnë shprehjen e lirë të mendimit të popullit për zgjedhjen e organit ligjvënës."

a. Fushëveprimi i Nenit 3 të Protokollit Nr. 1

A3P1 ka lidhje me 'zgjedhjen e legjislaturës', që do të thotë se mbrojtjet e tij në përgjithësi nuk përfshijnë zgjedhjet lokale,^[509] referendumet,^[510] ose zgjedhjet presidenciale. Megjithatë, nuk është i kufizuar vetëm në legjislaturat nacionale, për shembull mund të mbulojë zgjedhjet për Parlamentin Evropian.^[511] Sipas kësaj

[507] Shih <https://www.coe.int/en/web/electoral-assistance/elecdata-covid-impact>; "Impakti i Covid-19 mbi zgjedhjet dhe referendumet në Evropë", Raport i Këshillit të Evropës, qershor 2020; <https://www.idea.int/news-media/multimedia-reports/global-overview-covid-19-impact-elections>; "Shikim Global i Covid-19: Impakti mbi zgjedhjet", Raport i International Idea, 18 mars 2020; <https://www.economist.com/graphic-detail/2020/08/17/the-pandemic-is-affecting-elections-around-the-world> "Pasqyra e ditës - Pandemia po ndikon në zgjedhjet anembanë botës", The Economist, 17 gusht 2020.

[508] *Mathieu-Mohin dhe Clerfayt k. Belgjikës*, vendim i 2 marsit 1987, Nr. 9267/81, §§ 48-51; *Ždanoka k. Letonisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 16 marsit 2006, Nr. 58278/00, § 102.

[509] Shih, në lidhje me zgjedhjet bashkiake: *Xuereb k. Maltës*, vendimi për pranueshmërinë i 16 qershorit 2000, Nr. 52492/99; *Salleras Linares k. Spanjës*, vendimi për pranueshmërinë i 12 tetorit 2000, Nr. 52226/99; dhe në lidhje me zgjedhjet rajonale: *Malarde k. Francës*, vendimi për pranueshmërinë i 15 shtatorit 2000, Nr. 46813/99.

[510] *Moochan dhe Gillon k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi për pranueshmërinë i 13 qershorit 2017, Nr. 22962/15 dhe 23345/15, § 40.

[511] *Matthews k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i Dhomës së Madhe i 18 shkurtit 1999, Nr. 24833/94, §§ 45-54; *Occhetto k. Italisë*, vendimi për pranueshmërinë i 12 nëntorit 2013, Nr. 14507/07, § 42.

dispozite, zgjedhjet për legjislaturë duhet të mbahen në 'intervale të rregullta' dhe të sigurojnë 'shprehjen e lirë të opinionit të popullit'.

Përcaktimi nëse zgjedhjet mbahen në intervale të arsyeshme duhet të bëhet duke pasur parasysh qëllimin e zgjedhjeve parlamentare, i cili është që të sigurohet që ndryshimet themelore në opinionin publik mbizotërues të pasqyrohen në opinionet e përfaqësuesve të popullit. Shtetet duhet të balancojnë nevojën për të lejuar Parlamentin që të funksionojë aq gjatë sa të zhvillojë dhe të ekzekutojë plane legjislative afatgjata (duke i mundësuar të zbatojnë vullnetin e elektoratit), duke siguruar ndërkohë që ligjvënësit të mos qëndrojnë në detyrë aq gjatë sa që nuk pasqyrojnë më vullnetin e elektoratit.^[512]

Prandaj, pandemia Covid-19 ndërhyri në A3P1 në dy aspekte:

- i) Shtyrja e rreziqeve të zgjedhjeve që i mundësojnë atyre që janë në pushtet të vazhdojnë mandatin e tyre në mënyrë jodemokratike për të qëndruar në pushtet kur nuk përfaqësojnë më vullnetin e popullit, në shkelje të së drejtës për të votuar dhe kriterit për të mbajtur zgjedhje në intervale të arsyeshme.
- ii) Mbajtja e zgjedhjeve gjatë pandemisë rrezikon kufizimin e kapacitetit të kandidatëve për të bërë fushatë, duke reduktuar numrin e votuesve si pasojë dhe për shkak të frikës së votuesve për sigurinë e tyre. Kjo potencialisht mund të dëmtojë legjitimitetin e legjislaturës së sapozgjedhur, duke dështuar të sigurojë 'shprehjen e lirë të opinionit të popullit'.^[513]

b. Ndërhyrjet e lejuara në të drejtën për të votuar

Ndryshe nga Nenet 8-11 të Konventës, A3P1 nuk përfshin një listë specifike të "qëllimeve legjitime", në vijim të të cilave e drejta për të votuar mund të kufizohet. Koncepti i "kufizimeve të nënkuptuara" është i aplikueshëm dhe Shtetet mund të mbështeten në qëllimet që nuk janë të renditura në Konventë për të justifikuar kufizimet në këtë të drejtë. Gjykata nuk aplikon testet e "nevojshmërisë" ose "nevojës shoqërore urgjente" gjatë vlerësimit nëse kufizimi është i justifikuar. Në vend të kësaj, çdo qëllim i synuar duhet të jetë në pajtueshmëri me parimin e

[512] *Timke k. Gjermanisë*, vendimi për pranueshmërinë i 11 shtatorit 1995, Nr. 27311/95.

[513] Shih <https://rm.coe.int/election-and-covid-19/16809e20fe> "Zgjedhjet dhe Covid-19", Rekomandimet e Këshillit të Evropës, 29 mars 2020.

sundimit të ligjit dhe objektivat e Konventës, dhe masa e marrë për të ndjekur këtë qëllim nuk duhet të jetë arbitrare ose joproportionale.

Qëllimi legjitim

Mbrojtja e shëndetit

Mbrojtja e shëndetit dhe sigurisë së votuesve, fushatëbërësve, dhe punonjësve të zgjedhjeve duke shtyrë zgjedhjet, për të limituar rrezikun e infektimit me Covid-19, kështu, ka gjasa të përbëjë arsye legjitime për të kufizuar të drejtën për të votuar.^[514] Rreziqet ndaj shëndetit mund të rrjedhin nga njerëz të shumtë që vijnë dhe punojnë në vendvotime, e madje edhe votat me postë mund të shkaktojnë shqetësime shëndetësore meqenëse ato duhet të merren në dorë, të hapen dhe të numërohen nga grupe të stafit.

Mbrojtja e shprehjes së lirë të vullnetit të popullit

Mbrojtja e shprehjes së lirë të vullnetit të popullit mund të përbëjë një tjetër arsye legjitime për të kufizuar të drejtën për të votuar gjatë pandemisë, kur rreziqet ndaj shëndetit janë të reduktuara. Shqetësimet rreth marrjes së virusit Covid-19 mund të ndikojnë në numrin e votuesve edhe nëse tubimi në grupe të mëdha në vendvotime lejohet zyrtarisht nga Shteti.^[515] Zgjedhjet mund të duhet

[514] Faza e parë e zgjedhjeve rajonale franceze u mbajt më 15 mars 2020, por faza e dytë, fillimisht e planifikuar për 22 mars 2020, u mbajt më 28 qershor 2020. Për një analizë ligjore interesante, shih https://www.lemonde.fr/idees/article/2020/03/19/municipales-le-maintien-des-elections-acquises-au-1er-tour-et-le-report-du-2nd-tour-en-juin-est-la-solution-la-plus-juste_6033697_3232.html "Municipales: « Le maintien des élections acquises au 1er tour et le report du 2nd tour en juin est la solution la plus juste »", profesori i të drejtës publike, Romain Rambaud, Le Monde, 19 mars 2020.

[515] Për shembull në Serbi zgjedhjet fillimisht u shtynë, por më pas u mbajtën më 21 qershor 2020, dhe ku pjesëmarrja në votime u vlerësua se ishte rreth 48%, rreth 8% ose 9% më e ulët sesa në zgjedhjet e mëparshme parlamentare: <https://balkaninsight.com/2020/06/25/ehy-everyone-lost-out-in-serbias-elections/> "Përse të Gjithë Humbën në Zgjedhjet e Serbisë", F. Bieber, Balkan Insight, 25qershor 2020. Më pas u ngritën pyetje rreth vendimit për të hequr kufizimet e mbylljes brenda para zgjedhjeve, kur masat e mbylljes brenda u futën sërish pas shtimit të rasteve: <https://balkaninsight.com/2020/07/08/serbia-rocked-by-violent-clashes-around-parliament/> "Serbia Tronditet nga Përlëshje të Dhunshme në Parlament", S. Dragojlo, Balkan Insight, 8 korrik 2020; shih gjithashtu në Francë ku pjesëmarrja në zgjedhje ishte më e ulëta në histori me rreth 46%, në krahasim me 63.5% në zgjedhjet lokale të vitit 2014. Pjesëmarrja e ulët iu atribua frikës së votuesve nga infektimi: <https://www.euronews.com/2020/03/15/france-voters-take-to-the-polls-amid-coronavirus-fears> "Rekorde të ulëta të

të shtyhen kur ekziston rreziku që rezultatet e zgjedhjeve mund të mos paraqesin si duhet pikëpamjet e elektoratit, nëse votuesit janë aq të shqetësuar për marrjen e Covid-19 saqë nuk dalin në votime.

Ligjshmëria

Kufizimet gjithashtu mund të vihen në përputhje me sundimin e ligjit, duke përfshirë në përputhje me procedurat në të drejtën vendase. Cilësia e procesit të vendimmarrjes para caktimit të vënies së kufizimit të së drejtës për të votuar është relevant për vendimin lidhur me justifikimin e tij. Kur Shteti mund të tregojë që legjislatura e tij ka marrë pjesë në një debat të konsideruar, duke peshuar interesat konkurruese të përshira para se të konkludojnë që duhet të futet ndalimi, ka më gjasa që të konsiderohet i justifikuar nga Gjykata.^[516]

Proporcionaliteti

Ndërkohë që Shtetet kanë hapësirë të gjerë vlerësimi për të përcaktuar qëllimin legjitim që përdoret për të justifikuar kufizimin e të drejtës për të votuar, Gjykata është më strikte në shqyrtimin e saj të proporcionalitetit të masave që ndërhyjnë në A3P1, posaçërisht kur masa ndikon në mundësinë për të votuar.^[517] Demokracia përbën element themelor të "Rendit publik evropian", dhe të drejtat e garantuara sipas A3P1 janë thelbësore në përcaktimin dhe ruajtjen e themeleve të një demokracie efektive dhe domethënëse të qeverisur nga sundimi i ligjit.^[518] Prandaj kufizimet në të drejtën për të votuar duhet të jenë të përkohshme, dhe zgjedhjet e shtyra për shkak të pandemisë duhet të mbahen sapo mbajtja e tyre të bëhet e sigurt.

pjesëmarrjes në votime në zgjedhjet bashkiake franceze në mesin e frikës së koronavirusit", Euronews, 16 mars 2020.

- [516] *Shih Shindler k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 7 majit 2013, Nr. 19840/09, § 117, ku Gjykata e gjeti të udhës që parlamenti kishte kërkuar më shumë se një herë të peshonte interesat konkurruese, dhe kishte debatuar me hollësi çështjen e të drejtave të votimit të jorezidentëve, dhe zhvillimi i opinioneve në parlament u pasqyrua në amendamentet në legjislacionin përkatës.
- [517] *Aziz k. Qipros*, vendim i 22 qershorit 2004, Nr. 69949/01, § 28; *Tănase k. Moldavisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 27 prillit 2010, Nr. 7/08, § 158.
- [518] *Shih Ždanoka k. Letonisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 16 marsit 2006, Nr. 58278/00, §§ 98 dhe 103; *Tănase k. Moldavisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 27 prillit 2010, Nr. 7/08, § 154.

c. E drejta për të marrë pjesë në fushatë zgjedhore

A3P1 gjithashtu përfshin të drejtën për të mbështetur zgjedhjet, përfshirë të drejtën për të zhvilluar fushatë zgjedhore. Pandemia Covid-19 ka vënë pengesa të shumta për zhvillimin e një fushate politike. Kufizimet e grumbullimeve dhe udhëtimeve nënkuptonin që teknikat tradicionale të fushatës si mbajtja e grumbullimeve, shkuarja derë më derë, dhe udhëtimet substanciale nuk ishin të mundura.

Gjykata më parë ka deklaruar që nuk ka pasur shkelje të A3P1 kur një politikan është ankuar që kushtet e arrestit të tij shtëpiak e kanë penguar atë nga pjesëmarrja e barabartë në zgjedhjet legjislativë. Gjykata gjeti që ai ishte në gjendje të bënte fushatë nga shtëpia e tij^[519] dhe ka një argument që evolucionin e metodave të bërjes së fushatës online do të thotë që fushata efektive mund të zhvillohej nga shtëpia e politikanit gjatë pandemisë. Megjithatë, në këtë rast ishte po ashtu relevante që anëtarët e partisë së kërkuesit kishin marrë pjesë në takime me votuesit personalisht, ku ai nuk ishte mundur, dhe arresti shtëpiak nuk e kishte penguar pjesëmarrjen e tij deri në atë pikë sa të ndikoheshin rezultatet finale të zgjedhjeve. Një situatë e tillë mund të dallojë nga konteksti i pandemisë Covid-19, kur kufizimet nganjëherë nënkuptonin që asnjë kandidat nuk mund t'i takonte votuesit personalisht, dhe kështu fushata të tëra u zhvilluan tërësisht online, potencialisht duke i penguar ata/ato nga shtrirja deri tek një numër substancial votuesish (sidomos ata që nuk dinë të përdorin teknologjinë informative). Organizimi i duhur i zgjedhjeve pati më shumë gjasa të ndikohej nga kufizimet, kriteri i garantimit të 'shprehjes së lirë të opinionit publik' pati më pak gjasa të arrihej, dhe A3P1 pati më shumë gjasa të shkelej.

E drejta për lirinë e shprehjes dhe e drejta për lirinë e tubimit janë të lidhura ngushtë me të drejtën për të marrë pjesë në një fushatë zgjedhore. Liria e shprehjes dhe takimet me elektoratin shihen si kusht i nevojshëm për të garantuar shprehjen e lirë të opinionit të popullit në zgjedhjen e legjislaturës, dhe është posaçërisht e rëndësishme në periudhën para zgjedhjeve që opinionet dhe informacionet e të gjitha llojeve të lejohen të qarkullojnë lirisht.^[520] Përveç kufizimeve të takimeve personale, vëmendja e mediave dhe diskutimet online u fokusuan së tepërmi mbi pandeminë. Kjo mund të ketë reduktuar kapacitetin e informacioneve dhe opinionëve lidhur me çështje të rëndësishme për zgjedhjet (përveç Covid-19) që

[519] *Uspaskich k. Lituanië*, vendim i 20 dhjetorit 2016, Nr. 14737/08.

[520] *Bowman k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 19 shkurtit 1998, Nr. 24839/94, § 42.

të qarkullojnë mjaftueshëm për të mundësuar që zgjedhjet që mbahen në mes të pandemisë të jenë të drejta dhe plotësisht të informuara.

Kjo mund t'i japë shkas një çështjeje tjetër sipas A3P1 nëqoftëse zgjedhjet mbahen u mbajtën pas një periudhe kur përfaqësuesit e partive në fuqi kanë dominuar mbulimin e medias për shkak se mbulimi i gjerë i është kushtuar diskutimit të reagimit të tyre ndaj pandemisë, në dëm të kohës së transmetimit vënë në dispozicion të kandidatëve.^[521] A3P1 nuk i garanton asnjë të drejtë një partie politike për të pasur kohë transmetimi në televizion ose radio gjatë një fushate zgjedhore, por mund të dalë problem kur një partie i mohohet e drejta për çdo lloj transmetimi, nëse partive të tjera u jepen këso të drejtash transmetuese.^[522]

d. Mbajtja e zgjedhjeve gjatë pandemisë

Nëqoftëse Shtetet vendosin të mbajnë zgjedhje ndërkohë që liria e lëvizjes dhe e tubimit janë të kufizuara^[523] dhe ndërkohë që diskutimet dhe debatet publike mbeten të dominuara nga një emergjencë si pandemia Covid-19, ato duhet të marrin masa specifike për të inkurajuar debatin e lirë publik para zgjedhjeve në mënyrë që votat të jenë të lira dhe të informuara. Kjo mund të përfshijë, për shembull, dhënien e më shumë të drejtave të transmetimit dhe më shumë mbulim në media për partitë opozitare ku mbulimi mediatik përndryshe dominohet nga ato që janë në pushtet.

Çdo metodë e re votimi duhet të planifikohet me kujdes dhe të futet në përdorim në përputhje me të drejtën vendase një kohë të mjaftueshme para zgjedhjeve në mënyrë që njerëzve të mos u mohohet e drejta për të votuar për shkak të problemeve praktike që dalin nga implementimi i një sistemi të ri. Votuesit/et gjithashtu duhet të vihen në dijeni për mënyrën e drejtë se si të

[521] Shqetësimet në Poloni rreth dominimit të presidentit në detyrë dhe kontrollit të mediave para zgjedhjeve: <https://www.institutmontaigne.org/en/blog/parliamentary-elections-poland-era-covid-19> "Zgjedhjet Presidenciale në Poloni në Epokën e Covid-19", R. Kravosky, Institute Montaigne, 18 qershor 2020.

[522] *Partija "Jaunie Demokrāti" dhe Partija "Mūsu Zeme" k. Letonisë*, vendimi për pranueshmërinë i 29 nëntorit 2007, Nr. 10547/07 34049/07.

[523] Shih seksionet mbi Nenin 2 të Protokollit Nr. 4 (E drejta për lirinë e lëvizjes, përfshirë hyrjen e daljen nga vendi i vet) dhe Nenin 5 (E drejta e lirisë) për diskutime të mëtejshme rreth kufizimeve të lëvizjes dhe tubimit, dhe seksionin mbi Nenin 11 (E drejta e lirisë së tubimit dhe organizimit) për diskutime të mëtejshme rreth kufizimit të tubimeve.

regjistrohen dhe të përdorin çdo sistem të ri votimi.^[524] Ndërkohë që Shtetet mund të mos jenë të detyruara të fusin një sistem për t'u siguruar mbajtjen e zgjedhjeve gjatë pandemisë, nëse vendosin ta bëjnë këtë atëherë kjo duhet bërë në mënyrë të atillë që të respektojë të drejtën e votimit për të gjithë; ekzistimi i pengesave organizative dhe kostove shtesë me gjasë nuk justifikon asnjë kufizim të të drejtës së votimit në këtë kontekst.^[525]

Ankesat në lidhje me zgjedhjet sipas Neneve 8 dhe 14

Duhet shënuar gjithashtu që ankesat në lidhje me zgjedhjet mund të bëhen sipas Neneve të tjera të Konventës, dhe që ankesa të tilla aplikohen në një gamë më të gjerë të zgjedhjeve përveç atyre që hyjnë brenda hapësirës së A3P1, përfshirë zgjedhjet rajonale dhe lokale. Për shembull, Gjykata ka gjetur më herët ndërhyrje në Nenin 8 kur vendvotimet nuk kanë qenë të gatshme për votuesit në karrige me rrota dhe ata nuk janë lejuar të marrin fletëvotimet jashtë qendrës.^[526] Neni 14 gjithashtu mund të aplikohet i marrë së bashku me Nenin 8 të A3P1 në rastet kur popullatat me status të caktuar privohen nga e drejta e tyre për të votuar. Prandaj, Shtetet duhet të marrin masa të veçanta administrative për t'u siguruar që çdo sistemet e reja të votimit të futura gjatë pandemisë të krijojnë mundësi për ata që janë veçanërisht të cenueshëm, dhe të cilët mund të vazhdojnë të ruhen në shtëpi ndërkohë që të tjerëve u hiqen kufizimet e lëvizjes. Futja e votimit elektronik mund të ndihmojë në këtë aspekt.^[527]

[524] *Shih Partija "Jaunie Demokrati" dhe Partija "Mūsu Zeme" k. Letonisë*, vendimi për pranueshmërinë i 29 nëntorit 2007, Nr. 10547/07 3 4049/07; gjetja e Gjykatës Supreme të Polonisë që ligji i ri zgjedhor i prezantuar në parlament ishte i paligjshëm sepse ai do ta transformonte Postën e Polonisë në një organ zgjedhor pa asnjë garanci që votat do të numëroheshin në mënyrë efektive, nuk ishte e qartë se si qytetarët do t'i vendosnin fletëvotimet në kutitë e votimit, dhe nuk kishte procedurë se si të veprohej nëse votat humbisnin etj.

[525] *Shih Riza dhe të Tjerë k. Bullgarisë*, vendim i 13 tetorit 2015, Nr. 48555/10 dhe 48377/10, ku, pavarësisht nga fakti që organizimi i zgjedhjeve të reja në një vend tjetër sovran mund të shkaktojë pengesa të mëdha diplomatike ose organizative dhe kosto shtesë, dështimi për ta bërë këtë sidoqoftë ka përbërë shkelje të A3P1.

[526] *Móta k. Polonisë*, vendimi për pranueshmërinë i 11 prillit 2006, Nr. 56550/00.

[527] Shih <https://rm.coe.int/election-and-covid-19/16809e20fe> "Zgjedhjet dhe Covid-19", Rekomandimet e Këshillit të Evropës, 29 mars 2020.

11. Neni 2 i Protokollit Nr. 1 - E drejta për arsimim

Si reagim emergjent ndaj pandemisë Covid-19, Shtetet fizikisht mbyllën shkollat, universitetet dhe institucionet e aftësimit dhe morën masa në përpjekje për të realizuar shkollimin në distancë. Përdorimi inovativ nga Shtetet i teknologjisë ndihmoi mbrojtjen e të drejtës për arsim për shumë nxënës dhe studentë, së paku deri në njëfarë mase, por ofroi qasje më pak efektive arsimit për ata që nuk kishin në dispozicion infrastrukturën e duhur dixhitale ose shkathtësitë e duhura teknike.

Edhe kur teknologjia ishte në dispozicion, qasja në arsim u kufizua në mënyra të tjera. Për shembull, disa nxënës patën reduktime ose vonesa në ofrimin e mësimin dhe/ose detyrat e shtëpisë, dhe morën komente kthyes minimale lidhur me punën që kryen, ndërkohë që ndërveprimet direkte me mësuesit dhe shokët/shoqet e klasës qenë të limituara ose nuk ndodhën fare. E drejta e arsimit mbrohet sipas Nenit 2 të Protokollit Nr. 1 (ang. A2P1). Pjesa e parë e A2P1 thotë:

“Askujt nuk i mohohet e drejta për arsimim.”

a. Fushëveprimi i Neni 2 të Protokollit Nr. 1

E drejta për arsimim u ofron individëve të drejtën për të pasur qasje efektive në institucionet arsimore që ekzistojnë.^[528] Ajo nuk kërkon që Shtetet të ngrenë institucione të reja, të krijojnë sistem të arsimit publik ose të subvencionojnë shkollat private,^[529] por Shtetet nuk mund të mohojnë të drejtën për arsimim në institucionet arsimore që kanë zgjedhur të ngrenë ose të autorizojnë. A2P1 ka të bëjë me arsimin fillor, sekondar dhe të lartë, kurse të specializuara dhe aftësim

[528] *Şahin k. Turqisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 20 tetorit 2011, Nr. 13279/05 §§ 136-137; Çështja Gjuhësore e Belgjikës, vendim i 23 korrikut 1968, Nr. 1474/62, 1677/62, 1691/62, 1769/63, 1994/63 dhe 2126/64, §§ 3-4.

[529] Çështja Gjuhësore e Belgjikës, vendim i 23 korrikut 1968, Nr. 1474/62, 1677/62, 1691/62, 1769/63, 1994/63 dhe 2126/64.

profesional,^[530] kështu që nga kjo e drejtë përfitojnë të rriturit dhe fëmijët^[531]. Shteti është përgjegjës për shkollat publike dhe private^[532] dhe nuk mund të delegojë detyrimet e tij për të siguruar të drejtën e arsimit në institucione ose individë privatë. Gjithashtu, Shtetet kanë për detyrë të mbrojnë nxënësit si në shkolla shtetërore ashtu edhe në ato private nga keqtrajtimi.^[533]

b. Ndërhyrjet e lejuara në të drejtën për arsimim

A2P1 nuk përmban një listë shteruese arsyeshe për të cilat e drejta për arsimim mund të kufizohet. Megjithatë, e drejta nuk është absolute. Nga vetë natyra ajo kërkon rregullim nga Shteti^[534] dhe mund të kufizohet nga limitime që pranohen në mënyrë të nënkuptuar. Çdo kufizim megjithatë duhet të jetë i parashikueshëm për palët e interesuara, të synojë një qëllim legjitim, dhe duhet të ketë marrëdhënie proporcionale mes mënyrës së përdorur dhe qëllimit që synohet të arrihet.^[535]

Qëllimi legjitim

Gjykata ka pranuar që mbrojtja e shëndetit të fëmijëve dhe mësuesve në shkollë nga përhapja e një sëmundjeje ngjitëse është qëllim legjitim në synim të të cilit e drejta për arsimim mund të kufizohet.^[536] Prandaj mbyllja në shkollë të gjerë e institucioneve arsimore për të mbrojtur stafin dhe nxënësit/studentët për parandalimin e përhapjes së Covid-19 me gjasë vlerësohet se synon qëllimin legjitim të mbrojtjes së shëndetit.

[530] *Sulak k. Turqisë*, vendim për pranueshmërinë i 17 janarit 1996, Nr. 24515/94; *Cyprus k. Turqisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 10 majit 2001, Nr. 25781/94, § 278; *Leyla Şahin k. Turqisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 10 nëntorit 2005, Nr. 44774/98, § 141.

[531] *Velyo Velev k. Bullgarisë*, vendim i 27 majit 2014, Nr. 16032/07.

[532] *Kjeldsen, Busk Madsen dhe Pedersen k. Danimarkës*, vendim i 7 dhjetorit 1976, Nr. 5095/71, 5920/72 dhe 5926/72.

[533] *O'Keefe k. Irlandës*, vendim i Dhomës së Madhe i 28 janarit 2014, Nr. 35810/09, §§ 144-152.

[534] Çështja Cjuhësore e Belgjikës, vendim i 23 korrikut 1968, Nr. 1474/62, 1677/62, 1691/62, 1769/63, 1994/63 dhe 2126/64, § 5; *Golder k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 21 shkurtit 1975, Nr. 4451/70, § 38; *Fayed k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 21 shtatorit 1994, Nr. 17101/90, § 65.

[535] *Leyla Şahin k. Turqisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 10 nëntorit 2005, Nr. 44774/98.

[536] *Memlika k. Greqisë*, vendim i 6 tetorit 2015, Nr. 37991/12.

Proporcionaliteti

Për të siguruar proporcionalitetin mes mbrojtjes së shëndetit dhe masave të marra për këtë qëllim, autoritetet duhet të veprojnë me zell dhe menjëherë për të siguruar që masat që janë veçanërisht strikte dhe të vështira (për shembull të ndaluarit e nxënësve për të shkuar në shkollë) të mbahen vetëm për sa kohë që duhet pa tjetër për të arritur qëllimin e dëshiruar. Masat duhet të hiqen sapo të pushojnë së ekzistuari arsytet për të cilat janë marrë.^[537] Prandaj, Shteteve iu desh të monitoronin nga afër rrezikun e marrjes së Covid-19 që u kanosej fëmijëve dhe stafit nëse shkollat rihapeshin, për të siguruar që shkollat të rihapeshin sapo hapja të ishte e sigurt. Ndërkohë që niveli i rrezikut bie, Shtetet duhet të vlerësojnë nëse mund të merren masa të tjera, më pak restriktive, për mbrojtjen e nxënësve/studentëve dhe mësuesve, për shembull gjetja e masave të reja të distancimit social në klasa ose kthimi i shkallëzuar në shkollë ku gjysma e klasës vjen në shkollë një ditë dhe gjysma tjetër ditën tjetër.

E drejta për arsimim shihet nga Gjykata si e domosdoshme për zhvillimin e të drejtave të njeriut, dhe çdo kufizim i kësaj të drejte duhet të mos e shkurtojë këtë të drejtë deri aty sa të dëmtojë vetë thelbin e saj dhe ta privojë atë nga efektiviteti i saj.^[538] Vendimet e Shteteve për të mbyllur institucionet arsimore dhe për të futur në punë sistemet e mësimin në distancë mund të kenë ndihmuar për të mbrojtur të drejtën për arsimim për shumë njerëz, në shkallën më të lartë të mundshme në kontekstin e pandemisë. Megjithatë, mbështetja tek zgjidhjet e natyrës dixhitale për të zbatuar efektisht ato masa bëri që e drejta për arsimim të mos ishte e garantuar për ata që nuk kishin qasje në infrastrukturën dixhitale që kërkohej për të përfutur si duhet nga mësimi në distancë. Kur një nxënës/student nuk ka kompjuter ose internet, të cilat duhen për t'u përfshirë në mësim në distancë, ose nëse atyre iu mungojnë njohuritë e teknologjisë informative për të marrë pjesë, kjo shkurton të drejtën e tyre për arsimim në masë të atillë sa që e drejta privohet nga çdo efektivitet ose esencë. Ky pozicion është analog me mosofrimin e arsimimit në gjuhën që flet fëmija^[539] dhe Shtetet duhet të konsiderojnë

[537] *Shih Memlika k. Greqisë*, vendim i 6 tetorit 2015, Nr. 37991/12, ku shkolla në fjalë i ndaloi fëmijët e diagnostikuar gabimisht me leprozë që të ktheheshin në shkollë. Gjykata gjeti që shkolla kishte synuar një qëllim legjitim për të mbrojtur shëndetin e fëmijëve dhe mësuesve nga përhapja e sëmundjes. Megjithatë, vonesa në ripranimin e fëmijëve në shkollë (pasi u zbulua që diagnoza ishte e gabuar) shkeli A2P1, sepse masa nuk ishte proporcionale me qëllimin e synuar dhe autoritetet nuk kishin vepruar me zell ose shpejtësi.

[538] *Leyla Şahin k. Turqisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 10 nëntorit 2005, Nr. 44774/98, § 154.

[539] Çështja Gjuhësore e Belgjikës, vendim i 23 korrikut 1968, Nr. 1474/62, 1677/62, 1691/62, 1769/63, 1994/63 dhe

nëse mund të ofrojnë burime për të ndihmuar ata që nuk kanë mundësi për qasje në sistemin e arsimit që i ofrohet popullatës në tërësi.^[540]

c. Diskriminimi dhe lidhja mes Nenit 14 dhe Nenit 2 të Protokollit Nr. 1

Mbështetja e gjerë në zgjidhjet dixhitale në distancë po ashtu mund t'i japë shkas një çështjeje të ngritur sipas Nenit 14 në lidhje me A2P1. Universaliteti dhe mosdiskriminimi janë parime themelore kur përcaktohet se si do t'i zhvillojnë detyrat e tyre Shtetet sipas A2P1. Arsimi duhet të jetë përfshirës, dhe në kontekstin e nxënësve/studentëve me paaftësi, Shtetet kanë detyrimin për të bërë organizimet e nevojshme dhe të duhura për mënyrën se si ofrohet arsimi, të përmirësojnë pabarazitë faktike të cilat janë të pajustificuara e rrjedhimisht përbëjnë diskriminim.^[541] Këshilli i Evropës ka njohur faktin që masat e jashtëzakonshme të marra sot në kuadër të luftës kundër përhapjes së virusit me gjasë do të ngrenë pyetje në lidhje me pasojat e tyre potenciale diskriminuese.^[542] Një prej sfidave madhore ka qenë çështja e garantimit të përfshirjes dhe qasjes së barabartë në mundësitë për mësim në distancë.^[543]

Kur arsimi ofrohet kryesisht përmes platformave dixhitale, kjo mund të ketë impakt diskriminues mbi të drejtën për qasje në arsim për personat me paaftësi dhe nevoja arsimore të veçanta^[544], si dhe për grupet me disavantazhe

2126/64.

[540] Shih, për shembull, letrën e shkruar nga Good Law Project për Sekretarin e Shtetit për Arsim në Mbretërinë e Bashkuar, ku parashtron argumentet e tij. Sekretari i Shtetit më pas lajmëroi që disa grupeve të fëmijëve në disavantazh do t'u jepeshin laptopë ose tableta falas, dhe lidhje interneti 4G për të pasur qasje në mësimin online. Shih <https://www.dropbox.com/s/2gscecp99josic2/GLPtoGavinWilliamson.pdf?dl=0> "Koronavirusi dhe Qasja në Arsimin", Letër e Good Law Project drejtuar Sekretarit të Shtetit për Arsim në Mbretërinë e Bashkuar, 9 prill 2020.

[541] *Çam k. Turqisë*, vendim i 23 shkurtit 2016, Nr. 51500/08, § 64; *Sanlısoy k. Turqisë*, vendimi për pranueshmërinë i 8 nëntorit 2016, Nr. 77023/12, § 59.

[542] Shih <https://rm.coe.int/sg-inf-2020-11-respecting-democracy-rule-of-law-and-human-rights-in-th/16809e1d91> "Respekti për demokracinë, sundimin e ligjit dhe të drejtat e njeriut në kuadër të krizës sanitare të Covid-19: instrumente për shtetet anëtare", Dokumentet e Informacionit të Këshillit të Evropës, 7 prill 2020.

[543] Shih <https://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-8610-2020-INIT/en/pdf> "Konkluzionet e Këshillit rreth përballimit të krizës së Covid-19 në arsim dhe aftësim", Konkluzionet e Këshillit të Bashkimit Evropian, 16 qershor 2020.

[544] Për shembull, në dhjetor 2020, Gjykata Kushtetuese e Sllovenisë suspendoi ekzekutimin e një dekreti që ndalonte

socio-ekonomike dhe ata që jetojnë në zona rurale ose të mbipopulluara. Nxënësit me disavantazhe socio-ekonomike ka më shumë gjasa të jetojnë në një ambient shtëpiak jo të përshtatshëm për mësim në shtëpi,^[545] e më pak gjasa të kenë qasje në teknologji siç është laptopi, dhe mund të kenë vetëm një pajisje elektronike që përdoret nga tërë familja. Ata mund të mos kenë qasje në internet me shpejtësi të mjaftueshme, ose mund të mos kenë internet fare. Këto probleme janë posaçërisht akute në rajonin e Ballkanit Perëndimor, ku nxënësit kanë më pak qasje në laptopë dhe lidhje interneti të shpejta sesa bashkëmoshatarët e tyre në BE.^[546] Më tej, mësuesit, nxënësit/studentët dhe prindërit që i mbështesin ata me mësimin në shtëpi mund të mos kenë shkathtësitë e duhura të teknologjisë informative për t'u angazhuar në kurset online, edhe nëse i kanë pajisjet.^[547]

përkohësisht mbledhitë në ngrehina arsimore për fëmijët me nevoja edukative të veçanta dhe urdhëroi qeverinë të rihapte shkollat e veçanta edukative deri më 4 janar 2021 më së voni. Kërkesuit, nxënës me nevoja arsimore të veçanta, të përfaqësuar nga prindërit e tyre, argumentuan se ndalimi i mbledhjeve në institucione arsimore, dhe ofrimi vetëm i shërbimeve edukative online, shkeli të drejtat e tyre për arsim dhe liri nga diskriminimi, meqenëse ata nuk kishte qasje në asistencë të veçantë, përfshirë për shembull fizioterapinë, terapinë e punës, terapitë në pishinë, qasjen e individualizuar dhe trajtimin psikologjik, gjëra që prindërit nuk mund t'ua ofronin. Gjykata Kushtetuese gjeti, duke marrë parasysh ekspertizën shkencore, që shkolla të tilla nuk kontribuonin substancialisht në parandalimin e përhapjes së Covid-19, duke pasur parasysh numrin e vogël të fëmijëve që vijonin këto shkolla, kështu që nuk mund të justifikonin ndërhyrjen tek të drejtat e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore (shih Ustavno sodišče Republike Slovenije, vendim i 21 dhjetorit 2020, U-I-473/20-14).

[545] Shih <https://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-8610-2020-INIT/en/pdf> "Konkluzionet e Këshillit rreth përballimit të krizës së Covid-19 në arsim dhe aftësim", Konkluzionet e Këshillit të Bashkimit Evropian, 16 qershor 2020.

[546] Shih <http://documents1.worldbank.org/curated/en/590751590682058272/pdf/The-Economic-and-Social-Impact-of-COVID-19-Education.pdf> "Impakti Ekonomik dhe Social i Covid-19", Raport i Bankës Botërore, pranverë 2020, i cili gjen që, mesatarisht në Ballkanin Perëndimor, rreth 60% e familjeve kanë internet me shpejtësi të mjaftueshme (definiuar si 10 mbps dhe më lart) për të ndjekur mësimin online. 10 mbps është më e ulët sesa standardi i pranueshëm në BE (30 mbps), duke përdorur kutin matës të BE-së, shumica e familjeve në rajon nuk janë të pajisura me internet me shpejtësi të madhe. Rreth 22% e nxënësve të Ballkanit Perëndimor raportojnë se kanë pak ose aspak qasje në internet në shtëpi, në krahasim me 1% në BE27. Mesatarisht, një në dhjetë familje me nxënës në shtëpi në Ballkanin Perëndimor nuk kanë kompjuter; në Shqipëri kjo shkon deri në 28%.

[547] Shih <https://ec.europa.eu/digital-single-market/en/news/survey-schools-ict-education> "Sondazh në shkolla: TIK-u në arsim", Raport i Komisionit Evropian, 8 mars 2020, ku u gjet se 6 nga 10 nxënës evropianë mësohen nga mësues që zhvillojnë shkathtësitë e tyre të TIK-ut gjatë kohës së tyre të lirë.

Shtetet në Ballkanin Perëndimor u përpoqën t'i tejkalonin problemet me lidhjet e internetit duke transmetuar mësimet e regjistruara përpara në televizionin kombëtar, në të cilin ka qasje një përqindje shumë më e madhe e popullsisë. Megjithatë, për të ofruar mësimet televizive në masë, lëndët e shtjelluara dhe koha e mësimi u shkurtuan në mënyrë të konsiderueshme,^[548] që do të thotë se e drejta për arsimim për nxënësit që mbështeteshin në televizion ishte më pak e mbrojtur efektivisht sesa për ata që kishin infrastrukturën e duhur dixhitale dhe shkathhtësitë e teknologjisë informative.

Mbyllja e shkollave po ashtu shkoi në disavantazh të nxënësve/studentëve me paaftësi në të nxënë, të cilët mund të kenë nevojë për këshillim dhe përkrahje shtesë gjatë mësimi dhe për të cilët transmetimi masiv i mësimëve në televizion nuk mund të përshtatet si duhet. Ndërkohë që ndërveprimi direkt me mësuesit dhe punonjësit përkrahës është i kufizuar, nxënësit që nuk jetojnë me prindër ose kujdestarë të cilët mund t'i përkrahin me mësimin në distancë po ashtu janë në disavantazh në krahasim me ata që përfitojnë nga këshillat dhe përkrahja që jepet nga njerëzit në shtëpi.

Detyrimi për të bërë përshtatjet e arsyeshme

Shtetet kanë për detyrim të jenë "veçanërisht të vëmendshëm" ndaj impaktit të zgjedhjeve të tyre për ofrimin e arsimit mbi të drejtën për arsimim të personave më të prekshëm.^[549] Prandaj, Shtetet duhet të bëjnë kujdes të veçantë për t'u siguruar që anëtarët e grupeve të prekshme të vazhdojnë të përfitojnë nga e drejta për arsimim dhe të kenë qasje të barabartë në mjete dhe materiale arsimore edhe gjatë kohës së kufizimeve fizike. Megjithatë, kjo nuk barazohet domosdoshmërisht me detyrimin pozitiv për të bërë përshtatje për të adresuar ndonjë impakt diskriminues që mund të identifikohet. Në mënyrë që dallimet në trajtim të mos shihen si diskriminuese, ato duhet të kenë qëllim legjitim dhe të jenë proporcionale. Gjykata e ka pranuar që mungesa e fondeve ose burimeve publike mund të përbëjë arsye legjitime për të justifikuar dështimin në bërjen e përshtatjeve.^[550] Edhe kur identifikohet diskriminim në të drejtën për arsimim,

[548] Shih <http://documents1.worldbank.org/curated/en/590751590682058272/pdf/The-Economic-and-Social-Impact-of-COVID-19-Education.pdf> "Impakti Ekonomik dhe Social i Covid-19", Raport i Bankës Botërore, pranverë 2020.

[549] *Enver Şahin k. Turqisë*, vendim i 30 janarit 2018, Nr. 23065/12, § 68.

[550] *Shih McIntyre k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi për pranueshmërinë i 21 tetorit 1998, Nr. 29046/95, ku përdorimi i fondeve dhe burimeve publike gjithashtu çoi në konkluzionin që dështimi për të instaluar një asensor

Shtetet duhet të bëjnë përshtatje të arsyeshme deri në masën që ato nuk imponojnë një barrë joproporcionale ose të panevojshme për Shtetin.^[551]

Në rastet kur Gjykata ka gjetur shkelje të A2P1 në lidhje me Nenin 14, autoritetet në asnjë moment nuk ishin përpjekur të identifikonin nevojat e kërkuesit apo qoftë edhe të merrnin në konsideratë akomodim të veçantë për të përmbushur nevojat e veçanta arsimore.^[552] Shtetet e Ballkanit Perëndimor kanë marrë masa të shumta për të lehtësuar deri diku impaktin potencialisht diskriminues të daljes në mësimin në distancë.^[553]

Masa të tilla tregojnë që Shtetet i 'kanë kushtuar vëmendje' impaktit mbi personat më të prekshëm në shoqëri të masave të marra për mësimin në distancë. Në vazhdimësi, ato duhet të vazhdojnë të marrin parasysh impaktin mbi komunitetet e prekshme apo më të dobëta të dixhitalizimit të sistemeve arsimore, gjë që me gjasë do të vazhdojë përtej kontekstit të pandemisë Covid-19, dhe të marrin masa për ta bërë arsimin dixhital gjithëpërfshirës, aty ku është e mundur në aspektin financiar dhe administrativ.

në një shkollë fillore për hir të një nxënësi që vuante nga distrofia muskulare nuk përbënte shkelje të Nenit 2 të Protokollit Nr. 1, pavarësisht nëse merrej vetëm apo së bashku me Nenin 14 të Konventës.

[551] Çam k. Turqisë, vendim i 23 shkurtit 2016, Nr. 51500/08, § 64; *Sanlısoy k. Turqisë*, vendimi për pranueshmërinë i 8 nëntorit 2016, Nr. 77023/12, § 59.

[552] Çam k. Turqisë, vendim i 23 shkurtit 2016, Nr. 51500/08.

[553] Për shembull, në Maqedoninë e Veriut, Ministria e Arsimit bashkëpunoi me UNICEF-in, donatorët dhe kompanitë private për të zgjeruar mundësitë për mësimin online: <https://www.worldbank.org/en/topic/edutech/brief/how-countries-are-using-edtech-to-support-remote-learning-during-the-covid-19-pandemic>; "Si po e përdorin vende të ndryshme teknologjinë arsimore (edtech) për të mbështetur mësimin në distancë gjatë pandemisë Covid-19", Përmbledhje e Bankës Botërore. Mali i Zi mori në konsideratë një marrëveshje me operatorët e telekomit për të ofruar dataplane të pakufizuara për nxënësit që kanë më pak qasje në internet; në Bosnje-Hercegovinë u ofrua mbështetje për fëmijët refugjatë dhe migrantë në qendrat e përkohshme të pritjes: <https://news.un.org/en/story/2020/04/1060982> "Covid-19: nga konflikti në pandemi, migrantët në Bosnje përballesh me sfida të reja", OKB, 3 prill 2020.

12. Neni 1 i Protokollit Nr.1 - E drejta e pronës

Masat e mbylljes brenda në shtëpi që janë marrë për të luftuar përhapjen e Covid-19 kanë sjellë mbylljen e kafeneve, dyqaneve, restoranteve, bareve, dhe bizneseve në të gjitha industritë e argëtimit, sportit dhe kohës së lirë. Ngjarjet kulturore dhe sportive u pezulluan dhe, në një moment të caktuar gjatë pandemisë, vetëm dyqanet e ushqimeve, farmacitë, zyrat e postës dhe bankat qëndruan të hapura^[554]. Bizneset që mbetën të hapura gjithashtu u detyruan të ndryshonin mënyrën e operimit. Prandaj u angazhua e drejta e pronës e mbrojtur sipas Nenet 1 të Protokollit Nr. 1 (ang. A1P1) të Konventës. A1P1 parashikon:

"1. Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

2. Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk çenojnë të drejtën e Shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera."

Për të përfituar nga mbrojtja e A1P1, kërkuesi së pari duhet të konstatojë që një masë ndërhyrës tek një e drejtë e pronës, d.m.th. 'gëzimi i pasurisë së tij'. Në pajtim me qasjen e saj tradicionale të tri rregullave,^[555] Gjykata më pas shqyrton nëse ndërhyrja përbën:

- (a) Privim të pronës;
- (b) Kontroll mbi përdorimin e pronës në fjalë; ose
- (c) Ndërhyrje në parimin e përgjithshëm të respektit për gëzimin paqësor të pasurive.

[554] Shih <http://www.oecd.org/coronavirus/policy-responses/covid-19-crisis-response-in-south-east-european-economies-c1aacb5a/> "Reagimet ndaj krizës së Covid-19 në ekonominë e Evropës Juglindore", Reagimet e OECD-së kundër koronavirusit (Covid-19), 15 prill 2020.

[555] *Sporrong dhe Lönnroth k. Suedisë*, vendim plenar i Gjykatës i 18 dhjetorit 1984, Nr. 7151/75 dhe 7152/75.

Pavarësisht se cilës prej kategorive të mësipërme i përket ndërhyrja, për të qenë në pajtueshmëri me A1P1 ndërhyrja tek një e drejtë duhet t'i shërbeje interesit publik, të jetë në përputhje me kushtet e parashikuara në ligj, dhe të gjejë një ekuilibër të drejtë mes të drejtës së pronës dhe interesit publik të cilit i shërben. Katëgorizimi i mësipërm është i rëndësishëm sepse ai ndikon tek mënyra se si zhvillohet ekuilibri i drejtë / proporcionaliteti, te faktorët që merren në konsideratë, dhe pesha që i jepet atyre. Për shembull, privimi i pasurive përmban pothuajse të drejtën automatike për pagimin e kompensimit^[556], ndërsa kontrolli i përdorimit të pronës mund të kërkojë kompensim, por jo zakonisht.^[557]

a. Gëzimi paqësor i pasurive

Koncepti i "pasurisë" është koncept autonom, dhe fakti që ligjet vendase të një Shteti nuk e njohin një interes të veçantë si "e drejtë" apo qoftë edhe "e drejtë e pronës" nuk e ndalon domosdoshmërisht interesin në fjalë nga të konsideruarit si "pasuri" brenda kuptimit të A1P1.^[558] Licenca për të zhvilluar biznes^[559] dhe klientela e një biznesi profesional janë të dyja shembuj të interesave që janë gjetur se përbëjnë "pasuri" sipas A1P1.^[560]

b. Natyra e ndërhyrjes

Privimi i pronës

Në përgjithësi, Gjykata shqyrton një ankesë si privim i pronës vetëm kur ka pasur përvetësim të hapur të pronës nga Shteti, kur të drejtat e pronës së kërkuesit janë shuar nga operimi i ligjit.^[561] Në rrethana të caktuara një masë po ashtu mund të njihet si privim de facto i pronës, kur impakti i disa masave mbi pasurinë e

[556] *Pincová dhe Pinc v Republikës Çeke*, vendim i 5 nëntorit 2002, Nr. 36548/97; Gjykata gjithashtu ka thënë se shumica e kompensimit e dhënë për pronën e marrë nga Shteti të jetë "me arsye e ndërlidhur" me vlerën e saj në *Bronioëski k. Polonisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 22 qershorit 2004, Nr.31443/96, § 186.

[557] *Banér k. Suedisë*, vendimi për pranueshmërinë i 9 marsit 1989, Nr. 11763/85.

[558] *Depalle k. Francës*, vendim i Dhomës së Madhe i 29 marsit 2010, Nr.34044/02, § 68.

[559] *Megadat.com SRL k. Moldavisë*, vendim me shpërblim të drejtë - fshirje i 17 majit 2011, Nr. 21151/04, §§ 62-63; *Bimer S.A. k. Moldavisë*, vendim i 10 korrikut 2007, Nr. 15084/03, § 49.

[560] *Könyv-Tár Kft dhe të Tjerë k. Hungarisë*, vendim i 16 tetorit 2018, Nr. 21623/13, §§ 31-32.

[561] Për shembull, një dispozitë statusore që automatikisht ia jepte posedimin dhe përdorimin e pronës në fjalë Shtetit, me efektin që pronësia e plotë e tokës iu transferua *Shtetit në Mastiret e Shenjta k. Greqisë*, vendim i 9 dhjetorit 1994, Nr. 13092/87 dhe 13984/88, §§ 60-61.

kërkuesit është kaç i thellë sa i bën ato të asimilueshme nga përvetësimi dhe përbën shkatërrim të të drejtave të pronës.^[562]

Kontrolli i përdorimit të pronës

Masat më pak invazive se përvetësimi mund të kualifikohen nga Gjykata si "kontroll i përdorimit të pronës". Ky koncept qarkon një sërë masash, përfshirë tërheqjen ose ndryshimin e kushteve të licencës që ndikon në zhvillimin e biznesit,^[563] sistemet e kontrollit të qirave,^[564] dhe pezullimin statusor të zbatimit të urdhrave për riposëdim në lidhje me qiramarrësit që kanë pushuar së paguari qiranë.^[565] Një masë që kërkon therjen e bagëtive të infektuara me brucelozë për të parandaluar përhapjen e sëmundjeve të kafshëve po ashtu është deklaruar se përbën "kontroll të përdorimit".^[566]

Ndërhyrja e përgjithshme

Nëse masat që prekin të drejtat e kërkuesit nuk mund të kualifikohen si privim ose kontroll i përdorimit të pronës, Gjykata shqyrton nëse faktet e çështjes mund të interpretohen si ndërhyrje në parimin e përgjithshëm të respektit për gëzimin paqësor të pasurisë.^[567] Për shembull, mohimi i vazhdueshëm i qasjes në pronë e dikujt kur ajo efektivisht e ka humbur kontrollin mbi të, si dhe e të gjitha mundësive për të përdorur dhe gëzuar pasurinë, por ku ajo ka mbetur pronarja e ligjshme, kanë përbërë ndërhyrje në gëzimin paqësor të pasurisë.^[568]

[562] Për shembull, *Papamichalopoulos k. Greqisë*, vendim i 24 qershorit 1993, Nr. 14556/89, §§ 44-46, kur marina mori në posedim tokën e kërkuesve për të ngritur një bazë detare, që do të thotë se kërkuesit nuk patën mundësi qasjeje në pronën e tyre ose për ta shitur, hipotekuar apo për ta dhuruar, kjo përfshiu pasoja të mjaftueshme de facto për Gjykatën që të konsideronte se kërkuesit ishin shpronësuar, edhe në mungesë të një vendimi zyrtar për shpronësim.

[563] *Tre Traktörer Aktiebolag k. Suedisë*, vendim i 7 korrikut 1989, Nr. 10873/84, § 55.

[564] *Mellacher dhe të Tjerë k. Austrisë*, vendim i Gjykatës plenare i 19 dhjetorit 1989 Nr. 10522/83, 11011/84, dhe 11070/84, § 44; *Hutten-Czapska k. Polonisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 19 June 2006, Nr. 35014/97, §§ 54, 160.

[565] *Immobiliare Saffi k. Italisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 28 korrikut 1999, Nr. 22774/93, § 46.

[566] *SA Bio d'Ardenne k. Belgjikës*, vendim i 12 nëntorit 2019, Nr. 44457/11.

[567] *Đokić k. Bosnje-Hercegovinës*, vendim i 27 majit 2010, Nr. 6518/04, §§ 55-56.

[568] *Loizidou k. Turqisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 18 dhjetorit 1996, Nr. 15318/89, §§ 61-64.

Kategorizimi i masave të marra në reagim ndaj pandemisë Covid-19

Mbi bazën e parimeve të cekura më lart, mbylljet ose kufizimet e përkohshme të operimit të bizneseve për të parandaluar përhapjen e Covid-19 ka më shumë gjasa të shihen si kontroll i përdorimit (ose potencialisht ndërhyrje e përgjithshme në gëzimin paqësor të pasurisë), sesa privim i pronës. E njëjta gjë vlen edhe për masat e marra për të mbrojtur njerëzit nga impakti ekonomik i pandemisë, për shembull pengimi i nxjerrjes jashtë nga banesa të atyre që kanë mbetur prapa me pagesën e qirasë, ose lejimi i shtyrjes së ripagesave të borxheve ose hipotekave.^[569]

Megjithatë, ky klasifikim mund të ndryshojë varësisht nga rreptësia e impaktit të kufizimeve në biznes, e posaçërisht nga kohëzgjatja e aplikimit të tyre. Ndërkohë që restriksionet mbi biznese u futën si masa të përkohshme në reagim ndaj një situatë emergjente, sa më gjatë që ato ishin në fuqi, aq më shumë dëme kishte gjasë t'i shkaktoheshin biznesit^[570]. Nëqoftëse kufizimet (qoftë edhe pa qëllim) shkaktojnë rrënimin e një biznesi, për shembull nëse biznesi humbi të ardhurat ose klientelën deri në atë masë sa u detyrua të mbyllej komplet, atëherë kufizimet mund të përbëjnë privim të pronës^[571].

[569] Për shembull, legjislacioni për kontrollin e qirave është trajtuar si "kontrollim i përdorimit" në *Hutten-Czapska k. Polonisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 19 qershorit 2006, Nr. 35014/97, § 160 dhe *Aquilina k. Maltës*, vendim i Dhomës së Madhe i 11 dhjetorit 2014, Nr.3851/12; shih gjithashtu vendimin e Gjykatës së Përgjithshme të BE-së në çështjen T-628/20, ku ajo vendosi që fondi spanjoll i mbështetjes për falimentim për kompanitë strategjike që kishin vështirësi të përkohshme për shkak të pandemisë ishte në linjë me të drejtën e Unionit. Sipas kësaj skeme, ndihma u jepej vetëm përfutuesve të vendosur në Spanjë. Gjykata e Përgjithshme pranoi se kjo rezultonte në trajtim të diferencuar, por gjeti se një trajtim i tillë i diferencuar ishte i justifikuar sepse ishte një mënyrë e nevojshme dhe proporcionale për të arritur qëllimin legjitim të zgjidhjes së trazirave serioze në ekonominë spanjolle të shkatuara nga pandemia Covid-19.

[570] Në kohën e këtij shkrimi, çështja *Toromag s.r.o. k. Sllovenisë*, e komunikuar më 5 dhjetor 2020, Nr. 41217/20, është në pritje para Gjykatës. Çështja ka të bëjë me mbylljen nga marsi deri në qershor 2020 të qendrave të fitnesit, sipas masave të marra nga Autoriteti i Shëndetit Publik në Sllovaki në kuadër të parandalimit të përhapjes së Covid-19. Kërkuetit, pronarë të këtyre qendrave, u ankuan për dëmet materiale të pësuar, humbjen e të ardhurave të mëtejshme dhe humbjen e klientelës.

[571] Shih, për shembull, vendimin e Gjykatës Supreme Administrative të Polonisë (*Naczelný Sąd Administracyjny*, urdhri i datës 27.10.2020, I GZ 294/20 (PL)), ku kërkueti argumentoi se një vendim administrativ që kompania e tij duhet të ripaguante fonde shkeli të drejtën e tij të pronës sepse, duke pasur parasysh humbjet e pësuar në kontekstin e pandemisë, rimarrja e shumave do të çonte drejt likuidimit të kompanisë dhe heqjes nga puna të punonjësve. Gjykata e shkallës së parë nuk e lejoi apelin e tij, sepse sipas mendimit të saj kompania nuk kishte rreguar rreziq të konsiderueshme ose efekte të pakthyeshme.

c. Ligjshmëria

Çdo ndërhyrje në të drejtat e mbrojtura nga A1P1 duhet të përmbushin kriterin e ligjshmërisë.^[572] Faza “varësisht nga kushtet e parashikuara nga ligji” në paragrafin 1 të A1P1 mund të interpretohet në të njëjtën mënyrë si fraza “në përputhje me ligjin” në Nenin 8 ose “parashikuar me ligj” në Nenin 9, 10 dhe 11 të Konventës, të diskutuara në seksionet e këtyre të drejtave në kuadër të këtij publikimi. Përveç kësaj, ndërkohë që A1P1 nuk përmban ndonjë kriter procedural eksplisit, Gjykata lë të kuptohet që çdo ndërhyrje tek gëzimi paqësor i pasurisë duhet të jetë e shoqëruar nga garanci procedurale të cilat i ofrojnë individit ose entitetit në fjalë mundësi të arsyeshme për të paraqitur argumentet e tyre para autoriteteve përgjegjëse me qëllim që të sfidojnë në mënyrë efektive masat që ndërhyjnë tek të drejtat e tyre nga A1P1^[573].

d. Testi i interesit publik

Ndërhyrja tek A1P1 mund të justifikohet vetëm nëse i shërben një interesi legjitim publik (ose të përgjithshëm). Nocioni i “interesit publik” në këtë kontekst shtrihet gjerë. Gjykata u lejon autoriteteve nacionale hapësirë të gjerë vlerësimi për të përcaktuar se çfarë është në interesin publik, dhe respekton VENDIMIN e tyre në lidhje me këtë çështje nëqoftëse nuk është dukshëm pa themele të arsyeshme.^[574] Andaj, masat si mbyllja e bizneseve apo kufizimi i udhëtimeve për të parandaluar përhapjen e Covid-19 për të mbrojtur shëndetin do të vlerësoheshin se i shërbejnë interesit publik. Ngjashëm, masat e marra për të mbrojtur njerëzit nga impakti ekonomik i pandemisë, si pengimi i nxjerrjes jashtë nga banesa kur qiramarrësi ka

[572] *Vistiņš dhe Perepjolkins k. Letonisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 25 tetorit 2012, Nr. 71243/01, § 95; *Bélané Nagy k. Hungarisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 13 dhjetorit 2016, Nr. 53080/13, § 112.

[573] *Capital Bank AD k. Bullgarisë*, vendimi i 24 nëntorit 2005, Nr. 49429/99 §; shih gjithashtu vendimin e Gjykatës Administrative të Voivodship në Opole, Poloni (Wojewódzki Sąd Administracyjny w Opolu, vendimi i datës 27.10. 2020, ISA/Op 219/20 (PL)), në lidhje me një gjobë të lëshuar për pronaren e një salloni flokësh për mos-respektimin e kufizimeve të përkohshme të biznesit gjatë pandemisë. Gjykata deklaroi që, përderisa kufizimet ishin të justifikuar në parim, teknika legjislative përmes së cilës ato aktivizoheshin kishte rezultuar në shkeljen e të drejtave themelore kushtetuese në fushën e lirisë së sipërmarrjes. Gjykata tha që, edhe sikur urdhrat sipas të cilave ishte bazuar gjoba të vlerësohej se ishin në përputhje me ligjin, masat e kontestuara do të ishin nul sepse ato shkelën rregullat bazë të procedurës administrative, sepse u bazuan vetëm mbi një shënim nga policia, pa i dhënë kërkueses mundësinë për të paraqitur argumentet e saj ose për të marrë pjesë aktive në procedurat që çuan deri tek gjoba.

[574] *Bélané Nagy k. Hungarisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 13 dhjetorit 2016, Nr. 53080/13, § 113.

mbetur prapa me pagesën e qirasë, ose lejimi i shtyrjes së pagesave të hipotekës, po ashtu me gjasë vlerësohen se i shërbejnë interesit publik.^[575]

e. Proporcionaliteti

Kompensimi

Si rregull i përgjithshëm, privimi i pasurisë nuk vlerësohet se arrin ekuilibrin e drejtë mes A1P1 dhe interesit publik përderisa kompensimi 'arsyeshëm i lidhur' me vlerën e tregut të asetit të marrë nuk i paguhet personit tek të drejtat e të cilit është ndërhyrë.^[576] Kontrolli i përdorimit të pronës mundet, por zakonisht nuk, kërkon kompensim, dhe çështja nëse ai është i justifikuar varet nga një sërë faktorësh të tjerë, disa prej të cilëve diskutohen më poshtë. Shkalla deri ku ndërhyrja e përgjithshme në gëzimin paqësor të pasurisë kërkon kompensim varet më shumë nga konteksti dhe gjithashtu varet (mes të tjerash) nga faktorët e diskutuar më poshtë.

Shtetet tashmë kanë jetësuar një sërë masash dhe skemash financiare për të kompensuar bizneset për humbjet që mund të pësojnë si rezultat i masave të marra gjatë pandemisë, disa prej të cilave aplikohen edhe në kontekste që mund të vlerësohen si kontroll i përdorimit të pronës^[577]. Megjithatë, mund të dalin probleme nëse një kompensim i tillë nuk është i mjaftueshëm për të parandaluar mbylljen e biznesit, nuk është arsyeshëm i lidhur me vlerën e tregut të mallit të humbur, ose kur personi apo biznesi nuk i përmbush kriteret për kompensim.

[575] Hapësira e vlerësimit që u jepet autoriteteve vendase për të përcaktuar se çfarë është në interesin publik është veçanërisht e gjerë kur masat merren në kontekstin e një ndryshimi në regjimin politik dhe ekonomik (*Valkov dhe të Tjerë k. Bullgarisë*, vendim i 25 tetorit 2011, Nr. 2033/04, 19125/04, 19475/04, 19490/04, 19495/04, 19497/04, 24729/04, 171/05 dhe 2041/05, § 91; për shembull, në kontekstin e masave të shtrëngueshme për shkak të krizës madhore ekonomike, *Koufaki dhe Adedy k. Greqisë*, vendimi për pranueshmërinë i 5 majit 2013, Nr. 57665/12 dhe 57657/12, §§ 37 dhe 39 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[576] *Pincová dhe Pinc k. Republikës Çeke*, vendim i 5 nëntorit 2002, Nr. 36548/97.

[577] Shih <https://www.gok.uk/guidance/get-a-discount-with-the-eat-out-to-help-out-scheme> "Fito zbritje me Ha Për Të Ndihmuar", Udhërrëfyes i Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar, 15 korrik 2020, ose subvencionimi i rrogave të punonjësve në Shtete të ndryshme, përfshirë (Bosnje-Hercegovina, Maqedonia e Veriut dhe Serbia) për periudhën e prillit dhe majit: <http://www.oecd.org/coronavirus/policy-responses/covid-19-crisis-response-in-south-east-european-economies-c1aacb5a/> "Reagimet ndaj krizës së Covid-19 në ekonomitë e Evropës Juglindore", Reagimet e OECD-së ndaj Koronavirusit, 15 prill 2020.

Konteksti në të cilin merret masa

Në disa kontekste, Gjykata u lejon hapësirë më të gjerë vlerësimi Shteteve për të përcaktuar masat më efektive për t'i shërbyer interesit publik. Gjykata përgjithësisht nuk është e gatshme të vërë në pyetje vendimin e një Shteti për të caktuar masa të cilat ndërhyjnë tek të drejtat e A1P1, kur këto masa futen për t'iu përgjigjur një situatë emergjente^[578], ose kur masat merren si pjesë e vendimeve të nivelit të lartë për ekonominë ose alokimi e burimeve publike.^[579] Impakti ekonomik i reagimeve ndaj pandemisë Covid-19 u parashikua të përfshinte humbjen e vendeve të punës dhe të ardhurave, si dhe potencialisht humbjen e pensione.^[580] Kjo mund të rezultojë nga mbyllja e bizneseve për shkak të masave të mbylljes brenda në shtëpi, ose humbja e vendeve të punës së sektorin publik nëse futeshin masat e shtrënguara. Mbi bazën e praktikës gjyqësore ekzistuese, vendime të tilla të nivelit të lartë rreth ekonomisë dhe alokimit të burimeve publike me gjasë i japin shkas kërkesave të suksesshme sipas A1P1 për humbjen e të ardhurave, posaçërisht nëse një person hiqet nga puna në përputhje me kushtet e kontratës së tij kur bëhet shkurtime.

Impakti joproporcional

Edhe kur lënda e një kufizimi përndryshe tërheq një hapësirë të gjerë vlerësimi, masat nuk duhet të imponojnë një 'barrë të tepërt individuale' mbi personat e prekur, ose 'të veçojnë' një grup të caktuar për trajtim të keq.^[581] Për shembull, në disa raste lidhur me kontrollin e furnizimeve në Maltë, Gjykata gjeti që dispozitat përkatëse vendase ishin në papajtueshmëri me A1P1 sepse ato vinin një barrë

[578] SA *Bio d'Ardennes k. Belgjikës*, vendim i 12 nëntorit 2019, Nr. 44457/11.

[579] Shih *Mamatas dhe të Tjerë k. Greqisë*, vendim i 21 korrikut 2016, Nr. 63066/14,64297/14 dhe 66106/14, ku Gjykata rrëzoi disa akuza kundër masave të shtrënguara që u imponuan pas krizës financiare të 2007 dhe 2008-ës.

[580] Shih: <http://documents1.worldbank.org/curated/en/236311590680555002/pdf/The-Economic-and-Social-Impact-of-COVID-19-Poverty-and-Household-Welfare.pdf> "Impakti Ekonomik dhe Social i Covid-19: Varfëria dhe Mirëqenia e Familjeve", Raporti i Rregullt Ekonomik i Grupit të Bankës Botërore për Ballkanin Perëndimor, Nr. 17, pranverë 2020.

[581] Shih *Ásmundsson k. Islandës*, vendim i 12 tetorit 2004, Nr. 60669/00, ku Gjykata gjeti shkelje të A1P1 kur modifikimet në ligjin për pensionet e paaftësisë për të zgjidhur presionet financiare mbi skemën rezultuan me humbjen nga një grup pensionistësh të krejt pensione të tyre. Shih gjithashtu *Sporrong dhe Lönnroth k. Suedisë*, vendim plenar i Gjykatës i 18 dhjetorit 1984, Nr. 7151/75 dhe 7152/75, dhe *Hentrich k. Francës*, vendim i 22 shtatorit 1994, Nr.13616/88.

joproporcionale mbi pronarët privatë.^[582] Prandaj, mund të dilnin probleme nëse skemat e kompensimit ose mbështetjes financiare të futura në reagim ndaj efekteve ekonomike të pandemisë përjashtojnë në mënyrë arbitrare disa biznese ose individë të caktuar^[583] ose, nëse vlerësohet se ato prekin një grup të caktuar më ashpër sesa të tjerët.^[584]

Kohëzgjatja

Masat e përhershme kanë më shumë gjasa të vlerësohen joproporcionale sesa masat e përkohshme. Në kontekstin e një pandemie është e vështirë të përcaktohet se për sa kohë do të jenë në fuqi masat, ose nëse masat që janë hequr do të rikthehen si reagim ndaj shpërthimeve të tjera të sëmundjes. Sa më gjatë që masat janë në fuqi, aq më e rëndësishme bëhet që të sigurohet që ka mbrojtje procedurale në mënyrë që ata që i nënshtrohen masave të paraqesin rrethanat e tyre individuale dhe të kërkojnë që të shqyrtohet nëse kufizimet ende janë të nevojshme dhe proporcionale në situatën e tyre të veçantë.^[585]

[582] *Cassar k. Maltës*, vendim i 30 janarit 2018, Nr. 50570/13.

[583] Për shembull, në Mbretërinë e Bashkuar u ngritën shqetësime rreth përjashtimit të atyre që sapo kishin ndërruar vendin e punës, që ishin sapo të vetpunësuar, drejtorë të kompanive të limituara, ose punonjës të lirë (freelance) prej programeve të ndihmës financiare: <https://www.theguardian.com/business/2020/jul/23/rishi-sunak-urged-to-plug-gaps-in-covid-19-furlough-scheme-for-1m-self-employed-now> "Rishi Sunak i kërkohet të tërheqë zbrazëtitë në skemat e lejeve për një milion punonjës" ("Rishi Sunak urged to plug furlough scheme gaps for 1m workers"), nga K. Makortoff dhe R. Partington, The Guardian, 23 korrik 2020.

[584] Për shembull, nëse një Shtet lejonte ngrirjen ose shtyrjen e pagesave, çka prekte veçanërisht fort pronarët, ndërkohë që mund të kishte miratuar masa të tjera më pak ndërhyrëse, për shembull subvencionimi i pagesave të qirave (si në Kosovë): <http://www.oecd.org/coronavirus/policy-responses/covid-19-crisis-response-in-south-east-european-economies-c1aacb5a/> "Reagimet ndaj krizës së Covid-19 në ekonomitë e Evropës Juglindore", Reagimet në Politikat e OECD-së ndaj Koronavirusit (Covid-19), 15 prill 2020. Shih gjithashtu vendimin e Gjykatës Kushtetuese Çeke (Pl. US 106/20 të 9 shkurtit 2021), i cili gjeti se nuk kishte justifikim për vendimin për të mbyllur disa biznese e disa jo. Gjykata gjeti se Qeveria i kishte ndaluar të gjitha shitjet me pakicë dhe shërbimet e ofrimit të produkteve dhe më pas, në mënyrë arbitrare dhe pa justifikim për nevojshmërinë dhe domethënien e tyre për kontrollimin e pandemisë, bëri përjashtime të shumta nga kjo ndalesë e tërësishme, duke rezultuar në trajtim të pabarabartë të llojeve të ndryshme të sipërmarrësve.

[585] *AGOSI k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 24 tetorit 1986, Nr. 9118/80.

13. Neni 14 dhe Neni 1 i Protokollit Nr. 12 - Liria nga diskriminimi

Parimi i mos-diskriminimit i mishëruar në Nenin 14 dhe Nenin 1 të Protokollit Nr. 12 (ang. A1P12) të Konventës ndalon dallimet në trajtimin e personave në situata relevante analoge ose të ngjashme,^[586] si dhe dështimin për të trajtuar ndryshe persona situatat e të cilëve janë të ndryshme në masë domethënëse, kur nuk ekzistojnë justifikime objektive dhe të arsyeshme për një trajtim të tillë diskriminues.^[587] Neni 14 mbron kundër diskriminimit në gëzimin e të drejtave të tjera të Konventës, dhe mbështetja te ky Nen bëhet së bashku me të drejtat e tjera të Konventës, ndërsa A1P12 ndalon diskriminimin në gëzimin e çdo të drejte të dhënë nga Shteti, gjatë ushtrimit të fuqisë së diskrecionit, ose çdo veprim apo mosveprim tjetër nga ana e Shtetit.

Ndërkohë që Neni 14 dhe A1P12 nuk renditen në mesin e të drejtave 'të paderogueshme' sipas Konventës, disa forma të caktuara të diskriminimit mund të përbëjnë trajtim degradues sipas Nenit 3, e cila është dispozitë e paderogueshme.^[588] Përveç kësaj, gjatë vlersimit nëse masat deroguese janë "strikt të kërkuara" sipas Nenit 15 të Konventës^[589] Gjykata shqyrton nëse masat e zbatuara për të reaguar ndaj një emergjence publike kanë diskriminuar në mënyrë të pajustificueshme mes kategorive të ndryshme të njerëzve.^[590]

Reagimet ndaj pandemisë Covid-19, dhe dështimet për t'u ofruar mbështetje shtesë ose të posaçme grupeve të prekshme si pjesë e atyre reagimeve, i acaruan pabarazitë ekzistuese dhe kanë krijuar kërcënime të reja për shëndetin dhe mirëqenien e grupeve të marginalizuara, përfshirë gratë, pakicat etnike, personat me paaftësi, të mosshuarit dhe anëtarët e LGBTQI, migrantët, dhe komunitetet rome.^[591]

[586] *Shih Biao k. Danimarkës*, vendim i Dhomës së Madhe i 24 majit 2016, Nr. 38590/10, § 89.

[587] *Shih Thlimmenos k. Greqisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 6 majit 2000, Nr. 34369/97, § 44.

[588] Për shembull, diskriminimi për shkak të racës, në rrethana të caktuara, mund të përbënte "trajtim degradues" brenda kuptimit të Nenit 3 (*Aziatikët e Afrikës Lindore k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi për pranueshmërinë i 6 marsit 1978, Nr. 4715/70, 4783/71 dhe 4827/71; *Abdu k. Bullgarisë*, vendim i 11 marsit 2014, Nr. 26827/08, § 23).

[589] *Shih Kapitujt e mëtejshëm III dhe IV të këtij publikimi*.

[590] *Shih A. dhe të Tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i Dhomës së Madhe i 19 shkurtit 2009, Nr. 3455/05, § 190, ku masat deroguese u gjetën të ishin joproporcionale sepse ato bënin diskriminim mes shtetasve dhe joshitetasve.

[591] *Shih* <https://rm.coe.int/cdadi-introductory-note-en-08042020-final-version/16809e201d> "Dimensionet

Impakti potencialisht diskriminues i kufizimit të lëvizjeve tek personat me paaftësi, përfshirë mbylljen në shtëpitë e veta dhe kufizimi i vizitave, u diskutua në seksionin mbi Nenin 2 të Protokollit Nr. 4 - E drejta e lirisë së lëvizjes, brenda këtij publikimi, dhe impakti diskriminues i mbylljes së shkollave u diskutua në seksionin mbi Nenin 2 të Protokollit Nr. 1 - E drejta për arsimim. Disa shembuj të tjerë se kur mund të ngrihen çështje sipas Nenit 14 dhe A1P12 diskutohen më poshtë, megjithëse këto shembuj nuk janë shterues.

a. Shëndeti

Siç u diskutua në seksionet e këtij publikimi mbi Nenin 2, 3 dhe 8, Shtetet kanë detyrimin që të ngrënë dhe të zbatojnë një kornizë ligjesh për të mbrojtur jetën dhe për të parandaluar vuajtjet, përfshirë të detyrojnë spitalet të marrin masat e duhura për mbrojtjen e jetës së pacientëve dhe stafit. Neni 14 angazhohet nëse rregulloret dhe masat e marra nga Shteti për të mbrojtur shëndetin nga pandemia Covid-19 kanë efekt diskriminues, qoftë për shkak se kanë impakt më të ashpër mbi anëtarë të grupeve të caktuara, ose për shkak se nuk marrin parasysh dhe nuk akomodojnë mjaftueshëm nevojat dhe dallimet mes grupeve të ndryshme.^[592]

Personat me paaftësi dhe të moshuarit mund të jenë në rrezik më të madh nga Covid-19 nëse kanë sistem imunitar më të dobët, nëse vuajnë nga sëmundje që i bëjnë më të prekshëm nga efektet e Covid-19, ose nëse mobilizimi i sistemit shëndetësor për të luftuar Covid-19 do të thotë që atyre nuk iu ofrohet trajtimi ose kujdesi që marrin zakonisht. Ata gjithashtu mund të mbështeten tek përkrahja formale nga ofruesit e shërbimeve ose përkrahja informale nga të afërmit dhe miqtë për të blerë ushqime, produkte dhe barna dhe për të zhvilluar aktivitetet ditore si bërja e banjës, gatimi dhe të ngrënit.^[593]

anti-diskriminuese, të diversitetit, dhe të përfshirjes në reagimet ndaj Covid-19", Notë Hyrëse e Sekretariatit të Komitetit Drejtues për Anti-Diskriminim, Diversitet dhe Përfshirje, 8 prill 2020. Shih gjithashtu <https://rm.coe.int/prems-126920-gbr-2530-cdadi-covid-19-ëeb-a5-final-2774-9087-5906-1/1680a124aa> - studimi i përgatitur nga Komiteti Drejtues i Këshillit të Evropës për Anti-Diskriminim, Diversitet dhe Përfshirje (CDADI) nga Stéphanie Cramer Marsal (autore kryesore), Christian Ahlund dhe Robin Wilson, "COVID-19: Analizë e dimensioneve të anti-diskriminimit, diversitetit dhe përfshirjes në Shtetet Anëtare të Këshillit të Evropës", nëntor 2020.

[592] *Enver Şahin k. Turqisë*, vendim i 30 janarit 2018, Nr. 23065/12, §§ 67-69; *Çam k. Turqisë*, vendim i 23 shkurtit 2016, Nr. 51500/08, §§ 65-67, ku Gjykata gjeti detyrimin për të siguruar "akomodim të arsyeshëm" për t'u lejuar personave me paaftësi që të realizonin plotësisht të drejtat e tyre, dhe ku dështimi për ta bërë këtë përbëri diskriminim.

[593] Shih *Glor k. Zvicrës*, vendim i 30 prillit 2009, Nr. 13444/04, § 80; *G.N. dhe të Tjerë k. Italisë*, vendim i 1

Siç diskutohet në seksionin rreth Nenit 8 (E drejta e jetës private) në këtë publikim, ka disa aspekte në të cilat politikat e vaksinimit të Shteteve mund të ngrenë çështje të diskriminimit. Kjo përfshin situatat ku politikat e vaksinimit të detyrueshëm zbatohen vetëm kundër grupeve të caktuara ose anëtarëve të profesioneve të caktuara^[594]. Përveç kësaj, bërja e statusit të vaksinimit kusht për të udhëtuar ose për të hyrë në hapësira të caktuara publike ose private rrezikon t'i japë shkas diskriminimit mbi bazën e statusit të imunitetit të një personi.

Personat LGBTQI përjetojnë rregullisht stigmën dhe diskriminimin kur kërkojnë ndihmë shëndetësore, çka shpie drejt pabarazive në cilësinë dhe disponibilitetin e kujdesit shëndetësor për ta.^[595] Si pasojë e kësaj, shëndeti i tyre tashmë mund të jetë komprometuar, duke i bërë ata më të ndjeshëm ndaj efekteve të Covid-19, ose me gjasë ata mund të mos kërkojnë ndihmë mjekësore nëse kanë simptoma të Covid-19.^[596] Më tej, riprioritizimi i shërbimeve të kërkuara shëndetësore mund të nënkuptojë që trajtimi i personave LGBTQI shtyhet ose reduktohet, përfshirë trajtimet hormonale dhe operacionet për ndërrimin e gjinisë.^[597]

Neni 14 dhe A1P12 shkelen vetëm kur nuk ka justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për dallimet në trajtim, ose dështimet për të trajtuar ndryshe situata të ndryshme. Mund të jetë i nevojshëm ricaktimi i prioriteteve në shërbimet shëndetësore të ofruara gjatë pandemisë, por kur ky ricaktim ka impakt diskriminues tek personat me paaftësi dhe personat LGBTQI, Shtetet duhet të tregojnë që vendimet që u japin përparësi llojeve të caktuara të kujdesit kundrejt të tjerëve janë të bazuara mbi prova dhe të dhëna mjekësore, dhe jo mbi paragjykime apo stigma. Ngjashëm,

dhjetorit 2009, Nr. 43134/05, § 126; *Kiyutin k. Rusisë*, vendim i 10 marsit 2011, Nr. 2700/10 për konfirmimin që fushëveprimi i Nenit 14 të Konventës dhe Neni 1 i Protokollit Nr. 12 përfshin diskriminimin për shkak të paaftësisë, gjendjes mjekësore ose tipareve gjenetike.

[594] Çështja *Thevenon k. Francës*, vendimi i 13 shtatorit 2022, Nr. 46061/21, kishte të bënte me pyetjen nëse imponimi i vaksinimit të detyrueshëm për shkak të profesionit të kërkuesit si zjarrfikës profesionist shkeli të drejtat e tij të Neneve 8 dhe 14. Megjithatë, çështja u rrëzua për dështimin e shterimit të zgjidhjeve vendase, kështu që kjo pikë substanciale nuk u shqyrtua.

[595] Shih <https://www.ohchr.org/Documents/Issues/LGBT/LGBTpeople.pdf> "Covid-19 dhe Të Drejtat e Njeriut të Personave LGBTQI", Dokument i OKB-së, 17 prill 2020.

[596] Shih <https://blogs.worldbank.org/europeandcentralasia/closing-data-gap-lgbti-exclusion> "Mbyllja e hendekut të të dhënave mbi përjashtimin e personave LGBTQI", L. Gelder, blogu i Bankës Botërore, 26 maj 2020.

[597] Gjykata ka njohur të drejtën për të bërë operacion për ndërrimin e gjinisë sipas Nenit 8, dhe në *YY k. Turqisë*, vendim i 10 marsit 2015, Nr. 14793/08, ajo gjeti shkelje të Nenit 8 kur kërkuesit iu mohua për shumë vite mundësia e bërjes së një operacioni të tillë.

kur Shtetet zbatojnë politika të vaksinimit të detyrueshëm për grupe të caktuara ose anëtarë të caktuar të profesioneve të caktuara, ato duhet të jenë në gjendje të japin justifikim objektiv dhe të arsyeshëm përse ato grupe ose individë, e jo të tjerë, i nënshtrohen detyrimit për vaksinim. Më tej, Shtetet duhet të tregojnë që ato e kanë ekuilibruar qëllimin e mbrojtjes së shëndetit dhe të drejtave të personave, kujdesi dhe trajtimi mjekësor i të cilëve gjatë pandemisë është reduktuar ose është shtyrë për shkak të nevojës për të mbrojtur njerëzit dhe parandaluar përhapjen e Covid-19.

Dallimi në trajtimin mes personave me “status imunitar” të ndryshëm, varësisht nga statusi i tyre i vaksinimit, jo domosdoshmërisht përbën diskriminim të pajustificuar. Për të shmangur diskriminimin e pajustificuar, politikat e kufizimit të lëvizjes ose tubimit të bazuara mbi statusin e vaksinimit duhet të përfshijnë përjashtime për ata/ato që nuk janë vaksinuar. Për shembull, duke i lejuar njerëzit të paraqesin një test negativ të Covid-19 si alternativë e statusit të vaksinimit, ose të paraqesin prova që, për arsye mjekësore ose të tjera, ata/ato nuk mund të vaksinohen^[598].

Kur Shtetet marrin masa të përgjithshme për të mbrojtur shëndetin e kombit nga përhapja e Covid-19, atyre po ashtu u kërkohet të marrin parasysh që impakti i atyre masave mbi komunitetet të ndryshme është i ndryshëm, dhe që mund të jenë të detyruar të marrin hapa pozitive për të siguruar që masa të tilla janë efektive për të mbrojtur jetën dhe shëndetin e njerëzve në komunitete të ndryshme po aq efektivisht sa edhe njerëzit në komunitete të tjera. Duhet të zbatohen masa siç janë fushatat informative të shënjestruara, të përcjella në gjuhë të ndryshme përfshirë gjuhën e shenjave, për të siguruar që mesazhet në lidhje me mbrojtjen e shëndetit të shkojnë tek ata që kanë nevojë më së shumti. Shtetet gjithashtu mund të konsiderojnë nëse është e udhës që të përfshihet një përjashtim nga kufizimet e përgjithshme për vizitat tek të moshuarit, dhe/ose personat e prekshëm ose më të dobët, që personat që kujdesen për ta të kryejnë punët esenciale për shëndetin dhe mirëqenien e tyre. Nëse bëhen përjashtime të tilla, kjo mundësohet vetëm nëse ato ofrojnë gjithashtu pajisje mbrojtëse të mjaftueshme për personat që kujdesen.

Rregulloret që udhëzojnë njerëzit ‘të qëndrojnë në shtëpi’, të lajnë/pastrojnë duart, sendet dhe shtëpitë më rregullisht dhe të qëndrojnë në distancë prej njerëzve

[598] <https://rm.coe.int/dh-bio-2021-7-final-statement-vaccines-e/1680a259dd> “Deklaratë mbi Konsideratat e të Drejtave të Njeriut Relevante për ‘Certifikatën e Vaksinimit’ dhe Dokumente të Ngjashme”, Komiteti i Këshillit të Evropës për Bioetikën (DH-BIO), 4 maj 2021.

të tjerë mund të ndihmojnë që të mbrohet një pjesë e popullatës. Megjithatë, masa të tilla nuk i ndihmojnë ata që jetojnë në ngushtica me shumë njerëz bashkë, pa qasje në produkte higjienike. Për shembull, një përqindje e konsiderueshme e Romëve jetojnë në shtëpi pa uje çezme, pa pajisje sanitare dhe në kushte të ngarkuara shumë njerëz në një vend, çka e bën distancimin social thuajse të pamundur.^[599] Shtetet duhet të konsiderojnë zbatimin e masave shtesë për të mbrojtur jetën dhe shëndetin e komuniteteve të tilla, për shembull duke i lejuar komunitetet Rome dhe ato Udhëtare që të banojnë në zona më të hapura ose duke krijuar ambiente të reja për përdorim prej tyre për të mundësuar distancimin social, duke ndihmuar vendosjen e pajisjeve sanitare në këto hapësira, duke shtuar qasjen në akomodim emergjent për njerëzit e pastrehë dhe duke ofruar produkte higjienike për ata që nuk kanë.^[600]

Refuzimi për të ofruar ndihmë emergjente një personi, për shkak se ai nuk është shtetas i Shtetit në të cilin ai e kërkon këtë ndihmë po ashtu mund të përbëjë diskriminim mbi bazën e nacionalitetit.^[601] Prandaj, Shtetet mund të kenë detyrimin për t'i bërë sistemet e kujdesit shëndetësor më të hapura ndaj personave pa status rezidence në vendin e vet, posaçërisht nëse kufizimet e udhëtimit janë ende në fuqi dhe i ndalojnë njerëzit nga të udhëtuarit drejt vendit të shtetësisë së vet për të kërkuar mjekim.^[602]

[599] Shih https://ec.europa.eu/info/sites/info/files/overview_of_covid19_and_roma_-_impact_-_measures_-_priorities_for_funding_-_23_04_2020.docx.pdf "Shikim i përgjithshëm i impaktit të masave të koronavirusit tek komunitetet e marginalizuara Rome", Raport nga Komisioni Evropian 6 maj 2020.

[600] Shih [https://www.coe.int/en/web/interculturalcities/covid-19-special-page#{%2262433518%22:\[3\]}](https://www.coe.int/en/web/interculturalcities/covid-19-special-page#{%2262433518%22:[3]}) "Qytete Ndërkulturore: Faqja Speciale e Covid-19", Këshilli i Evropës, ku shembujt përfshijnë rastin e Zvicrës që u kërkoi kantoneve dhe bashkive të hapnin qendra të përkohshme për Romët dhe Udhëtarët në parkingjet e qendrave sportive për të zvogëluar numrin e njerëzve në një vend dhe për të shtuar distancimin social, të pezullonin tarifatat e parkingut për të lehtësuar presionin financiar, dhe të improvizonin instalime sanitare me ujë të rrjedhshëm dhe sapun të lëngshëm për larjen e shpeshtë të duarve.

[601] *Gaygusuz k. Austrisë*, vendim i 16 shtatorit 1996, Nr. 17371/90.

[602] Qeveria Portugeze, për shembull, e mohoi që të gjithë imigrantët me kërkesa në pritje për lejeqëndrim qysh prej 18 marsit 2020 do të merrnin leje për qëndrim të përkohshëm dhe do të kishin qasje në të njëjtat të drejta si të gjithë qytetarët e tjerë, përfshirë mbështetje sociale: <https://ec.europa.eu/migrant-integration/news/portuguese-government-gives-temporary-residence-to-immigrants-with-pending-applications> "Qeveria portugeze u jep rezidencë të përkohshme imigrantëve me aplikime në pritje", A. Esteves, faqja e internetit e Komisionit Evropian mbi Integrimin, 28 mars 2020.

b. Abuzimi shtëpiak

Seksionet e Nenit 2 (e drejta e jetës), Nenit 3 (mbrojtja nga trajtimi çnjerëzor dhe degradues) dhe Nenit 8 (e drejta për respekt të jetës private dhe familjare) brenda këtij publikimi përshkruajnë detyrimet pozitive të Shteteve sipas Neneve 2, 3 dhe 8 në lidhje me abuzimin shtëpiak. Kjo përfshin detyrimet për të ngritur një kornizë legjislative për parandalimin dhe ndëshkimin e abuzimit shtëpiak, për t'u ofruar viktimave mbrojtje aktive dhe për të ndëshkuar përgjegjësit e abuzimit shtëpiak me anë të asaj kornize. Këto detyrime shpesh interpretohen në lidhje me Nenin 14, duke marrë parasysh efektin joproporcional të abuzimit shtëpiak me gratë dhe fëmijët.

Gjykata ka konsideruar në mënyrë eksplicite që dhuna shtëpiake është një formë e dhunës gjinore, e cila është një formë e diskriminimit ndaj grave. Dështimi për të mbrojtur gratë kundër dhunës shtëpiake mund të shkelë të drejtën e tyre për mbrojtje të barabartë të ligjit, edhe kur dështimi nuk është i qëllimshëm.^[603] Shtetet kanë për detyrim pozitiv të ndërtojnë dhe të zbatojnë efektivisht një sistem i cili ndëshkon të gjitha format e dhunës shtëpiake në një mënyrë e cila njuh rreptësinë e lëndimeve të shkaktuara dhe e cila ofron mbrojtje të mjaftueshme për viktimat.^[604] Edhe kur korniza e kërkuar ligjore është e ngritur, diskriminimi mund të rezultojë po ashtu nga qasja e përgjithshme e autoriteteve lokale, siç është mënyra se si trajtoheshin gratë në stacionin e policisë kur raportonin incidente të dhunës shtëpiake dhe pasiviteti gjyqësor në ofrimin e mbrojtjes efektive për viktimat.^[605]

Konventa e Stambollit është shumë relevante në këtë aspekt, dhe Kapitulli IV i saj përcakton me hollësi detyrimet e Palëve Shtetërore për të marrë masa për parandalimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër grave dhe fëmijëve, përfshirë me anë të legjislacionit dhe hetimeve.

Duke pasur parasysh këto detyrime pozitive, Shtetet duhet të sigurohen që autoritetet, përfshirë policinë dhe gjykatat, të vazhdojnë të quajnë dhe të trajtojnë incidentet e abuzimit shtëpiak si raste urgjente të cilave duhet t'u jepet përparësi dhe burimet për to duhet të rialokohen edhe në mes të pandemisë. Shtetet gjithashtu duhet të marrin masa për t'u siguruar që strehimoret dhe shërbimet

[603] *Opuz k. Turqisë*, vendim i 9 qershorit 2009, Nr. 33401/02, §§ 184-191 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[604] *Volodina k. Rusisë*, vendim i 9 korrikut 2019, Nr. 41261/17.

[605] *Opuz k. Turqisë*, vendim i 9 qershorit 2009, Nr. 33401/02, § 192 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

mbështetëse të vazhdojnë të funksionojnë në maksimumin e mundshëm pa komprometuar kërkesat për shëndetin dhe sigurinë gjatë pandemisë.^[606] Duke marrë parasysh impaktin diskriminues mbi gratë dhe fëmijët, dhe dëmet që mund të shkaktojë për shëndetin e tyre mendor dhe fizik, mbyllja totale e këtyre shërbimeve nuk ka gjasë të jetë mjet proporcional për arritjen e qëllimit të mbrojtjes shëndetësore për parandalimin e përhapjes së Covid-19.

Kufizimet e lëvizjes gjithashtu nënkuptojnë që të rinjtë e të rejtat LGBTQI janë mbyllur në ambiente armiqësore me familjarë ose bashkëjetues që nuk i mbështesin, çka mund të shtojë ekspozimin e tyre ndaj dhunës, si dhe të shkaktojë ose të acarojë ankthin dhe depresionin e tyre.^[607] Prandaj, masat e marra për të mbajtur hapur strehimoret dhe për të siguruar vazhdimin e shërbimeve përkrahëse në mënyra të sigurta duhet të përfshijnë edhe anëtarët e komunitetit LGBTQI.

c. Zbatimi i kufizimeve të lëvizjes dhe tubimit

Mënyrat se si janë zbatuar kufizimet e lëvizjes dhe tubimit po ashtu i kanë dhënë shkas situatave ku ka pasur diskriminime^[608]. Ka shqetësime se Romët që jetojnë në vendbanime informale, dhe refugjatët, azilkërkuessit dhe migrantët që jetojnë nëpër kampe i janë nënshtruar zbatimit joproporcional dhe diskriminues të masave reaguese ndaj Covid-19, për shembull imponimi i masave ushtarake dhe të detyrueshme të karantinës, të cilat nuk iu imponuan pjesës tjetër të popullatës dhe të cilat u policuan madje edhe nga forcat ushtarake.^[609] Kufizimet joproporcionale të lirisë së lëvizjes që kanë në shënjestër të selektuar Romët, refugjatët dhe migrantët, veçanërisht kur kufizime të tilla policohen nga prania ushtarake, pa prova që këto grupe përfaqësonin kërcënim objektiv për shëndetin

[606] Shih <https://eca.unwomen.org/en/news/stories/2020/4/albania-adopts-new-protocol-to-ensure-undisrupted-shelter-services> "Shqipëria miraton protokoll të ri për të garantuar vazhdimësinë e shërbimeve strehimore", UN Women, 21 prill 2020.

[607] Shih <https://www.ohchr.org/Documents/Issues/LGBT/LGBTpeople.pdf> "Covid-19 dhe Të Drejtat e Njeriut të Personave LGBTI", Dokument i OKB-së, 17 prill 2020.

[608] <https://www.aljazeera.com/indepth/opinion/police-covid-19-pandemic-excuse-abuse-roma-200511134616420.html> "Policia po përdor pandeminë Covid-19 si arsytim për të abuzuar romët", Joannathan Lee, Al Jazeera, 14 maj 2020.

[609] Shih <https://www.amnesty.org/download/Documents/EUR0125112020ENGLISH.PDF> "Policimi i Pandemisë: Shkeljet e të Drejtave të Njeriut gjatë Zbatimit të Masave për Covid-19 në Evropë", Raport i Amnesty International, 24 qershor 2020; shih gjithashtu seksionin mbi Nenin 3 (Mbrojtja nga trajtimi çnjerëzor dhe degradues) brenda këtij publikimi.

apo sigurinë publike, vendosin një barrë të panevojshme dhe joproportionale mbi grupe të tilla dhe përbëjnë diskriminim.^[610]

Gjithashtu, ka shqetësime që fuqitë e reja të gjera që i janë dhënë policisë për të jetësuar rregullimin e lëvizjeve dhe tubimit kanë çuar në praktika diskriminuese në mënyrën se si janë policuar rregulloret lidhur me Covid-19, sidomos duke pasur parasysh që fushëveprimi i saktë i këtyre rregulloreve nuk është gjithmonë i qartë. Në vendet që mbledhin të dhëna të ndara mbi praktikën e zbatimit të ligjit, ka prova që tregojnë shtimin e praktikave ndal-e-kontrolo dhe të kontroleve policore ndaj personave të pakicave etnike dhe zezake e aziatike, të cilët po ashtu shënohen si persona që kanë më shumë mundësi të marrin gjoba dhe dënime të tjera për shkeljen e rregullave të Covid-19.^[611] Veprimet e policisë, siç janë ndalimi e kontrollimi, hyjnë brenda fushëveprimit të Nenit 8 dhe janë të paligjshme nëse nuk ka mbrojtje të mjaftueshme për të përmbajtur diskrecionin e policëve që bëjnë kontrollin.^[612] Lidhja automatike e racës ose përkatësisë etnike me sjelljen kriminale dhe marrja e vendimeve për çfarëdo lloji të ndërhyrjes policore në sjelljen e një personi mbi bazën e profilizimit etnik apo racor është diskriminuese dhe e paligjshme.^[613] Prandaj, Shtetet duhet të sigurohen që të gjitha veprat e reja që hyjnë në kuadër të rregulloreve kundër Covid-19 të definojnë sa më qartë që është e mundur dhe që të ketë mbrojtje të mjaftueshme kundër keqpërdorimit të diskrecionit të policisë gjatë zbatimit të këtyre rregulloreve.

[610] *A dhe të Tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i Dhomës së Madhe i 19 shkurtit 2009, Nr. 3455/05 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[611] Shih <https://www.bbc.co.uk/news/uk-53556514> "Koronavirusi: Të rinjtë meshkuj të pakicave etnike 'më shumë gjasa për t'u gjobitur për Covid'", BBC, 27 korrik 2020; <https://www.amnesty.org/download/Documents/EUR0125112020ENGLISH.PDF> "Policimi i Pandemisë: Shkeljet e të Drejtave të Njeriut gjatë Zbatimit të Masave për Covid-19 në Evropë", Raport i Amnesty International, 24 qershor 2020; <https://www.met.police.uk/sd/stats-and-data/met/stop-and-search-dashboard> "Tabela ilustruese për 'ndalo dhe kontrollo'", Metropolitan Police, korrik 2020; <http://www.leparisien.fr/seine-saint-denis-93/coronavirus-en-seine-saint-denis-un-nombre-record-d-amendes-police-et-justice-durcissent-le-ton-19-03-2020-8284008> "Coronavirus en Seine-Saint-Denis: un nombre record d'amendes, police et justice durcissent le ton", N. Revenu, Le Parisien, 19 mars 2020; https://www.lexpress.fr/actualite/societe/selon-le-prefet-de-seine-saint-denis-le-confinement-est-globalement-bien-respecte_2122683.html "Selon le préfet de Seine-Saint-Denis, le confinement est globalement bien respecté", L'EXPRESS, 1 prill 2020.

[612] *Gillan dhe Quinton k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 12 janarit 2010, Nr. 4158/05.

[613] *Lingurark. Rumanisë*, vendim i 16 prillit 2019, Nr. 48474/14.

Kapitulli II - Derogimet

1. Sfondi

Ashtu si traktatet e tjera ndërkombëtare të të drejtave të njeriut,^[614] Konventa u ofron Shteteve Kontraktuese mundësinë për të deroguar prej detyrimeve të tyre për të siguruar të drejta dhe liri të caktuara të Konventës, në disa situata shumë të veçanta dhe të kufizuara. Një mundësi e tillë për të deroguar parashikohet nga Neni 15 i KEDNj-së. Ky Nen thotë:

"1. Në rast lufte ose rreziku tjetër publik që i kanoset jetës së kombit, çdo Palë e Lartë Kontraktuese mund të marrë masa që iu shmangen detyrimeve të parashikuara nga kjo Konventë, vetëm për aq sa e kërkon situata, me kusht që këto masa të mos jenë të papajtueshme me detyrimet e tjera sipas të drejtës ndërkombëtare.

2. Dispozita e mësipërme nuk lejon asnjë shmangie si nga neni 2, me përjashtim të rastit të vdekjes që vjen si pasojë e akteve të ligjshme të luftës, ashtu edhe nga nenet 3, 4 (paragrafi 1) dhe

3. Çdo Palë e Lartë Kontraktuese që ushtron këtë të drejtë derogimi e mban plotësisht të informuar Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Evropës për të gjitha masat e marra dhe arsyet pse ato janë marrë. Gjithashtu, ajo duhet të informojë Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Evropës për datën në të cilën këto masa kanë humbur fuqinë dhe dispozitat e Konventës vihen sërish në zbatim të plotë."

Kapitulli II i këtij publikimi diskuton situatat në të cilat Shtetet janë lejuar të ndërhyjnë në disa të drejta të caktuara të Konventës për të reaguar ndaj pandemisë së Covid-19. Për shembull, kufizimet e lejuara në paragrafët e dytë të Neneve 8 deri në 11, të cilat lejojnë ndërhyrjen te këto të drejta ku këto ndërhyrje synojnë

[614] Shih Nenin 5 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (ang. ICCPR), (1976) 999 UNTS 171; Neni 27 i Konventës Amerikane për të Drejtat e Njeriut (1978), UNTS, 123; Neni F § 1 i Kartës Sociale Evropiane ETS 163.

një qëllim legjitim (siç është mbrojtja e shëndetit) dhe u përmbahen parimeve të ligjshmërisë dhe proporcionalitetit. Natyra dhe qëllimi i derogimit sipas Neni 15 të Konventës janë ndryshe nga qëllimi i kufizimeve të bëra, për shembull, sipas paragrafëve të dytë të Neneve 8 deri në 11 të Konventës dhe gjithashtu nga qëllimi i kufizimeve të parashikuara sipas Neneve 16 dhe 17 të KEDNJ-së.

Neni 15 nënkupton mosaplikimin e të drejtave të caktuara të mbrojtura nga Konventa në rrethana specifike, ndërkohë që ndërhyrjet e lejuara të cekura specifikuhen në disa nene të KEDNJ-së janë pjesë e zbatimit dhe jetësimit të përditshëm të këtyre të drejtave. Neni 15 operon vetëm përkohësisht në rrethana të limituara dhe jo në lidhje me individë specifike, ndërsa ndërhyrjet dhe kufizimet në të drejta aplikohen zakonisht edhe në lidhje me individë specifike. Sipas Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, derogimi si koncept ka efektin e pushimit të mbrojtjes së ofruar nga drejta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.^[615] Prandaj, të referuarit në Nenin 15 duhet të konsiderohet vetëm kur një Shtet arrin në përfundimin që urgjencat e një situatë emergjente e bëjnë të pamundur të mbrohen të drejtat brenda kornizës së parashikuar nga përjashtimet e lejuara.

Secili nga instrumentet ndërkombëtare kryesore të të drejtave të njeriut sot përmban një klauzolë derogimi për rastet e emergjencave^[616], me sa duket duke pranuar që në situata emergjencash publike, siguria e Shtetit dhe institucioneve të tij demokratike, si dhe siguria e popullatës së tij, janë interesa jetike që meritojnë mbrojtje dhe që mund të kërkojnë derogimin e përkohshëm nga të drejta të caktuara të njeriut në mënyrë që Shtetet të mund të zbatojnë masa të jashtëzakonshme në përpjekje për t'i mbrojtur interesa të tilla^[617]. Në fakt,

[615] Ky është interpretimi i dhënë nga GjND për derogimin e parashikuar nga Neni 4 i ICCPR-së. Shih Opinionin Këshillues të GjND-së mbi Posojat Ligjore të Ndërtimit të një Muri në Territorin e Pushtuar Palestinez, vendim i 9 korrikut 2004, Raportet e Gj.N.D. 2004, fq. 178, § 106, dhe vendimin e GjND-së Aktivitetet e Armatosura në Territorin e Kongos (*Republika Demokratike e Kongos (ang. DRC) k. Ugandës*), vendim i 19 dhjetorit 2005, Raportet e Gj.N.D. 2005, § 216. Dhoma e Madhe e KEDNJ-së ka pranuar që derogimi i parashikuar me Nenin 15 të KEDNJ-së është i ngjashëm me derogimin e parashikuar nga Neni 4 ICCPR: Hassan k. Mbretërisë së Bashkuar, vendimi i Dhomës së Madhe i 16 shtatorit 2014, Nr. 29750/09, § 41.

[616] Neni 14 i KEDNJ-së lejon derogimin në rastet e "luftës ose emergjencave të tjera publike që kërcënojnë jetën e kombit"; ICCPR, Neni 4 i referohet një "emergjence publike që kërcënon jetën e kombit", ndërsa Konventa Amerikane e të Drejtave të Njeriut (ACHR, Neni 27) i referohet një „luftë, rreziku publik, ose emergjence tjetër publike që kërcënon pavarësinë ose sigurinë e një pale të Shtetit“.

[617] <https://rm.coe.int/16809e38a6>: „Përmbledhja e Opioneve të Komisionit të Venecias dhe Raporteve mbi Gjendjen e Emergjencës“, Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias), Strasburg, 16

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës e sheh mundësinë që Shtetet të bëjnë derogim nga Konventa si tipar i rëndësishëm i sistemit, ku lejohet vazhdimi i implementimit të Konventës dhe makinerisë së saj mbikqyrëse edhe në kohët më kritike^[618]. Megjithatë, siç theksohet nga Komisioni i Venecias, derogimet nga të drejtat themelore të njeriut kanë tendencë të ndodhin në kontekstin e situatave emergjente. Fuqitë emergjente janë abuzuar nga qeveritë autoritariste për të qëndruar në pushtet, për të heshtur opozitën dhe për të kufizuar të drejtat e njeriut në përgjithësi^[619]. Prandaj, kufijtë striktë mbi kohëzgjatjen, rrethanat dhe fushëveprimin e fuqive të tilla janë thelbësore. Operimi i derogimeve sipas Nenit 15 të KEDNj-së dhe kufijtë e përdorimit të tij do të analizohen shkurtimisht në seksionin 2 poshtë.

Para shpërthimit të pandemisë Covid-19, nëntë Shtete e kishin shfrytëzuar të drejtën e tyre për të bërë derogim sipas Nenit 15, në 35 raste^[620]. Mes muajve mars dhe prill të vitit 2020, pandemia rezultoi me dhjetë derogime të reja^[621]. Shumica e derogimeve në lidhje me Covid-19 zgjatën prej dy deri në gjashtë muaj^[622], dhe

prill 2020, CDL-PI(2020)003.

- [618] Respektimi i demokracisë, shtetet të së drejtës dhe të drejtave të njeriut në kuadër të krizës sanitare të Covid-19, një paketë instrumentesh për shtetet anëtare, SG/Inf(2020)11, 7 prill 2020.
- [619] <https://rm.coe.int/16809e38a6>: Përmbledhja e Opinioneve të Komisionit të Venecias dhe Raporteve mbi Gjendjen e Emergjencës", Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias), Strasburg, 16 prill 2020, CDL-PI(2020)003.
- [620] Para shpërthimit të pandemisë Covid-19, Shqipëria, Armenia, Franca, Gjeorgjia, Greqia, Irlanda, Turqia, Ukraina dhe Mbretëria e Bashkuar kishin deklaruar derogimin sipas Nenit 15 në rrethana të tjera. Shih përmbledhjen e të dhënave nga regjistrat e Këshillit të Evropës mes 5 majit 1949 dhe 18 majit 2020 mbi të gjitha derogimet e bëra ndonjëherë sipas Konventës: https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/005/declarations?p_auth=dA605sOe "Rezervimet dhe Deklarimet për Traktatin Nr. 005 – Konventa për Mbrojtjen e Të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore", Zyra e Traktateve e Këshillit të Evropës, 10 shtator 2020. Shih gjithashtu https://www.academia.edu/42294162/Derogations_from_the_European_Convention_on_Human_Rights_The_Case_for_Reform, "Derogimet nga Konventa Evropiane e Të Drejtave të Njeriut – Argumentet pro Reformës", S. Wallace, academia.edu.
- [621] Shtetet që bënë derogim nga KEDNj si reagim ndaj pandemisë ishin: Shqipëria, Armenia, Estonia, Gjeorgjia, Letonia, Maqedonia e Veriut, Republika e Moldavisë, Rumania, San Marino dhe Serbia. Shih <https://www.coe.int/en/web/conventions/derogations-COVID-19>: "Lajmërimet sipas Nenit 15 të Konventës në kontesktin e pandemisë Covid-19", Zyra e Traktateve e Këshillit të Evropës, statusi deri më 3 janar 2022.
- [622] Shtetet që bënë derogim gjatë periudhave në vijim: Shqipëria nga marsi deri në qershor 2020 (tre muaj), Armenia nga marsi në shtator 2020 (gjashhtë muaj), Estonia nga marsi në maj 2020 (dy muaj), Letonia nga marsi në qershor 2020 (tre muaj), përsëri nga dhjetori 2020 deri në prill 2021 (katër muaj) dhe sërish nga tetori në nëntor 2021

nga dhjetë Shtete nëntë prej tyre i tërhoqën derogimet mes muajve maj dhe shtator 2020. Letonia dhe Republika e Moldavisë ishin dy Shtetet e vetme që i rifutën derogimet si reagim ndaj impaktit të pandemisë Covid-19 në vitin 2021^[623].

Gjeorgjia së pari bëri derogim nga Konventa më 23 mars 2020, dhe ende nuk e ka tërhequr derogimin e saj, duke u bërë i vetmi Shtet derogimi i të cilit si reagim ndaj pandemisë mbetet në fuqi në kohën e këtij shkrimi. Më 3 janar 2022, Gjeorgjia informoi Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Evropës se ajo ka ndërmend ta vazhdojë derogimin deri më 1 janar 2023, duke deklaruar se kërcënimi global dhe lokal i Covid-19 mbetet domethënës, që do të thotë se Parlamenti i Gjeorgjisë miratoi zgjatjen e legjislacionit special të emergjencës deri më 1 janar 2023^[624].

(një muaj), Maqedonia e Veriut nga prilli në qershor 2020 (gati tre muaj), Republika e Moldavisë nga marsi në maj 2020 (dy muaj) dhe përsëri në prill 2021 (më pak se një muaj), Rumania nga marsi në maj 2020 (dy muaj), San Marino nga prilli në korrik 2020 (tre muaj) dhe Serbia nga prilli në tetor 2020 (gjashtë muaj).

[623] <https://www.coe.int/en/web/conventions/derogations-COVID-19>: "Lajmërimet sipas Nenit 15 të Konventës në kontekstin e pandemisë Covid-19", Zyra e Traktateve e Këshillit të Evropës, statusi deri më 3 janar 2022.

[624] Lajmërimi - JJ9303C Tr./005-285, 3 janar 2022, Njoftim i Komunikimit nga Gjeorgjia: <https://rm.coe.int/1680a4fdb0>.

2. Si operon KEDNJ në rastet e derogimit?

a. Kriteret substanciale

Neni 15 § 1 ravigjeron tre kriteret substanciale në mënyrë që derogimi të jetë në pajtueshmëri me Konventën^[625].

i) **Koha e luftës dhe emergjenca të tjera publike që kërcënojnë jetën e kombit**

E drejta për derogim mund të shfrytëzohet në dy kategori të dalluara situatash: si reagim në "kohë lufte" ose si reagim ndaj një "emergjence tjetër publike".

"Koha e luftës"

Derogimet e nxitura nga një situatë lufte, në kuptim të konfliktit të armatosur ndërkombëtar ose të brendshëm apo agresionit ushtarak nga një Shtet tjetër^[626] janë bërë nga Ukraina, Armenia, Azerbajxhani dhe Republika e Moldavisë. Prej këtyre derogimi i parë ndodhi pas ngjarjeve në Krime dhe në Ukrainën lindore në vitin 2014.^[627] Në Notën Verbale të saj Qeveria e Ukrainës iu referua "agresionit të armatosur", "aneksimit" dhe "pushtimit".^[628] Në mars 2022, Ukraina sërish e informoi Sekretarin e

[625] "Përmbledhja e Opinioneve dhe Raporteve të Komisionit të Venecias mbi Gjendjen e Jashtëzakonshme", Komisioni Evropian për Demokraci Përmes Ligjit (Komisioni i Venecias), Strasburg, 16 prill 2020, CDL-PI(2020)003, përmban pjesë të shkëputura nga raportet/studimet e miratuara nga Komisioni i Venecias në lidhje me gjendjen e jashtëzakonshme dhe kriteret e ligjshmërisë në këtë fushë.

[626] *Hassan k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i Dhomës së Madhe i 16 shtatorit 2014, Nr. 29750/09, §§ 40-41.

[627] Shih <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/webContent/62111354>. "Njoftimet sipas Nenit 15 të Konventës në kontekstin e pandemisë Covid-19", Zyra e Pakteve e Këshillit të Evropës, 29 qershor 2020. Në mënyrë të veçantë, Deklarata në Notën Verbale nga Përfaqësuesi i Përhershëm i Ukrainës, datë 5 qershor 2015; Deklarata në Notën Verbale nga Përfaqësuesi i Përhershëm i Ukrainës e datës 3 nëntor 2015; Deklarata në Notën Verbale nga Përfaqësuesi i Përhershëm i Ukrainës, datë 31 janar 2017.

[628] Shih https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list//conventions/treaty/005/declarations?p_auth=dA-605sOe "Rezervimet dhe Deklarimet për Paktin Nr. 005 – Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut", Zyra e Pakteve e Këshillit të Evropës, 10 shtator 2020. Në mënyrë të veçantë, § 1-3 të Notës Verbale nga Përfaqësuesi i Përhershëm i Ukrainës, datë 5 qershor 2015.

Përgjithshëm të Këshillit të Evropës në lidhje me qëllimin e saj për të bërë derogim nga Konventa, si rezultat i "agresionit ushtarak të Federatës Ruse kundër Ukrainës" dhe pas vendosjes së shtettrrethimit në Ukrainë^[629]. Në Notën Verbale, Qeveria e Ukrainës deklaroi që situata kërkonte derogim nga Nenet 8, 9, 10, 11, 14 dhe A1P1, A2P1 dhe A2P4. Shtettrrethimi dhe derogimi i Ukrainës më tej janë vazhduar me periudha vijuese prej 90 ditësh, dhe mbeten në fuqi në kohën e këtij shkrimi^[630].

Republika e Moldavisë gjithashtu ka bërë derogim nga KEDNJ në mars 2022, duke cituar "kërcënime madhore ndaj sigurisë kombëtare në afërsi të madhe me kufirin tokësor mes Republikës së Moldavisë dhe Ukrainës, si pasojë e fillimit të aksioneve ushtarake masive mbi territorin e Ukrainës më 24 shkurt 2022". Në Notën Verbale të saj, Republika e Moldavisë deklaroi që masat që tashmë ishin në fuqi, ose që ishin parashikuar të merreshin, mund të përfshijnë kufizime si (mes të tjerash): vendosja e një regjimi special për hyrjet dhe daljet nga vendi; nxjerrja jashtë territorit të saj e njerëzve prezencë e të cilëve mund të ndikonte në rendin dhe sigurinë publike; ndalimi i tubimeve, demonstratave publike dhe veprimeve të tjera masive; dhe koordinimi i aktivitetit të mas medias / futjen e rregullave të veçanta për përdorimin e komunikimeve masive, luftën kundër dezinformatave, lajmeve të rreme dhe gjuhës së urrejtjes^[631].

Armenia dhe Azerbajxhani bënë derogim nga KEDNJ në lidhje me shpërthimin e konfliktit të armatosur në Nagorno-Karabakh në shtator 2020. Derogimi i Armenisë zgjati prej shtatorit 2020 deri në prill 2021. Nota Verbale e saj deklaronte që masat emergjente ishin të nevojshme për t'iu përgjigjur sulmeve ajrore, raketore dhe tokësore në shkallë të gjerë nga forcat azerbajxhanase, që do të thoshte se ekzistonte rreziku i menjëhershëm i pushtimit të territorit të saj i cili kërcënonte sovranitetin, sigurinë dhe integritetin e saj territorial, si dhe jetën dhe sigurinë e qytetarëve paqësorë^[632]. Derogimi i Azerbajxhanit vazhdoi prej shtatorit 2020 deri në dhjetor

[629] <https://rm.coe.int/0900001680a5b0b0>: Lajmërimi JJ9325C Tr./005-287, 2 mars 2022.

[630] Në kohën e këtij shkrimi, komunikimi i fundit ishte më 12 shtator 2022, kur Ukraina njoftoi Këshillin e Evropës për vazhdimin e Ligjit Ushtarak prej 23 gushtit 2022 për një periudhë prej 90 ditësh: <https://rm.coe.int/0900001680a8076b>: Lajmërimi JJ9398C Tr./005-298, 12 shtator 2022.

[631] Shih Notën Verbale Nr. FRA-CoE/352/96 nga Përfaqësuesi i Përhershëm i Moldavisë në Këshillin e Evropës, datë 3 mars 2022, regjistruar në Sekretariatit e Përgjithshëm më 3 mars 2022. Derogimi u rinovua së fundi më 5 gusht 2022. Në kohën e shkrimit, gjendja e jashtëzakonshme dhe derogimi ishin vazhduar tri herë dhe ishin zgjatuar deri më 6 tetor 2022.

[632] Shih Notën Verbale Nr. 3201/C-308/2020 nga Përfaqësuesi i Përhershëm i Armenisë, datë 29 shtator 2020, regjistruar në Sekretariatit e Përgjithshëm më 29 shtator 2020, në të cilin Armenia njoftoi Këshillin e Evropës në lidhje me derogimet e përkohshme nga detyrimet e saj sipas Neneve 8, 10 dhe 11 të Konventës, Neni 1, Protokollit

2020 si reagim ndaj “aktit të agresionit” nga Armenia, për t’iu “kundërpërgjigjur agresionit ushtarak”, për të “garantuar sigurinë e civilëve” dhe për të mundësuar që forcat azerbajxhanase të ndërmerrenin masa kundër ofensivës , gjatë kohës që hynë në fuqi shtetrrëthimi dhe ora policore prej 9 të mbrëmjes deri në 6 të mëngjesit^[633].

Duhet theksuar se Gjykata nuk ka vlerësuar nëse derogimet e lartpërmendura përbënë shkelje të vlefshme sipas Nenit 15.

“Emergjenca të tjera publike”

Të gjitha situatat e tjera në lidhje me të cilat derogimi sipas Nenit 15 është përdorur nga Shtetet kanë pasur të bëjnë me “emergjencë tjetër publike”. Situatat të cilat më parë janë vlerësuar se përbëjnë ‘emergjencë publike’ dhe të cilat janë konsideruar se justifikojnë derogimet sipas Nenit 15, përfshijnë: kërcënimin ndaj sigurisë që kanoset nga aktivitetet e IRA-s (Ushtria Republikane Irlandeze) në Irlandën e Veriut,^[634] trazirat e armatosura në Noumea, Kaledonia e Re, në vitin 1985,^[635] kryengritja e armatosur në Shqipëri në vitin 1997,^[636] kërcënimi i sulmeve të rënda terroriste në Mbretërinë e Bashkuar pas sulmeve në Shtetet e Bashkuara më 11 shtator 2001,^[637] aktivitetet terroriste të PKK-së në Turqinë juglindore,^[638] sulmet

1 i Konventës dhe Neni 2, Protokolli 4 i Konventës.

[633] Shih Notën Verbale Nr. 5/11-3283/01/20 nga Ministria e Punëve të Jashtme e Azerbajxhanit, datë 28 shtator 2020, e regjistruar në Sekretariatën e Përgjithshëm më 28 shtator 2020, në të cilën Republika e Azerbajxhanit ushtron të drejtën e saj për derogim nga detyrimet e saj sipas Neneve 5, 6, 8, 10 dhe 11, Nenit 1 dhe 2 të Protokollit të Konventës dhe A2P4.

[634] *Irlanda k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 18 janarit 1978, Nr. 5310/71; shih gjithashtu Njoftimet e Derogimit të Mbretërisë së Bashkuar, datë 20 gusht 1971, 23 janar 1973 dhe 16 gusht 1973, Libri Vjetor i Konventës, vëllimi 14, faqe 32 dhe vëllimi 16, faqet 24, 26 dhe 28, respektivisht.

[635] Shih letrën nga i Ngarkuari me Punë a.i. i Francës, datë 7 shkurt 1985.

[636] Shih https://www.coe.int/en/web/conventions/fulllist//conventions/treaty/005/declarations?p_auth=dA605sOe "Rezervimet dhe Deklarimet për Paktin Nr. 005 – Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut", Zyra e Pakteve e Këshillit të Evropës, 10 shtator 2020. Në mënyrë të veçantë, Nota Verbale nga Ministria e Punëve të Jashtme e Shqipërisë, datë 26 korrik 1997.

[637] A. dhe të Tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar, vendimi i Dhomës së Madhe i 19 shkurtit 2009, Nr. 3455/05, § 181; shih gjithashtu https://www.coe.int/en/web/conventions/fulllist//conventions/treaty/005/declarations?p_auth=dA605sOe "Rezervimet dhe Deklarimet për Paktin Nr. 005 – Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut", Zyra e Pakteve e Këshillit të Evropës, 10 shtator 2020. Në mënyrë të veçantë, Notën Verbale nga Përfaqësuesi i Përhershëm i Ukrainës, datë 18 dhjetor 2001.

[638] *Aksyok k. Turqisë*, vendimi i 18 dhjetorit 1996, Nr. 21987/93, § 70; shih gjithashtu <https://www.coe.int/en/web/>

terroriste në Francë në vitin 2015^[639] dhe grushshteti ushtarak në tentativë në Turqi në vitin 2016.^[640] Mes vitit 2021 dhe 2022, Republika e Moldavisë bëri derogim nga KEDNJ (përfshirë detyrimet e saj për të mbrojtur lirinë e shprehjes sipas Nenit 10) në dy raste si reagim ndaj "krizës së madhe të energjisë" në territorin e saj, e cila (sipas mendimit të saj) mund të kërkonte racionimin e konsumimit të gazit natyror në tërë vendin dhe koordinimin e punës së mediave^[641]. Gjykata nuk ka marrë vendim nëse kriza e energjisë përbëri 'emergjencë publike' brenda kuptimit të Nenit 15.

"Kërcënimi i jetës së kombit"

Edhe kur situata vlerësohet se përbën "*luftë ose emergjencë tjetër publike*", për të mund të justifikuar derogimin sipas Nenit 15 § 1, ajo gjithashtu duhet "*të kërcënojë jetën e kombit*".

Historikisht, Gjykata e ka interpretuar këtë në kuptimin "një situatë e pazakontë krize ose emergjence e cila prek tërë popullatën dhe përbën kërcënim ndaj jetës së organizuar të komunitetit prej të cilit përbëhet Shteti."^[642] Kohët e fundit, është bërë e qartë se "emergjenca" mund të prekë vetëm një rajon të caktuar të një kombi, e jo krejt kombin në tërësi.^[643] Megjithatë, kur deklarohet derogim vetëm

[conventions/full-list/-/conventions/treaty/005/declarations?p_auth=dA605sOe](https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/005/declarations?p_auth=dA605sOe) "Rezervimet dhe Deklarimet për Paktin Nr. 005 – Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut", Zyra e Pakteve e Këshillit të Evropës, 10 shtator 2020. Në mënyrë të veçantë, Notën Verbale nga Përfaqësuesi i Përhershëm i Republikës së Turqisë, datë 24 korrik 2016.

[639] Shih https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/005/declarations?p_auth=dA605sOe "Rezervimet dhe Deklarimet për Paktin Nr. 005 – Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut", Zyra e Pakteve e Këshillit të Evropës, 10 shtator 2020. Në mënyrë të veçantë, letrën nga Përfaqësuesi i Përhershëm i Francës pranë Këshillit të Evropës, datë 24 nëntor 2015.

[640] Shih https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/005/declarations?p_auth=dA605sOe "Rezervimet dhe Deklarimet për Paktin Nr. 005 – Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut", Zyra e Pakteve e Këshillit të Evropës, 10 shtator 2020. Në mënyrë të veçantë, Notën Verbale nga Përfaqësuesi i Përhershëm i Republikës së Turqisë, datë 21 korrik 2016.

[641] Derogimet e përmbytura në Notën Verbale Nr. FRA-CoE/352/536 të Përfaqësuesit të Përhershëm të Moldavisë, datë 3 nëntor 2021, regjistruar në Sekretariatit e Përgjithshëm më 3 nëntor 2021, dhe në Notën Verbale Nr. FRA-CoE/352/81 nga Përfaqësuesi i Përhershëm të Moldavisë në Këshillin e Evropës, datë 25 shkurt 2022, regjistruar në Sekretariatit e Përgjithshëm të Moldavisë në Këshillin e Evropës, datë 25 shkurt 2022, regjistruar në Sekretariatit e Përgjithshëm më 25 shkurt 2022.

[642] *Lawless k. Irlandës (Nr. 3)*, vendimi i 1 korrikut 1961, Nr. 332/57, § 28.

[643] Për shembull, derogimi i Francës më 7 shkurt 1985 në lidhje me kryengritjet e armatosura në Noumea, Kaledonia e Re.

në lidhje me një rajon të veçantë brenda një Shteti, efektet ligjore të atij derogimi kanë të bëjnë rreptësisht vetëm me shtrirjen territoriale të cekur në notën drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm. As Shteti, as Gjykata nuk mund të shtrijnë efektet e derogimit drejt pjesëve të një Shteti që nuk përmenden në derogim^[644].

Emergjencia duhet të jetë aktuale ose e afërt, por nuk ka nevojë të jetë domosdoshmërisht e përkohshme. Është e mundur që një emergjencë publike brenda kuptimit të Nenit 15 të vazhdojë për disa vjet me radhë. Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, për shembull, ka dërguar gjashtë nota deroguese në lidhje me ushtrimin e fuqive jashtëgjyqësore të arrestimit, paraburgimit dhe internimit në Irlandën e Veriut nga viti 1971 deri në vitin 1975, dhe Gjykata pranoi që kërcënimi ndaj sigurisë që kanosej nga IRA përbënte emergjencë publike që kërcënonte jetën e kombit gjatë tërë kësaj kohe.^[645] Më tej, kriteri i afërsisë (ang. imminence) jo domosdoshmërisht kërkon që Shteti të presë që të ndodhë fatkeqësia para se të marrë masa për ta trajtuar atë, ndaj derogimi mund të thirret për të marrë masa parandaluese.^[646] Nga shembujt e cekur më lart duket e qartë që situatat siç janë kërcënimet ose sulmet terroriste,⁴⁷⁴^[647] protestat e armatosura, apo grushtshtetet^[648] pranohen nga Gjykata të jenë situata të emergjencave publike të cilat justifikojnë përdorimin e derogimit sipas Nenit 15. Megjithatë, demonstratat me turma të mëdha prej disa mijëra vetash të cilat

[644] *Barseghyan k. Armenisë*, vendimi i 21 dhjetorit 2021, nr. 17804/09, ku Gjykata e refuzoi argumentin e Qeverisë së Armenisë që ankesa e kërkuarit rreth arrestimit dhe paraburgimit të tij në qytetin Gyumri hyri brenda fushëveprimit të gjendjes së jashtëzakonshme dhe derogimit që ishte deklaruar në Yerevan.

[645] *Shih Irlanda k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 18 janarit 1978, Nr. 5310/71; *Brannigan dhe McBride k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 26 Maj 1993, Nr. 14553/89 dhe 14554/89; *Marshall k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi për pranueshmërinë i 10 korrikut 2001, Nr. 41571/98; dhe më së fundi *A. dhe të Tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i Dhomës së Madhe i 19 shkurtit 2009, Nr. 3455/05, § 178. Shih gjithashtu *Macdonald R. St. J.*, "Derogimi sipas Nenit 15 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut", në *Columbia Journal of International Law*, 36, 1998, pp. 241-242; Shih gjithashtu https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/005/declarations?p_auth=dA605sOe "Rezervimet dhe Deklarimet për Paktin Nr. 005 – Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut", Zyra e Pakteve e Këshillit të Evropës, 10 shtator 2020. Në mënyrë të veçantë, tërheqja e derogimit të përmbytur në një letër nga Përfaqësuesi i Përhershëm i Mbretërisë së Bashkuar, datë 5 maj 2006.

[646] *A. dhe të Tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar*, Vendimi i Dhomës së Madhe i 19 shkurtit 2009, Nr. 3455/05, § 177.

[647] *Shih Brannigan dhe McBride k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 26 majit 1993, Nr. 14553/89 dhe 14554/89, § 48; *A. dhe të Tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar*, Vendimi i Dhomës së Madhe i 19 shkurtit 2009, Nr. 3455/05, § 181.

[648] *Shih Mehmet Hasan Altan k. Turqisë*, vendimi i 20 marsit 2018, Nr. 13237/17, §§ 91-93; *Şahin Alpay k. Turqisë*, vendimi i 20 marsit 2018, Nr. 16538/17, §§ 75-77.

janë kryesisht paqësore nuk përbëjnë emergjencë publike që “kërcënon jetën e kombit”. Kur demonstrata të tilla përfshijnë dhunë të kryer nga grupe të vogla protestuesish, kjo mund të përbëjë “situatë serioze të rendit publik” por nuk e justifikon derogimin sipas Nenit 15^[649].

Kriza ose rreziku gjithashtu duhet të jetë të tilla që masat ose kufizimet normale të lejuara nga Konventa (siç janë ato që merren për ruajtjen e sigurisë, shëndetit dhe rendit publik sipas Neneve 8-11 të Konventës) janë qartazi të pamjaftueshme.^[650] Kapitulli II i këtij publikimi diskuton situatat në të cilat Shtetet mund të lejohen të ndërhyjnë në të drejta të caktuara, në kontekstin e reagimeve ndaj pandemisë, dhe kushtet në të cilat mund të bëhet kjo sipas Neneve 8-11. Ai po ashtu diskuton mënyrat në të cilat sigurohet pajtueshmëria me Nenet e tjera të Konventës. Në Kapitullin II nuk dolën shembuj ku vlerësohej e pamundur që Shteti të reagoje ndaj pandemisë brenda kornizës ekzistuese të Konventës. Prandaj, mbetet e paqartë nëse dhe në çfarë rrethanash pandemia Covid-19 do ta përmbushte këtë parakusht të veçantë për t’u mbështetur në Nenin 15. Në kohën e këtij shkrimi, Gjykata nuk e ka adresuar këtë çështje direkt^[651]. Megjithatë, çështja në fjalë analizohet më me hollësi në seksionin (c) poshtë.

ii) **Shkalla rreptësisht e kërkuar nga urgjencat e situatës**

Shtetet lejohen të derogojnë nga detyrimet e tyre për të mbrojtur të drejtat e Konventës vetëm deri në masën që kërkohet rreptësisht nga situata. Kjo nënkupton një kriter proporcionaliteti mes situatës së emergjencës dhe masave të marra në reagim ndaj saj^[652]. Edhe në gjendje të jashtëzakonshme, Shtetet vazhdojnë ta kenë detyrimin për të mbrojtur vlerat e një shoqërie demokratike, siç është pluralizmi, toleranca dhe mendja e hapur^[653].

[649] *Dareskizb Ltd k. Armenisë*, vendimi i 21 shtatorit 2021, Nr. 61737/08, §§ 61 – 63.

[650] *Shih Danimarka, Norvegjia, Suedia dhe Holanda k. Greqisë (“çështja greke”)*, vendimi i 24 janarit 1968, Nr. 3321/67, 3322/67, 3323/67 dhe 3344/67, Raport i Komisionit, § 153.

[651] Në *Terheş v. Romania*, vendimi i 13 prillit 2021, Nr. 49933/20, §46 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim), Gjykata gjeti se ishte e panevojshme të shqyrtohej validiteti i derogimit të bërë nga qeveria rumune gjatë pandemisë Covid-19. Qeveria rumune kishte deroguar nga KEDNj në lidhje me A2P4 (E drejta e lirisë së lëvizjes). Megjithatë, ankesa u bë në lidhje me shkeljen e Nenit 5, i cili u gjet se nuk angazhohej. Kërkuesi nuk iu referua të drejtave nga A2P4.

[652] <https://rm.coe.int/0900001680a8311e> “Drafti i raportit të CDDH mbi praktikën e Shteteve anëtare në lidhje me derogimet nga KEDNj në situata krize”, Komiteti Drejtues për të Drejtat e Njeriut (CDDH), 29 shtator 2022.

[653] *Mehmet Hasan Altan k. Turqisë*, vendimi i 20 marsit 2018, Nr. 13237/17, § 210; *Şahin Alpay k. Turqisë*, vendimi i 20

Ka një sërë faktorësh që janë relevantë për vendimin e Gjykatës lidhur me faktin nëse një Shtet ka shkuar përtej asaj që kërkohet rreptësisht nga një situatë emergjente, për shembull natyra e të drejtave të prekura nga derogimi, rrethanat që kanë çuar deri aty, dhe kohëzgjatja e situatës emergjente.^[654] Gjykata gjithashtu merr parasysh nëse masat përbëjnë një reagim të mirëfilltë ndaj situatës së emergjencës, nëse ato janë përdorur për qëllimin për të cilin janë lejuar, nëse derogimi është i kufizuar në fushëveprim, nëse nevoja për derogim është mbajtur nën shqyrtim, nëse masat i janë nënshtruar mbrojtjeve strikte, proporcionaliteti i masave dhe nëse ato përfshinin ndonjë diskriminim të justifikueshëm dhe nëse masat janë futur përmes një procedure që është në përputhje me ligjin dhe i nënshtrohen kontrollit efektiv dhe shqyrtimit gjyqësor e parlamentar^[655]. Për shembull, edhe kur Gjykata e pranon ekzistencën e një emergjence publike që kërcënon jetën e kombit, masat deroguese që diskriminojnë në mënyrë të pajustificueshme mes shtetasve dhe jo-shtetasve dhe të cilat janë pra disproporcionale, vlerësohen se shkojnë përtej asaj që kërkohet në mënyrë strikte nga urgjencat e situatës^[656].

Neni 15 § 1 nuk i detyron Shtetet të bëjnë derogim. Termi "mund" i përdorur në këtë paragraf nënkupton që Shtetet duhet ta vlerësojnë vetë nëse kërkohet derogim në situata emergjencash specifike me të cilat përballen. Gjykata përgjithësisht ka lejuar hapësirë të gjerë vlerësimi që Shtetet të përcaktojnë nëse jeta e kombit është në rrezik, dhe ka gjykuar se qeveritë janë në pozicion më të përshtatshëm për të vendosur dy gjëra: i) nëse emergjenca ekziston; dhe ii) fushëveprimin e derogimeve të nevojshme për të shmangur ose lehtësuar efektet e një emergjence të tillë^[657].

marsit 2018, Nr. 16538/17, § 180.

[654] *Brannigan dhe McBride k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 26 majit 1993, Nr. 14553/89 dhe 14554/89, § 43; *A. dhe të Tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar*, Vendimi i Dhomës së Madhe i 19 shkurtit 2009, Nr. 3455/05, § 173.

[655] [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2020\)014-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2020)014-e): Komisioni i Venecias, Raport – Respekti për demokracinë, të drejtat e njeriut dhe shtetin e së drejtës gjatë gjendjeve të jashtëzakonshme, reflektime, 19 qershor 2020, parashtron një numër parimesh që qeverisin deklarimin e gjendjes së jashtëzakonshme, përfshirë nevojshmërinë, proporcionalitetin, përkohshmërinë, këqyrjen efektive parlamentare dhe gjyqësore si dhe parashikueshmërinë e ligjeve të emergjencës. Shih gjithashtu Komitetin e OKB-së për Të Drejtat e Njeriut, Deklarata për Derogimet nga Konventa në Lidhje me Pandeminë Covid-19, 30 prill 2020, <https://www.ohchr.org/Documents/HRBodies/CCPR/COVIDstatementEN.pdf>

[656] *A. dhe të Tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i Dhomës së Madhe i 19 shkurtit 2009, Nr. 3455/05, §190.

[657] *Aksoy k. Turqisë*, vendimi i 18 dhjetorit 1996, Nr. 21987/93.

Megjithatë, ky diskrecion nuk është i pakufishëm. Deri më sot, Gjykata ka vendosur në tri raste që derogimi ishte i pavlefshëm^[658]. Gjykata nuk e ka për detyrë të përcaktojë vlefshmërinë e çdo derogimi. Megjithatë, Gjykatës mund t'i kërkohet të shqyrtojë: vendimet e Shteteve për të bërë derogim në rrethana të caktuara; zgjedhjen e tyre për masat e marra gjatë periudhës së derogimit; dhe shkallën deri ku ato masa kërkohen rreptësisht nga urgjencat e krizës. Përveç kësaj, gjatë derogimit Shtetet duhet të respektojnë kriteret e përmendura më poshtë për sa i përket pamundësisë për të deroguar nga të drejtat absolute dhe respekti për detyrimet e tjera sipas të drejtës ndërkombëtare.

iii) Konsekuenca ndaj detyrimeve të tjera sipas të drejtës ndërkombëtare

Derogimet nga KEDNJ-ja gjithashtu duhet të jenë në pajtueshmëri me detyrimet e tjera të një Shteti sipas të drejtës ndërkombëtare, një formulim i cili gjendet po ashtu në Nenin 4 ICCPR^[659]. Kështu, kur bëhet derogim prej të drejtave të përmbajtura në ICCPR dhe në KEDNJ, do të ishte e nevojshme të veprohet në përputhje me formatetet e ndryshme në lidhje me derogimin e përcaktuar në të dy instrumentet^[660].

iv) Derogimet e pamundura

Neni 15 § 2 parashikon që asnjë derogim nuk mund të bëhet në mënyrë të vlefshme, në çfarëdo situatë, nga të drejtat e garantuara nga Nenet 2, 3, 4 § 1 dhe

[658] *Greqia k. Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. 3321/67, në të cilën Komisioni gjeti se nuk kishte 'emergjencë publike që kërcënonte jetën e kombit'. *A. dhe të Tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i Dhomës së Madhe i 19 shkurtit 2009, Nr. 3455/05, ku derogimi ishte i pavlefshëm sepse masat relevante u gjetën se ishin pa justifikim diskriminuese dhe joproportionale; dhe *Dareskizb Ltd k. Armenisë*, vendimi i 21 shtatorit 2021, Nr. 61737/08, ku Gjykata gjeti se situata relevante nuk përbënte emergjencë publike që kërcënonte jetën e kombit.

[659] Neni 4 ICCPR parashikon që "Në kohë emergjencash publike që kërcënojnë jetën e kombit dhe ekzistenca e të cilave shpallet zyrtarisht...".

[660] *Brannigan dhe McBride k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 26 majit 1993, Nr. 14553/89 dhe 14554/89, §§ 67-73, ku Gjykata e konsideroi dështimin e qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar për të lëshuar një deklaratë zyrtare nënkuptonte që derogimi i saj nga ICCPR nuk ishte në përputhje me detyrimet e saj sipas të drejtës ndërkombëtare. Gjykata gjeti se nuk ishte roli i saj të përipiqej të përkufizonte në mënyrë autoritare kuptimin e termave "zyrtarisht e deklaruar" në Nenin 4 ICCPR, por, pavarësisht nga kjo, arriti në përfundimin se deklarata e bërë nga Sekretari i Brendshëm në parlament ishte i mjaftueshëm për të nënkuptuar se Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar veprroi në përputhje me Nenin 4 ICCPR, dhe se për këtë arsye ajo kishte vepruar në përputhje me detyrimet e saj sipas të drejtës ndërkombëtare.

7 të KEDNj- së. Gjithashtu, është e pamundur të derogohet prej heqjes së dënimit me vdekje, parashikuar nga Protokollet 6 dhe 13 të Konventës.^[661] Urgjencat e një emergjence publike nuk parashikojnë përjashtime nga kjo rregullë^[662].

b. Kriteret procedurale

Sa u përket mbrojtjeve procedurale, Neni 15 § 3 përmban detyrimin për të njoftuar dhe mbajtur Sekretarin e Përgjithshëm plotësisht të informuar rreth masave të marra, arsyeve për to, dhe momentin kur ato do të përfundojnë. Neni 15 § 3 gjithashtu kërkon shqyrtim të përhershëm të nevojës për marrjen e masave emergjente^[663].

Njoftimi për Sekretarin e Përgjithshëm duhet të përfshijë informacione të mjaftueshme për t'u mundësuar Shteteve dhe Gjykatës që të vlerësojnë natyrën dhe shkallën e derogimit. Në mungesë të një note deroguese zyrtare dhe publike, Neni 15 nuk aplikohet, dhe Konventa i aplikohet në tërësi të gjitha masave të marra nga Shteti.^[664] Shtetit derogues nuk i kërkohet detyrimisht të tregojë Nenet specifike të Konventës që do të preken nga derogimi^[665]. Megjithatë, Shtetet shpesh vendosin ta bëjnë këtë, dhe qëndrimi i Sekretarit të Përgjithshëm është që preferohet që Shtetet, për arsye të sigurisë ligjore, të specifikojnë saktësisht se prej cilave dispozita kanë qëllim të bëjnë derogim^[666].

Sekretari i Përgjithshëm gjithashtu merret me Shtetet në lidhje me masat e emergjencës, dhe ka filluar të luajnë një rol gjithnjë e më aktiv në këqyrjen e justifikimeve për derogim sipas Nenit 15. Për shembull, gjatë trazirave civile në Shqipëri në vitin 1997, ai kërkoi justifikime të mëtëjshme për masat e emergjencës

[661] Shih Nenin 3 të Protokollit 6 dhe Nenin 2 të Protokollit 13 ku të dy parashikojnë me formulime identike që: "Prej dispozitave të këtij Protokollit nuk lejohet derogim sipas Nenit 15 të Konventës."

[662] Shih *Öcalan k. Turqisë (No. 2)*, vendimi i 18 marsit 2014, Nr. 24069/03, 197/04, 6201/06 dhe 10464/07, §§ 97-98; *Rantsev k. Qipros dhe Rusisë*, vendimi i 7 janarit 2010, Nr. 25965/04, § 283.

[663] *Brannigan dhe McBride k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 26 majit 1993, Nr. 14553/89 dhe 14554/89, § 54.

[664] *Qipro k. Turqisë*, Raporti i Komisionit i datës 4 tetor 1983, Nr. 8007/77, §§ 66-68.

[665] *Ahmet Hüseyin Altan k. Turqisë*, vendimi i 13 prillit 2021, nr. 13252/17, ku nota e derogimit nga Turqia nuk përmendi specifikisht se me cilat Nene kishte të bënte derogimi, por vetëm shpalli se „masat e marra mund të përfshijnë derogimin nga detyrimet e Konventës" dhe Gjykata ishte e përgatitur të pranonte se kërkesat formale të derogimit ishin përbushur.

[666] <https://rm.coe.int/0900001680a8311e> "Drafti i raportit të CDDH mbi praktikën e Shteteve anëtare në lidhje me derogimet nga KEDNj në situata krize", Komiteti Drejtues për të Drejtat e Njeriut (CDDH), 29 shtator 2022, § 23.

të Qeverisë dhe në vitin 2005 ai nuk e pranoi lajmërimin e Francës për gjendjen e emergjencës që u shpall gjatë protestave në Paris si notë deroguese.^[667]

Rezoluta e PACE-s 2209 (2018) rekomandoi që Sekretari i Përgjithshëm të vepronte si organ këshillimor para dhe gjatë derogimeve për "t'i ofruar këshillim cilësdo Palë Shteti që konsideronte mundësinë e derogimit në lidhje me faktin nëse derogimi ishte i nevojshëm dhe, nëse po, se si të kufizohej në mënyrë strikte fushëveprimi i tij."^[668] Kjo shtresë e re e mbikqyrjes jo-gjyqësore u bë gjithnjë e më relevante teksa Shtetet u sfiduan me shkallën deri ku masat e tyre ndaj pandemisë së Covid-19 mund të ndërhyjnë lejueshëm tek të drejtat e njeriut. Kohët e fundit, Sekretari i Përgjithshëm i shkroi një letër Kryeministrit të Hungarisë, duke e paralajmëruar që legjislacioni i ndërmarrë në reagim ndaj pandemisë Covid-19 do të vinte në rrezik parimet demokratike dhe të drejtat e njeriut.^[669] Sekretari i Përgjithshëm gjithashtu publikoi një paketë instrumentesh për Shtetet në lidhje me respektimin e demokracisë, shtetit të së drejtës dhe të drejtave të njeriut gjatë pandemisë, ku përfshihej një seksion rreth derogimit në përputhje me Konventën gjatë kohëve të emergjencave^[670].

c. Të derogohet apo të mos derogohet gjatë situatës së pandemisë Covid-19?

Mes marsit dhe prillit 2020, dhjetë Shtete e njoftuan Këshillin e Evropës mbi qëllimin e tyre për të deroguar nga detyrimet e tyre sipas KEDNj-së në kuadër të reagimit ndaj pandemisë.^[671] Kjo përfaqësonte një numër pa precedent të

[667] Shih <https://assembly.coe.int/nw/xml/XRef/Xref-XML2HTML-en.asp?fileid=24505&lang=en> "Gjendja e emergjencës: çështjet e proporcionalitetit lidhur me derogimin sipas Nenit 15 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut", R. Comte, Raport i Asamblesë Parlamentare, Komiteti për Çështjet Ligjore dhe të Drejtat e Njeriut, 27 shkurt 2018.

[668] Shih <https://bit.ly/2HoXd2Q> "Gjendja e emergjencës: çështjet e proporcionalitetit lidhur me derogimin sipas Nenit 15 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut", Rezoluta 2209 (2018), Asambleja Parlamentare, 24 prill 2018.

[669] Shih <https://rm.coe.int/orban-pm-hungary-24-03-2020/16809d5f04> Letra e Sekretarit të Përgjithshëm drejtuar Kryeministrit të Hungarisë, 24 mars 2020.

[670] Respektimi i demokracisë, shtetit të së drejtës dhe të drejtave të njeriut në kuadër të krizës sanitare të Covid-19, Paketë instrumentesh për shtetet anëtare, SG/Inf(2020)11, 7 prill 2020.

[671] Shtetet Kontraktuese që e kanë shfrytëzuar këtë mundësi deri më 13 gusht 2020 janë: Shqipëria, Armenia, Estonia, Gjeorgjia, Letonia, Maqedonia e Veriut, Moldavia, Rumania, San Marino dhe Serbia. Shih <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/ëebContent/6211354> "Njoftimet sipas Nenit 15 të Konventës në kontekstin e pandemisë Covid-19", Zyra e Pakteve e Këshillit të Evropës, 29 qershor 2020.

derogimeve të njëkohshme, dhe nxiti debatet nëse pandemia Covid-19 justifikon derogimin sipas Nenit 15.^[672] Shumë Shtete të tjera kanë raportuar se kanë marrë në konsideratë derogimin nga detyrimet e tyre sipas KEDNJ-së në lidhje me masat e marra gjatë pandemisë Covid-19, por kanë arritur në përfundimin që nuk ishte e nevojshme^[673]. Siç u diskutua më lart, në vitin 2021, Letonia dhe Moldavia e njoftuan Këshillin e Evropës rreth qëllimit të tyre për të deroguar sërish nga KEDNJ-ja, gjatë një ri-vërshimi të infektiveve me Covid-19. Të gjitha Shtetet, përveç Gjeorgjisë, tani i kanë tërhequr derogimet e tyre, ndërsa Gjeorgjia ka thënë se planifikon ta vazhdojë derogimin deri në janar 2023.

Gjykata nuk i është adresuar specifikisht vlefshmërisë së ndonjë derogimi të futur gjatë pandemisë Covid-19. Megjithatë, ndërkohë që Gjeorgjia vazhdon ta zgjasë gjendjen e emergjencës dhe derogimin e saj, kjo zgjatje e derogimit mund t'i japë shkas ankesës.

[672] Shih <https://www.leclubdesjuristes.com/blog-du-coronavirus/que-dit-le-droit/recours-article-15-cedh/> "Rekursi në Nenin 15 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut" (frëngji: "La recours à l'article 15 de la Convention européenne des droits de l'homme"), J.P. Costa, klubi i juristëve, 27 prill 2020; <https://www.leclubdesjuristes.com/blog-du-coronavirus/que-dit-le-droit/la-convention-edh-face-au-covid-19-depasser-les-apparences/> "KEDNJ përballë Covid-19: përtej aparençave" (frëngji: "La Convention EDH face au Covid-19: dépasser les apparences"), F. Sudre, klubi i juristëve, 27 prill 2020; <https://www.leclubdesjuristes.com/blog-du-coronavirus/que-dit-le-droit/la-restriction-vaudra-toujours-mieux-que-la-derogation/> "Kufizimet shkojnë gjithmonë më mirë se derogimet..." (frëngji: "La restriction vaudra toujours mieux que la derogation..."), S. Touzé, klubi i juristëve, 22 prill 2020; shih gjithashtu: https://www.academia.edu/42294162/Derogations_from_the_European_Convention_on_Human_Rights_The_Case_for_Reform, "Derogatimet nga Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut – Argumentet Pro Reformës", S. Wallace, academia.edu <https://verfassungsblog.de/covid-19-and-derogations-before-the-european-court-of-human-rights/> "Covid-19 dhe Derogatimet para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut", S. Molloy, Verfassungsblog on Constitutional Matters, 10 prill 2020; <https://strasbourgobservers.com/2020/04/01/states-should-declare-a-state-of-emergency-using-article-15-echo-to-confront-the-coronavirus-pandemic/> "Shtetet duhet të deklarojnë Gjendjen e Emergjencës duke përdorur Nenin 15 të KEDNJ-së për të Përballuar Pandeminë e Koronavirusit", A. Greene, Strasbourg Observers, 1 prill 2020; <https://www.euractiv.com/section/justice-home-affairs/news/coronavirus-derogations-from-human-rights-send-wrong-signal-say-meps/> "Derogatimet nga të drejtat e njeriut për shkak të koronavirusit japin sinjalet e gabuara, thotë MEP", K. Maksimov, euractiv news, 24 mars 2020.

[673] <https://rm.coe.int/0900001680a8311e> "Draft raporti mbi praktikat e Shteteve anëtare mbi derogimet nga KEDNJ në situata krize", Komiteti Drejtues për Të Drejtat e Njeriut (CDDH), 29 shtator 2022, raporti përfshin përgjigjet e 28 Shteteve në një pyetësor lidhur me qasjen e tyre ndaj derogimit, dhe citon Belgjikën, Francën, Lituani dhe Poloninë si Shtete që kanë konsideruar derogimin gjatë pandemisë, por nuk e kanë bërë, dhe raportin që Estonia e ka konsideruar derogimin për herë të dytë, por nuk e ka bërë.

A përbën pandemia Covid-19 emergjencë publike që kërcënon jetën e kombit?

Pothuajse nuk ka dyshime që në shumë vende pandemia Covid-19 përbën ose ka përbërë një situatë të pazakontë krize ose emergjence e cila prek tërë popullatën dhe kërcënon jetën e organizuar të komunitetit. Megjithatë, është më pak e qartë nëse masat ose kufizimet normale të të drejtave të lejuara nga Konventa janë "qartazi të pamjaftueshme" në kontekstin e luftimit të pandemisë e rrjedhimisht nëse derogimi është i justifikuar.^[674] Kjo ka sjellë një situatë ku disa Shtete e kanë vlerësuar të nevojshme të bëjnë derogim prej Konventës për të implementuar masa të cilat janë gjerësisht të ngjashme me ato që implementohen nga Shtetet të cilat nuk kanë deroguar prej Konventës, por të cilat besojnë se masat janë të justifikueshme sipas përjashtimeve që përmban Konventa^[675].

Gjykata ka sugjeruar në mënyrë implicite se do t'u takonte Shteteve të dilnin në përfundimin që pandemia Covid-19 përbën emergjencë publike që kërcënon jetën e kombit, por nuk ka vendosur në mënyrë eksplicite nëse ndonjëri prej derogimeve kanë qenë / janë të vlefshme^[676]. Kjo pasqyron qasjen e marrë nga disa prej organeve të Këshillit të Evropës të cilat kanë deklaruar se përdorimi i klauzolave të kufizimeve të zakonshme në lidhje me mbrojtjen e shëndetit në shumë raste duhet të kishte qenë i mjaftueshëm për të justifikuar masat kufizuese të ndërmarra si reagim ndaj pandemisë, por që, përjashtimisht, masa të caktuara kombëtare mund të kenë kërkuar derogime nga detyrimet e Konventës^[677].

[674] *Danimarka, Norvegjia, Suedia dhe Holanda k. Greqisë* ("çështja greke"), Raporti i Komisionit, Nr. 3321/67, 3322/67, 3323/67 dhe 3344/67, § 153.

[675] Shih <https://opiniojuris.org/2020/04/06/covid-19-symposium-to-derogate-or-not-to-derogate/> "Simpoziumi i Covid-19: Të Derogohet apo Të Mos Derogohet?", Martin Scheinen, *Opinio Juris*, 6 prill 2020.

[676] *Communauté genevoise d'action syndicale (CGAS) k. Zvicrës*, vendimi i 15 marsit 2022, Nr. 21881/20, §§ 68 dhe 90 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim). Megjithatë, kjo çështje iu referua Dhomës së Madhe më 5 shtator 2022, që do të thotë se vendimi i seksionit të tretë të Gjykatës nuk është përfundimtar dhe në lidhje me këtë çështje do të merret një vendim i ri i Dhomës së Madhe. Seksioni i tretë i Gjykatës theksoi se Shtetet e Tjera, të vetëdijshme për faktin se një ndalesë e përgjithshme e të drejtës për të protestuar do të ishte në pajtueshmëri me Nenin 11, zgjodhën të bënin derogim formal nga KEDNj, dhe kur ishte relevante për gjetjen e shkeljes së Nenit 11, që Zvicra nuk kishte zgjedhur të bënte derogim.

[677] Për shembull, Drejtori i Këshillit të Evropës për Këshillim Ligjor dhe Të Drejtën Ndërkombëtare Publike, në Memorandumin mbi Covid-19 – Derogimet sipas Nenit 15 të KEDNj-së, JJ011/2020 AG/gd, 16 mars 2020, dhe Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës, në paketën e instrumenteve: Respektimi i demokracisë, shtetit të së drejtës dhe të drejtave të njeriut në kuadër të krizës sanitare të Covid-19, SG/Inf(2020)11, 7 prill 2020.

Siç diskutohet më lart dhe në Kapitullin II të këtij publikimi, Shtetet nuk lejohen të derogojnë prej Neneve 2 dhe 3 (të drejtat e jetës dhe të lirisë nga trajtimi çnjerëzor dhe degradues) edhe gjatë një situatë emergjente. Ndërkohë që Shtetet mund të lejohen të derogojnë prej Neneve 8 – 11 të Konventës, Shtetet po ashtu lejohen të ndërhyjnë në këto të drejta (pa nevojën e derogimit) deri në shkallën e nevojshme në një shoqëri demokratike, për qëllimet e mbrojtjes së shëndetit, sigurisë dhe rendit publik, nëqoftëse ndërhyrja është e parashikuar me ligj. Më tej, Neni 5 i Konventës lejon paraburgimin e ligjshëm të personave për të parandaluar përhapjen e sëmundjeve ngjitëse. Kapitulli II jep shembuj të situatave që janë shfaqur në kontekstin e pandemisë të cilat mund të përbëjnë ndërhyrje në Nenet 8 deri në 11, ose privim të lirisë sipas Neni 5. Ai gjithashtu ofron udhërrëfim rreth kushteve që Shtetet duhet të plotësojnë për t'u siguruar që situata të tilla që përfshijnë privimin e lirisë ose ndërhyrje në Nenet 8-11 të jenë në përputhje me Konventën.

E drejta për gjyq të drejtë sipas Neni 6 është një e drejtë tjetër nga e cila lejohet derogimi sipas Neni 15, por e cila nuk përmban ndonjë përjashtim eksplicit për qëllimin e mbrojtjes së shëndetit publik. Çështjet që mund të dalin për Shtetet që përpiqen të sigurojnë pajtueshmërinë me kriteret e Neni 6 gjatë diskutohen në seksionin mbi Nenin 6 (E drejta për gjyq të drejtë) në Kapitullin II të këtij publikimi. Nëse Shtetet e vlerësojnë të nevojshme të ndërhyjnë në këtë të drejtë si pjesë e reagimit të tyre ndaj pandemisë, mungesa e një kufizimi relevant të lejuar mund të përbëjë argument për të justifikuar derogimin. Megjithatë, seksioni përkatës në Kapitullin II të këtij publikimi përmban sugjerime se si Shtetet mund të përpiqen të sigurojnë pajtueshmërinë me Nenin 6 edhe gjatë pandemisë, për shembull përmes përdorimit kreativ të teknologjisë.

Më tej, Neni 6 nuk u shfaq në njoftimet e bëra nga Shtetet për të justifikuar derogimet e tyre prej Konventës në kushtet e pandemisë. Masat e parashikuara në njoftime përfshinin kufizime të paspecifikuara të lirisë së lëvizjes,^[678] ndalimet për të hyrë e dalë nga Shteti, gjoha të larta dhe masa të rrepta për zbatimin e mbylljeve, lirimi me kusht i të burgosurve, zgjatjen e mundshme të dënimeve me burg, koordinimin e aktiviteteve të mediave dhe kufizimet ndaj llojeve dhe burimeve të informacionit që lejohen të publikohen në lidhje me Covid-19.^[679]

[678] Shih <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/webContent/62111354> "Njoftimet sipas Neni 15 të Konventës në kontekstin e pandemisë Covid-19", Zyra e Pakteve e Këshillit të Evropës, 29 qershor 2020. Në mënyrë të veçantë, Deklaratën në the Notën Verbale nga Përfaqësuesi i Përhershëm i Republikës së Moldavisë, datë 20 mars 2020; Deklarata në Notën Verbale nga Përfaqësuesi i Përhershëm i Rumanisë, datë 18 mars 2020.

[679] Shih <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/webContent/62111354> "Njoftimet

Gjykata ka sugjeruar që masat siç është ndalimi i tërësishëm i të drejtës për të protestuar mund të jenë lloji i masave në lidhje me të cilat derogimi është i përshtatshëm, duke pasur parasysh se kufizime të tilla janë përgjithësisht më të vështira për t'u justifikuar në përputhje me Nenin 11 § 2^[680]. Megjithatë, këto shembuj të arsyeve për të cilat janë bërë derogimet ngrenë alarmin për gjerësinë e mundshme të masave për implementimin e të cilave është përdorur derogimi. Për shembull, ndalimet e tërësishme të lirisë së lëvizjes, tubimit dhe hyrje-daljes nga një shtet mund të shkojnë përtej asaj që është e nevojshme për të mbrojtur shëndetin publik, nëqoftëse do të kishte qenë e mundur të futeshin masa të tjera më pak kufizuese (si caktimi i kushteve për të drejtën për t'u tubuar me qëllim të kufizimit të rreziqeve shëndetësore, përfshirë kriterin për të mbajtur maska, për të ruajtur distancën dhe për t'u takuar vetëm në ambiente të jashtme^[681]). Masat për të kontrolluar informacionet e publikuara rreth Covid-19 mund të kenë penguar transmetimin e nevojshëm të informacionit rreth pandemisë dhe faktikisht mund të ketë penguar mbrojtjen e shëndetit, duke theksuar nevojshmërinë e kontrolleve efektive për të siguruar që masat e futura në kushtet e gjendjes së emergjencës realisht t'u shërbejnë qëllimeve për të cilat është bërë derogimi.^[682]

Në fund, siç theksohet në Kapitullin II, kur masat që kufizojnë të drejtat merren për të reaguar ndaj situatave të pazakonta të krizave, Gjykata përgjithësisht u

sipas Nenit 15 të Konventës në kontekstin e pandemisë Covid-19", Zyra e Pakteve e Këshillit të Evropës, 29 qershor 2020. Në mënyrë të veçantë, për 'hyrjen e daljen' Shih Deklaratën nga Përfaqësuesi i Përhershëm i Republikës së Armenisë, datë 20 mars 2020; për 'gjobat e larta dhe masat strikte për zbatimin e mbylljeve' shih Deklaratën nga Republika e Shqipërisë, datë 1 prill 2020; për 'lirimim me kusht të të burgosurve dhe zgjatjen e mundshme të dënimeve me burg' shih Deklaratën nga Përfaqësuesi i Përhershëm i Letonisë, datë 16 mars 2020; për 'koordinimin e aktiviteteve të medias' shih Deklaratën nga Përfaqësuesi i Përhershëm i Estonisë, datë 20 mars 2020; për 'kufijtë për llojet dhe burimet e informacionit', shih Deklaratën nga Përfaqësuesi i Përhershëm i Rumanisë, datë 18 mars 2020.

[680] *Communauté genevoise d'action syndicale (CGAS) k. Zvicrës*, vendimi i 15 marsit 2022, Nr. 21881/20, § 68 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim). Megjithatë, kjo çështje iu referua Dhomës së Madhe më 5 shtator 2022, që do të thotë se ky vendim i seksionit të tretë të Gjykatës nuk është përfundimtar dhe se në lidhje me çështjen do të merret një vendim i ri nga Dhoma e Madhe.

[681] *Communauté genevoise d'action syndicale (CGAS) k. Zvicrës*, vendimi i 15 marsit 2022, Nr. 21881/20, § 68 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim). Megjithatë, kjo çështje iu referua Dhomës së Madhe më 5 shtator 2022, që do të thotë se ky vendim i seksionit të tretë të Gjykatës nuk është përfundimtar dhe se në lidhje me çështjen do të merret një vendim i ri nga Dhoma e Madhe.

[682] Për diskutim të mëtejshëm mbi këto çështje dhe për shembuj të këtyre kufizimeve, shih seksionin mbi Nenin 10 (E drejta e shprehjes së lirë) në Kapitullin II të këtij publikimi.

ka lejuar Shteteve interpretim të gjerë të fushëveprimit të kufizimeve të lejuara. Prandaj derogimi sipas Nenit 15 mund të ketë qenë i panevojshëm nëse vetëm perceptimet e zgjeruara të të drejtave mund të jenë të justifikueshme në vijim të qëllimit legjitim të mbrojtjes së shëndetit të kombit dhe të drejtës së jetës në kohë krizash.

Të derogohet?

Ndërmarrja e qasjes që derogimi është i panevojshëm sepse Gjykata do t'u lejojë Shteteve hapësirë të gjerë vlerësimi për të ndërhyrë në të drejtat në këtë kontekst rrezikon dobësimin e mbrojtjeve të të drejtave të njeriut. Kjo qasje rrezikon normalizimin e implementimit të fuqive të jashtëzakonshme, duke zgjeruar fushëveprimin e kufizimeve të lejuara për të mbuluar rrethana më të gjera dhe modifikimin e testit të përdorur për të justifikuar përdorimin e tyre. Atëherë mund të nënvizohet dhe të thirret një nocion i zgjeruar i kufizimeve të lejuara të këtyre të drejtave përtej kontekstit të reagimit ndaj Covid-19. Rreziku është se, në vend të 'mosaplikimit' të të drejtave të caktuara të Konventës përmes derogimit, respekti për mu këto të drejta do të pësonte njësoj nga një metodë 'akomodimi' e të drejtave të Konventës në një situatë që ka karakter emergjent.^[683] Një avantazh i deklarimit të derogimit është se vihet një vijë e qartë mes kufizimeve të të drejtave që janë të lejueshme në rrethana të zakonshme dhe atyre që janë të lejueshme vetëm në kontekstin e reagimeve ndaj krizës së Covid-19. Derogimi mund të përfaqësojë pranimin që çdo kufizim i të drejtave duhet të jetë i përkohshëm, të shqyrtohet dhe të përdoret vetëm për qëllimin e luftimit të impaktit të emergjencës^[684].

[683] Shih për këtë debat: *Hassan k. Mbretërisë së Bashkuar, Vendimi i Dhomës së Madhe* i 16 shtatorit 2014, Nr. 29750/09, Opinioni Mospajtuës i Gjyqarit Spano, së bashku me gjyqtarët Nicolou, Bianku dhe Kalaydjjeva, ku thuhet "Për më tepër, meqenëse opsioni i mosaplikimit nuk është më në tavolinë, sepse derogimi nga Konventa nuk ka ndodhur, kjo metodë e re e akomodimit nuk mund të implementohet në mënyrë të tillë që të ketë efektivisht të njëjtat efekte ligjore si mosaplikimi"; shih gjithashtu debatin në Dhomën e Lordëve në Mbretërinë e Bashkuar në gësitjen al-Jedda (R. (mbi kërkesën e Al-Jedda) (FC) (Kërkuesi) k. Sekretarit të Shtetit për Mbrojtjen (I padituri) [2007] UKHL 58.

[684] Për shembull, sipas mendimit të Komisionit të Venecias, „derogimi mund të jetë tregues i qartë se disa masa të caktuara të pazakonta janë vërtet jashtë normales dhe nuk „bëjnë ligjin“. Shih: reflektime mbi respektimin e demokracisë, të drejtave të njeriut dhe shtetit të së drejtës gjatë gjendjeve të jashtëzakonshme, CDLAD (2020)014, 19 qershor 2020.

Apo të mos derogohet?

Megjithatë, derogimi nga detyrimet sipas Konventës rrezikon vendosjen e një pragu edhe më të ulët justifikues për ata që kërkojnë të kufizojnë të drejtat, dhe mund të bëjë të mundur që Shtetet të ndërhyjnë në të drejta në masë edhe më të madhe sesa është e nevojshme, pa të njëjtin nivel këqyrjeje që vjen nga testi i nevojshmërisë dhe proporcionalitetit të kërkuar për të justifikuar ndërhyrjen në të drejta sipas kufizimeve të lejuara. Në teori, pas derogimit, të drejtat duhet të kufizohen vetëm në shkallën e kërkuar nga urgjencat e situatës emergjente, dhe parimet e proporcionalitetit dhe ligjshmërisë duhet të vazhdojnë të jenë relevante.^[685] Në praktikë, mund të jetë e vështirë të sigurohet pajtueshmëria me këtë kriter.

Pas procesit të njoftimeve sipas Nenit 15 § 3, Gjykata nuk ka mundësi të këqyrë justifikimin për derogim derisa në Gjykatë të arrijë një kërkesë mbase vite pas miratimit të masës, e shpesh pasi gjendja e emergjencës ka pushuar së ekzistuari.^[686] Qasja e llojit shenjo-kutinë (ang. check-box), ku njoftimet mjaftojnë si parakusht për implementimin e një derogimi, është kritikuar nga raportuesi special i OKB- së për terrorizmin^[687] i cili shënon që problemet me procedurat e derogimit duhet të adresohen që në fillim, e jo në retrospektivë, për të evituar vonesat e gjata në adresimin e abuzimeve potenciale të procesit të derogimit. Nga ana tjetër, ndërhyrjet në të drejtat e Konventës në raste individuale nga Shtetet Anëtare që nuk kanë deroguar po ashtu mund të marrë kohë deri sa të mbërrijë në Strasburg.

Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës ka shprehur shqetësim që zgjatja e periudhave të emergjencës dhe derogimeve kanë efektin e normalizimit të standardeve më të ulëta dhe të adaptimit të popullatës me ndërhyrje më të

[685] Për diskutim të mëtejshëm në lidhje me kriteret e ligjshmërisë dhe proporcionalitetit gjatë gjendjes së emergjencës, shih Kapitullin III të këtij publikimi.

[686] Shih, për shembull, *A. dhe të Tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar*, Vendimi i Dhomës së Madhe i 19 shkurtit 2009, Nr. 3455/05; *Aksoy k. Turqisë*, vendimi i 18 dhjetorit 1996, Nr. 21987/93; *Brannigan dhe McBride k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 26 majit 1993, Nr. 14553/89 dhe 14554/89; *Lawless k. Irlandës (Nr. 3)*, vendimi i 1 korrikut 1961, Nr. 332/57; *Şahin Alpay k. Turqisë*, vendimi i 20 marsit 2018, Nr. 16538/17.

[687] Shih https://www.ohchr.org/Documents/Issues/Terrorism/A_HRC_37_52.pdf "Raporti i Raportuesit Special për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në luftën kundër terrorizmit, mbi sfidat e të drejtave të njeriut në gjendjen e emergjencës në kontekstin e luftës kundër terrorizmit", Raporti i Këshillit të OKB-së për të Drejtat e Njeriut, 27 shkurt 2018.

mëdha tek të drejtat e tyre. Mbi këtë bazë, Asambleja rekomandoi që Shtetet të ndër marrin një qasje të kujdesshme dhe progresive ndaj masave të emergjencës, duke miratuar ato që kërkojnë derogimin vetëm si zgjidhje e fundit, kur kërkohet rreptësisht për shkak se opsionet e tjera më pak kufizuese janë vërtetuar të jenë të pamjaftueshme^[688].

Rëndësia e këqyrjes

Është e qartë se ekzistuan rreziqe reale për të drejtat e njeriut nga reagimet e Shteteve ndaj pandemisë Covid-19, pavarësisht nëse bënë apo jo derogim nga Konventa. Pyetja nëse derogimi ishte i justifikuar nga pandemia varet nga natyra e masave të marra nga shteti, nëse ato mund të justifikohen sipas përjashtimeve normale të lejuara, nëse përbëjnë mjet efektiv për mbrojtjen e shëndetit dhe nëse përdoren vetëm për qëllimet për të cilat janë marrë. Ecuria dhe zhvillimi i pandemisë Covid-19 ishin të paparashikueshme, dhe natyra fluide e situatës nënkuptoi që përgjigjet ndaj këtyre pyetjeve dhe natyra e masave që nevojiten për të reaguar efektivisht vazhduan të mbeteshin të ndryshueshme. Megjithatë, analiza jonë në Kapitullin II të këtij publikimi mbi masat e marra nga Shtetet për të reaguar ndaj pandemisë, dhe impakti i tyre tek të drejtat e njeriut nuk identifikoi asnjë aspekt ku dukej krejtësisht e pamundur që Shtetet t'i përgjigjen pandemisë brenda parametrave të masave apo kufizimeve të zakonshme që lejohen nga Konventa.

Edhe nëse derogimi do të gjendej i justifikuar në një moment të caktuar, do të ishte e nevojshme të garantohej që ai të mbetet i justifikuar përgjatë tërë kohëzgjatjes së tij, dhe të mbetet nën shqyrtim të vazhdueshëm. Këqyrja efektive e masave të marra pas derogimit është thelbësore për të siguruar që reagimi ndaj pandemisë Covid-19 të mos minojë statusin më të gjerë të mbrojtjes së të drejtave të njeriut përtej pandemisë^[689]. Nevoja e këqyrjes dhe mënyrat e

[688] 26 T 26 Rezoluta 2338(2020), Impakti i pandemisë Covid-19 tek të drejtat e njeriut dhe shtetin e së drejtës.

[689] *Dareskizb Ltd k. Armenisë*, vendimi i 21 shtatorit 2021, Nr. 61737/08, § 58, ku Gjykata pranoi se barra duhet t'i vihet vendimit të ekzekutivit dhe parlamentit të Armenisë në lidhje me faktin nëse kishte pasur 'emergjencë publike që kërcënonte jetën e kombit'. Megjithatë, kur qe në mospajtim lidhur me përfundimin e kësaj pyetjeje, Gjykata nënvizoi se nevoja e deklarimit të gjendjes së emergjencës dhe masat e veçanta të përfshira nuk iu nënshtruan asnjë këqyrjeje gjyqësore në vend. Kjo u krahasua me situatën në *A. dhe Të Tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i Dhomës së Madhe i 19 shkurtit 2009, Nr. 3455/05, § 177, dhe *Mehmet Hasan Altan k. Turqisë*, vendimi i 20 marsit 2018, Nr. 13237/17, § 93, çështje në të cilat Gjykata qe dakord me përfundimet e Shteteve në lidhje me ekzistencën e emergjencës publike që kërcënonte jetën e kombit.

ndryshme në të cilat ajo mund të zhvillohet diskutohen më hollësisht në Kapitullin III të këtij publikimi. Sipas pikëpamjes së Komitetet Drejtues të Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut (ang. CDDH), shumica e derogimeve të vendosura gjatë pandemisë ishin relativisht të shkurtra në kohëzgjatje, ku mund të argumentohet se kjo tregon njohjen e natyrës së tyre të pazakontë. Fakti që, ndërkohë që situata ishte në evolucion të vazhdueshëm, disa Shtete u tërhoqën dhe i rikthyen derogimet ose reduktuan fushëveprimin e tyre sugjeron se ato Shtete mund të argumentohet se qenë në gatishmëri për të bërë derogim vetëm kur, dhe deri në atë masë sa, ishte rreptësisht e nevojshme^[690].

[690] <https://rm.coe.int/0900001680a8311e> "Draft raporti i CDDH mbi praktikat e Shteteve anëtare për derogimet nga KEDNj në situata krize", Komiteti Drejtues për të Drejtat e Njeriut, (CDDH), 29 shtator 2022, shih përfundimet e raportit në § 97.

Kapitulli III - Garancitë institucionale dhe procedurale gjatë situatës së krizës

Situatat e krizës siç është pandemia e Covid-19, gjatë së cilës ekzekutivit i jepen fuqi të gjera, kanë potencial që të abuzohen duke kërcënuar themelet e demokracisë kushtetuese.^[691] Shkeljet e të drejtave të njeriut gjithashtu mund të shtohen ndërkohë që në këto të drejta mund të bëhen ndërhyrje të panevojshme në emër të mbrojtjes së shëndetit^[692]. Reagimet ndaj pandemisë Covid-19 u

[691] Shih "Impakti i Masave të Covid-19 mbi Shtetin e së Drejtës në Ballkanin Perëndimor dhe Rritja e Autoritarizmit", Andi Hoxha dhe Fabian Zhilla, Revista Evropiane e të Drejtës Krahasuese dhe Qeverisjes, faqet: 271–303, Data e Publikimit Online: 24 gusht 2021, ku argumentohet se Covid-19 ka ekspozuar më haptas dobësitë e sistemit ekzistues të kontrollit dhe bilancit në Ballkanin Perëndimor dhe ka krijuar një mundësi të re për udhëheqësit në Ballkanin Perëndimor që të thellojnë modelin e tyre autoritar të qeverisjes duke dëmtuar shtetin e së drejtës. Një shembull tjetër është „normalizimi i fuqive të emergjencës“ për të trajtuar personat e dyshuar për krime lidhur me terrorizmin pas 11 shtatorit dhe incidente të tjera madhore të natyrës terroriste: [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2017/596832/IPOL_STU\(2017\)596832_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2017/596832/IPOL_STU(2017)596832_EN.pdf) "Politikat dhe ligjet e Shteteve Anëtare të BE-së mbi personat e dyshuar për vepra terrorizmi", Komiteti i Lirive Civile, Drejtësisë dhe Çështjeve të Brendshme, Studim mbi Komitetin LIBE, Drejtorati i Përgjithshëm për Politika të Brendshme të Unionit, dhjetor 2017; Një shembull në kontekstin e pandemisë Covid-19 është shqetësimi që qeveria e Hungarisë miratoi fuqi të jashtëzakonshme që i lejonin Kryeministrin të merrte pushtetin për kohë të pacaktuar, si pjesë e ndryshimeve që u bënë për të luftuar krizën e Covid-19: <https://www.forbes.com/sites/isabeltogoh/2020/03/30/death-of-democracy-hungary-approves-orbans-controversial-emergency-powers/#7719cc74360d> "Vdekja e Demokracisë? Hungaria Miratoi Fuqi Emergjente Kontradiktore të Orbani", nga I. Togoh, Forbes, 30 mars 2020.

[692] Shih: <https://verfassungsblog.de/states-of-emergency/> "Gjendjet e Emergjencës", Joelle Grogan, VerfBlog, 26 maj 2020, ku jepet shembulli që qeveria hungareze përdor fuqitë legjislative që i janë dhënë gjatë pandemisë për të suspenduar operacionet e GDPR-së në Hungari, dhe për të transferuar burimet më profitabile të të ardhurave për qeveritë lokale drejt qeverive krahinore në zonat e kontrolluara nga partitë opozitare – ku asnjëri prej këtyre

karakterizuan nga zhvendosja e pushtetit nga dega legislative në atë ekzekutive të Qeverive. Në tërë Evropën, përgjegjësia parësore për reagimin ndaj emergjencës i takoi degës ekzekutive, ndërkohë që legjislaturat përgjithësisht kryen funksione mbikqyrëse, dhe intensiteti i këqyrjes parlamentare të ekzekutivit varionte nga një Shtet në tjetrin^[693]. Shumë Shtete kanë deklaruar gjendjen e emergjencës dhe/ose i kanë dhënë fuqi të pazakonta ekzekutivit për të hartuar dhe implementuar masa që zakonisht janë jashtë fushës së kompetencës së tyre.^[694] Të tjerë u mbështetën tek legjislacioni 'i zakonshëm' ose ekzistues mbi bazën e të cilit futën masat e jashtëzakonshme^[695].

Duke pasur parasysh këto rreziqe, Komisioneri i Lartë i OKB-së për të Drejtat e Njeriut paralajmëroi që *"Fuqitë e emergjencës nuk duhet të jenë armë që qeveritë mund ta vringëlljnë për të shtypur mospajtimin, kontrollin e popullatës, e madje*

nuk kishte lidhje të mundshme me Covid-19.

[693] „Kushtetutat dhe Infektimi. Sistemet Kushtetuese Evropiane dhe Pandemia Covid-19“, Angelo Jr Golia, Laura Hering, Carolyn Moser, Tom Sparks, Seria e Kërkimeve Hulumtuese Nr. 2020-42. Shih gjithashtu, në lidhje me përdorimin e fuqive ekzekutive në Mbretërinë e Bashkuar: „Qeveri me dekret: Covid-19 dhe Kushtetuta“, Lord Sumption, Cambridge Freshfields Annual Law Lecture, 27 tetor 2020.

[694] Shih [https://www.hugenwb.net/uploads/materials/The%20Parliamentary%20Response%20to%20COVID-19%20and%20States%20of%20Emergency%20\(SoE\)%20in%20the%20Western%20Balkans.pdf](https://www.hugenwb.net/uploads/materials/The%20Parliamentary%20Response%20to%20COVID-19%20and%20States%20of%20Emergency%20(SoE)%20in%20the%20Western%20Balkans.pdf) "Reagimi i Parlamentit ndaj Covid-19 dhe Gjendjeve të Emergjencës (SoE) në Ballkanin Perëndimor", nga I. Radojevic dhe N.Stankovic, Fondacioni Westminster për Demokraci: të Drejtat e Njeriut dhe Barazia Gjinore e Komiteteve në Ballkanin Perëndimor (HUGEN). Të gjitha Shtetet e Ballkanit Perëndimor, me përjashtim të Malit të Zi, shpallën gjendjen e emergjencës, gjendjen e fatkeqësisë natyrore shëndetësore, ose situatën e emergjencës së shëndetit publik, në përputhje me procedurat e vendosura në kushtetutat e tyre. Në Mal të Zi, qeveria miratoi mbi 25 urdhëresa në përputhje me Nenin 39 të kushtetutës të cilat specifikisht autorizojnë derogimin e nga e drejta për lëvizjen e lirë nëse shpejton parandalimin e infeksioneve. Shih gjithashtu "Vlerësim i Të Drejtave të Njeriut dhe Shtetit të së Drejtës në Reagimet Legjislative dhe Rregullatore ndaj Pandemisë Covid-19 në 27 Juridiksione", Seria e Raporteve Bonavero, n. 7/2020, 30 tetor 2020. Shih gjithashtu diskutimin në lidhje me masat e pazakonta të marra nga Shtetet për të reaguar ndaj pandemisë në Kapitullin II (Derogimet) brenda këtij publikimi. Shih gjithashtu "La liberté individuelle face au Covid-19 : l'adaptation des garanties de l'article 66 de la Constitution aux circonstances d'urgence sanitaire (1re partie)", Annabelle Pena, actu-juridique.fr, 1 dhjetor 2020, në lidhje me 'gjendjen e re të shëndetit' të deklaruar në Francë.

[695] Shih: <https://verfassungsblog.de/states-of-emergency/> "Gjendjet e Emergjencës", Joelle Grogan, VerfBlog, 26 maj 2020. Ky blog bën një studim krahasues të masave të emergjencës të marra nga Qeveritë në tërë botën si reagim ndaj pandemisë Covid-19, dhe përfshin Irlandën dhe Turqinë si shembuj të Shteteve që nuk deklaruan 'gjendjen e emergjencës' sepse kriza nuk përbëri 'emergjencë' sipas dispozitave të tyre kushtetuese, ose sepse u besua që kishin fuqi dhe/ose mekanizma të mjaftueshme në kuadër të legjislacionit të zakonshëm.

edhe për ta vazhduar më tej pushtetin e tyre... Ato duhet të përdoren për të trajtuar në mënyrë efektive pandeminë – as më shumë, as më pak.^[696]

Duke pasur parasysh shpejtësinë me të cilën u desh të futeshin masat për të luftuar Covid-19 dhe sferën e gjerë të problemeve që këto masa adresuan, delegimi i fuqive ligj-bërëse tek ekzekutivi mund të ketë qenë i nevojshëm për të mundësuar zbatimin e vullshëm dhe modifikimin e masave të reja. Po ashtu, ai mund të ketë pasur avantazhin e inkurajimit të kontributit nga ekspertët përkatës brenda organeve administrative^[697]. Megjithatë, në shumë shtete pati mungesë kontributi nga ekspertët e të drejtave të njeriut dhe të barazisë në strukturat vendimmarrëse të udhëhequra nga ekzekutivi^[698]. Probleme të tjera që dolën përfshinë pasigurinë në lidhje me dallimin mes udhëzimeve/këshillave të qeverisë dhe rregulloreve ligjore/ligjërish të zbatueshme si dhe respektimit të udhëzimeve si të ishin ligje, për shkak se qeveritë jepnin këshilla për shëndetin publik sikur ato të ishin të detyrueshme nën kërcënimin e ndjekjes penale^[699].

Fushëveprimi pa precedent i masave të futura për të luftuar Covid-19, gama e gjerë e problemeve që mbulonin dhe shpejtësia me të cilën u morën nënkuptoi që kujdesi rreth impaktit të tyre mbi të drejtat e njeriut dhe pajtueshmëria e tyre

[696] "COVID-19: Masat e jashtëzakonshme nuk duhet të jenë maskë për abuzimet dhe shkeljet e të drejtave të njeriut", Zyra e Komisionerit të Lartë të OKB-së për Të Drejtat e Njeriut, 27 prill 2020.

[697] Për shembull, në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Ministri i Shëndetësisë formoi shtabin e krizës të përbërë vetëm nga ekspertë mjekësorë nga fusha e sëmundjeve infektive të cilët dhanë rekomandime specialiste për përbajtjen e pandemisë dhe ishin përgjegjës për informimin e publikut rreth pandemisë, shih: „Reagimi Parlamentar ndaj Pandemisë Covid-19 dhe Gjendjes së Emergjencës (SoE) në Ballkanin Perëndimor: Raporti i Dytë“, I.Radojevic and N.Stankovic, Westminster Foundation for Democracy: HUGEN, page 16.

[698] „Fuqitë Emergjente në Irlandë gjatë Pandemisë Covid-19: Raporti i Observatorit të Kolegjit Trinity të Dublinit mbi Të Drejtën dhe Të Drejtat e Njeriut“, në emër të Komisionit Irlandez për të Drejtat e Njeriut dhe Barazinë.

[699] Shih për shembull: „Fuqitë Emergjente në Irlandë gjatë Pandemisë Covid-19: Raporti i Observatorit të Kolegjit Trinity të Dublinit mbi Të Drejtën dhe Të Drejtat e Njeriut“, në emër të Komisionit Irlandez për të Drejtat e Njeriut dhe Barazinë, shih gjithashtu „Kushtetutet dhe Infektimi. Sistemet Kushtetuese Evropiane dhe Pandemia Covid-19“, Angelo Jr Golia, Laura Hering, Carolyn Moser, Tom Sparks, Seria e Kërkimeve Hulumtuese MPIL Nr. 2020-42, faqe 26, ku jepet shembulli i Kryeministrit të Mbretërisë së Bashkuar, më 23 mars 2020, ku ai lajmëron në një video në kanalet e Qeverisë në media sociale se këshilla e Qeverisë që individët të respektojnë distancimin social dhe të qëndrojnë në shtëpi do të zëvendësohet me mbylljen brenda ligjërish të detyrueshme. Vetëm më 26 mars 2020 u ngrit baza ligjore për mbylljen. Megjithatë, ka raporte që policët filluan të vepronin për zbatimin e mbylljes qysh më 24 mars.

me parimet e ligjshmërisë dhe proporcionalitetit ishin të rëndësishme jetike^[700]. Komisioni Evropian e konsideroi pandeminë Covid-19 test stresi për rezistencën e shtetit të së drejtës^[701]. Është e qartë se ajo vuri në dukje nevojën për të qartësuar fushëveprimin e fuqive të emergjencës së Shteteve, kontekstin në të cilin mund të përdoren ato dhe procedurat përmes të cilave ato duhet të futen^[702].

Masat e vendosura për të reaguar ndaj pandemisë e bënë më të vështirë të realizoheshin metodat tradicionale të këqyrjes ose kërkimi i llogarisë nga qeveritë, meqenëse legjislaturat nuk mundën të mblidheshin dhe gjykatat qenë të mbyllura. Këshilli i Evropës dhe Komisioni i Venedikut të dy përgatitën udhërrëfyes të dobishëm për garantimin e llogaridhënies dhe respektimin e të drejtave të njeriut në kohë emergjencash.^[703] Ato theksuan se respekti për parimin e ligjshmërisë dhe proporcionalitetit është i panegociueshëm, megjithëse këto terma mund të marrin kuptime të ndryshme në kohë emergjencash. Prandaj, Shtetet u desh të punonin për t'u siguruar që tërë kohën të bëhej këqyrja e thellësishme, në një kohë kur nevoja për të mbajtur Qeverinë përgjegjëse ishte më e rëndësishme se kurrë, por kur mekanizmat për ta bërë këtë nuk ishin në gjendje të operonin siç do të operonin në kushte normale.

[700] Shih: "Pandemokracia në Evropë, Pushteti, Parlamentet dhe Populli në Kohërat e Covid-19", Matthias C Kettemann dhe Konrad Lachmayer, Hart Publishing, 2022.

[701] "Raporti i Shtetit të së Drejtës 2020: Situata e shtetit të së drejtës në Bashkimin Evropian", COM/2020/580 final, 30 shtator 2020.

[702] „Kushtetutat dhe Infektimi. Sistemet Kushtetuese Evropiane dhe Pandemia Covid-19", Angelo Jr Golia, Laura Hering, Carolyn Moser, Tom Sparks, Seria e Kërkimeve Hulumtuese MPIL, Nr. 2020-42.

[703] Shih <https://rm.coe.int/sg-inf-2020-11-respecting-democracy-rule-of-law-and-human-rights-in-th/1680-9e1f40> "Respektimi i demokracisë, sundimit të ligjit dhe të drejtave të njeriut në kuadër të krizës sanitare të Covid-19: paketë instrumentesh për shtetet anëtare", Dokumentet e Informacionit të Këshillit të Evropës, SG/Inf (2020) 11, 7 prill 2020, dhe [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-PI\(2020\)005rev-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-PI(2020)005rev-e) "Respekti për demokracinë, të drejtat e njeriut dhe sundimin e ligjit gjatë gjendjeve të emergjencës – refleksione", nga N.Alivizatos dhe të tjerë, Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venedikut), CPL-PI(2020)005rev, 26 maj 2020.

1. Kriteret kundër abuzimit

Edhe në situatë emergjente, Këshilli i Evropës dhe Gjykata kanë theksuar se sundimi i ligjit duhet të mbizotërojë.^[704] Ndërkohë që Shtetet mund të kenë nevojë të marrin masa të pazakonta për të reaguar ndaj situatës emergjente, këto masa prapë se prapë duhet të jenë në përputhje me parimet madhore të Konventës të ligjshmërisë dhe proporcionalitetit. Kriteret e ligjshmërisë dhe proporcionalitetit janë relevante për të vlerësuar justifikimin e një ndërhyrjeje në Nenet 8-11, siç diskutohet në seksionet mbi Nenet 8 (E drejta për respekt të jetës private dhe familjare), 10 (E drejta e shprehjes së lirë) dhe 11 (E drejta e lirisë së tubimit dhe organizimit) brenda këtij publikimi^[705]. Ligjshmëria dhe proporcionaliteti gjithashtu janë relevante për të vlerësuar nëse një derogim sipas Nenit 15 është në pajtueshmëri me Konventën.^[706]

Siç diskutohet në Kapitullin III të këtij publikimi, pas një derogimi sipas Nenit 15, Shtetet lejohen të derogojnë nga detyrimet e tyre për të siguruar mbrojtjen e të drejtave të tjera të Konventës vetëm deri në shkallën strikte që kërkohet prej situatës.^[707] Në bërjen e këtij vlerësimi, Gjykata merr parasysh proporcionalitetin dhe ligjshmërinë e masave të marra, përfshirë nëse ato janë reagim i vërtetë ndaj situatës, nëse ato janë përdorur për qëllimin për të cilin janë lejuar, nëse derogimi është i kufizuar në fushëveprim, nëse nevoja për derogim është mbajtur nën shqyrtim, nëse masat i janë nënshtruar mbrojtjeve strikte, nëse ato përfshinin ndonjë diskriminim të justifikueshëm dhe nëse masat janë futur me anë të një procedure që është në përputhje me ligjin dhe i janë nënshtruar kontrollit dhe shqyrtimit gjyqësor.

[704] *Mehmet Hasan Altan k. Turqisë*, vendim i 20 marsit 2018, Nr. 13237/17, §§ 94 dhe 210; dhe *Şahin Alpay v. Turkey*, vendim i 20 marsit 2018, Nr. 16538/17, §§ 78 dhe 180 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[705] *Communauté genevoise d'action syndicale (CGAS) k. Zvicrës*, vendimi i 15 March 2022, Nr. 21881/20, § 91 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim). Megjithatë, kjo çështje iu referua Dhomës së madhe më 5 shtator 2022, që do të thotë se vendimi i seksionit të tretë të Gjykatës nuk është përfundimtar dhe një vendim i ri do të merret nga Dhoma e Madhe në lidhje me këtë çështje.

[706] *Brannigan dhe McBride k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim plenar i Gjykatës i 25 majit 1993, Nr. 14553/89 dhe 14554/89, § 43 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim); *A. dhe të Tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i Dhomës së Madhe i 19 shkurtit 2009, Nr. 3455/05, § 173 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[707] *Brannigan dhe McBride k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim plenar i Gjykatës i 25 majit 1993, Nr. 14553/89 dhe 14554/89, § 54 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

a. Ligjshmëria

Pothuajse të gjitha Shtetet futën një formë të caktuar të një regjimi specifik për të shtuar fuqitë ekzekutive për të luftuar pandeminë Covid-19, qoftë duke deklaruar gjendjen e emergjencës ose duke futur ligje dhe/ose rregullore të reja që kanë për qëllim specifik trajtimin e Covid-19.^[708] Procedura për futjen e gjendjes së emergjencës, procedura për futjen e fuqive të reja legjislative, dhe masat e marra sipas fuqive të emergjencës duhet të jenë në pajtueshmëri me parimin e ligjshmërisë.

Procedura e vendosjes së gjendjes së emergjencës ose fuqive të emergjencës

Duhet të ketë rregulla të qarta dhe të përdorshme se kur mund të merren masat e emergjencës ose kur mund të deklarohet gjendja e emergjencës. Këto rregulla duhet të hartohen përpara situatës së emergjencës të cilën ato duhet të adresojnë. Ato duhet të parashtrojnë një procedurë të qartë për të vlerësuar nëse ekziston situata emergjente dhe si mund të miratohen masat e emergjencës. Një deklaratë emergjente, ose ligje të emergjencës të miratuara jashtë procedurës së zakonshme legjislative, duhet të bëjnë të qarta bazat ligjore dhe faktike mbi të cilat ato po prezantohen, kush i ka kompetencat për të vepruar sipas këtyre fuqive dhe fushëveprimin e fuqive të sjella dhe situatat ekzakte në të cilat ato mund të përdoren.^[709]

Masat e marra sipas fuqive të emergjencës

Masat e emergjencës duhet të futen dhe të zbatohen në përputhje me procedurat përkatëse të parashikuara në të drejtën vendase. Respektimi i këtyre procedurave,

[708] Shih [https://www.hugenwb.net/uploads/materials/The%20Parliamentary%20Response%20to%20COVID-19%20and%20States%20of%20Emergency%20\(SoE\)%20in%20the%20Western%20Balkans.pdf](https://www.hugenwb.net/uploads/materials/The%20Parliamentary%20Response%20to%20COVID-19%20and%20States%20of%20Emergency%20(SoE)%20in%20the%20Western%20Balkans.pdf) "Reagimi Parlamentar ndaj Covid-19 dhe Gjendjes së Emergjencës (SoE) në Ballkanin Perëndimor", nga I.Radojevic dhe N.Stankovic, Fondacioni Westminster për Demokraci: Rrjeti i Komiteteve për Drejtat e Njeriut dhe Barazinë Cjinore në Ballkanin Perëndimor. Shumica e Shteteve të Ballkanit Perëndimor kanë shpallur gjendjen e emergjencës, me përjashtim të Malit të Zi, ku qeveria miratoi mbi 25 urdhëresa në përputhje me Nenin 39 të kushtetutës të cilat autorizojnë derogimin e të drejtës për lëvizjen e lirë nëse shpejton parandalimin e infeksioneve.

[709] Shih listën kontrolluese për sundimin e ligjit të Komisionit të Venedikut për një përshkrim më të hollësishëm të kriterëve për parimin e ligjshmërisë https://www.venice.coe.int/images/SITE%20IMAGES/Publications/Rule_of_Law_Check_List.pdf "Lista kontrolluese e sundimit të ligjit", Komisioni i Venedikut i Këshillit të Evropës, i miratuar në Seancën Plenare të 106-të, 11-12 mars 2016.

për shembull kriteri për ta publikuar një rregullore para se ajo të ketë fuqi ligjore^[710], ka rëndësi të veçantë për të siguruar parashikueshmërinë dhe qartësinë e ligjit në kohë emergjencash, kur rregulloret për sjelljen publike ndryshojnë me shpejtësi në reagim ndaj situatës emergjente. Për të njëjtat arsye, çdo ligj dhe/ose masë që hyn sipas gjendjes së emergjencës ose duke përdorur fuqitë legislative të emergjencës duhet të jetë mjaftueshëm i/e qartë në fushëveprim për të mundësuar që publiku të kuptojë se çfarë kërkohet prej tij, të përshtasë sjelljen sipas tij/saj dhe të mbrohet nga zbatimi ose interpretimi joproporcional ose i papajtueshëm nga ana e zyrtarëve ligjzbatues ose gjykatave. Shtetet duhet të sigurohen që popullatat e tyre të jenë mjaftueshëm të informuara mbi fushëveprimin e saktë substancial, territorial dhe të përkohshëm të zbatimit të gjendjes emergjente, si dhe mbi fuqitë dhe ligjet e miratuara për të reaguar ndaj emergjencës. Kjo mund të kërkojë që autoritetet të jenë në komunikim të rregullt me publikun përmes kanaleve të ndryshme përfshirë, për shembull, radio, televizion, internet, publicitet me postera dhe me letra postare, në të gjitha gjuhët zyrtare të Shtetit si dhe në gjuhët e folura rëndom në zona të ndryshme të Shtetit^[711]. Gjatë komunikimeve me publikun, autoritetet duhet ta bëjnë të qartë dallimin mes këshillave për shëndetin publik dhe udhëzimeve të qeverisë, në krahasim me detyrimet ligjërish të zbatueshme që publiku të veprojë në një mënyrë të caktuar, për t'u siguruar që publiku t'i kuptojë si duhet dhe t'i parashikojë pasojat e veprimeve të veta^[712].

[710] Shih për shembull vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Sllovenisë Nr. U-I-445/20-13. Çështja kishte të bënte me kontestimin e një urdhri ministror që arsimit të zhvillohej në distancë. Për shkak se urdhri i ministrit rregullonte pozicionin ligjor të një numri të pacaktuar personash ligjorë dhe natyrorë, prej natyrës ishte rregullore. Sipas procedurës vendase, një rregullore hyn në fuqi kur publikohet në mënyrën e duhur. Për shkak se urdhri i ministrit nuk u publikua si duhej, u gjet se nuk kishte hyrë në fuqi ndaj nuk duhet të aplikohet.

[711] Shih për shembull rekomandimet e Komisionit të Përbashkët të Mbretërisë së Bashkuar për të Drejtat e Njeriut tek: <https://publications.parliament.uk/pa/jt5801/jtselect/jtrights/correspondence/Chairs-briefing-paper-regarding-Health-Protection-Coronavirus-Restrictions-England-Regulation-2020.pdf>

[712] Shih për shembull vendimin e Ombudsmanit të të Drejtave të Njeriut në Slloveni që një person nuk mund të penalizohet për mos-respektimin e një dekreti qeveritar që urdhëronte bartjen e detyrueshme të maskave në hapësira publike të mbyllura. Sipas dispozitave ligjore relevante, mund të viheshin gjoba për shkeljen e masave të marra sipas një kreu të caktuar të Ligjit për Sëmundjet Infektive. Ndërkohë që dekreti ishte formuluar si detyrim, ai nuk u fut brenda kreut të duhur në Ligj, që do të thotë se ai nuk mund të zbatohet me forcë: <https://www.varuh-rs.si/en/news/news/ombudsman-says-failure-to-wear-mask-in-enclosed-spaces-cannot-be-penalised/>

b. Proporcionaliteti

Parimi i proporcionalitetit kërkon që Shteti të marrë vetëm masa që kërkohen strikt nga situata emergjente. Kur futen fuqitë e pazakonta, ato duhet të përdoren vetëm për arsytet për të cilat janë lejuar. Shteteve mund t'u duhet t'u japin fuqi legjislativë marrësve të vendimeve ekzekutive të cilat janë mjaftueshëm të gjera sa t'u japin fleksibilitetin për të vepruar me shpejtësi dhe efektivitet ndaj natyrës evolutive të pandemisë Covid-19. Megjithatë, fuqitë duhet të formulohen sa më ngushtë që të jetë e mundur në atë situatë dhe të specifikojnë saktë se në çfarë kontekstesh mund të përdoren dhe qëllimet për të cilat duhet të përdoren. Situatat e emergjencës nuk duhet të shfrytëzohen për t'i dhënë ekzekutivit carte blanche për të vepruar sipas dëshirës apo për të marrë masa në fusha që nuk kanë lidhje me emergjencën.

Gjatë vlerësimit të proporcionalitetit të një mase, është me rëndësi të merren parasysh niveli i njohurive para-ekzistuese dhe përvoja që pati Qeveria në reagimin ndaj një situatë të tillë, si dhe niveli i rrezikut për individin dhe ato rreth tij në kohën e futjes së masës^[713]. Të dy faktorët ndryshuan në mënyrë domethënëse gjatë vazhdës së pandemisë, e cila pati cikle të ndryshme të vërshimit dhe rënies së valës së infektiveve. Mënyra se si aplikohet testi i proporcionalitetit duhet të përshtatet me këto ndryshime. Masat më të repta do të kishin qenë më të lehta për t'u justifikuar në fillim të pandemisë, për shkak të natyrës së menjëhershme dhe të papritur të rrezikut të paraqitur, dhe mungesës së të kuptuarit dhe kërkimeve shkencore rreth mënyrës më të mirë për t'iu kundërpërgjigjur asaj. Megjithatë, ndërkohë që Shtetet përjetuan valën 'e dytë' dhe 'të tretë' të pandemisë, mund të pritej që ato të kenë justifikime më të forta dhe të bazuara mbi më shumë prova për të treguar se masat e marra ishin 'rreptësisht të kërkuara' dhe hapësira e vlerësimit që u lejohet me gjasë është më e ulët^[714].

[713] https://www.europeanlawinstitute.eu/fileadmin/user_upload/p_eli/Publications/2021_Supplement_to_the_ELI_Principles_for_the_COVID-19_Crisis.pdf "Parimet ELI për Krizën Covid-19", Suplementi 2021, Parimi 16: „Proporcionaliteti i masave në rastet me rrezikshmëri të ulët epidemiologjike" thotë që provat shkencore duhet të vlerësohen rregullisht për të siguruar që kufizimet të hiqen kur rreziku epidemiologjik ulët.

[714] Shih, për shembull, Vendimin PL. US 106/20 të datës 9 shkurt February 2021, ku Gjykata Kushtetuese çeki kritikoi Qeverinë çeki për dështimin për të dhënë justifikime racionale të mbështetura mbi baza shkencore për masat e emergjencës që hynë në fuqi në janar 2021. Gjykata vendase gjeti se Qeveria kishte pasur më shumë kohë dhe përvojë praktike për të mbledhur të gjitha provat dhe informacionet e nevojshme eksperte, për të adresuar impaktin e masave të ndryshme të emergjencës për kontrollimin e përhapjes së Covid-19 dhe për të ristrukturuar planin e saj të përgatitjes për pandeminë gjatë kësaj kohe, në kohën e miratimit, pandemia kishte një vit që

Përkohshmëria

Masat e emergjencës duhet të jenë të kufizuara në kohëzgjatje. Një afat kohor i qartë i ekzistencës së tyre ose një 'klauzolë e përfundimit'^[715] (ang. 'sunset clause') duhet të përfshihet në tekstin prezantues të tyre. Duhet të ketë shqyrtim të vazhdueshëm dhe periodik parlamentar ose gjyqësor të nevojshmërisë së vazhduar për masat e emergjencës dhe, kur skadon afati kohor fillestar për ekzistencën e tyre, ato duhet të vazhdojnë vetëm nëse është e nevojshme. Barra për të treguar nevojshmërinë e vazhdimin bie mbi ekzekutivin.

Disa Shtete kanë përfshirë afate kohore në fuqitë e emergjencës që kanë futur për të reaguar ndaj pandemisë, duke nisur nga periudha fillestare prej 30 ditësh e deri në 6 muaj. Në Shtete të tjera, nuk ka pasur fare afate kohore.^[716] Mungesa e afatit kohor të këtyre fuqive qartazi shkel kriterin e proporcionalitetit. Në kontekstin e pandemisë, dhe duke pasur parasysh sa shpejt mund të ndryshonte niveli i rrezikut nga Covid-19, edhe kur afati kohor i fuqive që i përfshirë, ai nuk do t'i plotësonte domosdoshmërisht kriteret e proporcionalitetit. Niveli i rrezikut nga Covid-19 dhe llojet e masave që nevojiten për të parandaluar përhapjen e Covid-19 mund të variojnë në mënyrë dramatike brenda pak muajve e madje edhe brenda javësh. Shtetet u desh të ishin të vëmendshëm se sa shpejt mund të ndryshonte natyra e pandemisë kur caktojnë kufijtë kohorë brenda të cilëve duhen shqyrtuar fuqitë e emergjencës.

vazhdonte. Mbi justifikimin e ndërhyrjes tek të drejtat themelore u shtuan më shumë kritere, dhe u kërkuar një kontroll më i rreptë sesa në mars 2020. Gjykata i gjeti ndërhyrjet afatgjata dhe të përsëritura tek të drejtat themelore më invazive dhe më „të dhimbshme“ sesa kufizimet afatshkurtra dhe të përkohshme.

[715] Klauzola e 'perëndimit' parashikon se sa kohë do të zgjasë një akt legjislativ, dispozitë ose fuqi. Pas datës së specifikuar në klauzolën e perëndimit, legjislacioni, dispozita ose fuqia do të skadojë dhe do të pushojë së pasuri efekt nëse nuk ndërmerren veprime të mëtejshme për ta vazhduar.

[716] Për shembull, në Mbretërinë e Bashkuar fuqitë e emergjencës sipas Aktit të Koronavirusit 2020 janë të vlefshme për gjashtë muaj para shqyrtimit parlamentar: <https://www.legislation.gov.uk/ukpga/2020/7/section/98/enacted> "s. 98 Akti i Koronavirusit 2020"; shih gjithashtu Shqipërinë e cila fillimisht lejoi përdorimin e fuqive të emergjencës për 30 ditë duke filluar nga 24 marsi 2020, por që janë vazhduar prej asaj date: <https://verfassungsblog.de/albania-some-exceptional-extraordinary-measures/> "Shqipëria – Masa të Pazakonta të Jashtëzakonshme", nga L. Bianku, Verfassungsblog on Matters Constitutional, 17 maj 2020; shih gjithashtu Hungarinë, ku Akti i Autorizimit 2020 i dha fuqi të pacaktuar Kryeministrit, por më vonë votoi për t'i tërhequr fuqitë: <https://www.euronews.com/2020/05/28/coronavirus-hungary-bid-to-end-emergency-powers-an-optical-illusion-say-human-rights-ngos> "Koronavirusi: Përpjekjet e Hungarisë për t'i dhënë fund fuqive të emergjencës janë 'iluzion optik', thotë OJQ-ja e tre drejtave të njeriut", R. Palfi dhe L. Chadwick, Euronews, 28 maj 2020.

Zbatimi

Proporcionaliteti gjithashtu është relevant për mënyrat se si aplikohen dhe zbatohen masat. Sanksionet penale duhet të përdoren si zgjidhje e fundit për të zbatuar kufizimet e të drejtave që imponohen për të reaguar ndaj një emergjence, dhe gjobat nuk duhet të jenë të larta pa arsye. Më tej, fuqitë e emergjencës nuk duhet të zbatohen në mënyrë diskriminuese,^[717] ose për të çuar më tej ndonjë qëllim tjetër përveç qëllimit për të cilin ato janë futur në mënyrë eksplicite. Për shembull, janë ngritur shqetësime që sanksionet e futura për rregullimin e pajtueshmërisë me kufizimet e lëvizjes u përdorën për të heshtur zërat e opozitës, e jo për të mbrojtur shëndetin, meqenëse ato u zbatuan kundër njerëzve që nuk paraqisnin rrezik të dukshëm ndaj shëndetit.^[718] Kurdo që sanksionet imponohen ndaj individëve sipas fuqive të emergjencës, zyrtarët e zbatimit duhet të jenë në gjendje të ofrojnë prova konkrete të një shkeljeje të dispozitës përkatëse sipas fuqive të emergjencës dhe duhet të jenë në gjendje të demonstrojnë që veprimi i zbatimit ka shërbyer për të përmbushur qëllimin për të cilin u futën në punë fuqitë.

Më tej, ekzistenca e vazhdueshme e një shërbimi prokurorial të pavarur dhe efektiv gjatë një kohe emergjente është aspekt thelbësor i të siguruarit që të gjitha sanksionet penale për shkeljen e masave të emergjencës të ndiqen në mënyrë proporcionale dhe jo-diskriminuese^[719]. Kur konteksti i emergjencës e bën më të vështirë që prokurorët të kryejnë rolin e tyre, prokurorët duhet të fusin kritere dhe udhëzime objektive për të justifikuar vendimet e tyre për t'u dhënë përparësi hetimit dhe ndjekjes penale të veprave të caktuara para disa veprave të tjera^[720].

[717] Shqetësimet në lidhje me angazhimin e forcave ushtarake në kufizimet policore të lëvizjeve dhe me zbatimin joproporcional të kufizimeve ndaj komuniteteve pakicë diskutohen në seksionin mbi lirinë nga diskriminimi në këtë publikim.

[718] Për shembull, një artiste serbe që mbështeti publikisht bojkotin zgjedhor të opozitës në Serbi, u arrestua për shkeljen e masave të vetizolimit, pavarësisht nga fakti që ajo u kthye nga Mali i Zi në Serbi një ditë para se të shpallej gjendja e emergjencës dhe nuk kishte marrë udhëzime me shkrim ose me gojë në lidhje me vetizolimin pas kthimit nga jashtë shtetit: <https://biepag.eu/crisis-at-europes-periphery-serbian-democracy-in-quarantine/> "Krizë në periferi të Evropës – demokracia serbe në karantinë", nga L.Lohmann dhe S.Stojković, BiEPAG Blog, 16 prill 2020.

[719] <https://rm.coe.int/opinion-no-15-ccpe-en/1680a05a1b> Opinioni i CCPE-së Nr. 15 (2020): Roli i prokurorëve në situata emergjente, posaçërisht gjatë përballjes me pandeminë.

[720] Për shembull, në Serbi, disa organizata të shoqërisë civile ngritën padi kundër brutalitetit policor, por Prokuroria Publike refuzoi të hetonte akuzat, duke cituar qëndrimin e qeverisë se policia thjesht ishte duke zbatuar rregullat e Covid-19 kundër tubimeve masive, me sa duket si rezultat i presionit të paduhur i qeverisë mbi Prokurorinë,

2. Garancitë kundër abuzimit

Brenda çdo skeme duhet të ketë mekanizma shqyrtuese të masave emergjente për t'u siguruar që masat e propozuara me gjasë do të zgjidhin, përmirësojnë, ose së paku nuk do ta acarojnë problemin të cilin ato janë dizajnuar të zgjidhin, dhe që ato në realitet janë duke u aplikuar dhe zbatuar për të bërë të njëjtën gjë^[721]. Nëse nuk është e mundur që kjo të ndodhë me anë të procesit të zakonshëm legjislativ, atëherë duhet të jetë vendi i një forme tjetër të shqyrtimit parlamentar, gjyqësor ose ekspert që faktorizohet në masat e emergjencës^[722].

a. Kontrolli parlamentar

Duhet të ketë mekanizma që i mundësojnë degës legjislative të qeverive të kontrollojë që deklarimi i gjendjes së emergjencës është në pajtueshmëri me kriteret e ligjshmërisë dhe proporcionalitetit, për të vlerësuar nevojshmërinë

shih: „Impakti i Masave të Covid-19 mbi Shtetin e së Drejtës në Ballkanin Perëndimor dhe Rritja e Autoritarizmit“, Andi Hoxhaj dhe Fabian Zhilla, Revista Evropiane e Të Drejtës Krahasuese dhe Qeverisjes, faqet 271–303, Data e publikimit online: 24 gusht 2021.

[721] Për shembull, OECD thekson rrezikun që Qeveritë të përdorin procedurat e prokurimit të emergjencës që u futën gjatë pandemisë për t'iu shmangur proceseve standarde, sadoqë të gjata, të prokurimit, duke shtuar kështu rrezikun e mashtrimit, korrupsionit dhe prokurimit të mallrave që nuk i përbushin standardet e cilësisë, shih „Integriteti Publik për Reagimin dhe Shërimin Efektiv nga Covid-19“, 19 prill 2020 tek <http://www.oecd.org/coronavirus/policy-responses/public-integrity-for-an-effective-covid-19-response-and-recovery-a5c35d8c/>; shih gjithashtu: <https://www.opengovpartnership.org/documents/a-guide-to-open-government-and-the-coronavirus/> “Udhërrëfyes për Qeveri të Hapur dhe Koronavirus”, Partneriteti për Qeveri të Hapur, 28 prill 2020.

[722] *Communauté genevoise d'action syndicale (CGAS) k. Zvicrës*, vendimi i 15 marsit 2022, Nr. 21881/20, § 75 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim). Megjithatë, kjo çështje iu referua Dhomës së Madhe më 5 shtator 2022, që do të thotë se ky vendim i seksionit të tretë të Gjykatës nuk është përfundimtar dhe në lidhje me çështjen do të merret një vendim i ri nga Dhoma e Madhe. Seksioni i tretë i Gjykatës gjeti se, duke pasur parasysh urgjencën me të cilën qeveritë u desh të merrnin masa për të adresuar pandeminë, nuk mund të pritët domosdoshmërisht që masat e marra të jenë objekt debati të hollësishtëm, sidomos me përfshirjen e parlamentit. Megjithatë, në rrethana të tilla, mundësia e shqyrtimit gjyqësor efektiv dhe të pavarur të masave të tilla u gjykua se bëhej edhe më e rëndësishme. Shih gjithashtu: *Mbrojtësit Ndërkombëtarë të Kafshëve k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i Dhomës së Madhe i 22 prillit 2013, Nr. 48876/08, § 108, ku Gjykata theksoi se cilësia e shqyrtimit parlamentar dhe gjyqësor të nevojshmërisë së një mase kishte rëndësi të veçantë për përcaktimin e proporcionalitetit të saj.

e zgjatjes dhe përfundimit të fuqive emergjente, për të shqyrtuar se si janë përdorur këto fuqi dhe nëse ato u kanë shërbyer qëllimeve për të cilat janë vendosur^[723]. Legjislaturat duhet të përpiqen të vendosin një ekuilibër mes vënies së masave ekzekutive para një sprove konstruktive dhe kritike, dhe shmangies së obstrukcionizmit ose vonesave politiko-partiake në reagimin ndaj emergjencës. Në rrethana të jashtëzakonshme, Gjykata e pranon që mund të jetë e pamundur të zhvillohet debati parlamentar, në mes të një emergjence urgjente dhe të paparashikuar. Në kushte të tilla, duhet të merren të gjitha masat e mundshme për të rivendosur kontrollin parlamentar të veprimit ekzekutiv sa më shpejt që të jetë e mundur^[724]. Nëse nuk është e mundur të shqyrtohet deklarimi i gjendjes së emergjencës para se të implementohet, ose nëse nuk është e mundur të realizohet në legjislacion me procedurë normale ligjvënëse për shkak të urgjencës së futjes së masës, deklarimi i gjendjes së emergjencës dhe masave, ligjeve, dekreteve etj. që krijohen sipas fuqive të emergjencës duhet së paku të sillen para legjislaturës për shqyrtim *ex post facto* sa më shpejt që të jetë e mundur^[725].

[723] *Brannigan dhe McBride k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim plenar i Gjykatës i 25 majit 1993, Nr. 14553/89 dhe 14554/89, § 13 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[724] Shih opinionin pajtues të Gjyqtarit Krenc, të cilit iu bashkua Gjyqtari Pavli në *Communauté genevoise d'action syndicale (CGAS) k. Zvicrës*, vendimi i 15 marsit 2022, Nr. 21881/20 §§ 20 - 22 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim), në të cilin theksohet rëndësia e këqyrjes parlamentare, duke deklaruar se cilësia e debatit parlamentar është aspekt thelbësor i vlerësimit të proporcionalitetit dhe është kundërpeshë e çmuar për fuqitë e ekzekutivit, por në të cilin gjyqtarët e pranojnë se mund të ketë rrethana të pazakonta në të cilat parlamenti nuk mund të mbledhet.

[725] Shih kritikën e shprehur në lidhje me këtë pikë nga Lady Hale, ish-Kryetare e Gjykatës Supreme të Mbretërisë së Bashkuar: <https://www.theguardian.com/world/2020/sep/20/parliament-surrendered-role-over-covid-emergency-laws-says-lady-hale>, leximi i fundit më 7.04.2022. Ajo përshkruan miratimin fillestar të legjislacionit të emergjencës si „kohë thelbësore“ kur parlamenti duhet të ketë kontroll, e jo t'ia dorëzojë kontrollin ekzekutiv për t'i rimarrë ma pas funksionet e tij. Shih gjithashtu, raportin e Dhomës së Komuneve dhe Dhomës së Lordëve, Komisioni i Përbashkët për të Drejtat e Njeriut: „Reagimi i Qeverisë ndaj pandemisë Covid-19: çfarë do të thotë kjo për të drejtat e njeriut“, Raporti i Shtatë i Sesionit 2019–21 14 shtator 2020, ku theksohet se, edhe nëqoftëse fuqitë e emergjencës fillimisht hyjnë pa këqyrje nga parlamenti, çdo zgjatje përtej datës së përfundimit të dispozitave emergjente duhet t'i nënshtrohet debatit parlamentar dhe miratimit përpara, dhe jo pasi që, zgjatja të hyjë në fuqi. Shih gjithashtu, „Prorogation de l'état d'urgence sanitaire et libertés“, la Commission nationale consultative des droits de l'homme (CNCDH) France, Avis, A-2020–6, ku theksohet rëndësia e vënies fund menjëherë masave kufizuese, sapo ato të mos jenë më të nevojshme.

Shqyrtimi ex post facto

Legjislatura duhet të ketë pushtetin për të revokuar gjendjen e emergjencës, dhe duhet të jetë në gjendje të bëjë amendamente ose të rrëzojë masat e marra nëse nuk beson se janë përmbushur kriteret e ligjshmërisë dhe proporcionalitetit^[726]. Pasi hiqet gjendja e emergjencës, ato gjithashtu duhet të kenë pushtetin të nisin hetime më substanciale dhe të hollësishme rreth masave të vëna nga ekzekutivi^[727]. Ndërkohë që shqyrtimi ex post facto mund të mos mjaftojë për të parandaluar abuzimet e të drejtave të njeriut, ai mund të shërbejë për të identifikuar abuzime të tilla, dhe të rekomandojë se si mund të ishin bërë gjërat ndryshe. Një shqyrtim i tillë është veçanërisht i rëndësishëm në kontekstin e pandemisë Covid-19, e cila ka pasur shumë valë të ndryshme të infektiveve me virusin dhe ngritje sporadike lokale të infeksionit. Prandaj shqyrtimi prej të cilit nxirren mësim është thelbësor për të pajisur Shtetet që të luftojnë shpërthimet e mëtejshme të virusit, dhe shërbejnë si reagime në situata të tjera emergjente, duke siguruar respekt maksimal të drejtat themelore^[728].

Impakti i kërkesave për t'u mbyllur brenda dhe për distancim social

Kufizimet e imponuara në reagim ndaj pandemisë Covid-19 e bënë të vështirë që parlamentet të funksiononin si zakonisht, ku kufizimi i lëvizjes dhe tubimit nënkupton se ata (deputetët) nuk u lejuan të takoheshin personalisht. Megjithatë, shpërbërja e parlamentit nuk duhet të jetë përgjigje ndaj një emergjence dhe, kur mandati i legjislaturës është t'i japë fund emergjencës, ai duhet të shtyhet deri sa

[726] Për shembull, Komisioni i Përbashkët Parlamentar për Të Drejtat e Njeriut në Mbretërinë e Bashkuar bëri një kontroll me shkrim dhe me gojë të ligjeve të lidhura me Covid-19, hartoi raporte të rregullta në lidhje me masat e marra, mblodhi prova me shkrim nga palët përkatëse dhe i bëri rekomandime Qeverisë për t'u siguruar që reagimi i saj ndaj emergjencës të ishte në përputhje me të drejtat e njeriut, veçanërisht me Nenin 2, dhe që çdo ndërhyrje tek të drejtat e derogueshme të ishte proporcionale, shih uebfaqen e Komisionit këtu: <https://committees.parliament.uk/work/218/the-governments-response-to-covid19-human-rights-implications/publications/>

[727] Shih për shembull Hetimet e Mbretërisë së Bashkuar për Covid-19, të cilat analizojnë (mes shumë pikash të tjera) kontrollin dhe zbatimin legjislativ dhe rregullator; përdorimin e mbylljeve brenda dhe izolimit; dhe impaktin mbi shëndetin mendor dhe mirëqenien: <https://covid19.public-inquiry.uk/terms-of-reference/>

[728] Shih gjithashtu serinë e studimeve krahasuese të Parlamentit Evropian në lidhje me miratimin e gjendjeve të emergjencës në shtete të ndryshme, ku theksohen mësimet e nxjerra dhe praktikatat më të mira, për shembull: "Droit d'Exception, une Perspective de Droit Comparé - France : lois d'urgence pour faire face à l'épidémie de Covid-19", studim i shërbimit kërkimor të Parlamentit Evropian, PE 690.624—maj 2021 (përditësuar më 1 qershor 2021).

të jetë i mundur organizimi i zgjedhjeve. Prandaj, legjislaturat duhet të përshtasin mënyrat e punës për të maksimizuar mundësitë që anëtarët e legjislaturës të vazhdojnë të këqyrin ligjshmërinë, proporcionalitetin dhe efektivitetin e masave të marra për t'iu përgjigjur pandemisë Covid-19, edhe nëse kjo nuk bëhet duke pasur të gjithë anëtarët e legjislaturës aty për të debatuar së bashku personalisht në parlament.

Futja e teknologjive të reja është pjesë kyçe e kësaj, për të mundësuar diskutimet dhe votimet online gjatë pandemisë.^[729] Inovacione të tilla mund të vazhdojnë të paraqesin avantazhe përtej pandemisë ose në periudha të tjera emergjente. Një inovacion i tillë mund të vazhdojë të përbëjë avantazh edhe përtej pandemisë, nëse lehtëson pjesëmarrjen e atyre që e kanë më të lehtë pjesëmarrjen në distancë, siç janë deputetët që jetojnë në zona të largëta, që udhëtojnë prej larg për të ardhur deri në ndërtesën e parlamentit, ose ata që duhet të kujdesen për fëmijët. Një metodë tjetër e punës mund të jetë të lejohet një numër i kufizuar i ligjvënësve, me shifra proporcionale të përfaqësuesve nga secila parti, që të hyjnë në parlament dhe/ose të votojnë personalisht.^[730]

Raportet sugjerojnë që mbikqyrja parlamentare gjatë pandemisë në Ballkanin Perëndimor ka qenë e ulët.^[731] Këtu përfshihet mungesa e kontrollit parlamentar për vendimet ekzekutive për zbatimin dhe shtrirjen e gjendjes së emergjencës, derogimin nga KEDNJ-ja dhe futjen e masave të emergjencës^[732]. Prej vendeve të

[729] Për shembull, Parlamenti Evropian mbajti me sukses seanca në distancë duke përdorur teknologjinë për videokonferenca, dhe futi votimin elektronik për të vazhduar të funksiononte gjatë pandemisë.

[730] Në Irlandë, ku përfaqësuesit u takuan personalisht, ata u ndanë proporcionalisht sipas partive varësisht nga numri i vendeve dhe iu kërkua që të mbanin distancë minimale të sigurt nga njëri-tjetri, shih <https://commonslibrary.parliament.uk/parliament-and-elections/coronavirus-hoë-are-parliaments-ëorldëide-ëorking-during-the-pandemic/> "Koronavirusi: Si po funksionojnë parlamentet anëmbanë botës gjatë pandemisë?", nga J.Curtis dhe R.Kelly, Biblioteka e Dhomës së Komuneve, 15 prill 2020.

[731] Shih: [https://www.hugenwb.net/uploads/materials/The%20Parliamentary%20Response%20to%20COVID-19%20and%20States%20of%20Emergency%20\(SoE\)%20in%20the%20Western%20Balkans.pdf](https://www.hugenwb.net/uploads/materials/The%20Parliamentary%20Response%20to%20COVID-19%20and%20States%20of%20Emergency%20(SoE)%20in%20the%20Western%20Balkans.pdf) "Reagimi Parlamentar ndaj Covid-19 dhe Gjendjes së Emergjencës në Ballkanin Perëndimor", nga I.Radojevic dhe N.Stankovic, Fondacioni Westminster për Demokraci: Rrjeti i Komiteteve për të Drejtat e Njeriut dhe Barazinë Gjinore në Ballkanin Perëndimor, i cili raporton se numri i seancave dëgjimore mbikqyrëse, sesioneve të komisioneve, dhe proceseve të shqyrtimit të qeverive ka qenë në nivel të ulët.

[732] Impakti i Masave të Covid-19 dhe Shteti i së Drejtës në Ballkanin Perëndimor dhe Rritja e Autoritarizmit", Andi Hoxhaj dhe Fabian Zhilla, Revista Evropiane e të Drejtës Krahasuese dhe Qeverisjes, faqet 271–303, publikuar online më 24 gusht 2021, ku jepen këto shembuj: Presidenti, Kryeministri dhe Kryetari i Parlamentit të Serbisë

Ballkanit Perëndimor, vetëm parlamenti i Federatës së Bosnje dhe Hercegovinës organizoi një seancë plenare të plotë online, ndërkohë që shumica e parlamenteve kanë organizuar seanca të komisioneve parlamentare online. Gjithashtu, ka shqetësime që komisionet dhe taskforcat e organizuara në reagim ndaj Covid-19 nuk përfshinë anëtarë të parlamentit. Komitetet e ngritura për këqyrjen e punës së ekzekutivit në kuadër të reagimit ndaj emergjencave duhet të përbëhen nga ekspertët përkatës (në këtë rast ata/ato me ekspertizë në shëndetin publik dhe të drejtat e njeriut) si dhe përfaqësues të zgjedhur nga të gjitha partitë në qeveri dhe nga të gjitha rajonet e Shtetit.

Komisioni i Venedikut ka theksuar rëndësinë e pluralitetit politik dhe opozitës efektive në mbrojtje kundër keqpërdorimit të pushtetit dhe abuzimit të të drejtave.^[733] Prandaj të gjitha masat e marra për të lehtësuar këqyrjen legjislative gjatë pandemisë duhet t'i aplikohen njësoj anëtarëve të të gjitha partive dhe përfaqësuesve prej të gjitha rajoneve. Edhe kur vlerësohet që ka siguri për kthimin e disa anëtarëve të legjislaturës në parlament, mund të jetë e nevojshme të mbahen opsionet e pjesëmarrjes në distancë, për të siguruar vazhdimësinë e pjesëmarrjes së përfaqësuesve të sëmure, gjendja e të cilëve mund ta bëjë të pamundur që ata të vijnë personalisht në debate dhe të votojnë.^[734]

b. Kontrolli gjyqësor

Shqyrtimi nga një organ i pavarur dhe efektiv gjyqësor i cilësisë së ligjeve të miratuara gjatë periudhës së emergjencës, dhe aplikimi i këtyre ligjeve në praktikë, është mënyra tjetër kyçe për të parandaluar abuzimin e të drejtave gjatë situatës

deklaruan gjendjen e jashtëzakonshme më 15 mars 2020, pa u konsultuar me anëtarët e parlamentit serb dhe pa dhënë shpjegim zyrtar se përse parlamenti nuk mundi të mblidhej për të deklaruar gjendjen e emergjencës vetë; Qeveria e Shqipërisë derogoi nga disa nene të KEDNJ-së më 1 prill 2020, dhe nuk informoi parlamentin as publikun në lidhje me këtë derogim; dhe ekzekutivi i Maqedonisë së Veriut deklaroi gjendjen e jashtëzakonshme dhe futi masa emergjente kur parlamenti nuk ishte në sesion për shkak të datës së zgjedhjeve.

[733] Shih [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2019\)015-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2019)015-e) "Parametrat e marrëdhënieve mes shumicës parlamentare dhe opozitës në demokraci: listë kontrolluese", Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venedikut), CDL-AD(2019)015, 25 qershor 2019.

[734] Shih, për shembull, shqetësimet në Mbretërinë e Bashkuar që vendimi për të hequr votimin në distancë pati impakt diskriminues mbi deputetët: <https://www.euronews.com/2020/06/02/uk-mps-to-vote-on-whether-it-s-safe-to-return-to-parliament> "Koronavirus: Deputetët anglezë votojnë për t'u kthyer në parlament pas punës në distancë gjatë mbylljes brenda" nga A.Tidey me Associated Press, Euronews, 2 qershor 2020.

së emergjencës^[735]. Siç diskutohet më lart, duhet të ketë rregulla dhe procedura të qarta dhe të disponueshme që rregullojnë se kur dhe si mund të futen masat e emergjencës. Gjykatat po ashtu duhet të shqyrtojnë nëse ekzekutivi i ka ndjekur këto rregulla dhe procedura kur është deklaruar gjendja e emergjencës dhe/ose kur janë dhënë fuqitë e emergjencës^[736]. Dispozitat që rregullojnë futjen e fuqive të emergjencës duhet të përfshijnë gjithashtu një mekanizëm ku ky shqyrtim gjyqësor ndodh automatikisht.

Shtetet duhet të sigurohen që gjykatat të qëndrojnë të hapura sa më shumë që të jetë e mundur për t'u mundësuar individëve që të kontestojnë shkeljet e pretenduara të të drejtave të tyre^[737]. Për shembull, gjykatat duhet ta përdorin teknologjinë në mënyrë inovative për të zhvilluar seanca në distancë kurdo që është e nevojshme dhe e përshtatshme, ose të zbatojnë masa të sigurisë për të mbrojtur ata/ato që janë në gjendje të vijnë në gjykatë personalisht, për të garantuar që shkeljet e rënda të pretenduara të të drejtave të njeriut të vazhdojnë të dëgjohen. Për të kontestuar kufizimet e Covid-19 para GjEDNj-së gjatë pandemisë vazhdoi të ishte i nevojshëm shterimi i mjeteve vendase^[738]. Kjo e bëri funksionimin e vazhdueshëm të gjykatave vendase gjatë pandemisë edhe më të nevojshëm, për të siguruar që kufijtë e kapaciteteve të tyre për të shqyrtuar ankesat gjatë periudhës së emergjencës nuk e pengojnë mundësinë e individit për të hapur çështje si në nivel vendi, ashtu edhe në nivel evropian.

[735] Shih opinionin pajtues të Gjyqtarit Krenc, së bashku me Gjyqtarin Pavli, në *Communauté genevoise d'action syndicale (CGAS) k. Zvicrës*, vendimi i 15 marsit 2022, Nr. 21881/20 §§11, 18-19 dhe 23. Kjo çështje megjithatë iu referua Dhomës së Madhe më 5 shtator 2022, që do të thotë se vendimi i seksionit të tretë të Gjykatës nuk është përfundimtar dhe në lidhje me çështjen do të merret një vendim i ri i Dhomës së Madhe.

[736] Për shembull, një gjykatë në Bruksel vendosi më 31 mars 2021 që Qeveria belge duhet t'i heqë „të gjitha masat e koronavirusit“ brenda 30 ditësh, sepse dekreteve ministrore që u përdorën për t'i futur këto masa u mungonte baza ligjore dhe u futën pa inputin e parlamentit. Gjyqtari i dha Shtetit 30 ditë kohë për të paraqitur një bazë ligjore të shëndoshë ose do të përballej me gjobë prej 4,000 Euro në ditë. Shih: „Gjyqtari: Belgjika duhet t'i anulojë rregullat e koronës brenda 30 ditësh“, 31 mars 2021, tek <https://euobserver.com/tickers/151420>; shih gjithashtu “Mbrojtja e të drejtave themelore para Gjykatës Kushtetuese Federale të Gjermanisë gjatë krizës së Covid-19”, Klubi i Juristëve, 8 maj 2020 jep hollësi se si shumë veprime për masa të përkohshme u morën para Gjykatës Kushtetuese Federale të Gjermanisë gjatë tërë pandemisë dhe ndihmuan që të ruhej mbrojtja gjyqësore efektive.

[737] Vështirësitë që siguronin qasje të shpejtë dhe efektive ndaj drejtësisë në gjykata gjatë pandemisë diskutohen me hollësi në seksionin rreth Nenit 6 (E drejta e seancës së drejtë) në Kapitullin I në këtë publikim.

[738] *Zambrano k. Francës*, vendimi i 7 tetorit 2021, Nr. 41994/21, ku kërkesa u deklarua e papranueshme sepse kërkuesi nuk kishte bërë apel pranë gjykatës administrative franceze dhe prandaj u gjet se nuk i kishte shteruar zgjidhjet vendore. Shih gjithashtu *Thevenon k. Francës*, vendimi i 13 shtatorit 2021, Nr. 46061/21.

Raportet sugjerojnë se këqyrja substanciale gjyqësore gjatë pandemisë ishte më e përhapur dhe efektive në vendet ku gjykatat e shkallës së parë janë më të lehta për t'iu qasur, dhe ku ekziston një qark gjyqësor specifik i specializuar në shqyrtimin e veprimeve të autoriteteve publike^[739]. Për shembull, në Francë procedura "référé-liberté" u vërtetua të ishte mjet efektiv për të garantuar këqyrjen efektive gjyqësore për të parandaluar shkeljet e të drejtave të njeriut gjatë pandemisë^[740]. Kjo procedurë i mundëson çdo qytetari që të bëjë apel para një tribunali administrativ duke shfrytëzuar procedurën e përshpejtuar kur argumentohet se një masë ka shkelur të drejtat e tij themelore. Më pas vendimi i gjykatës së shkallës së parë mund të apelohej para Këshillit të Shtetit (frëng. Conseil d'Etat). Conseil d'Etat ka funksionuar pa ndërprerje dhe është ftuar në vazhdimësi për të bërë vlerësimin e kushtetutshmërisë së masave të marra në reagim ndaj pandemisë. Mes muajve mars 2020 dhe mars 2021, 647 kërkesa në lidhje me pandeminë u vendosën me procedura urgjente, dhe Conseil d'Etat urdhëroi masa ose suspendoi vendime të Qeverisë dhe autoriteteve në 51 raste^[741].

Shembujt e mëtejshëm më poshtë të këqyrjes gjyqësore gjatë pandemisë tregojnë se si mund të përdoren parimet e ligjshmërisë dhe proporcionalitetit për të kërkuar llogari nga qeveria, qoftë edhe gjatë një situatë të emergjencës ose të krizës:

[739] „Kushtetutat dhe Infektimi. Sistemi Kushtetues Evropian dhe Pandemia Covid-19”, Angelo Jr Golia, Laura Hering, Carolyn Moser, Tom Sparks, Seria e Shkrimeve Hulumtuese MPIL Nr. 2020-42.

[740] [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2021/690624/EPRS_STU\(2021\)690624_FR.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2021/690624/EPRS_STU(2021)690624_FR.pdf), "Droit d'exception, une perspective de droit comparé France : lois d'urgence pour faire face à l'épidémie de Covid-19", studim nga shërbimi hulumtues i Parlamentit Evropian, PE 690.624-maj 2021 (përditësuar më 1 qershor 2021).

[741] Për shembull, Këshilli i Shtetit urdhëroi rifillimin e regjistrimit të aplikimeve për azil (prill), ceremonive në vendet e faljes (maj), demonstratat (qershor dhe korrik), urdhëroi dhënie të maskave të burgosurve në burgje (maj), kufizoi bartjen e detyrueshme të maskave në zonat e rrezikuara (shtator), suspendoi kriterin e tregimit të gjendjes shëndetësore si parakusht për të përfitur nga masat e liridajes (tetor) dhe videolidhjeve në gjyqe penale (nëntor dhe shkurt). Shih <https://www.conseil-etat.fr/en/news/one-year-of-legal-proceedings-linked-to-covid-19>: „Një shikim mbi shifrat e aktivitetit në Këshillit Shtetëror të Francës, gjykata përgjegjëse për masat urgjente dhe liritë”, 21 prill 2021.

- i) Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Bosnjës i 22 prillit 2020^[742] që ndalimi i të miturve dhe personave mbi 65 vjeç nga dalja jashtë shtëpisë kishte shkelur të drejtën e tyre për lirinë e lëvizjes, për shkak se kufizimet nuk përmbushnin kriterin e proporcionalitetit, autoritetet nuk e kishin bërë të qartë përse vlerësonin se disa grupmosha të caktuara ishin në rrezik më të madh të infektimit ose të transmetimit të infeksionit, mundësia e futjes së masave më të lehta nuk u mor në konsideratë, masat nuk ishin rreptësisht të kufizuara në kohë, dhe nuk kishte detyrim për të shqyrtuar nevojën për vazhdimin e tyre.
- ii) Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës i 23 marsit 2020^[743] që disa ndalime të caktuara të lëvizjes nuk ishin të parashikuara me ligj meqenëse ato nuk ishin në pajtueshmëri me kriterin kushtetues që kufizimi i të drejtave dhe lirive mund të bëhet me anë të ligjeve të miratuara në Kuvend.
- iii) Vendimi i Giudice di Pace di Frosinone i 15 qershorit 2020, n. 516, i cili shpalli që urdhri i Këshillit të Ministrave të Italisë i datës 31.01.2020 që deklaronte gjendjen e emergjencës ishte në kundërshtim me Kushtetutën italiane.
- iv) Urdhri i Tribunalit Administrativ të Strasburgut i 20 majit 2020 për të pezulluar dekretin e Qytetit të Strasburgut që i detyronte të gjithë personat mbi moshën 11 vjeç të vinin maska kur dilnin nëpër qytet.^[744] Tribunali iu referua Nenit 8 të KEDNj-së dhe parimit të qëllimit legjitim dhe proporcionalitetit, duke gjetur që masa nuk ishte e justifikuar nga një arsye bindëse të lidhur me rrethanat lokale në Strasburg. Duke u bazuar mbi të njëjtat parime, më 2 shtator 2020 i njëjti tribunal e anuloi dekretin dhe ftoi autoritetet lokale që ta ndryshonin.
- v) Vendimi i Këshillit Kushtetues Francez i 29 janarit 2021 që urdhri i Qeverisë që lejonte zgjatjen automatike të paraburgimit paragjyqësor ishte në papajtueshmëri me Nenin 66 të Kushtetutës (ndalimi i paraburgimit arbitrar), duke e prishur

[742] Shih <https://balkaninsight.com/2020/04/22/bosnia-court-rules-against-movement-curbs-on-minors-seniors/> "Gjykata e Bosnjës vendos kundër zbutjes së lëvizjeve për të miturit", nga N.Dervisbegovic, Balkan Insight, 22 prill 2020.

[743] K054/20, Kërkesi: Presidenti i Republikës së Kosovës, Shqyrtim Kushtetues i Vendimit Nr. 01/15 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, i 23 marsit 2020.

[744] Shih <http://strasbourg tribunal-administratif.fr/content/download/171091/1705849/version/1/file/2003058-1.pdf> Urdhëresa Nr. 2003058 e 25 majit 2020, Tribunali Administrativ i Strasburgut.

urdhrin me efekt të menjëhershëm^[745]. Përveç kësaj, më 15 janar 2021, Këshilli Kushtetues konsideroi se përdorimi i telekomunikimeve audio-vizuale, për të vendosur vazhdimin ose jo të paraburgimit paragjyqësor, ishte jokushtetues sepse përdorimi i telekomunikimeve audio-vizuale nuk i nënshtrohej ndonjë kushti ose përjashtimi ligjor, ose kriterit të pëlqimit të palëve^[746].

Qasja e gjykatës boshnjake po ashtu pasqyron fushat relative të kompetencës së gjyqësorit dhe qeverisë gjatë një situatë krize. Gjykata nuk e anuloi komplet urdhrin në fjalë. Në vend të tij, ajo kërkoi justifikime të mëtëjshme dhe amendamente të masës për të siguruar që ajo ishte në pajtim me parimet e ligjshmërisë dhe proporcionalitetit, por e la Qeverinë boshnjake të aplikonte ekspertizën e vet të politikave për të vendosur se si të bëhej kjo, duke marrë parasysh kërkesat që gjykata i kishte sjellë në vëmendje. Ngjashëm, në prill të vitit 2020, Gjykata Kushtetuese e Sllovenisë vlerësoi nëse një urdhëresë qeveritare që kufizonte lirinë e lëvizjes dhe tubimit ishte kushtetuese. Gjykata gjeti që masat nuk ishin proporcionale mbi bazën se ato ishin vendosur për një periudhë të pakufizuar kohore. Në vend që të anulonte masat, gjykata urdhëroi që ato t'i nënshtroheshin shqyrtimit periodik të proporcionalitetit, të paktën çdo shtatë ditë, në mënyrë që masat të mund të zgjateshin vetëm nëqoftëse, varësisht nga rrethanat dhe opinionet eksperte, ato vazhdonin të konsideroheshin të nevojshme për të arritur objektivat e synuara^[747].

c. Kontrolli ndërqeveritar dhe ombudspersoni(at) e pavarur

Një mënyrë tjetër se si Shtetet mund të përpiqen të sigurojnë llogaridhënie gjatë pandemisë është përmes emërimit të ekspertëve brenda qeverisë ose organeve eksperte të jashtme për të mbikqyrur dhe këshilluar veprimet ekzekutive. Ombudspersoni i pavarur ekzistues ose komisionet ekzistuese të të drejtave të njeriut mund të caktohen me detyrën e vëzhgimit të masave të emergjencës dhe pikasjes së abuzimeve potenciale të të drejtave të njeriut^[748]. Përndryshe, Shtetet

[745] Vendimi Nr. 2020-878/879 QPC.

[746] Vendimi Nr. 2020-872 QPC.

[747] Gjykata Kushtetuese e Republikës së Sllovenisë (2020), Opravilna št. U-I-83/20, 16 prill 2020.

[748] Për shembull, ndërhyrjet e ndryshme të Ombudspersonit francez „Mbrojtësja e të drejtave“ të bëra para parlamentit francez në lidhje me përputhshmërinë me të drejtat e njeriut e masave të ndryshme të marra për të reaguar ndaj pandemisë, përfshirë vendimin për të zgjatur gjendjen e emergjencës, proporcionaliteti i masave të futura për të luftuar pandeminë, dhe kufizimet e imponuara kundër njerëzve të pavaksinuar https://www.defenseurdesdroits.fr/sites/default/files/rapport_annuel/ddd_rapport-annuel-2021_20220705.pdf. Shih

mund të krijojnë taskforca të reja dhe role të reja për ekspertë të cilët të këshillojnë se si të garantohet pajtueshmëria me të drejtat e njeriut gjatë realizimit të reagimit ndaj pandemisë.

Në Afrikën e Jugut, për shembull, ish-gjyqtarja e Gjykatës Kushtetuese, Kate O'Regan, u emërua si gjyqtare e caktuar për Covid-19 për t'i bërë rekomandime ministrive të qeverisë në lidhje me amendimin ose zbatimin e rregulloreve për mbrojtjen e të drejtës së privatësisë krahas garantimit të mundësisë së Departamentit të Shëndetësisë për t'u marrë me gjurmimin e kontaktimit.^[749] Çështja e mbrojtjes së privatësisë së të dhënave është një fushë ku kjo mund të jetë shumë e dobishme, sepse njohuritë teknologjike duhet të kombinohen me ekspertizën ligjore për të siguruar që sistemet e gjurmimit dhe gjetjes të mbrojnë privatësinë e të dhënave sa të jetë e mundur, krahas të shërbyerit e qëllimit të mbrojtjes së shëndetit publik.

Angazhimi me ekspertët e pavarur nga fusha të ndryshme si shëndetësia, teknologjia, transporti, ekonomia etj. duhet të ndihmojë në garantimin e pajtueshmërisë me parimet e ligjshmërisë dhe proporcionalitetit. Bashkëpunimi me ekspertët ndihmon që vendimet të udhëhiqen në mënyrë shkencore, dhe t'i shërbejnë qëllimit për të cilin janë marrë. Ekspertët e pavarur po ashtu qenë në gjendje t'u ofronin qeverive një gamë të gjerë opsionesh lidhur me mënyrat e reagimit ndaj pandemisë, duke bërë që qeveritë të ishin në pozicion më të favorshëm për të zgjedhur mënyrat e mbrojtjes së shëndetit të cilat kishin impaktin më të vogël ndaj të drejtave të tjera. Vënia në dispozicion për publikun e këshillimit dhe inputit të pavarur që i jepet Qeverisë mund të forcojë llogaridhënien kur vendimet e qeverisë ndryshojnë nga këshillat e ekspertëve. Në këtë situatë, qeveritë me gjasë ndodhen nën këqyrje më të madhe nga parlamenti dhe shtypi për të justifikuar vendimet që janë larg këshillave të ekspertëve dhe për të demonstruar bazat e qasjes së tyre, për t'u siguruar që të jenë të ligjshme dhe proporcionale.^[750]

gjithashtu vendimin e Ombudspersonit sloven të të Drejtave të Njeriut që një person nuk mund të penalizohet për mos-respektimin e dekretit të qeverisë që urdhëron bartjen e detyrueshme të maskave të fytyrës në ambiente publike të mbyllura sepse dekreti nuk u bë mbi bazën ligjore që e lejon këtë: <https://www.varuh-rs.si/en/news/news/ombudsman-says-failure-to-wear-mask-in-enclosed-spaces-cannot-be-penalised/>.

[749] Shih <https://www.law.ox.ac.uk/news/2020-04-06-kate-oregan-appointed-south-africas-covid-19-designated-judge> "Kate O'Regan emërohet Gjyqtare për Covid-19 në Afrikën e Jugut", Lajme nga Fakulteti Juridik, Universiteti i Oksfordit, 6 prill 2020.

[750] Bëhet krahasimi, duke parë shembullin në Angli të profesionistëve që nuk janë dakord me qëndrimin e qeverisë për

Kapitulli IV - Përfundime

Kërcënimi i pandemisë së Covid-19, dhe masat urgjente që duhen marrë në reagim ndaj këtij kërcënimi, qartazi i kanë dhënë shkas sfidave pa precedent në një gamë të gjerë aspektesh, përfshirë mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Ndërkohë që natyra e pandemisë vazhdon të zhvillohet edhe më tej, qeveritë zhvillojnë masa dhe teknologji të reja për të luftuar dhe përmbajtur përhapjen e saj, përfshirë edhe përpunimin e vaksinave, testimet masive dhe politikatat e gjurmimit të kontakteve.

Prandaj, ky publikim nuk përpiqet të mbulojë çdo aspekt të çdo të drejte që mund të preket nga pandemia ose nga reagimet e qeverive ndaj saj. Në fakt, ai ofron një shikim të përgjithshëm mbi disa prej fushave kyçe të Konventës të cilat janë prekur nga pandemia, dhe që mund të vazhdojnë të preken nga impakti dhe pasojat e saj. Ai gjithashtu jep shembuj të disa prej aspekteve kyçe ku mund të dalin detyrimet pozitive të Shteteve për të ndërmarë veprime sipas Konventës. Më tej, ai analizon mënyrën se si janë aplikuar nga gjykatat parimet e përgjithshme si proporcionaliteti, subsidiariteti dhe hapësira e vlerësimit gjatë periudhës së pandemisë, për të ofruar udhërrëfim se si ato mund dhe duhet të aplikohen në situata të tjera emergjence prej tash e tutje.

Ndërkohë që jemi duke dalë nga pandemia, një numër vendimesh përfundimtare dhe vendimesh për pranueshmërinë tashmë janë marrë nga gjykatat evropiane dhe vendase specifikisht në lidhje me çështje të pandemisë. Ajo që është e qartë nga jurisprudenca relevante e Gjykatës që analizohet në këtë Udhërrëfyes është se parimet e ligjshmërisë dhe proporcionalitetit nuk mund të injorohen në një situatë krize. Ndërkohë që mënyra se si aplikohen mund të rregullohet sipas urgjencave të situatës së emergjente, ato duhet të mbeten qenësore në çdo reagim ndaj emergjencave.

Gjykata njeh faktin që pandemia nxori në pah pyetje komplekse në lidhje me të drejtat konkurruese, dhe që Shtetet u desh të merrnin masa të pazakonta për

heqjen nga platformat publike: <https://www.independent.co.uk/news/uk/politics/nurse-ruth-may-dropped-coronavirus-briefings-dominic-cummings-a9628681.html> "Kryeinfiermjerja e Anglisë konfirmon që është 'hequr' nga konferenca e shtypit Nr. 10 pas shprehjes së kritikave për Dominic Cummings" nga A. Coëburn, The Independent, 20 korrik 2020.

t'iu kundërpërgjigjur pandemisë. Natyrisht, Gjykata u jep Shteteve hapësirë më të gjerë vlerësimi për sa i përket reagimit ndaj pandemisë dhe hartimit të politikave shëndetësore dhe ekonomike. Megjithatë, Gjykata ka ri-theksuar se kjo hapësirë vlerësimi nuk është e pakufishme. Pavarësisht nga sfidat e sjella nga pandemia, Shtetet mbeten nën detyrimin për të bërë një vlerësim të kujdesshëm të ndërhyrjes së tyre tek të drejtat dhe liritë e atyre brenda juridiksionit të tyre, dhe për të kufizuar impaktin e tyre mbi këto të drejta vetëm deri në atë shkallë, dhe vetëm për atë kohë sa kërkohet nga urgjencat e situatës emergjente. Ky publikim përpiket të ofrojë një shikim të përgjithshëm të faktorëve kyç që duhen marrë në konsideratë gjatë bërjes së vlerësimeve të tilla dhe gjatë marrjes së vendimeve për masat që duhen marrë. Më tej, ndërkohë që këqyrja parlamentare mund të jetë e kufizuar gjatë një situatë emergjente, këqyrja gjyqësore e pavarur dhe efektive e masave emergjente bëhet edhe më e rëndësishme.

Ky publikim përpiket të tregojë që Shteteve mund t'u jetë dashur që të tregojnë kreativitet në qasjen e tyre për të mundësuar që gjykatat, legjislaturat dhe institucionet e tjera të vazhdonin të funksiononin gjatë pandemisë, por që operimi i tyre i vazhdueshëm ishte i mundur po atë sa thelbësor. Teksa shkojmë përpara, këto mësim të nxjerra do të jenë relevante për mbrojtjen e këqyrjes gjyqësore dhe legjislative në kontekstin e emergjencave të ardhshme.

Për fund, shpresojmë që ky publikim ka arritur të tregojë që mbrojtja e të drejtave të njeriut nuk duhet të shihet si pengesë për mbrojtjen e shëndetit. Përkundrazi, mbrojtja e të drejtave kërkon mbrojtjen e shëndetit. Aplikimi i parimeve të ligjshmërisë dhe proporcionalitetit mund të ndihmojë të garantohet që masat e marra për të reaguar ndaj pandemisë të jenë efikase dhe efektive në qëllimin e tyre për mbrojtjen e shëndetit, pa shkelur të drejtat e tjera të njeriut në shkallë të panevojshme. Dispozitat e Konventës dhe praktikës gjyqësore të Gjykatës ofrojnë udhërrëfim të dobishëm në lidhje me interesat që duhen marrë parasysh gjatë deshifrimit të mënyrës se si të reagohet ndaj një situatë të krizës. Po ashtu, ato ofrojnë korniza të dobishme brenda të cilave të strukturohen vendimet që përfshijnë ekuilibrimin e interesave komplekse e nganjëherë konkurruese.

Pa dyshim që pandemia e Covid-19 ishte situatë e jashtëzakonshme, por kjo nuk është arsye për të shpërfillur kërkesat e KEDNJ-së për të mbrojtur të drejtat e njeriut në përputhje me parimet e ligjshmërisë dhe proporcionalitetit. Në të vërtetë, kjo e ka bërë mbrojtjen dhe aplikimin e tyre edhe më thelbësore.

P J E S A 2

Përmbledhjet e çështjeve

I. Derogimi dhe masat e pazakonta

Kërcënimet terroriste pas 11 shtatorit kanë përbërë "emergjencë publike në kërcënim të jetës së kombit", por fuqitë e derogimit të përdorura sipas Nenit 15 kanë qenë joproporcionale pra të pavlefshme sepse kanë diskriminuar në mënyrë të pajustificueshme kundër shtetasve të huaj

VENDIMI I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN A. DHE TË TJERË K. MBRETËRISË SË BASHKUAR

(Kërkesa Nr. 3455/05)
19 shkurt 2009

1. Faktet kryesore

Çështja u ngrit nga njëmbëdhjetë kërkues: gjashtë me shtetësi algjeriane; katër me shtetësi franceze, jordaneze, marokene dhe tuniziane respektivisht; dhe një pa shtetësi, meqenëse ishte i lindur në një kamp refugjatësh palestinezë në Jordani.

Qeveria konsideroi që Mbretëria e Bashkuar, duke pasur parasysh lidhjet e saj të ngushta me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ishte veçanërisht nën kërcënim terrorist pas ngjarjeve të 11 shtatorit 2001. Si e tillë, ajo shpalli gjendjen e emergjencës publike brenda kuptimit të Nenit 15 § 1 të Konventës – 'derogimi në kohë emergjencash'.

Qeveria konsideroi që kërcënimi terrorist buronte në mënyrë të veçantë nga shtetasit e huaj në Mbretërinë e Bashkuar, përfshirë kërkuesit, që kinëse ishin pjesë e një rrjeti mbështetës për organizatat ndërkombëtare, si al'Qaeda. Qeveria kishte fuqinë të ndalonte persona të tillë mbi bazën e sigurisë kombëtare sipas Aktit të Imigracionit të vitit 1971. Megjithatë, një fuqi e tillë mund të ushtrohej vetëm nëse

deportimi vijues ishte i mundur brenda një kohe të arsyeshme, përndryshe çdo ndalim do të konsiderohej i paligjshëm.

Deportimi, e rrjedhimisht ndalimi, i kërkuesve nuk ishte i mundur sepse ata rrezikonin keqtrajtimin në vendet e tyre të origjinës, çka përbënte shkelje të Nenit 3 të Konventës. Kështu, Pjesa 4 e Aktit të Kundër-Terrorizmit, Krimin dhe Sigurisë të vitit 2001 ("Akti i vitit 2001") hyri në fuqi më 4 dhjetor 2001, pas një note derogimi sipas Nenit 15 në nëntor 2001. Kjo i dha Qeverisë fuqinë për të ndaluar shtetas të huaj të certifikuar nga Sekretari i Shtetit si "terroristë të dyshuar ndërkombëtarë" të cilët "për momentin" nuk mund të zhvendoseshin nga Mbretëria e Bashkuar.

Mes dhjetorit 2001 dhe tetorit 2003, të gjithë kërkuesit u ndaluan sipas Aktit të vitit 2001, fillimisht në Burgun Belmarsh në Londër. Dy prej kërkuesve u liruan meqenëse ata zgjodhën që të largoheshin nga Mbretëria e Bashkuar. Tre prej tyre u transferuan në Spitalin Mendor të Sigurisë në Broadmoor pas përkeqësimit të shëndetit të tyre mendor, përfshirë një tentativë vetëvrasjeje. Një tjetër u lirua në kushte të barasvlershme me arrest shtëpiak për shkak të shqetësimeve serioze për shëndetin mendor.

Secili kërkues apeloj tek Komisioni i Posaçëm për Apelet e Imigracionit (SIAC) kundër certifikimit të Sekretarit të Shtetit që ata ishin "terroristë të dyshuar ndërkombëtarë". Vendimi për certifikimin u mbështet nga SIAC më 30 korrik 2002. Megjithatë, SIAC nuk gjeti që regjimi i ndalimit shkelte Konventën meqenëse ai aplikohet vetëm ndaj shtetasve të huaj e prandaj ishte diskriminues.

Kërkuesit gjithashtu kontestuan ligjshmërinë e derogimit të Qeverisë sipas Nenit 15. Më 16 dhjetor 2004, Dhoma e Lordëve deklaroi që ekzistonte një emergjencë që kërcënonte jetën e kombit por që skema e ndalimit nuk adresonte në mënyrë racionale kërcënimin ndaj sigurisë e prandaj ishte joproportionale. Ajo gjeti në mënyrë të veçantë që skema e ndalimit diskriminonte pajustificueshmërinë kundrejt shtetasve të huaj. Prandaj, ajo bëri një deklaratë papërputhshmërie sipas Aktit të të Drejtave të Njeriut dhe e rrëzoi urdhrin e derogimit.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesit u ankuan që ndalimi i tyre për një kohë të pacaktuar shkelte të drejtat e tyre nga Neni 3, dhe që atyre u ishte mohuar zgjidhja efektive për këtë në shkelje të Nenit 13. Për më tepër, ata argumentuan që ndalimi i tyre ishte diskriminues, meqenëse aplikohet vetëm ndaj shtetasve të huaj, në shkelje të Neneve 5 § 1 dhe

14. Kërkuesit po ashtu debatuan që procedura e apeleve të SIAC shkelte Nenin 5 § 4. Në fund, ata debatuan që shkeljet e mësipërme i linin ata pa kërkesë të zbatueshme për kompensim në gjykatat shtetërore, duke shkelur të drejtat e tyre nga Neni 5 § 5.

Neni 3 vetëm ose në lidhje me Nenin 13

Gjykata vërejtë që ndalimi i pacaktuar i kërkuesve ishte serioz mjaftueshëm sa të ndikonte në shëndetin e tyre mendor. Pavarësisht nga kjo, kërkuesit kishin mundur, dhe ia kishin dalë me sukses, që të kontestonin ligjshmërinë e skemës së ndalimit sipas sistemit të apelit në SIAC. Për më tepër, secili kërkues kishte mundur që të ngrinte kontest individual ndaj certifikimit të vet, dhe me statut kërkohej që ky të rishikohej çdo gjashtë muaj. Prandaj, Gjykata deklaroi që situata e tyre nuk krahasohej me dënim të përjetshëm të paretdueshëm, i cili mund t'i jepte shkas ndonjë shkeljeje nga Neni 3.

Për më tepër, kërkuesit kishin zgjidhje vendore në dispozicion sipas të drejtës administrative dhe civile, çka ata nuk u përpoqën t'i shfrytëzonin. Prandaj, Gjykata nuk mundi të shqyrtonte ankesat e kërkuesve rreth kushteve të ndalimit të tyre, meqenëse ato nuk u përmbaheshin kriterëve të Nenit 35 për shterimin e zgjidhjeve vendore. Përveç kësaj, nuk kishte shkelje të Nenit 13.

Prandaj Gjykata nuk gjeti shkelje të Nenit 3, i marrë vetëm ose në lidhje me Nenin 13.

Nenet 5 § 1 dhe 15

Gjykata nuk gjeti shkelje në lidhje me kërkuesit marokenë dhe francezë, të cilët ishin ndaluar vetëm për periudha të shkurtra para se të vendosnin të largoheshin nga Mbretëria e Bashkuar. Megjithatë, sa u përket nëntë kërkuesve të tjerë, Gjykata deklaroi që politika e Qeverisë për "mbajtjen nën shqyrtim aktiv" të mundësisë së deportimit të tyre ngërthente siguri apo vendosmëri të pamjaftueshme për të përbërë "veprime të ndërmarra me qëllim deportimi". Prandaj, ndalimi i kërkuesve nuk hynte brenda përjashtimit tek e drejta për liri që përcaktohet në Nenin 5 § 1(f).

Në vend të kësaj, Gjykata deklaroi se ishte e qartë nga kushtet e notës së derogimit dhe Pjesës 4 të Aktit të vitit 2001 që ndalimi ishte i natyrës parandaluese: kërkuesit ishin certifikuar dhe ishin ndaluar sepse dyshohej se ishin terroristë ndërkombëtarë, dhe sepse besohej se prania e tyre në Mbretërinë e

Bashkuar kërcënonte sigurinë kombëtare. Ndalimi parandalues pa akuza është i papërputhshëm me të drejtën themelore për liri sipas Nenit 5 § 1 në mungesë të një derogimi të vlefshëm sipas Nenit 15.

Prandaj, Gjykata vazhdoi më tej duke shqyrtuar nëse derogimi i Qeverisë ishte i vlefshëm. Për ta bërë këtë, Gjykata së pari diskutoi nëse ekzistonte një "emergjencë publike që kërcënonte jetën e kombit". Ajo shfrytëzoi praktikën e kaluar gjyqësore për të hedhur dritë mbi këtë prag, duke shënuar se emergjenca duhet të ishte "aktuale ose e pritshme... që prek tërë vendin deri në atë pikë sa të kërcënohet vazhdimësia e jetës së organizuar të komunitetit; dhe që kriza ose rreziku duhet të jenë të jashtëzakonshme, çka do të thotë se masat apo kufizimet normale të lejuara nga Konventa për ruajtjen e sigurisë, shëndetit dhe rendit publik ishin qartazi të pamjaftueshme"^[751].

Gjatë shqyrtimit të pritshmërisë, Gjykata pranoi që Qeveria frikësohej se një sulm nga al'Qaeda ishte i pritshëm, pavarësisht se një sulm i tillë nuk kishte ndodhur brenda Mbretërisë së Bashkuar në kohën kur u bë derogimi. Së pari, kriteri i pritshmërisë nuk mund të interpretohet aq ngusht sa t'u kërkojë Shteteve të presin që të godasë fatkeqësia para se të marrin masat e duhura. Së dyti, meqenëse vetë qëllimi i Nenit 15 është të mbrohet popullata nga rreziqet e ardhshme, Gjykata u shpreh se ekzistenca e një kërcënimi duhet të vlerësohet kryesisht duke iu referuar fakteve të njohura nga Qeveria në kohën e derogimit, megjithëse Gjykata mund të ketë parasysh gjithashtu informacionet që dalin në dritë më pas. Duke zbatuar këto parime, Gjykata vërejti që Sekretari i Shtetit kishte sjellë prova para gjykatave vendase për të treguar ekzistencën e kërcënimit për sulme të rënda terroriste kundër Mbretërisë së Bashkuar, krahas provave të mbyllura që u sollën para SIAC. Të gjithë gjyqtarët kombëtarë kishin vlerësuar se kjo ishte e besueshme, me një përjashtim.

Gjatë shqyrtimit të kohëzgjatjes së kërcënimit, Gjykata vërejti se Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut kishte vënë re se masat e derogimit duhet të jenë "të natyrës së jashtëzakonshme dhe të përkohshme". Megjithatë, praktika gjyqësore e Gjykatës nuk kishte kërkuar asnjëherë, deri në atë kohë, inkorporimin specifik të përkohshmërisë. Sidoqoftë, Gjykata shënoi se kohëzgjatja e emergjencës mund të ketë lidhje me proporcionalitetin e reagimit, duke shtuar se kishte pasur emergjenca publike të kaluara të cilat konsiderohej se kishin ekzistuar për shumë vite, ku u morën shembuj nga Irlanda Veriore.

[751] Danimarka, Norvegjia, Suedia dhe Holanda k. Greqisë, nr. 3321/67, nr. 3322/67, nr. 3323/67 dhe nr. 3344/67, raporti i Komisionit i datës 5 nëntor 1969.

Gjatë shqyrtimit të natyrës së kërcënimit, Gjykata e rrëzoi të vetmin mendim mospajtues të një gjyqtari kombëtar që kërcënimi do të duhej të shtrihej deri tek institucionet e Shtetit. Aty Gjykata shënoi se ajo në të kaluarën kishte arritur në përfundimin se kishte emergjenca edhe kur Shteti nuk ishte në rrezik dhe, për më tepër, gjatë vlerësimit të këtij pragu kishte marrë në konsideratë një gamë edhe më të gjerë faktorësh.

Më tej, megjithëse Mbretëria e Bashkuar ishte i vetmi shtet i Konventës që derogonte në lidhje me rrezikun nga al'Qaeda, Gjykata zbatonte një hapësirë të gjerë vlerësimi ndaj të drejtës së Qeverisë, si rojtare e sigurisë së popullit të vet, për të bërë vlerësimin e vet mbi bazën e fakteve të njohura për të në atë kohë. Prandaj, Gjykata, ashtu si shumica e Dhomës së Lordëve, pranoi që kishte pasur gjendje emergjente.

Më pas, Gjykata vazhdoi të shqyrtonte nëse Qeveria kishte deroguar nga detyrimet e saj sipas Nenit 5 § 1 vetëm "deri në masën e kërkuar rreptësisht nga urgjenca e situatës" siç parashikohet nga Neni 15.

Së pari, Gjykata konsideroi pretendimin e Qeverisë që Dhoma e Lordëve i kishte dhënë peshë të pamjaftueshme pikëpamjeve të ekzekutivit dhe parlamentit. Autoritetet vendase kanë hapësirë të gjerë vlerësimi për të vendosur rreth natyrës dhe fushëveprimit të masave deroguese. Pavarësisht nga kjo, në fund të fundit i takon Gjykatës të vendosë nëse këto masa kanë qenë "rreptësisht të kërkuara". Kështu, Gjykata duhet të jetë e bindur që: ka qenë reagim i vërtetë ndaj situatës së emergjencës, ka qenë plotësisht i justifikuar nga rrethanat e veçanta të emergjencës, dhe ka pasur mbrojtje të përshtatshme kundër abuzimit. Megjithatë, Gjykata theksoi se e njëjta hapësirë vlerësimi nuk zbatohet në nivelin e Shtetit, ku çështja e proporcionalitetit në fund të fundit është vendim i gjykatave kombëtare, posaçërisht aty ku e drejta e lirisë është privuar për një kohë kaq të gjatë. Prandaj, duke pasur parasysh mënyrën e kujdesshme në të cilën i trajtonte çështjet Dhoma e Lordëve, Gjykata e rrëzoi pretendimin e Qeverisë që Dhoma i kishte dhënë peshë të pamjaftueshme pikëpamjeve të ekzekutivit dhe parlamentit.

Së dyti, Gjykata rrëzoi pretendimin e Qeverisë që shqyrtimi i legjislacionit nga Dhoma ishte tepër abstrakt, duke nënvizuar se qasja sipas Nenit 15 domosdoshmërisht është e përqendruar tek situata e përgjithshme në vendin në fjalë. Kështu, Gjykata theksoi se si gjykatave ndërkombëtare ashtu edhe atyre kombëtare u kërkohet të shqyrtojnë masat e derogimit në fjalë dhe t'i peshojnë ato karshi natyrës së kërcënimit emergjent. Në qoftë se kjo rezulton me një gjetje

joproporcionale dhe diskriminuese, siç ka ndodhur këtu, nuk ka nevojë të shkohet më tej e të merret në shqyrtim rasti i veçantë i secilit kërkues.

Së treti, Gjykata që dakord me Dhomën e Lordëve që skema e ndalimit nuk ishte masë imigracioni, ku dallimi mbi bazën e shtetësisë do të ishte legjitim, por në fakt ishte masë që kishte të bënte me sigurinë kombëtare.

Së katërti, Gjykata deklaroi se Qeveria nuk kishte paraqitur prova për të vërtetuar pretendimin e saj se myslimanët britanikë kishin shumë më tepër gjasa për të reaguuar negativisht ndaj ndalimit pa akuza të myslimanëve vendas sesa të myslimanëve të huaj me lidhje të dyshuara terroriste.

Së pesti, Gjykata nuk që e bindur që kërcënimi nga joshtetasit ishte në mënyrë domethënëse më serioz sesa ai nga shtetasit, duke pasur parasysh që gjykatat vendase, përfshirë SIAC, kishin parë edhe informata të hapura edhe të mbyllura dhe nuk ishin bindur për këtë pabarazi.

Prandaj, Gjykata gjeti që derogimi ishte joproporcional meqenëse diskriminonte në mënyrë të pajustificueshme mes shtetasve dhe joshtetasve. Rrjedhimisht, kishte shkelje të Nenit 5 § 1 në lidhje me nëntë kërkuesit e tjerë.

Neni 5 § 4

Gjykata i deklaroi të papranueshme ankesat e dy kërkuesve të cilët kishin zgjedhur të largoheshin nga Mbretëria e Bashkuar. Kërkuesit e mbetur u ankuan që procedura e apelit në SIAC ishte e padrejtë sepse provat kundër tyre nuk ishin zbuluar tërësisht.

Gjykata pohoi që SIAC ishte në pozitën më të mirë për të garantuar që asnjë material të mos mbahej pa nevojë larg kërkuesve, duke shënuar më tej se nevojshmëria e sekretit justifikohet nga emergjenca publike. Aty ku materialet e hapura përbëheshin vetëm nga konstatime të përgjithshme, kriteret procedurale nga Neni 5 § 4 nuk do të përmbusheshin, meqenëse kjo do ta bënte të pamundur që kërkuesit të jepnin informata për të kundërshtuar argumentet e parashtruara kundër tyre.

Rrjedhimisht, Gjykata gjeti shkelje të Nenit 5 § 4 në lidhje me katër kërkuesit, meqenëse akuzat e hedhura haptas ishin të një natyre tepër të përgjithshme, çka i privonte ata prej të qenit në pozitë për të sfiduar efektivisht provat kundër tyre.

Neni 5 § 5

Gjykata gjeti shkelje të Nenit 5 § 5 meqenëse shkeljet e mësipërme nuk mund t'i jepnin shkas pretendimit të zbatueshëm për kompensim në gjykatat kombëtare. Kjo kishte lidhje me të gjithë kërkuesit përveç dyve prej tyre që kishin zgjedhur të largoheshin nga Mbretëria e Bashkuar.

Neni 41

Në lidhje me dëmet jomateriale, Gjykata u caktoi gjashtë kërkuesve algjerianë 3,400 Euro, 3,900 Euro, 3,800 Euro, 3,400 Euro, 2,500 Euro dhe 1,700 Euro, respektivisht; kërkuesve pa shtetësi dhe atyre me shtetësi tuniziane 3,900 Euro secili; dhe kërkuesit jordanëz 2,800 Euro. Të gjithë kërkuesve së bashku iu caktua shuma 60,000 Euro për shpenzime ligjore.

Gjykata deklaroi që këto shpërblime ishin thelbësisht më të ulëta sesa ato që ajo kishte caktuar në çështje të kaluara për ndalim të paligjshëm. Kjo ishte për shkak të faktit se skema e ndalimit ishte hartuar në kushtet e emergjencës publike, dhe si përpjekje për të përmbushur nevojën e mbrojtjes së publikut të Mbretërisë së Bashkuar kundër terrorizmit me detyrimin për të mos i kthyer kërkuesit në vendet ku ata përballeshin me rrezikun real të keqtrajtimit.

Megjithëse aktiviteti terrorist në Turqi ishte emergjencë publike e pranuar, mbajtja 14-ditëshe incommunicado e kërkuesit pa mundësi të pasjes së gjyqtarit nuk është kërkuar rreptësisht nga ajo emergjencë dhe kështu ka përbërë shkelje të Nenit 5

VENDIMI NË ÇËSHTJEN AKSOY K. TURQISË

(Kërkesa Nr. 21987/93)

18 dhjetor 1996

1. Faktet kryesore

Për rreth 11 vite para këtij VENDIMI, kishte pasur trazira serioze në Turqi mes forcave të sigurisë dhe PKK-së (Partia e Punëtorëve e Kurdistanit). Sipas Qeverisë, kjo kishte sjellë vdekjen e thujse 8000 njerëzve. Në kohën e VENDIMIT të Gjykatës, dhjetë prej njëmbëdhjetë provincave në Turqinë juglindore kishin qenë nën sundimin e kushteve të emergjencës qysh prej vitit 1987. Në gusht të vitit 1990, Qeveria shpalli derogimin nga Neni 15 i Konventës për shkak të aktivitetit terrorist, çka pesë muaj më vonë u modifikua për t'iu zbatuar vetëm Nenit 5.

Faktet u vunë në diskutim mes palëve. Kërkuesi pretendoi që, në nëntor të vitit 1992, ai ishte marrë në ndalim nga njëzet policë pasi ishte identifikuar si anëtar i PKK- së nga një i ndaluar tjetër. Megjithatë, Qeveria pretendoi se kërkuesi ishte ndaluar me trembëdhjetë të tjerë me dyshimin për dhënien e ndihmës terroristëve të PKK-së.

Kërkuesi pretendoi se ishte mbajtur me dy të tjerë në një qeli të vogël, me një krevat dhe dy shujta ushqimore në ditë. Ai pretendoi se ishte kërcënuar me torturë gjatë kohës që merrej në pyetje dhe më pas ishte lidhur me krahët lart në një formë torture të njohur si "varja palestineze", ku polici kishte lidhur elektroda tek gjenitalet e tij dhe kishte hedhur ujë mbi të. Tortura supozohej se kishte zgjatur katër ditë dhe si pasojë ai kishte humbur lëvizjen e krahëve dhe duarve. Atij i ishte refuzuar leja për t'u kontrolluar nga mjeku menjëherë, megjithëse ishte vizituar nga një mjek disa ditë më pas. Raporti i mjekut thoshte që kërkuesi nuk kishte shenja dhune, megjithëse kërkuesi pretendoi që mjeku e kishte pyetur se si i kishte lënduar krahët.

Qeveria parashtrroi që kishte dyshime lidhur me keqtrajtimin e kërkuesit në ndalim dhe që, pak para lirim të tij, ai ishte sjellë para prokurorit publik, kishte nënshkruar një deklaratë ku mohonte përfshirjen e tij në PKK, dhe nuk kishte

bërë ndonjë ankesë se ishte torturuar. Kërkuesi pretendoi që i ishte paraqitur një deklaratë e rreme, të cilën prokurori kishte këmbëngulur që ai ta firmoste, por ai nuk kishte mundur sepse duart i kishte pasur të palëvizshme.

Kërkuesi u lirua më 10 dhjetor 1992 dhe u shtrua në spital pesë ditë më pas, ku u diagnostikua me paralizë radiale bilaterale. Ai qëndroi aty deri më 31 dhjetor 1992, kur Qeveria pretendon se ai iku pa u lëshuar tamam nga spitali, duke marrë dosjen e tij mjekësore me vete.

Në ndërkohë, prokurori publik vendosi që nuk kishte baza për të nisur procedurë penale kundër kërkuesit. Në gjykatat vendase nuk u ngrit asnjë procedurë penale apo civile në lidhje me keqtrajtimin e supozuar të kërkuesit.

Kërkuesi u gjuajt dhe u vra më 16 prill 1994. Që atëherë, babai i tij shprehu dëshirën për ta ndjekur çështjen. U supozua që vdekja e tij ishte rezultat i drejtpërdrejtë i këmbënguljes së tij për kërkesën sipas Konventës, pavarësisht nga kërcënimi me vdekje për ta tërhequr atë. Megjithatë, Qeveria parashtrroi se vdekja e tij ishte larje hesapësh mes fraksioneve të PKK-së dhe se një kinëse anëtar i PKK-së ishte akuzuar për vrasjen.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi u ankua që ai i ishte nënshtruar keqtrajtimin në kundërshtim me Nenin 3 dhe që paraburgimi i tij shkelte të drejtën e tij për t'u sjellë menjëherë para gjyqtarit sipas Nenit 5. Ai gjithashtu u ankua që atij i ishte mohuar qasja në gjykatë dhe zgjidhja efektive, ku Gjykata i shqyrtoi të dyja sipas Nenit 13. Vdekja e kërkuesit u ankimua si ndërhyrje tek e drejta për kërkesë individuale sipas Nenit 25 (tani Neni 34). Çështja u shqyrtua para futjes së Protokollit 11 në vitin 1998, që do të thotë se Komisioni kreu një rol faktmbledhës dhe dha opinionin e vet para se Gjykata të shqyrtonte çështjen.

Neni 3

Komisioni kishte konkluduar që kërkuesi ishte torturuar. Gjykata, pasi kishte vendosur të pranonte gjetjet e faktit të Komisionit, konsideroi që, aty ku një individ ishte mirë me shëndet në kohën e ndalimit por më pas gjendej se ishte i/e lënduar në kohën e lirimit, ishte detyrë e Shtetit të paraqiste një shpjegim bindës për shkakun e lëndimit. Dështimi për ta bërë këtë ngriste çështje nga Neni 3.

Gjykata përsëriti që Neni 3 ngërthente një prej vlerave themelore të shoqërisë demokratike dhe, për këtë arsye, derogimi prej tij nuk ishte i lejueshëm sipas Nenit 15, qoftë edhe në rast emergjencash publike.

Përkufizimi i torturës u përsërit si "trajtim i qëllimshëm çnjerëzor që shkakton vuajtje shumë të rënda dhe mizore". Komisioni e kishte pranuar që kërkuesi i ishte nënshtruar "varjes palestineze", gjë që sipas pikëpamjes së Gjykatës mund të ishte shkaktuar me dashje sepse për ta kryer këtë duhej përgatitje dhe përpjekje. Për më tepër, provat mjekësore tregonin që ajo kishte çuar në paralizë të të dy krahëve që kishte zgjatur për një kohë të konsiderueshme. Ky trajtim ishte i një natyre kaq të rëndë dhe mizore sa që mund të përshkruhej vetëm si torturë. Prandaj kishte pasur shkelje të Nenit 3.

Neni 5

Gjykata së pari shqyrtoi derogimin tek Neni 5 të deklaruar nga Qeveria. Ajo përsëriti që Shtetet janë përgjegjëse për të përcaktuar nëse jeta e qytetarëve kërcënohet nga ndonjë "emergjencë publike" dhe, nëse po, deri ku është e nevojshme të shkohet në përpjekje për ta tejkaluar atë emergjencë. Prandaj, Shtetet kanë hapësirë të gjerë vlerësimi, nën mbikqyrjen e Gjykatës, për të vlerësuar nëse masat kanë shkuar përtej "shkallës rreptësisht të kërkuar nga urgjencat e situatës".

U pranua që ekzistonte një "emergjencë publike" e tillë duke marrë parasysh shkallën dhe impaktin e aktiviteteve terroriste të PKK-së në Turqinë juglindore, kështu që Gjykata vazhdoi më tej duke shqyrtuar nëse masat ishin rreptësisht të kërkuara nga urgjenca e situatës.

Kërkuesi ishte mbajtur për të paktën katërmëdhjetë ditë pa u sjellë para gjyqtarit, në përputhje me të drejtën turke, çka lejonte që një person i paraburgosur për një vepër kolektive të mbahej deri në tridhjetë ditë gjatë një emergjence publike. U pranua që hetimi i veprave terroriste paraqiste probleme të veçanta për autoritetet, por Gjykata nuk mund të pranonte që për këtë arsye ishte e nevojshme të mbahej kërkuesi për katërmëdhjetë ditë pa ndërhyrje gjyqësore. Kjo periudhë ishte tejet e gjatë dhe e linte kërkuesin të ekspozuar si ndaj ndërhyrjes arbitrare tek e drejta e tij për liri ashtu edhe ndaj torturës. Për më tepër, Qeveria nuk kishte nxjerrë ndonjë arsye të hollësishme se pse lufta kundër terrorizmit në Turqinë juglindore e bënte ndërhyrjen gjyqësore jopraktike. Kërkuesi kishte në dispozicion mbrojtje të pamjaftueshme. Në mënyrë të veçantë, mohimi i pasjes në dispozicion

të një avokati, mjeku, të afërmi ose miku dhe mungesa e çdo mundësie reale për t'u sjellë para një gjykate për të testuar ligjshmërinë e paraburgimit nënkuptonte që ai ishte në mëshirë të atyre që e mbanin.

Duke pasur parasysh se masa e kundërshtuar nuk ishte rreptësisht e kërkuar nga urgjenca e situatës, Gjykata e gjeti të panevojshme të vendoste nëse derogimi i përmbushte kriteret formale të Nenit 15. Prandaj kishte pasur shkelje të Nenit 5.

Neni 13

Prokurori publik vendosi të mos zhvillonte hetime lidhur me natyrën, masën dhe shkakun e lëndimeve të kërkuarit pavarësisht nga fakti që ato ishin qartazi të dukshme gjatë takimit të tyre, dhe sipas të drejtës turke ai kishte për detyrë të bënte hetime. Duke ditur këtë, ishte e kuptueshme nëse kërkuari krijoi besimin që ai nuk mund të gjente zgjidhje përmes kanaleve ligjore nacionale. Prandaj u konkludua që ekzistonin rrethana të veçanta të cilat e çlironin kërkuarin nga detyrimi i tij për të shteruar zgjidhjet në vend.

Në rastet e akuzave për torturë, "zgjidhja efektive" ndërthet, përveç pagesës së kompensimit aty ku shihet e udhës, një hetim të tërësishëm dhe efektiv që mund të çojë drejt identifikimit dhe dënimit të përgjegjësve.

Akuzat për tortura në paraburgim janë shumë të vështira të vërtetohen nëse kërkuari është izoluar nga bota e jashtme pa qasje në avokat, mjek, familjarë apo miq të cilët mund të ofrojnë mbështetje dhe të mbledhin prova. Për më tepër, në rastin konkret duke marrë parasysh lëndimet e kërkuarit, kapaciteti i tij për të nisur ankesë me gjasë do të ishte i dobësuar.

Prokurori i injoroi provat e dukshme para tij, dhe nuk u paraqit asnjë provë që tregonte se ishte ndërmarrë ndonjë veprim tjetër. Gjykata i pa këto veprime të atilla që dëmtonin efektivitetin e çdo zgjidhjeje tjetër që mund të kishte ekzistuar, dhe prandaj gjeti që kërkuarit i ishte mohuar zgjidhja efektive në lidhje me akuzat e tij për torturë. Prandaj, kishte pasur shkelje të Nenit 13.

Neni 25 (tani Neni 34)

U përsërit rëndësia e komunikimit të lirë me institucionet e Strasburgut, pa presion nga autoritetet. Megjithatë, nuk kishte prova për të vërtetuar që vdekja e kërkuarit ishte e lidhur me kërkesën e tij, ose që autoritetet e Shtetit kishin

qenë përgjegjëse për çfarëdo ndërhyrjeje në formën e kërcënimit apo frikësimit. Prandaj, Gjykata nuk mundi të gjente që kishte pasur shkelje të Nenit 25.

Neni 50 (tani Neni 41)

Gjykata vendosi që Turqia do t'i paguante babait të kërkuesit shumën 4,283,450,000 Lira Turke si kompensim për dëmet materiale dhe jomateriale, dhe 20,710 Paund në lidhje me kosto dhe shpenzime.

Derogimi i Qeverisë në lidhje me aktivitetin terrorist në Irlandën Veriore ka përmbushur kriteret e Nenit 15 meqenëse kishte fushëveprim të kufizuar, kundër abuzimit të tij kishte mbrojtje themelore, dhe ishte rreptësisht i kërkuar nga urgjenca e situatës

VENDIMI NË ÇËSHTJEN BRANNIGAN DHE MCBRIDE k. MBRETËRISË SË BASHKUAR

(Kërkesa Nr. 14553/89; Nr. 14554/89)

25 maj 1993

1. Faktet kryesore

Më 22 dhjetor 1988, Sekretari i Shtetit deklaroi emergjencë publike për shkak të aktivitetit terrorist në Irlandën Veriore, duke thënë se nevojitej që policia të kishte mundësinë për të paraburgosur të dyshuarit terroristë pa akuza ose gjyq deri në shtatë ditë.

Dy kërkuesit u arrestuan secili në shtëpinë e vet, respektivisht më 9 janar dhe 5 janar 1989 në përputhje me Seksionin 12 të Aktit për Parandalimin e Terrorizmit (Dispozitat e Përkohshme) të vitit 1984 ('Akti'), i cili lejonte arrestimin pa urdhërarrest kur kishte baza për përfshirje të dyshuar në terrorizëm. Kërkuesi i parë u paraburgos për gjashtë ditë, katërmëdhjetë orë e tridhjetë minuta dhe kërkuesi i dytë për katër ditë, gjashtë orë e njëzet e pesë minuta. Gjatë tërë kësaj kohe, të dy kërkuesve iu mohua qasje në të gjitha materialet e shkruara, radio dhe televizion, dhe u ndaluan nga shoqërimi me të burgosurit e tjerë. Të dy iu nënshtruan marrjeve të shumta në pyetje, respektivisht dyzet e tri herë dhe njëzet e dy herë, dhe vizitave nga ushtrues të profesionit mjekësor, respektivisht shtatëmbëdhjetë herë dhe tetë herë. Të parit iu mohua pasja në dispozicion e një juristi (solicitor) gjatë dyzet e tetë orëve të para të paraburgimit të tij.

Kërkuesi i dytë u vra më 4 shkurt 1992 nga një polic që kishte sulmuar Shtabin Qendror të Sinn Fein në Belfast.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesit u ankuan që paraburgimi i tyre kishte shkelur të drejtën e tyre për t'u sjellë menjëherë para një gjyqtari, sipas Nenit 5 § 3 dhe § 5. Më tej, ata u ankuan që nuk kishin pasur zgjidhje efektive siç kërkohet nga Neni 13, dhe që derogimi i Mbretërisë së Bashkuar nga Neni 15 ishte i pavlefshëm.

Neni 5

Gjykata përsëriti që Shtetet janë përgjegjëse për të përcaktuar nëse jeta e qytetarëve është e kërcënuar nga "emergjencat publike", dhe, nëse po, deri ku është e nevojshme të shkohet në përpjekje për ta tejkaluar atë emergjencë. Prandaj, Shtetet kanë hapësirë të gjerë vlerësimi, të mbikqyrur nga Gjykata, për të vlerësuar nëse masat kanë shkuar përtej "shkallës rreptësisht të kërkuar nga urgjenca e situatës". U konsiderua që, duke marrë parasysh shkallën dhe impaktin e dhunës terroriste në Irlandën Veriore, nuk kishte dyshim që në kohën relevante ekzistonte një emergjencë publike.

U vu re që pushteti për të arrestuar dhe për të vazhduar paraburgimin ishte konsideruar i nevojshëm nga Qeveria qysh në vitin 1974 në trajtimin e kërcënimeve terroriste. Pas një rasti të ngjashëm⁵²⁵, ku Qeveria ishte gjetur se kishte shkelur detyrimet nga Neni 5, Gjykata shënoi se Qeveria ose mund të fuste kontroll gjyqësor të paraburgimit sipas Aktit ose mund të bënte derogim në këtë aspekt. Qeveria e shihte të parin si të përcaktueshëm për shkak të vështirësive të lidhura me hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve terroriste, çka e bënte derogimin të paevitueshëm. Prandaj, ishte e qartë se derogimi ishte reagim i vërtetë ndaj vazhdimësisë së situatës së emergjencës.

U përsëriti që nuk ishte roli i Gjykatës të zëvendësonte pikëpamjen e vet se çfarë masash ishin më të përshtatshme në kohën relevante me pikëpamjen e Qeverisë. Meqenëse gjyqësori në Irlandën Veriore ishte i vogël dhe i dobët ndaj sulmeve terroriste, pavarësia e tij shihej si e rëndësishme së veçantë nga Qeveria. Raportet mbi legjislacionin për Parandalimin e Terrorizmit shënonin se vështirësitë në hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve terroriste parashtronin nevojën e një periudhe të zgjatur paraburgimi e cila nuk do t'i nënshtrohej kontrollit gjyqësor. Qeveria diskutoi që ishte thelbësore të parandalohej dhënia të paraburgosurit dhe përfaqësuesit të tij ligjor e informacionit mbi bazën e të cilit merreshin vendimet për paraburgim të zgjatur. Pavarësia e gjyqësorit po ashtu do të komprometohej nëse gjyqtarët do të përfshiheshin në dhënien e zgjatjes. Gjithashtu u shënuar që Neni 5 kërkon që procedura të ketë karakter gjyqësor, edhe pse nuk është e thënë që procesi të jetë identik në çdo rast ku kërkohet ndërhyrje gjyqësore.

Kërkuesit u ankuan që paraburgimi i tyre kishte shkelur të drejtën e tyre për t'u sjellë menjëherë para një gjyqtari, sipas Nenit 5 § 3 dhe § 5. Më tej, ata u ankuan që nuk kishin pasur zgjidhje efektive siç kërkohet nga Neni 13, dhe që derogimi i Mbretërisë së Bashkuar nga Neni 15 ishte i pavlefshëm.

Neni 5

Gjykata përsëriti që Shtetet janë përgjegjëse për të përcaktuar nëse jeta e qytetarëve është e kërcënuar nga "emergjencat publike", dhe, nëse po, deri ku është e nevojshme të shkohet në përpjekje për ta tejkaluar atë emergjencë. Prandaj, Shtetet kanë hapësirë të gjerë vlerësimi, të mbikqyrur nga Gjykata, për të vlerësuar nëse masat kanë shkuar përtej "shkallës rreptësisht të kërkuar nga urgjenca e situatës". U konsiderua që, duke marrë parasysh shkallën dhe impaktin e dhunës terroriste në Irlandën Veriore, nuk kishte dyshim që në kohën relevante ekzistonte një emergjencë publike.

U vu re që pushteti për të arrestuar dhe për të vazhduar paraburgimin ishte konsideruar i nevojshëm nga Qeveria qysh në vitin 1974 në trajtimin e kërcënimeve terroriste. Pas një rasti të ngjashëm^[752], ku Qeveria ishte gjetur se kishte shkelur detyrimet nga Neni 5, Gjykata shënoi se Qeveria ose mund të fuste kontroll gjyqësor të paraburgimit sipas Aktit ose mund të bënte derogim në këtë aspekt. Qeveria e shihte të parin si të porealizueshëm për shkak të vështirësive të lidhura me hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve terroriste, çka e bënte derogimin të paevitueshëm. Prandaj, ishte e qartë se derogimi ishte reagim i vërtetë ndaj vazhdimësisë së situatës së emergjencës.

U përsërit që nuk ishte roli i Gjykatës të zëvendësonte pikëpamjen e vet se çfarë masash ishin më të përshtatshme në kohën relevante me pikëpamjen e Qeverisë. Meqenëse gjyqësori në Irlandën Veriore ishte i vogël dhe i dobët ndaj sulmeve terroriste, pavarësia e tij shihej si e rëndësishme së veçantë nga Qeveria. Raportet mbi legjislacionin për Parandalimin e Terrorizmit shënonin se vështirësitë në hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve terroriste parashtronin nevojën e një periudhe të zgjatur paraburgimi e cila nuk do t'i nënshtrohej kontrollit gjyqësor. Qeveria diskutoi që ishte thelbësore të parandalohej dhënia të paraburgosurit dhe përfaqësuesit të tij ligjor e informacionit mbi bazën e të cilit merreshin vendimet për paraburgim të zgjatur. Pavarësia e gjyqësorit po ashtu do të komprometohej nëse gjyqtarët do të përfshiheshin në dhënien e zgjatjes. Gjithashtu u shënuar që Neni 5 kërkon që procedura të ketë karakter gjyqësor, edhe pse nuk është e thënë që procesi të jetë identik në çdo rast ku kërkohet ndërhyrje gjyqësore.

[752] Brogan dhe të tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar, vendimi i 19 nëntorit 1988, kërk. nr. 11209/84; nr. 11234/84; nr. 11266/84; nr. 11386/85.

Gjykata deklaroi që kishte mbrojtje të mjaftueshme kundër abuzimit të fuqisë së paraburgimit. Së pari, zgjidhja e habeas corpus ishte në dispozicion për të testuar ligjshmërinë e arrestimit dhe paraburgimit fillestar. Nuk kishte diskutim që kjo zgjidhje ishte e hapur për kërkuesit sikur ata të kishin vendosur ta shfrytëzonin. Së dyti, të paraburgosurit kishin të drejtën absolute dhe ligjërisht të zbatueshme për t'u konsultuar me një jurist (solicitor) pas dyzet e tetë orësh prej kohës së arrestimit. Vendimi për të vonuar qasjen i nënshtrohej shqyrtimit gjyqësor dhe barrën e përcaktimit të bazës së arsyeshme për ta bërë këtë e kishin autoritetet. Po ashtu nuk diskutohej që të paraburgosurit kishin të drejtë të informonin një të afërm apo mik në lidhje me paraburgosjen e tyre dhe të kishin një mjek aty. Për më tepër, u shënuar që operimi i Aktit ishte mbajtur rregullisht nën shqyrtim të pavarur dhe, që prej vitit 1989, i nënshtrohej përtëritjeve të rregullta.

Gjykata arriti në përfundimin që Qeveria nuk kishte dalë jashtë hapësirës së saj vlerësuese kur kishte vendosur që derogimi kërkohej rreptësisht nga urgjenca e situatës.

Nota deroguese e Qeverisë drejtuar Këshillit të Evropës sipas Nenit 15 më 23 dhjetor 1988 pas gjendjes së emergjencës konsiderohej e karakterit formal, bënte publike qëllimet e saj dhe ishte në përputhje me konceptin e një shpalljeje zyrtare. Prandaj, u konsiderua që nuk kishte bazë për argumentin e kërkuesve që derogimi nuk ishte "shpallur zyrtarisht" brenda kuptimit të Nenit 4 të Konventës Ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Civile dhe Politike të vitit 1966.

Në përfundim, u vendos që derogimi i Mbretërisë së Bashkuar përmbushte kriteret e Nenit 15 dhe që prandaj kërkuesit nuk mund të ankoreshin në mënyrë valide që të drejtat e tyre ishin shkelur sipas Nenit 5.

Neni 13

U përsërit që kërkuesit mund të kishin kontestuar ligjshmërinë e paraburgimit të tyre me anë të habeas corpus, çka ishte konstatuar më parë se përmbushte kriteret e Nenit 5 § 4. Meqenëse kriteret e Nenit 13 ishin më pak strikte sesa Neni 5 § 4, u vendos që nuk kishte pasur shkelje të kësaj dispozite.

Ankesa lidhur me reduktimin e rrogave dhe pensioneve të shërbyesve publikë si pasojë e krizës financiare të Greqisë u deklarua e papranueshme meqenëse ishte në interesin publik dhe nuk shkaktonte vështirësi mbijetese në shpërputhje me Nenin 1 të Protokollit Nr. 1

VENDIMI NË ÇËSHTJEN KOUFAKI DHE ADEDY K. GREQISË

(Kërkesat Nr. 57665/12 dhe Nr. 57657/12)

7 maj 2013

1. Faktet kryesore

Si pasojë e krizës financiare të Greqisë në vitin 2010, Qeveria futi në zbatim masa shtrënguese të cilat përfshinin reduktimin e pagesave, benefiteve, shtesave dhe pensioneve të shërbyesve publikë me qëllim të uljes së shpenzimeve publike.

Kërkuesja e parë punonte për Zyrën e Ombudspersonit të Greqisë dhe e dyta, Konfederata Sindikale e Shërbimeve Publike, ishte organizatë sindikale që përfaqësonte shumë punonjës të sektorit publik.

Në korrik të vitit 2010, të dy kërkueset i dërguan çështjet e tyre në Gjykatën Administrative Supreme duke kërkuar shqyrtim gjyqësor: e para në lidhje me një reduktim në deklaratën e pagesës së saj, dhe e dyta për shkak të efekteve të masave shtrënguese tek anëtarët e saj. Më 20 shkurt 2012, Gjykata Administrative Supreme i refuzoi kërkesat e tyre.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkueset u ankuan që shkurtime të rroga dhe pensione përbënin privim të pasurisë së tyre siç mbrohet nga Neni 1 i Protokollit Nr. 1.

Neni 1 i Protokollit Nr.1

Gjykata konsideroi që kufizimet e vendosura nuk duhet të konsiderohen si "privim i pasurisë", siç pretendonin kërkueset, por si ndërhyrje tek e drejta e gëzimit paqësor të pasurisë, të parashikuar sipas të drejtës vendase.

U përsërit që Shtetet gëzojnë hapësirë mjaft të gjerë vlerësuese në rregullimin e politikave të tyre sociale. Kriteret e Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 janë që çdo

ndërhyrje nga autoritetet publike tek e drejta e gëzimit paqësor të pasurisë duhet të jetë: e ligjshme, të synojë një qëllim legjitim “në interes publik” dhe të jetë në masë të arsyeshme proporcionale me qëllimin e synuar.

Interesi publik kishte përkufizim të gjerë dhe Gjykata përsëriti që ajo do të respektonte VENDIMIN e Qeverisë se çfarë e përbënte atë interes, përveç rastit kur ishte dukshëm pa baza të arsyeshme. Qeveria i kishte justifikuar masat e kundërshtuara me krizën nacionale të pa precedent, dhe masat ishin pjesë e një programi më të gjerë shtrëgimesh që synonin të përmirësonin gjendjen ekonomike të Greqisë. Ky qëllim pra ishte në interes të përgjithshëm nacional dhe koïncidonte me interesat e anëtarëve të eurozonës, të cilët ishin të detyruar të respektonin disiplinën buxhetore. Prandaj, Gjykata nuk kishte arsye të dyshonte se masat ishin në interes publik.

Kishte dy ligje të njëpasnjëshme që kishin të bënin me të gjithë shërbyesit civilë pa dallim, të cilët parashikonin 20% reduktim të rrogave dhe pensioneve si dhe reduktime në shtesa dhe benefite. Masat e marra nga ligji i dytë u konsideruan të nevojshme nga Qeveria sepse ato që ishin marrë sipas ligjit të parë ishin vërtetuar të pamjaftueshme për të zgjidhur problemet ekonomike të vendit.

Gjykata u dha peshë të veçantë arsyeve të dhëna nga Gjykata Administrative Supreme e cila, në VENDIMIN e saj të 20 shkurtit 2012, hodhi poshtë një sërë argumentesh që sugjeronin se masat kishin shkelur parimin e proporcionalitetit. Në mënyrë të veçantë, ajo deklaroi se fakti që shkurtime të rroga dhe pensione nuk ishin thjesht të përkohshme ishte i justifikuar meqenëse qëllimi i Qeverisë ishte që jo vetëm të zgjidhte krizën buxhetore të momentit por edhe të konsolidonte financat e Shtetit në afat të gjatë. Më tej ajo vërejti se kërkueset para saj nuk kishin pretenduar specifikisht që situata e tyre ishte përkeqësuar deri në atë masë ku ata rrezikonin të binin nën kufirin e mbijetesës.

Sa i përket kërkueses së parë, Gjykata konsideroi që reduktimi i rrogës së saj mujore, nga 2,435.83 Euro në 1,885.79 Euro, nuk rrezikonte ta ekspozonte atë ndaj vështirësive të mbijetesës të papërputhshme me Nenin 1 të Protokollit Nr. 1. Duke pasur parasysh klimën e skajshme ekonomike, ndërhyrja nuk mund të thuhet se kishte vënë peshë të stërmadhe mbi supet e saj.

Sa i përket kërkueses së dytë, heqja e një pjese të pagesave pensionale u kompensua, në rastin e personave që merrnin më pak se 2,500 Euro në muaj, me futjen e një shtese prej 800 Euro në vit. Më tej, u fut një shtesë vjetore prej

1000 Euro, e financuar nga reduktimi i ndihmave financiare që u paguheshin atyre që fitonin më shumë, me qëllim që të mbroheshin kategoritë me të ardhura më të ulëta. Sa u përket zgjidhjeve alternative, nuk u konsiderua që ekzistenca e tyre e mundshme e bënte legjislacionin e kontestuar të pajustificuar. Përderisa autoritetet vendase nuk shkelnin kufijtë e hapësirës së tyre vlerësuese, Gjykata përsëriti që nuk i takonte asaj të deklaronte nëse Qeveria kishte zgjedhur mënyrat më të mira për t'iu qasur problemit, apo nëse ajo do të mund ta kishte përdorur pushtetin e vet ndryshe.

Prandaj, Gjykata i deklaroi kërkesat të papranueshme.

Kërcënimi i aktiviteteve terroriste ka përbërë emergjencë publike që kërcënonte jetën e kombit ku legjislacioni i zakonshëm ishte i pamjaftueshëm për ta luftuar, duke justifikuar kështu derogimin nga Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut sipas Nenit 15

VENDIMI NË ÇËSHTJEN LAWLESS k. IRLANDËS (Nr. 3)

(Kërkesa Nr. 332/57)

1 korrik 1961

1. Faktet kryesore

Në vitin 1939, Ushtria Republikane Irlandeze (ang. IRA) nisi 'Fushatën e Sabotazhit' të saj. Në përgjigje ndaj kësaj, Qeveria Irlandeze siguroi paraburgimin pa akuza ose gjyq sipas Aktit ('Akti') të Veprave Kundër Shtetit (Amendament) të vitit 1940. Gjatë viteve 1956 dhe 1957 pati një shpërthim të ri të dhunës nga IRA, çka e bëri Qeverinë të shpallte gjendjen e jashtëzakonshme më 5 korrik 1957, duke futur në funksion fuqitë paraburgosëse të Aktit.

Kërkuesi ishte shtetas irlandez dhe u arrestua më 11 korrik 1957 si anëtar i IRA-s, e cila ishte organizatë e paligjshme. Ai u paraburgos pa akuza ose gjyq por iu ofrua lirimi në këmbim të zotimit për të respektuar ligjin dhe për t'u përmbajtur nga aktivitete në kundërshtim me Aktin, gjë që ai e refuzoi. Eventualisht ai u lirua pesë muaj më vonë pasi dha një zotim të ngjashëm verbalisht.

Ndërkohë, Gjykata e Lartë Irlandeze e refuzoi kërkesën e tij për shkresë të habeas corpus, e cila u afirmua nga Gjykata Supreme e Irlandës më 6 nëntor 1957.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi u ankua që, me arrestimin e tij pa akuza ose gjyq, Qeveria kishte shkelur të drejtat e tij për liri dhe gjyq të drejtë sipas Neneve 5 dhe 6. Meqenëse Gjykata njohu faktin që paraburgimi i kërkuesit shkelte të drejtat e tij nga Neni 5, ajo u përpoq të shqyrtonte nëse paraburgimi ishte i justifikuar sipas Nenit 15.

Neni 15

Gjykata u shpreh se 'emergjencës publike që kërcënonte jetën e kombit' duhet t'i jepej kuptimi i zakonshëm: "situatë e jashtëzakonshme krize ose emergjencë

që ndikon tek e gjithë popullata dhe përbën kërcënim ndaj jetës së organizuar të komunitetit nga i cili përbëhet Shteti".

Ajo konkludoi që përkufizimi përmbushej sepse IRA ishte organizatë e gjallë, sekrete dhe jokushtetuese e cila përdorte dhunën për të arritur qëllimet e veta, duke operuar jashta Shtetit duke rrezikuar kështu marrëdhëniet e tij me fqinjët. Aktiviteti i saj terrorist po ashtu ishte shtuar në mënyrë të vazhdueshme dhe me ritme alarmante mes viteve 1956 dhe 1957. Megjithëse Qeveria më herët ia kishte dalë me sukses që të përdorte legjisllacionin e zakonshëm për të ruajtur paqen, u theksua se incidentet terroriste të 3 – 4 korrikut 1957 i kishin shtuar rreziqet e afërta.

Më tej u konkludua që paraburgimi pa gjyq kërkohet rreptësisht nga urgjenca e situatës për shkak të karakterit ushtarak, sekret dhe terrorist të IRA-s; faktit që e drejta e zakonshme dhe gjykatat speciale ushtarake ishin vërtetuar të pamjaftueshme për të rikthyer paqen dhe rendin; dhe vështirësisë së mbledhjes së provave të nevojshme për të dënuar anëtarët e saj, posaçërisht për shkak se ajo operonte kryesisht në Irlandën Veriore. Akti gjithashtu i nënshtrohej mbrojtjeve për të parandaluar abuzimin me të. Këto përfshinin mbikqyrjen e vazhdueshme nga Parlamenti, një Komision Paraburgimi i cili mernte në shqyrtim kërkesat për lirim nga të paraburgosurit sipas Aktit, dhe ofrimin e një zotimi për t'iu përmbajtur ligjit në përgjithësi, dhe Aktit në veçanti, në këmbim të lirit.

Gjykata shënoi që asaj nuk i ishte bërë i ditur asnjë fakt që sugjeronte se derogimi ishte në shpërputhje me detyrimet e tjera sipas të drejtës ndërkombëtare.

Për më tepër, ajo deklaroi që kriteret e lajmërimit sipas Nenit 15 zakonisht duhet të marrin përgjigje pa vonesë përmes një letre me shkrim drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, me kopje të bashkangjitura të teksteve ligjore sipas të cilave janë marrë masat ligjore, përfshirë një shpjegim rreth qëllimit të tyre. U konfirmua që veprimet e Qeverisë ishin të mjaftueshme: një letër e dërguar më 20 korrik 1957, me kopje të bashkangjitura të Aktit, Shpalljes së 5 korrikut dhe një shpjegim që masat ishin marrë për të mbrojtur paqen dhe rendin publik. Periudha e lajmërimit prej dymbëdhjetë ditësh pas hyrjes në fuqi të masave deroguese u konsiderua mjaftueshëm e shpejtë. U theksua që nuk kishte ndonjë specifikim sipas Nenit 15 që Shteti duhet ta ndante me publikun notën e derogimit drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm.

Paraburgimi i paligjshëm paragjyqësor i një gazetari nuk ka qenë rreptësisht i kërkuar nga gjendja e emergjencës publike e vendosur pas grushtshtetit ushtarak, dhe ka shkelur Nenit 5, 6 dhe 10, ku Gjykata ka urdhëruar lirimin e kërkuarit sipas Nenit 46

VENDIMI NË ÇËSHTJEN ŞAHIN ALPAY K. TURQISË

(Kërkesa Nr. 16538/17)

20 mars 2018

1. Faktet kryesore

Më 20 korrik 2016, Qeveria shpalli gjendjen e jashtëzakonshme pas një grushtshteti ushtarak, që shkaktoi mbi 300 vdekje. Ajo fajësoi një qytetar turk me banim në Shtetet e Bashkuara, që konsiderohej të ishte udhëheqësi i FETÖ/PDY ("Organizata e Terrorit Gylenist/Struktura Shtetërore Paralele"), se kishte udhëhequr përpjekjen për grushtshteti, dhe të nesërmen i dërgoi Këshillit të Evropës një notë derogimi sipas Nenit 15 të Konventës.

Kërkuari ishte shtetas turk dhe gazetar që punonte për një gazetë ditore, Zaman, e cila ishte mbyllur pas Dekretit Legjislativ Nr. 688 lëshuar më 27 korrik 2016 në lidhje me gjendjen e jashtëzakonshme të shpallur. Ai gjithashtu jepte ligjërata mbi historinë politike turke dhe politikë krahasuese në Universitetin e Stambollit. Për disa vite deri në kohën e grushtshtetit në tentativë, kërkuari ishte bërë i njohur për pikëpamjet e tij kritike ndaj politikave të qeverisë aktuale.

Më 27 korrik 2016, ai u arrestua në shtëpinë e tij dhe u dërgua në paraburgim policor me dyshimin se ishte anëtar i organizatës terroriste FETÖ/PDY. Ai u vu në paraburgim paragjyqësor me arsyetimin se artikujt e tij kishin promovuar FETÖ/PDY dhe kërkesa e tij për lirim u refuzua. Në shtator 2016, ai bëri një kërkesë individuale drejtuar Gjykatës Kushtetuese.

Në prill të vitit 2017 prokurori publik në Stamboll ngriti aktakuzë kundër disa individëve që dyshohej se ishin pjesë e krahut mediatik të FETÖ/PDY, përfshirë kërkuarin, në mënyrë të veçantë duke i akuzuar, sipas Kodit Penal të Turqisë, se ishin përpjekur të përmbysnin rendin kushtetues, Asamblenë e Madhe Nacionale Turke dhe qeverinë me forcë e dhunë, dhe për kryerjen e veprave në emër të një organizate terroriste pa qenë anëtarë të saj.

Më 11 janar 2018, Gjykata Kushtetuese deklaroi që kishte pasur shkelje të së drejtës për liri e siguri dhe të drejtës për lirinë e shrehjes dhe të shtypit. Megjithatë, Gjykata e Assizes në Stamboll e refuzoi kërkesën e kërkuetit për lirim.

Në kohën e këtij VENDIMI, kërkueti ishte ende në paraburgim në pritje të procedurave penale kundër tij.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkueti u ankua, sipas Neneve 5 § 1 dhe 5 § 3, që paraburgimi i tij paragjyqësor fillestar dhe vazhdimi i tij i mëtejshëm ishin arbitrare meqenëse nuk kishte prova mbi të cilat të bazohej dyshimi që ai kishte kryer vepër penale. Më tej ai u ankua që Gjykata Kushtetuese kishte dështuar të respektonte kriterin e "shpejtueshmërisë" dhe që ai nuk kishte pasur qasje në zgjidhje efektive, sipas Neneve 5 § 4 dhe 5 § 5 respektivisht. Ai gjithashtu u ankua, sipas Neneve 10 dhe 8 respektivisht, për shkelje të së drejtës së tij për lirinë e shprehjes, dhe pretendoi se ishte paraburgosur për faktin se kishte shprehur opinione kritikuese rreth autoriteteve qeveritare.

Neni 5 § 1

Gjykata përsëriti që të drejtat e garantuara nga Neni 5 janë të rëndësishme parësore në një shoqëri demokratike, dhe që një person mund të paraburgoset sipas Nenit 5 § 1 (c) vetëm në kushtet e procedurave penale me qëllim të sjelljes së tij para një autoriteti ligjor kompetent për dyshimin "e bazuar" të kryerjes së një veprë. Ky prag presupozon ekzistencën e informacionit që do të bindte një vëzhgues të pavarur që personi në fjalë mund ta ketë kryer veprën, sadoqë kjo do të varej nga rrethanat e çështjes. U përsërit që Gjykata zakonisht nuk e zëvendëson vlerësimin e vet me atë të gjykatave vendase.

Në VENDIMIN e saj të 11 janarit 2018, Gjykata Kushtetuese konstatoi që kërkueti ishte vënë dhe mbajtur në paraburgim paragjyqësor në shkelje të Nenit 19 § 3 të Kushtetutës, duke u shprehur se autoritetet nuk kishin arritur të demonstironin ndonjë bazë faktike që mund të tregonte se ai kishte qenë duke vepruar në përputhje me qëllimet e FETÖ/PDY. Mbi bazën e provave të paraqitura nga prokuroria, Gjykata Kushtetuese deklaroi që nuk kishte tregues të qartë se kërkueti i kishte kryer veprat për të cilat akuzohej. Sa i përket zbatimit të Nenit 15 të Kushtetutës së Turqisë (i cili parashikonte pezullimin e ushtrimit të të drejtave dhe lirive themelore në rast gjendjeje të jashtëzakonshme), ajo konkludoi që e drejta për liri dhe siguri do të ishte e pakuptimtë nëse do të pranohej se njerëzit

do të mund të futeshin në paraburgim paragjyqësor pa prova të forta që kanë kryer ndonjë vepër penale. Prandaj, sipas pikëpamjes së Gjykatës Kushtetuese, privimi i kërkuesit nga liria ishte joproportional me urgjencat e rrepta të situatës. Gjykata e mbështeti këtë gjetje, duke kufizuar analizën e saj brenda përcaktimit nëse autoritetet nacionale kishin ofruar zgjidhje të mjaftueshme për shkeljen.

Megjithëse Gjykata Kushtetuese kishte gjetur shkelje të Kushtetutës, Gjykata e 13- të dhe ajo e 14-të e Assizes në Stamboll refuzuan ta lironin kërkuesin, duke gjetur që VENDIMI nuk ishte në përputhje me ligjin dhe përbënte uzurpim të pushtetit. Gjykata nuk e pranoi argumentin e Gjykatës së 13-të të Assizes që Gjykata Kushtetuese nuk kishte juridiksion për të vlerësuar provat në dosjen e lëndës. Të vepruarit ndryshe do të shpinte drejt nënkuptimit që Gjykata Kushtetuese do të mund ta kishte shqyrtuar ankesën e kërkuesit pa konsideruar thelbin e provave të nxjerra kundër tij. Për më tepër, duke marrë parasysh natyrën detyruese të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese në përputhje me Kushtetutën, Gjykata gjeti që nuk kishte shkak për të dyshuar që gjykimet ku Gjykata Kushtetuese kishte gjetur shkelje do të zbatoheshin efektivisht.

Gjykata më tej vërejtë që, para VENDIMIT të Gjykatës Kushtetuese, Qeveria shprehimisht e kishte nxitur Gjykatën që ta refuzonte kërkesën e kërkuesit për dështimin e shterimit të zgjidhjeve në vend për shkak se kërkesa e tij individuale drejtuar Gjykatës Kushtetuese ishte ende në pritje. Kjo u përforcua nga pikëpamja e Qeverisë që kërkesa individuale në Gjykatën Kushtetuese ishte zgjidhje efektive për qëllimet e Nenit 5 të Konventës. Gjykata konsideroi që kjo mund të interpretohet vetëm si e tillë që nënkupton se, sipas të drejtës turke, nëse Gjykata Kushtetuese do të kishte vendosur që paraburgimi paragjyqësor i kërkuesit shkelte Kushtetutën, përgjigjja nga gjykatat e duhura për të vendosur rreth paraburgimit paragjyqësor domosdoshmërisht do të ngërthente lirimimin e tij, nëse nuk dilnin baza dhe prova të reja që justifikonin vazhdimin e paraburgimit të tij. Prandaj, hedhja poshtë e kërkesës nga Gjykata e 13-të e Assizes distancohej prej qasjes së shfaqur nga Qeveria para Gjykatës.

Gjykata vërejtë që arsyet e dhëna nga Gjykata e 13-të e Assizes në refuzimin e kërkesës për lirimimin e kërkuesit, pas një VENDIMI "përfundimtar" dhe "detyrues" të shpallur nga autoriteti suprem kushtetues gjyqësor, nuk mund të konsiderohej se përmbushte kriteret e Nenit 5 § 1 të Konventës. Një gjykatë që vë në pikëpyetje fuqitë që i mvishen një gjykate kushtetuese për të marrë vendime përfundimtare dhe detyruese mbi kërkesa individuale është në kundërshtim me parimet e saj themelore të shtetit të së drejtës dhe sigurisë ligjore. Gjykata përsëriti që këto

parime janë gurthemet e garancive kundër arbitraritetit. Më tej ajo vërejtë që dosja e lëndës nuk paraqiti baza ose prova të reja që tregonin se baza për paraburgim kishte ndryshuar pas VENDIMIT të Gjykatës Kushtetuese. Rrjedhimisht, vazhdimi i paraburgimit paragjyqësor të kërkuesit nuk mund të shihej si "i ligjshëm" dhe "në përputhje me procedurën e parashikuar në ligj" siç kërkohet nga Konventa.

Më tej, Gjykata mori në shqyrtim derogimin, dhe pranoi që nota e dërguar përmbushte kriteret formale të Nenit 15 të Konventës. Ajo vërejtë që Gjykata Kushtetuese, pasi kishte shqyrtuar nga këndvështrimi kushtetues faktet që kishin shpënë drejt shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme, konkludoi që grushtshteti ushtarak në tentativë paraqiste kërcënim serioz ndaj jetës dhe ekzistencës së kombit. Duke pasur parasysh gjetjet e Gjykatës Kushtetuese dhe të gjitha materialet e tjera në dispozicion, Gjykata po ashtu konsideroi që grushtshteti ushtarak në tentativë kishte paraqitur ekzistencën e një "emergjence publike" brenda kuptimit të Konventës.

Sa i përket faktit nëse masat e marra në çështjen në fjalë kishin qenë rreptësisht të kërkuara nga urgjenca e situatës, Gjykata konsideroi, duke marrë parasysh Nenin 15 dhe derogimin, që, ashtu siç kishte gjetur Gjykata Kushtetuese, një masë për paraburgim paragjyqësor që nuk ishte "e ligjshme" dhe që nuk ishte zbatuar "në përputhje me procedurën e parashikuar në ligj" për shkak të mungesës së dyshimit të arsyeshëm nuk mund të thuhet se kishte qenë rreptësisht e kërkuar nga situata.

Prandaj, Gjykata deklaroi që kishte shkelje të Nenit 5 § 1. Më tej ajo theksoi që vazhdimi i paraburgimit paragjyqësor të kërkuesit, edhe pas VENDIMIT të Gjykatës Kushtetuese, si pasojë e vendimeve të marra nga Gjykata e 13-të e Assizes, ngrinte dyshime serioze rreth efektivitetit të zgjidhjes së një kërkesë individuale pranë Gjykatës Kushtetuese në rastet që kishin të bënin me paraburgimin paragjyqësor. Megjithatë, ashtu si qëndronin punët, Gjykata nuk u distanca nga gjetja e saj e mëhershme që e drejta për të bërë kërkesë individuale në Gjykatë Kushtetuese përbënte zgjidhje efektive për ankesat nga persona të privuar nga liria e tyre sipas Nenit 19 të Kushtetutës. Pavarësisht nga kjo, ajo rezervonte të drejtën për të shqyrtuar efektivitetin e sistemit të kërkesave individuale drejtuar Gjykatës Kushtetuese në lidhje me kërkesat sipas Nenit 5 të Konventës, sidomos duke pasur parasysh çdo zhvillim të mëtejshëm në praktikën gjyqësore të gjykatave të shkallës së parë, posaçërisht gjykatat e assizes, në lidhje me autoritetin e gjykimeve të Gjykatës Kushtetuese. Në lidhje me atë pikë, do t'i takonte Qeverisë të vërtetonte që kjo zgjidhje ishte efektive, si në teori ashtu edhe në praktikë.

Duke pasur parasysh ato që u përmendën më lart, Gjykata e quajti të panevojshme ta shqyrtonte këtë ankesë sipas Nenit 5 § 3.

Neni 5 § 4

U përsërit që pragu i kërkuar për një vendim gjyqësor “të shpejtë” duhet të përcaktohet nën dritën e rrethanave, duke përfshirë: kompleksitetin e procedurave, sjelljen e autoriteteve vendase dhe të kërkuesit, dhe ajo çka rrezikonte ky i fundit. Për më tepër, aty ku urdhri fillestar i paraburgimit ose urdhrat vijuese për vazhdimin e paraburgimit ishin marrë nga një gjykatë që garantonte procesin e duhur, dhe ku e drejta vendase përmbante një sistem apeli, Gjykata ishte e përgatitur të toleronte periudha më të gjata shqyrtimi.

Gjykata konsideroi që kohëzgjatja prej 16 muajsh e tre ditësh para Gjykatës Kushtetuese nuk do të përshkruhej rëndom si “e shpejtë”. Megjithatë, rasti në fjalë ishte kompleks, duke qenë i pari që ngrinte çështje të reja dhe të komplikuar lidhur me të drejtat për liri dhe siguri në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme. Për më tepër, Gjykata Kushtetuese ishte së tepërmi e ngarkuar me çështje në kohën relevante. Prandaj, Gjykata vendosi që nuk kishte shkelje të Nenit 5 § 4.

Sidoqoftë, ajo përsëriti që Gjykata Kushtetuese nuk kishte carte blanche gjatë trajtimit të ankesave të ngjashme dhe Gjykata e ruante juridiksionin e vet mbikqyrës.

Neni 5 § 5

Gjykata njëzëri e deklaroi këtë ankesë të papranueshme, duke gjetur se ishte dukshëm e pabazuar për sa i përkiste Nenit 5 § 1 të Konventës, dhe e papërputhshme racione materiae për sa i përkiste Nenit 5 § 4.

Neni 10

Gjykata konsideroi, nën dritën e VENDIMIT të Gjykatës Kushtetuese, që paraburgimi paragjyqësor i kërkuesit përbënte “ndërhyrje” tek e drejta e tij për liri të shprehjes.

Paraburgimi kishte bazë të padiskutueshme ligjore në dispozitat përkatëse të Kodit Penal dhe të Kodit të Procedurës Penale, dhe ajo kishte synuar qëllimet legjitime të parandalimit të trazirave dhe krimeve. Megjithatë, Gjykata nuk mund

të shihte arsye për arritjen e një përfundimi të ndryshëm prej atij të Gjykatës Kushtetuese, e cila kishte gjetur që paraburgimi paragjyqësor fillestar dhe ai i vazhduar i kërkuesit, pas shprehjes së opinionëve të tij, kishte përbërë një masë të rreptë e cila nuk mund të shihej si ndërhyrje e nevojshme dhe proporcionale në një shoqëri demokratike për qëllimet e Neneve 26 dhe 28 të Kushtetutës. Duke gjetur që gjyqtarët nuk kishin vërtetuar që privimi i kërkuesit prej lirisë kishte plotësuar një nevojë shoqërore urgjente, Gjykata Kushtetuese deklaroi që përderisa paraburgimi i tij nuk ishte bazuar në ndonjë provë konkrete përveç artikujve të tij, ai mund të kishte pasur efekt rrënoqthës mbi lirinë e shprehjes dhe të shtypit.

Gjykata shënoi që tentativa për grushtshteti dhe aktet e tjera terroriste qartazi përbënin kërcënim të madh ndaj demokracisë në Turqi. Megjithatë, ajo konsideroi që një prej tipareve kryesore të demokracisë është mundësia e zgjidhjes së problemeve me anë të debatit publik. Prandaj, ekzistenca e një "emergjence publike" nuk duhet të shërbejë si pretekst për kufizimin e kësaj lirie, e cila qëndron të thelb të shoqërisë demokratike. U konsiderua që, edhe në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme, Shtetet duhet të garantojnë mbrojtjen e rendit demokratik, duke ruajtur vlerat e tij të pluralizmit, tolerancës dhe mendjes së hapur.

Në këtë kontekst, Gjykata konsideroi që kritikën ndaj qeverive dhe publikimi i informacioneve që shihen nga udhëheqësit e një vendi si të tilla që rrezikojnë interesat kombëtare nuk do të duhej të shpinin në akuza penale për vepra posaçërisht të rënda si të qenit pjesë ose dhënia e ndihmës një organizate terroriste, tentativa për të rrëzuar qeverinë apo rendin kushtetues, ose përhapja e propagandës terroriste. Për më tepër, edhe kur ngrihen akuza të tilla kaq të rënda, paraburgimi paragjyqësor do të duhej të përdorej vetëm si masë e pazakontë e fundit pasi të gjitha masat e tjera të jenë vërtetuar të pamundura për të garantuar plotësisht ecurinë e duhur të procedurave. Nëse nuk do është kështu, interpretimi i gjykatave vendase nuk mund të shihet si i pranueshëm.

Sa i përket derogimit të Turqisë, në mungesë të arsyeve të forta për t'u distancuar nga vlerësimi i saj rreth zbatimit të Nenit 15 në lidhje me Nenin 5 § 1 të Konventës, Gjykata gjeti që konkluzionet e saj ishin po ashtu të vlefshme në kuadër të shqyrtimit të saj sipas Nenit 10.

Neni 18

Duke pasur parasysh të gjitha konkluzionet që ajo kishte arritur sipas Nenit 5 § 1 dhe Nenit 10 të Konventës, Gjykata nuk e konsideroi të nevojshme ta shqyrtonte këtë ankesë ndaras.

Neni 46

Gjykata gjeti që çdo vazhdim i paraburgimit paragjyqësor të kërkuesit nënkuptonte zgjatjen e shkeljes së Nenit 5 § 1 dhe shkelje të detyrimeve të Shteteve për t'iu përmbajtur VENDIMIT të Gjykatës në përputhje me Nenin 46 të Konventës. Rrjedhimisht, Gjykata vendosi që i takonte Qeverisë në pushtet të sigurohej për përfundimin e paraburgimit paragjyqësor të kërkuesit në datën më të hershme të mundur.

Neni 41

Gjykata vendosi që Turqia do t'i paguante kërkuesit 21,500 Euro në lidhje me dëme jomateriale.

II. Detyrimet pozitive për të mbrojtur jetën dhe shëndetin përfshirë në ambientet e paramburgimit

Detyrimet pozitive të Shtetit për të mbrojtur të drejtën e jetës dhe pronës në lidhje me fatkeqësitë natyrore

VENDIMI NË ÇËSHTJEN BUDAYEVA DHE TË TJERË k. RUSISË

(Kërkesat Nr. 15339/02, Nr. 21166/02, Nr. 20058/02,
Nr. 11673/02 dhe Nr. 15343/02)

20 mars 2008

1. Faktet kryesore

Gjashtë kërkuesit ishin shtetas rusë të lindur mes viteve 1953 dhe 1961. Ata jetonin në qytetin Tyrnauz, që ndodhet në rrethin malor të Republikës së Kabardino-Balkariya (në Rusi). Që prej vitit 1937, në atë zonë janë shënuar rrëshqitje balte çdo vit, sidomos në verë.

Më 18 qershor 2000, një rrjedhë balte dhe copëra mbeturinash goditën qytetin Tyrnauz dhe vërshuan në një pjesë të zonës së banuar. Sipas kërkuesve nuk pati paralajmërim të mëhershëm, dhe ata mezi arritën të iknin. Një prej kërkuesve, Fatima Atmurzayeva, dhe bija e saj, u zunë nga balta dhe copërat gjatë kohës që përpiqeshin të iknin, dhe u lënduan. Ato pësuan djegie të rënda si pasojë e fërkimit. Sapo goditi rrëshqitja baltore, u lëshua alarmi përmes altoparlantëve, por kërkuesit pretenduan se nuk pati as forca shpëtimi as ndonjë lloj tjetër ndihme emergjente në vendin e fatkeqësisë.

Mëngjesin e 19 korrikut 2000, niveli i baltës ra dhe, meqenëse nuk kishte barriera, e as policë apo zyrtarë emergjence për t'i ndaluar, disa banorë, mes të cilëve kërkuesja Khalimat Budayeva dhe familja e saj, u kthyen në shtëpitë e tyre. Ato nuk ishin në dijeni të ndonjë urdhri për evakuim. Më vonë atë ditë, qyteti u godit nga një valë e dytë më e fuqishme rrëshqitjeje baltore. Znj. Budayeva dhe biri i saj më i madh arritën të iknin. Bashkëshorti i saj, Vladimir Budayev, i cili qëndroi për të ndihmuar vjehrritë e tij, humbi jetën kur blloku i apartamenteve ku jetonte me familjen e tij u shemb.

Më pas qyteti u godit nga një sërë rrëshqitjesh baltore gjatë një periudhe që zgjati deri më 25 korrik 2000. Tetë persona u raportuan zyrtarisht të vdekur,

megjithëse kërkuesit pretenduan që 19 persona të tjerë ishin zhdukur. Të gjithë kërkuesit pretenduan që shtëpitë dhe posedimet e tyre ishin shkatërruar, dhe që kushtet e jetesës dhe shëndeti i tyre ishin përkeqësuar që prej fatkeqësisë.

Sipas Qeverisë, forca e jashtëzakonshme e rrëshqitjeve baltore nuk mund të ishte parashikuar apo ndaluar. Pas valës së parë të baltës më 18 qershor 2000, autoritetet urdhëruan evakuimin urgjent të Tyrnauz. Policia dhe zyrtarët vendas shkuan nëpër shtëpitë e njerëzve dhe automjete policie të pajisura me altoparlantë shëtitën nëpër tërë qytetin duke kërkuar që qytetarët të evakuoeshin. Ata banorë që u kthyen në shtëpitë e tyre u kthyen duke shkelur urdhrin e evakuimit. U morën të gjitha masat e nevojshme për të shpëtuar viktimat, për të rikthyer banorët dhe për të sjellë furnizime emergjente.

Më 3 gusht 2000, Prokuroria e Rrethit Elbrus vendosi të mos hapte hetime penale për fatkeqësinë ose për vdekjen e Z. Budayev, e cila u konsiderua aksidentale.

Pas një vendimi nga Qeveria e Republikës së Kabardino-Balkariya më 12 gusht 2000, të gjithë kërkuesve iu dhanë falas ambiente zëvendësuese banimi dhe ndihmë financiare emergjente në formën e një shume të rrumbullakësuar (13,200 rubla, të barasvlershme në atë kohë me 530 Euro).

Më pas, kërkuesit hapën procedura civile për kompensim. Pretendimet e tyre u refuzuan mbi bazën e faktit se autoritetet i kishin marrë të gjitha masat e arsyeshme për të lehtësuar rrezikun e rrëshqitjes baltore.

Kërkuesit nuk qenë dakord me ato përfundime. Ata akuzuan autoritetet për tri të meta kryesore në funksionimin e sistemit të mbrojtjes kundër rreziqeve natyrore në Tyrnauz: së pari, ata pretenduan se autoritetet kishin dështuar të mirëmbanin objektet inxhinierike për mbajtjen e baltës, konkretisht të riparoin një digë për të mbajtur baltën e cila ishte dëmtuar në vitin 1999; së dyti, ata u ankuan për mungesën e lajmërimit publik; dhe në fund, ata u akuan që nuk ishin zhvilluar hulumtime për vlerësimin e sjelljes së autoriteteve para dhe gjatë rrëshqitjes së baltës.

Në mbështetje të atyre akuzave, kërkuesit paraqitën artikuj gazetash; deklarata dëshmitarësh; dhe letra zyrtare e dokumente që vërtetonin se në buxhetin e rrethit nuk ishin ndarë fonde për punët riparuese që duheshin ndërmarrë pas rrëshqitjes baltore të vitit 1999, dhe që autoritetet kishin marrë disa paralajmërime për fatkeqësitë e pritshme nga Instituti Malor, një agjenci shtetërore përgjegjëse për monitorimin e rreziqeve të motit në zona të lartësisë së madhe. Në paralajmërimet

e tij, Instituti rekomandonte që të riparohej diga e dëmtuar baltëmbrojtëse dhe të vendoseshin pika vrojtimi për të lehtësuar evakuimin e popullatës në rast rrëshqitjeje të baltës.

2. Vendimi i Gjykatës

Duke u mbështetur në Nenet 2 (e drejta e jetës), 8 (e drejta për respektim të jetës private dhe familjare), 13 (e drejta për zgjidhje efektive) dhe Nenin 1 të Protokollit Nr. 1 (mbrojtja e pronës), kërkuesit pretenduan që, si rezultat i dështimit të autoriteteve ruse për të lehtësuar pasojat e rrëshqitjeve baltore nga 18 deri më 25 korrik 2000, autoritetet kishin vënë jetën e tyre në rrezik dhe mbanin përgjegjësi për vdekjen e Z. Budayev dhe për shkatërrimin e shtëpive të tyre. Ata gjithashtu u ankuan sipas Nenit 2 që autoritetet kishin dështuar në zhvillimin e hulumtimeve gjyqësore rreth fatkeqësisë.

Neni 2

Gjykata shënoi që në vitin 1999 autoritetet kishin marrë një sërë paralajmërimesh të cilat duhet t'i kishin bërë të vetëdijshëm për rreziqet në rritje të rrëshqitjeve baltore masive. Në rrethana të tilla, autoritetet duhet të kishin marrë masat praktike bazë për të siguruar mbrojtjen e popullatës vendase siç janë paralajmërimi i publikut dhe bërja e përgatitjeve paraprake për evakuim urgjent.

Megjithatë, kërkuesit u shprehën në mënyrë konsistente dhe Qeveria konfirmoi që banorët nuk kishin marrë asnjë paralajmërim deri sa balta kishte arritur në qytet më 18 korrik 2000. Për më tepër, pavarësisht nga kërkesat këmbëngulëse të Institutit Malor, nuk ishin ngritur pikat e vrojtimit në male, kështu që autoritetet nuk kishin mjete për të vlerësuar kohën, forcën apo kohëzgjatjen e rrëshqitjes baltore. Në fund, Qeveria nuk kishte ofruar informacione lidhur me mënyra të tjera të parashikuara për të siguruar mbrojtjen e popullatës vendase, si korniza rregullatore, politikat e planifikimit të tokës apo masa të veçanta sigurie. Parashtrësat e tyre i referoheshin ekskluzivisht digës baltëmbajtëse dhe kolektorit, i cili, siç ishte konstatuar tashmë, nuk ishte mirëmbajtur si duhej.

Mirëmbajtja e pamjaftueshme e infrastrukturës së mbrojtjes ndaj baltës, dhe dështimi për të ndërtuar sistemin e paralajmërimit nënkuptonte që autoritetet ruse kishin dështuar në detyrën e tyre për të ngritur një kornizë legislative dhe administrative me të cilën të ofrohej pengesë efektive ndaj kërcënimit të së drejtës së jetës, në shkëlqe të Nenit 2.

Më pas Gjykata vazhdoi me shqyrtimin e reagimit gjyqësor ndaj fatkeqësisë. Brenda një jave pasi ndodhi fatkeqësia prokuroria tashmë kishte vendosur të mos hapte hetimet penale mbi rrethanat e vdekjes së Vladimir Budayev. Hetimi ishte mjaftuar me shkaqet e menjëhershme të vdekjes së tij, dhe nuk kishte marrë fare në shqyrtim çështjet e veprimeve në përputhje me rregullat e sigurisë apo përgjegjësinë e autoriteteve. Pretendimet e kërkuesve për dëmshpërblim ishin rrëzuar nga gjykatat ruse mbi bazën e dështimit për të vërtetuar se deri në ç'masë neglizhenca e Shtetit kishte shkaktuar dëme që tejkalonin të paevitueshmen në fatkeqësi natyrore.

Prandaj, Gjykata arriti në përfundimin që çështja e përgjegjësisë së Rusisë për aksidentin në Tournay nuk ishte hetuar fare si e tillë e as nuk ishte marrë në shqyrtim nga ndonjë autoritet gjyqësor apo administrativ, në shkelje të Nenit 2.

Neni 1 i Protokollit Nr. 1

Palët ranë dakord që ishte e paqartë se deri në ç'masë mirëmbajtja e duhur e infrastrukturës mbrojtëse, ose sistemi i përshtatshëm paralajmërues, mund të kishin lehtësuar forcën e jashtëzakonshme të atyre rreshqitjeve baltore. Kështu që dëmet e shkaktuara nga rreshqitjet baltore nuk mund t'i atribuoheshin pa dyshim neglizhencës së Shtetit.

Për më tepër, detyrimi i një Shteti për të mbrojtur pronën private nuk mund të shihej si sinonimik me detyrimin për të kompensuar vlerën e plotë në treg të një prone të shkatërruar.

Mbi atë bazë, Gjykata arriti në përfundimin që kompensimi banesor dhe kompensimi për posedimet shtëpiake që u takonin kërkuesve nuk kishte qenë dukshëm joproportional me shtëpitë e tyre të humbura. Prandaj, nuk kishte pasur shkelje të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1.

Nenet e tjera

Gjykata konsideroi se ishte e panevojshme të shqyrtohej ndaras ankesa nga Neni 8, dhe që nuk dilte asnjë çështje e ndarë sipas Nenit 13.

Neni 41

Gjykata u caktoi, për dëme jomateriale, shumat 30,000 Euro për Khalimat Budayeva, 15,000 Euro për Fatima Atmurzayeva, dhe 10,000 Euro për secilin prej kërkuesve të tjerë.

Nuk ka shkelje të Nenit 2 meqenëse kërkuesit, bebja e posalindur e të cilëve vdiq në spital, kishin pranuar vullnetarisht kompensim përmes një marrëveshjeje dhe prandaj hoqën dorë nga e drejta e tyre për të nisur procedura civile

VENDIMI NË ÇËSHTJEN CALVELLI & CIGLIO K. ITALISË

(Kërkesa Nr. 32967/96)

17 janar 2002

1. Faktet kryesore

Kërkuesit ishin të dy shtetas italianë, bebja e të cilëve u lind në një klinikë private në Kozenca të Italisë më 7 shkurt 1987. Menjëherë pas lindjes, bebja e tyre u shtrua në repartin e kujdesit intensiv, me sindromën e post-asfiksionit të rëndë respiratore dhe neurologjike e shkaktuar nga pozicioni në të cilin kishte qenë gjatë lindjes. Bebja vdiq dy ditë më pas.

Më 10 shkurt 1987 kërkuesit bënë ankesë dhe Prokuroria Publike e Kozencës filloi hetimet. Kërkuesit u informuan që do të ngriheshin akuza kundër mjekut përgjegjës për lindjen e bebes së tyre dhe bashkëpronarit të klinikës, dhe, më 7 korrik 1989, ato u bashkuan si palë civile në procedura. Më 17 dhjetor 1993, Gjykata Penale e Kozencës e gjeti mjekun fajtor in absentia për vrasje pa paramendim, e dënoi me një vit burg dhe e urdhëroi të paguante shpenzimet dhe kompensimin për palët civile.

Gjykata Penale gjeti që i akuzuari e dinte që lindja duhet të konsiderohej me rrezikshmëri të lartë meqenëse nëna ishte diabetike e shkallës A dhe përpara kishte pasur disa lindje që kishin qenë po aq të vështira për shkak të madhësisë së fetusit. Rreziqet e lindjeve në këto rrethana nënkuptonin që duhet të ishin marrë masa paraprake dhe që mjeku në detyrë duhet të kishte qenë aty. Megjithatë, Gjykata Penale gjeti që i akuzuari, me të cilin kërkuesja ishte konsultuar gjatë shtatzanisë, nuk kishte marrë masa paraprake dhe kishte munguar gjatë lindjes, duke vizituar pacientë diku tjetër. Kur ndodhën komplikimet, infermierëve iu deshën gjashtë apo shtatë minuta për ta gjetur atë, dhe vonesa në ndërhyrje i zvogëloi shumë shanset e bebes për të mbijetuar.

Pavarësisht nga kjo, Gjykata Penale e pezulloi dënimin dhe urdhëroi që dënimi të mos paraqitej në dosjen penale të të akuzuarit. Përveç kësaj, ajo e rrëzoi kërkesën e palëve civile për caktim të përkohshëm të kompensimit. I akuzuari apeloj dhe,

në një gjykim të 3 korrikut 1995, Gjykata e Apelit e Katanzaros vendosi që ndjekja penale e çështjes ishte vjetëruar dhe afati kohor për veprën në fjalë kishte skaduar më 9 gusht 1994.

Ndërkohë, kërkuesit po ashtu nisën procedurën civile kundër të akuzuarit. Megjithatë, më 27 prill 1995, ndërsa procedura penale vazhdonte në Gjykatën e Apelit të Katanzaros, ata arritën një marrëveshje me të dhe me sigurimet e klinikës sipas të cilës siguruesit do të paguanin 95,000,000 Lira italiane (ITL)^[753] për dëmin e pësuar nga kërkuesit. Pas kësaj, meqenëse palët nuk u paraqitën në një seancë të 16 nëntorit 1995, çështja u hoq fare.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesit u ankuan, sipas Nenit 2, që, për shkak të vonesave procedurale, kishte skaduar afati kohor që e bënte të pamundur ndjekjen penale të mjekut përgjegjës për lindjen e fëmijës së tyre. Ata gjithashtu u ankuan, sipas Nenit 6 § 1, që kohëzgjatja e procedurave ishte e paarsyeshme.

Neni 2

Gjykata vërejti që, sipas Nenit 2, Italisë i kërkohej që të miratonte rregullore që i detyronin spitalet, qofshin publike apo private, që të merrnin masat e duhura për mbrojtjen e jetës së pacientëve. Gjithashtu i kërkohej të ofronte një sistem efektiv të pavarur gjyqësor në mënyrë që shkak i vdekjes së pacientëve nën kujdesin e profesionit mjekësor, qoftë në sektorin publik apo privat, të mund të konstatohej dhe përgjegjësit të jepnin llogari. Prandaj Neni 2 u konsiderua i aplikueshëm në çështjen në fjalë.

U shënua që sistemi italian u ofronte paditësve zgjidhje të cilat, në teori, përmbushnin kriteret e Nenit 2, meqenëse u ofronte palëve të lënduara procedura penale të detyrueshme dhe mundësinë e ndërmarrjes së veprimeve në procedurë civile. Qeveria gjithashtu afirmoi, dhe kërkuesit nuk e mohuan, që mund të nisnin procedurat disiplinore nëse mjeku do të jepte përgjegjësi para gjykatave civile. Megjithatë, kjo dispozitë nuk mund të përmbushej nëse një mbrojtje e tillë ekzistonte vetëm në teori: mbi të gjitha, ajo duhet të operonte efektivisht në praktikë brenda një harku kohor të atillë që gjykatat të mund të kryenin shqyrtimin e meritave të secilës çështje individuale.

[753] Afërsisht të barasvlershme me 49,000 Euro në atë kohë.

Gjykata shënoi që procedurat penale të nisura kundër mjekut në fjalë ishin vjetëruar sepse mangësitë procedurale kishin shkaktuar vonesa, posaçërisht gjatë hetimeve policore dhe hetimeve gjyqësore. Megjithatë, kërkuesit po ashtu kishin pasur të drejtë të nisnin procedura në gjykatat civile, dhe këtë e kishin bërë. Ishte e vërtetë që asnjë gjykatë civile nuk kishte gjetur që mjeku ishte përgjegjës. Megjithatë, kërkuesit kishin arritur marrëveshje miqësore dhe vullnetarisht kishin hequr dorë nga e drejta e tyre për të vazhduar procedurat. Kjo mund të kishte çuar drejt dhënies së një urdhri kundër mjekut për pagimin e dëmshpërblimit dhe mundësisht drejt veprimeve disiplinore kundër mjekut. Prandaj u konsiderua që kërkuesit ia kishin mohuar vetes qasjen ndaj mënyrave më të mira të cilat, në rrethanat e veçanta të çështjes në fjalë, do të kishin përmbushur detyrimet pozitive që dilnin nga Neni 2: ndriçimi i shkallës së përgjegjësisë së mjekut për vdekjen e fëmijës së tyre.

Gjykata përsëriti që kur të afërmit e një personi të vdekur pranonin kompensim në një marrëveshje miqësore të një padie civile të bazuar në neglizhencën mjekësore, ai ose ajo në parim nuk mund të pretendonte më se ishte viktimë. Prandaj nuk ishte e nevojshme që Gjykata të shqyrtonte nëse fakti që vjetërsimi i lëndës e pengonte ndjekjen penale të mjekut për veprën e supozuar ishte në përputhje me Nenin 2. Prandaj Gjykata deklaroi që nuk kishte pasur shkelje të Nenit 2.

Neni 6 § 1

Gjykata shënoi që procedurat në fjalë ishin pa dyshim komplekse. Më tej, megjithëse pasi kërkuesit u bashkuan si palë civile në procedurat e 7 korrikut 1989, procedura e shkallës së parë u ndikua prej vonesave për fat të keq, nuk kishte pasur periudha të mëtijshme mosaktiviteti që mund t'i atribuoheshin autoriteteve (përveç ndërprerjes së seancës së parë dëgjimore, që ishte shkaktuar nga një grevë e juristëve). Prandaj ajo konsideroi që një periudhë prej gjashtë vjetësh, tre muajsh e dhjetë ditësh për procedura para katër shkallëve të juridiksionit nuk mund të shihej si e paarsyeshme. Rrjedhimisht, nuk kishte pasur shkelje të Nenit 6 § 1.

OJQ-ja ngre çështje para Gjykatës në emër të një të riu mendërisht të paaftë dhe HIV-pozitiv i cili vdiq në një spital psikiatrik

VENDIMI I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN E QENDRËS PËR BURIME LIGJORE NË EMËR TË VALENTIN CÂMPEANU k. RUMANISË

(Kërkesa Nr. 47848/08)

17 korrik 2014

1. Faktet kryesore

Kërkesa u paraqit në emër të Valentin Câmpeanu, i cili u lind në vitin 1985 dhe vdiq në vitin 2004. Z. Câmpeanu ishte braktisur në lindje dhe ishte vendosur në jetimore. Në vitin 1990, në moshën 5-vjeçare, ai u diagnostikua pozitiv me virusin HIV dhe me sëmundje të rëndë mendore.

Në mars 1992 ai u transferua në Qendrën Craiova për Fëmijë me Paaftësi, dhe më pas në Qendrën e Vendosijes Craiova Nr. 7.

Në shtator 2003, komisioni Krahinor për Mbrojtjen e Fëmijëve urdhëroi që Z. Câmpeanu të mos kishte më përkujdesje nga Shteti, mbi bazën e faktit që ai e kishte mbushur moshën 18-vjeçare dhe nuk ishte i regjistruar në ndonjë formë arsimimi. Në fillim të shkurtit 2004, pas refuzimeve të njëpasnjëshme për pranim nga disa institucione, Z. Câmpeanu dikur u pranua në një qendër kujdesi mjekësor dhe social (CMSC), ku u gjet se ai ishte në fazë të avancuar degradimi psikiatrik dhe fizik, pa asnjë mjekim antiretroviral, dhe se vuante nga kequshqyerja.

Më 9 shkurt, pas një shpërthimi të papritur gjatë të cilit Z. Câmpeanu kinëse u soll në mënyrë agresive, ai u dërgua në Spitalin Neuropsikiatrik Poiana Mare (PMH) për ekzaminim dhe trajtim. Megjithatë, atë e kthyen në qendrën e kujdesit mjekësor dhe social brenda të njëjtës ditë. Më 13 shkurt, Z. Câmpeanu sërish u dërgua për trajtim në PMH. Pasi kaloi një javë atje, ai u vendos në reparte të ndryshme të Psikiatrisë.

Më 20 shkurt ai u pikas nga një ekip monitoruesish nga Qendra për Burime Ligjore (CLR) të cilët raportuan që Z. Câmpeanu ishte lënë vetëm në një dhomë të izoluar dhe pa ngrohje, me krevat por pa shtresa, i veshur hollë vetëm me këmishë pizhamesh, dhe pa ndihmesën që i duhej për të ngrënë ose përdorur

banjon, meqenëse stafi i spitalit kinëse refuzonte ta ndihmonte për shkak të frikës nga infektimi me HIV. Përfaqësuesit e CLR-së deklaruan se kishin kërkuar që ai të transferohej menjëherë në Spitalin e Sëmundjeve Infektive në Craiova, ku ai mund të merrte trajtimin e përshtatshëm. Megjithatë, menaxheri i spitalit kishte vendosur kundër kësaj kërkesë, meqenëse besonte se pacienti nuk ishte "rast emergjent, por rast social", dhe që sidoqoftë ai nuk do të ishte në gjendje të duronte udhëtimin. Në të njëjtën ditë, 20 shkurt 2004, Z. Câmpeanu vdiq.

Ende pa e ditur për vdekjen e Z. Câmpeanu, CLR hartoi disa letra urgjente dhe ua dërgoi disa zyrtarëve vendas dhe qendrorë duke theksuar gjendjen kritike shëndetësore të tij dhe faktin që ai ishte transferuar në një institucion që nuk mund t'i ofronte atij kujdesin e përshtatshëm. Më tej, CLR kritikoi trajtimin e pamjaftueshëm që po i jepej atij, dhe kërkoi të merreshin masa urgjente për të zgjidhur situatën. Më tej, deklaroi që pranimi i Z. Câmpeanu në CMSC dhe transferimi i mëtejshëm në tij në PMH kishte qenë shkelje e të drejtave të njeriut karshi tij, dhe nguli këmbë që të hapeshin hetime përkatëse në lidhje me këtë rast.

Më 22 shkurt 2004, CLR lëshoi një kumtesë për shtyp duke theksuar kushtet dhe trajtimin e marrë nga pacientët në PMH, duke iu referuar në mënyrë të veçantë rastit të Z. Câmpeanu dhe duke kërkuar veprime të menjëhershme.

2. Vendimi i Gjykatës

Në përgjigje ndaj shumë ankesave të depozituara nga CLR dhe pas hetimeve vijuese rreth vdekjes së Z. Câmpeanu, CLR ngriti supozimin se ishin shkelur të drejtat e Z. Câmpeanu sipas Neneve 2, 3, 5, 8, 13 dhe 14.

Pranueshmëria

Gjykata rrëzoi kundërshtimin nga Qeveria rumune që CLR nuk ishte e kualifikuar të ngrinte ankesë në emër të Valentin Câmpeanu, meqenëse CLR nuk mund të pretendonte se ishte vetë viktimë e shkeljeve të supozuara të Konventës, dhe nuk ishte as përfaqësuese e vlefshme e Z. Câmpeanu. Gjykata theksoi se Konventa garanton të drejta të cilat janë praktike dhe efektive, jo teorike dhe iluzive, dhe që duke pasur parasysh natyrën e rëndë të akuzave, duhet të ishte e hapur ndaj të vepruarit të CLR-së si përfaqësuese e Z. Câmpeanu.

Neni 2

Gjykata deklaroi që vendimi i autoriteteve rumune për ta vendosur Z. Câmpeanu në një qendër kujdesi mjekësor e social dhe më tej për ta transferuar atë në PMH kryesisht ishte marrë në varësi të gadishmërisë së cilitdo institucion që do ta akomodonte, e jo në varësi të një institucioni ku ai do të mund të merrte mbështetjen dhe kujdesin mjekësor që i duhej. Pasi u pa që qendra mjekësore dhe sociale nuk ishte e pajisur me kushtet e duhura për t'u kujdesur për shëndetin mendor të pacientëve, ata e transferuan në PMH, pavarësisht nga fakti që spitali më parë kishte refuzuar ta pranonte atë, dhe më pas u vendos në një repart pa staf psikiatrik.

Transferimet nga njëri vend në tjetrin ishin bërë pa diagnozë të mirëfilltë e kujdes vijues, dhe duke mos llogaritur fare gjendjen aktuale shëndetësore dhe nevojat mjekësore elementare të Z. Câmpeanu. Në mënyrë të veçantë, duhet shënuar dështimi i autoriteteve për t'u siguruar që ai të merrte mjekimin antiretroviral.

Gjykata i kushtoi vëmendje të veçantë gjendjes së dobësuar të Z. Câmpeanu, si dhe faktit që gjatë tërë jetës së tij Z. Câmpeanu kishte qenë në duart e autoriteteve, të cilat rrjedhimisht kishin për detyrë të merrnin përsipër trajtimin e tij. Me vendimin që Z. Câmpeanu të dërgohej në atë spital, sadoqë ishin të vetëdijshëm për kushtet e tmerrshme në spitalin psikiatrik, autoritetet e kishin vënë jetën e tij në rrezik pa arsye. Më tej, dështimi për t'i ofruar atij kujdesin dhe mjekimin e duhur ishte një faktor tjetër vendimtar që shpuri drejt vdekjes së tij të pakohshme. Prandaj, Gjykata arriti në përfundimin që autoritetet rumune kishin shkelur Nenin 2 duke dështuar të garantonin mbrojtjen e nevojshme për jetën e Z. Câmpeanu.

Më tej, Gjykata gjeti shkelje të Nenit 2 për sa i përket kërkesave procedurale sipas atij Neni, meqenëse autoritetet kishin dështuar në sqarimin e rrethanave të vdekjes së Z. Câmpeanu dhe identifikimin e personave përgjegjës.

Neni 13 në lidhje me Nenin 2

U gjet një shkelje e Nenit 13 në lidhje me Nenin 2, meqenëse Shteti kishte dështuar t'u ofronte mekanizma të përshtatshme për zgjidhje personave me paaftësi mendore që pretendonin se ishin viktima sipas Nenit 2.

Duke pasur parasysh gjetjet e saj sipas Neneve 2 dhe 13, Gjykata deklaroi që nuk ishte e nevojshme të shqyrtoheshin ndaras ankesat sipas Nenit 3, i marrë vetëm dhe në lidhje me Nenin 13, Nenet 5, 8 dhe 14.

Neni 46

Gjykata deklaroi që Shteti përgjegjës duhet të merrte masat e përgjithshme të nevojshme për t'u siguruar që personat mendërisht të paaftë në situata të ngjashme të kishin përfaqësim të pavarur, çka u mundëson këtyre të fundit që ankesat sipas Konventës në lidhje me shëndetin dhe trajtimin e tyre të shqyrtohen para një gjykate apo një organi tjetër të pavarur.

Neni 41

CLR nuk kishte paraqitur pretendime në lidhje me dëme materiale ose jomateriale, kështu që një shpërblim i tillë nuk u vendos. Gjykata vendosi që Rumania duhet të paguante 10,000 Euro CLR-së dhe 25,000 Euro organizatës Interights, e cila kishte vepruar si këshilluese për CLR-në, për kosto dhe shpenzime.

Dështimi i vazhdueshëm i autoriteteve për të zbatuar masa për mbrojtjen e komuniteteve të prekura nga emetimet toksike nga një fabrikë përpunimi të çelikut ka shkelur Nenin 8

VENDIMI NË ÇËSHTJEN CORDELLA DHE TË TJERË k. ITALISË

(Kërkesat Nr. 54414/13 dhe Nr. 54264/15)

24 janar 2019

1. Faktet kryesore

Kërkuesit ishin 180 persona që jetonin në komunën Taranto, Itali ose në zonat fqinje. Ata u ankuan për impaktin mjedisor të emetimeve toksike nga fabrika Ilva e përpunimit të çelikut në Taranto (Fabrika Ilva), që ishte kompleksi industrial më i madh i përpunimit të çelikut në Evropë.

Më 30 nëntor 1990, Këshilli i Ministrave në Itali e klasifikoi Taranton dhe disa komuna të tjera si zona me "rrezikshmëri të lartë mjedisore". Një numër raportesh shkencore gjetën që rastet e tumoreve dhe sëmundjeve kardiovaskulare në popullatën vendase ishin më të larta sesa mesatarja rajonale dhe kombëtare. Raportet gjithashtu konstatuan lidhje shkakësore mes kësaj gjetjeje dhe emetimeve toksike të prodhuara nga Fabrika Ilva.

Nga fundi i vitit 2012, Qeveria miratoi disa dekrete legjislativë (dekrete "Salva- Ilva") në lidhje me aktivitetet e Fabrikës Ilva. Në vitin 2017, Kryetari i Këshillit të Ministrave ekzekutoi një dekret i cili shtynte zbatimin e masave të parashikuara nga planet për mjedisin deri në vitin 2023. Rajoni i Apulias dhe komuna e Tarantos e kontestuan ligjshmërinë dhe kushtetutshmërinë e dekretit pranë Gjykatës Administrative të Apulias, duke pasur parasysh pasojat në mjedis dhe në shëndetin publik të një shtyrjeje të tillë. Ata kërkuan anulimin e dekretit dhe pezullimin e ekzekutimit të tij. Këto procedura administrative ishin ende në pritje në kohën kur çështja doli para Gjykatës Evropiane.

Menaxhmenti i Fabrikës Ilva ishte po ashtu objekt i disa procedurave penale për dëme ekologjike serioze, helmimin e substancave ushqimore, dështimin në parandalimin e aksidenteve në vendin e punës, degradimin e pronës publike, dhe emetimin e ndotësve dhe ndotjen e ajrit. Disa prej këtyre procedurave qenë të suksesshme dhe rezultuan me dënime në vitet 2002, 2005 dhe 2007. Gjykata e Kasacionit dënoi menaxhmentin e Fabrikës Ilva në mënyrë të veçantë, për ndotjen

e ajrit, hedhjen e materialeve të rrezikshme, dhe emetimin e copëzave; ku kjo e fundit kishte vazhduar të ndodhte pavarësisht nga marrëveshjet e shumta të arritura me autoritetet vendase në vitet 2003 dhe 2004.

Në një gjykim të 31 marsit 2011, Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian deklaroi që Italia kishte dështuar të vepronte në përputhje me detyrimet e saj për parandalimin dhe kontrollimin e ndotjes së integruar sipas Direktivës 2008/1 EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit. Pas një procedure për shkelje që nisi kundër Italisë më 16 tetor 2014, Komisioni Evropian lëshoi një opinion të arsyetuar ku shënohej që Italia kishte dështuar në përmbushjen e detyrimeve të saj për të garantuar që Fabrika Ilva t'i përmbahej Direktivës së Emetimeve Industriale, dhe kërkoi që autoritetet italiane të zgjidhnin problemet serioze të shkaktuara nga ndotja prej Fabrikës Ilva.

Kompania që drejtonte Fabrikën Ilva falimentoi në vitin 2015 dhe administratorit iu dha imunitet administrativ dhe penal për zbatimin e masave mjedisore.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesit u ankuan që dështimi i autoriteteve për të miratuar masa ligjore dhe administrative për të mbrojtur shëndetin dhe mjedisin rreth tyre, si dhe dështimi i tyre për t'u ofruar atyre informacione rreth ndotjes dhe rrezikut ndaj shëndetit të tyre, shkelte të drejtat e tyre sipas Neneve 2 dhe 8 të Konventës. Gjykata i mori në shqyrtim ankesat nën prizmin e Nenit 8.

Pranueshmëria

Qeveria argumentoi që ankesat ishin të papranueshme sepse, mes arsyeve të tjera, ato ishin të karakterit të përgjithshëm dhe nuk iu referoheshin situatave të veçanta apo nuk paraqisnin prova të dëmeve mjaftueshëm serioze të pësuar nga individët. Gjykata përsëriti që Konventa nuk ofronte ndonjë mbrojtje të përgjithshme ndaj dëmeve mjedisore. Megjithatë, Gjykata mori në konsideratë raportet e shumta shkencore që iu dorëzuan, dhe gjeti që ato përmbanin prova të pakontestueshme që ndotja e prodhuar nga Fabrika Ilva kishte pasoja të dëmshme mbi shëndetin dhe mirëqenien e kërkuesve të cilët jetonin në zonat e identifikuara nga Qeveria si "me rrezikshmëri të lartë mjedisore". Prandaj pretendimet e atyre që jetonin në zona të tilla ishin të pranueshme. Megjithatë, 19 kërkuesit të cilët nuk kishin banuar në këto zona nuk mund të pretendonin statusin e viktimës.

Neni 8

Gjykata shënoi se që nga vitet 1970 një numër raportesh shkencore, shumë prej të cilave ishin hartuar nga organet e Shtetit dhe ato rajonale, kishin treguar impaktin e emetimeve toksike nga Fabrika Ilva mbi mjedisin dhe shëndetin e popullatës vendase. Gjetjet e këtyre raporteve nuk viheshin në diskutim nga asnjëra palë. Kjo përfshinte një raport të vitit 2012 i cili konfirmonte që kishte një lidhje shkakësore mes ekspozimit ndaj substancave karcinogjene të thithshme të prodhuara nga Fabrika Ilva dhe përhapjes së tumoreve të mushkërive dhe sëmundjeve kardiovaskulare në popullatën vendase. Raporti jepte rekomandime të shëndetit publik për zonat e interesuara, çka Shteti dështoi t'i zbatonte. Nuk i takonte Gjykatës të përcaktonte masat e sakta të cilat autoritetet duhet të kishin marrë për të reduktuar nivelin e ndotjes në rajon. Megjithatë, i takonte Shtetit të demonstroi që ai e kishte trajtuar këtë çështje me zell, duke marrë në konsideratë të gjitha interesat në fjalë, përfshirë impaktin e emetimeve tek kërkuesit.

Dëmi ekologjik serioz mund të angazhojë Nenin 8 kur ai redukton në mënyrë domethënëse kapacitetin e kërkuesit për të gëzuar shtëpinë e vet, ose jetën e vet private ose familjare. Fakti nëse ky nivel minimal është arritur apo jo varet nga shkaku, intensiteti, dhe kohëzgjatja e dëmit, si dhe pasojat mbi shëndetin fizik dhe psikologjik si dhe cilësia e jetës së kërkuesit. Ndërkohë që është shpeshherë e pamundur të shprehen në sasi efektet e ndotjes industriale dhe të bëhet dallimi mes tyre dhe ndikimit të faktorëve të tjerë në çdo rast të dhënë, Gjykata është e prirur ta bazojë vendimin e vet mbi të gjitha, sadoqë jo ekskluzivisht, konkluzionet e gjykatave dhe autoriteteve të tjera kompetente vendase.

Në rast aktiviteti të rrezikshëm, në mënyrë të veçantë, Shteti kishte detyrimin pozitiv të miratonte masa mbrojtëse duke marrë parasysh nivelin e rrezikut të ndërlidhur me aktivitetin. Për të përmbushur edhe këtë detyrim pozitiv edhe detyrimin negativ për të mos ndërhyrë në mënyrë arbitrare tek e drejta e kërkuesve për shtëpinë e tyre, si dhe në jetën e tyre private dhe familjare, Shteti duhet të balancojë interesat e Fabrikës Ilva nga njëra anë dhe ato të kërkuesve nga ana tjetër. Përpjekjet e autoriteteve për të dekontaminuar rajonin deri në atë moment nuk kishin sjellë rezultatet e dëshiruara. Dështimi i tyre në zbatimin e masave të vitit 2012, parashikuar nga "AIA" (dekret administrativ mjedisor), ishte baza e një procedure shkeljeje të nisur pranë institucioneve të Bashkimit Evropian. Për më tepër, zbatimi i planeve mjedisore të miratuara në vitin 2014 u shty për në gusht të vitit 2023. Ndërkohë, Qeveria kishte ndërhyrë përmes dekretive Salva-Ilva për të garantuar vazhdimin e prodhimit të çelikut në Fabrikën Ilva, pavarësisht nga

gjetjet gjyqësore që këto aktivitete paraqisnin rreziqe serioze për mjedisin dhe shëndetin e popullatës vendase.

Përveç kësaj, kompania që drejtonte Fabrikën Ilva kishte falimentuar dhe individët përgjegjës për pajtueshmërinë e Fabrikës Ilva me masat mjedisore, pra administratori dhe blerësi i ardhshëm, kishin fituar imunitet administrativ dhe penal. Përfundimisht, menaxhimi nga autoritetet i rrezikut mjedisor të shkaktuar nga aktivitetet e llvës kishin mbërritur në një pikë pa rrugëdalje. Gjykata shënoi që zgjatja e kësaj situatë do të rrezikonte më tej shëndetin e popullatës vendase, e cila ende ishte e privuar nga informacionet lidhur me rehabilitimin e zonës.

Në përfundim, autoritetet kishin dështuar në gjetjen e ekuilibrit të duhur mes interesave të kërkuesve për të mos shkaktuar dëme serioze në mjedis të cilat mund të ndikonin tek mirëqenia e tyre dhe jeta e tyre private, dhe interesit të shoqërisë në tërësi. Rrjedhimisht, Gjykata deklaroi që kishte shkelje të Nenit 8.

Neni 13

Duke pasur parasysh se që e pamundur për kërkuesit të siguronin një masë që garantonte dekontaminimin e zonës, ata nuk patën qasje në zgjidhje efektive. Prandaj, kishte shkelje të Nenit 13.

Neni 46

Kërkuesit e kërkesës nr. 54264/15 synonin operimin e procedurës së pilot-VENDIMIT. Ndërkohë që Gjykata mund t'i asistonte Shtetit duke sugjeruar masa potenciale të natyrës së përgjithshme, i takonte Këshillit të Ministrave të vendoste rreth masave specifike të nevojshme për të përmbushur detyrimet e Shtetit nga Neni 46. Duke pasur parasysh kompleksitetin e teknikave të duhura për rehabilitimin e zonës, gjë që hynte brenda kompetencave të autoriteteve nacionale, nuk ishte me vend që të aplikoheshin procedura e pilot-VENDIMIT. Megjithatë, puna për pastrimin e Fabrikës Ilva dhe rajonit të prekur ishte e rëndësishme thelbësore dhe urgjente. Si e tillë, çdo plan relevant i miratuar nga autoritetet nacionale duhet të zbatohet sa më shpejt që të ishte e mundur.

Neni 41

Gjykata deklaroi që gjetja prej saj e një shkeljeje përbënte shpërblim të drejtë të mjaftueshëm në lidhje me dëmet jomateriale dhe që Italia duhet të paguante 5000 Euro për kostot dhe shpenzimet në lidhje me secilën kërkesë.

Dështimi sistematik për të konstatuar shkakun e vdekjes së djalit të rritur të kërkueses ka shkelur aspektin procedural të Nenit 2

VENDIMI NË ÇËSHTJEN EUGENIA LAŽAR k. RUMANISË

(Kërkesa Nr. 32146/05)

16 shkurt 2010

1. Faktet kryesore

Kërkuesja ishte e lindur në vitin 1951 dhe jetonte në Dobra, Rumani. Natën e 10 korrikut 2000, djali 22-vjeçar i kërkueses, Adrianit, shfaqti shenja asfiksie dhe ajo e dërgoi me makinë në Spitalin Krahinor në Deva. Ai u shtrua në repartin e emergjencës në ora 2:30 të mëngjesit dhe u transferua në repartin e veshit, hundës dhe fytit ("ENT"), ku Dr. C administroi kortizon për ta trajtuar. Rreth orës 2:45 të mëngjesit, Dr. C thirri Dr. M i cili vendosi të kryente trakeotomi për të pastruar traktin respirator të Adrianit. Rreth orës 3:15 të dy mjekët e operuan atë, por ai pësoi arrest respirator dhe nuk qe e mundur të ringjallej. Ai vdiq rreth orës 5:00 të mëngjesit.

Në korrik të vitit 2000, kërkuesja bëri ankesë penale kundër të dy mjekëve duke pretenduar se ata kishin dështuar të vepronin aq shpejt sa duhej për të shpëtuar jetën e Adrianit. Me kërkesë të policisë, më 6 nëntor 2000 u hartua një raport autopsy ku thuhej se ai kishte vdekur nga asfiksia pas trakeotomisë, e cila ishte kryer me korrektesë por me vonesë meqenëse ai ishte transferuar gabimisht në repartin ENT. Megjithatë, një institut tjetër mjeko-ligjor doli me konkluzionin që mjekët nuk mund të mbaheshin përgjegjës për këtë problem koordinimi. Në fund, më 15 tetor 2001, Bordi i Lartë Mjekësor Mjeko-Ligjor pranë Institutit Mina Minovici në Bukuresht ("Autoritet Nacional Suprem për Mjekësinë Ligjore") dha opinionin e vet në dy raporte dhe konkludoi që mjekët kishin vepruar në përputhje me praktikën e pranuar dhe nuk kishin kryer asnjë gabim mjekësor.

Prokuroria i ndërpreu hetimet penale kundër mjekëve në nëntor të vitit 2001, duke u mbështetur në vendimin e Autoritetit Nacional Suprem të Mjekësisë Ligjore. Kërkuesja bëri dy apele kundër këtij vendimi për ndërprerjen e procedurave penale dhe prokurori publik urdhëroi paraqitjen e raporteve të reja mjekësore e mjeko-ligjore në të dy rastet. Megjithatë, tre institute refuzuan të hartonin këso raportesh të reja, duke thënë se Akti për Institutet e Mjekësisë Ligjore ("Akti") ua ndalonte kryerjen e ekzaminimeve të reja eksperte pasi Autoriteti Nacional

Suprem i Mjekësisë Ligjore të kishte dhënë opinionin e vet dhe/ose nuk kishin dalë në dritë prova të reja. Prandaj procedurat penale u ndërpre në të dy rastet.

Më 15 tetor 2004, gjykata e shkallës së parë e lejoi apelin e kërkuësës kundër vendimit për ndërprerjen e procedurave dhe urdhëroi prokurorinë që të niste procedurat penale kundër Dr. C për vrasje të pavullnetshme pa paramendim. Gjykata u tregua kritike rreth mënyrës se si ishin zhvilluar hetimet dhe faktit që procedurat penale kishin zgjatur pesë vjet. Ajo po ashtu e gjeti të pakonceptueshme që Autoriteti Nacional Suprem i Mjekësisë Ligjore ishte mbështetur në Aktin për t'iu shmangur detyrimit për të paraqitur një raport të dytë mjekësor, dhe theksoi që nevojitej një raport tepër shkencor dhe intelektual për të konstatuar të vërtetën e kësaj çështjeje. Ajo shënoi që raporti i 15 tetorit 2001 i kishte shfajësuar mjekët pa ndonjë bazë shkencore. Çështja u referua prapa tek Gjykata Krahinore për hetime të mëtejshme. Më 8 shkurt 2005, Gjykata Krahinore solli një gjykim përfundimtar ku e shpallte Dr. C të pafajshëm për vrasje pa paramendim. Ai deklaronte që, pasi Autoriteti Nacional Suprem i Mjekësisë Ligjore kishte dhënë opinionin e vet, Akti ua ndalonte autoriteteve gjyqësore që të kërkonin raporte të tjera mjekësore e mjeko-ligjore pa prova të reja. Pa mundësinë për të mbledhur prova të tjera, ai u mbështet në opinionin e Autoritetit Nacional Suprem dhe konkludoi që vdekja e Adrianit ishte shkaktuar nga komplikimet pas operacionit.

Në fund, kërkuësja arriti të merrte një vendim disiplinor kundër Dr. C nga një këshill mjekësor. Megjithatë, ky vendim më vonë u prish për shkak se kërkuësja e kishte bërë kërkesën para këshillit të gabuar, pavarësisht nga fakti që ajo kishte informuar dhe ftuar këshillin e saktë për të marrë pjesë në procedurat disiplinore.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuësja u ankua që vdekja e djalit të saj ishte rezultat i neglizhencës së spitalit dhe që hetimet penale rreth vdekjes së tij kishin shkelur Nenin 6 të Konventës. Gjykata vendosi ta shqyrtonte ankesën sipas Nenit 2.

Neni 2

Gjykata pohoi që aspekti procedural i Nenit 2 cakton një detyrim pozitiv mbi Shtetin që të ngrejë një sistem juridik efektiv dhe të pavarur për të konstatuar shkakun e vdekjes së pacientëve në duart e profesionistëve mjekësorë dhe, aty ku duhet, për t'i vënë ata para përgjegjësisë. Ndërkohë që problemet e koordinimit në spitale publike ishin shqetësim i madh, Gjykata nuk mund të spekulonte rreth

shkakut të vdekjes së Adrianit. Në vend të kësaj, Gjykata shqyrtoi mjaftueshmërinë e hetimeve penale për të konstatuar shkakun e vdekjes dhe mjaftueshmërinë e zgjidhjeve gjyqësore në dispozicion të kërkueses për të përcaktuar përgjegjësinë për vdekjen e djalit të saj.

Gjykata së pari shqyrtoi nëse hetimet penale të autoriteteve ishin të shpejta dhe efektive. Kriteri i shpejtshtërisë ishte i nënkuptuar në rastet e neglizhencës mjekësore të shqyrtuara sipas Nenit 2. Hetimet në këtë rast nuk e kishin përmbushur këtë kriter meqenëse ishin dashur katër vjet. Pavarësisht nga kjo, Gjykata shqyrtoi nëse hetimet kishin qenë efektive dhe gjeti që ato ishin minuar nga dy mangësi domethënëse: mungesa e bashkëpunimit nga ana e ekspertëve mjeko-ligjorë dhe mungesa e arsyeve në opinionet eksperte të dhëna.

Pavarësisht nga kohëzgjatja e hetimeve, mungesa e bashkëpunimit nga ana e ekspertëve mjeko-ligjorë nënkuptonte që autoritetet kishin qenë të paafta të jepnin një përgjigje koherente dhe shkencërisht të bazuar nëse vdekja e Adrianit kishte ndodhur aksidentalisht gjatë trakeotomisë, si pasojë e vonesës në procedurë, apo nga asfiksioni. Kjo pyetje ishte themelore për hetimet dhe do të kishte konstatuar nëse stafi i spitalit mbante përgjegjësi penale për neglizhencë mjekësore. Gjykata shënoi që autoritetet kishin kërkuar ndihmën e instituteve mjeko-ligjore. Megjithatë, këto institute kishin refuzuar të ndihmonin, duke ngulur këmbë që Akti ua ndalonte të zhvillonin ekzaminime të reja eksperte pasi Autoriteti Nacional Suprem i Mjekësisë Ligjore tashmë e kishte dhënë opinionin e vet dhe/ose nuk kishin dalë në pah prova të reja.

Më tej, gjetja e Gjykatës Krahinore në VENDIMIn e saj të 8 shkurtit 2005 që provat merrnin vlera vërtetuese kur nuk mund të zëvendësoheshin më nga prova të reja ose të hidheshin poshtë nga prova të tjera me të njëjtën vlerë shkencore ishte në kundërtënie të drejtpërdrejtë me detyrimin e nënkuptuar sipas Nenit 2 për të marrë hapa drejt hartimit të një raporti të plotë të fakteve dhe një analize objektive të gjetjeve klinike. Ekzistenca e një dispozite ligjore që autorizonte institutet mjekësore ligjore për të injoruar kërkesat nga autoritetet gjyqësore që të bashkëpunonin për qëllime hetimore nuk ishte në përputhje me detyrën parësore të Shtetit për të mbrojtur të drejtën e jetës. Kjo detyrë përfshinte zbatimin e një kornize ligjore dhe administrative për të konstatuar shkakun e vdekjes së pacientëve në duart e profesionistëve mjekësorë.

Sa u përket arsyeve të dhëna në opinionet e ekspertëve, raporti i parë i 6 tetorit 2000 kishte shënuar qartë që protokollin mjekësor i ndihmës emergjente në spital

ishite jofunksional dhe shkaktoi vonesa në kryerjen e operacionit. Ky konkluzion u konfirmua, të paktën pjesërisht, pas rishikimit në raportin e dytë. Megjithatë, Autoriteti Nacional Suprem i Mjekësisë Ligjore, opinionet e të cilit bazoheshin vetëm mbi ato të instituteve të nivelit më të ulët, i refuzuan këto konkluzione pa arsye. Gjykata konsideroi që vetëm një raport i hollësishëm dhe shkencërisht i vërtetuar që shtjellonte drejt kundërtënit në opinionet e instituteve të nivelit më të ulët mund t'i ndihmonte autoritetet gjyqësore dhe të frymëzonte besimin e publikut në administrimin e drejtësisë. Detyrimi për të dhënë arsye në opinionin e tij shkencor ishte posaçërisht i rëndësishëm në rastin konkret meqenëse Akti i ndalonte institutet më të ulëta nga hartimi i raporteve të reja ose plotësimi i raporteve të kaluara pasi Autoriteti Nacional Suprem e kishte dhënë opinionin e vet. Përveç kësaj, palët ndërgjyqëse nuk e kishin të mundur të mbështeteshin në opinionet shkencore të dhëna nga institucione të tjera përveç institutet mjeko-ligjore të Shtetit që renditeshin në Akt. Regjimi i brendshëm i raporteve mjeko-ligjore duhet të kishte kërkuar që ekspertët të jepnin arsye për opinionet e tyre dhe të bashkëpunonin me organet gjyqësore për të rrejtosur besimin dhe efektivitetin në brendi të sistemit.

Më pas Gjykata konsideroi nëse sistemi gjyqësor nacional i kishte ofruar kërkueses zgjidhjet e duhura për të konstatuar përgjegjësinë e mjekut. Në lidhje me procedurat disiplinore të nisura nga kërkuesja, ajo gjeti që autoritetet kishin kërkuar formalizëm të tepruar pasi që ajo i kishte informuar si duhej të dy institucionet disiplinore për apelin e saj. Më tej, një apel drejtuar komisioneve disiplinore do të kishte qenë i kotë sepse Akti autorizonte institutet mjeko-ligjore që të refuzonin hartimin e një raporti pasi Autoriteti Nacional Suprem e kishte dhënë opinionin e vet. Në fund, një padi civile për kompensim do të kishte dështuar pa gjetjen e neglizhencës mjekësore nga hetimet e autoriteteve. Ndërkohë që kishte pasur ndryshime në rregulloret nacionale të shëndetësisë publike për llogaridhënien e mjekëve për rrejtqet e marra përsipër në praktikën mjekësore, ato nuk aplikoheshin në mënyrë retroaktive në rastin e kërkueses.

Në përfundim, për arsyet e mësipërme, në mënyrë të veçantë për pamundësinë e autoriteteve për të konstatuar në mënyrë konkluzive shkakun e vdekjes së Adrianit dhe përgjegjësinë korresponduese të mjekëve të tij, Gjykata vendosi që kishte pasur shkelje të aspektit procedural të Nenit 2.

Neni 41

Gjykata i caktoi kërkueses 20,000 Euro në lidhje me dëme jomateriale dhe 296 Euro për kosto dhe shpenzime.

Paraburgimi i zgatur dhe i pajustificuar i kërkuesit në një qendër mbajtjeje të imigrantëve në kushte jo-higjienike dhe të mbingarkuara me njerëz, dhe mbajtja e panevojshme në karantinë për Covid-19, u gjet se kishin shkelur Nenet 5 § 1 dhe 3

VENDIMI NË ÇËSHTJEN FEILAZOO K. MALTËS

(Kërkesa Nr. 6865/19)

11 mars 2021

1. Faktet kryesore

Kërkuesi, Joseph Feilazoo, ishte shtetas nigerian i lindur në vitin 1975 që jetonte në Safi (Maltë). Në shkurt të vitit 2010, ai u deklarua fajtor për akuza në lidhje me drogë dhe u dënua me 12 vjet burg dhe me gjobë, si dhe iu kërkua të paguante kostot. Në pamundësi për të paguar gjobën dhe kostot, kërkuesi mori një dënim shtesë me 22.5 muaj burg.

Pak ditë para lirimit të tij, kërkuesi informoi zyrtarët e imigracionit se ai dëshironte të kthehej në Spanjë meqenëse kishte leje qëndrimi. Megjithatë, autoritetet spanjolle u supozua se refuzuan ta praninin kërkuesin. Përkundrazi, në datën e lirimit të tij (10 prill 2018) kërkuesit iu tha se ai do të vazhdonte të mbahej në pritje të largimit për në Nigeri dhe se ishte vlerësuar si imigrant i ndaluar sipas të drejtës malteze. U supozua se kërkuesi u bë agresiv gjatë këtij takimi, ku i rezistoi arrestit dhe u shkaktoi lëndime trupore dy oficerëve korrektues. Kërkuesi u dërgua në spital; siç u shënuar në raportet eksperte, ai pësoi disa lëndime përfshirë traumë të fortë në kokë dhe fytyrë.

Filluan hetimet në lidhje me sulmin ndaj oficerëve korrektues. Më 11 prill 2018, kërkuesi u mor në pyetje në lidhje me incidentin e 10 prillit 2018 pa praninë e avokatit, e rrjedhimisht ai refuzoi të firmoste deklaratën rezultuese. Në shkurt të vitit 2019, kërkuesi u gjet fajtor për disa akuza sulmimi dhe u dënua me dy vjet burg dhe gjobë, si dhe u urdhërua të paguante kostot. U urdhërua deportimi i tij i menjëhershëm (pas pagimit të gjobës), por gjoba u konvertua në gjashtë muaj burg për shkak të pamundësisë së tij për të paguar. Gjatë kohës së qëndrimit në burg, kërkuesi pretendoi se ai u lëviz nga një regjim sigurie në tjetrin disa herë për të penguar qasjen e tij në ndihmë ligjore dhe ecurinë e kërkesës së tij në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Përveç kësaj, ai pretendoi se atij iu mohua qasja në dokumentacionin e tij mjekësor, dhe se pati ndërhyrje në korrespondencën e tij me Gjykatën. Megjithëse u lirua më 14 shtator 2019, kërkuesi u vu menjëherë

në mbajtje si imigrant në kazeramat e Safit ku qëndroi deri në nëntor 2020. Në një moment të caktuar, kërkuesi u vendos me personat që ishin të karantinuar me Covid-19, me sa duket pa asnjë arsye. Autoritetet nigeriane refuzuan të lëshonin dokument udhëtimi, duke penguar kështu deportimin e kërkuesit.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi pretendoi shkelje të nenit 3 (ndalimi i trajtimit çnjerëzor dhe poshtëruës), 5 (e drejta për liri dhe siguri) dhe 34 (e drejta për kërkesë individuale) të Konventës.

Neni 3

Kërkuesi pretendoi shkelje të shumta të nenit 3: i) se kundër tij ishte përdorur forcë e tepruar; ii) se nuk ishin zhvilluar hetimet përkatëse; iii) se Qeveria kishte dështuar ta mbronte; dhe iv) se kushtet e paraburgimit në qendrën e mbajtjes së imigrantëve përbënin trajtim çnjerëzor dhe poshtëruës. Tri ankesat e para u vlerësuan të papranueshme mbi bazën se kërkuesi nuk i kishte shteruar zgjidhjet në vend.

Për sa i përket ankesës së katërt, kërkuesi parashtrroi se kazeramat e Safit, ish-kazerma ushtrie, nuk ishin ndërtuar me qëllim të strehimit të azilkërkuesve si ai dhe se autoritetet kishin dështuar të mbronin mirëqenien e tij mendore dhe fizike. Ai tha, *inter alia*, që ai kishte fjetur në një dyshek në kushte të mbingarkuara me njerëz (pretendim i mbështetur me prova fotografike), me probleme të mëdha për shkak të insekteve dhe përgatitje jo-sanitare të ushqimit, dhe se ai ishte mbajtur në një kontejner pa dritë natyrale për afro 75 ditë, 40 prej të cilave ai ishte mbajtur në izolim *de facto* pa mundësi ushtrimesh. Pasi u ankua për këto kushte, ai u lëviz në ambiente të tjera qëndrimi të cilat, siç e mori vesh ai më pas, përdorshin për personat që arrinin në vend me Covid-19 dhe viheshin në karantinë.

Gjykata kujtoi se, për të hyrë brenda fushëveprimit të nenit 3, keqtrajtimi duhet të arrijë një shkallë minimale rreptësie, vlerësimi i së cilës varet nga të gjitha rrethanat e çështjes. Shtetet duhet të sigurohen që një person të mbahet në kushte të cilat janë në përputhje me respektin për dinjitetin njerëzor, dhe se individi nuk i nënshtrohet shqetësimit ose vështirësive në një shkallë intensiteti që e tejkalon nivelin e pashmangshëm të vuajtjes që ngërthen paraburgimi. Gjatë vlerësimit të kushteve, duhet të merren parasysh efektet e tyre kumulative dhe pretendimet specifike, si dhe kohëzgjatja e periudhës.

Gjykata shqyrtoi parashtrimet në kundërshti të kërkuesit dhe Qeverisë, duke theksuar se në çështjet që kanë të bëjnë me pretendime për kushte të papërshtatshme të paraburgimit nuk aplikohet parimi *affirmanti incumbit probatio* (ai që pretendon diçka duhet ta vërtetojë atë pretendim) sepse në raste të tilla vetëm Qeveria e paditur normalisht ka qasje në informacione të cilat do të mund t'i vërtetonin ose t'i hidhnin poshtë këto pretendime.

Gjykata theksoi se, ndërkohë që kërkuesi kishte paraqitur prova fotografike, Qeveria u mbështet në deklarata të përgjithësuara dhe të pavërtetuara. Mungesa e të dhënave të mjaftueshme në lidhje me numrin e të mbajturve e pengoi Gjykatën nga nxjerrja e përfundimeve në lidhje me mbingarkesën me njerëz. Megjithatë, ajo vazhdoi të ishte e shqetësuar në lidhje me elementet e ndryshme të pakundërshtuara të pretendimeve të kërkuesit, në mënyrë të veçantë vendosja e tij në kontejner për afro 75 ditë. Gjykata gjeti se, ndërkohë që vendosja në kontejner mund të mos përbëjë trajtim çnjerëzor dhe poshtëruar, kushtet në këtë rast ishin veçanërisht shqetësuese duke pasur parasysh nxehësinë, dritën dhe ventilimin e pamjaftueshëm, qasjen e kufizuar në ushtrime (nëse kishte), qasjen e kufizuar në përdorimin e telefonit të tij, dhe faktin që ai ishte mbajtur në izolim për 40 ditë.

Për më tepër, nuk kishte asnjë tregues të nevojës për ta vendosur kërkuesin në ambientet e personave të karantinuar me Covid-19, sidomos duke ditur faktin që ai tashmë kishte qenë në izolim gjatë shtatë javëve të mëparshme. Masa e pajustificuar e vendosjes së tij për javë të tëra në ambiente të përbashkëta me persona të cilët paraqisnin rrezik për jetën e tij nuk mund të shihej si diçka që ishte në përputhje me kriteret sanitare bazë. Duke marrë parasysh efektin kumulativ të të gjithë këtyre faktorëve, Gjykata arriti në përfundimin se kishte pasur shkelje të nenit 3.

Neni 5 § 1

Kërkuesi u ankua se disa periudha të paraburgimit të tij ishin të paligjshme meqenëse nuk kishte gjasa për deportimin e tij, gjë që nuk ishte trajtuar zellshëm siç kërkohet nga neni 5 § 1(f). Gjykata përsëriti se neni 5 ngërthente mbrojtjen e individit nga ndërhyrja arbitrare e Shtetit tek e drejta e tij/saj për liri, dhe që në mospajtim me parashtrimin e Qeverisë që periudha e paraburgimit që nisi më 15 shtator 2019 kishte për qëllim deportimin e kërkuesit. I vetmi hap i dukshëm që u mor drejt deportimit ishte një letër e vetme dërguar autoriteteve nigeriane pas kërkesës së tij fillestare për lëshimin e një dokumenti udhëtimi. Qeveria u

gjet se nuk kishte vepruar zellshëm gjatë 14 muajve vijues, dhe prandaj arsyet për paraburgimin e kërkuesit nuk kishin qenë të vlefshme gjatë tërë periudhës. Rrjedhimisht, kishte pasur shkelje të nenit 5 § 1.

Neni 5 § 2 / Neni 6

Kërkuesi gjithashtu u ankua sipas nenit 5 § 2 se ai nuk kishte pasur avokat gjatë marrjes së tij në pyetje më 11 prill 2018, megjithatë Gjykata konsideroi se kjo ankesë hynte brenda nenit 6 §§ 1 dhe 3 (c). Ankesa u vlerësua e papranueshme mbi bazën se kërkuesi nuk i kishte shteruar zgjidhjet në vend.

Neni 34

Kërkuesi pretendoi se Qeveria e kishte penguar të drejtën e tij për kërkesë para Gjykatës duke ndërhyrë në korrespondencën e tij me Gjykatën dhe duke penguar qasjen e tij në përfaqësim efektiv me anë të ndihmës ligjore në vend.

Në lidhje me të parën, Gjykata kujtoi se neni 34 kërkon që kërkuesit ose kërkuesit potencialë të jenë në gjendje të komunikojnë lirshëm me organet e Konventës, pa iu nënshtruar asnjë forme të presionit nga autoritetet për të tërhequr ose rishikuar ankesat. Konfidencialiteti i korrespondencës me organet e Konventës duhet të respektohet meqenëse ai mund të ketë lidhje me pretendimet kundër zyrtarëve ose autoriteteve të burgut. Në rastin konkret, Gjykata konsideroi se mënyra se si kërkuesit i ishte përcjellur korrespondenca nga Gjykata përmes avokatit të ndihmës ligjore me anë të emailave drejtuar personelit të qendrës së paraburgimit nënkuptonte se korrespondenca e tij nuk ishte trajtuar me konfidencialitet. Autoritetet gjithashtu dështuan të siguronin që kërkuesit t'i ofrohej mundësia e marrjes së dokumentacionit për të vërtetuar kërkesën e tij. Prandaj, kishte pasur ndërhyrje të pajustificuar tek e drejta e kërkuesit për kërkesë individuale.

Në lidhje me të dytën, Gjykata gjithashtu gjeti se përfaqësimi i kërkuesit nga ndihma ligjore në vend kishte qenë i pamjaftueshëm duke pasur parasysh, në mënyrë të veçantë, mungesën e kontakteve të rregullta avokat-klient (pavarësisht nga kërkesat e Gjykatës), mungesën e zellit nga ana e avokatit në trajtimin e çështjes dhe mos-veprimi nga ana e Qeverisë (me të cilin kishin të bënin veprimet e avokatit të ndihmës ligjore falas në vend) për të zgjidhur situatën.

Kështu, kishte pasur shkelje të së drejtës së kërkuesit për kërkesë individuale sipas nenit 34.

Neni 41

Gjykata urdhëroi që Qeveria t'i paguajë kërkesit 25,000 euro në lidhje me dëme jomateriale.

Ankesat kundër paraburgimit paragjyqësor dhe pezullimit të procedurave gjyqësore gjatë pandemisë Covid-19 u shpallën të papranueshme

Kushtet e paraburgimit të të dyshuarit gjatë pandemisë Covid-19 nuk përbënë shkelje të neneve 2 ose 3

VENDIMI PËR PRANUESHMËRINË DHE THEMELIN NË ÇËSHTJEN FENECH K. MALTËS

(Kërkesa Nr. 19090/20)

Vendimi për pranueshmërinë 23 mars 2021

Vendimi për pranueshmërinë dhe themelin 1 mars 2022

1. Faktet kryesore

Kërkuesi, z. Yorgen Fenech, ishte shtetas maltez i lindur në vitin 1981. Ai ishte biznesmen dhe ish-kryetar i Tumas Group (kompani e madhe e zhvillimit të patundshmërisë në Maltë). Më 20 nëntor 2019, ai u arrestua në jahtin e tij për shkak të dyshimeve rreth përfshirjes së tij në vrasjen e gazetares malteze Daphne Caruana Galizia, në tetor 2017. Në të njëjtën ditë ai u lirua me dorëzani.

Më 30 nëntor, kërkuesi doli para Gjykatës së Magjistratëve dhe u akuzua për promovimin, organizimin ose financimin e një organizate me qëllim të kryerjes së një veprë penale, dhe pjesëmarrje në vrasje të vullnetshme. Kërkuesi u deklarua jo fajtor, u dërgua në paraburgim dhe u mbajt në Qendrën e Korrektimit Corradino (CCF). Në CCF, kërkuesi u vendos në izolim vetmitar nga 30 nëntori 2019 deri më 3 janar 2020, meqenëse testoi pozitiv për kokainë. Ishte politikë e CCF-së që të mos lejonte të burgosurit që dilnin pozitiv në testin e drogës të përziheshin me të tjerët deri kur të testonin negativ.

Më 18 dhjetor 2019 kërkuesi bëri kërkesë për dorëzani. Gjykata e Magjistratëve e refuzoi kërkesën për shkak të rreziqeve që paraqiste lirimi i kërkuesit, siç ishte manipulimi i provave dhe ndërhyrja në proceset e drejtësisë. Kërkuesi bëri një kërkesë të dytë për dorëzani më 30 janar 2020, e cila po ashtu u refuzua sepse u vlerësua se ende ekzistonte rreziku i manipulimit të rrjedhës së drejtësisë. Ai rrezik ishte bërë edhe më domethënës dhe ishte i mjaftueshëm për të refuzuar lirimin me dorëzani. Procedurat e mbajtjes u shtynë për 27 mars 2020.

Më 13 mars 2020, për shkak të krizës së Covid-19 në Maltë, Mbikqyrësi i Shëndetit Publik deklaroi, përmes një Shpalljeje Ligjore, që Malta ishte në kushtet e emergjencës shëndetësore publike. Në të njëjtën ditë, Departamenti maltez i Informimit publikoi Shpalljen Ligjore Nr. 65 të vitit 2020, për 'Urdhrin për Mbylljen e Gjykatave të Drejtësisë' dhe Shpalljen Ligjore Nr. 61 të vitit 2020, për 'Urdhrin për Epidemitë dhe Sëmundjet Infektive (Pezullimi i Periudhave Ligjore dhe Gjyqësore), 2020', ("Masat Emergjente"). Në përmbledhje, Masat Emergjente mbyllën gjykatat e drejtësisë dhe kancelarinë e gjykatave duke nisur nga data 16 mars 2020, dhe pezulluan zhvillimin e të gjitha periudhave/afateve ligjore ose gjyqësore si dhe çdo periudhë tjetër kohore sipas të drejtës substanciale ose procedurale. Rregullorja 3 e Shpalljes Ligjore Nr. 61 e vitit 2020 parashikonte pushtetin e gjykatës për të hapur kancelarinë e saj, dëgjimin e çështjeve, çdo gjë tjetër që kishte lidhje me pasojat dhe aspektet shoqëruese në çështje urgjente ose në çështje ku vlerësohej se duhet të mbizotëronte interesi publik për dëgjimin e çështjes, duke iu nënshtruar mbrojtjeve për mbajtjen nën kontroll të epidemive të rrezikshme ose sëmundjeve infektive. Këto masa do të ishin në fuqi deri në shtatë ditë pas heqjes së këtyre urdhrave të Mbikqyrësit.

Më 1 prill 2020, avokatët e kërkuarit depozituan një kërkesë *habeas corpus* para Gjykatës Penale. Kërkuarisi u ankua, *inter alia*, që vendimi për të pezulluar të gjitha procedurat penale për një kohë të pacaktuar përbënte pezullim *side die*, çka nënkuptonte se kërkuarisi nuk do të gjykohej brenda një kohe të arsyeshme përderisa ishte në paraburgim. Gjykata Penale e refuzoi kërkesën e kërkuarit, duke theksuar se kërkuarisi nuk kishte bërë kërkesë për vazhdimin e procedurave të tij, një mbrojtje e parashikuar nga Rregullorja 3 e Shpalljes Ligjore nr. 61 të vitit 2020. Prandaj kërkesat e kërkuarit ishin të parakohshme dhe të pabazuara, duke pasur parasysh që ai kishte qasje në zgjidhje të tilla dhe kërkesat e tij për lirim me dorëzani ishin dëgjuar dhe refuzuar, duke e bërë paraburgimin e tij të nevojshme në këto rrethana. Për më tepër, edhe pse Malta nuk kishte bërë derogim sipas nenit 15 të KEDNJ-së, e drejta e lirisë nuk ishte e drejtë absolute në kushtet e gjendjes së emergjencës siç ishte pandemia Covid-19, e cila ishte emergjencë ndërkombëtare.

Më 6 prill 2020, kërkuarisi paraqiti kërkesë për dorëzani para Gjykatës Penale, e cila u refuzua. U theksua se kërkuarisi ishte akuzuar për një vepër të rëndë dhe ishte paraqitur në gjykatë vetëm para katër muajsh, kohë gjatë së cilës procedurat ishin dëgjuar me ritëm të përsheptuar. Rrethanat nuk kishin ndryshuar dhe rreziqet nuk ishin zhdukur për shkak të mbylljes së gjykatave. Kërkuarisi ende mund të bënte kërkesë sipas Rregullores 3 të Shpalljes Ligjore Nr. 61 të vitit 2020 për rifillimin e procedurave të tij.

Më 8 prill 2020, kërkuesi bëri kërkesë sipas Rregullores 3 të Shpalljes Ligjore Nr. 61 të vitit 2020 për rifillimin e procedurave të përmbledhjes së provave nga Gjykata e Magjistratëve dhe dëgjimin e provave. Gjykata Penale e refuzoi këtë kërkesë, duke theksuar kriterin procedural që kërkonte praninë e palëve, çka do të vinte një numër të konsiderueshëm personash brenda një hapësire të kufizuar për një periudhë të konsiderueshme kohore. Përveç kësaj, mungonte infrastruktura dixhitale për mbajtjen e procedurave në mënyrë elektronike. Kështu, duke balancuar interesin publik, urgjencën e çështjes dhe rrezikun e kontaminimit, duhet të mbizotëronte shëndeti publik i të gjithë personave të përfshirë në procedura.

Më 16 prill 2020, kërkuesi bëri një kërkesë tjetër për dorëzani, duke ngritur çështjen e pezullimit *sine die* të procedurave gjyqësore dhe rrezikun e marrjes së Covid-19 gjatë qëndrimit në burg, ku të gjitha këto shkelnin të drejtën e tij të jetës dhe lirisë nga keqtrajtimi. Ai gjithashtu theksoi gjendjen e tij shëndetësore, humbjen e mëparshme të veshkës, si rrezik shëndetësor i konsiderueshëm po të infektohej me Covid-19. Kjo kërkesë u refuzua më 21 prill. Gjykata Penale mori në konsideratë faktorë të shumtë siç janë, *inter alia*, pësia e veprës dhe rreziku i ndikimit të dëshmitarëve. Më tej, ajo theksoi se kishte tregues specifikë të kriterit real të interesit publik i cili peshonte më shumë sesa rregulla e respektimit të lirive individuale. Në mënyrë të veçantë, vrasja kishte të bënte me vdekjen e një gazetareje hulmuese me bombë në makinë gjatë një periudhe shumë specifike në një kontekst historik dhe socio-politik. Vrasja kishte pasur impakt në nivel ndërkombëtar dhe kishte tërhequr vëmendjen e medias dhe reagime nga organizata si Këshilli i Evropës. Më tej, mbyllja e gjykatës si reagim ndaj pandemisë Covid-19 ishte e justifikuar për arsye shëndetësore dhe ishte vetëm masë e përkohshme. Megjithatë, Gjykata Penale organizoi zhvillimin e të paktën pjesës së fundit të procedurave në çështjen e kërkuesit në formë virtuale. Përfundimisht, dorëzania nuk u pranua sepse ndryshimet e rrethanave të kërkuesit ishin minimale.

Me vendimin e datës 19 maj 2020, Gjykata Penale autorizoi vazhdimin e procedurave penale të kërkuesit. Në kohën e vendimit të Gjykatës Evropiane për pranueshmërinë dhe themelin, procedurat ishin duke vazhduar dhe kërkuesi ndodhej ende në paraburgim në CCF. Sipas mendimit të kërkuesit, kushtet e paraburgimit të tij në CCF ishin jo-sanitare dhe të pashëndetshme, sidomos sa i përkiste stërmbushjes me njerëz, mungesës së rrobave të pastra dhe të ngruhta, dhe ushtrimeve shumë të kufizuara fizike. Ai po ashtu konsideroi se Shteti kishte dështuar të merrte masa të përshtatshme për ta mbrojtur atë nga infektimi me

Covid-19 gjatë qëndrimit në burg pavarësisht se gjendja e tij shëndetësore – humbja e mëparshme e veshkës – e vinte atë në rrezik të shtuar dhe zvogëlonte shanset e tij për ta tejkaluar Covid-19 sikur të infektohej.

Kërkuesi filloi procedura kushtetuese para Gjykatës Civile më 1 maj 2020, duke kërkuar deklarimin e shkeljeve të neneve 5 § 1 (c) dhe 5 § 3 dhe 5 § 4 të Konventës, dhe kërkoi që gjykata ta lironte. Megjithëse Gjykata Civile e shkallës së parë deklaroi se të drejtat e kërkuesit sipas nenit 5 ishin shkelur, ky vendim u rrëzua në apel nga Gjykata Kushtetuese më 23 nëntor 2020.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi u ankua sipas neneve 2 dhe 3 të Konventës në lidhje me kushtet e mbajtjes në paraburgim dhe dështimin e Shtetit për të mbrojtur shëndetin e tij gjatë qëndrimit në burg, në mënyrë të veçantë për shkak të gjendjes së tij shëndetësore. Ai u ankua sipas neneve 5 §§ 1, 3 dhe 4 të Konventës në lidhje me ligjshmërinë e paraburgimit të tij dhe zgjidhjet përkatëse. Në fund, duke u mbështetur tek neni 6 § 1, kërkuesi u ankua se ishte privuar nga e drejta për qasje në gjykatë dhe në gjyq brenda një kohe të arsyeshme.

Vendimi për Pranueshmërinë

Nenet 2 dhe 3

Gjykata vendosi ta paralajmëronte Qeverinë e paditur për ankesat e kërkuesit sipas neneve 2 dhe 3.

Nenet 5 § 1 dhe 5 § 3

Duke u mbështetur tek neni 5 § 1 (c) dhe neni 5 § 3, kërkuesi u ankua se Masat Emergjente që ishin vendosur dhe ekzekutimi i tyre nuk kishin qenë qartë të definuara dhe të parashikueshme.

Në lidhje me nenin 5 § 1 (c), Gjykata vlerësoi nëse qëllimi i paraburgimit të vazhduar të kërkuesit ishte që ai të sillej para një “autoriteti ligjor kompetent” në përputhje me nenin 5 § 1 (c). Gjykata konsideroi se thjesht fakti që Masat Emergjente të vendosura në lidhje me pandeminë Covid-19 kishin pezulluar procedurat *sine die*, nëse nuk autorizoheshin, nuk nënkuptonin që prokuroria nuk synonte ta sillte kërkuesin para një autoriteti ligjor kompetent. Përveç kësaj,

pezullimi ishte në fuqi për më pak se tre muaj. Rrjedhimisht, Gjykata e refuzoi kërkesën sipas nenit 5 § 1 (c) si të papranueshme.

Në lidhje me nenin 5 § 3, Gjykata theksoi se kërkuesi kishte bërë katër kërkesa për dorëzani, të cilat ishin vendosur me shpejtësi nga gjykatat vendase pavarësisht nga mbyllja e gjykatave. Secili vendim në lidhje me dorëzanimin përmbante hollësi rreth bazave të vendimeve duke marrë parasysh zhvillimet e situatës dhe deklaronte nëse dhe përse bazat origjinale vazhdonin të ekzistonin pavarësisht nga koha e shkurtër mes kërkesave për dorëzani. Rrjedhimisht, Gjykata e refuzoi kërkesën sipas nenit 5 § 3 si të papranueshme.

Neni 5 § 4

Duke u mbështetur në nenin 5 § 4, kërkuesi u ankua se Gjykata Penale, me dekretin e saj të 2 prillit 2020, kishte refuzuar të merrte në shqyrtim ligjshmërinë e paraburgimit të tij.

Gjykata theksoi se, në përputhje me nenin 5 § 4, një i paraburgosur ka të drejtë t'i kërkojë "gjykatës" që ka juridiksion për të vendosur "me shpejtësi" nëse privimi i tij nga liria është bërë apo jo "i paligjshëm" për shkak të faktorëve të rinj që kanë dalë në dritë pas vendimit fillestar për të urdhëruar vendosjen e tij në paraburgim. Gjykata deklaroi se vendimi i Gjykatës Penale e kishte trajtuar mjaftueshëm ankesën e kërkuetit duke u bazuar mbi argumentet në kërkesën e tij të dorëzimit dhe kishte shkuar më tej duke mbuluar çështje të natyrës substanciale dhe procedurale që kërkuesi nuk i kishte ngritur.

Rrjedhimisht, Gjykata vendosi që ankesa ishte dukshëm e pabazuar dhe duhet të refuzohet në përputhje me nenin 35 §§ 3 (a) and 4.

Neni 6

Duke u mbështetur tek neni 6 § 1, kërkuesi u ankua se ishte privuar nga e drejta e tij për qasje në gjykatë dhe gjyq brenda një kohe të arsyeshme.

Gjykata theksoi se, në atë pikë, procedurat kishin zgjatur gjashtë muaj, çka nuk ishte periudhë kohore e paarsyeshme duke pasur parasysh kompleksitetin e çështjes së kërkuetit. Kërkuesi nuk kishte paraqitur prova që autoritetet nuk po e ndiqnin çështjen e tij në mënyrë aktive ose që baza të tjera për t'i qortuar autoritetet për trajtimin që po i bënin çështjes së kërkuetit. Më tej, Gjykata

deklaroi se pezullimi i seancave dëgjimore për shkak të masave të emergjencës në Maltë gjatë pandemisë Covid-19 nuk e kishin dëmtuar të drejtën e kërkuarit për qasje në gjykatë.

Rrjedhimisht, Gjykata vendosi që ankesa ishte dukshëm e pabazuar dhe duhet të refuzohet në përputhje me nenin 35 §§ 3 (a) and 4.

Vendimi për Themelet

Neni 3

Në lidhje me vendosjen e kërkuarit në izolim vetmitar nga 30 nëntori 2019 deri më 3 janar 2020, Gjykata përsëriti se ndalimi i kontakteve me të burgosurit e tjerë për arsye sigurie, disiplinore ose mbrojtëse në vetvete nuk përbënte trajtim çnjerëzor ose ndëshkim poshtërues. Duhet të merren parasysh rrethanat e veçanta, rreptësia e masës, kohëzgjatja e saj, objektivi i synuar dhe efektet e saj tek personi në fjalë. Në rastin konkret, Gjykata theksoi se izolimi ishte vendosur për arsye sigurie dhe mbrojtjeje, periudha në fjalë nuk ishte më e gjatë se dyzet e pesë ditë, kërkuari nuk kishte pasur ndonjë efekt psikologjik apo fizik nga ajo, dhe kufizimet nuk kishin qenë privim shqisor i tërësishëm. Ndërkohë që Gjykata konsideroi se kërkuari duhet të ishte informuar me shkrim për këtë vendim, ajo nuk gjeti shkelje të nenit 3 në lidhje me këtë pikë.

Në lidhje me kushtet e fjetores në të cilën u lëviz kërkuari pas lirimimit të tij nga izolimi vetmitar, Gjykata përsëriti se ajo nuk mund të përcaktonte numrin specifik të sipërfaqes së metrave katrorë që duhet t'i lejohet një të paraburgosuri për të qenë në përputhje me nenin 3. Në vend të kësaj Gjykata reflektoi rreth faktorëve të tillë si kohëzgjatja e paraburgimit, mundësia për ushtrime përjashta, si dhe shëndeti fizik dhe mendor i të paraburgosurit. Gjykata konsideroi metodologjinë e Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës (ang. CPT) gjatë përcaktimit të hapësirës fizike minimale që duhet të ketë një i paraburgosur, kryesisht përfshirjen nga CPT të hapësirës për ushtrime përjashta. Në rastin konkret, kërkuari mund të lëvizte normalisht dhe kishte qasje në një oborr të vogël gjatë tërë ditës, si dhe në një oborr më të madh një orë në ditë. Ankesat e tjera të kërkuarit – përfshirë mungesa e veshjeve të pastra dhe të ngrohta, ventilimi i pamjaftueshëm, stërmbushja me njerëz – u konsideruan të pabazuara sepse atij iu dhanë veshje të holla pikërisht për shkak të rekomandimeve mjekësore specifike, në këmbim atij iu dhanë disa batanije dhe nuk u duk se vuante nga ndonjë shqetësim shëndetësor në lidhje me veshjet. Kërkuari po ashtu arriti të kërkonte më shumë batanije dhe

pati qasje në lavatriçe për veshjet e tij. Ankesat e kërkuetit rreth ventilimit të pamjaftueshëm ishin të pabazuara sepse ai pranoi që qelia ishte e pajisur me një dritare të madhësisë së arsyeshme. Në fund, Gjykata nuk gjeti prova që CCF ishte përgjithësisht e stërbushur me të burgosur, dhe kërkueti gjithmonë kishte qasje në oborrin ngjitur me fjetoren e tij.

Në lidhje me kufizimet e tjera, konkretisht qasja në palestër, takimet me familjarë, shkuarja në kishë dhe aktivitete të tjera, Gjykata theksoi se kufizimet e ankmuara kishin ndodhur brenda kontekstit shumë specifik të emergjencës shëndetësore publike, dhe ato kufizime ishin vendosur mbi tërë shoqërinë. Këto kufizime nuk duhet të konsiderohet se kanë shkaktuar tek kërkueti vështirësi të një intensiteti që e tejkalon shkallën e pashmangshme të vuajtjes së ngërthyer në paraburgim gjatë një pandemie. Rrjedhimisht, Gjykata gjeti se kushtet e paraburgimit të kërkuetit nuk ishin në shkelje të nenit 3.

Neni 2 i marrë me nenin 3

Ndërkohë që Gjykata nuk e përjashtonte aplikueshmërinë e nenit 2 në çështjet e lidhura me Covid-19, ai nuk ishte i aplikueshëm në rastin konkret. Kërkueti nuk ishte infektuar me Covid-19 dhe atij iu vu në dispozicion vaksinimi qysh prej prillit 2021. Edhe nëse do të supozohej infektimi i tij eventual, kërkueti nuk ofroi studime ose materiale që jepnin përgjigje të qartë nëse gjendja e tij do të ishte kërcënim për jetën, çka do të tërhiqte aplikueshmërinë e nenit 2.

Gjykata përsëriti se neni 3 cakton detyrimin pozitiv të Shteteve për të ruajtur shëndetin dhe mirëqenien e të burgosurve. Në tërësi, Gjykata deklaroi se autoritetet kishte zbatuar masa të përshtatshme dhe proporcionale për të parandaluar dhe përmbajtur përhapjen e virusit. Në mesin e masave të tjera, burgu ishte vendosur në mbyllje të brendshme (ang. lockdown) dhe ishin vënë masa të përgjithshme si dizinfektimi, maskat, kontrolli i temperaturës, testimi i të burgosurve dhe punonjësve të burgut për Covid-19 dhe zonat e karantinës për të burgosurit e dyshuar me Covid-19. Në lidhje me ankesën e kërkuetit se ai duhet të ishte mbrojtur më shumë sesa të burgosurit e tjerë, Gjykata pranoi se ndërkohë që duhet të merreshin masa për veçimin e disa të burgosurve më të ndjeshëm, kërkueti nuk kishte vërtetuar se ai hynte te kjo kategori.

Rrjedhimisht, Gjykata vendosi se nuk kishte pasur shkelje të nenit 3.

Dështimi sistemik për të mbrojtur shëndetin e të burgosurve dhe për t'u ofruar atyre kujdesin e duhur mjekësor në burg ka shkelur Nenin 3 dhe ka kërkuar marrjen e masave të përgjithshme dhe individuale sipas Nenit 46

VENDIMI NË ÇËSHTJEN GHAVTADZE k. GJEOGJISË

(Kërkesa Nr. 23204/07)

3 mars 2009

1. Faktet kryesore

Kërkuesi ishte i lindur në vitin 1982 dhe ishte i burgosur në Burgun Nr. 5 në Tbilisi. Ai u arrestua më 19 tetor 2006 dhe u dënua në apel me tetë vjet e gjashtë muaj burg. Ai afirmoi sidoqoftë se, megjithëse kishte qenë përdorues intravenoz i drogës, ai ishte në gjendje të mirë shëndetësore para arrestimit. Për të mbështetur këtë, ai paraqiti rezultatet e një analize gjaku të datës 10 tetor 2006 që tregonte mungesën e antitropave për hepatit B dhe C.

Gjatë vitit 2007 ai u shtrua në spital tri herë. Ai u shtrua në spitalin e burgut për herë të parë më 22 janar 2007 me dhimbje gjoksi, pështjellim, të vjellura, verdhëz, dhe ethe. Hepatologu e diagnostikoi me hepatit C akut, dhe konkludoi që ai kishte tre muaj me ethe dhe që verdhëza ishte shfaqur rreth një javë më parë. Pavarësisht nga trajtimi intensiv, gjendja e tij mbeti e rëndë dhe më 8 shkurt ai u diagnostikua me sindromën e kolestasis për të cilën mjeku i dha trajtim të mëtejshëm. Pavarësisht nga këto, ai u lirua dhe u kthye në burg më 10 shkurt pa autorizimin e mjekut.

Në burg, ai iu ankua Qendrës së Rehabilitimit për Viktimat e Torturës ("Empathy") për kushtet e padurueshme të burgimit të tij, dhe që ai vuante nga verdhëza, dobësia e përgjithshme, marramendja, vështirësitë në të ushqyer, pagjumësia, temperatura e lartë, dhimbjet në gjoks, dhe puçrrat në pjesë të ndryshme të trupit të tij. Ai u shtrua në spital për herë të dytë më 20 shkurt me kërkesë të mjekut të burgut. Atij iu dha trajtim për zgjebe dhe hepatit C. Në ndërkohë, një specialist i sëmundjeve infektive konkludoi që ishte e nevojshme të bëhej rezonanca magnetike (MRI) për të konstatuar shkakun e etheve të tij, të cilat kishin muaj që vazhdonin, por administrata e burgut refuzoi. Megjithëse iu bënë rrezet rëntgen (X-ray) të shpinës, ato nuk treguan shenja sëmundjeje. Megjithatë, X-ray të shpinës mund të tregojnë vetëm spondilitin në fazë të avancuar. Ai doli nga spitali më 31 mars. Ishte e paqartë nëse kjo u bë me autorizim të mjekëve të spitalit.

Ai u shtrua në spital për herë të tretë më 23 prill për pleurit, dobësi të skajshme, dështim i frymëmarrjes, dhe temperaturë të lartë. Mjeku e diagnostikoi me hepatit C subakut dhe pleurit tuberkular, për çka ai mori trajtim intensiv. Sipas opinionit të një specialisti të pavarur të hepatologjisë, avancimi i hepatitit C në kushte të vështira kishte shkaktuar imunodeficienë tek kërkuesi. Gjithashtu u gjet që kërkuesi e kishte marrë zgjeben dhe tuberkulozin në burg. Specialisti rekomandoi trajtim afatgjatë në poliklinikë për të siguruar përdorimin e trajtimit të përshtatshëm për hepatit dhe tuberkuloz. Duket se kjo nuk u bë. Trajtimi i tij përtej gushtit 2007 ishte i panjohur për Gjykatën deri në kohën e këtij VENDIMI.

2. Vendimi i Gjykatës

Duke u mbështetur në Nenin 3 të Konventës, kërkuesi u ankuar që ai kishte marrë sëmundje të ndryshme në burg dhe që shëndeti i tij ishte përkeqësuar për shkak të kushteve të burgimit dhe mungesës së kujdesit të duhur mjekësor.

Neni 3

Gjykata gjeti që mungesa e kujdesit të duhur mjekësor dhe burgosja e një personi të sëmurë në kushte të papërshtatshme, në parim, mund të përbënte shkelje të Nenit 3. Shtetet kishin detyrimin të organizonin sistemet e tyre penale në mënyrë të atillë që të respektonin dinjitetin njerëzor, pavarësisht nga vështirësitë praktike ose financiare.

Palët nuk e kontestuan që kërkuesit i duhej trajtim mjekësor për sëmundjet e tij. Megjithatë, Qeveria argumentoi që ai nuk kishte marrë asnjë sëmundje gjatë burgimit dhe që analiza e gjakut të kërkuesit e datës 10 tetor 2006 nuk mund të vërtetonte që ai e kishte marrë hepatitin C në burg sepse ai ishte arrestuar 9 ditë më pas. Palët gjithashtu ishin dakord që, për tre muaj para diagnozës së tij në janar 2007, kërkuesi kishte pasur ethe të vazhdueshme dhe nuk ishte mirë me shëndet. Megjithatë, nuk kishte prova të ndonjë përpjekjeje për të konstatuar shkakun e etheve të tij dhe as prova që ai kishte marrë ndonjë trajtim mjekësor.

Më tej, Qeveria nuk mundi të shpjegonte mungesën e përpjekjeve për të konstatuar gjenotipin e hepatitit C që ishte i nevojshëm për të caktuar trajtimin e duhur antiviral dhe për të siguruar shanset e kërkuesit për shërim. Autoritetet nuk e morën asnjëherë parasysh rekomandimin e specialistit për ta shtruar kërkuesin në poliklinikë. Në vend të kësaj, ato vendosën ta trajtonin tuberkulozin e tij dhe të pazonin trajtimin që synonte eliminimin e virusit të hepatitit C. Prandaj kujdesi mjekësor për hepatit C u gjet të ishte dukshëm i pamjaftueshëm. Kjo

pamjaftueshmëri, si dhe ndërprerjet e pajustificuara të shtrimit në spital, kishin lejuar avancimin e sëmundjes në fazë kronike.

Gjykata konsideroi që kërkuesi me gjasë e kishte marrë tuberkulozin gjatë qëndrimit në burg duke marrë parasysh rezultatet negative të një vizite me rreze rëntgen të marsit 2007, mungesën e higjienës në Burgun Nr. 5, dhe faktin që të burgosurit me tuberkuloz nuk ishin të ndarë prej të burgosurve të shëndetshëm. Ndërkohë që atij iu dha trajtim për eliminimin e infeksionit, nuk kishte prova që ishin bërë përpjekje për të parandaluar rikthimin e sëmundjes. Megjithatë trajtimi i tij për zgjebe ishte i mjaftueshëm, u vendos që burgu duhet të ketë pasur kushte rrënuese që ai të sëmuhej nga kjo sëmundje ngjitëse.

Nuk kishte justifikim për lëshimin e kërkuesit nga spitali dy herë. Këto ndërprerje nuk duke se kishin pasur miratimin e mjekëve të spitalit, dhe kthimi i tij në kushtet rrënuese të burgut duke qenë në shëndet të dobët e kishin bërë atë edhe më të prekshëm. Edhe sikur Gjykata të kishte pranuar argumentin e Qeverisë që sëmundjet e kërkuesit ishin shkaktuar nga imunodeficienca, kjo paraqiste edhe një arsye më shumë që autoritetet e burgut të vepronin në koordinim me mjekët.

Në fund, sipas pikëpamjes së Gjykatës, nuk ishte në pajtueshmëri me Nenin 3 që një i burgosur të shtrohej në spital kur simptomat e tij ishin në kulm dhe të lëshohej nga spitali para se të shërohej për t'u kthyer në një burg ku nuk ofrohej kujdes i mjaftueshëm. Prandaj, kishte shkelje të Nenit 3.

Neni 46

Numri i çështjeve që ishin në pritje para Gjykatës kundër Gjeorgjisë në lidhje me pamjaftueshmërinë e kujdesit mjekësor ndaj të burgosurve që vuanin nga sëmundje ngjitëse vinte në dukje një problem sistemik. Duhet të merreshin masat e nevojshme legjislative dhe administrative sa më shpejt që ishte e mundur për të parandaluar transmetimin e mëtejshëm të sëmundjeve ngjitëse brenda sistemit të burgut në Gjeorgji, dhe duhet të futej një sistem ekzaminimi para hyrjes në burg për të garantuar trajtimin e tyre të shpejtë dhe efektiv. Sa i përket rastit të kërkuesit, Shteti u urdhërua ta vendoste atë në një qendër që kishte mundësi t'i ofronte atij trajtimin e duhur mjekësor për hepatitin C krahas tuberkulozit.

Neni 41

Gjykata i caktoi kërkuesit 17 Euro për dëme materiale, 9,000 Euro për dëme jomateriale, dhe 1,639 Euro për kosto dhe shpenzime.

Mungesa e kujdesit mjekësor, futja në grackë dhe arsyetimi i pamjaftueshëm për paraburgimin e kërkuesit, i cili ishte HIV pozitiv dhe vuante nga disa sëmundje kronike dhe mendore, ka shkelur Nenet 3, 5 dhe 6

VENDIMI NË ÇËSHTJEN KHUDOBIN k. RUSISË

(Kërkesa Nr. 59696/00)

26 tetor 2006

1. Faktet kryesore

Kërkuesi ishte shtetas rus i cili ishte i lindur në vitin 1979 dhe jetonte në Moskë.

Më 29 tetor 1998 ai u thirr nga një informatore e fshehtë e policisë, e cila i kërkoi atij t'i gjente ca drogë. Kërkuesi pranoi dhe bleu 0.05 gram heroinë, të cilën e pagoi me paratë që ajo i dha atij. Kur u kthye tek vendi i takimit për t'ia dhënë atë asaj, ai u kap nga policia.

Të nesërmen atij iu ngarkuan akuza për trafikim droge dhe u vendos në paraburgim. Gjatë marrjes së urdhrat për paraburgim, prokurori iu referua rrethanave të kapjes së kërkuesit, peshës së akuzave kundër tij dhe rrezikut të fshehjes. Paraburgimi i tij u vazhdua më tej disa herë. Për ato vendime nuk u dha asnjë arsye.

Kur u arrestua kërkuesi, ai vuante prej disa sëmundjeve kronike, përfshirë epilepsi, pankreatit, hepatit viral B dhe C, si dhe sëmundje të ndryshme mendore. Gjithashtu ai ishte HIV pozitiv. Gjatë paraburgimit ai po ashtu mori edhe disa sëmundje të tjera të rënda si fruthi, brokiti dhe pneumonia akute. Njëkohësisht, ai pati edhe disa kriza epileptike. Shumë herë mbrojtja informoi gjykatën, administratën e qendrës së paraburgimit dhe autoritete të tjera shtetërore rreth problemeve të rënda shëndetësore që kishte ai dhe kërkoi ekzaminim të tërësishëm mjekësor, por pa sukses.

Më 27 korrik 1999 gjykata vendase vendosi që nevojitej një ekzaminim i ri i shëndetit mendor të kërkuesit. Ajo e pushoi çështjen dhe urdhëroi që kërkuesi të mbetej në burg në ndërkohë, pa dhënë asnjë arsye. Apeli i kërkuesit kundër atij vendimi nuk u dëgjua kurrë.

Seanca e parë dëgjimore mbi meritat u mbajt më 11 nëntor 1999 para Gjykatës së Rrethit. Kërkuesi nuk ishte i pranishëm. Avokati i kërkuesit kërkoi shtyrjen e

seancës sepse shumë dëshmitarë, përfshirë personi që i kishte shitur heroinën kërkuesit, si dhe policët e përfshirë në operacion, nuk ishin paraqitur. Gjykata e refuzoi këtë kërkesë dhe e gjeti kërkuesin fajtor për shitje të heroinës, por e liroi atë për shkak të gjetjeve në një raport psikiatrik ku thuhej se ai e kishte kryer krimin në gjendje çmendurie (insanity).

Gjatë gjyqit mbrojtja e kërkuesit argumentoi që, në kundërshtim me të drejtën ruse, kërkuesi ishte cytur të kryente vepër penale nga një informatore e policisë. Në apelin e tij, ai pretendoi që policia e kishte fabrikuar krimin dhe që rrëfimi ishte nxjerrë me forcë. Gjykata e Qytetit të Moskës e rrëzoi apelin më 11 janar 2000.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi pretendoi, në mënyrë të veçantë, që ai nuk kishte marrë trajtimin e duhur mjekësor në burg, që kushtet e paraburgimit të tij ishin çnjerëzore dhe poshtëruese, që paraburgimi i tij në pritje të gjyqit e kishte tejkaluar kohën e arsyeshme, që kërkesat e tij për lirim ose ishin shqyrtuar me vonesa të konsiderueshme ose nuk ishin shqyrtuar fare, dhe, në fund, që dënimi i tij ishte bazuar tërësisht mbi prova të marra si rezultat i provokimit të policisë. Ai u mbështet në Nenin 3, Nenin 5 §§ 3 dhe 4 dhe Nenin 6 § 1.

Neni 3

Gjykata shënoi që palët parashtruan versione të ndryshme të ndihmës mjekësore të marrë nga kërkuesi gjatë qëndrimit në qendrën e paraburgimit, dhe kujtuan që standardi përkatës për vlerësimin prej saj të provave ishte "përtej dyshimit të arsyeshëm". Aty ku ngjarjet në fjalë ndodhen tërësisht, ose në masë të madhe, brenda dijenisë ekskluzive të autoriteteve, siç është rasti i personave në paraburgim, dalin në pah presupozime të forta fakti në lidhje me lëndimet e ndodhura gjatë një mbajtjeje të tillë. Në raste të tilla, barra e provës bie mbi autoritetet të cilat duhet të ofrojnë shpjegime të kënaqshme dhe bindëse. Në mungesë të një shpjegimi të tillë, Gjykata mund të nxjerrë përfundime të cilat mund të jenë të pafavorshme për Qeverinë e paditur. Rrjedhimisht, ajo më tej shqyrtoi nëse barra e provës duhet të bjerë diku tjetër në çështjen në fjalë. Kërkuesi pretendoi që ai nuk kishte marrë trajtimin e përshtatshëm për sëmundjet e tij gjatë paraburgimit, por ai nuk paraqiti ndonjë dokument mjekësor që saktësonte natyrën e trajtimit që në fakt ka marrë, nëse ka marrë trajtim, gjatë kohës së paraburgimit.

Qeveria nuk e mohoi që kërkuesi kishte vuajtur nga sëmundje kronike dhe të meta mendore në momentin e arrestimit. Prandaj u shënua që, në përputhje me rekomandimet e Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Dënimit Çnjerëzor ose Poshtëruës, autoritetet duhet të kishin mbajtur dosje për gjendjen e tij shëndetësore dhe për çdo trajtim të dhënë gjatë paraburgimit. Njëkohësisht u ngritën shqetësime në lidhje me përkeqësimin e menjëhershëm të shëndetit të tij gjatë qëndrimit në paraburgim, gjë që ngriti dyshime rreth përshtatshmërisë së trajtimit mjekësor në dispozicion. Më tej u shënua që kërkuesi paraqiti ankesat e tij para autoriteteve në një kohë kur, me arsye, do të pritej prej tyre që të mund të merrnin masat e duhura, dhe që babai i tij gjithashtu kërkoi ekzaminim mjekësor të pavarur të paktën dy herë. Gjykata e gjeti alarmant faktin që këto kërkesa u refuzuan, dhe që ekzaminimet ishin të mundura vetëm me iniciativën e autoriteteve hetimore. Po ashtu u theksua me shqetësim të veçantë një incident i 16 prillit 1999, kur kërkuesi pretendoi se shoku i tij i qelisë u desh të administronte një injeksion për të ndalur një krizë. Tregimi i kërkuesit mbi rrjedhën e ngjarjes u pranua sepse ai paraqiti një dëshmi të firmosur nga shokët e qelisë, dhe Qeveria nuk paraqiti prova për të kundërtën. Një ndihmesë e tillë nga persona të pakualifikuar nuk mund të shihej si e mjaftueshme.

Përgjithësisht, faktorët e mësipërm ishin në favor të akuzave të kërkuesit që kujdesi mjekësor në qendrën e paraburgimit ishte i pamjaftueshëm. Në këto rrethana, i takonte Qeverisë t'i refuzonte ato. Megjithatë, ajo nuk paraqiti ndonjë dokument që shpjegonte se çfarë lloj trajtimi i ishte dhënë kërkuesit. Në realitet, parashtrësat e saj me shkrim ishin të turbullta dhe të argumentuara dobët. Prandaj u pranua tregimi i kërkuesit.

Gjykata pranoi që ndihma mjekësore në dispozicion nëpër spitalet e burgjeve mund të mos jetë gjithmonë në të njëjtin nivel si në institucionet më të mira mjekësore për publikun e përgjithshëm. Pavarësisht nga kjo, Shteti duhet të sigurohet që shëndeti dhe mirëqenia e të burgosurve të sigurohen mjaftueshëm, mes të tjerash, duke i ofruar atyre ndihmën e kërkuar mjekësore. U shënua që kërkuesi vuante prej shumë sëmundjeve kronike, ishte HIV pozitiv, dhe vuante nga një çrregullim i rëndë mendor, edhe pse asgjë nuk sugjeronte se statusi i tij parimisht ishte në shpërputhje me paraburgimin. Në këto rrethana, mungesa e ndihmës së kualifikuar dhe të kohshme, plus refuzimi i autoriteteve për të lejuar ekzaminimin e pavarur mjekësor të gjendjes së tij shëndetësore, ka krijuar një ndjenjë kaq të fortë pasigurie saqë, në kombinim me vuajtjet e tij fizike, Gjykata gjeti që përbënte trajtim poshtëruës. Prandaj Gjykata deklaroi që kishte pasur shkelje të Nenit 3.

Duke pasur parasysh këtë, u konsiderua e panevojshme të shqyrtohej ankesa e kërkuesit rreth kushteve të përgjithshme të paraburgimit të tij ndaras.

Neni 5 § 3

Gjykata vuri në dukje se fuqia e saj për të shqyrtuar gjetjet e gjykatave vendase në këtë kontekst ishte e kufizuar: vetëm nëse arsyetimi ishte arbitrar ose i mungonte baza faktike atëherë ajo mund të ndërhynte dhe të gjente që paraburgimi ishte i pajustificuar.

Ajo shënoi arsyet e dhëna për urdhrin fillestar të paraburgimit më 30 tetor 1998. Megjithatë, ajo vërejti që gjykatat vendase nuk kishin dhënë arsye për vazhdimin e paraburgimit ose për rrëzimin e disa kërkesave për lirim të depozituara nga mbrojtja. Ajo rikujtoi që pesha e veprës në vetvete nuk mund të shërbente për të justifikuar periudha të gjata paraburgimi në pritje të gjyqit, e as nuk mund të përdorej për t'i paraprirë një dënimi me burg. Më tej ajo vërejti që autoritetet nuk kishin marrë parasysh faktorë të rëndësishëm, si mosha e re e kërkuesit, problemet e tij shëndetësore, mungesa e dënimeve të mëparshme, fakti që ai kishte një vendbanim të përhershëm dhe marrëdhënie familjare të qëndrueshme. Dukej se kjo mungesë arsyetimi nuk ishte e rastësishme ose harresë afatshkurtër, por një mënyrë e zakonshme për trajtimin e kërkesave për lirim.

Gjykata arriti në përfundimin që paraburgimi i kërkuesit, që zgjati një vit e 23 ditë, nuk ishte i justifikuar nga arsye "relevante dhe të mjaftueshme" dhe prandaj vendosi që kishte pasur shkelje të Nenit 5 § 3.

Neni 5 § 4

Gjykata rikujtoi që kishte dy aspekte të kriterit të "shpejtueshmërisë", ku të dyja vlerësoheshin nën dritën e rrethanave të secilës çështje: së pari, mundësia për shqyrtim ligjor duhet të ofrohet shpejt pas marrjes së personit në mbajtje dhe, nëse nevojitet, në intervale të arsyeshme prej aty e tutje. Së dyti, procedurat e shqyrtimit duhet të zhvillohen me zellin e duhur.

Gjykata gjeti që shqyrtimet e kërkesave për lirim ishin vonuar në mënyrë të paduhur. Duke pasur parasysh këto gjetje, Gjykata deklaroi që kishte pasur shkelje të Nenit 5 § 4.

Neni 6 § 1

Gjykata shënoi që kërkuesi nuk kishte histori penale të mëparshme dhe që të vetmet akuza për përfshirjen e tij në drogë kishin ardhur nga informatorja e policisë. Më tej, ai nuk kishte pasur asnjë përfitim financiar nga kjo marrëveshje. Prandaj, Gjykatës iu duk që operacioni i policisë nuk kishte vënë në shënjestër kërkuesin personalisht si shitblerës i njohur droge, por çdo person që do të pranonte t'i siguronte heroinë informantes.

Në mungesë të një sistemi gjithëpërfshirës kontrollesh për të shoqëruar operacionin e policisë, roli i kontrollit vijues nga gjykata e gjyqit bëhej thelbësor. Megjithatë, Gjykata shënoi që policët e përfshirë në "blerjen testuese" nuk u morën në pyetje fare nga gjykata, megjithëse mbrojtja kërkoi që ata të dëgjoheshin, e as personi që u dënua për shitjen e drogës kërkuesit nuk u dëgjua. Në fund, Gjykatës i bëri përshtypje në mënyrë të veçantë fakti që vetë kërkuesi nuk u dëgjua nga gjykata në lidhje me çështjen e nxitjes meqenëse ai mungoi në seancën dëgjimore të 11 nëntorit 1999.

Në përmbledhje, Gjykata gjeti që, megjithëse gjykata vendase kishte arsye të dyshonte që ishte grackë, ajo nuk kishte analizuar elementet relevante faktike dhe ligjore të cilat do ta kishin ndihmuar atë të dallonte grackën nga një formë legjitime aktiviteti hetimor. Nga kjo rridhte që procedurat, të cilat kishin shpënë në dënimin e kërkuesit, kishin qenë jo "të drejta" dhe Gjykata deklaroi që kishte pasur shkelje të Nenit 6 § 1.

Neni 41

Gjykata i caktoi kërkuesit 12,000 Euro për dëme jomateriale dhe afro 3,130 Euro për kosto dhe shpenzime.

Kërkuesi nuk pati argumente para Gjykatës sepse ai nuk mundi të vërtetonte se ishte prekur drejtpërsëdrejti nga dështimet e pretenduara të qeverisë franceze për të reaguar në mënyrë efektive ndaj pandemisë Covid-19 dhe prandaj nuk qe "viktimë" sipas nenit 34

VENDIMI NË ÇËSHTJEN LE MAILLOUX K. FRANCËS

(Kërkesa Nr. 18108/20)

5 nëntor 2020

1. Faktet kryesore

Kërkuesi, z. Renaud Le Mailloux, ishte shtetas francez i lindur në vitin 1974.

Në kuadër të reagimit ndaj pandemisë Covid-19 në vitin 2020, autoritetet franceze futën masa të ndryshme për të parandaluar dhe reduktuar efektet mbi shëndetin publik. Më 23 mars 2020 u miratuan një sërë dekretesh dhe një ligj. Më 24 mars 2020 u shpall gjendja e jashtëzakonshme për dy muaj. Më 11 maj 2020 gjendja e jashtëzakonshme u vazhdua deri më 10 korrik 2020.

Duke i konsideruar të pamjaftueshme masat e marra nga autoritetet, Sindikata Mjekësore e Aix dhe Rajonit (SMAER) dhe dy individë privatë paraqitën një kërkesë urgjente pranë Conseil d'État (Këshilli i Shtetit) për mbrojtjen e një lirie themelore. Ata kërkuan lëshimin e një urdhri që Shteti të merrte të gjitha masat për të ofruar maska FFP2 dhe FFP3 për profesionistët e shëndetësisë, maska kirurgjike për pacientët dhe popullatën e gjerë, dhe pajisje kontrolluese masive për të gjithë. Ata gjithashtu donin që Shteti të autorizonte mjekët dhe spitalet që të administronin një kombinim të barnave hidroksiklorokin dhe azitromicin për pacientët me rrezikshmëri të lartë, dhe laboratore mjekësore për zhvillimin e testeve të kontrollit.

Kërkuesi ndërhyri në procedura në mbështetje të kërkesës, duke pretenduar se ai ishte me rrezikshmëri të lartë për shkak të një sëmundjeje të rëndë. Më 28 mars 2020, Conseil d'État e rrëzoi kërkesën e bërë nga SMAER dhe të tjerë.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi u ankua sipas neneve 2, 3, 8 dhe 19 të Konventës për dështimin e Shtetit në përmbushjen e detyrimeve të tij pozitive për të mbrojtur jetën dhe

integritetin fizik të personave brenda juridiksionit të tij. Në mënyrë të veçantë, ai u ankua për qasje të kufizuar në teste diagnostifikuese dhe trajtime specifike, për pamjaftueshmërinë e masave të marra për të parandaluar përhapjen e virusit, dhe për ndërhyrje në jetët private të individëve të cilët vdiqën nga virusi në vetmi.

Pranueshmëria

Si pikë paraprake, Gjykata vuri në dukje që, megjithëse e drejta e shëndetit nuk garantohet shprehimisht në Konventë, Shtetet kanë detyrimin pozitiv për të marrë masa për mbrojtjen e jetëve të personave brenda juridiksioneve të tyre. Ndërkohë që ajo e interpretoi ankesën e kërkuesit në aspektin e të drejtës së shëndetit, Gjykata deklaroi që ajo nuk nevojitej që të vendoste nëse Franca i kishte shkelur këto detyrime pozitive, meqenëse kërkesa ishte e papranueshme.

Gjykata përsëriti se, për t'u mbështetur në nenin 34 të Konventës, një kërkues duhet të ishte "viktimë" e një shkeljeje të Konventës. Për këtë arsye, personi në fjalë duhet të arrijë të demonstrojë se ai është "prekur drejtpërsëdrejti" nga masa e kontestuar.

Më tej, Gjykata theksoi se Konventa nuk autorizon ankesa *in abstracto* për shkelje të Konventës. Ankesat *actio popularis* nuk njihen: pra kërkuesit nuk mund të ankohen për një dispozitë të së drejtës vendase, një praktikë vendase ose akte publike thjesht për shkak se ato duket se i kundërvihen Konventës Evropiane. Përkundrazi, në mënyrë që një kërkues të pretendojë statusin e viktimës, ai duhet të paraqesë prova të arsyeshme dhe bindëse të gjasave të një shkeljeje të ndodhur karshi atij personalisht. Dyshimet apo sajimet janë të pamjaftueshme në këtë aspekt.

Në rastin konkret, Gjykata vendosi që kërkuesi po ankohej *in abstracto* për pamjaftueshmërinë e masave të marra nga autoritetet franceze për të luftuar përhapjen e Covid-19. Gjykata konsideroi se kërkesa përbënte *actio popularis* për dy arsye.

Së pari, Gjykata theksoi se kërkuesi i kishte bërë këto ankesa vetëm në cilësinë e tij si ndërhyrës i palës së tretë në mbështetje të kërkesës urgjente para Conseil d'État, dhe nuk i kishte nisur procedurat vetë. Kjo nuk ishte e mjaftueshme për t'i dhënë atij statusin e viktimës brenda kuptimit të nenit 34.

Së dyti, Gjykata theksoi se kërkuesi nuk ofroi informacione në lidhje me sëmundjen e tij. Ai nuk shpjegoi se në ç'mënyrë dështimet e pretenduara të autoriteteve franceze me gjasë do të ndikonin mbi shëndetin e tij dhe jetën e tij private. Më tej, ai nuk ofroi asnjë provë të arsyeshme dhe bindëse që masat e marra nga autoritetet franceze mund të çonin drejt shkeljeve që ai pretendonte. Kështu, Gjykata vendosi që kërkesa kishte për qëllim vetëm kontestimin e masave të marra nga autoritetet franceze në mënyrë të përgjithshme.

Si pikë finale, Gjykata shtoi se në qoftë se kërkuesi do të ishte prekur drejtpërsëdrejti nga masat – për shembull në qoftë se atij do t'i ishte mohuar ndihma ose trajtimi si pasojë e dështimeve të pretenduara – ai mund të kontestonte përputhshmërinë e këtyre dështimeve me Konventën para gjykatave vendase.

Rrjedhimisht, Gjykata e refuzoi kërkesën si të papranueshme, meqenëse kërkuesi nuk mund të konsiderohej viktimë e shkeljeve të pretenduara sipas nenit 34 të Konventës.

Ndërkohë që korniza rregullatore nuk zbuloi asnjë mangësi në lidhje me detyrimin e Shtetit për të mbrojtur të drejtën e jetës së bashkëshortit të kërkueses, mungesa e zgjidhjeve efektive ka përbërë shkelje të aspektit procedural të Nenit 2

VENDIMI I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN LOPES DE SOUSA FERNANDES K. PORTUGALISË

(Kërkesa Nr. 56080/13)
19 dhjetor 2017

1. Faktet kryesore

Kërkuesja ishte shtetase portugeze bashkëshorti i së cilës bëri operacion për të hequr polipet nga hunda në Spitalin Vila Nova de Gaia (CHVNG) në nëntor 1997. Gjatë kthimit për në shtëpi ai pati kokëdhembje tepër të forta, kështu që u kthye në CHVNG, ku u diagnostikua me probleme psikologjike dhe iu dha recetë për qetësues. Të nesërmen, ai u diagnostikua me meningjit bakterial nga një ekip i ri mjekësor dhe u transferua në njësinë e kujdesit intensiv. Ai qëndroi aty deri në fillim të dhjetorit 1997, kur u lëviz në një repart mjekësor të përgjithshëm, i diagnostikuar me dy ulçera të duodenit, dhe u mjekua nga Dr. J.V.

Bashkëshorti i kërkueses doli nga spitali pas tetë ditësh, por vazhdoi të kishte dhimbje. Ai shkoi në qendrën e emergjencës së CHVNG-së edhe tri herë të tjera dhe u shtrua në spital dy herë. Mes gjetjeve të testeve ishte bakteria *Clostridium difficile*. Në fillim të shkurtit 1998, ai u lëshua nga spitali prej Dr. J.V., i cili i dha recetë për mjekim dhe e referoi atë tek departamenti i kujdesit vijues për pacientët e jashtëm. Më vonë në shkurt 1998, bashkëshorti i kërkueses u shtrua në një spital tjetër, ku vdiq me 8 mars 1998. Certifikata e vdekjes deklaronte se shkaku i vdekjes ishte septicaemia (sepsis).

Në gusht 1998, kërkuesja i shkroi një letër Ministrisë së Shëndetësisë, Autoritetit Rajonal të Shëndetit dhe Shoqatës së Mjekëve, ku deklaronte se ajo nuk kishte marrë asnjë shpjegim lidhur me përkeqësimin e papritur të shëndetit të burrit të saj dhe për vdekjen e tij më pas. Në shtator të vitit 2000, Inspektori i Përgjithshëm për Shëndetësi urdhëroi hetime, të cilat rezultuan me një raport të lëshuar në korrik 2006, i cili dilte në konkluzionin që nuk kishte baza për përgjegjësi disiplinore për neglizhencë kundër profesionistëve në fjalë. Megjithatë, aty thuhej se referimi i Dr. J.V. për kujdesin vijues si pacient i jashtëm ishte i pamjaftueshëm, dhe që në vend të kësaj bashkëshorti i kërkueses duhet të kishte vazhduar qëndrimin në

spital nën mbikqyrje të afërt. prandaj, Inspektori i Përgjithshëm urdhëroi procedura disiplinore kundër Dr. J.V., të cilat u pezulluan në pritje të procedurës penale. Dr. J.V. u akuzua për vrasje nga neglizhenca, por u lirua nga akuza në janar 2009 nga Gjykata e Rrethit për mungesë provash. Procedura disiplinore u mbyll, dhe apelet e mëpasme të kërkuases u refuzuan, duke kulminuar me hedhjen poshtë nga Gjykata Administrative Supreme në shkurt të vitit 2013.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkesja u ankuar që vdekja e bashkëshortit të saj ishte shkaktuar nga neglizhenca dhe pakujdesia e stafit mjekësor, dhe që autoritetet nuk ia kishin shpjeguar shkaku dhe përqësimit të papritur të shëndetit të tij. Ajo më tej u ankuar për kohëzgjatjen dhe rezultatin e procedurave vendore. Më 15 dhjetor 2015, një Dhomë deklaroi që kishte pasur shkelje substanciale dhe procedurale të Nenit 2. Me kërkesë të Qeverisë sipas Nenit 43, çështja iu referua Dhomës së Madhe.

Neni 2 (substanciale)

Gjykata shënoi që asaj i kërkohej shpesh të vendoste në çështje lidhur me akuzat për neglizhencë në kushtet e trajtimit mjekësor në spitale. Ajo konsideroi që çështja në fjalë ofronte mundësi për të riafirmuar dhe sqaruar fushëveprimin e detyrimeve pozitive substanciale të Shteteve në raste të tilla. Ajo vuri në pah dy lloje "rrethanash shumë të pazakonta" në të cilat mund të angazhohet përgjegjësia e Shtetit sipas Nenit 2 në lidhje me ofruesit e kujdesit shëndetësor.

Së pari, mund të angazhohet aty ku jeta e një pacienti individual me dijeni vihet në rrezik përmes mohimit të qasjes në trajtimin urgjent jetëshpëtues. Ajo nuk përfshin rastet e trajtimit të mangët, të pasaktë apo të vonuar.

U vu re që kërkesja nuk pretendonte se vdekja e bashkëshortit të saj ishte e qëllimshme, por që ai kishte vdekur si rezultat i një infeksioni të marrë në spital dhe neglizhencës mjekësore. Trajtimi mjekësor i bashkëshortit të kërkuases i ishte nënshtruar hulumtimit vendas dhe asnjë organ gjyqësor ose disiplinor nuk kishte gjetur ndonjë të metë aty. Për më tepër, asnjë prej provave të ekspertizës mjekësore nuk kishte përcaktuar në mënyrë konkluzive neglizhencën mjekësore. Gjykata përsëriti që, përveç rasteve të arbitrarisht apo gabimit të dukshëm, nuk ishte funksion i saj që të vinte në pyetje gjetjet e faktit të bëra nga autoritetet vendase, posaçërisht në lidhje me vlerësimet e ekspertizës shkencore. Më tej u

shënua që kërkuesja nuk u ankua që bashkëshortit të saj i ishte mohuar qasja në trajtim mjekësor, dhe nuk kishte as prova që sugjeronin një gjë të tillë. U përsërit se rastet kur kishte qoftë gabim të supozuar në diagnozë, që shpinte drejt administrimit të vonuar të trajtimit të duhur, apo qoftë një vonesë të supozuar në një ndërhyrje mjekësore të caktuar, në vetvete nuk mund të konsideroheshin të barasvlershme me mohimin e kujdesit shëndetësor.

Së dyti, përgjegjësia e Shtetit mund të angazhohet aty ku mosfunksionimi sistematik ose strukturor i shërbimeve spitalore rezulton me privimin e pacientit nga qasja në trajtim urgjent jetëshpëtues. Autoritetet duhet, ose do të duheshin, ta kenë ditur atë rrezik dhe të kenë dështuar në marrjen e masave të nevojshme për të ndaluar materializimin e atij rreziku, duke vënë kështu jetët e pacientëve, përfshirë pacientin në fjalë, në rrezik. Veprimet dhe mosveprimet duhet të kenë shkuar përtej thjesht gabimit ose neglizhencës mjekësore, duke qenë ndërkohë sistematike dhe strukturore. Më saktë, duhet të ketë pasur një lidhje mes mosfunksionimit dhe dëmit që ka pësuar pacienti, dhe ai mosfunksionim duhet të ketë rezultuar nga dështimi i Shtetit për të ofruar një kornizë rregullatore.

Kishte prova të pamjaftueshme për të treguar që ndonjë mosfunksionim, siç përshkruhet më lart, të kishte prekur spitalet në çështjen konkrete. Për më tepër, nuk ishte demonstruar që e meta e pretenduar shkonte përtej thjesht gabimit ose neglizhencës mjekësore, apo që personat e përfshirë në trajtimin mjekësor kishin dështuar, në shkelje të detyrimeve të tyre profesionale, t'i ofronin trajtime mjekësore urgjente bashkëshortit të kërkueses, pavarësisht se ishin plotësisht të vetëdijshëm që jeta e tij ishte në rrezik nëse nuk i jepej ai trajtim. Për më tepër, Gjykata konsideroi që mungesa e pretenduar e koordinimit mes departamenteve në CHVNG, në vetvete, nuk përbënte mosfunksionim të shërbimeve spitalore të tillë që të angazhonte përgjegjësinë e Shtetit. Duke pasur parasysh rregullat e hollësishtme dhe standardet e vendosura në të drejtën vendase dhe praktikën ligjore të Shtetit të paditur në zonën në fjalë, Gjykata gjeti që korniza rregullatore përkatëse nuk paraqiste ndonjë mangësi sa i përket detyrimit të Shtetit për të mbrojtur të drejtën për jetë të bashkëshortit të kërkueses.

Prandaj, Gjykata deklaroi që nuk kishte shkelje të pjesës substanciale të Nenit 2. Neni 2 (procedurale) Gjykata theksoi që detyrimi procedural parësor i Portugalisë ishte të kishte të ngritur një sistem ligjor në mënyrë që të mund të përcaktohej shkaku i vdekjes së pacientëve dhe përgjegjësit të mund të jepnin llogari. Në rastet e neglizhencës mjekësore, e drejta portugeze parashikonte mundësinë e procedurave penale dhe civile, dhe për kërkesa drejtuar Ministrisë së

Shëndetësisë dhe Shoqatës së Mjekëve. Kërkuesja i shfrytëzoi këto zgjidhje, por ndërkohë u shënuan mangësitë në vijim.

Procedurës para Inspektorit të Përgjithshëm të Shëndetësisë (ang. IGS) i mungonte veprueshmëria e menjëhershme, meqë i ishin dashur dy vjet për nisur hetimet, e më pas edhe një vit për të emëruar një inspektor për t'i zhvilluar ato. Kërkuesja dha dëshmi për herë të parë pothuaj tre vjet e gjashtë muaj pasi ajo kishte kontaktuar autoritetet. Ajo u informua mbi shtatë vjet e dhjetë muaj pas nisjes së procesit nga IGS që procedura disiplinore kundër Dr. J.V. do të pezullohej në pritje të procedurës penale.

Procedura penale që joefektive sepse zgjati mbi gjashtë vjet e tetë muaj, nuk u zhvillua me shpejtësinë e duhur, dhe kishte të bënte vetëm me akuzat kundër Dr. J.V., dhe nuk ishte marrë me rastet e tjera të neglizhencës mjekësore të pretenduara nga kërkuesja.

Kohëzgjatja e procedurës para Shoqatës së Mjekëve, rreth katër vjet e pesë muaj, ishte e paarsyeshme duke pasur parasysh që ajo kishte shqyrtuar vetëm të dhënat mjekësore dhe opinionet e specialistëve dhe nuk kishte dëgjuar asnjë dëshmi.

Gjykata deklaroi që kërkesa për kompensim para gjykatave administrative kishte qenë në gjendje t'i ofronte kërkueses zgjidhjen më të përshtatshme. Megjithatë, procedurat kishin zgjatur mbi nëntë vjet e njëmbëdhjetë muaj pa justifikim.

Në përfundim, sistemi vendas ka dështuar të ofronte një përgjigje të duhur dhe të kohshme në përputhje me detyrimet e Portugalisë sipas Nenit 2, duke shkelur kështu aspektin procedural.

Neni 41

Gjykata deklaroi që Portugalia duhet t'i paguante kërkueses 23,000 Euro për dëme jomateriale.

Paraburgimi i vazhdueshëm i kërkuesit, dhe kushtet në të cilat u transferua në spital për t'u trajtuar nga leuçemia, kanë shkelur të drejtat e tij sipas Nenit 3

VENDIMI NË ÇËSHTJEN MOUISEL K. FRANCËS

(Kërkesa Nr. 67263/01)

14 nëntor 2002

1. Faktet kryesore

Kërkuesi, Jean Mouisel, ishte i lindur në vitin 1948 dhe jetonte në Francë. Më 12 qershor 1996 ai u dënua me pesëmbëdhjetë vjet burgim për grabitje të armatosur, rrëmbim dhe mashtrim. Një certifikatë mjekësore që mban datën 8 janar 1999 tregon që ai vuante nga leuçemia limfatike kronike. Kur gjendja e tij u keqësua, ai bëri seanca kemoterapie në një spital gjatë ditës si pacient i jashtëm. Kërkuesi u vendos në pranga gjatë udhëtimeve për në spital dhe pretendoi se gjatë seancave të kemoterapisë këmbët i kishte të lidhura me zinxhirë dhe njëri prej kyçeve të tij ishte i kapur për krevat. Ai vendosi ta ndalte trajtimin mjekësor në qershor të vitit 2000, duke u ankuar për këto kushte dhe për sjelljen agresive të rojeve ndaj tij.

Për të përcaktuar nëse gjendja shëndetësore e kërkuesit ishte në përputhje me mbajtjen e vazhduar të tij në burg, më 28 qershor 2000 u hartua një raport mjekësor. Ai nxori përfundimin që kërkuesi duhet të trajtohej në një klinikë të specializuar, dhe më 19 korrik 2000 ai u transferua në Burgun Muret me urgjencë në mënyrë që të mund të ishte afër Spitalit të Toulouse. Ai u lirua me kusht më 22 mars 2001 në bazë të një detyrimi për t'iu nënshtruar trajtimit ose kujdesit mjekësor.

2. Vendimi i Gjykatës

Duke u mbështetur në Nenin 3 të Konventës, kërkuesi u ankua për mbajtjen e tij në burg pavarësisht se ishte i sëmurë rëndë, dhe për kushtet e burgimit.

Neni 3

Gjykata shënoi që periudha që duhet marrë në shqyrtim lidhur me çështjen filloi në datën e raportit të parë mjekësor që diagnostikonte gjendjen e kërkuesit, 8 janar 1999, dhe mbaroi me lirimin e tij me kusht më 22 mars 2001.

Gjykata përsëriti që Konventa nuk përmban ndonjë dispozitë që ka të bëjë specifikisht me situatën e personave të privuar nga liria, e jo më kur ata janë të sëmurë, por raste të tilla mund të ngrenë çështje nga Neni 3. Megjithëse nuk ka një detyrim të përgjithshëm për të liruar të burgosurit që vuajnë nga shëndeti i lig, Neni 3 u kërkon Shteteve që të mbrojnë integritetin fizik të personave që janë privuar nga liria, kryesisht duke u ofruar atyre çdo ndihmë mjekësore të nevojshme. Gjykata gjithashtu përsëriti se metoda e ekzekutimit të masës nuk duhet ta vendosë personin e burgosur në stres apo vështirësi të një intensiteti që e tejkalon shkallën e pashmangshme të vuajtjes që ngërthen në vetvete mbajtja në burg.

Autoritetet franceze ishin të lejuara me ligj që të ndërhyjnë në rastet kur të burgosurit ishin të sëmurë rëndë. Sipas Ligjit të 15 qershorit 2000, të burgosurit mund të liroheshin me kusht kur u duhej të merrnin trajtim. Më tej, në përputhje me Ligjin e 4 marsit 2002 mbi Të Drejtat e Të Sëmurëve, dënimet e të burgosurve mund të pezulloheshin nëse ata ishin të sëmurë në gjendje kritike ose nëse vuanin nga ndonjë sëmundje kronike e cila nuk përputhej me mbajtjen e vazhdueshme në burg. Kështu, Gjykata shënoi që shëndeti i të burgosurve tani ishte faktor për t'u marrë parasysh gjatë përcaktimit se si do të vuhej dënimi, kryesisht duke iu referuar kohëzgjatjes së tij. Megjithatë, ajo pranoi që, në çështjen që kishte përpara, asnjëra prej zgjidhjeve nuk i ishte vënë në dispozicion kërkuesit gjatë periudhës në fjalë, meqenëse ai nuk i përmbushte kriteret e kërkuara për të fituar lirinë me kusht dhe ligji për lejimin e pezullimit të dënimeve nuk ishte miratuar deri në atë kohë.

Sa u përket pasojave të mbajtjes së vazhduar në burg dhe kushteve në të cilat u mbajt kërkuesi, Gjykata gjeti që gjendja e tij ishte bërë gjithnjë e më shumë e papërputhshme me burgimin e tij të vazhdueshëm teksa sëmundja e tij avanconte. Për shembull, raportet mjekësore i referoheshin vështirësisë së ofrimit të trajtimit në burg dhe gjendjes psikologjike të kërkuesit, e cila ishte rënduar nga stresi i të qenit i sëmurë. Pavarësisht nga kjo, autoritetet e burgut kishin dështuar në marrjen e masave të veçanta të cilat mund të kishin përfshirë shtruarjen e kërkuesit në spital ose transferimin e tij në ndonjë institucion tjetër ku ai mund të mbahej nën monitorim dhe mbikqyrje, posaçërisht natën.

Më tej, edhe pse nuk ishte vërtetuar që kërkuesi ishte mbajtur me zinxhirë gjatë kohës që merrte trajtimin mjekësor, nuk kishte dyshim që ai i kishte pasur duart me pranga gjatë rrugës për në spital dhe në kthim. U përsërit që prangosja normalisht nuk i jep shkas çështjeve nga Neni 3, aty ku ajo bëhet në lidhje me

burgosje të ligjshme dhe nuk përfshin përdorimin e forcës që shkon përtej asaj që konsiderohet e nevojshme, duke pasur parasysh çdo rrezik që paraqiste kërkuesi dhe rrezikun e fshehjes së tij. Megjithatë, duke marrë parasysh gjendjen e kërkuesit, faktin që ai ishte shtruar në spital, natyrën e trajtimit dhe brishtësinë e kërkuesit, Gjykata konsideroi që përdorimi i prangave në duar ishte joproportional me rrezikun ekzistues të sigurisë.

Ajo shënoi që nuk kishte asnjë element që sugjeronte se ekzistonte ndonjë rrezik që ai të fshihej apo të kalonte në dhunë. Në fund, Gjykata vuri në dukje rekomandimet e Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës në lidhje me kushtet në të cilat të burgosurit transferoheshin në spital për t'iu nënshtruar trajtimeve mjekësore – kushte të cilat vazhdonin të ngrinin probleme për sa i përket etikës mjekësore dhe respektit për dinjitetin njerëzor. Përshkrimi nga kërkuesi i kushteve në të cilat ai ishte shoqëruar për në spital dhe në kthim nuk dukeshin shumë ndryshe nga situatat të cilat shkaktonin shqetësim për Komitetin në këtë pikë.

Sipas pikëpamjes së Gjykatës, autoritetet nacionale kishin dështuar të merrnin parasysh sa duhet gjendjen e kërkuesit. Mbajtja e vazhduar e tij në burg, sidomos nga qershori 2000 e më tej, minonte dinjitetin e tij dhe përbënte vështirësi posaçërisht akute që kishte shkaktuar vuajtje përtej asaj që është e pashmangshme në dënimin me burg apo trajtimin për kancer. Rrjedhimisht, Gjykata vendosi që mbajtja e vazhduar e kërkuesit në burg ka përbërë trajtim çnjerëzor dhe poshtërues dhe që ka pasur shkelje të Nenit 3.

Neni 41

Gjykata i caktoi kërkuesit 15,000 Euro për dëme jomateriale.

Dështimi në marrjen e masave të duhura për të mbrojtur jetën e fëmijëve me shëndet të dobët nën kujdestari, dhe dështimi për të zhvilluar hetime efektive rreth vdekjes së tyre, kanë shkelur Nenin 2

VENDIMI NË ÇËSHTJEN NENCHEVA DHE TË TJERË k. BULLGARISË

(Kërkesa Nr. 48609/06)

18 qershor 2013

1. Faktet kryesore

Kërkesit ishin Shoqata për Integrim Evropian dhe të Drejtat e Njeriut dhe nëntë prindër të shtatë prej pesëmbëdhjetë fëmijëve dhe të rinjve që vdiqën gjatë dimrit të viteve 1996-97 në shtëpinë Dzhurkovo. Shtëpia Dzhurkovo kishte rreth 80 fëmijë gjatë dimrit të viteve 1996-97, ku të gjithë ishin me paaftësi të rënda fizike ose mendore. Disa fëmijë ishin vendosur aty me kërkesë të prindërve dhe disa të tjerë në vijim të një vendimi administrativ pasi prindërit i kishin dhënë për adoptim.

Mes viteve 1996-97, Bullgaria kaloi një krizë të rëndë ekonomike, financiare, dhe shoqërore. Inflacioni u ngrit mbi 1000% dhe buxhetit të alokuar për shtëpinë Dzhurkovo, e cila ishte përgjegjësi e kryebashkiakut, i ra vlera së tepërmi. Si rezultat, autoritetet nuk mundën t'i ofronin shtëpisë Dzhurkovo më fonde për të mbuluar kostot e ushqimit dhe nevojave të tjera. Gjatë këtij dimri, ushqimi në shtëpinë Dzhurkovo qe tepër i pamjaftueshëm, ngrohja vinte vetëm një orë në mëngjes e në mbrëmje, ishte e vështirë të mbahej higjiena elementare, dhe stafi ishte i pamjaftueshëm. Stafi dhe banorët e fshatit fqinjë sillnin ushqime rregullisht, për t'u siguruar që fëmijët të mos ngelnin krejtësisht të paushqyer.

Më 20 shtator 1996, menaxherja e shtëpisë Dzhurkovo dërgoi një letër, të firmosur nga kryebashkiaku i Lakit, pranë Ministrisë së Punësimit dhe Politikave Sociale ku thuhej se ajo nuk kishte mjetet materiale për të mbuluar nevojat elementare të fëmijëve që jetonin aty, dhe që kushtet përbënin rrezik serioz dhe të menjëhershëm për jetën e tyre. Fëmija i parë në shtëpinë Dzhurkovo vdiq më 15 dhjetor 1996. Në janar të vitit 1997, shërbimet sociale të bashkisë vendosën edhe tetë fëmijë të tjerë nga një shtëpi tjetër kujdestarie në shtëpinë Dzhurkovo.

Gjatë janarit 1997, menaxherja e shtëpisë Dzhurkovo dhe kryebashkiaku i Lakit apeluan tek një sërë organizatash humanitare, donatorë privatë, dhe Ministria e Punësimit dhe Politikave Sociale për furnizime bazë sepse ekzistonte rreziku që fëmijët nuk do t'i mbijetonin dimrit. Deri më 22 shkurt 1997, shtatë fëmijë kishin vdekur. Menaxherja i dërgoi një telegram Ministrisë së Punësimit dhe Politikave Sociale duke theksuar rreptësinë e situatës dhe e përsëriti kërkesën për veprime urgjente. Në të njëjtën datë, ajo kontaktoi departamentin e mirëqenies sociale pranë Ministrisë, i cili i dërgoi asaj një pagesë të vetme prej 3,720 Euro. Deri në atë moment, 15 fëmijë kishin vdekur në atë shtëpi.

Në korrik 1999, prokuroria publike rajonale nisi procedurën penale kundër një personi ose personave të panjohur për 10 prej 15 vdekjeve. Gjithashtu u urdhëruan hetime për të konstatuar nëse ekzistonte lidhje shkakësore mes dështimit për t'iu përmbajtur detyrimit për të mbrojtur jetën dhe shëndetin e fëmijëve duke ofruar ushqim të mjaftueshëm, ngrohje, dhe nevoja të tjera, dhe vdekjes së tyre. Një raport mjeko-ligjor, i urdhëruar në kuadër të këtyre hetimeve, deklaroi që ishte e vështirë të konstatohej shkak i vdekjes pa autopsi. Për të përcaktuar shkakun e vdekjes nuk ishte bërë asnjë autopsi sepse e drejta vendase e kërkonte këtë vetëm kur një person vdiste në spital, ose me kërkesë të familjarëve.

Në prill 2004, menaxherja, zyrtari mjekësor, dhe kryeinfermieri në shtëpinë Dzhurkovo u ngarkuan me akuzën e vrasjes së paqëllimshme për shkelje të detyrës statutores. Në tetor 2004, Ministria e Financave iu përgjigj një kërkesë të hetuesit për dokumente relevante duke thënë se ato ishin shkatërruar pas skadimit të periudhës së mbajtjes së dokumenteve. Në janar të vitit 2005, prokuroria publike rajonale i dërgoi gjykatës një aktakuzë kundër menaxheres, zyrtarit mjekësor, dhe kryeinfermierit për neglizhencë profesionale e cila kishte shkakuar vdekjen e 13 fëmijëve. Megjithatë, gjykata i shfajësoi të pandehurit. Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme e Kasacionit e mbështetën këtë vendim.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesit u ankuan që Shteti kishte shkelur detyrimin e tij pozitiv për të mbrojtur jetën e individëve të dobët nën kujdesin e tij dhe që ai kishte dështuar në kryerjen e hetimeve efektive për të konstatuar shkakun e vdekjeve dhe për të identifikuar përgjegjësit. Më tej, ata u ankuan për kushtet në shtëpinë Dzhurkovo dhe pretenduan që Shteti kishte vepruar në mënyrë diskriminuese për shkak të gjendjes shëndetësore dhe dobësisë së fëmijëve. Gjykata zgjodhi që t'i trajtonte ankesat sipas Neneve 2, 3 dhe 13. Në fund, kërkuesit pretenduan se refuzimi i

gjykatës për t'i bashkuar ata si palë në procedurë penale dhe kohëzgjatja e procedurës penale kishte shkelur Nenin 6.

Pranueshmëria

Nëntë kërkuesit të cilët ishin persona natyralë kishin statusin e viktimës si trashëgimtarë legjitimë të fëmijëve të tyre në shtëpinë Dzhurkovo. Shoqata për Integrim Evropian dhe të Drejtat e Njeriut i kishte kërkuar Gjykatës autorizim për të përfaqësuar ligjërisht individët trashëgimtarët legjitimë të të cilëve ishin të panjohur. Megjithatë, Shoqata nuk kishte arritur të vërtetonte që pjesëmarrja e saj ishte në interes të drejtësisë dhe i dha arsye Gjykatës që të distancohej nga jurisprudenca e vendosur e saj. Prandaj, Shoqata nuk mundi të konsiderohej viktimë e një shkeljeje të Konventës dhe ankesat e bëra prej saj u refuzuan si të papërputhshme *ratione personae*.

Neni 2

Gjykata deklaroi që fjalia e parë e Nenit 2 i cakton Shtetit detyrimin për të marrë masat e nevojshme për të mbrojtur jetën e personave brenda juridiksionit të tij. Autoritetet nuk e diskutonin që ato ishin përgjegjëse për kujdesin e fëmijëve dhe të rriturve të dobët të vendosur në shtëpitë e shtetit, të cilat ato i kishin ekskluzivisht nën mbikqyrje. Gjykata konsideroi që kishte shumë faktorë që sugjerorin se autoritetet duhet ta kishin ditur që kishte rreziqe reale ndaj jetës së fëmijëve dhe që ato nuk kishin marrë masa të arsyeshme, brenda kufijve të pushtetit të tyre, për ta lehtësuar këtë rrezik.

Duke ditur se dimri ishte shumë i egër dhe kriza ekonomike gëlonte, informacionet lidhur me rrezikun që u kanosej fëmijëve nga mungesa e ngrohjes, ushqimit dhe mjekimit u bënë të ditura që prej 10 shtatorit 1996. Nga kjo datë, me mbështetjen e kryebashkiakut të Lakit, menaxherja e shtëpisë Dzhurkovo filloi të bënte apel tek autoritetet për këto rreziqe dhe kërkoi ndihmën e nevojshme. Në fakt, menaxherja e kishte ngritur në mënyrë të përsëritur seriozitetin e situatës tek autoritetet. Prandaj, dukej se zyrtarët në nivelet më të larta të Ministrisë së Punësimit dhe Politikave Sociale dhe institucione të tjera ishin në dijeni të rreziqeve ndaj shëndetit dhe jetës së fëmijëve që prej shtatorit të vitit 1996, tre muaj para vdekjes së parë.

Fakti që ngjarjet tragjike nuk kishin ndodhur në mënyrë të papritur, vetëm një herë, dhe në mënyrë të paparë ekuivalente me atë të një ngjarjeje force majeure

ishite element thelbësor i çështjes. Kjo çështje kishte të bënte me rrezikun ndaj jetës së personave të dobët nën kujdesin e Shtetit për çka autoritetet kishin dijani të plotë, në një situatë që mund të përshkruhej si krizë nacionale. Ishte e qartë se autoritetet nuk kishin marrë masa të menjëhershme, vendimtare dhe të mjaftueshme për të parandaluar vdekjet, pavarësisht prej dijenisë së saktë rreth rreziqeve reale dhe urgjente që i kanoseshin jetës së personave në fjalë.

Gjykata konsideroi që faktet e çështjes ishin të pazakonta dhe dallonin nga një rast i zakonshëm neglizhence. Si i tillë, lejimi i kërkuesve për të nisur procedurë civile nuk ishte i mjaftueshëm për të përmbushur detyrimin e Shtetit për zhvillimin e hetimeve efektive sipas Nenit 2 meqenëse ngritja e një padie civile varej vetëm nga iniciativa e viktimave. Neni 2 kërkonte që autoritetet të zhvillonin hetime të shpejta dhe të zellshme me iniciativën e tyre. Gjykata shënoi që hetimet zyrtare filluan dy vjet pas ngjarjeve dhe që procedura penale e mëpasme zgjati rreth tetë vjet. Qeveria nuk dha shpjegime për këtë vonesë në procedurën penale, gjatë së cilës njëri prej personave përgjegjës për drejtimin e shtëpisë Dzhurkovo kishte vdekur dhe disa prej të dhënave ishin shkatërruar për shkak të skadimit të periudhës pesëvjeçare të ruajtjes së dokumenteve. Prandaj, autoritetet nuk kishin vepruar me zellin e arsyeshëm që duhej për të konstatuar shkakun e vdekjeve dhe përgjegjësinë e zyrtarëve. Paraqitja e mungesës së zellit po ashtu hidhte dyshime mbi faktin nëse hetimet ishin zhvilluar në mirëbesim dhe ua shtonin vuajtjen kërkuesve.

Gjykata nuk e pranoi argumentin e Qeverisë që shkatërrimi i arkivave nënkuptonte se nuk mund të konstatohej me siguri nëse ishte zhvilluar ndonjë procedurë administrative apo disiplinore për t'u siguruar nëse autoritetet ishin përgjegjëse për vdekjet. Ky argument u gjet të ishte në kundërshtim me kriterin e zellit, i cili ishte i ngërthyer brenda nocionit të përgjigjes së përshtatshme. Më tej, nuk kishte asnjë tregues tjetër mes provave në dispozicion që cilatdo prej këtyre procedurave ishin nisur për të shqyrtuar problemet në menaxhimin e shtëpisë çka kishte shpënë drejt vdekjeve. Duke marrë parasysh rrethanat e pazakonta të çështjes, procedurat civile në dispozicion të kërkuesve nuk qenë të mjaftueshme për të përmbushur detyrimet e Shtetit sipas Nenit 2. Shteti kishte dështuar në detyrimin e tij për të mbrojtur jetën e fëmijëve të dobët të vendosur nën kujdesin e tij dhe detyrën e tij për të ngritur mekanizma procedurale të përshtatshme për të konstatuar faktet e çështjes, duke dështuar kështu në mbrojtjen e interesit publik, gjë që e kishin zbuluar faktet e kësaj çështjeje. Prandaj, Gjykata vendosi që kishte pasur shkelje si të aspektit substancial ashtu edhe të aspektit procedural të Nenit 2.

Neni 13 në lidhje me Nenin 2

Gjykata shënoi që në kohën e ngjarjeve mund të ishin bërë kërkesa për kompensim kundër institucioneve përgjegjëse për shtëpinë Dzhurkovo, duke bërë fjalë për Ministrinë e Punësimit dhe Politikave Sociale dhe Bashkinë Laki. Më tej, e drejta bullgare nuk ua ndalonte kërkuesve që të bënin padi civile për kompensim krahas procedurës penale. Prandaj, ankesa sipas Nenit 13 në lidhje me Nenin 2 që e papranueshme si dukshëm e pabazuar.

Nenet 3 dhe 13

Gjykata vendosi që nuk ishte e nevojshme të shqyrtoheshin këto ankesa meqenëse ato ishin paraqitur pas kufirit kohor gjashtëmuor. Rrjedhimisht, kjo pjesë e kërkesës që e papranueshme.

Neni 6

Gjykata shënoi që kërkuesit nuk apeluan kundër vendimit të gjykatës për të mos bashkuar padinë civile me procedurën penale. Për më tepër, ky vendim nuk preku të drejtën e kërkuesve për të nisur procedurë civile të ndarë. Sidoqoftë, ankesa nuk ishte sjellë në Gjykatë brenda gjashtë muajve pas vendimit të gjykatës dhe prandaj i kishte kaluar koha. Sa i përket ankesës lidhur me kohëzgjatjen e procedurave penale, kërkuesit nuk ishin bashkuar si palë civile në procedura dhe prandaj Neni 6 nuk ishte i aplikueshëm. Prandaj kjo pjesë e kërkesës që e papranueshme.

Neni 41

Gjykata u caktoi dy kërkuesve 10,000 Euro secili/a në lidhje me dëme jomateriale dhe 2,000 Euro Shoqatës për Integrim Evropian dhe të Drejtat e Njeriut për kosto dhe shpenzime. Ajo konsideroi që gjetja e një shkeljeje përbënte shpërblim të drejtë të mjaftueshëm për kërkuesit e tjerë.

Shteti ka dështuar të vepronte në përputhje me detyrimet e tij pozitive për të mbrojtur të drejtën e jetës dhe gëzimin paqësor të pasurive nga një shpërthim metani, dhe për të ofruar kompensim të mjaftueshëm

VENDIMI I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN ÖNERYILDIZ k. TURQISË

(Kërkesa Nr. 48939/99)

30 nëntor 2004

1. Faktet kryesore

Kërkuesi, Maşallah Önerıldız, ishte i lindur në vitin 1955. Në kohën materiale ai ishte duke jetuar me dymbëdhjetë kushërinj të afërt në lagjen e varfër Kazım Karabekir në Stamboll.

Zona Kazım Karabekir ishte pjesë e zgjerimit të vendbanimeve bazike të ndërtuara pa autorizim në një tokë të rrethuar nga një gropë hedhurinash që ishte përdorur bashkërisht nga katër këshilla rrethi që prej viteve 1970, nën autoritetin dhe përgjegjësinë e Këshillit Bashkiak të Stambollit (Istanbul City Council). Një raport ekspert i hartuar më 7 maj 1991 me kërkesë të Gjykatës së Rrethit, të cilit çështja në fjalë i ishte referuar nga Këshilli i Rrethit, tërhiqte vëmendjen e autoriteteve, mes të tjerash, drejt faktit se nuk ishin marrë fare masa rreth gropës në fjalë për të parandaluar shkaktimin e ndonjë shpërthimi metani si pasojë e mbeturinave të dekompozuar. Raporti i dha shkas një sërë mosmarrëveshjeve mes kryetarëve të komunave të përfshira. Megjithatë, para se të përfundonin procedurat e nisura prej secilit prej tyre, në gropë ndodhi një shpërthim metani më 28 gusht 1993 ku mbeturinat e ngritura në ajër nga shpërthimi i përgjithshëm të hedhurinave gllabëruan më se dhjetë shtëpi që ndodheshin poshtë tyre, përfshirë shtëpinë që i përkiste kërkuetit, i cili humbi nëntë kushërinj të afërt.

Pas zhvillimit të hetimeve penale dhe administrative rreth çështjes, dy kryetarët e komunave të përfshira u sollën para gjykatave për dështim të dhënies së urdhrit për shkatërrimin e kasolleve të paligjshme rreth gropës së hedhurinave, dhe për dështim të rinovimit të gropës ose urdhërimit të mbylljes së saj, pavarësisht nga përfundimet e raportit ekspert të 7 majit 1991. Më 4 prill 1996, kryetarët e komunave në fjalë të dy u dënuan për "neglizhencë në kryerjen e detyrave të tyre" dhe u gjykojnë të dy me 160,000 Lira turke (TRL) dhe u dënuan me minimum tre

muaj burg siç parashikohej në Nenin 230 të Kodit Penal. Dënimet e tyre më pas u zëvendësuan me gjoba, zbatimi i të cilave u pezullua.

Pas kësaj, kërkuesi bëri padi për dëmshpërblim pranë Gjykatës Administrative të Stambollit në emrin e tij dhe në emër të tre fëmijëve të tij të mbijetuar, ku mbante përgjegjës autoritetet për vdekjen e kushërinjve të tij dhe për shkatërrimin e pronës së tij. Në një gjykim të 30 nëntorit 1995, autoritetet u urdhëruan t'i paguanin kërkuesit dhe fëmijëve të tij 100,000,000 TRL për dëme jomateriale dhe 10,000,000 TRL për dëme materiale në lidhje me shkatërrimin e sendeve në shtëpinë e tij (në atë kohë të barasvlershme me rreth 2,077 Euro dhe 208 Euro respektivisht). Në kohën e VENDIMIT nga Gjykata evropiane, ato shuma ende nuk i ishin paguar kërkuesit.

2. Vendimi i Gjykatës

Në një gjykim të Dhomës më 18 qershor 2002, Gjykata deklaroi që kishte pasur shkelje të Nenit 2 të Konventës dhe Nenit 1 të Protokollit Nr. 1. Me kërkesë të Qeverisë turke sipas Nenit 43, çështja iu referua Dhomës së Madhe.

Kërkuesi pretendoi që faktet për të cilat ishte ankuar i kishin dhënë shkas shkeljeve të Neneve 2 (e drejta për jetë), 13 (e drejta për zgjidhje efektive), 6 § 1 (e drejta për seancë dëgjimore të drejtë brenda një kohe të arsyeshme), dhe 8 (e drejta për respekt ndaj jetës private dhe familjare) të Konventës, dhe të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 (mbrojtja e pronës ose pasurisë).

Neni 2

Gjykata së pari shqyrtoi përgjegjësinë që mbante Shteti për vdekjet e ndodhura. Raporti ekspert i paraqitur më 7 maj 1991 i ishte referuar në mënyrë specifike rrezikut të shpërthimit për shkak të metanogjenezës, meqenëse gropa e hedhurinave nuk kishte pasur "asnjë mënyrë për të parandaluar shpërthimin e metanit të ndodhur si pasojë e dekompozimit" të mbeturinave shtëpiake. Gjykata konsideroi që nuk viheshin në diskutim as realiteti e as urgjenca e rrezikut në fjalë, duke qenë se rreziku i shpërthimit kishte filluar të ekzistonte shumë kohë para se të theksohej në raportin e 7 majit 1991 dhe, duke pasur parasysh faktin që gropa ka vazhduar të shërbejë në të njëjtat kushte, që rreziku ka mundur vetëm të shtohet në ndërkohë.

Meqenëse autoritetet turke e kishin ditur, ose duhej ta kishin ditur, që ekzistonte një rrezik real ose i menjëhershëm ndaj personave që jetonin në afërsi

të gropës së hedhurinave (së paku deri më 27 maj 1991, kur ato ishin informuar për raportin e 7 majit 1991), ato kishin pasur një detyrim nga Neni 2 i Konventës për të marra masa të atilla operacionale parandaluese siç ishin të nevojshme dhe të mjaftueshme për të mbrojtur ata individë, sidomos duke qenë se ato vetë e kishin ngritur atë gropë dhe kishin autorizuar operacionalizimin e saj, çka kishte shkaktuar rrezikun në fjalë. Megjithatë, Këshilli Bashkiak i Stambollit kishte dështuar të merrte masat e nevojshme urgjente.

Në lidhje me argumentin e Qeverisë që kërkuesi kishte vepruar në mënyrë të paligjshme duke u vendosur të banonte pranë gropës së hedhurinave, Gjykata vërejtí se pavarësisht nga ndalimet statusore në fushën e planifikimit të qytetit, politika e vazhdueshme e Shtetit turk mbi lagjet e varfra kishte inkurajuar integrimin e zonave të tilla në ambientet urbane, duke njohur kështu ekzistencën e tyre dhe mënyrën e jetesës së qytetarëve, që ishte vetë shkaku i shtimit të tyre që prej viteve 1960.

Në rastin konkret, nga viti 1988 e deri në aksidentin e 28 prillit 1993, kërkuesi dhe kushërinjtë e tij të afërt kishin jetuar fare të pashqetësuar në shtëpinë e tyre, në ambientin shoqëror e familjar që kishin krijuar. Gjithashtu, dukej se autoritetet kishin hequr tatimin bashkiak ndaj kërkuesit dhe banorëve të tjerë të lagjeve të varfra, dhe u kishin ofruar atyre shërbime publike, me pagesë. Rrjedhimisht, Qeveria nuk mund të thoshte se ajo ishte e zhveshur nga përgjegjësia për shkak të neglizhencës apo mungesës së largpamësisë së viktimave.

Më tej, Gjykata shënoi që Qeveria nuk kishte treguar që ishte marrë ndonjë masë për t'u ofruar banorëve të lagjeve të varfra informacione rreth rreziqeve me të cilat përballeshin.

Në përfundim, Gjykata shënoi që korniza rregullatore e zbatueshme në çështjen në fjalë ishte vërtetuar të ishte difektoze sepse gropa ishte lejuar të hapej e të operonte, dhe nuk kishte pasur sistem të qëndrueshëm mbikqyrjeje. Rrjedhimisht Gjykata vendosi që kishte pasur shkelje të Nenit 2.

Pas kësaj Gjykata vazhdoi me shqyrtimin e përgjegjësisë së mbajtur nga Shteti në lidhje me natyrën e hetimeve. Qëllimi i vetëm i procedurave penale kishte qenë të përcaktohej nëse autoritetet mund të mbareshin përgjegjëse për "neglizhencë në kryerjen e detyrave të tyre" sipas Nenit 230 të Kodit Penal, dispozitë e cila nuk kishte fare lidhje me aktet e rrezikimit të jetës apo me mbrojtjen e të drejtës së jetës brenda kuptimit të Nenit 2. VENDIMI i 4 prillit 1996 kishte lënë pezull çështjet e përgjegjësisë së mundshme të autoriteteve për vdekjen e kushërinjve të afërt të kërkuesit.

Rrjedhimisht, nuk mund të thuhet se sistemi i drejtësisë penale në Turqi kishte siguruar përgjegjshmërinë e plotë të zyrtarëve apo autoriteteve të Shtetit për rolin e tyre në tragjedi, ose zbatimin efektiv të dispozitave të së drejtës vendase që garantonte respektimin e të drejtës së jetës, në mënyrë të veçantë funksionin pengues të së drejtës penale. Prandaj Gjykata vendosi që kishte pasur gjithashtu shkelje të Nenit 2 në lidhje me hetimet e pamjaftueshme rreth vdekjes së kushërinjve të afërt të kërkuesit.

Neni 1 i Protokollit Nr. 1 të Konventës

Gjykata e refuzoi argumentin e Qeverisë që autoritetet turke ishin përmbajtur nga shkatërrimi i shtëpisë së kërkuesit për arsye humanitare. Detyrimi pozitiv i autoriteteve nga Neni 1 i Protokollit Nr. 1 kërkonte që ato të ndërmerrnin hapa praktikë, siç është instalimi i kohshëm i sistemit të nxjerrjes së gazrave, për parandalimin e shkatërrimit të vendbanimit.

Më tej, Gjykata shënoi që kompensimi të cilin gjykatat turke i kishin caktuar kërkuesit për dëme materiale ende nuk ishte paguar, edhe pse ishte shpallur VENDIMI përfundimtar financiar. Prandaj kishte pasur shkelje të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1.

Neni 13

Gjykata së pari shqyrtoi ankesën e kërkuesit për mungesën e zgjidhjes efektive në lidhje me Nenin 2, dhe shënoi që zgjidhja në kuadër të së drejtës administrative e përdorur nga kërkuesi dukej se kishte qenë e mjaftueshme që ai të realizonte thelbin e ankesës së tij lidhur me vdekjen e kushërinjve të tij, dhe kishte qenë në gjendje t'i ofronte atij zgjidhje të përshtatshme për shkeljen e gjetur të Nenit 2. Megjithatë, Gjykata e pa atë zgjidhje si joefektive në shumë aspekte dhe konsideroi vendimtar faktin që dëmshpërblimet e caktuara kërkuesit – vetëm në lidhje me dëmet jomateriale si pasojë e humbjes së kushërinjve të tij të afërt – faktikisht nuk ishin paguar kurrë. Rrjedhimisht, ajo vendosi që kishte pasur shkelje të Nenit 13.

Në lidhje me Nenin 1 të Protokollit Nr. 1, vendimi për kompensim kishte marrë shumë kohë të gjatë dhe shuma e caktuar në lidhje me shkatërrimin e sendeve shtëpiake nuk ishte paguar kurrë. Prandaj Gjykata vendosi që kishte pasur edhe shkelje të Nenit 13 gjithashtu në lidhje me atë ankesë.

Neni 6 § 1 dhe Neni 8

Duke pasur parasysh gjetjet e saj të arritura tashmë, Gjykata nuk e konsideroi të nevojshme të shqyrtonte pretendimet e një shkeljeje të Nenit 6 § 1 dhe Nenit 8.

Neni 41

Gjykata vendosi t'i caktonte kërkuesit shumën 2,000 Dollarë (që përputhet me rimbursimin e shpenzimeve të varrimit), shumën 45,000 Dollarë për dëme materiale dhe jomateriale dhe 16,000 Dollarë për kosto dhe shpenzime. Gjithashtu Gjykata u caktoi 33,750 Dollarë secilit prej djemve të kërkuesit për dëme jomateriale.

Gjykim referues mbi dhunën në familje - dështimi për mbrojtje në shkelje të Neneve 2, 3 dhe 14

VENDIMI I DHOMËS NË ÇËSHTJEN OPUZ K. TURQISË

(Kërkesa Nr. 33401/02)

9 qershor 2009

1. Faktet kryesore

Kërkuesja, Nahide Opuz, ishte shtetase turke e lindur në vitin 1972. Në vitin 1990 Znj. Opuz filloi të jetonte me H.O., djalin e bashkëshortit të nënës së saj. Znj. Opuz dhe H.O. u martuan në nëntor 1995 dhe nga kjo martesë u lindën tre fëmijë në vitet 1993, 1994 dhe 1996. Ata patën mosmarrëveshje serioze që nga fillimi i marrëdhënies së tyre dhe tani janë të divorcuar.

Mes prillit 1995 dhe marsit 1998 pati katër incidente të sjelljes së dhunshme dhe kërcënuese të H.O. ndaj kërkueses dhe nënës së saj, gjë që erdhi në vëmendje të autoriteteve. Ato incidente përfshinin rrahje të shumta, një përlëshje gjatë së cilës H.O. nxori thikën dhe H.O. i zuri të dyja gratë me makinë. Pas atyre sulmeve gratë u ekzaminuan nga mjekët të cilët dëshmuuan në raportet e tyre për lëndime të ndryshme, përfshirë gjekderdhje, mavijosje, gunga, gërricje dhe gërvishtje. Të dyja gratë u vërtetua në aspektin mjekësor se kishin pësuar lëndime kërcënuese për jetën: kërkuesja si pasojë e një rrahjeje veçanërisht të dhunshme; dhe nëna e saj pas sulmit me makinë.

Kundër H.O. nisi procedura penale për tre raste të kërcënimeve me vdekje, lëndimeve trupore faktike të rënduara dhe të dhimbshme, dhe për vrasje në tentativë. Sa i përket incidentit me thikë, u vendos që të mos ndiqej penalisht për mungesë provash. H.O. u vendos në paraburgim paragyqësor dy herë dhe u lirua në pritje të gjyqit.

Megjithatë, meqenëse kërkuesja dhe nëna e saj i tërhoqën ankesat gjatë secilës prej atyre procedurave, gjykatat vendase i ndërprejnë çështjet e tyre, meqenëse për të vazhduar më tej, sipas Kodit Penal, duheshin ankesat e tyre. Pavarësisht nga kjo, procedurat në lidhje me incidentin me makinë vazhduan në lidhje me nënën e kërkueses, duke pasur parasysh seriozitetin e lëndimeve të saj, dhe H.O. u shpall fajtor dhe u dënua me tre muaj burgim, çka më vonë u konvertua në gjobë.

Më 29 tetor 2001 kërkuesja u ther me thikë shtatë herë nga H.O. dhe u dërgua në spital. H.O. u akuzua për sulm me thikë dhe iu caktua një gjobë tjetër prej pothuaj 840,000 Lira turke (e barasvlershme me afro 385 Euro) të cilën ai mund të paguante në tetë këste. Pas atij incidenti, nëna e kërkueses kërkoi që H.O. të paraburgosej në pritje të gjyqit, duke thënë se më përpara asaj dhe vajzës së saj i ishte dashur t'i tërhiqnin ankesat e tyre kundër tij për shkak të presioneve këmbëngulëse dhe kërcënimeve për vdekje prej tij.

Në fund, më 11 mars 2002 nëna e kërkueses, pasi kishte vendosur të lëvizte në Izmir me vajzën e saj, ishte duke udhëtuar me kamionin e bartjes së sendeve të saj kur H.O. e detyroi kamionin të ndalonte në anë të rrugës, hapi derën e pasagjerit dhe e gjuajti atë. Nëna e kërkueses vdiq në vend.

Në mars 2008 H.O. u shpall fajtor për vrasje dhe posedim të paligjshëm të armës dhe u dënua me burgim të përjetshëm – megjithatë ai u lirua në pritje të procedurës së apelit. Në prill të vitit 2008 kërkuesja bëri një ankesë tjetër penale pranë autoriteteve prokuroriale ku ajo kërkonte që autoritetet të merrnin masa për ta mbrojtur atë sepse, që prej lirimt të tij, ish-burri i saj kishte filluar ta kërcënonte përsëri. Në maj dhe nëntor 2008 përfaqësuesi i kërkueses informoi Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut që nuk ishte marrë asnjë masë e tillë dhe Gjykata kërkoi shpjegime. Pas kësaj autoritetet morën masa të veçanta për të mbrojtur kërkuesen, duke shpërndarë fotografinë e tij dhe gjurmët e gishtave të tij në stacionet e policisë me urdhrin që ai të arrestohej nëqoftëse shihej në afërsi të vendbanimit të kërkueses.

Në ndërkohë, në janar të vitit 1998, në Turqi hyri në fuqi Akti i Mbrojtjes së Familjes i cili parashikonte masa specifike për mbrojtjen kundër dhunës në familje.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesja pretendoi që autoritetet turke kishin dështuar të mbronin të drejtën e jetës për nënën e saj dhe që ato kishin qenë neglizhente karshi dhunës, kërcënimeve me vdekje dhe lëndimeve të vazhdueshme të cilat i kishte pësuar edhe ajo vetë. Ajo u mbështet në Nenet 2, 3, 6 dhe 13. Më tej, ajo u ankua për mungesën e mbrojtjes së grave kundër dhunës në familje në kuadër të së drejtës vendase në Turqi, në shkelje të Nenit 14.

Neni 2

Gjykata konsideroi që, në rastin e kërkueses, dhuna e mëtejshme, faktikisht sulmi vdekjeprurës, nuk kishte qenë vetëm e mundur por kishte qenë e parashikueshme, duke ditur historinë e sjelljes së dhunshme të H.O. dhe historinë penale të tij ndaj gruas së tij dhe nënës së saj si dhe kërcënimit e vazhdueshëm ndaj shëndetit dhe sigurisë së tyre.

Sipas praktikës së zakonshme në Shtetet anëtare, sa më serioze që është vepra ose sa më i madh që është rreziku i veprave të mëtejshme, aq më shumë gjasa ka që të vazhdojë ndjekja penale në interes të publikut, edhe nëqoftëse viktimat i tërheqin ankesat e tyre. Megjithatë, duke vendosur në vazhdimësi që të ndërprisnin procedurat penale kundër H.O., autoritetet iu referuan ekskluzivisht nevojës për t'u frenuar nga ndërhyrja në atë që ato e perceptuan si "çështje familjare". Me sa duket autoritetet nuk i kishin marrë në konsideratë motivet e tërheqjes së ankesave të tyre, pavarësisht nga deklaratat e nënës së kërkueses drejtuar autoriteteve prokuroriale që ajo dhe vajza e saj ishin detyruar ta bënin këtë për shkak të presionit dhe kërcënimeve me vdekje nga H.O. Pavarësisht nga tërheqja e ankesave nga viktimat, korniza legjislative duhet t'u kishte mundur autoriteteve prokuroriale vazhdimin e hetimeve penale kundër H.O. për shkak se sjellja e tij e dhunshme kishte qenë mjaftueshëm e rëndë sa që të kërkonte ndjekjen penale dhe se kishte pasur kërcënim të vazhdueshëm ndaj integritetit fizik të kërkueses.

Prandaj, Gjykata konkludoi që autoritetet nacionale nuk kishin treguar zellin e duhur në parandalimin e dhunës kundër kërkueses dhe nënës së saj, posaçërisht në vijimin e masave penale ose masave të tjera parandaluese kundër H.O. As hetimet për vrasje, për të cilat pati rrëfim, nuk mund të konsideroheshin efektive meqenëse kishin zgjatur, deri në atë kohë, më shumë se gjashtë vjet. Për më tepër, sistemi i të drejtës penale nuk kishte pasur efekt pengues në rastin konkret. As nuk ishte e mundur që autoritetet të mbështeteshin tek dështimi i viktimave për të ndërmarrë masat e duhura. Prandaj, autoritetet turke kishin dështuar të mbronin të drejtën e jetës për nënën e kërkueses, në shkelje të Nenit 2.

Neni 3

Gjykata konsideroi që përgjigjja ndaj sjelljes së H.O. kishte qenë dukshëm e pamjaftueshme karshi peshës së rëndë të veprave të tij. Vendimet gjyqësore, të cilat nuk kishin pasur efekt parandalues e as pengues mbi H.O., kishin qenë

joefektive dhe madje kishin zbuluar njëfarë niveli të tolerancës për aktet e tij. Vlen të shënohet që, pas incidentit me makinë, H.O. kishte kaluar 25 ditë në burg dhe kishte marrë vetëm gjobë për lëndimet e rënda që i kishte shkaktuar nënës së kërkueses. Çka bën edhe më shumë përshtypje është fakti se, si ndëshkim për therjen shtatë herë me thikë të kërkueses, atij iu dha vetëm një gjobë e vogël të cilën mund ta paguante me këste.

Përveç kësaj, e drejta turke nuk parashikonte masa të veçanta administrative dhe policore për të mbrojtur personat e dobët nga dhuna familjare para janarit të vitit 1998, kur hyri në fuqi Akti për Mbrojtjen e Familjes. Edhe pas asaj date, autoritetet vendase nuk i kishin zbatuar ato masa dhe sanksione për të mbrojtur kërkuesen.

Në fund, Gjykata shënoi me shqetësim të madh që dhuna e pësuar nga kërkuesja faktikisht nuk kishte përfunduar dhe që autoritetet vazhdonin të tregonin mungesë veprimi.

Pavarësisht nga kërkesa e kërkueses në prill të vitit 2008, nuk u bë asgjë deri kur Gjykata i kërkoi Qeverisë që të jepte informacione rreth masave mbrojtëse që kishte ndërmarrë.

Prandaj, Gjykata konkludoi që kishte pasur shkelje të Nenit 3 si pasojë e dështimit të autoriteteve për marrjen e masave mbrojtëse në formën e pengimit efektiv kundër shkeljeve të rënda të integritetit personal të kërkueses nga ish-bashkëshorti i saj.

Neni 14

Sipas raporteve të paraqitura nga kërkuesja, të hartuara nga dy organizata joqeveritare kryesore, dhe të pakontestuara nga Qeveria, numri më i madh i viktimave të raportuara të dhunës shtëpiake ishin gra, shumica e të cilave ishin me origjinë kurde, analfabete ose me nivel të ulët shkollimi dhe përgjithësisht pa asnjë burim të pavarur të ardhurash. Në fakt, raportet sugjeronin që dhuna shtëpiake tolerohej nga autoritetet dhe që zgjidhjet e përmendura nga Qeveria nuk funksiononin efektivisht.

Prandaj, Gjykata konsideroi që kërkuesja kishte arritur të tregonte që dhuna shtëpiake prekte kryesisht gratë dhe që pasiviteti i përgjithshëm dhe diskriminues në Turqi kishte krijuar një klimë që shpinte drejt dhunës shtëpiake. Duke pasur

parasysh këtë, dhuna e pësuar nga kërkuesja dhe nëna e saj mund të shihej si e bazuar në gjini, çka përbënte një formë të diskriminimit kundër grave. Pavarësisht nga reformat e sjella nga Qeveria gjatë viteve të fundit, mosreagimi i përgjithshëm i sistemit gjyqësor dhe pandëshkueshmëria që gëzonin agresorët, siç u gjet në rastin e kërkueses, tregonin që kishte përkushtim të pamjaftueshëm për të ndërmarrë veprimet e duhura për t'iu adresuar dhunës shtëpiake. Prandaj, Gjykata konkludoi që kishte pasur shkelje të Nenit 14, në lidhje me Nenet 2 dhe 3.

Nene të tjera

Duke pasur parasysh gjetjet e mësipërme, Gjykata nuk e pa të nevojshme të shqyrtonte të njëjtat fakte në kontekstin e Neneve 6 dhe 13.

Neni 41

Gjykata i caktoi kërkueses 30,000 Euro shpërblim për dëme jomateriale dhe 6,500 Euro për kosto dhe shpenzime.

Vendosja e parimit të detyrimit pozitiv për të mbrojtur jetën sipas Nenit 2, në një çështje që përfshinte një të ri të lënduar rëndë nga ish-mësuesi i tij

VENDIMI NË ÇËSHTJEN OSMAN K. MBRETËRISË SË BASHKUAR

(Kërkesa Nr. 23452/94)

28 tetor 1998

1. Faktet kryesore

Kërkuesja e parë, Mulkiye Osman, ishte nëna e kërkuesit të dytë, Ahmet Osman, i cili ishte një ish-nxënës i Paul Paget-Leëis në Shkollën Homerton House.

Në vitin 1986 drejtori i Shkollës Homerton House, Z. Prince, vuri re që një prej anëtarëve të stafit të tij, Paul Paget-Leëis, ishte afruar me Ahmet Osmanin. Në janar të vitit 1987, Znj. Green, nëna e Leslie Green, nxënës në të njëjtën shkollë, u ankua tek Z. Prince që Paget-Leëis e kishte ndjekur djalin e saj rrugës për në shtëpi pas shkollës dhe e kishte ngacmuar. Pasi u intervistua nga zv/mësuesi kryesor Z. Perkins, Paget-Leëis po ashtu dha një deklaratë me shkrim, të cilën Z. Perkins e gjeti "shqetësuese" sepse ajo shfaqte qartë se ai kishte "xhelozitë të shfrenuar" për miqësinë mes Ahmet Osmanit dhe Leslie Green. Z. Perkins i sugjeroi atij të kërkonte ndihmë psikiatrike.

Ndërkohë, menaxhmenti i shkollës zhvilloi shumë intervista të tjera me individë relevantë. Sipas ditarit të Z. Prince, mes 3 marsit 1987 dhe 17 marsit 1987 ai u takua me policinë katër herë për ta diskutuar këtë çështje.

Gjatë organizimit të transferimit të Ahmet Osmanit në një shkollë tjetër, u zbulua që dosjet e Ahmetit dhe Leslie Green ishin vjedhur nga zyra e shkollës. Paget-Leëis e mohoi përfshirjen në vjedhje.

Më 14 prill 1987, Paget-Leëis e ndryshoi emrin me anë të një dokumenti ligjor të njëanshëm (ang. deed poll) në Paul Ahmet Yildirim Osman. Z. Prince informoi policinë dhe i shkroi në lidhje me këtë Autoritetit të Arsimit në Londër (ILEA), ai gjithashtu i informoi ata që ishte i shqetësuar që mungesa e ekuilibrit psikologjik të Paget-Leëis mund të përbente kërcënim për sigurinë e Ahmet Osmanit. Paget-Leëis u vizitua nga Dr. Ferguson, një psikiatër nga ILEA, më 19 maj 1987. Dr. Ferguson rekomandoi që Paget-Leëis të mbetej në shkollë si mësimdhënës por të merrte një formë të këshillimit dhe psikoterapisë.

Gjatë ditëve në vijim, një tullë u hodh drejt një dritareje të shtëpisë së kërkuesit. Një polic u dërgua tek shtëpia dhe plotësoi raportin e krimit. Në dy raste në qershor 1987, gomat e makinës së Z. Ali Osman (bashkëshorti i kërkueses së parë dhe babai i kërkuesit të dytë) u shpërthyen me dashje. Të dy incidentet u raportuan në polici.

Pas një ekzaminimi tjetër të Paget-Leëis, Dr. Ferguson konkludoi që ai duhet të hiqej nga shkolla Homerton House, dhe u klasifikua si përkohësisht i paaftë për punë. Paget-Leëis u pezullua përkohësisht nga mësimdhënia, megjithatë kjo u hoq dhe ai filloi të punonte si zëvendës-mësues në dy shkolla të tjera lokale.

Në gusht ose shtator 1987, u kryen disa sulme kundër pronave të familjes Osman, përfshirë hedhjen e vajit të makinave dhe parafinës mbi shtëpi, copëtimi i xhamit të përparmë të makinës së Z. Osman, bllokimi i derës së hyrjes së shtëpisë së tyre me super-ngjites, dhe përlyerja me jashtëqitje qeni e pragut të derës së tyre dhe makinës së tyre. Të gjitha këto incidente u raportuan në polici.

Policia vizitoi shtëpinë e familjes Osman dhe më pas bisedoi me Paget-Leëis rreth akteve të vandalizmit. Në një deklaratë të mëvonshme në polici, Paget-Leëis supozohet se tha aty se humbja e vendit të punës së tij kishte qenë aq stresuese sa që ai ndiente se ishte në rrezik të bënte diçka të çmendur kriminale, megjithëse Qeveria e mohoi që kjo ishte thënë.

Më 7 dhjetor 1987 një makinë e drejtuar nga Paget-Leëis u përplas me një furgon ku pasagjer ishte Leslie Green.

Më 15 dhjetor 1987 Paget-Leëis u intervistua nga zyrtarët e ILEA-s me kërkesë të tij. Një memorandum i ILEA-s që mban të njëjtën datë shënonte se Paget-Leëis ishte në gjendje tërësisht vetëshkatërruese, duke fajësuar Z. Perkins për të gjitha telashet e tij.

Më 17 dhjetor 1987, policët shkuan në shtëpinë e Paget-Leëis me qëllim që ta arrestonin mbi bazën e dyshimeve për dëmtim kriminal, por ai nuk ishte aty.

Në fillim të janarit 1988, policia filloi një procedurë me qëllim të ndjekjes penale të Paget-Leëis për drejtim automjeti pa kujdes dhe vëmendje të duhur. Përveç kësaj, emri i Paget-Leëis u vendos në Kompjuterin Nacional të Policisë si njeri i kërkuar në lidhje me incidentin e përplasjes së automjeteve dhe për dyshimin se kishte kryer veprat e dëmtimit kriminal.

Më 7 mars 1988, Paget-Leëis u pa nga disa persona në afërsi të shtëpisë së kërkuesit. Rreth orës 11:00 të darkës, Paget-Leëis gjuajti dhe vrau Z. Osman dhe plagosi rëndë Ahmet Osman. Më pas ai shkoi me makinë drejt shtëpisë së Z. Perkins ku e gjuajti dhe e plagosi atë, si dhe vrau djalin e tij. Të nesërmen herët në mëngjes Paget-Leëis u arrestua.

Më 28 tetor 1988, Paget-Leëis u shpall fajtor për dy akuza për vrasje pasi ishte deklaruar fajtor për shkak të përgjegjësisë së zvogëluar. Ai u dënua me dërgimin në një spital mendor të siguruar pa kufi kohor.

Më 28 shtator 1989, kërkuesit nisën procedurat kundër, inter alia, Komisionerit të Policisë së Metropolis duke cituar neglizhencë për faktin se, megjithëse policia ishte në dijeni të aktiviteteve të Paget-Leëis që nga maji 1987, ajo nuk e kishte kapur ose intervistuar atë, nuk kishin bastisur shtëpinë e tij ose nuk e kishin akuzuar për ndonjë vepër para marsit 1988. Më 19 gusht 1991, Komisioneri i Policisë Metropolitane bëri kërkesë për heqjen e deklaramit të pretendimit për shkak se ai nuk paraqiste shkak të arsyeshëm për veprime ligjore. Më pas Gjykata e Apelit u shpreh që, sipas rregullës përjashtimore të vitit 1989 të vendimit të Dhomës së Lordëve në çështjen Hill kundër Kryepolicit të Ëest Yorkshire, kundër policisë nuk mund të ndërmerreshin veprime ligjore për neglizhencë në hetime dhe përmbajtje të krimin për shkak se politikat publike kërkonin imunitet nga paditë.

2. Vendimi i Gjykatës

Duke u mbështetur në Nenet 2, 6, 8 dhe 13 kërkuesit u ankuan që kishte pasur dështim në mbrojtjen e jetës së Ali dhe Ahmet Osman dhe parandalimin e ngacmimit të familjes së tyre, dhe që ata nuk kishin pasur qasje në gjykatë e as zgjidhje efektive në lidhje me atë dështim.

Neni 2

Kërkuesja pohoi që duke dështuar të merrnin hapat e përshtatshëm dhe të duhur për të mbrojtur jetën e kërkuesit të dytë dhe babait të tij, Ali Osman, nga rreziku real dhe i njohur që kanoste Paget-Leëis, autoritetet kishin dështuar në përmbushjen e detyrimit të tyre pozitiv nga Neni 2.

Së pari, Gjykata deklaroi që, kur ka akuza që autoritetet kanë shkelur detyrimin e tyre pozitiv për të mbrojtur të drejtën për jetë në kuadër të detyrës së tyre për të parandaluar dhe përmbajtur veprat, duhet të konstatohet në mënyrë bindëse

për Gjykatën që autoritetet e kanë ditur ose duhet ta kishin ditur në atë kohë ekzistencën e rrezikut real dhe të afërt ndaj jetës së një individi ose individëve të identifikuar prej akteve kriminale të një pale të tretë dhe që ato kanë dështuar në marrjen e masave brenda fushëveprimit të fuqive të tyre prej të cilave, duke gjykuar me arsye, mund të ishte pritur shmangia e atij rreziku.

Megjithëse ishte pohuar që deri në fazën kur policia u informua rreth të gjitha çështjeve relevante të ndërlidhura, përfshirë një incident me grafite, vjedhja e dosjeve shkollore, dhe ndryshimi i emrit të Paget-Leëis, policia duhet të kishte qenë në gjendje vigjilence ndaj nevojës për të hetuar më tej përfshirjen e supozuar të Paget-Leëis në ato incidente ose ta mbante nën vëzhgim të afërt, Gjykata nuk u bind që dështimi i policisë për ta bërë këtë në këtë fazë mund të kundërshtohet nga këndvështrimi i Nenit 2, duke pasur parasysh gjendjen e njohurive të tyre në atë kohë. Sipas mendimit të Gjykatës, ndërkohë që afërsia e Paget-Leëis me Ahmet Osmanin mund të gjykohej nga policët që vizituan shkollën si diçka e qortueshme nga aspekti profesional, nuk pati kurrë ndonjë sugjerim që Ahmet Osman ndodhej në rrezik të natyrës seksuale prej tij, e aq më pak që jeta e tij ishte në rrezik.

Meqenëse Paget-Leëis kishte mohuar çdo përfshirje të tij kur u intervistua nga Z. Perkins dhe asgjë nuk e lidhte atë me asnjërin prej incidenteve, Gjykata vendosi që vlerësimi i situatës nga policia dhe vendimi i saj për ta trajtuar këtë si çështje të brendshme të shkollës nuk mund të konsideroheshin të paarsyeshme.

Në lidhje me aktet e vandalizmit kundër shtëpisë dhe pronës së familjes Osman, dhe pohimit që policia nuk mbante të dhëna për raportet e policisë, Gjykata deklaroi që ky dështim nuk mund të thuhet se e kishte penguar policinë nga kapja e mëparshme e ndonjë kërcënimi real ndaj jetës së familjes Osman ose që mungesa e racionalitetit në sjelljen e Paget-Leëis fshihte predispozita vdekjeprurëse. Në lidhje me këtë, Gjykata gjithashtu shënoi që, kur më në fund u mor vendimi për të arrestuar Paget-Leëis, ai vendim nuk u bazua mbi ndonjë rrezik të perceptuar ndaj jetës së familjes Osman por mbi përfshirjen e dyshuar të tij në aktet e dëmtimit të vogël kriminal.

Sa i përket faktit të supozuar që Paget-Leëis ia kishte komunikuar policisë tri herë, qoftë direkt apo indirekt, qëllimet e tij vrasëse, Gjykata konsideroi që këto deklarata nuk mund të konsideroheshin me arsye që nënkuptonin se familja Osman ishte shënjestra e kërcënimeve të tij dhe se ai e kishte vënë policinë në dijeni për to.

Rrjedhimisht, Gjykata konsideroi që kërkuesit kishin dështuar të tregonin ndonjë fazë vendimtare gjatë rrjedhës së ngjarjeve deri në të shtënat tragjike kur mund të thuhej se policia e dinte ose duhet ta kishte ditur që jeta e familjes Osman ishte në rrezik real dhe të afërt nga Paget-Leëis. Rrjedhimisht, Gjykata nuk gjeti shkelje të Nenit 2.

Neni 8

Gjykata kujtoi që ajo nuk e kishte gjetur të konstatuar se policia dinte ose duhet ta kishte ditur në atë kohë që Paget-Leëis paraqiste rrezik real dhe të afërt për jetën e Ahmet Osmanit dhe që reagimi i saj ndaj ngjarjeve gjatë kohës që ato po ndodhnin ishte i arsyeshëm në ato rrethana dhe jo i papërputhshëm me detyrën e autoriteteve sipas Nenit 2. Ai konkluzion po ashtu mbështeti gjetjen që nuk kishte pasur shkelje të detyrimit pozitiv nga Neni 8.

Sa i përket diskutimit të kërkuesve që policia dështoi në hetimin e sulmeve kundër shtëpisë së tyre me qëllim të dhënies fund të fushatës së ngacmimeve kundër familjes Osman, Gjykata përsëriti që policia pikësëpari kishte pasur mendimin se nuk kishte prova për të implikuar Paget-Leëis, dhe më vonë, nën dritën e zhvillimeve të reja, ishin bërë në fakt përpjekje për të arrestuar dhe marrë në pyetje Paget-Leëis për dyshimet për dëmtim kriminal. Prandaj, Gjykata konkludoi që nuk kishte pasur shkelje nga autoritetet të ndonjë detyrimi pozitiv nga Neni 8.

Neni 6 § 1

Kërkuesit pretenduan që rrëzimi nga Gjykata e Apelit i padisë së tyre kundër policisë për neglizhencë për arsye të politikave publike përbënte kufizim të së drejtës së tyre për qasje në gjykatë, në shkelje të Nenit 6 § 1.

Në lidhje me zbatueshmërinë e Nenit 6, çka Qeveria e kishte konstestuar me argumentin se ligjet vendase nuk parashikonin të drejtën për të paditur policinë për neglizhencë, Gjykata nuk qe dakord dhe konsideroi që kërkuesit kishin të drejtën, që rridhte nga ligji mbi neglizhencën, për të kërkuar një gjykim në lidhje me pranueshmërinë dhe themelet e një pretendimi të argumentueshëm që ata ishin në marrëdhënie afërsie me policinë, dhe që dëmi i shkaktuar ishte i parashikueshëm.

Pastaj, Gjykata shënoi që arsyet që shtynë Dhomën e Lordëve në çështjen Hill të shtronin një rregullë përjashtimore për të mbrojtur policinë nga paditë për neglizhencë bazoheshin në pikëpamjen që interesave të komunitetit në tërësi u shërbente më së miri një shërbim policie efikasiteti dhe efektiviteti i të cilit në luftën kundër krimit nuk prekeshin nga rreziku i vazhdueshëm i ekspozimit ndaj përgjegjësisë kompensuese për politika dhe vendime operacionale.

Megjithëse qëllimi i një rregulle të tillë mund të pranohej si legjitim në kuadër të Konventës, si i tillë që është i orientuar drejt ruajtjes së efektivitetit të shërbimit policor dhe parandalimit të trazirave dhe krimit, Gjykata theksoi çështjen e proporcionalitetit. Zbatimi i rregullës pa hulumtuar më tej për ekzistencën e konsideratave për interesat publike konkurruese shërbente vetëm për t'i dhënë imunitet të tërësishëm policisë për veprimet dhe mosveprimet e saj gjatë hetimeve dhe përmbajtjes së krimit, dhe përbente kufizim të pajustificueshëm ndaj të drejtës së kërkueses që çështja e saj të vlerësohej mbi themelet e pretendimit të tij/saj kundër policisë në rastet kur e meritonin.

Gjykata konkludoi që kërkesa për rregullën përjashtimore në këtë çështje përbente kufizim joproporcional të së drejtës së kërkuesve për qasje në gjykatë dhe kishte shkelur Nenin 6 § 1.

Neni 13

Gjykata konsideroi që nuk ngrihej asnjë çështje e ndarë sipas Nenit 13 duke pasur parasysh gjetjen prej saj të një shkeljeje të Nenit 6 § 1.

Neni 50 (tani Neni 41)

Gjykata i caktoi secilit prej kërkuesve shumën 10,000^[754] GBP si dëmshpërblim, dhe 30,000 GBP për kosto dhe shpenzime.

[754] Vlera e përafërt £1 = €1.60.

Sistemi ligjor turk nuk i ka ofruar kërkuesit zgjidhje të përshtatshme në lidhje me një të posalindur të infektuar me HIV përmes transfuzioneve të gjakut, dhe autoritetet u urdhëruan të ofronin mbulesë mjekësore të përrjetshme - shkëlqe e Neneve 2, 6 dhe 13

VENDIMI NË ÇËSHTJEN OYAL K. TURQISË

(Kërkesa Nr. 4864/05)

23 mars 2010

1. Faktet kryesore

Kërkuesi i parë ishte i lindur më 6 maj 1996. Kërkuesja e dytë dhe kërkuesi i tretë ishin nëna dhe babai i tij, të gjithë me banim në Izmir.

Kërkuesi i parë u infektua me virusin HIV kur, pas lindjes së parakohshme, ai u desh të merrte disa transfuzione gjaku për hernia inguinale dhe umbilikale. Prindërit e tij morën vesh për këtë infeksion, dhe për faktin që ai mund të zhvillohej deri në formën më të rëndë të Sindromit të Fituar të Mungesës së Imunitetit (ang. AIDS), kur ai ishte afro gjashtë muajsh.

Në maj 1997, kërkuesit hapën procedurë penale për neglizhencë mjekësore kundër mjekëve të përfshirë në transfuzionet e gjakut, Drejtorit të Përgjithshëm të Kryqit të Kuq Turk në Izmir ("Kızılay" prej ku ishte marrë gjaku për transfuzion) dhe Ministrin të Shëndetësisë. Procedurat përfunduan sepse nuk qe e mundur të atribuohet faji i drejtpërdrejtë.

Në dhjetor të vitit 1997 kërkuesit nisën procedurën civile kundër Kızılay dhe Ministrisë së Shëndetësisë, dhe në tetor 1998 procedurën administrative kundër të dyve. Si gjykata civile ashtu edhe ajo administrative vendosën që Kızılay kishte faj për dhënien e gjakut të infektuar me HIV dhe që Ministria e Shëndetësisë duhet të mbante përgjegjësi për neglizhencën e stafit në kryerjen e detyrave të tyre. Më tej, Gjykata Civile e Shkallës së Parë në Ankara konstatoi që gjaku i infektuar me HIV dhënë kërkuesit të parë nuk ishte pikasur sepse stafi mjekësor nuk i kishte bërë testet e kërkuesit të parë, duke menduar se ato do të kushtonin shtrenjtë. Për më tepër ajo gjykatë gjeti që, para infektimit të kërkuesit të parë, nuk kishte rregullore që u kërkonte dhuruesve të gjakut të jepnin informacione rreth historisë së tyre seksuale për të përcaktuar nëse mund të ishin dhurues ose jo. Për shkak të këtyre mangësive, dhe dështimit për të vepruar në përputhje me rregulloret

tashmë ekzistuese, gjykata civile dhe ajo administrative u caktuan kërkuesve dëmshpërblime jomateriale plus interesat statusore.

Pas këtyre urdhrave për kompensim, kërkuesve iu hoq "karta jeshile" e lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë për t'u ofruar njerëzve me të ardhura në pragun më të ulët qasje falas në kujdes shëndetësor dhe mjekësor. Megjithatë, kompensimi i dhënë arriti të mbulonte vetën shpenzimet e trajtimit mjekësor për një vit, dhe nuk mjaftoi për të paguar kostot e mjekimit të kërkuesit të parë. Pavarësisht nga premtimet e bëra nga autoritetet për të paguar shpenzimet mjekësore të kërkuesit të parë, si Kızılay ashtu edhe Ministria e Shëndetësisë i refuzuan pretendimet e kërkuesve për kujdes shëndetësor dhe mjekim në shumën 6,800 Euro në muaj.

Kërkuesi i tretë u prek rëndë nga reagimet e prindërve të fëmijëve të tjerë ndaj gjendjes së djalit të tij dhe nga refuzimi i shkollës për ta pranuar atë. Për shkak të shëndetit të lig, kërkuesi i tretë nuk ishte në gjendje të punonte në kohën e VENDIMIT. Kjo krijoi vështirësi të mëdha ekonomike, ku familja përpiqej të paguante shpenzimet mjekësore me ndihmën e familjarëve dhe miqve. Kërkuesi i parë, edhe pse përfundimisht u pranua në shkollë publike, i duhej të shkonte në psikoterapi çdo javë, dhe nuk kishte shokë.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesit u ankuan që autoritetet e Shtetit kishin dështuar në përmbushjen e detyrimit të tyre pozitiv për të mbrojtur të drejtën e jetës së kërkuesit të parë si pasojë e infektimit të tij me virusin HIV nga gjaku i furnizuar nga Kızılay, dhe që për ankesat e tyre penale nuk ishin zhvilluar fare hetime efektive. Ata gjithashtu u ankuan, sipas Neneve 6 dhe 13, për kohëzgjatjen e tepërt të procedurave administrative dhe që kompensimi i caktuar eventualisht nuk i mbulonte shpenzimet e mjekimit të nevojshëm.

Neni 2

Gjykata përsëriti që, edhe pse Konventa si e tillë nuk garanton të drejtën për të nisur procedura penale kundër palëve të treta, sistemi gjyqësor efektiv që kërkohet nga Neni 2 mundet, dhe në rrethana të caktuara duhet, të përfshijë rekurs në të drejtën penale. Megjithatë, nëse shkelja e të drejtës për jetë ose integritet personal nuk shkaktohet qëllimisht, detyrimi pozitiv i imponuar nga Neni 2 për të ngritur një sistem gjyqësor efektiv nuk kërkon domosdoshmërisht ofrimin e një zgjidhjeje përmes të drejtës penale në çdo rast. Në sferën e neglizhencës mjekësore, ky

detyrim mund të përmbushet me anë të një zgjidhjeje civile, duke mundësuar konstatimin e përgjegjesisë së mjekëve të përfshirë dhe vendosjen e zgjidhjes së duhur civile, siç është urdhri për dëmtshpërblim ose për masa disiplinore. Prandaj, Gjykata mori në konsideratë nëse sistemi ligjor turk u ka ofruar kërkuesve zgjidhje civile të duhur dhe të mjaftueshme.

Ajo vuri në dukje se kërkuesit patën mundësinë që t'u drejtoheshin si gjykatës civile ashtu edhe asaj administrative, të cilat vendosën që Kızılay dhe Ministria e Shëndetësisë ishin përgjegjëse për dëmet shkaktuar kërkuesve. Megjithatë, Gjykata e gjeti këtë zgjidhje të pamjaftueshme në rrethanat ku: kompensimi mbulonte shpenzimet mjekësore vetëm për një vit për kërkuesin e parë dhe karta jeshile e familjes u tërhoq. Kështu famija u la në borxhe dhe varfëri, dhe në pamundësi për të paguar koston prej 6,800 Eurosh çdo muaj për trajtimin e kërkuesit.

Megjithëse Gjykata njohu qasjen e ndjeshme dhe pozitive të gjykatave nacionale në vendosjen e çështjes, ajo konsideroi që zgjidhja më e përshtatshme në këto rrethana do të kishte qenë të urdhëroheshin Kızılay dhe Ministria e Shëndetësisë që të paguanin trajtimin dhe shpenzimet mjekësore të përgjeshme të kërkuesit të parë, përveç dëmeve jomateriale.

Në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave administrative, u rikujtua që detyrimet e Nenit 2 do të përmbusheshin vetëm nëse mbrojtja ekzistonte edhe në teori edhe në praktikë, çka kërkonte shqyrtimin e menjëhershëm të çështjes pa vonesë të panevojshme. Duke pasur parasysh kohëzgjatjen e tepërt, gjatë nëntë viteve e katër muajve, Gjykata deklaroi që ky kriter nuk ishte plotësuar dhe prandaj kishte pasur shkelje të Nenit 2.

Nenet 6 dhe 13

U konsiderua që procedurat administrative nuk kishin qenë komplekse meqenëse neglizhenca dhe përgjegjësia e autoriteteve tashmë ishte konstatuar gjatë procedurave civile. Duke pasur parasysh peshën e situatës dhe atë çka rrezikonin kërkuesit, gjykatat duhet të kishin vepruar me "zell të pazakontë" gjatë vendosjes rreth çështjes. Prandaj Gjykata vendosi që kohëzgjatja e procedurave administrative kishte qenë e tepërt, në shkelje të Nenit 6. Duke kujtuar që ajo tashmë kishte gjetur në të drejtën e së kaluarës që sistemi ligjor turk nuk kishte ofruar zgjidhje efektive aty ku kohëzgjatja e procedurave mund të ishte kontestuar me sukses, Gjykata më tej gjeti që kishte pasur shkelje të Nenit 13.

Neni 41

Gjykata deklaroi që kërkuesve duhet t'u paguheshin 300,000 Euro për dëme materiale, 78,000 Euro për dëme jomateriale, dhe 3,000 Euro për kosto dhe shpenzime. Përveç kësaj, Qeveria duhet të ofronte mbulesë falas dhe të plotë për kërkuesin e parë për tërë jetën e tij.

Ankesa në lidhje me përdorimin e dezinfektantëve në vend të programit për shkëmbimin e shiringave në burgje për të parandaluar përhapjen e infeksioneve e shqyrtuar sipas Neneve 8 dhe 14 - u deklarua e papranueshme

VENDIMI NË LIDHJE ME PRANUESHMËRINË E SHELLEY K. MBRETËRISË SË BASHKUAR

(Kërkesa Nr. 23800/06)
4 dhjetor 2008

1. Faktet kryesore

Kërkuesi ishte i lindur në vitin 1972 dhe, në kohën e këtij vendimi, ishte duke vuajtur dënimin në Burgun H.M. Ëhitemoor.

Studimet zyrtare tregonin që përdorimi intravenoz i drogës ndodhte në masë të madhe nëpër burgjet e Mbretërisë së Bashkuar. Ndarja e shiringave mes njëri-tjetrit përmbante rrezikun e infektimit nga viruset përfshirë HIV dhe Hepatit C, të cilat paraqisnin rreziqe shëndetësore serioze, dhe mund të rezultonte me vdekje. Burgjet ofronin tableta dezinfektuese për të pastruar shiringat në përpjekje për të reduktuar këtë rrezik infeksioni, e megjithatë studimet tregonin se kjo nuk ishte aq efektive sa programet për shkëmbimin e shiringave (ang. NEP), të cilat i ofroheshin popullatës së përgjithshme por jo asaj të burgut.

Kërkuesi nuk specifikoi nëse ai ishte përdorues droge apo kishte vuajtur nga efektet shëndetësore të ndarjes së shiringave mes të burgosurve. Ai kishte kërkuar leje për shqyrtim gjyqësor të vendimit për të ofruar tableta dezinfektuese në vend të NEP. Kjo u refuzua dhe më tej u hodh poshtë nga Gjykata e Apelit, e cila vuri në dukje se nuk kishte prova bindëse lidhur me përfitimet shtesë të NEP në krahasim me skemat e dezinfektimit. Për më tepër, ajo kishte shqetësimin që NEP mund të ishin në konflikt me politikën e Qeverisë për të reduktuar përdorimin e drogës në burgje. Sidoqoftë, ajo theksoi se çështja duhet të mbahej nën shqyrtim.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi u ankua sipas Neneve 2, 3 dhe 8 që autoritetet kishin dështuar në marrjen e hapave drejt parandalimit të rrezikut ndaj jetës, shëndetit dhe mirëqenies së tij, duke refuzuar të fusnin NEP për përdorim në burg. Më tej, ai u

ankua sipas Nenit 14 që ndaj tij kishte pasur diskriminim, meqenëse personat në burg trajtoheshin në mënyrë më pak të favorshme sesa personat në komunitet.

Nenet 2, 3 dhe 8

Gjykata theksoi se ankesa kishte të bënte me situatën e përgjithshme në sistemin e burgjeve. Megjithëse pranoi se kishte prova të mjaftueshme që tregonin nivele më të larta të infeksioneve me HIV dhe Hepatit C në popullatën e burgut, ajo nuk ishte e bindur që rreziku, apo frika, e përgjithshme e paspecifikuar, e infektimit ishte mjaftueshëm e rreptë sa për të ngritur çështje sipas Neneve 2 dhe 3.

Më tej ajo mori në konsideratë shkallën në të cilën Neni 8, në mbrojtjen e integritetit fizik dhe moral, mund t'u ketë kërkuar autoriteteve të merrnin masa të veçanta parandaluese për t'u bërë ballë nivelit të infeksioneve nëpër burgje. Ajo pranoi se kërkuesi kishte kërkuar statusin e viktimës për shkak të të qenit në burg, ku kishte rrezik më të lartë të infeksionit me HIV dhe Hepatit C, dhe se ai mund të ndikohej nga politika shëndetësore e autoriteteve të burgut. Megjithatë, ajo shënoi që nuk kishte autoritet që vendoste ndonjë detyrim të Nenit 8 mbi një Shtet në mënyrë që ky i fundit të ndiqte politika të caktuara parandaluese shëndetësore, në vend të politikave të përgjithshme shëndetësore. Ndërkohë që Gjykata nuk përjashtoi mundësinë e daljes në pah të një detyrimi pozitiv për të parandaluar përhapjen e një infeksioni të caktuar, ajo nuk ishte e bindur që një kërcënim i mundshëm ndaj shëndetit që nuk plotësonte standardet e Nenit 2 ose 3 impononte një detyrim ndaj Shtetit për të marrë masa parandaluese të veçanta.

Çështjet e politikave shëndetësore ishin brenda hapësirës vlerësuese të autoriteteve vendore. Kërkuesi nuk mundi të jepte një shembull të veçantë të ndonjë efekti negativ direkt mbi jetën e tij private, e as nuk iu mohuan informatat apo ndihmesa në lidhje me ndonjë kërcënim ndaj shëndetit të tij për të cilin autoritetet ishin përgjegjëse.

Me rezervat e duhura ndaj: vendimeve mbi burimet dhe prioritetet, një politikë legjitime për reduktimin e përdorimit të drogës në burgje, hapat parandaluese të marra në formën e tabletave dezinfektuese dhe faktin që autoritetet ishin duke monitoruar zhvillimet, Gjykata arriti në përfundimin që Qeveria nuk kishte dështuar në respektimin e jetës private të kërkuesit sipas Nenit 8.

Prandaj, kjo pjesë e kërkesës u hodh poshtë si dukshëm e pabazuar dhe u deklarua e papranueshme.

Neni 14 në lidhje me Nenin 8

Gjykata përsëriti, për qëllime të Nenit 14, se dallimi mes trajtimit të personave në pozicione analoge ose të ngjashme është diskriminues nëqoftëse ai nuk ka justifikim objektiv ose të arsyeshëm. Për më tepër, Shtetet gëzojnë hapësirë vlerësuese në aspekt të VENDIMIT nëse dhe në ç'masë dallimet në situata të ngjashme justifikojnë dallimin në trajtim. U shënua që të burgosurit nuk i kishin humbur të drejtat e tyre të Konventës, sadoqë mënyra dhe shkalla në të cilën ata mund t'i gëzonin ato të drejta ndikoheshin në mënyrë të pashmangshme nga konteksti.

Fakti nëse kërkuesi mund të pretendonte se ishte në pozicion analog varej nga subjekti i ankesës së tij. U vu re që Rregullat Evropiane të Burgut, Komiteti për Parandalimin e Torturës (ang. CPT) dhe rregulloret vendase të burgut deklarorin që kujdesi shëndetësor në burgje duhet të jetë i njëjtë me atë në komunitet. Prandaj, Gjykata ishte e përgatitur të supozonte që të burgosurit mund të pretendonin se ishin në të njëjtën situatë me komunitetin për sa i përket kësaj çështjeje.

Megjithatë, Gjykata arriti në përfundimin që dallimi mes politikave parandaluese hynte brenda hapësirës vlerësuese të Shtetit, ishte proporcional, dhe ishte i mbështetur në justifikime objektive dhe të arsyeshme. Ky përfundim nxirrej nga: gëzimi nga Shteti i një hapësire veçanërisht të gjerë vlerësimi lidhur me masat parandaluese; mungesa e udhërrëfyesit nga CPT në lidhje me NEP specifikisht; fakti që rreziku i infeksionit rridhte kryesisht nga sjellja e vetë të burgosurve për çka ata e dinin, ose duhet ta kishin ditur, që ishte e rrezikshme për shëndetin e tyre; konsideratat e politikave të cilat bënin që autoritetet të vinin në dispozicion dezinfektantët; dhe zotimi për të marrë në konsideratë NEP në të ardhmen përmes monitorimit të ofrimit të tyre diku tjetër.

Prandaj, kjo pjesë e kërkesës gjithashtu u hodh poshtë si dukshëm e pabazuar dhe u deklarua e papranueshme.

Dështimi për të trajtuar pretendimin e kërkesit lidhur me vdekjen e djalit të vet ka shkelur aspektin procedural të Nenit 2

VENDIMI I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN ŠILIH K. SLOLOVENISË

(Kërkesa Nr. 71463/01)

9 prill 2009

1. Faktet kryesore

Franja dhe Ivan Šilih ishin shtetas slovenë të lindur në vitet 1949 dhe 1940, me banim në Slovenj Gradec.

Biri i kërkesve, Gregor Šilih, 20 vjeç, vdiq në spital më 19 maj 1993 pasi pësoi shok anafilaktik, me gjasë si pasojë e reagimit alergjik ndaj njërit prej ilaçeve të administruara nga një mjek në përpjekje për të trajtuar urtikarien e tij (vraja ose puçrrat e hithrës).

Më 13 maj 1993 kërkesit bënë një ankesë penale kundër mjekut dezurn për neglizhencë mjekësore, e cila u rrëzua për mungesë provash të mjaftueshme.

Më 1 gusht 1994, pas hyrjes në fuqi të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në lidhje me Slloveninë, kërkesit shfrytëzuan të drejtën e tyre sipas Aktit të Procedurës Penale të Sllovenisë si palë e dëmtuar për të vepruar si prokurorë dhe bënë një kërkesë për hapjen e hetimeve penale. Hetimet u rihapën më 26 prill 1996 dhe aktakuza u ngrit më 28 shkurt 1997; çështja u ridërgua dy herë për hetime të mëtejshme para se hetimet penale të ndërpriteshin më 18 tetor 2000 sërish mbi bazën e provave të pamjaftueshme. Kërkesit apeluan pa sukses.

Në ndërkohë, më 6 korrik 1995 kërkesit gjithashtu hapën procedurë civile kundër spitalit dhe mjekut në fjalë. Procedura e shkallës së parë, e pezulluar mes tetorit 1997 dhe majit 2001, u mbyll me rrëzimin e pretendimit në datën 25 gusht 2006, më shumë se 11 vjet pas nisjes fillestare të procedurës. Gjatë asaj periudhe, çështja u trajtua nga të paktën gjashtë gjyqtarë të ndryshëm. Në vijim, kërkesit bënë apel dhe një apel në lidhje me çështje të ligjit, ku të dy apelet qenë të pasuksesshme.

Në kohën e VENDIMIT të Gjykatës Evropiane, çështja ishte ende në pritje para Gjykatës Kushtetuese.

2. Vendimi i Gjykatës

Në VENDIMIN e saj të Dhomës më 28 qersor 2007, Gjykata shpalli njëzëri që kishte pasur shkelje të Nenit 2 të Konventës. Më 27 shtator 2007 Qeveria kërkoi që çështja t'i referohej Dhomës së Madhe sipas Nenit 43 dhe kërkesa u pranua.

Kërkuesit u ankuan për inefikasitetin e sistemit gjyqësor slloven në përcaktimin e përgjegjësisë për vdekjen e djalit të tyre, në shkelje të së drejtës për jetë nga Neni 2. Duke u mbështetur më tej në të drejtën për seancë dëgjimore të drejtë tek Neni 6 dhe të drejtën për zgjidhje efektive tek Neni 13, ata pretenduan se procedurat ligjore ishin tejet të zgjata dhe që procedurat penale ishin të padrejta.

Neni 2

Gjykata së pari deklaroi që ankesa procedurale e kërkuesve në thelb kishte lidhje me procedurat gjyqësore që ishin zhvilluar pas hyrjes në fuqi të Konventës me qëllim të përcaktimit të rrethanave në të cilat kishte vdekur biri i kërkuesve dhe të përgjegjësisë për të. Andaj, ndërhyrja e pretenduar me Nenin 2 në aspektin e saj procedural hynte brenda juridiksionit të përkohshëm të Gjykatës, dhe kufizohet me të përcaktuarit nëse ngjarjet e ndodhura pas hyrjes në fuqi të Konventës në lidhje me Slloveninë zbulonin shkelje të asaj dispozite.

Gjykata shënoi që palët nuk e vinin në diskutim faktin që gjendja e Gregor Šilih kishte nisur të përkeqësohej shumë në spital dhe që vdekja e tij mbase kishte pasur lidhje me trajtimin mjekësor të tij aty. Duke marrë parasysh se kërkuesit pretendonin që biri i tyre kishte vdekur si pasojë e neglizhencës mjekësore, Shteti, për të vepruar në përputhje me detyrimet e tij sipas Nenit 2, duhet të ngrinte një sistem gjyqësor efektiv dhe të pavarur për të përcaktuar shkakun e vdekjes dhe për të kërkuar llogari nga ata që mbanin përgjegjësi.

Kërkuesit shfrytëzuan dy zgjidhje ligjore, penale dhe civile, me qëllim që të përcaktoheshin rrethanat dhe përgjegjësia për vdekjen e birit të tyre.

Gjykata konsideroi që gjatësia e tepërt e procedurave penale, dhe në mënyrë të veçantë e hetimeve, nuk mund të justifikohet as nga sjellja e kërkuesve e as nga kompleksiteti i çështjes.

Procedura penale e nisur më 6 korrik 1995, deri më shumë se 13 vjet më vonë ishte ende në pritje para Gjykatës Kushtetuese. Duhet shënuar se, megjithëse

ajo procedurë ishte pezulluar për tri vjet e shtatë muaj në pritje të rezultatit të procedurës penale, ajo në fakt kishte qenë vendnumëro tashmë qysh dy vjet përpara. Në të vërtetë, edhe pas ndërprerjes së procedurës penale në tetor 2000, gjykatave vendase iu deshën pesë vjet e tetë muaj të tjerë për të vendosur në lidhje me padinë civile të kërkuësve.

Kërkesat e kërkuësve për ndryshimin e vendit dhe për tërheqjen e gjyqtarëve të caktuar u pranua që i kishin vonuar procedurat deri në njëfarë mase; megjithatë, vonesat që kishin ndodhur pas heqjes së pezullimit shpesh nuk kishin qenë të arsyeshme. Disa seanca dëgjimore, për shembull, ishin vonuar deri në nëntë ose dhjetë muaj thjesht për shkak të ndryshimit të vendit ose si pasojë e faktit që çështja ishte marrë në dorë nga një gjyqtar tjetër sërish. Vlente të shënohej, Gjykata deklaroi, se gjyqtari i gjashtë dhe i fundit kishte arritur ta përfundonte procedurën e shkallës së parë në më pak se tre muaj.

Së fundi, ishte e pakënaqshme që çështja e kërkuësve ishte trajtuar nga të paktën gjashtë gjyqtarë të ndryshëm në një dorë të vetme procedurash të shkallës së parë. Ndërkohë që gjykatat vendase ishin më të përgatitura për të vlerësuar nëse një gjyqtar individual mund të shërbente në një çështje të dhënë, ndryshimi i shpesh të i gjyqtarit në fjalë duhet të ketë penguar procedimin efektiv.

Prandaj, Gjykata doli në përfundimin që autoritetet vendase kishin dështuar në trajtimin e ankesës së kërkuësve në lidhje me vdekjen e birit të tyre në masën e zellit të kërkuar nga Neni 2. Rrjedhimisht, kishte pasur shkelje të Nenit 2 për shkak të paefikasitetit të sistemit gjyqësor slloven për të përcaktuar shkakun e vdekjes së birit të kërkuësit dhe përgjegjësinë për të.

Nenet 6 dhe 13

Duke pasur parasysh arsyetimin që shpuri tek gjetja nga Gjykata e një shkeljeje të Nenit 2, ajo deklaroi se nuk kishte nevojë që çështja të shqyrtohej ndaras sipas Neneve 6 dhe 13.

Neni 41

Gjykata u caktoi kërkuësve shpërblimet në shumën 7,540 Euro për dëme jomateriale dhe 4,039 Euro për kosto dhe shpenzime.

Mbajtja e një njeriu mendërisht të sëmurë në burg, e jo në institucion mjekësor, në kushte të papërshtatshme jetese dhe nën kujdes të pamjaftueshëm psikiatrik, ka shkelur Nenin 3 dhe Nenin 5 §§ 1,4 dhe 5

VENDIMI NË ÇËSHTJEN STRAZIMIRI k. SHQIPËRISË

(Kërkesa Nr. 34602/16)

21 janar 2020

1. Faktet Kryesore

Kërkuesi ishte shtetas shqiptar i lindur në vitin 1973. Në kohën e VENDIMIT të Gjykatës Evropiane ai kishte qenë duke u mbajtur në Spitalin e Burgut të Tiranës qysh në vitin 2011.

Kërkuesi u arrestua në vitin 2008 për vrasje të paramenduar në tentativë dhe u gjykua. Gjykata e Rrethit të Tiranës gjeti që kërkuesi e kishte kryer veprën, por që ai ishte i liruar nga përgjegjësia penale për shkak të sëmundjes së tij mendore, meqenëse ai vuante nga skizofrenia paranoiake. Gjykata e Rrethit urdhëroi që kërkuesi të merrte "trajtim mjekësor të detyrueshëm në një institucion mjekësor" në përputhje me Nenin 46 të Kodit Penal. Kërkuesi fillimisht u dërgua në burgun e Krujës në vitin 2009, dhe më pas u transferua në Spitalin e Burgut të Tiranës në vitin 2011.

Situata e kërkuesit u shqyrtua disa herë mes viteve 2010 dhe 2014 nga Gjykata e Rrethit të Tiranës, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme. Në secilin rast, u gjet që trajtimi i tij i detyrueshëm mjekësor në një institucion mjekësor duhet të vazhdohej. Kjo u justifikua nga gjendja shëndetësore e kërkuesit, tentativat e tij për vetëvrasje dhe pamundësia e familjes së tij për të siguruar kushtet e nevojshme për gjendjen e tij shëndetësore po qe se ai do të lirohej. Duke marrë parasysh këto faktorë, Gjykata e Rrethit arriti në përfundimin, në secilin shqyrtim, që trajtimi i detyrueshëm i kërkuesit në një institucion mjekësor ishte e vetmja masë që përputhej me rrezikun që paraqiste ai, nevojën për vëmendje të vazhdueshme ndaj jetës dhe shëndetit të tij, dhe mbrojtjen e anëtarëve të familjes së tij dhe pjesëtarëve të komunitetit.

Më 17 shtator 2014, kërkuesi bëri një ankesë në Gjykatën e Rrethit, pjesërisht duke u mbështetur në Nenin 3 dhe 5 të Konventës. Ai kërkoi që t'i jepej fund mbajtjes së tij në Spitalin e Burgut dhe diskutoi që, meqenëse ai nuk ishte as i burgosur në vuajtje të dënimit e as në pritje të VENDIMIT, vendosja e tij në një institucion penal

ishite në kundërshtim me të drejtën vendase. Në vend të kësaj, ai duhet të vendosej në një institucion mjekësor special, siç ishte urdhëruar nga Gjykata e Rrethit.

Kërkuesi më tej pretendoi që kushtet e mbajtjes së tij dhe trajtimi mjekësor që merrete në Spitalin e Burgut përbënin trajtim çnjerëzor dhe poshtëruës, që ambientet e burgut ishin konsideruar nga Komisioni Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin apo Ndëshkimit Çnjerëzor ose Poshtëruës ("CPT") si çnjerëzore dhe poshtëruese dhe që, sipas protokollit mbi diagnostikimin dhe kujdesin terapeutik të skizofrenisë i miratuar nga Ministria e Shëndetësisë, sëmundja e tij duhet të trajtohej përmes një kombinimi të mjekimit me terapi të tjera mbështetëse. Në atë kohë, trajtimi i tij mjekësor kryesisht përbëhej nga marrja e ilaçeve psikotropike.

Më 20 nëntor 2014, të dy ankesat u rrëzuan nga Gjykata e Rrethit si dukshëm të pabazuara. Gjykata e Rrethit u pajtua me parashtrësën e prokurorisë që vendosja e kërkuesit në Spitalin e Burgut nuk ishte në kundërshtim me ligjin, meqenëse në atë kohë në Shqipëri faktikisht nuk ekzistonte asnjë institucion mjekësor special për individë për të cilët gjykata urdhëronte trajtim mjekësor të detyruar për çrregullime mendore. Prandaj mbajtja e tij në një institucion penal nuk do të ishte e paligjshme për sa kohë që nuk ndërtohej një institucion i tillë.

Gjykata e Apelit e mbështeti këtë vendim, dhe apeli i kërkuesit para Gjykatës Supreme ishte ende në pritje në kohën kur Gjykata shpalli VENDIMIN e saj.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi pretendoi që mungesa e trajtimit të duhur mjekësor gjatë mbajtjes së tij, e kombinuar me kushtet e këqija të mbajtjes së tij, përbënin shkelje të Nenit 3 të Konventës. Gjithashtu, ai pretendoi shkelje të të drejtave të tij sipas Nenit 5 §§ 1, 4 dhe 5 sepse mbajtja e tij i kufizuar në burg ishte jo e ligjshme ose në përputhje me ligjin, atij nuk i ishte dhënë mundësia për të shqyrtuar me shpejtësi ligjshmërinë e mbajtjes së tij në burg nga një gjykatë dhe ai nuk kishte pasur qasje ndaj një zgjidhjeje efektive kompensuese në lidhje me ankesat e tij sipas Nenit 5. Më tej, ai pretendoi shkelje të Neneve 13 dhe 14.

Neni 3

Për sa i përket kushteve të mbajtjes në burg, Gjykata mori parasysh raportet e hartuara mes viteve 2015 dhe 2019 nga Zyra e Avokatit të Popullit të Shqipërisë

dhe CPT-ja, ku u gjet se Spitali i Burgut të Tiranës ishte në gjendje të avancuar rrënimi, me lagështi gjithandej dhe thujse me mungesë të tërësishme të ngrohjes qendrore. Gjithashtu, Gjykata ishte e shqetësuar për papërshtatshmërinë e aktiviteteve në ajër të pastër në dispozicion për pacientët. U konsiderua që kërkuesi ishte ndikuar direkt nga përkeqësimi i tërësishëm i kushteve të institucionit.

Sa i përket trajtimit mjekësor të kërkuesit, Gjykata deklaroi se ndihma mjekësore nuk konsiderohet "e përshtatshme" vetëm për shkak se i mbajturi në burg është vizituar nga mjeku dhe i është parashkruar një lloj recete mjekësore. Aty ku nevojitet, sipas llojit të sëmundjes, mbikqyrja duhet të ishte e rregullt, sistematike, dhe të përfshinte një strategji të tërësishme terapie me qëllim të trajtimit të duhur të problemeve shëndetësore të të mbajturit. Megjithatë kërkuesi ishte trajtuar me medikamente për problemet e tij shëndetësore, Gjykata gjeti që nuk kishte tregues se kishte pasur ndonjë strategji të tërësishme terapie, ose ndonjë plan të individualizuar trajtimi për të.

Gjithashtu, Gjykata deklaroi që do të merrte parasysh ndjeshmërinë e individit në fjalë, përfshirë kapacitetin e tij për t'u ankuar rreth efekteve të trajtimit të marrë. Në përgjigje ndaj ankesave të kërkuesit, Gjykata gjeti që si gjykatat vendase ashtu edhe autoritetet prokuroriale thjesht kishin konstatuar që në vend nuk ekzistonin institucione mjekësore speciale për të sëmurët mendorë të cilat urdhëroheshin për të realizuar trajtim të detyruar. Gjykata shënoi se, të paktën që nga viti 2014, CPT-ja kishte përshkruar shumë pacientë psikiatrie si kërkuesi si të atillë që ndodheshin në gjendje "braktisjeje terapeutike".

Prandaj, Gjykata arriti në përfundimin që efekti kumulativ i përkeqësimit të kushteve të jetesës në të cilat ishte kufizuar kërkuesi që nga viti 2011, dhe trajtimi i pamjaftueshëm psikiatrik dhe terapeutik dhënë atij përbënin trajtim çnjerëzor dhe poshtërues, në shkelje të Nenit 3.

Neni 5 § 1

Ishte e padiskutueshme që mbajtja e kërkuesit në burg mbulohej nga Neni 5 § 1 (e) i Konventës. Prandaj, Gjykata vlerësoi nëse mbajtja e tij në burg si "person me mendje jo të shëndoshë" kishte qenë "e ligjshme", duke pasur parasysh gjetjet e saj nga Neni 3 dhe përshtatshmërinë e institucionit në të cilin ai ishte mbajtur në burg.

Gjykata deklaroi që kishte një lidhje të ngushtë mes "ligjshmërisë" së mbajtjes së në burg të personave që vuanin nga çrregullimet mendore dhe

përshtatshmërisë së trajtimit të ofruar për sëmundjet e tyre mendore, përfshirë administrimin e terapive të përshtatshme. Gjykata afirmoi që çdo mbajtje në burg e një personi mendërisht të sëmurë duhet të ketë një qëllim terapeutik, me synim të shërimit ose lehtësimit të gjendjes së tyre të shëndetit mendor, përfshirë, aty ku duhet, reduktimin ose kontrollimin e rrezikshmërisë së tyre. Kështu, Gjykata do të verifikonte nëse ishte hartuar ndonjë program i individualizuar, duke marrë parasysh hollësitë specifike të shëndetit mendor të të burgosurit me qëllim të përgatitjes së tij ose të saj për riintegrim të mundshëm në shoqëri në të ardhmen.

Gjykata mori në konsideratë raportet e CPT-së të cilat në vazhdimësi kritikonin vendosjen në qendra penale të “personave me mendje jo të shëndoshë” të cilët përjashtoheshin nga përgjegjësia penale, dhe theksoi që Spitali i Burgut nuk ishte institucion i përshtatshëm për mbajtjen e individëve mendërisht të sëmurë të cilët i nënshtroheshin trajtimit mjekësor me urdhër të gjykatës. Gjithashtu, Gjykata pati parasysh vëzhgimet e Avokatit të Popullit që mbajtja në burg e individëve të tillë në qendra penale shkelte të drejtën vendase, e cila thoshte se ata duhet të vendoseshin në një institucion mjekësor special të integruar në sistemin shëndetësor e jo në sistemin penal.

Ky dështim i gjatë i autoriteteve shqiptare për ngritjen e një institucioni të tillë, në kundërshtim të dukshëm me detyrimet e tyre statutores në vend që nga viti 2012, u gjet të ishte tregues i një problemi më të gjerë strukturor, i cili mbetej i pazgjidhur.

Së fundi, Gjykata vërejti që autoritetet kishin dështuar të merrnin në konsideratë mënyrat alternative të vendosjes së kërkuesit jashtë qendrave penale, për shembull në një qendër civile të shëndetit mendor. Përkundrazi, ata ishin mjaftuar në vazhdimësi me gjetjen që familja e kërkuesit nuk ishte në gjendje të ofronte kushte të përshtatshme për sëmundjen e tij.

Prandaj, Gjykata gjeti që kërkuesit nuk ishin ofruar mjedisi terapeutik i përshtatshëm për një person të burgosur për shkak të çrregullimeve mendore, dhe privimi i vazhdueshëm i lirisë së tij ishte i paligjshëm dhe shkelte kriteret e Nenit 5 § 1 (e) të Konventës.

Neni 5 § 4

Gjykata gjeti që çështjet e përputhshmërisë me këtë të drejtë duhet të përcaktohen nën dritën e rrethanave të secilit rast, përfshirë kompleksitetin e

procedurave, zhvillimin e tyre nga autoritetet vendase dhe nga kërkuesi, dhe çfarë rrezikonte të humbiste kërkuesi. Gjykata konsideroi që vonesa prej më shumë se tre vitesh për të adresuar apelin e kërkuesit para Gjykatës Supreme i atribuohet tërësisht autoriteteve. Prandaj, procedurat nuk ishin në përputhje me të drejtën e garantuar nga Neni 5 § 4 për vendim të shpejtë gjyqësor lidhur me ligjshmërinë e mbajtjes në burg. Rrjedhimisht, kishte pasur shkelje të Nenit 5 § 4.

Neni 5 § 5

Gjykata arriti në përfundimin që kërkuesi nuk kishte pasur të drejtën e zbatueshme për kompensim në lidhje me shkeljet e Neneve 5 §§ 1 dhe 4, që do të thotë se kishte pasur po ashtu shkelje të Nenit 5 § 5 të Konventës.

Nenet 13 dhe 14

Gjykata konsideroi që, duke pasur parasysh gjetjet e saj nga Nenet 3 dhe 5, ishte e panevojshme të shqyrtoheshin ndaras ankesat sipas Neneve 13 dhe 14.

Neni 46

Në lidhje me kërkuesin, Gjykata deklaroi që autoritetet duhet siguronin me urgjencë administrimin e formave të duhura dhe të individualizuara të terapisë, dhe të merrnin në konsideratë mundësinë e vendosjes së tij në një ambient alternativ jashtë qendrave penale.

Gjithashtu, Gjykata deklaroi që Shteti përgjegjës duhet të krijonte një "institucion të përshtatshëm" që do të siguronte kushte të përshtatshme jetese dhe ofrimin e shërbimeve të nevojshme të kujdesit shëndetësor për personat mendërisht të sëmurë të cilëve u hiqet liria mbi bazën e trajtimit të detyrueshëm mjekësor me urdhër të gjykatës. Një institucion i tillë do të duhej të vepronte në përputhje me qëllimin terapeutik të kësaj forme të heqjes së lirisë.

Neni 41

Gjykata caktoi shpërblimin në shumën 15,000 Euro për kërkuesin në lidhje me dëme jomateriale dhe në shumën 2,500 për kosto dhe shpenzime.

III. Përrjashtimi dhe ekstradimi

*Dështimi i autoriteteve për të konsideruar shëndetin e kërkuesit dhe
impaktin largimit të tij mbi jetën e tij familjare gjatë procedurës
së largimit kanë përbërë shkelje të Nenit 3 dhe Nenit 8*

VENDIMI I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN PAPOSHVILI k. BELGJIKËS

(Kërkesa Nr. 41738/10)
13 dhjetor 2016

1. Faktet kryesore

Kërkuesi, Georgie Paposhvili, ishte shtetas gjeorgjian i cili ishte i lindur në vitin 1958 dhe jetonte në Bruksel. Më 20 qershor 2016, gruaja e kërkuesit dhe tre fëmijët e tij shprehën dëshirën që të hapnin procedura para Gjykatës.

Z. Paposhvili kishte ardhur në Belgjikë më 25 nëntor 1998, i shoqëruar nga gruaja e tij dhe fëmija i tyre gjashtëvjeçar. Më pas çiftit i lindën edhe dy fëmijë të tjerë. Mes vitit 1998 dhe vitit 2007, Z. Paposhvili u dënua për një sërë veprash, përfshirë grabitje të armatosur dhe pjesëmarrje në një organizatë kriminale. Gjatë vuajtjes së dënimeve të ndryshme me burg, Z. Paposhvili u diagnostikua me disa sëmundje serioze, përfshirë leuçemi limfocite kronike dhe tuberkuloz, për të cilat ai mori trajtim në spital. Ai bëri disa kërkesa të pasuksesshme për rregullimin e statusit të qëndrimit (rezidencës) të tij për arsye të pazakonta ose mjekësore duke u mbështetur në Nenet 3 dhe 8 dhe duke pretenduar se ai nuk do të kishte mundësi të merrte trajtim po qe se do të kthehej në Gjeorgji.

Në gusht të vitit 2007, Ministri i Brendshëm mori një urdhër deportimi sipas të cilit kërkuesit duhet të largohet nga vendi, dhe e ndaloi atë nga ri-hyrja në Belgjikë për dhjetë vjet për shkak të rrezikut që i kanosej rendit publik prej tij. Urdhri u bë i zbatueshëm pasi Z. Paposhvili e kishte kryer dënimin e tij por në fakt nuk u zbatua sepse ai ishte duke kaluar nëpër trajtim mjekësor. Më 7 korrik 2010 Zyra e të Huajve lëshoi një urdhër që ai të ikte nga vendi, bashkë me një urdhër për paraburgimin e tij. Ai u transferua në një objekt të sigurisë për imigrantët e paligjshëm me qëllim që kthimit të tij në Gjeorgji, dhe për këtë iu lëshuan dokumentet e udhëtimit.

Më 23 korrik 2010 Z. Paposhvili bëri kërkesë pranë Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut për një masë të përkohshme sipas Rregullës 39 të Rregullave të saj të Gjykatës që pezullonte largimin e tij; kërkesa u pranua. Pas kësaj ai u lirua. Afati kohor për zbatimin e urdhrin për t'u larguar nga territori belg u shty disa herë. Në nëntor gruas dhe tre fëmijëve të kërkuarit iu dha leje e pacaktuar për të qëndruar në Belgjikë. Mes viteve 2012 dhe 2015 Z. Paposhvili u arrestua disa herë për disa raste të vjedhjeve në dyqane.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuari, duke u mbështetur në të drejtën e tij për jetë sipas Nenit 2 dhe ndalimin e trajtimit çnjerëzor dhe poshtëruar sipas Nenit 3, pretendoi që ishin shfaqur prova substanciale për të besuar se po të ishte përjashtuar për në Gjeorgji, ai do të ishte përballur me rrezikun real të trajtimit çnjerëzor dhe poshtëruar dhe me vdekje të parakohshme. Ai gjithashtu u ankua, sipas Nenit 8, që largimi i tij do të kishte rezultuar në ndarjen e tij prej familjes, e cila ishte burimi i vetëm i përkrahjes morale për të.

Një Dhomë e Gjykatës vendosi më 17 prill 2014 që nuk kishte pasur shkelje të Nenit 2, 3 ose 8. Më 20 prill 2005 kolegji i Dhomës së Madhe pranoi një kërkesë në emër të kërkuarit që çështja t'i delegohej Dhomës së Madhe sipas Nenit 43 të Konventës. Gjykata gjeti që, duke marrë parasysh natyrën e pretendimeve dhe rolin e sistemit të Konventës, ajo nuk ndalohej prej dëgjimit të çështjes, pavarësisht se kërkuari kishte vdekur.

Nenet 2 dhe 3

Gjykata riafirmoi të drejtën e të gjitha Shteteve Kontraktuese për të kontrolluar hyrjen, qëndrimin dhe përjashtimin e të huajve. Megjithatë, nëse kishte baza substanciale për të besuar se personi në fjalë, pas përjashtimit, do të përballej me rrezikun real të nënshtrimit ndaj torturës apo trajtimit çnjerëzor ose poshtëruar, Neni 3 kërkon që personi të mos përjashtohet. Se çfarë konsiderohet keqtrajtim varet nga rrethanat e rastit, si kohëzgjatja e trajtimit, efektet e tij fizike dhe mendore, dhe në disa raste nga seksi, moshja dhe gjendja shëndetësore e viktimës. Vuajtja që vjen nga një sëmundje natyrale po ashtu mund të mbulohet nga Neni 3, kur ajo rrezikon të përkeqësohet nga trajtimi për të cilin janë përgjegjëse autoritetet.

Gjykata, pas shqyrtimit të praktikës së saj gjyqësore, konkludoi që zbatimi i Nenit 3 nga Gjykata deri në atë moment nuk u ofronte mbrojtje të mjaftueshme të huajve që ishin të sëmurë rëndë (në krahasim me ata që janë në prag të vdekjes). Gjykata konsideroi që termi "raste të tjera shumë të pazakonta" i përdorur në praktikën e mëhershme gjyqësore i cili mund të ngrejë çështje sipas Nenit 3 duhet të kuptohet si i tillë që i referohet situatave që kanë të bëjnë me largimin e një personi të sëmurë rëndë kur janë treguar baza substanciale për të besuar se ai ose ajo do të përballej me rrezikun real, për shkak të mungesës së trajtimit të duhur në vendin pritës ose mungesës së qasjes në këtë trajtim, të përballjes me rënien serioze, të shpejtë dhe të pakthyeshme të gjendjes së tij/saj shëndetësore duke rezultuar me vuajtje të mëdha ose një reduktim i madh i jetëgjatësisë së pritshme.

Shteti është i detyruar të vlerësojë rreziqet që do të haste kërkuesi po të largohej drejt vendit pritës për të vepruar në përputhje me detyrimin e tij negativ për të mos i ekspozuar personat ndaj rrezikut të keqtrajtitimit. Shteti duhet të verifikojë nëse kujdesi përgjithësisht në dispozicion në Shtetin pritës është i mjaftueshëm dhe i përshtatshëm në praktikë për trajtimin e sëmundjes së kërkuesit dhe nëse personi në fjalë faktikisht do të ketë qasje në kujdes së tillë. Nëse vazhdon të ketë dyshime serioze rreth impaktit të largimit, Shteti kthyes duhet të marrë garanci individuale dhe të mjaftueshme nga Shteti pritës që individit do t'i vihet në dispozicion trajtimi i duhur. Këtu, kërkuesi kishte paraqitur dokumentacion mjekësor të gjerë ku tregohet me hollësi se si trajtimi i marrë në Belgjikë e kishte stabilizuar gjendjen e tij dhe që nëse trajtimi ndërpritej jetëgjatësia e pritshme e tij do të ishte më pak se gjashtë muaj. Kërkuesi po ashtu kishte parashtruar që në Gjeorgji nuk kishte as trajtim e as transplantim nga dhuruesit.

Pavarësisht nga faktet e lartpërmendura, kërkesat e kërkuesit për qëndrim të rregullt për arsye mjekësore u refuzuan nga Zyra për të Huajt. Bordi i Apelit për të Huajt vendosi që, kur autoriteti administrativ paraqiste baza për përjashtim, nuk ishte e nevojshme që ai të shqyrtonte provat mjekësore që i vinin përpara. Në lidhje me ankesën e bazuar mbi Nenin 3 të Konventës, Bordi i Apelit për të Huajt më tej shënoi që vendimi për të refuzuar lejen për vazhdimin e qëndrimit nuk ishte shoqëruar nga masa për largim, me rezultatin që rreziku i ndërprerjes së trajtimit të kërkuesit në rast kthimi në Gjeorgji ishte thjesht hipotetik. Conseil d'État (këshilli i shtetit), pranë të cilit kërkuesi kishte aplikuar për çështje të ligjit, e mbështeti arsyetimin e Bordit të Apelit për të Huajt.

Prandaj, Gjykata konkludoi që për shkak se certifikatat mjekësore të kërkuesit nuk ishin shqyrtuar nga Zyra për të Huajt ose nga Bordi i Apelit për të Huajt

nga këndvështrimi i Nenit 3 gjatë procedurave të rregullimit të qëndrimit ose të largimit, nëqoftëse kërkuesi do të ishte kthyer në Gjeorgji do të kishte pasur shkelje të Nenit 3. Kështu, Gjykata vendosi që ishte e nevojshme të merrej në konsideratë Neni 2 i Konventës.

Neni 8

Në kontekst të procedurave për rregullimit të qëndrimit për arsye mjekësore, Bordi i Apelit për të Huajt e kishte rrëzuar ankesën e Z. Paposhvili sipas Nenit 8 me arsyetimin që vendimi për refuzimin e lejes së tij për të qëndruar nuk ishte shoqëruar nga masa për largimin e tij. Pavarësisht nga kjo, Gjykata konsideroi që u kishte takuar autoriteteve nacionale që të bënin vlerësimin e impaktit të largimit të Z. Paposhvili; kjo përbënte detyrim procedural në përputhje me të cilin duhet të vepronin autoritetet për të siguruar efektivitetin e të drejtës për respekt ndaj jetës familjare. Shteti duhet të kishte shqyrtuar nëse, në kohën e largimit, do të kishte qenë e arsyeshme të pritej që familja ta ndiqte atë për në Gjeorgji ose, nëse jo, nëse respektimi i të drejtës së Z. Paposhvili për respekt ndaj jetës së tij familjare kërkonte që atij t'i jepej leje për të mbetur në Belgjikë, për aq kohë sa i kishte mbetur të jetonte. Kështu, Gjykata vendosi që nëse Z. Paposhvili do të ishte larguar drejt Gjeorgjisë pa u vlerësuar këto faktorë, do të kishte pasur edhe shkelje të Nenit 8 të Konventës.

Neni 41

Gjykata vendosi që konkluzionet e saj në lidhje me Nenet 3 dhe 8 përbënin shpërblim të drejtë të mjaftueshëm në lidhje me çdo dëm jomaterial që mund të kishte pësuar Z. Paposhvili. Ajo gjithashtu vendosi që Belgjika duhet t'i paguante familjes së Z. Paposhvili 5,000 Euro në lidhje me kosto dhe shpenzime.

IV. Masat kufizuese dhe paraburgimi

Përmbajtja brenda kordonit të policisë gjatë demonstratave nuk rezultoi në heqje të lirisë

VENDIM I DHOMËS SË MADHE PËR ÇËSHTJEN AUSTIN DHE TË TJERËT k. MBRETËRISË SË BASHKUAR

(Kërkesa nr. 39692/09)
15 mars 2012

1. Faktet kryesore

Katër kërkuesit në këtë çështje ishin Lois Austin, shtetas britanik i lindur më 1969; George Black, shtetas grek dhe australian lindur më 1949; Bronëyn Loëenthal, shtetas britanik dhe australian lindur më 1972 dhe Peter O'Shea, shtetas britanik i lindur më 1963.

Policia u vu në dijeni se më 1 maj 2001, aktivistë nga grupe protestuese ambientaliste, anarkiste dhe të krahut të majtë, synonin të kryenin disa protesta bazuar në vendndodhjet e lojës Monopoli. Organizatorët e protestës "Dita e majit e Monopolit" nuk patën asnjë kontakt me policinë për të marrë një autorizim për kryerjen e demonstratave. Rreth orës 2 të asaj dite, rreth 1,500 njerëz ishin mbledhur pranë Cirkut të Oksfordit në qendër të Londrës dhe të tjerë vazhdonin t'u bashkoheshin. Policia, duke pasur frikë për ndonjë trazirë publike, vendosi afërsisht në orën 2 të drekës të përmbante turmën duke rrethuar Cirkun e Oksfordit. Ajo u mundua të bëjë një shpërndarje të kontrolluar të turmës, gjë që rezultoi e pamundur për shkak se disa anëtare të turmës brenda dhe jashtë kordonit u treguan shumë të dhunshëm, duke thyer pllakat e shtruara dhe duke hedhur plehra drejt policisë. Shpërndarja përfundoi rreth orës 21:00 të mbrëmjes.

Znj. Austin, anëtare e Partisë Socialiste dhe pjesëmarrëse e rregullt në demonstrata, mori pjesë në protestën e 1 majit 2001 dhe ishte nodhur brenda kordonit të Cirkut të Oksfordit. Z. Black donte të shkonte në një librari në rrugën "Oksford", por një polic e ngatërroi me demonstruesit që po afroreshin dhe u has me një mur policie, të cilët e futën brenda Cirkut të Oksfordit, ku qëndroi deri në orën 9:20 të mbrëmjes. Në mënyrë të ngjashme znj. Loëenthal dhe z. O'Shea nuk kishin asnjë lidhje me demonstratën. Të dy ndodheshin gjatë pushimit të drekës kur u mbajtën brenda kordonit, respektivisht deri në orën 21:35 dhe 20:00 të mbrëmjes.

Në prill 2002 znj. Austin ngriti një procedurë kundër Komisionerit të Policisë së Metropolit, duke pretenduar dëme për burgosje të rreme dhe për shkelje të së drejtave të saj sipas nenit 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në mars 2005, pretendimet e saj u rrëzuan. Ankesat e saj të mëvonshme u hodhën poshtë nga Gjykata e Apelit dhe në janar 2009 edhe nga Dhoma e Lordëve. Dhoma e Lordëve doli në përfundimin se znj. Austin nuk ishte privuar nga liria e saj dhe rrjedhimisht, nuk zbatohet neni 5 i Konventës.

Kërkuesit pretendonin se ju ishte privuar nga liria në mënyrë të pajustificuar, në shkelje të nenit 5 § 1.

2. Vendimi i Gjykatës

Neni 5

Gjykata vërejt se kjo ishte hera e parë që ishte thirrur për të shqyrtuar zbatimin e Konventës në lidhje me “kettling” ose mbajtjen e një grupi njerëzish nga policia, për arsye të rendit publik. Si rrjedhojë, së pari duhet të vlerësonte nëse kërkuesit ishin privuar nga liria, në kuptimin e nenit 5 § 1.

Gjykata iu referua një sërë parimesh të përgjithshme të përcaktuara në praktikën gjyqësore. Së pari, Konventa ishte një “instrument i gjallë”, i cili duhej të interpretohej në dritën e kushteve të ditëve të sotme. Edhe deri në vitin 2001, përparimet në teknologjinë e komunikacionit kishin bërë të mundur mobilizimin e protestuesve me shpejtësi dhe fshehtësi. Së dyti, Konventa duhet të interpretohej në mënyrë harmonike, si një e tërë. Duhet të merrej në konsideratë që nene të ndryshme të Konventës detyronin policinë të mbronin individët nga dhuna dhe lëndimet fizike. Së treti, konteksti në të cilin kishte ndodhur masa në fjalë ishte i rëndësishëm. Anëtarëve të publikut shpesh u kërkohej të duronin kufizime të përkohshme të lirisë së lëvizjes në kontekste të caktuara, të tilla si udhëtimi me transport publik ose në autostradë, ose pjesëmarrja në një ndeshje futbolli.

Gjykata konsideroi se kufizime të tilla që ndodhin zakonisht, nuk mund të përshkruheshin si “heqje të lirisë” në kuptimin e nenit 5 § 1, për aq kohë sa ato ishin bërë të pashmangshme si rezultat i rrethanave që dilnin përtej kontrollit të autoriteteve, ishin të nevojshme për të shmangur një rrezik real të dëmtimit ose lëndimit të rëndë, dhe ishin mbajtur në minimumin e kërkuar. Më tej Gjykata theksoi se, brenda sistemit të Konventës, i takonte gjykatave vendase të vërtetonin faktet dhe Gjykata do të ndiqte gjetjet e fakteve të arritura nga gjykatat vendase.

Në këtë rast, Gjykata u bazua në faktet e përcaktuara nga Gjykata e Lartë, pas një VENDIMI tre javor dhe shqyrtimit të provave thelbësore. Ishte vërtetuar se policia kishte pritur që një grup prej 500-1000 demonstruesish të dhunshëm të mblidheshin në Cirkun e Oksfordit rreth orës 4 të mëngjesit. Policia gjithashtu kishte parashikuar një rrezik të vërtetë të dëmtimit dhe lëndimit serioz, madje edhe vdekjes dhe dëmtimit të pronës, nëse turmat nuk kontrolloheshin në mënyrë efektive. Duke pasur parasysh se, rreth dy orë më parë, mbi 1,500 njerëz ishin mbledhur tashmë atje, policia kishte vendosur të rrethonte me një kordon absolut.

Brenda kordonit, kishte hapësirë që njerëzit të shëtisnin dhe nuk kishte asnjë shtypje. Sidoqoftë, kushtet kishin qenë të pakëndshme: pa strehim, ushqim, ujë ose tualete. Edhe pse policia kishte provuar vazhdimisht gjatë gjithë pasdites të fillonte lirin e njerëzve, përpjekjet e tyre u pezulluan vazhdimisht për shkak të sjelljes së dhunshme dhe jo bashkëpunuese të një pakice të konsiderueshme, brenda dhe jashtë kordonit. Si rezultat, policia kishte arritur të shpërndante plotësisht personat e përfshirë vetëm rreth orës 21:30. Në këto rrethana, një kordon absolut kishte qenë ndër mjetet më pak ndërhyrëse dhe më efektive të disponueshme për policinë për të mbrojtur publikun, brenda dhe jashtë kordonit, nga dhuna. Si pasojë, nuk pati "privim të lirisë". Në të vërtetë, kërkuesit nuk kishin pretenduar se ata që ndodheshin brenda kordonit ishin privuar menjëherë nga liria.

Për më tepër, Gjykata nuk mund të identifikonte një moment nga kur mbajtja brenda kordonit mund të kishte ndryshuar nga një kufizim i lirisë së lëvizjes, në kufizim të lirisë. Në të vërtetë, pesë minuta pasi u vendos kordoni, policia kishte planifikuar të kryente një shpërndarje të kontrolluar të turmës. Menjëherë pas kësaj, policia ishte munduar të niste shpërndarjen e qytetarëve dhe kishte mbajtur situatën vazhdimisht nën vëzhgim. Meqenëse gjatë gjithë periudhës kishte vazhduar të ekzistonte rreziku prej të cilit ishte vendosur kordoni, Gjykata konstatoi se njerëzit brenda kordonit nuk ishin privuar nga liria e tyre e lëvizjes, në kuptim të nenit 5 § 1.

Gjykata theksoi rëndësinë thelbësore të lirisë së shprehjes dhe tubimit në të gjitha shoqëritë demokratike dhe nënvizoi se autoritetet nuk mund të përdorin masa kontrolli të turmës për të shtypur ose dekurajuar protestën, por vetëm kur është e nevojshme për të parandaluar lëndime ose dëmtime serioze.

Meqenëse neni 5 nuk zbatohet në këtë rast, Gjykata u shpreh se nuk kishte pasur shkelje të këtij neni.

Arsyet relevante dhe të mjaftueshme që duhen dhënë për arrestimin dhe paraburgimin "menjëherë" pas arrestimit - shkelje e Nenit 5 § 3

VENDIMI I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN BUZADJI K. REPUBLIKËS SË MOLDAVISË

(Kërkesa Nr. 23755/07)
5 korrik 2016

1. Faktet kryesore

Kërkuesi, Petru Buzadji, ishte shtetas moldav i lindur në vitin 1947 me banim në Comrat.

Kërkuesi ishte aksioner pakicë dhe Kryemenaxher (CEO) i një kompanie gazi të lëngshëm nga Moldavia jugore. Në korrik të vitit 2006 nisën hetimet penale në lidhje me një përpjekje të pasuksesshme nga kërkuesi për të kryer mashtrim në lidhje me aktivitetin e tij në kompani. Gjatë hetimeve dhjetëmujore që vijuan, Z. Buzadji doli para autoriteteve hetimore sa herë që u ftua dhe bashkëpunoi me to. Djemtë e Z. Buzadji po ashtu ishin të dyshuar në procedurat penale por nuk u arrestuan.

Më 2 maj 2007 kërkuesi u arrestua dhe më 5 maj 2007 u akuzua zyrtarisht për përvetësim të madh në tentativë të mallrave që i përkisnin kompanisë ku punonte. Në të njëjtën ditë, Gjykata e Rrethit Buiucani urdhëroi paraburgimin e kërkuesit në pritje të gjyqit për një periudhë prej pesëmbëdhjetë ditësh, duke marrë parasysh seriozitetin e veprës dhe kompleksitetin e çështjes, dhe duke pasur parasysh faktin që baza e arsyeshme mbështeste rrezikun e marrëveshjeve të fshehta, pra me djemtë e tij. Gjykata e Rrethit i rrëzoi si të pavërtetuar dhe të pamundshme arsyet e tjera mbi të cilat u mbështet prokurori, konkretisht rrezikun e fshehjes dhe ndikimit të dëshmitarëve ose atë të shkatërrimit të provave. Vendimi i Gjykatës së Rrethit më vonë u mbështet nga Gjykata e Apelit mbi të njëjtat baza.

Pas kësaj paraburgimi i Z. Buzadji u vazhdua disa herë pavarësisht nga kërkesat e tij të përsëritura për lirim, ku përfshiheshin arsye shëndetësore. Në mënyrë të veçantë, paraburgimi i tij u vazhdua për pesëmbëdhjetë ditë më 16 maj 2007 dhe më pas për njëzet ditë të tjera më 5 qershor 2007. Të dy vendimet, më vonë të mbështetura nga Gjykata e Apelit, u morën mbi bazën e seriozitetit dhe kompleksitetit të çështjes, rrezikut të fshehjes së kërkuesit dhe rrezikun e ndikimit të dëshmitarëve prej tij si dhe futja e duarve tek provat. Pas kërkesës së tretë të

prokurorit për zgjatjen e paraburgimit të kërkuesit, Gjykata e Rrethit, duke pasur parasysh kohëzgjatjen e qëndrimit të Z. Buzadji në paraburgim deri atëherë në pritje të gjyqit – në atë kohë, pesëdhjetepesë ditë – si dhe pjesëmarrjen e tij në të gjitha veprimet e nevojshme hetimore, urdhëroi që ai të vihej në arrest shtëpiak për tridhjetë ditë. Megjithatë, pas tre ditësh në arrest shtëpiak, Gjykata e Apelit e prishi këtë vendim dhe urdhëroi paraburgimin e kërkuesit në pritje të gjyqit për njëzet ditë. Me kërkesën e katërt të prokurorit, paraburgimi më pas u vazhdua edhe për njëzet ditë të tjera nga Gjykata e Rrethit më 16 korrik 2007, duke pasur parasysh seriozitetin e veprës dhe rrezikun që Z. Buzadji mund të fshihej ose të pengonte hetimet. Përfundimisht, më 20 korrik 2007, Gjykata e Apelit pranoi kërkesën e Z. Buzadji për t'u vendosur në arrest shtëpiak, çka më pas u zgjat në dhjetor 2007 me nëntëdhjetë ditë. Në fund, në mars të vitit 2008 Gjykata e Rrethit Comrat vendosi ta lironte kërkuesin me dorëzani.

Më 9 qershor 2011 Z. Buzadji u lirua nga akuzat për të cilat ishte mbajtur në paraburgim mes 2 majit 2007 dhe 12 marsit 2008. Edhe djemtë e kërkuesit po ashtu u liruan nga akuzat.

2. Vendimi i Gjykatës

Më 16 dhjetor 2014 një Dhomë e Gjykatës gjeti që kishte pasur shkelje të Nenit 5 § 3 të Konventës. Me kërkesë të Qeverisë, çështja iu referua Dhomës së Madhe sipas Nenit 43.

Kërkuesi u ankua që privimi i tij nga liria në pritje të gjyqit, përfshirë mbajtjen e tij në paraburgim dhe vendosjen në arrest shtëpiak, nuk kishin qenë të bazuara në arsye relevante dhe të mjaftueshme në shkelje të Nenit 5.

Pranueshmëria

Gjykata e hodhi poshtë kundërshtimin paraprak të Qeverisë lidhur me mos-shterimin e zgjidhjeve vendore me arsyetimin që ky kundërshtim ishte ngritur vetëm para Dhomës së Madhe dhe nuk ishte përmendur asnjë rrethanë e pazakontë për të lejuar ngritjen e kundërshtimit në një fazë kaq të vonshme të procedurave.

Neni 5 § 3

Gjykata përsëriti që ngulmimi i dyshimit të bazuar ishte kusht sine qua non për vlefshmërinë e paraburgimit të vazhduar, por nuk mjaftonte për të justifikuar

zgjatjen e paraburgimit pas kalimit të njëfarë kohe, pas së cilës kërkoheshin arsye të tjera “relevante dhe të mjaftueshme” për ta mbajtur të dyshuarin. Gjykata njohu që ajo nuk kishte vendosur apo caktuar më parë ndonjë kriter për zbatimin e nocionit të turbullt të “kalimit të njëfarë kohe” prej të cilit varej grupi i dytë i garancive sipas Nenit 5 § 3, dhe vijoi të zhvillonte praktikën e vet gjyqësore relevante në kuadër të çështjes në fjalë.

Në mënyrë të veçantë, Gjykata gjeti që kishte argumente bindëse për sinkronizimin e pjesës së dytë të garancive me të parën, çka ndërkohë nënkuptonte se kushti që zyrtari gjyqësor të jepte arsye relevante dhe të mjaftueshme për paraburgim – përveç ngulmimit të dyshimit të bazuar – aplikohet qysh në kohën e vendimit të parë që urdhëronte paraburgimin paragjyqësor, që do të thotë “menjëherë” pas arrestimit.

Gjykata më tej përsëriti që arresti shtëpiak konsiderohej, varësisht nga shkalla dhe intensiteti i tij, se përbënte privim të lirisë brenda kuptimit të Nenit 5, dhe që nuk kishte arsye për t’u larguar nga praktika e saj gjyqësore në këtë rast. Ajo hodhi poshtë argumentin e Qeverisë që kërkesa e kërkuesit për t’u vënë në arrest shtëpiak dhe mos-kontestimi i masës prej tij përbënte heqje dorë nga e drejta e tij për liri, dhe që kështu kërkuesi nuk mund të pretendonte se ishte “viktimë” në kuptimin e Nenit 34 për qëllimet e ankesës së tij sipas Nenit 5 § 3 në lidhje me arrestin shtëpiak. Në lidhje me atë pikë, Gjykata gjeti që arresti shtëpiak i kërkuesit nuk mund të barazohej me lirin nga paraburgimi, as nuk mund të shihej si formë ndreqjeje që përputhej me kriteret e Nenit 5 § 5 për të ofruar të drejtën e kompensimit.

Gjykata gjithashtu hodhi poshtë parashtresën e Qeverisë që për të justifikuar arrestin shtëpiak kundrejt paraburgimit në një qendër të zakonshme mbajtjeje kërkoheshin arsye më të pakta, duke shtuar se në praktikën e saj të mëhershme ligjore nuk ishte bërë ndonjë regjim dallimesh mes llojeve të ndryshme të mbajtjes. Ajo përsëriti që nocioni i “shkallës” dhe “intensitetit” si kriteret për zbatueshmërinë e Nenit 5 i referoheshin vetëm shkallës së kufizimeve të lirisë së lëvizjes, jo dallimeve mes vendeve të ndryshme të mbajtjes. Rrjedhimisht, Gjykata zbatoi të njëjtat kriteret për tërë periudhën e privimit të lirisë, pavarësisht nga vendi ku ishte mbajtur kërkuesi.

Duke iu kthyer justifikimeve të paraqitura për paraburgimin e përkohshëm të kërkuesit në çështjen në fjalë, Gjykata gjeti që arsyet e nxjerra nga gjykatat vendase për urdhërimin dhe zgjatjen e paraburgimit të kërkuesit ishin të stereotipizuara dhe

abstrakte si dhe të paqëndrueshme. As në urdhërin fillestar për të paraburgosur kërkuesin në pritje të gjyqit e as në vendimet vijuese për zgjatjen e paraburgimit të tij nuk kishte ndonjë tregues që gjykatat vendase të kishin marrë në konsideratë karakterin e kërkuesit, moralin e tij, asetet e tij dhe lidhjet me vendin e vet si dhe sjelljen e tij gjatë dhjetë muajve të parë të hetimeve penale. Më tej, herën e parë dhe të dytë të zgjatjes, si dhe në vendimin me të cilin Gjykata e Apelit prishi vendimin e gjykatës së shkallës së parë për ta vënë kërkuesin në arrest shtëpiak pas kërkesës së tretë të prokurorit, gjykatat u bazuan në arsye të cilat si gjykata e shkallës së parë ashtu edhe Gjykata e Apelit gjatë vendosjes për urdhrin fillestar për paraburgosjen e kërkuesit në pritje të gjyqit i kishin hedhur poshtë si të pavërtetuara dhe të pamundshme. Edhe në rastet (në qershor dhe korrik 2007) kur ato pranuan që nuk kishte baza për paraburgimin e vazhduar të kërkuesit, gjykatat vendase kaluan në urdhrin për arrestin e tij shtëpiak.

Duke marrë parasysh konsideratat e mësipërme, Gjykata gjeti që nuk ishin dhënë arsye relevante dhe të mjaftueshme për të urdhëruar dhe zgjatur paraburgimin e kërkuesit në pritje të gjyqit, dhe prandaj kishte shkelje të Nenit 5 § 3.

Neni 41

Gjykata i caktoi kërkuesit 3,000 Euro në lidhje me dëme jomateriale dhe 4,837 Euro për kosto dhe shpenzime.

Ligji kombëtar nuk përcaktonte mjaft qartë përmbajtjen e masave parandaluese të cilat mund t'i imponohen një individ në kundërshtim me të drejtën e lirisë së lëvizjes sipas nenit 2 të Protokollit 4

VENDIMI I DHOMËS SË MADHE PËR ÇËSHTJEN DE TOMMASO K. ITALISË

(Kërkesa Nr. 43395/09)
23 shkurt 2017

1. Faktet kryesore

Kërkuesi Angelo de Tommaso, ishte shtetas italian i lindur në vitin 1963.

Sipas Ligjit Italian (Ligji nr. 1423/1956), një sërë masash parandaluese mund të vendoseshin ndaj "personave që paraqesin rrezik për sigurinë dhe rendin publik". Këtu përfshihen ata persona që "mund të konsiderohen shkelësit e zakonshëm", si "ata që bëjnë një jetë normale, madje edhe pjesërisht me të ardhurat nga krimi" dhe "paraqesin kërcënim për shëndetin, sigurinë ose rendin publik". Gjykata Kushtetuese Italiane në një sërë rastesh kishte sqaruar kriteret që duheshin përdorur për të vlerësuar nëse masat parandaluese ishin të nevojshme. Ajo, kishte konsideruar se dyshimet nuk mjaftonin, por përkundrazi duhet të vërtetohen përmes prova të bazuara që tregojnë një rrezik real dhe jo thjesht teorik.

Më 11 prill 2008, Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Barit e vendosi kërkuesin nën mbikëqyrje të veçantë për dy vjet. Kjo u bazua në dënimet e mëparshme të kërkuesit për trafik droge, armëmbajtje pa leje dhe arratisje, të cilat tregonin se ai shoqërohej me kriminelë dhe ishte një individ i rrezikshëm. Masat parandaluese parashikonin detyrime të ndryshme, siç janë (1) raportimi një herë në javë tek autoritetet policore, (2) mos ndryshimin e vendbanimit të tij (3) të kishte një jetë të ndershme, të respektonte ligjin dhe mos ngrinte shkak për dyshime (4) të mos kthehej në shtëpi më vonë se ora 10 e darkës ose të dilte nga shtëpia para orës 6 të mëngjesit. (5) të mos frekuentonte baret, lokalet e natës ose të mernte pjesë në takime publike, dhe (6) të mos përdorte telefon celular ose radiomarrës.

Më 28 janar 2009, Gjykata e Apelit e rrëzoi masën parandaluese, pasi nuk konsideroi se ekzistonte një rrezik "real" për shoqërinë; të gjitha aktivitetet kriminale të kërkuesit datonin 5 vite para dhënies së masës parandaluese, dhe se ai e kishte vuajtur dënimin për to dhe ishte rehabilituar. Megjithë pozitën e

favorshme të proceseve të kërkuesit, ai u mbajt nën vëzhgim për 221 ditë për shkak të mosrespektimit të afatit ligjor 30 ditor të dhënë nga Gjykata e Apelit të Barit.

2. Vendimi i Gjykatës

Veçanërisht, kërkuesi pretendonte se masat parandaluese, ndaj të cilave ai i ishte nënshtruar për një periudhë dy vjeçare, përbënin shkelje të neneve 5, 6 dhe 13 të Konventës dhe nenit 2 të Protokollit Nr. 4.

Neni 5

Autoritetet vendase e kundërshtuan zbatueshmërinë e nenit 5 me arsyetimin se masat parandaluese nuk kanë të bëjnë me heqjen e lirisë në kuptimin e nenit 5.

Gjykata iu referua jurisprudencës së saj të mëparshme për kuptimin e togfjalëshit “heqje e lirisë”. Ajo përsëriti që faktorët që duhet të merren parasysh përfshijnë llojin, kohëzgjatjen, efektet dhe mënyrën e zbatimit të masës në fjalë dhe se ndryshimi midis heqjes dhe kufizimit të lirisë është ajo që lidhet me shkallën e ashpërsisë ose intensitetit, dhe jo me natyrën ose thelbin e rastit. Duke e zbatuar këtë për rastin në fjalë, Gjykata nuk pranoi se kërkesa për të mos u larguar nga shtëpia gjatë natës, lidhet me arrestin në shtëpi dhe rrjedhimisht heqje të lirisë. Disa nga faktorët kryesorë që çuan në këtë vendim përfshijnë faktin që nuk kishte kufizime të lirisë së kërkuesit për t’u larguar nga shtëpia gjatë ditës, ai mund të kishte një jetë shoqërore, të mbante marrëdhënie me botën e jashtme dhe të krijonte kontakte.

Gjykata iu referua çështjeve analoge, në lidhje me urdhrat e detyrueshëm të qëndrimit dhe kërkesat për të mos u larguar nga shtëpia natën, të cilën ajo nuk i kishte konsideruar si një kufizim i lirisë, por me tepër si kufizim të lirisë së lëvizjes, duke arritur në përfundimin se nuk kishte asnjë arsye për të ndryshuar qasjen e saj në rastin në fjalë. Më tej, Gjykata vërejti se, ndryshe nga rastet kur Gjykata kishte konstatuar një kufizim të lirisë, në këtë rast kërkuesi nuk ishte i detyruar të jetonte brenda një zone të kufizuar, dhe nuk kishte asnjë tregues se kërkuesi kishte aplikuar ndonjëherë tek autoritetet për leje për të udhëtuar diku larg vendbanimit të tij. Ndryshe ndodh në rastin e *Guzzardit kundër Italisë*^[755], ku Gjykata kishte arritur në përfundimin se kërkuesit i ishte “hequr liria”, pasi ai ishte detyruar të jetonte në një ishull brenda një sipërfaqeje prej 2.5 km², nën mbikëqyrje thuajse

[755] Shiko *Guzzardi k. Italisë*, vendim i 6 nëntorit 1980, nr. 7367/76) (i përfshirë si përmbledhje në këtë botim).

të përhershme dhe ku kishte qenë pothuajse plotësisht e pamundur për të krijuar kontakte shoqërore. Për rrjedhojë, në këtë rast Gjykata vijoi të shqyrtojë pretendimin e kërkuesit sipas nenit 2 të Protokollit Nr. 4.

Neni 2 i Protokollit nr. 4

Gjykata përsëriti që neni 2 i Protokollit Nr. 4 i garanton çdo personi të drejtën e lirisë së lëvizjes brenda një territori të caktuar dhe të drejtën për të lënë atë territor, që nënkupton të drejtën për të udhëtuar në një vend që personi zgjedh në të cilin ai ose ajo mund të pranohet. Gjykata i konsideroi kufizimet e vendosura ndaj kërkuesit si masa që kufizojnë të drejtën e lirisë së lëvizjes për qëllimet e nenit 2 të Protokollit Nr. 4. Për rrjedhojë, vijoi të shqyrtojë nëse ato ishin në përputhje me ligjin, ndiqnin një nga qëllimet legjitime referuar në paragrafin e tretë të nenit 2 të Protokollit Nr. 4 dhe përbënin një ekuilibër të drejtë midis interesit publik dhe të drejtave të individit.

Gjykata përsëriti jurisprudencën e saj të konsoliduar, sipas të cilës shprehja “në përputhje me ligjin” jo vetëm që kërkon që masa e kundërshtuar të jetë e bazuar në të drejtën e brendshme, por gjithashtu i referohet cilësisë së ligjit në fjalë, duke kërkuar që të jetë e aksesueshme për personat në fjalë dhe efektet e tij të jenë të parashikueshme. Për këtë, një normë nuk mund të konsiderohet si “ligj”, vetëm nëse është formuluar me përpikëri të mjaftueshme për t’iu dhënë mundësi qytetarëve të rregullojnë sjelljen e tyre; personi duhet të jetë në gjendje – nëse është e nevojshme me këshillat e përshtatshme - të parashikojë, në një shkallë të arsyeshme lidhur me rrethanat, për pasojat që mund të sjellë një veprim i caktuar. Megjithatë, pasoja të tilla nuk kanë nevojë të parashikohen me siguri absolute; shumë ligje, për të shmangur ashpërsinë e tepërt, janë shoqëruar në mënyrë të pashmangshme në terma që, në një masë më të madhe ose më të vogël, janë të paqarta dhe interpretimi dhe zbatimi i të cilave është çështje praktike. Niveli i saktësisë së kërkuar nga legjislacioni i brendshëm varet në një shkallë të konsiderueshme nga përmbajtja e tij dhe fusha që është krijuar për të mbuluar dhe si dhe numrin dhe statusin e atyre për të cilët adresohet. Për më tepër, Gjykata përsëriti që një ligj që i jep diskrecion një autoriteti publik duhet të tregojë fushën e këtij VENDIMI, por jo domosdoshmërisht procedurat dhe kushtet e hollësishme që duhet të respektohen.

Duke zbatuar këto parime në rastin në fjalë, së pari, Gjykata vuri në dukje se masat parandaluese në fjalë ishin të bazuara në ligjin e brendshëm, përkatësisht Ligjin nr. 1423/1956, ashtu siç interpretohet dhe në dritën e vendimeve të

Gjykatës Kushtetuese. Gjykata vuri në dukje se mundësia e parashikueshmërisë dhe efikasiteti i efekteve të këtij ligji ishin veçanërisht të rëndësishme në një rast të tillë si çështja në fjalë, ku legjislati kishte një ndikim shumë domethënës mbi kërkuesin dhe të drejtën e tij për lirinë e lëvizjes. Gjykata pranoi që Gjykata Kushtetuese Italiane në disa raste sqaroi kriteret që do të përdoren për të vlerësuar nëse masat parandaluese janë të nevojshme. Megjithatë, imponimi i masave të tilla lidhej me një analizë në perspektivë nga ana e gjykatave vendase pasi as ligji dhe as Gjykata Kushtetuese nuk kishin identifikuar qartë "provat faktike" ose llojet specifike të sjelljeve që duhet të merren në konsideratë për të vlerësuar rrezikun që paraqet individit për shoqërinë. Për këtë, ligji nuk përmbante dispozita të detajuara aq sa duhet se cilat lloje të sjelljes duhej të konsideroheshin se përbënin një rrezik për shoqërinë. Duke vënë në dukje që Gjykata e Rrethit Gjyqësor e kishte bazuar vendimin e saj në vendimet penale ekzistuese "aktive" nga ana e kërkuesit, pa i atribuuar atij ndonjë sjellje specifike ose veprimtari kriminale. Gjithashtu, Gjykata konsideroi se ligji nuk tregonte mjaft qartë fushëveprimin ose mënyrën e ushtrimit të VENDIMIT shumë të gjerë që ju ishte dhënë gjykatave vendase.

Përsa i takon masave që u aplikuan për kërkuesin të parashikuara në këtë ligj, Gjykata vuri në dukje formulimin e paqartë dhe të papërcaktuar të disa prej tyre, siç është detyrimi për të "pasur një jetë të ndershme dhe që respekton ligjin" dhe "nuk ngre shkaqe për dyshime". Megjithatë, nga një interpretim i dhënë nga Gjykata Kushtetuese, nuk ishte e mundur që kërkuesi të konstatonte përmbajtjen e tyre të saktë. Çështja e tij i kishte paraprirë udhëzimeve të Gjykatës Kushtetuese, dhe në çdo rast, çdo interpretim mbi atë kriter nuk do ta zgjidhte problemin e mungesës së parashikueshmërisë, pasi ligji legjislativ i lejoi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor që të vendoste çdo masë që e konsideronte të domosdoshme - pa specifikuar përmbajtjen e tyre - duke pasur parasysh kërkesat e mbrojtjes së shoqërisë.

Për rrjedhojë, Gjykata konsideroi se kjo pjesë e ligjit nuk përcaktonte qartë mjaftueshëm përmbajtjen e masave parandaluese, të cilat mund të shihen edhe nën praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese. Ndërrhyrja në lirinë e lëvizjes së kërkuesit nuk mund të thuhet se ka qenë e bazuar në dispozita ligjore që përputhen me kërkesat e ligjshmërisë sipas Konventës, dhe për rrjedhojë kishte pasur një shkelje të nenit 2 të Protokollit Nr. 4.

Neni 6

Gjykata vërejti se ka pasur shkelje të nenit 6 (1) për shkak të mungesës së një dëgjese publike. Megjithatë, për sa i përket padrejtësisë së pretenduar mbi

procesin, ashtu siç evidentohet nga vendimi i Gjykatës së Apelit lidhur me masat mbrojtëse procedurale, në tërësi kërkuesit i ishte garantuar një proces i rregullt.

Neni 13

Duke mbajtur në konsideratë mundësinë e kërkuesit për të apeluar në Gjykatën e Apelit, e cila më pas solli dhe heqjen e masës së mbikëqyrjes së veçantë, Gjykata konsideroi se kërkuesi kishte pasur një mjet efektiv sipas ligjit italian, duke i akorduar mundësinë për tu ankuar për shkelje të Konventës.

Neni 41

Kërkuesit ju akordua shuma prej 5,000 € në lidhje me dëmin jo material dhe 11,525 € në lidhje me kostot dhe shpenzimet, përfshi dhe ato që kishin ndodhur para gjykatave vendase.

*Izolimi i detyrueshëm i personit të infektuar me HIV
shkeli të drejtën për liri garantuar nga neni 5*

VENDIMI PËR ÇËSHTJEN ENHORN K. SUEDISË

(Kërkesa nr. 56529/00)

25 janar 2005

1. Faktet kryesore

Kërkuesi, Eie Enhorn, ishte një shtetas suedezi lindur në vitin 1947. Në 1994 u zbulua se ai ishte i infektuar me virusin HIV dhe se e kishte transmetuar virusin tek një djalë 19-vjeçar, me të cilin kishte pasur kontakte seksuale në 1990. Në dritën e kësaj situate, mjeku i qarkut lëshoi udhëzime për kërkuesin në bazë të Ligjit të Sëmundjeve Infektive të vitit 1988 ("Akti i vitit 1998"), të cilat kishin për qëllim parandalimin e tij nga përhapja e infeksionit HIV. Kërkuesi do të ishte i detyruar të informojë çdo partner seksual të mundshëm në lidhje me infeksionin e tij, të përdorte prezervativ dhe të mos konsumonte sasi të alkooli, të cilat mund të dëmtonin VENDIMin e tij duke vendosur kështu atë ose të tjerët në rrezik. Gjithashtu, ai ishte i detyruar të informonte stafin mjekësor dhe dentistin e tij për infeksionin përpara se t'i nënshtrohej procedurave të tilla si ekzaminimet fizike, vaksinimet ose testet e gjakut. Ai ishte i detyruar të nënshtrohej konsultave mjekësore dhe të shkonte në vizitat e përcaktuara nga mjeku i qarkut.

Midis shtatorit dhe nëntorit 1994, kërkuesi u paraqit në katër konsulta me mjekun e qarkut dhe mori dy vizita në shtëpi. Sidoqoftë, në pesë raste, ai nuk arriti të përmbushte detyrimin e paraqitjes. Prandaj, mjeku i qarkut aplikoi në Gjykatën Administrative të Qarkut me kërkesën, që z. Enhorn të mbahej në izolim të detyrueshëm në një spital deri në tre muaj. Më 16 shkurt 1995, Gjykata Administrative e Qarkut vërejti se kërkuesi kishte dështuar të zbatonte masat e përcaktuara nga mjeku i qarkut dhe urdhëroi, që ai të mbahej në izolim të detyrueshëm deri në tre muaj, në përputhje me nenin 38 të Akti i vitit 1988. Ndërsa ishte i izoluar, kërkuesi kishte të drejtë të dilte jashtë së paku një herë në ditë, por vetëm nëse shoqërohej nga anëtarët e stafit të spitalit.

Pas kësaj, urdhrat për të zgjatur privimin e tij të lirisë u lëshuan vazhdimisht çdo gjashtë muaj deri më 12 dhjetor 2001. Meqenëse kërkuesi u zhduk disa herë, privimi i tij aktual nga liria zgjati nga 16 marsi deri më 25 prill 1995, 11 qershor deri më 27 shtator 1995, 28 maj deri më 6 nëntor 1996, 16 nëntor 1996 deri më

26 shkurt 1997 dhe 26 shkurt 1999 deri më 12 qershor 1999 - gati një vit e gjysmë gjithsej.

Më 12 dhjetor 2001, një kërkesë për të zgjatur më tej urdhrin e ndalimit u rrëzua nga Gjykata Administrative e Qarkut, e cila iu referua faktit se vendndodhja e kërkuetit ishte e panjohur dhe për këtë arsye nuk kishte asnjë informacion në lidhje me sjelljen e tij, gjendjen e shëndetit etj. Në kohën e VENDIMIT të çështjes në Gjykatën Evropiane u duk se prej vitit 2002 vendndodhja e kërkuetit ishte e ditur, por mjeku i qarkut vlerësoi se nuk kishte arsye për të vendosjen e mëtëjshme të kërkuetit në izolim të pavullnetshëm.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkueti u ankua se urdhrat e izolimit të detyrueshëm dhe vendosja e tij në mënyrë të pavullnetshme në spital kishin shkelur nenin 5 § 1 të Konventës.

Neni 5 § 1

Duke qenë e bindur se ndalimi i kërkuetit ishte bazuar në ligjin suedez, Gjykata vazhdoi të shqyrtonte nëse privimi i lirisë kishte qenë "ndalim i ligjshëm i një personi me qëllim parandalimin e përhapjes së sëmundjeve infektive" në kuptimin e nenit 5 § 1 (e) të Konventës.

Gjykata theksoi se nuk mjafton që privimi i lirisë të jetë në përputhje me ligjin vendas. Ai gjithashtu duhet të përputhet me parimin e përgjithshëm të sigurisë juridike, do të thotë se kushtet për ndalim duhet të përcaktohen qartë dhe ligji përkatës duhet të jetë mjaftueshëm i aksesueshëm dhe i saktë për të qenë i parashikueshëm.

Gjykata theksoi se ajo kishte vendosur "vetëm në një masë shumë të kufizuar" për çështjet kur një person është ndaluar nga autoritetet e një Shteti Palë "për shkak të parandalimit të përhapjes së sëmundjeve infektive". Prandaj, ajo vendosi të vlerësonte disa krahasime nga praktika gjyqësore e saj në lidhje me arsyet e tjera të privimit të lirisë sipas nga neni 5 § 1 (e) [konkretisht: ndalimi i personave me probleme të shëndetit mendor, të alkoolizuarve ose atyre që kanë varësi nga droga, endacakëve]. Gjykata konstatoi se ekziston një lidhje midis këtyre personave, për aq sa kohë sa ata mund të privohen nga liria: ose për të marrë trajtim mjekësor, ose për shkak të konsideratave të diktuar nga politika sociale, ose mbi baza mjekësore dhe sociale. Prandaj, Gjykata deklaroi se ishte e ligjshme

të arrihej në përfundimin nga ky kontekst se një arsye pse Konventa lejon që personat e përmendur në nenin 5 § 1 (e) të privohen nga liria nuk lidhet vetëm me shkakun se ata përbëjnë rrezik për publikun, por edhe me interesa përfituese të këtyre individëve .

Kështu, Gjykata konstatoi se duhet të ketë një marrëdhënie midis bazës së privimit të lejuar të lirisë dhe vendit e kushteve të paraburgimit. Për shembull, ndalimi i një personi si një pacient me probleme të shëndetit mendor do të jetë i ligjshëm vetëm për qëllimet e nën-paragrafit (e) nëse bëhet në spital, klinikë ose institucion tjetër të përshtatshëm.

Gjykata vërejti se kriteret thelbësore që duhen marrë në konsideratë kur vlerëson "ligjshmërinë" e ndalimit të një personi "për parandalimin e përhapjes së sëmundjeve infektive" ishin: nëse përhapja e sëmundjes infektive ishte e rrezikshme për shëndetin ose sigurinë publike, si edhe nëse ndalimi i personi i infektuar ishte mjeti i fundit për të parandaluar përhapjen e saj, për aq sa masa më pak të rënda ishin konsideruar dhe ishin gjetur të pamjaftueshme për të mbrojtur interesin publik. Kur ato kriteret nuk u plotësohen më, baza për privimin e lirisë pushoi së ekzistuari. Pra, nuk mjafton fakti nëse privimi i lirisë në këtë kontekst ishte i ligjshëm, ai duhej të ishte edhe i domosdoshëm.

Në rastin në shqyrtim, ishte e padiskutueshme që kriteri i parë ishte përmbushur, meqenëse virusi HIV ishte i rrezikshëm për shëndetin dhe sigurinë publike. Në lidhje me kriterin e dytë, Gjykata vuri në dukje se Qeveria nuk kishte ofruar shembuj të masave më pak të rënda të cilat mund të ishin konsideruar për llogari të kërkuesit në periudhën nga 16 shkurt 1995 deri më 12 dhjetor 2001, por kishte vendosur gjithsesi se ato nuk ishin të mjaftueshme për të ruajtjen e interesin publik.

Ndër të tjera, përveç faktit se kërkuesi ishte i lirë gjatë pjesës më të madhe të kohës nga 16 shkurt 1995 deri më 12 dhjetor 2001, nuk kishte asnjë provë ose indikacion që gjatë asaj periudhe ai kishte transmetuar virusin HIV tek dikush, ose që kishte kryer marrëdhënie seksuale pa njoftuar partnerin për infeksionin e tij me HIV, ose se ai nuk kishte përdorur prezervativ. Kërkuesi kishte vizituar mjekun dy herë gjatë periudhës 1997 - 1999, dhe në të dyja rastet ai i kishte njoftuar ata për infeksionin e tij. Prandaj dukej se kërkuesi kishte vepruar në përputhje me shumë nga udhëzimet e lëshuara ndaj tij nga mjeku i qarkut në 1994.

Në ato rrethana, Gjykata konstatoi se izolimi i detyrueshëm i kërkuesit nuk ishte zgjidhja e fundit për të parandaluar përhapjen e virusit HIV, pasi masat më pak të rënda ishin konsideruar dhe gjetur se ishin të pamjaftueshme për të mbrojtur interesin publik. Për më tepër, duke zgjatur për një periudhë prej gati shtatë vitesh urdhrin për izolimin e detyrueshëm të kërkuesit, me rezultatin që ai ishte vendosur në mënyrë të pavullnetshme në një spital për gati një vit e gjysmë në total, autoritetet nuk kishin arritur të vendosnin një ekuilibër të drejtë midis nevojës për të siguruar që virusi HIV të mos përhapet dhe të drejtës së kërkuesit për liri. Prandaj, Gjykata vendosi se kishte pasur një shkelje të nenit 5 § 1 të Konventës.

Neni 41

Gjykata i dha kërkuesit 12,000 € si shpërblim i dëmit jo-pasuror dhe 2,083 € për shpenzimet gjyqësore.

Paraburgimi i kërkuesit për më shumë se 19 orë dhe vonesa gjyqësore në shqyrtimin e paraburgimit të tij ka shkelur të drejtën e tij për liri sipas Nenit 5 § 1 (b)

VENDIMI NË ÇËSHTJEN EPPLE k. GJERMANISË

(Kërkesa Nr. 77909/01)

24 mars 2005

1. Faktet kryesore

Kërkuesi ishte i lindur në vitin 1970 dhe jetonte në Wasserburg, Gjermani. Më 18 korrik 1997 në Ishullin Lindau u zhvillua një festival popullor. Dita e shtatë e Kaosit të Lindau (një mbledhi e përvitshme e ndjekësve të rrymës 'punk', që kishte për qëllim të shkaktonte rrëmujë dhe trazira) ishte planifikuar të mbahej në të njëjtën datë por u ndalua me anë të një urdhërese të përgjithshme të 14 korrikut 1997 për shkak të rrezikut të kërcënimit ndaj sigurisë dhe rendit publik.

Rreth orës 6 pasdite policia i kërkoi kërkuesit që të largohej nga lokacioni i festivalit, por ai kinëse refuzoi. Për shkak të atij refuzimi, paraqitjes së tij si ndjekës i rrymës 'punk' dhe faktit që databaza qendrore e policisë tregonte se ai kishte marrë pjesë edhe përpara në Ditët e Kaosit në Lindau dhe në qytete të tjera, policia i tha të largohej nga ishulli dhe të mos kthehej gjatë tërë fundjavës. Kërkuesi raportohet të ketë refuzuar që të vepronte në përputhje me këtë, dhe kështu u mor në stacionin e policisë, ku u mbajt për afro 19 orë. Kërkuesi pohoi që ai nuk kishte refuzuar të largohej nga festivali por kishte kërkuar të dinte emrin e policit dhe arsyet për urdhrin.

Më 19 korrik 1997 Gjykata e Rrethit Lindau urdhëroi lirimin e tij por vendosi që paraburgimi i tij kishte qenë i ligjshëm. Gjyqtari që urdhëroi lirimin e tij kishte arritur në gjykatë një orë e gjysmë me vonesë dhe ishte planifikuar që ai të shqyrtonte paraburgimin e 17 personave, çka nënkuptonte se çështja e kërkuesit u dëgjua rreth orës 1:45 pasdreke.

Në apel, Gjykata Rajonale e Kempten vendosi që paraburgimi i kërkuesit ishte i justifikuar nga refuzimi i tij për t'u larguar nga festivali, dhuna që shpesh ndodhte në ngjarjet e Ditëve të Kaosit, paraqitja e kërkuesit, dhe historia e tij e mëparshme e pjesëmarrjes në ngjarjet e kaluara të Ditëve të Kaosit. Gjithashtu ajo vendosi që çështja e tij ishte dëgjuar nga Gjykata e Rrethit sapo kishte qenë e mundur në përputhje me Aktin e Policisë. Gjykata Supreme e Bavarisë e mbështeti këtë vendim dhe Gjykata Kushtetuese e refuzoi apelin e kërkuesit pa arsye.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi pretendoi që arrestimi dhe paraburgimi i tij kishin shkelur të drejtën e tij për liri dhe siguri sipas Nenit 5 të Konventës dhe të drejtën e tij për lirinë e shprehjes sipas Nenit 10. Ai gjithashtu pretendoi që ai ishte trajtuar në mënyrë diskriminuese për shkak të paraqitjes së tij 'punk', në shkelje të Nenit 14.

Neni 5

Gjykata gjeti që arrestimi dhe paraburgimi fillestar i kërkuesit nga policia u bë për të siguruar përmbushjen e një detyrimi të parashikuar me ligj, duke parandaluar kërkuesin nga shkelja e urdhëresës së përgjithshme që i ndalonte Ditët e Kaosit, në përputhje me Nenin 5 § 1 (b). Megjithatë, që paraburgimi të ishte i justifikuar sipas kësaj dispozite, detyrimi ligjor duhet të ishte konkret dhe specifik, personi i paraburgosur të mos kishte vepruar në përputhje me detyrimin ligjor, dhe qëllimi i arrestimit dhe paraburgimit të ishte i nevojshëm për të siguruar pajtueshmërinë me detyrimin, e jo të ishte ndëshkues. Më tej, paraburgimi i personit duhet të ndërpritej sapo të përmbushej detyrimi ligjor. Shtetit gjithashtu i kërkohet të demonstroi që paraburgimi ishte "i nevojshëm në një shoqëri demokratike".

Kërkuesi pohoi që ai nuk kishte refuzuar të largohej nga vendi ku mbahej festivali por kishte qëndruar për të marrë vesh emrin e policit dhe arsytet për urdhrin. Megjithatë, duke iu referuar deklaratave të dëshmitarëve para Gjykatës Rajonale të Kempten, Gjykata konsideroi që ky pretendim ishte i pavërtetuar. Autoritetet nacionale, në mënyrë të veçantë gjykatat, ishin në pozicion më të mirë për të zbatuar dhe interpretuar të drejtën vendase. Prandaj, Gjykata vendosi që arrestimi dhe paraburgimi fillestar i kërkuesit kishin qenë në përputhje me Nenin 5 § 1 (b).

Sa i përket kohëzgjatjes së paraburgimit, ajo shënoi që kërkuesi ishte mbajtur për më shumë se 19 orë, meqenëse gjyqtari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Lindau më 19 korrik 1997 kishte ardhur me vonesë (rreth orës 11:30 në vend të orës 10:00) dhe kishte pasur të shqyrtonte kërkesat e 17 personave për ligjshmërinë e paraburgimit të tyre. Gjykata shënoi që nuk kishte pasur dështim formal për të vepruar në përputhje me kufirin kohor statutor vendas për paraburgim, meqenëse Akti i Policisë thoshte se në mungesë të një urdhri nga gjykata për vazhdimin e paraburgimit, personat në paraburgim policor duhet të liroheshin më së voni deri të nesërmen e arrestimit të tyre në fund të ditës. Megjithatë nuk ishte detyrë e Gjykatës të vendoste in abstracto mbi legalitetin e periudhës maksimale

të paraburgimit të parashikuar me të drejtën nacionale. Në realitet, Gjykatës i takonte në konsideronte nëse kohëzgjatja e paraburgimit të kërkuesit kishte qenë proporcionale me qëllimin e vet. Kështu, Gjykata mori parasysh që vepra për të cilën u arrestua kërkuesi (refuzimi për të vepruar në përputhje me urdhrin për t'u larguar nga Ishulli Lindau atë fundjavë) parashikonte një gjobë maksimale prej 250 Euro.

Nën dritën e rrethanave të çështjes dhe rëndësisë së të drejtës për liri sipas Konventës, Gjykata gjeti që kombinimi i kohëzgjatjes së paraburgimit të kërkuesit dhe vonesa e gjyqtarit në shqyrtimin e çështjes së tij nënkuptonte që nuk ishte gjetur ekuilibri i duhur mes nevojshmërisë për të zbatuar urdhrin e marrë kundër kërkuesit dhe të drejtës së kërkuesit për liri. Rrjedhimisht, Gjykata vendosi që kishte pasur shkelje të Nenit 5 § 1 (b).

Nenet 10 dhe 14

Kjo pjesë e kërkesës u refuzua si dukshëm e pabazuar. Neni 41 Gjykata nuk caktoi shpërblim sipas Nenit 41 meqenëse kërkuesi nuk kishte bërë kërkesë për shpërblim të drejtë. Megjithatë, pas rishikimit, më 15 dhjetor 2005, Gjykata vendosi që gjetja prej saj e një shkeljeje përbente shpërblim të drejtë të mjaftueshëm dhe i caktoi kërkuesit 1,700 Euro për kosto dhe shpenzime.

Qëndrimi i detyrueshëm i kërkuesit në një seksion të vogël të një ishulli të largët italian përbënte kufizim të lirisë dhe shkelte nenin 5 § 1

GUZZARDI k. ITALISË

(Kërkesa nr.7367/76)

6 nëntor 1980

1. Faktet kryesore

Kërkuesi është shtetas italian i lindur në vitin 1942 i cili u arrestua në 8 shkurt të vitit 1973, u vendos në paraburgim dhe më pas u akuzua për komplot dhe si bashkëpunëtor i rrëmbimit të një biznesmeni. Ai fillimisht u lirua më 13 nëntor 1976 nga Gjykata Rajonale e Milano për mungesë provash të mjaftueshme, por më vonë u dënua më 19 dhjetor 1979 nga Gjykata e Apelit në Milano. Ai u dënua me tetëmbëdhjetë vjet burg dhe gjobë.

Sipas nenit 272 të Kodit italian të Procedurave Penale, masa e paraburgimit të kërkuesit nuk mund të kalonte dy vjet. Kështu, më 8 shkurt 1975 ai u hoq nga Milano dhe u dërgua në ishullin Asinara. Ky transferim u pasua nga një raport në 23 dhjetor 1974, dërguar nga Shefi i Policisë së Milanos për Prokurorin e Shtetit në Milano, duke rekomanduar që z. Guzzardi t'i nënshtrohej masës së "mbikëqyrjes speciale" të parashikuar në ligjin italian. Raporti u referua indikacioneve që kërkuesi nuk punonte në tregtinë e ndërtesave siç pretendonte ai, por në fakt ishte i përfshirë në aktivitete të paligjshme dhe bënte pjesë në një bandë mafiozësh. Raporti e përshkruan kërkuesin si "një nga individët më të rrezikshëm".

Më 30 janar 1975 Gjykata Rajonale e Milanos, mori vendimin se kërkuesi duhej të vuante dënimin e tij për tre vite, si rezident në një komunë në ishullin Asinara (pjesë e Sardenjës). Ndër masat që ai duhet të zbatonte ishin: orare të përcaktuara largimi dhe hyrje në banesën e tij, raportimi ndaj mbikëqyrësve të tij 2 herë në ditë dhe sa herë ti kërkohet, lajmërimi paraprakisht i supervizorit kur donte të bënte ose priste një telefonatë të largët, duke bërë me dije emrin dhe numrin e personit me të cilin do të komunikonte. I gjithë ishulli Asinara kishte një sipërfaqe prej 50 km², por zona e rezervuar për individët me vendbanim të rezervuar ishte 2.5 km². Ata që qëndronin në vendbanimin e detyrueshëm mund të kërkonin leje për një vizitë të mbikëqyrtur në Sardenjë ose në territorin italian nëse do të kishin arsye bindëse. Ekzistonte gjithashtu mundësia për të vizituar Porto Torres për të blerë

furnizime sipas një autorizimi dhe nën mbikëqyrje. Sidoqoftë, shpeshësia dhe mundësia aktuale e vizitave të tilla ishte e diskutueshme.

Kërkuesi, bashkë me avokatin e tij u drejtuan Gjykatës Rajonale të Apelit të Milanos për rrëzimin e këtij vendimi si të pabazuar në ligj dhe të pajustificuar. Por kërkesa në gjykatën e apelit nuk kishte efekt pezullues mbi vendimin paraprak, pra kërkuesi duhet të vazhdonte të jetonte në ishull gjatë gjithë kohëzgjatjes së dënimit. Ankesa u rrëzua më 12 mars 1975. Gjykata e Apelit zbuloi se Asinara ishte një vend i përshtatshëm për qëndrim të detyrueshëm. Ai theksoi se qëllimi i masës ishte ndarja e kërkuesit nga mjedisi i tij shoqëror në mënyrë që të bëhej më i vështirë kontakti me bashkëpunëtorët e tij të mëparshëm dhe se kjo kërkesë kishte përparësi ndaj kërkesave të tjera, siç ishte mungesa e punësimit të rregullt ose akomodimi i përshtatshëm për një familje. Më 3 prill 1975, kërkuesi apeloj në Gjykatën e Kasacionit, por çështja u pushua si e pabazuar në themel më 6 tetor 1975.

Dhoma e Dytë e Gjykatës së Apelit dha vendimin e saj më 20 janar 1976. Ajo pohoi se kërkesat e mbrojtjes së shoqërisë justifikonin formën e veçantë të izolimit që jepeshin për individë jashtëzakonisht të rrezikshëm, të cilët dërgoheshin në Asinara. Sidoqoftë, vendosi që këto kërkesa të mos ndikonin në ndarjen e këtyre personave nga familjet e tyre ose të privoheshin nga punësimi i rregullt. Pas këtij vendimi, më 21 korrik 1976, Gjykata Rajonale e Milanos urdhëroi që kërkuesi të dërgohej në rrethin e Force në territorin italian. Arsyetimi i dhënë ishte se i bashkakuzuari i tij po vuante gjithashtu një masë të detyrueshme qëndrimi në Asinara dhe prania e vazhdueshme e kërkuesit mund të kishte pasoja negative mbi sigurinë e ishullit dhe proceset penale që pasuan. Z. Guzzardi atëherë duhej të qëndronte në Force deri në 8 shkurt 1978, kur perioda tre vjeçare e caktuar fillimisht nga Gjykata Rajonale e Milanos për mbikëqyrjen e veçantë të përfundonte.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi u ankua se veprimet e autoriteteve italiane për ta detyruar atë të banonte në një zonë kaq të vogël, ku ai nuk ishte në gjendje të punonte, ta mbante familjen e tij me vete, të praktikonte fenë katolike ose të siguronte edukimin e të birit, përbënin shkelje të neneve 3, 8, 9 dhe nenit 2 të Protokollit nr.1. Vëzhgime shtesë u kërkuan në nenet 5 dhe 6, dispozita për të cilat kërkuesi më vonë u mbështet në vazhdim të ankesave të tij të mëparshme. Kërkesa sipas nenit 5 u vu në fokus të VENDIMIT.

Neni 5

Gjykata duhet të përcaktonte nëse në rastin konkret kemi të bëjmë me kufizim të lirisë së individit sipas nenit 5 të Konventës. Këto kufizime rregullohen nga neni 2 i Protokollit nr. 4, i cili nuk është ratifikuar nga Italia. Për të përcaktuar nëse dikujt i është hequr liria për qëllimin e nenit 5, duhet të merren parasysh një sërë faktorësh siç janë lloji, kohëzgjatja, efektet dhe mënyra e zbatimit të masës në situatën konkrete të individit. Në rastin e kërkuesit, Gjykata pranoi që "mbikëqyrja e veçantë" sipas ligjit italian nuk binte brenda fushës së veprimit të nenit 5. Megjithatë, është e mundur që mënyra e zbatimit të një mase mund të çojë në konstatimin e heqjes së lirisë dhe në këtë rast, u vlerësua vetëm mënyra e zbatimit të mbikëqyrjes së veçantë.

Gjykata vendosi më shumë theks në gamën e faktorëve që kufizonin lirinë e kërkuesit dhe më pak në faktin se zona në të cilën kërkuesi ishte i kufizuar, i tejkalohte përmasat e një qelie dhe nuk haste asnjë pengesë fizike për të dalë. Ndër faktorë të tjerë, Gjykata vuri në dukje se zona e izolimit ishte një pjesë e vogël e një ishulli që ishte e vështirë për t'u aksesuar dhe që më parë kishte qenë burg. Ajo gjithashtu u shpreh lidhur me mungesën e mundësive për kontakte sociale. Gjykata ishte e mendimit se, nëse merrreshin veç e veç, secili nga faktorët e përmendur nuk do të përbënte kufizim të lirisë, por marrë së bashku dhe në ndërthurje me njëri-tjetrin ato ngrinin çështje sipas nenit 5. Si pasojë, Gjykata konstatoi se kishte pasur heqje të lirisë.

Gjykata konsideroi nëse situata binte në njërin nga kufizimet e autorizuara të lirisë, të përcaktuara në nenin 5 § 1 (a) - (f). Së pari, Gjykata hodhi poshtë argumentin e qeverisë se kërkuesi mund të klasifikohet si "endacak" për qëllimet e nenit 5 § 1 (e). Ajo u shpreh se gjatë procedurave, autoritetet italiane nuk e përshkruanin z. Guzzardi si një njeri të parëndësishëm, por përkundrazi u përqendruan në të dhënat e tij kriminale, aktivitetet e tij të paligjshme dhe lidhjet e tij me mafien. Për më tepër, Gjykata nuk e konsideroi mënyrën e jetesës së kërkuesit sipas kuptimit të zakonshëm të fjalës "endacak". Më e rëndësishmja, është theksuar se neni 5 § 1 (e) lejon ndalimin e personave jo të shëndetshëm mendërisht, alkoolikë, të varur nga droga dhe endacakë, jo vetëm sepse ata herë pas here vlerësohen të rrezikshëm për sigurinë publike, por sepse edhe vetë interesat e tyre mund të kërkojnë ndalimin e tyre. Si pasojë, Gjykata nuk mund të pranojë se fakti që neni 5 § 1 (e) autorizon ndalimin endacakëve, do të nënkuptonte që arsyetimi i lartpërmendur mund të zbatohet për çdo individ që vlerësohet si i rrezikshëm.

Gjykata më pas vazhdoi të shqyrtojë mundësinë e ndalimit të kërkuesit për arsyetim sipas paragrafëve të tjerë të nenit 5 § 1, të cilat nuk ishin pranuar nga Qeveria. Ajo

përjashtoi paraburgimin “pas dënimit nga një gjykatë kompetente” (neni 5 § 1 (a)) sepse vendbanimi i detyrueshëm nuk ishte ndëshkim për një vepër specifike, por një masë parandaluese e marrë mbi forcën e treguesve për të qenë i prirur ndaj krimit. Gjykata gjithashtu kundërshtoi mundësinë e një arsyetimi sipas nenit 5 § 1 (b) pasi paralajmërimi i lëshuar nga Shefi i Policisë nuk përbënte “urdhër gjykate”.

Për më tepër, neni 5 § 1 (c) nuk u vlerësua si i zbatueshëm, pasi vendimet e Gjykatës Rajonale nuk kishin asnjë lidhje juridike me hetimin penal lidhur me rrëmbimin, vepra që kërkuesi dyshohej se kishte kryer. Legjislacioni i posaçëm i mbikëqyrjes mund të zbatohet pavarësisht nëse është ngritur një akuzë ndaj një individi. Për më tepër, meqenëse neni 5 § 1 (c) dhe aftësia për të ndaluar një individ, kur kjo konsiderohet e domosdoshme, për t'i parandaluar ata të kryejnë një vepër penale, nuk autorizon një politikë të përgjithshme parandalimi, të drejtuar kundër një kategorie të veçantë të individëve, siç është mafia, paraburgimi i kërkuesit nuk mund të justifikohet sipas kësaj dispozite.

Për rrjedhojë, Gjykata arriti në përfundimin se nuk kishte asnjë arsyetim sipas nenit 5 § 1 (a) - (f) për ndalimin e kërkuesit, kështu që kishte pasur shkelje të nenit 5 § 1.

Nenet 3, 6, 8, 9

Gjykata trajtoi shkurtimisht pretendimet e tjera të kërkuesit. Ajo vendosi që kushtet e tij të jetesës nuk e arrinin pragun e duhur të ashpërsisë për t'u konsideruar brenda fushës së veprimit të nenit 3. Gjykata konstatoi se nuk kishte prova për shkelje të nenit 6 § 1. Meqenëse gruaja dhe djali i kërkuesit ishin në gjendje të jetonin me të për katërmbëdhjetë nga gjashtëmbëdhjetë muajt që ai kaloi në ishull dhe arsyeja për të cilën duhej t'i linte ishte se ata nuk kishin aplikuar për rinovimin e lejeve të tyre të qëndrimit, Gjykata arriti në përfundimin se nuk kishte asnjë sjellje që mund t'i atribuohet shtetit italian në kundërshtim me nenin 8. Si përfundim, Gjykata nuk gjeti prova që të vërtetonte pretendimin e kërkuesit se e drejta për të manifestuar besimin e tij fetar ishte shkelur.

Neni 50

Gjykata vendosi se Republika e Italisë duhet ti paguante kërkuesit 1 milion lireta.^[756]

[756] Ekuivalente me 557.23 £ në atë kohë.

Zbatimi i rreptë i rezolutave kundër terrorizmit të miratuara nga Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara ka shkelur Nenin 8 por nuk e ka privuar kërkuesin prej lirisë së tij brenda kuptimit të Nenit 5

VENDIMI I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN NADA k. ZVICRËS

(Kërkesa Nr. 10593/08)
12 shtator 2012

1. Faktet kryesore

Kërkuesi ishte shtetas italian dhe egjiptian i lindur në vitin 1931. Ai jetonte në Campiona d'Italia, një enklavë italiane me sipërfaqe rreth 1.6 kilometra katrorë që rrethohej nga Kantoni zviceran Ticino dhe ndahej nga pjesa tjetër e Italisë prej liqenit të Luganos. Prandaj ai nuk e kishte të mundur të udhëtonte drejt pjesës tjetër të Italisë pa hyrë nëpër Zvicër. Kërkuesi vuante prej disa sëmundjeve, dhe nuk mundi të kryente një operacion të caktuar për t'u realizuar në vitin 2004 për shkak të ndalim-udhëtimit, çka ishte lënda e kësaj kërkesë.

Në përgjigje të sulmeve nga Osama bin Laden dhe rrjetit të tij, Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara (OKB) miratoi rezolutën 1267 më 15 tetor 1999 e cila vinte sanksione ndaj Talibanit dhe krijoi Komitetin e Sanksioneve të OKB-së. Më 2 tetor 2000, Këshilli Federal Zviceran miratoi Urdhëresën Taliban e cila përmbante masa kundër Talibanit. Këshilli i Sigurimit e vazhdoi regjimin e sanksioneve në vitin 2000 me anë të Rezolutës 1333, duke i kërkuar Komitetit të Sanksioneve të OKB-së që të mbante një listë të personave dhe organizatave të lidhura me Osama bin Laden dhe al-Qaedën. Në Urdhëresën Taliban u bënë amendamentet përkatëse.

Prokurori Federal Zviceran nisi hetimet rreth aktiviteteve të kërkuesit më 24 tetor 2001. Emri i tij dhe një sërë organizatash të ndërlidhura me të u futën në listën e sanksioneve dhe në listën shtojcë të Urdhëresës Taliban në nëntor të vitit 2001. Në janar 2002, Rezoluta 1390 e Këshillit të Sigurimit futi një ndalesë hyrje-dhe-tranzit për të gjithë individët, grupet, sipërmarrjet, dhe entitetet e ndërlidhura në listën e sanksioneve. Qeveria zvicerane bëri amendamentet përkatëse në Urdhëresën Taliban dhe zbatoi ndalesën hyrje-dhe-tranzit për individët e emërtuar në Shtojcën e saj, përfshirë kërkuesin.

Kur kërkuesi udhëtoi për në Londër në nëntor të vitit 2002, atij iu konfiskuan paratë dhe ai u arrestua dhe u deportua mbrapa për në Itali. Më pas, në tetor të vitit 2003, Kantoni Ticino tërhoqi lejen e tij speciale për kalimin e kufirit. Në nëntor 2003, Zyra Federale Zvicerane e Imigracionit, Integrimin dhe Emigracionit ("IMES") e informoi atë që ai nuk ishte më i autorizuar të kalonte kufirin. Në mars 2004, IMES e refuzoi kërkesën e tij për leje për të hyrë ose për të kaluar tranzit përmes Zvicrës për trajtim mjekësor atje, dhe për procedura ligjore në Zvicër dhe në Itali, si të pabazuar. Më vonë, Zyra Federale për Migrim (pasuesja e IMES) i lejoi kërkuesit një përjashtim për një ditë për të ndjekur procedurat ligjore në Milano, çka ai nuk e përdori.

Në maj të vitit 2005, Prokurori Federal gjeti që akuzat kundër kërkuesit ishin të pabazuara dhe i mbylli hetimet. Kërkesa e kërkuesit drejtuar Këshillit Federal për ta hequr emrin e tij dhe organizatat e ndërlidhura me të nga Shtojca e Urdhëresës Taliban u refuzua mbi bazën e arsytimit që kjo nuk mund të bëhej për sa kohë që emri i tij mbetej në listën e Komitetit të Sanksioneve. Refuzimi tregonte se ai duhet t'i kërkonte Shtetit të shtetësisë ose rezidencës së tij që të aplikonte për heqjen e tij nga lista. Apeli i tij arriti në Gjykatën Federale e cila e rrëzoi atë mbi bazën e faktit që, sipas Nenit 25 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, Zvicra kishte marrë përsipër të pranonte dhe të zbatonte vendimet e Këshillit të Sigurimit. Megjithatë, gjatë një takimi mes avokatit të tij dhe një përfaqësuesi të Departamentit Federal të Çështjeve të Jashtme në shkurt të vitit 2008, ky i fundit u shpreh se Qeveria zvicerane do ta mbështeste atë në aplikimin për heqjen nga lista duke konfirmuar që procedurat penale kundër tij ishin ndërprerë.

Në korrik 2008, Komiteti i Sanksioneve refuzoi kërkesën e Qeverisë italiane për të hequr emrin e kërkuesit. Në gusht 2009, kërkuesi paraqiti një kërkesë në përputhje me Rezolutën 1730 për të hequr emrin e tij nga lista e Komitetit të Sanksioneve. Emri i tij u hoq nga kjo listë më 23 shtator 2009 dhe nga Shtojca e Urdhëresës Taliban më 29 shtator 2009.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi u ankua që ndalesa hyrje-dhe-tranzit që i ishte vënë atij nga Zvicra kishte shkelur të drejtën e tij për respekt ndaj jetës private, profesionale dhe familjare sipas Nenit 8 të Konventës. Ai gjithashtu u ankua që ajo e privonte atë nga liria e tij brenda kuptimit të Nenit 5 § 1. Më tej, ai pretendoi se kishte pësuar trajtim në shkelje të Nenit 3 dhe që pamundësia e tij për t'u larguar nga enklava për të shkuar në xhami kishte shkelur Nenin 9.

Kundërshtimet paraprake

Duke pasur parasysh që ndalesa u imponua përmes një Urdhërese nga Këshilli Federal Zviceran dhe që kërkesat e kërkuarit për përjashtim u refuzuan nga autoritetet zvicerane, masat e ankmuara u morën nga Zvicra gjatë ushtrimit të juridiksionit të saj brenda kuptimit të Nenit 1.

Megjithëse kërkuari nuk pengohej më nga kalimi i kufirit zviceran, ai ende kishte të drejtën për të pretenduar se kishte qenë viktimë gjatë periudhës në të cilën ai kishte qenë objekt i atyre kufizimeve. Heqja e sanksioneve nuk mund të konsiderohej pranimit i nënkuptuar nga Qeveria i një shkeljeje.

Neni 8

Një Shtet ka të drejtën të kontrollojë hyrjen e joshettesave në territorin e vet, dhe Konventa nuk garanton të drejtën e një të huaji për të hyrë në një vend tjetër. Megjithatë, Gjykata e mbështeti opinionin e Gjykatës Federale që masa në fjalë e ka kufizuar në mënyrë domethënëse lirinë e kërkuarit për shkak të lokacionit të veçantë të vendqëndrimit të tij në enklavën Campione d'Italia e cila rrethohej nga territor zviceran. Për një periudhë prej së paku gjashtë vitesh, u bë më e vështirë për të që të ushtronte të drejtën e tij për të mbajtur kontakte me të tjerët që jetonin jashtë enklavës. Prandaj, ka pasur ndërhyrje tek e drejta e tij për respekt ndaj jetës së tij private dhe familjare.

Kërkuari nuk u duk se vuri në diskutim faktin që ndalesa ishte vendosur në synim të një qëllimi legjitim. Sidoqoftë, Gjykata deklaroi që ndalesa synonte qëllime legjitime të cilat përfshinin parandalimin e krimeve, sigurinë kombëtare, dhe ruajtjen e publikut, meqenëse ajo ishte futur në përputhje me rezolutat e Këshillit të Sigurimit të miratuara për të luftuar terrorizmin ndërkombëtar sipas Kreut VII të Kartës së OKB-së. Megjithatë, Shtetet ishin të lira të zgjidhnin modelin përmes të cilit ato zbatonin rezolutat e Kreut VII.

Gjykata më tej mori në shqyrtim nëse masat ishin proporcionale me këtë qëllim. U pranua që kërcënimi i terrorizmit ishte serioz në kohën kur u morën masat. Megjithatë, hetimet e zhvilluara nga autoritetet zvicerane dhe italiane konkluduan që dyshimet rreth aktiviteteve të kërkuarit ishin të pabazuara. Gjykata u habit që autoriteteve zvicerane iu desh deri në shtator 2009 që të informonin Komitetin e Sanksioneve që hetimet kundër kërkuarit ishin mbyllur në maj 2005. Sikur autoritetet të ishin treguar më të shpejtë në komunikimet e tyre, emri i tij

mund të ishte fshirë nga lista e sanksioneve, e më pas nga Urdhëresa Taliban, shumë më herët.

Çështja kishte edhe një aspekt mjekësor. Pavarësisht nga fakti që kërkuesi ishte i lindur në vitin 1931 dhe kishte shumë probleme shëndetësore, kërkesat e tij për përjashtim nga ndalesa hyrje-dhe-tranzit për arsye mjekësore ose në lidhje me procedurat gjyqësore u refuzuan. Në rastet kur kërkesat e tij u pranuan, ishte e kuptueshme që ai kishte hequr dorë nga e drejta ndaj këtyre përjashtimeve si të pamjaftueshme në kohëzgjatje, duke pasur parasysh moshën e tij dhe distancën që duhej përshkuar. Ndërkohë që Zvicra nuk ishte përgjegjëse për futjen e emrit të kërkuesit në listë dhe nuk kishte kompetencë për t'i bërë kërkesë Komitetit të Sanksioneve për heqjen e tij nga lista, dukej se autoritetet zvicerane nuk u përpoqën fare të nxisnin Italinë për ta bërë një kërkesë të tillë ose për të ofruar ndihmesë për këtë qëllim. Prandaj, Gjykata deklaroi që ajo nuk kishte marrë parasysh sa duhej natyrën e veçantë të çështjes së kërkuesit, pra lokacionin e venbanimit të tij, moshën dhe shëndetin e tij, si dhe kohëzgjatjen e konsiderueshme të masave.

Shteti nuk arriti ta bindte Gjykatën që ai i kishte marrë të gjitha masat e mundshme brenda mundësive të tij për t'ia përshtatur regjimin e sanksioneve situatës së kërkuesit, duke mos u mbështetur thjesht tek natyra detyruese e rezolutave të Këshillit të Sigurimit. Prandaj, nuk ishte e nevojshme që Gjykata të përcaktonte hierarkinë mes detyrimeve sipas Konventës dhe Kartës së OKB-së. Përfundimisht, masat dështuan të arrinin një ekuilibër të drejtë mes qëllimeve legjitime të synuara dhe të drejtës së kërkuesit për respekt ndaj jetës së tij private dhe familjare. Rrjedhimisht, Gjykata deklaroi që kishte shkelje të Nenit 8.

Neni 13

Megjithëse kërkuesi pati mundësi të aplikonte tek autoritetet zvicerane për të hequr emrin e tij nga lista, Gjykata Federale konsideroi që vetëm Komiteti i Sanksioneve i OKB-së ishte kompetent për ta lejuar këtë kërkesë. Kështu, kërkuesi nuk kishte zgjidhje efektive për shkeljen e të drejtave të tij. Prandaj, ka pasur shkelje të Nenit 13.

Neni 5

Kufizimet e kërkuesit vazhduan për një kohë të konsiderueshme. Megjithatë, ai nuk u ndalua nga lëvizja e lirë brenda enklavës të cilën, vë në dukje Gjykata, ai e kishte zgjedhur si vendbanim të përhershëm me vullnetin e tij të lirë. Më tej, ai

nuk u bë objekt paraburgimi, arresti shtëpiak, dhe as nuk u vu nën vëzhgim nga autoritetet zvicerane, nuk u ndalua nga pranimi i vizitorëve, e as nuk iu kërkua të paraqitej rregullisht në polici. Atij iu ndalua vetëm hyrja ose tranziti përmes Zvicrës. Së fundi, regjimi i sanksioneve i kishte lejuar atij të kërkonte përjashtim nga ndalesa të cilin, pasi iu lejua, ai nuk e shfrytëzoi. Në përfundim, masa nuk e kishte privuar kërkuesin nga liria e tij brenda kuptimit të Nenit 5 § 1. Prandaj kjo pjesë e kërkesës u hodh poshtë si dukshëm e pabazuar.

Nenet 3 dhe 9

Gjykata e refuzoi këtë pjesë të kërkesës si të papranueshme meqenëse nuk kishte shenja të ndonjë shkeljeje të Neneve 3 dhe 9.

Neni 41

Gjykata i caktoi kërkuesit 30,000 Euro për kosto dhe shpenzime.

Mbyllja brenda (lockdown) e imponuar nga autoritetet rumune gjatë pandemisë Covid-19 nuk mund të barazohej me arrestin shtëpiak dhe neni 5 § 1 nuk qe i aplikueshëm

VENDIMI NË ÇËSHTJEN TERHEŞ K. RUMANISË

(Kërkesa Nr. 49933/20)

13 prill 2021

1. Faktet kryesore

Kërkuesi, z. Cristian-Vasile Terheş, ishte shtetas rumun i lindur në vitin 1978.

Më 11 mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetësisë deklaroi se bota po përballej me pandemi të shkaktuar nga Covid-19. Pesë ditë më pas, Presidenti rumun miratoi një dekret që vendoste gjendjen e jashtëzakonshme për tridhjetë ditë në Rumani, dhe vendosi kufizime në lirinë e lëvizjes. Presidenti rumun e zgjati gjendjen e jashtëzakonshme edhe për tridhjetë ditë të tjera më 14 prill 2020, duke i dhënë fund më 14 maj 2020 në mesnatë.

Si reagim ndaj situatës së zhvilluar, më 24 mars 2020 Ministri i Brendshëm lëshoi një urdhëresë që këshillonte njerëzit të mos dilnin nga shtëpia mes orës 6:00 të mëngjesit dhe orës 10:00 të mbrëmjes, dhe që i ndalonte ata të dilnin jashtë mes orës 10:00 të mbrëmjes dhe orës 6:00 të mëngjesit. Më pas Ministri lëshoi një urdhëresë të dytë e cila i ndalonte të gjitha lëvizjet jashtë shtëpisë, përveç një numri të caktuar të disa rrethanave shteruese. Çdo person që dilte nga shtëpia duhet të kishte me vete një dokument që vërtetonte arsyet valide për të dalë, dhe çdo shkelje e rregullave ishte e dënueshme me gjobë.

Një ditë pas shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme nga Presidenti, Përfaqësia e Përhershme e Rumanisë në Këshillin e Evropës e informoi Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit në lidhje me qëllimin e saj për të bërë derogim nga neni 15 i Konventës. Këshilli i Evropës mori përditësime të rregullta rreth masave që po merrte Rumania të cilat i lejonin atij vendi që të vazhdonte derogimin nga detyrimet e nenit 4 të Protokollit 2. Derogimi vazhdoi deri më 14 maj 2020, kur iu dha fund gjendjes së jashtëzakonshme.

Më 7 maj 2020, kërkuesi filloi procedurat kundër Gjykatës Krahinore të Bukureshtit sipas nenit 5 § 4 të Konventës. Kërkuesi pretendoi se ai i ishte

nënshtruar “paraburgimit administrativ” prej 24 marsit deri më 14 maj 2020, të shkaktuar nga masat e Covid-19 të vendosura nga autoritetet. Ai kërkoi një urdhër për lirimin e tij të menjëhershëm dhe një deklaratë që ai kishte të drejtë të dilte nga shtëpia e tij për çfarëdo arsyeje pa pasur nevojë të paraqiste ndonjë dokument mbështetës dhe pa rrezikuar gjobë. Kërkuesi i kërkoi Gjykatës Krahinore që ta gjente veprimin e tij të paqëllimshëm, për shkak të përfundimit të masës së mbylljes brenda (lockdown) më 12 qershor 2020.

Përveç kësaj, kërkuesi bëri apele për rikonsiderimin e dekreteve dhe urdhëresës së dytë më 8 dhe 25 maj 2020. Ai e justifikoi kërkesën e tij mbi bazën se masat kishin ndikuar personalisht tek e drejta e tij për liri dhe siguri. Apelet u rrëzuan mbi bazën se tekstet në fjalë nuk mund t'i nënshtroheshin shqyrtimit administrativ.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi u ankua sipas nenit 5 § 1 të Konventës që mbyllja e përgjithshme që u vendos prej 24 marsit 2020 përbëri privim të paligjshëm të lirisë.

Neni 5 § 1

Si pikë paraprake, Gjykata theksoi se kërkuesi nuk u mbështet para Gjykatës tek neni 2 i Protokollit Nr. 4 të Konventës, e drejta për lirinë e lëvizjes. Prandaj, ai tentoi të tregonte se mbyllja e përgjithshme përbëri privim të lirisë, e jo thjesht kufizim të lirisë së tij të lëvizjes.

Gjykata afirmoi që, për të përcaktuar nëse masa përbente privim të lirisë, situata e kërkuesit duhet të shqyrtohej sipas kritereve të vendosura nga praktika e saj gjyqësore. Gjykata ekzaminoi veçantitë e masës – pra kohëzgjatja e saj, lloji, efektet dhe metodat e ekzekutimit – në kuadër të kontekstit në të cilin ajo u zbatua.

Për sa i përket kontekstit, Gjykata vuri në dukje se masa u vendos në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme për arsye shëndetësore, me qëllim të parandalimit të transmetimit të infektimit në komunitet duke izoluar dhe kufizuar tërë popullatën. Në pajtim me autoritetet, Gjykata qe e mendimit se situata mund të përshkruhej si “kontekst i pazakontë i paparashikueshëm”. Legjislacioni zbatues specifikonte që nëse autoritetet rumune dështonin të vepronin urgjentisht për të kufizuar përhapjen e virusit, kjo do të kishte ndikim serioz mbi të drejtën e jetës si dhe të drejtën e shëndetit. Duke pasur parasysh këtë kontekst, Gjykata doli në

përfundimin që masat u vendosën me qëllim të lehtësimit të impaktit ekonomik dhe social të pandemisë dhe me qëllim të mbrojtjes së jetës.

Për sa u përket veçantive, Gjykata theksoi se masa në fjalë zgjati pesëdhjetë ditë, pra nga 24 marsi deri më 14 maj 2020. Për sa i përket llojit dhe metodës së ekzekutimit, kërkuesi nuk qe objekti i një mase individuale. Përkundrazi, masa ishte e përgjithshme dhe e vendosur mbi tërë popullatën me anë të legjislacionit të miratuar nga autoritetet rumune. Për sa u përket efekteve, kërkuesi kishte qenë i detyruar të qëndronte në shtëpi si rezultat i masës. Megjithatë, ai u lejua të dilte për njërën prej arsyeve shprehimisht të parashikuara në legjislacionin zbatues, me formularin përkatës të përjashtimit. Më tej, ai nuk iu nënshtrua vëzhgimit individual nga ana e autoriteteve, as nuk u detyrua të jetonte në një hapësirë të kufizuar ose të privohej nga kontaktet sociale. Rrjedhimisht, Gjykata gjeti se masa e kontestuar nuk mund të barazohej me arrest shtëpiak.

Gjykata theksoi në mënyrë të veçantë se kërkuesi nuk kishte shpjeguar se si masa kishte ndikuar tek ai personalisht, e as nuk identifikoi ndonjë rrethanë veçanërisht rënduese. Për shembull, kërkuesi nuk pretendoi se situata e tij nuk kualifikohet sipas ndonjërit prej përjashtimeve të parashikuara në urdhëresë i cili do ta lejonte atë të dilte nga shtëpia, e rrjedhimisht u detyrua të rrinte në shtëpi gjatë tërë periudhës së jashtëzakonshme. Përkundrazi, Gjykata theksoi se ai nuk dha asnjë përshkrim se si ai e kishte përjetuar personalisht mbylljen brenda në terma specifike.

Duke pasur parasysh të gjitha këto konsiderata, Gjykata doli në përfundimin që shkalla e kufizimeve të vëna mbi lirinë e kërkuesit nga masa e mbylljes brenda nuk ishte e një intesiteti të atillë sa të përbënte privim të lirisë. Rrjedhimisht, neni 5 § 1 nuk ishte i aplikueshëm në rastin konkret.

Në fund, Gjykata theksoi se Rumania kishte bërë derogim duke ndjekur procedurën e nenit 15 të Konventës dhe synonte ta zbatonte derogimin nga detyrimi që del nga neni 2 i Protokollit Nr. 4 të Konventës, i cili garanton lirinë e lëvizjes. Gjykata deklaroi se, meqenëse neni 5 § 1 nuk ishte i aplikueshëm në këtë rast, nuk ishte e nevojshme të shqyrtohej vlefshmëria e derogimit të bërë nga Rumania para Këshillit të Evropës.

Rrjedhimisht, Gjykata e refuzoi kërkesën si të papranueshme meqenëse nuk kishte dukje të ndonjë shkeljeje të nenit 5.

V. Procedurat gjyqësore dhe garancitë

Dështimi për të ofruar prova eksperte të pavarura dhe përgjigje të kohshme ndaj akuzave penale për praktikë të keqe mjekësore ku procedurat zgjatën mbi pesëmbëdhjetë vjet ka përbërë shkelje të Nenit 2

VENDIMI NË ÇËSHTJEN BAJIĆ k. KROACISË

(Kërkesa Nr. 41108/10)
13 nëntor 2012

1. Faktet kryesore

Kërkuesi ishte shtetas holandez i lindur në vitin 1950. Në gusht të vitit 1994, motra e tij u shtrua në spitalin Rebro në Zagreb për tumor abdominal ku u trajtua nga një kirurg dhe profesor në Fakultetin e Mjekësisë së Universitetit të Zagrebit ("Fakulteti"), të cili kërkuesi i pagoi 5000 Marka gjermane për operacionin e nevojshëm. Motra e tij vdiq pas dy ditësh, ku kirurgu konstatoi se shkaku ishte embolizma pulmonare (e mushkërive).

Në tetor 1994, kërkuesi dhe dy të afërm të tjerë depozituan një ankesë penale kundër kirurgut në Zyrën e Prokurorit të Shtetit pranë Bashkisë së Zagrebit, ku e akuzonin atë për mitosje dhe praktikë të keqe mjekësore. Një raport mjekësor nga dy profesorë të Fakultetit nuk gjetën praktikë të keqe mjekësore, dhe kështu këto akuza u rrëzuan. Kërkuesi kërkoi që Gjykata Penale Bashkiake e Zagrebit të kërkonte një raport të ri nga ekspertë që nuk kishin lidhje me të akuzuarin. Kështu, u hartua një raport i ri nga një mjek i Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Rijekës, i cili gjithashtu nuk gjeti praktikë të keqe mjekësore. Pavarësisht se mjeku vetë pranoi që nuk ishte i emëruar si ekspert mjekësor i përhershëm, gjykata e liri të akuzuarin nga akuzat për praktikë të keqe mjekësore. Procedurat në lidhje me akuzën për mito u ndërpre në vitin 2000 për arsye se kishte skaduar afati kohor.

Në shtator 2004, kërkuesi apeloj pranë Gjykatës Krahinore të Zagrebit, e cila urdhëroi riVENDIMIn dhe kërkoi hartimin e një raporti të ri, meqenëse mjeku nga Universiteti i Rijekës nuk ishte ekspert mjekësor nën betim. Sërish, ky raport i ri nuk gjeti praktikë të keqe mjekësore dhe u përgatit nga profesorë të Fakultetit. Kërkuesi bëri edhe tri kërkesa të tjera për raporte të reja, ku dy kërkesat e fundit specifikonin që raporti të hartohej nga një institucion jashtë Kroacisë, duke vënë në dukje se njëri prej ekspertëve ishte Drejtor Reparti në Spitalin Rebro. Të gjitha

kërkesat u refuzuan dhe, në dhjetor 2007, Gjykata Komunale e Zagrebit e liroi të akuzuarin nga akuzat. Kërkuesi bëri apele të mëtejshme, të cilat arritën në Gjykatën Kushtetuese në nëntor 2009, dhe u shpallën të papranueshme për shkak se procedurat në fjalë nuk kishin pasur të bënin me asnjë prej të drejtave të tij civile, detyrimeve apo ndonjë akuzë penale kundër tij.

Në maj 1995, kërkuesi bëri ankesë pranë Ministrisë së Shëndetësisë. Nisën procedurat disiplinore për akuzat për mitosje. I akuzuari fillimisht u gjet fajtor dhe u hoq nga spitali Rebro, por kjo u kthye mbrapsht në gusht 1995, dhe në vend të saj, ai u pezullua nga puna për një vit. Në mars 2001, kërkuesi ngriti procedurë civile pranë Gjykatës Komunale të Zagrebit kundër të akuzuarit, çka ishte ende në pritje në Gjykatën Kushtetuese në kohën e VENDIMIT të tanishëm.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi u ankua që të gjitha faktet relevante në lidhje me vdekjen e motrës së tij nuk ishin konstatuar siç duhej në procedurat penale të zgjatura në masë të paarsyeshme, çka Gjykata e mori në konsideratë nën prizmin e Nenit 2. Më tej ai u ankua për mungesën e zgjidhjes efektive në vend dhe mungesën e drejtësisë në procedurat penale, sipas Nenit 13 dhe 6 respektivisht.

Neni 2

Gjykata përsëriti që veprimet dhe mosveprimet e autoriteteve në fushën e kujdesit shëndetësor në rrethana të caktuara mund të angazhojnë përgjegjësinë e tyre sipas sferës pozitive të Nenit 2. Megjithatë, kjo nuk aplikohet në rastet e gabimit në gjykim ose koordinim neglizhent, ku një Shtet ka marrë masat e përshtatshme për garantimin e standardeve të larta profesionale mes profesionistëve shëndetësorë dhe mbrojtjen e jetës së pacientëve.

Më tej ajo përsëriti që Neni 2 krijon detyrimin pozitiv që Shtetet të ngrenë një sistem gjyqësor të pavarur për të përcaktuar shkaku të vdekjes së pacientëve në kujdes mjekësor, qoftë publik apo privat, dhe për të siguruar që përgjegjësit të japin llogari. Pavarësia përkufizohet si: mungesa e lidhjeve hierarkike ose institucionale mes atyre që bëjnë vlerësime në vazhden e procedurave dhe atyre që janë të implikuar në ngjarje, si dhe pavarësia formale dhe faktike e të parës. U theksua se kjo kishte rëndësi të veçantë në rastin e raporteve mjekësore nga dëshmitarë ekspertë, meqenëse ato kanë peshë thelbësore në çështjet e neglizhencës mjekësore.

Gjykata Penale Komunale e Zagrebit kërkoi hartimin e tre raporteve mjekësore. Nuk u vu në diskutim që të gjithë ekspertët mjekësorë mbi raportet e të cilëve bazoheshin vendimet e autoriteteve vendase ishin profesorë të Fakultetit. I akuzuari gjithashtu ishte profesor në Fakultet dhe mjek ekspert i njohur nga Zagrebi. Më tej, një prej ekspertëve ishte Drejtor i Patologjisë në Spitalin Rebro, pavarësisht nga Neni 250 i Kodit të Procedurës Penale të Kroacisë që shprehimisht thoshte se një ekspert i punësuar nga i njëjti autoritet ose punëdhënës shtetëror si edhe i akuzuari apo i lënduari duhet të skualifikohet.

Po ashtu u shënuar që kërkuesi kërkoi, shumë herë, që ekspertët nga Fakulteti të skualifikoheshin nga çështja. Megjithatë, gjykatat vendase, pa i pyetur direkt dëshmitarët ekspertë rreth lidhjeve të tyre me të akuzuarin, i rrëzuan mocionet e kërkuesit për skualifikim të tyre duke thënë se nuk kishte asnjë tregues që sugjeronte njëanshmëri.

Gjykata theksoi që këtu rrezikohej besimi i publikut në sistemin e drejtësisë penale: fakti që ekspertët mjekësorë nuk mund të shiheshin si objektivist të paanshëm sipas të drejtës kroate, duke qenë se ishin profesorë nga i njëjti Fakultet si i akuzuari.

Ajo përsëriti që Neni 2 garanton përgjigje të shpejta dhe të arsyeshme, të përkufizuara si 'pa vonesa të panevojshme', nga qeveria në hetimin e vdekjes së pacientit. Ajo shënoi që procedurat penale kishin zgjatur mbi pesëmbëdhjetë vjet, çka ishte kohë tepër e gjatë, dhe as sjellja e kërkuesit e as kompleksiteti i çështjes nuk mjaftonin për të shpjeguar një kohëzgjatje të tillë. Për më tepër, sa i përket ankesës së bërë pranë Ministrisë së Shëndetësisë, Gjykata shënoi që ajo kishte hapur vetëm procedurë për akuzat e mitos, pa trajtuar fare ankesën për praktikë të keqe mjekësore.

Prandaj, Gjykata gjeti që sistemi vendas në tërësi kishte dështuar të ofronte përgjigje të përshtatshme dhe të kohshme ndaj pretendimeve të kërkuesit, duke shkelur Nenin 2.

Article 13

Gjykata vuri në dukje që efektiviteti i zgjidhjeve ishte trajtuar mjaftueshëm sipas Nenit 2, kështu që nuk kishte nevojë të shqyrtohej më tej sipas Nenit 13.

Neni 6

Duke pasur parasysh provat në dispozicion, Gjykata konsideroi që nuk kishte paraqitje të ndonjë shkeljeje dhe prandaj konkludoi që kjo ankesë ishte e papranueshme meqenëse ishte dukshëm e pabazuar.

Neni 41

Gjykata i caktoi 10,000 Euro kërkesit për dëme jomateriale dhe 7,000 Euro për kosto dhe shpenzime.

Kryerja e një procedure mjekësisht të nevojshme tek një i paraburgosur pa pëlqimin e tij nuk ka shkelur Nenet 3 dhe 8 por dështimi për t'i ofruar atij ndihmë të vërtetë ligjore për ta përgatitur për gjyqin e tij penal ka shkelur Nenin 6

VENDIMI NË ÇËSHTJEN BOGUMIL K. PORTUGALISË

(Kërkesa Nr. 35228/03)

7 tetor 2008

1. Faktet kryesore

Kërkuesi ishte shtetas polak i lindur në vitin 1971. Në kohën kur bëri kërkesën në Gjykatë ai ishte i paraburgosur në Burgun e Lisbonës.

Në nëntor të vitit 2002, pas arritjes në aeroportin e Lisbonës nga Brazili, kërkuesi u kontrollua nga oficerët e doganës, të cilët gjetën disa paketa me kokainë të fshehura në këpucët e tij. Ai i informoi ata që ai kishte gëlltitur edhe një paketë tjetër, e cila ndodhej në stomakun e tij. Një kontroll me rreze X shfaqti praninë e qeskës në traktin digjestiv të tij. Kërkuesi iu nënshtrua endoskopisë së traktit të epërm digjestiv për të identifikuar lokacionin e saktë të qeskës, e cila më pas u nxor prej stomakut të tij me operacion. Sipas raporteve të mjekëve, ndërhyrja kirurgjike u desh të kryhet urgjentisht për të parandaluar tretjen e përmbajtjes së qeskës nga stomaku i kërkuesit. Dosja mjekësore e kërkuesit përmbante pëlqimin e tij me shkrim për endoskopinë e traktit digjestiv të epërm por nuk përmbante pëlqimin e tij për operacionin për nxjerrjen e paketës së kokainës nga stomaku i tij. Kërkuesi dhe Qeveria nuk qenë dakord lidhur me faktin nëse ai e kishte dhënë apo jo gojarisht pëlqimin për t'iu nënshtruar ekzaminimit dhe trajtimit mjekësor.

Kundër kërkuesit u ngritën akuza për trafikim droge, dhe ai u vendos në paraburgim paragyqësor. Gjatë fazës fillestare të procedurës, kërkuesi u ndihmua nga një avokat në trajnim. Në janar të vitit 2003, duke pasur parasysh rreptësinë e dënimit të mundshëm të kërkuesit, në çështjen e tij u caktua një avokat i ri më me përvojë. Megjithatë, ky avokat nuk ndërmori asnjë veprim në lidhje me çështjen, përveç se kërkoi që të lirohej nga procedura tre ditë para gjyqit. Ditën që filloi gjyqi u caktua një avokat tjetër zëvendësues i cili pati vetëm pesë orë kohë për të studiuar dosjen e lëndës. Në shtator 2003, Gjykata Penale e Lisbonës e shpalli kërkuesin fajtor, e dënoi me katër vjet e dhjetë muaj burgim dhe urdhëroi përjashtimin e tij nga Portugalia. Kërkuesi apeloj kundër vendimit pa ndihmë

ligjore, duke argumentuar që dënimi i tij ishte i tepërt dhe që ai nuk kishte pasur ndihmën e duhur ligjore. Apeli i tij u rrëzua në nëntor 2003.

Me një letër të 6 qershorit 2005, ai informoi Gjykatën që ai ishte transferuar në një burg në Poloni. Ai u lirua më 5 dhjetor 2005. Më 13 nëntor 2006, Dr. Viegas, i cili ishte kirurgu kryesor në spital në kohën e operacionit të kërkuesit, bëri një deklaratë ku tha se operacioni i kërkuesit kishte qenë i nevojshëm, që kërkuesi kishte dhënë gojarisht pëlqimin për ndërhyrjen kirurgjike dhe që operacioni ishte shpjeguar në të njëjtën gjuhë siç ishte shpjeguar edhe endoskopia e traktit digjestiv të epërm, çka kërkuesi i kishte kuptuar.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi pretendoi që ai nuk kishte pasur ndihmë ligjore të vërtetë gjatë procedurave penale kundër tij në kundërshtim me Nenin 6 §§ (1) dhe (3)(c) të Konventës. Ai gjithashtu u ankua që operacioni i kryer tek ai përbënte ndërhyrje serioze në integritetin e tij fizik. Gjykata e trajtoi ankesën e tij sipas Neneve 3 dhe 8.

Neni 6

Gjykata përsëriti që Shteti nuk mund të mbante përgjegjësi për çdo mangësi nga ana e një avokati të caktuar për qëllime të ndihmës ligjore. Neni 6 § 3 (c) kërkonte që Shteti të ndërhynte vetëm kur avokati i të akuzuarit ishte dukshëm inkompetent ose nëqoftëse Shteti vihej në dijeni të mjaftueshme në ndonjë mënyrë tjetër që ndihma ligjore ishte e mangët. Çështja në fjalë kishte të bënte me një vepër serioze e cila sillte me vete një dënim potencialisht të rreptë. Pesë orë përgatitje ditën e seancës dëgjimore u gjet të ishte qartazi kohë e pamjaftueshme që avokati të përgatitej për mbrojtjen e kërkuesit. Autoritetet gjyqësore dështuan në zgjidhjen e kësaj mangësie pavarësisht se kërkuesi ua kishte sjellë në vëmendje. Prandaj Gjykata gjeti që Gjykata Penale e Lisbonës ishte në dijeni se kërkuesi kishte pasur ndihmë ligjore dukshëm të mangët, dhe që ajo duhet ta kishte shtyrë procedurën me iniciativën e vet për t'u siguruar që kërkuesi të merrte ndihmën e duhur ligjore. Rrjedhimisht, Gjykata vendosi që kishte pasur shkelje të Nenit 6 § 1 i marrë së bashku me Nenin 6 § 3 (c).

Neni 3

Gjykata deklaroi që ekzistonte detyrimi sipas Nenit 3 për të mbrojtur integritetin fizik të personave të privuar nga liria, posaçërisht në rastet kur një i

paraburgosur i nënshtrohej trajtimit mjekësor të pavullnetshëm. Megjithatë, një procedurë mjekësore që gjykohet e nevojshme nga opinioni mjekësor, në parim, nuk përbënte trajtim çnjerëzor ose poshtëruës.

Gjykata së pari konsideroi nëse kërkuesi kishte dhënë pëlqimin për trajtimin, me ç'rast nuk do të kishte çështje sipas Nenit 3. Fakti që deklarata e Dr. Viegas që kërkuesi kishte dhënë pëlqimin për operacionin u bë katër vjet pas faktit e zvogëloi vlerën e saj provuese. Ndërkohë që Dr. Viegas deklaroi që kërkuesi "sigurisht që e kishte kuptuar" procedurën sepse ishte përdorur e njëjta gjuhë për t'i komunikuar atij endoskopinë, nuk u dhanë hollësi të tjera lidhur me çfarë gjuhe u përdor për të komunikuar me kërkuesin. Në fund, ishte e vështirë të kuptohej përse atij nuk i ishte kërkuar të jepte pëlqimin me shkrim për operacionin kur i ishte kërkuar ta jepte atë për endoskopinë e traktit të epërm, e cila ishte procedurë më pak invazive. Kështu, Gjykata konsideroi që nuk ishte vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm që kërkuesi e kishte dhënë pëlqimin për trajtimin në fjalë. As nuk ishte konstatuar që ai kishte refuzuar dhe ishte detyruar t'i nënshtrohej operacionit.

Megjithatë, ishte konstatuar që operacioni kishte qenë i nevojshëm për arsye terapeutike dhe nuk ishte bërë me qëllim të mbledhjes së provave, meqenëse kërkuesi rrezikonte të vdiste nga helmimi. Ishte një operacion i drejtpërdrejtë dhe kërkuesi kishte qenë nën mbikqyrje të vazhdueshme dhe kujdes mjekësor vijues siç duhej. Duke pasur parasysh provat në dosjen e lëndës, Gjykata konsideroi që nuk ishte konstatuar që lëndimet prej të cilave supozohej se vuante kërkuesi kishin lidhje me operacionin. Rrjedhimisht, operacioni nuk kishte qenë i tillë që përbënte trajtim çnjerëzor ose poshtëruës. Prandaj, nuk kishte pasur shkelje të Nenit 3.

Neni 8

Gjykata riafirmoi që mbrojtja e të drejtës për jetë private përfshinte mbrojtjen e integritetit fizik dhe moral të personit dhe që çdo ndërhyrje ndaj integritetit trupor, përfshirë procedura të vogla mjekësore, përbënte ndërhyrje në të drejtën për respekt ndaj jetës private.

Gjykata pranoi që vendimi i Shtetit për të operuar kërkuesin ishte i parashikuar nga e drejta vendase dhe se qëllimi legjitim i operacionit ishte mbrojtja e shëndetit të kërkuesit. Për arsyet e parashikuara në Nenin 3, Gjykata konsideroi që ishte arritur ekuilibri i drejtë mes interesit publik të mbrojtjes së shëndetit të kërkuesit dhe të drejtës së tij për mbrojtje kundër detyrimit fizik ose psikologjik. Prandaj, nuk kishte pasur shkelje të Nenit 8.

Neni 41

Gjykata i caktoi kërkuesit 3,000 Euro në lidhje me dëme jomateriale.

Autoritetet ukrainase nuk kanë qenë përgjegjëse për një apel të mbetur pa shqyrtuar për shkak të pamundësisë për të rimarrë dosjen e çështjes penale nga një zonë përtej kontrollit të tyre - nuk ka shkelje të Nenit 6

VENDIMI NË ÇËSHTJEN KHLEBIK k. UKRAINËS

(Kërkesa Nr. 2945/16)
25 korrik 2017

1. Faktet kryesore

Kërkuesi ishte shtetas ukrainas që jetonte në rajonin Chernihiv të Ukrainës.

Në prill të vitit 2013, ai u shpall fajtor nga një gjykatë në rajonin Luhansk për vepra që përfshinin bandizëm dhe grabitje të armatosur, dhe u dënua me tetë vjet e nëntë muaj burgim. Apeli i tij kundër dënimit ishte në pritje kur filluan luftimet në Ukrainën lindore në prill të vitit 2014. Ai priti shqyrtimin e apelit të tij në burgun paraprak në Starobilsk, i cili ndodhet në pjesën e rajonit të Luhanskut që kontrollohet nga Qeveria ukrainase. Megjithatë, dosja e lëndës së tij mbeti në Gjykatën e Apelit, në Luhansk, e cila nuk ishte nën kontroll të Qeverisë.

Kur Gjykata e Apelit u rivendos në Sieverodonetsk, zonë e kontrolluar nga Qeveria, kërkuesi u ankua për vonesën në shqyrtimin e apelit të tij. Atij iu tha që gjykata e apelit nuk mund ta shqyrtonte çështjen e tij sepse dosja e lëndës së tij ishte bllokuar në Luhansk. Kërkuesi i kërkoi ndihmë Komisionerit Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, por iu tha se ishte e pamundur të merreshin dosjet nga territori që nuk kontrollohej nga Qeveria. Kërkesa e tij për të rikthyer dosjen e çështjes së tij, për ta regjistruar në një gjykatë vendase, që gjithashtu pa sukses meqenëse gjykata konkludoi që në territorin e kontrolluar nga Qeveria nuk kishte materiale të mjaftueshme në lidhje me çështjen e tij. Ai po ashtu bëri kërkesë për lirim disa herë mes majit 2015 dhe shkurtit 2016, pa sukses. Ai u lirua në mars të vitit 2016 duke përfituar nga një reformë legjislativë që ishte miratuar ndërkohë, e cila lejonte lirimin e individëve që kishin vuajtur të paktën gjysmën e dënimit të tyre gjatë qëndrimit në paraburgim paraprak. Në kohën e këtij VENDIMI, apeli kundër dënimit të tij ishte ende në pritje para Gjykatës së Apelit.

Ndërkohë, më 21 maj 2015 Parlamenti i Ukrainës shpalli emergjencë publike duke cituar agresionin e vazhdueshëm të Federatës Ruse kundër Ukrainës, dhe bëri derogim nga Neni 15 i Konventës.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi u ankua që dështimi i autoriteteve për të miratuar masa dhe procedura të cilat do të lejonin që apeli i tij të shqyrtohej efektivisht përbënin shkelje të Nenit 6 dhe të Nenit 2 të Protokollit Nr. 7. Më tej ai u ankua, sipas Nenit 5 § 1, për paraburgimin e tij prej 31 prillit 2013 deri më 18 mars 2016 dhe që ai nuk kishte pasur të drejtën e zbatueshme për kompensim, sipas Nenit 5 § 5, në këtë pikë.

Neni 6

Gjykata shënoi që në fillim se fushëveprimi i saj kufizohej nga fakti që kërkesa drejtohej vetëm kundër Ukrainës dhe kërkuesi nuk pretendoi që të drejtat e tij ishin shkelur për shkak të një mangësie në bashkëpunimin ndërkombëtar mes Ukrainës dhe një Pale tjetër Të Lartë Kontraktuese. Ajo përsëriti që Neni 6 garanton si të drejtën e qasjes në gjykatë, ashtu edhe të drejtën për seancë dëgjimore të drejtë brenda një kohe të arsyeshme. Ajo konsideroi që shkalla deri ku ato të drejta ishin respektuar në këtë rast i bënte ato të lidhura ngushtë, prandaj u shqyrtuan së bashku.

Nuk u vu në diskutim që kërkuesi pati mundësinë të bënte apel kundër dënimit të tij dhe që ky apel u pranua për shqyrtim mbi meritat. Gjithashtu nuk u konstestua që arsyeja kyçe pse çështja e kërkuesit, në kohën e VENDIMIT, nuk ishte shqyrtuar nga Gjykata e Apelit ishte për shkak se dosja e lëndës së tij nuk ishte më si pasojë e luftimeve në zonat që nuk ishin nën kontrollin e Qeverisë.

Lidhur me çështjen nëse autoritetet ukrainase i kishin marrë të gjitha masat në dispozicion në praktikë, në ato rrethana, për të efektivizuar të drejtat e kërkuesit të garantuara me Nenin 6, Gjykata adresoi tre drejtime të mundshme të cilat, sipas kërkuesit, autoritetet i kishin në dispozicion për të vijuar me shqyrtimin e apelit të tij.

Sa i përket mundësisë së kërkimit të ndihmës së Komisionerit Parlamentar për të Drejtat e Njeriut për sigurimin e dosjes së lëndës, Gjykata shënoi në mënyrë të veçantë që kërkuesi e kishte kërkuar një ndihmë të tillë, çka Komisioneri nuk kishte mundur t'ia ofronte. Gjithashtu u mor parasysh që luftimet në zonë kishin vazhduar gjatë tërë periudhës në fjalë, dhe deri në kohën e VENDIMIT asnjë armëpushim nuk kishte zgjatur.

Sa i përket mundësisë së zhvillimit të hetimeve dhe një gjyqi të ri, Gjykata nuk shihte arsye për të dyshuar në përfundimin e gjykatës vendase, të arritur gjatë procedurës së rivendosjes së çështjes, që ajo nuk kishte në dispozicion asnjë material relevant lidhur me çështjen, meqenëse si vepra për të cilën ishte dënua kërkuesi ashtu edhe gjyqi i tij kishin ndodhur në zonën Luhansk e cila në atë kohë nuk kontrollohej nga Qeveria. Prandaj, nuk ishte vërtetuar që hetimet e reja dhe gjyqi i ri do të ishin efektive në praktikë.

Sa i përket opsionit të shqyrtimit të shpalljes fajtor të kërkuesit dhe dënimit të tij mbi bazën e materialeve në dispozicion, Gjykata shënoi që sipas legjislacionit në fuqi standardi i shqyrtimit do të ngërthente ekzaminimin e çështjeve të ligjit dhe atyre të faktit, çka nënkuptonte se duhej qasje në provat e mbledhura në dosjen e lëndës. Duke qenë se prova të tilla nuk ishin në dispozicion të autoriteteve në atë kohë, dhe se nuk mund të përjashtohet që ato mund të vinin në posedim të tyre në të ardhmen, një shqyrtim i tërësishëm i çështjeve para se të viheshin në dispozicion provat mund të paragjykonte mundësinë e një shqyrtimi më të informuar në të ardhmen.

Duke pasur parasysh faktin që çështja nëse kërkuesi ishte në paraburgim ishte faktor relevant për të përcaktuar arsyeshmërinë e kohëzgjatjes së çështjeve penale, Gjykata i vuri rëndësi faktit që gjykatat ukrainase kishin marrë vendimin për ta liruar atë.

Gjykata arriti në përfundimin që autoritetet ukrainase kishin bërë gjithçka që kishin në dorë në ato rrethana për të trajtuar situatën e kërkuesit. Ajo gjithashtu mirëpriti veprimet e tjera që kishin ndërmarrë autoritetet, veçanërisht kërkesat e tyre për ndihmë drejtuar Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq për ndërmjetësim në marrjen e dosjeve të ndodhura në territorin që nuk ishte nën kontrollin e tyre dhe një propozim legjislativ për lehtësimin e shqyrtimit të apeleve në situata ku një pjesë e dosjes së një çështjeje vazhdonte të mos ishte në dispozicion. Prandaj, Gjykata konkludoi që nuk kishte pasur shkelje të Nenit 6.

Në fund, Gjykata shënoi që palët nuk i kishin kërkuar asaj që të aplikonte Nenin 15 të Konventës në rastin e kërkuesit. Rrjedhimisht, dhe duke marrë parasysh konkluzionin e saj sipas Nenit 6, nuk qe e nevojshme të vlerësohej nëse situata e ankmuar mbulohej nga një derogim i vlefshëm i bërë prej Ukrainës sipas Nenit 15 të Konventës.

Neni 2 i Protokollit Nr. 7

Gjykata e konsideroi të panevojshme ta shqyrtonte këtë ankesë ndaras sipas Nenit 2 të Protokollit Nr. 7, meqenëse ajo kishte të bënte me të njëjtat fakte dhe çështje si ato nga Neni 6.

Neni 5

Gjykata shënoi që, meqenëse kërkuesi ishte paraburgosur pas dënimit nga një gjykatë kompetente, paraburgimi i tij ishte në përputhje me të drejtën vendase dhe kohëzgjatja e tij nuk e kishte tejkaluar dënimin e tij me burg. Nuk kishte tregues të tjerë që paraburgimi i tij nuk ishte në përputhje me Nenin 5. Prandaj, Gjykata e deklaroi këtë ankesë të papranueshme dhe dukshëm të pabazuar.

Megjithëse gjykatat vendase konstatuan përgjegjësinë dhe caktuan kompensim për shëndetin e rrezikuar të kërkueses pas pirjes së ujit të çezmës, shuma e caktuar ishte e pamjaftueshme në shkelje të Nenit 8

VENDIMI NË ÇËSHTJEN OTGON k. REPUBLIKËS SË MOLDAVISË

(Kërkesa Nr. 22743/07)
25 tetor 2016

1. Faktet kryesore

Kërkuesja ishte shtetase moldave që jetonte në Călărași, Republika e Moldavisë. Në tetor të vitit 2005, ajo dhe bija e saj 12-vjeçare u shtruan në spital me dizenteri akute pasi kishin pirë ujë nga çezma në apartamentin e tyre.

Ajo doli nga spitali pas dy javësh dhe menjëherë bëri padi kundër ofruesit shtetëror të shërbimeve shtëpiake, duke pretenduar shumën 6,700 Euro si kompensim për dëmin që i ishte shkaktuar shëndetit të saj.

Në mars të vitit 2006, Gjykata e Rrethit Călărași vendosi në favor të saj, meqenëse raporte të ndryshme teknike dhe sanitare tregonin që uji i kanalizimit kishte hyrë në tubat e ujit të pijshëm në afërsi të apartamentit të saj. Asaj iu caktua shuma e barasvlerëshme me 648 Euro, ku gjykata e bazoi vendimin e saj në sasinë e vuajtjes fizike dhe mendore të shkaktuar. Duke u mbështetur në të njëjtat elemente (shkalla e dëmit), gjykatat më të larta më pas i konfirmuan gjetjet e gjykatës së shkallës së parë, por e reduktuan kompensimin në barasvlerën 310 Euro.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesja u ankua, sipas Nenit 8, që shuma e kompensimit të caktuar ishte e pamjaftueshme duke pasur parasysh masën në të cilën ishte rrezikuar shëndeti i saj.

Neni 8

Gjykata kujtoi faktin që u takon së pari autoriteteve nacionale të zgjidhin çdo shkelje të pretenduar të Konventës. Një vendim i autoriteteve vendase në favor të kërkueses nuk është në parim i mjaftueshëm për ta privuar atë nga

statusi i "viktimës" sipas Konventës, nëse autoritetet nuk e zgjidhin shkeljen dhe caktojnë kompensim të mjaftueshëm. Lidhur me këtë të fundit, aty ku autoritetet nacionale kanë gjetur shkelje dhe vendimi i tyre përbën zgjidhje të duhur dhe të mjaftueshme, pala e interesuar nuk mund të pretendojë më se është viktimë brenda kuptimit të Nenit 34.

Në lidhje me çështjen në fjalë, u shënuar që shkelja e të drejtave të kërkuases sipas Nenit 8 nga kompania shtetërore nuk ishte objekt diskutimi mes palëve, siç u konfirmua nga gjetjet e gjykatave vendase që konstatuan përgjegjësinë dhe caktuan kompensimin. Ajo që vihej në diskutim ishte shuma e kompensimit të caktuar.

Ndërkohë që gjykata e shkallës së parë i kishte caktuar kërkuases shumën e barasvlershme me 648 Euro, gjykata më e lartë se ajo e kishte përgjysmuar atë shumë dhe Gjykata Supreme e kishte mbështetur atë vendim. Për këtë reduktim të shumës nuk ishin dhënë arsye të veçanta. Në fakt, gjykatat më të larta kishin dalë me konkluzione të ndryshme lidhur me shumën e kompensimit që duhet të caktohej edhe pse ato ishin mbështetur në të njëjtin element, shkalla e dëmit.

Për më tepër, kërkuësja kishte pësuar një shkallë të caktuar vuajtjeje mendore dhe fizike sepse kishte qëndruar në spital për dy javë. Në fund, shuma e caktuar nga gjykatat vendase ishte shumë më e ulët sesa minimumi që caktohej nga Gjykata në raste të ngjashme. Prandaj, Gjykata deklaroi që kishte pasur shkelje të Nenit 8.

Neni 41

Gjykata vendosi që Republika e Moldavisë duhet t'i paguante kërkuases 4000 Euro për dëme jomateriale.

Vonesat e paarsyeshme në procedurat e kujdestarisë shkelën të drejtën e kërkuesses së parë për gjyq të drejtë sipas nenit 6 § 1 dhe këto vonesa nuk mund të justifikoheshin nga masat e lidhura me Covid-19, megjithatë nuk pati shkelje të nenit 8

VENDIMI NË ÇËSHTJEN Q DHE R k. SLOVENISË

(Kërkesa Nr. 19938/20)

8 shkurt 2022

1. Faktet kryesore

Kërkuessit Q dhe R ishin shtetas slovenë dhe gjyshërit e W dhe Z, të cilët ishin të lindur në vitin 2010 dhe 2012 respektivisht. Në dhjetor 2015, vajza e kërkuessve, nëna e W dhe Z, u vra dhe burri i saj, babai i W dhe Z, u arrestua për vrasjen.

W dhe Z fillimisht jetuan me kërkuessit. Kërkuessa e parë bëri një kërkesë pranë Qendrës së Punës Sociale S.G. ("Qendra S.G.") për kujdestarinë prindërore të nipave/mbesave të saj. Më 17 shkurt 2016, Qendra S.G. gjeti që kërkuessa nuk ishte kandidatja më e përshtatshme për kujdestarinë e W dhe Z. Si rezultat i kësaj, Qendra e Punës Sociale V. ("Qendra V.") ia mori fëmijët më 30 mars 2016 dhe i vendosi ato në kujdesin e një familjeje kujdestare në një rajon tjetër pa dijeninë e kërkuessve.

Kërkuessa e parë ndoqi procedurat vendore kundër heqjes së nipave/mbesave të saj, duke e kontestuar vendimin në Gjykatën Administrative më 22 prill 2016. Më 2 nëntor 2016, ajo kërkoi që fëmijët të merrnin pjesë në procedura. Fëmijët fillimisht u përfaqësuan nga A.G., e cila vepronte si kujdestare e përkohshme e tyre, por që u hoq nga kjo pozitë me kërkesë të vet dhe u zëvendësua nga Qendra V. Gjykata Administrative mbajti seancën e parë më 8 mars 2017. Një ekspert i caktuar nga gjykata paraqiti një raport në lidhje me faktin nëse do të ishte në interesin e fëmijëve që të qëndronin me kërkuessen më 3 tetor 2017 dhe 19 nëntor 2017, ku gjeti se kërkuessa nuk ishte e aftë të kujdesej për nipat/mbesat e saj në afat të gjatë sepse të dy fëmijët kërkonin kujdes të veçantë për shkak të problemeve të natyrës konjitive dhe të sjelljes. Megjithëse ai shkroi dy raporte eksperte, gjykata refuzoi të dëgjonte mendimin e tij në lidhje me procedurat e kontaktit për shkak të fushëveprimit të kufizuar të ekspertizës së tij.

Gjykata Administrative mbajti seancën e dytë më 10 janar 2018, ku i hodhi poshtë pretendimet e kërkuases. Kërkuësja bëri ankesë në Gjykatën Kushtetuese më 27 korrik 2018, e cila lëshoi një vendim më 12 shtator 2019 i cili prishi vendimin përfundimtar të Gjykatës Administrative dhe e ktheu çështjen në rigjykim. Gjykata Kushtetuese argumentoi që, për shkak se Qendra V. kishte ushtruar pushtet publik në heqjen e fëmijëve nga kujdesi i gjyshërve dhe më përpara kishte ofruar opinionin që kërkuësja nuk ishte kujdestare prindërore e përshtatshme, Gjykata Administrative duhet të caktonte një kujdestar të përkohshëm të pavarur dhe të paanshëm për fëmijët.

Gjykata Administrative emëroi një kujdestar të përkohshëm të veçantë të interesave të fëmijëve më 20 nëntor 2019 dhe një komision për të dhënë një opinion ekspert më 20 maj 2020. Për shkak të kompleksitetit të situatës së kërkuases dhe pandemisë Covid-19, ekspertët e paraqitën raportin e tyre më 2 shkurt 2021. Në raport u tha se kërkuësja nuk ishte në gjendje të paguante për rritjen afatgjatë të nipave/mbesave të saj. Më tej, ekspertët thanë se ishte në interes të fëmijëve, për sa u përkiste dëshirave dhe mirëqenies mendore të fëmijëve, që të jetonin me familjen e tyre kujdestare. Raporti rekomandoi që kërkuësja t'i lejohej kontakti me fëmijët për periudha gradualisht më të gjata kohore, dhe që ri-integrimi potencial i fëmijëve të shqyrtohej kur ato të rriteshin.

Në kohën që çështja e kërkuases iu kthye Gjykatës Administrative, ajo bëri shumë apele për mbikqyrje dhe zgjidhje të përshpejtuara, ku të gjitha u refuzuan. Kërkuësja bëri një ankesë të dytë kushtetuese mbi bazën se si ekspertëve ashtu edhe gjyqtarëve të Gjykatës Administrative u mungonte paanshmëria. Ankesa, e cila u depozitua pas 1 shtatorit 2021, ishte ende në pritje pranë Gjykatës Kushtetuese në kohën e vendimit të Gjykatës Evropiane. Përveç kësaj, procedurat para Gjykatës Administrative ishin ende në pritje në kohën e vendimit të Gjykatës për shkak të emërimit nga gjykata të një paneli të ri ekspertësh për çështjen.

Në Slloveni, ishin dy raste të ndara kur në vend u shpall pandemia. Gjatë pandemisë së parë, prej 16 marsit 2020 deri më 5 maj 2020, gjykatat procesuan vetëm çështjet urgjente. Gjatë pandemisë së dytë, prej 16 nëntorit 2020 deri më 31 janar 2021, gjykatat i procesuan të gjitha çështjet por nuk mbajtën seanca për çështjet jo-urgjente përveç atyre me videolidhje.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuësja e parë u ankua që procedurat e kujdestarisë shkelën të drejtat e saj sipas nenit 6 § 1 të Konventës meqenëse procedurat qenë pa arsye të gjata dhe

të padrejta. Kërkuesit gjithashtu u ankuan që refuzimi i gjykatave vendase për të ekzaminuar njërin prej ekspertëve dhe dështimi për të caktuar një kujdestar të përkohshëm për të përfaqësuar interesat e fëmijëve kishte shkelur të drejtat e kërkuesve sipas nenit 8.

Neni 6

Në lidhje me pranueshmërinë e pretendimit të kërkuesve sipas nenit 6, Gjykata deklaroi se një person nuk mund të ankohet për shkelje të të drejtave të tij/saj të Konventës në procedura ku ai/ajo nuk ka qenë palë. Kështu, vetëm kërkuesja e parë mund të pretendonte shkelje të nenit 6 § 1, meqenëse kërkuesi i dytë nuk ishte palë në procedurat e kujdestarisë prindërore, dhe ankesa e tij u shpall e papranueshme.

Deri në kohën e vendimit të Gjykatës, procedurat kishin zgjatur gjashtë vjet. Gjatë përcaktimit të arsyeshmërisë së kohëzgjatjes së procedurave, Gjykata mori në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen e kërkuesve dhe autoriteteve, dhe çka rrezikonin kërkuesit.

Në lidhje me kompleksitetin e çështjes, Gjykata vuri në dukje se thjesht fakti që gjykatat vendase kishin kërkuar opinione eksperte në vetvete nuk shpjegonte as nuk justifikonte gjatësinë ekstreme të procedurave. Në lidhje me sjelljen e kërkuesve, Gjykata vuri në dukje se, megjithëse ajo kishte bërë shumë kërkesa për heqjen e ekspertëve, Qeveria nuk tregoi se si ato kërkesa i kishin zgjatur procedurat, veçanërisht për shkak se kërkesat ishin bërë gjatë kohës që Gjykata Administrative kishte qenë në pritje të hartimit të raporteve eksperte. Kështu, Gjykata deklaroi se kërkuesja nuk i vonoi procedurat në masë domethënëse.

Në lidhje me sjelljen e autoriteteve, Gjykata vuri në dukje se tri arsyet kryesore të kohëzgjatjes së procedurave ishin përgatitja e raporteve eksperte, rikthimi i çështjes në gjyq, dhe vonesat e shkaktuara nga pandemia Covid-19. Si dështimi i panelit të ekspertëve për të hartuar raportin, ashtu edhe dështimi i Gjykatës Administrative për të emëruar një kujdestar të përkohshëm të veçantë në shkallën e parë hynin brenda detyrimit të Shteteve për të siguruar që gjykatat e tyre të mund t'i garantojnë çdokujt një vendim përfundimtar në lidhje me kontestet që kanë të bëjnë me të drejtat dhe detyrimet civile brenda një kornize kohore të arsyeshme.

Gjykata theksoi se kufizimet e nevojshme për shkak të krizës së Covid-19 kuptueshëm mund të kishin pasur efekt negativ në procesimin e çështjeve para

gjykatave vendase. Megjithatë, ajo nuk qe e bindur se në rastin konkret kjo do të mund t'i shfajësonte autoritetet nga përgjegjësia e tyre për kohëzgjatjen e procedurave. Në mënyrë të veçantë, dukej se çështja do të kishte mundur të trajtohej gjatë periudhave të kufizimeve të Covid-19 sikur të ishte klasifikuar si urgjente. Qeveria kishte argumentuar se ajo nuk e kishte konsideruar çështjen urgjente sepse kjo nuk kishte pasur të bënte me vendosjen e fëmijëve në kujdestari prindërore apo heqjen e tyre prej një kujdesi të tillë. Gjykata mund të pranonte argumentin se çështja nuk kishte të njëjtën urgjencë siç mund të kishte një çështje lidhur me vendosjen e fëmijëve në kujdestari, meqenëse mes kërkueses së parë dhe nipave/mbesave të saj u mbajtën kontakte të rregullta. Pavarësisht nga kjo, u konsiderua që, duke pasur parasysh natyrën e kufizuar të atyre kontakteve, rëndësia e asaj çka rrezikonte kërkuesja e parë, pra dëshira e saj për t'u kujdesur për nipat/mbesat e saj pas vdekjes së vajzës së saj, kërkonte zell të veçantë nga autoritetet, sidomos duke pasur parasysh argumentin e kërkueses së parë në lidhje me efektin e kalimit të kohës mbi marrëdhënien e saj me W dhe Z.

Rrjedhimisht, Gjykata gjeti se procedurat e kujdestarisë prindërore nuk ishin dëgjuar brenda një kohe të arsyeshme dhe kishin shkelur të drejtën e kërkueses së parë për gjyq të drejtë sipas nenit 6 § 1 të Konventës.

Neni 8

Gjykata përmendi se koncepti i "jetës familjare" sipas nenit 8 përfshin të paktën lidhjet mes familjarëve të afërt, siç janë gjyshërit/gjyshet dhe nipat/mbesat e tyre, dhe "respekti" nënkupton që Shteti duhet të veprojë në mënyrë të atillë që lejon që lidhje të tilla të zhvillohen normalisht. Më tej, gjatë përcaktimit nëse kufizimet e kontaktit me një fëmijë mund të jenë "të nevojshme në një shoqëri demokratike", interesi i fëmijës duhet të vihet para çdo konsiderate tjetër. Duhet mbajtur parasysh si duhet edhe kontakti që kanë autoritetet kombëtare me fëmijën, dhe nuk është detyrë e Gjykatës që të zëvendësojë autoritetet vendase, por të shqyrtojë vendimet e tyre dhe pajtueshmërinë me Konventën.

Gjykata deklaroi se marrëdhënia mes kërkuesve dhe nipave/mbesave të tyre, ku fëmijët kishin mbetur pa kujdes prindëror pas vdekjes së nënës së tyre dhe burgosjes së babait të tyre, qartazi hynte brenda fushëveprimit të nenit 8 të Konventës.

Kërkuesit u ankuan që gjykatat kishin dështuar të dëgjonin pikëpamjet e W dhe Z. Megjithatë, Gjykata theksoi se deklaratat e drejtpërdrejta nga fëmijët nuk ishin

dëgjuar nga gjykata vendase sepse një psikiatër i fëmijëve i emëruar nga gjykata konsideroi se ato nuk ishin në gjendje të formonin opinion në lidhje me çështjen, dhe se në vend të këtyre opinioneve gjykata vendase kishte marrë në konsideratë një raport ekspert të hartuar nga ai psikiatër, i cili i kishte ekzaminuar fëmijët drejtpërdrejt. Më tej, kërkuesit nuk paraqitën argumente se përfaqësimi i fëmijëve nga Qendra V. në procedurat fillestare kishte ndikuar në rezultatin e procedurave. Prandaj Gjykata nuk gjeti arsye të vinte në pyetje vendimin e gjykatës vendase për të mos i dëgjuar fëmijët drejtpërdrejt.

Kërkuesit gjithashtu u ankuan në lidhje me refuzimin e gjykatës vendase për të ekzaminuar ekspertin. Në këtë aspekt, Gjykata deklaroi se, megjithëse eksperti nuk ishte ekzaminuar në seancën kontaktuese, gjykata e shkallës së parë e lexoi opinionin e tij ekspert dhe pati arsye valide për të mos e ekzaminuar atë. Kërkuesit po ashtu patën mundësinë për t'iu përgjigjur me shkrim dhe me gojë raportit të ekspertit të emëruar nga gjykata e shkallës së parë në vend të ekspertit origjinal. Gjykata deklaroi se kjo nuk ishte e paarsyeshme dhe se Shteti kishte vepruar në pajtueshmëri me kriteret procedurale të nenit 8.

Rrjedhimisht, Gjykata gjeti se nuk kishte pasur shkelje të të drejtave të kërkuesve sipas nenit 8 të Konventës.

Neni 41

Gjykata i caktoi kërkueses së parë €3,000 në lidhje me dëmë jomateriale dhe €3,500 për kosto dhe shpenzime.

Asistenca ligjore joefektive përmes videolidhjes gjatë procedurave penale të apelit shkeli nenin 8

VENDIMI I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN SAKHNOVSKIY K. RUSISË

(Kërkesa Nr. 21272/03)

2 nëntor 2010

1. Faktet kryesore

Kërkuesi, Sergey Sakhnovskiy, ishte i lindur në vitin 1979 dhe në kohën e vendimit të Gjykatës Evropiane ishte duke vuajtur dënimin me burgim për vrasje në rajonin e Novosibirsk në Rusi.

Kërkuesi u arrestua më 30 prill 2001 mbi bazën e dyshimeve se kishte vrarë babain dhe xhaxhain e tij. Tre ditë më pas, atij iu caktua që ta përfaqësonte një avokat i ndihmës ligjore. Në dhjetor 2001, gjykata kompetente rajonale e gjeti atë fajtor për vrasje dhe e dënoi me 18 vjet burg. Ai apeloj pa sukses në tetor 2002. Në seancën e apelit para Gjykatës Supreme nuk pati avokat mbrojtës, dhe kërkuesi mori pjesë në seancë përmes videolidhjes.

Kërkuesi bëri shumë kërkesa për shqyrtim mbikqyrës, ku të gjitha u refuzuan pa u ekzaminuar themelet e çështjes.

Në mars 2007, Gjykata ia komunikoi kërkesën Qeverisë ruse. Në korrik të të njëjtit vit, Presidiumi i Gjykatës Supreme të Rusisë u pajtua që ta shqyrtonte çështjen sipas procedurës së shqyrtimit mbikqyrës me kërkesë të Zv/Prokurorit të Përgjithshëm të Rusisë. Presidiumi gjeti se e drejta e kërkuesit për ndihmë ligjore ishte shkelur, dhe e dërgoi çështjen e tij për rishqyrtim në shkallën e apelit.

Në nëntor 2009, Gjykata Supreme, me trupin gjykues në Moskë, e mori në shqyrtim çështjen si shkallë apeli. Kërkuesi kërkoi të ishte personalisht i pranishëm në këtë seancë, por Gjykata Supreme gjeti që prania e tij nuk ishte e domosdoshme, dhe që videolidhja ishte e mjaftueshme për të siguruar pjesëmarrjen efektive të kërkuesit në procedurë. Si rezultat, kërkuesi mbeti në Novosibirsk, rreth 3000 km larg Moskës.

Në fillim të seancës dëgjimore, Gjykata Supreme e prezantoi kërkuesin me avokaten e tij të sapoemëruar të ndihmës ligjore, e cila ishte e pranishme në

sallën e seancës së Gjykatës Supreme, dhe u lejoi atyre një bisedë konfidenciale 15-minutëshe përmes videolidhjes para se të fillonte me shqyrtimin e apelit. Pasi foli me avokaten e ndihmës ligjore, kërkuesi refuzoi të ndihmohej prej saj, duke thënë se ai kishte nevojë të takohej me avokaten personalisht. Megjithatë, Gjykata Supreme nuk e lejoi atë kërkesë dhe vendosi të procedonte me çështjen menjëherë.

Pas seancës, Gjykata Supreme i mbështeti gjetjet substanciale dhe dënimin e kërkuesit që ishte vendosur në vendimin përfundimtar të dhjetorit 2001.

2. Vendimi i Gjykatës

Duke u mbështetur tek neni 6 §§ 1 dhe 3, e drejta për gjyq të drejtë, kërkuesi u ankua se procedurat penale kundër tij kishin qenë të padrejta. Kërkuesi e bazoi argumentin e tij mbi faktin se ai nuk kishte marrë ndihmë ligjore falas dhe, për shkak se ai kishte marrë pjesë në procedurat e apelit të gjykatës përmes videolidhjes, ai nuk kishte pasur mundësi ta mbronte veten në mënyrë efektive.

Më 15 janar 2009, në vendimin e Dhomës për çështjen, Gjykata gjeti një shkelje të nenit 6, meqenëse kërkuesi nuk kishte marrë ndihmë ligjore efektive gjatë procedurave të apelit. Çështja iu referua Dhomës së Madhe sipas nenit 43 me kërkesë të Qeverisë Ruse.

Neni 6 § 1

Gjykata së pari shqyrtoi nëse kërkuesi e kishte humbur statusin e viktimës pas rihapjes së procedurave penale kundër tij në shkallën e apelit. Gjykata kujtoi parimin e përgjithshëm që kërkuesi mund ta humbiste statusin e viktimës sikur autoritetet të kishin njohur një shkelje të Konventës dhe sikur ato t'i kishin eliminuar pasojat e saj negative për kërkuesin. Shteteve duhet t'u jepet mundësia për të ndrequr shkeljet e Konventës, megjithatë ato nuk mund të lejohen ta përdorin atë të drejtë për t'i ikur juridiksionit të Gjykatës. Në rastin e kërkuesit, procedurat ishin rihapur si pjesë e procedurës së shqyrtimit mbikqyrës, e cila nuk kishte rezultuar me rihapje deri sa Gjykata e kishte lajmëruar Qeverinë ruse në lidhje me kërkesën e kërkuesit drejtuar asaj. Kjo situatë kishte ndodhur në shumë raste të tjera në lidhje me Rusinë, për çka Gjykata kishte vendosur më përpara. Sipas procedurës së shqyrtimit mbikqyrës nuk kishte kufi për numrin e herëve që procedurat mund të rihapeshin, dhe varej nga diskrecioni i një prokurori ose një gjyqtari. Në ato kushte, Gjykata arriti në përfundimin që Qeveria ruse mund t'i

kishte përdorur rihapjet për shqyrtim mbikqyrës për t'i shmangur shqyrtimit të çështjes nga Gjykata, dhe që rihapja e procedurave ligjore nuk mund të shihej automatikisht si zgjidhje e mjaftueshme për ta privuar kërkuesin nga statusi i tij i viktimës.

Sipas nenit 6 § 3 (c), çdo person i akuzuar për vepër ligjore ka të drejtën për të "mbrojtur veten personalisht ose përmes ndihmës ligjore". Megjithatë, neni 6 § 3 nuk specifikon saktësisht se si duhet të ushtrohet ajo e drejtë. Gjykata kujtoi që, si parim i përgjithshëm nën nocionin e gjyqit të drejtë, personat e akuzuar për vepër penale kishin të drejtë të ishin fizikisht të pranishëm në seancën e tyre të parë dëgjimore në shkallën e parë. Megjithatë, kjo nuk ishte detyrimisht kështu në fazën e apelit meqenëse prania e të pandehurit personalisht nuk kishte domosdoshmërisht të njëjtën domethënie për seancën e apelit. Gjatë përcaktimit nëse një individ ka të drejtë të jetë fizikisht i pranishëm, Gjykata theksoi se duhet të merret në konsideratë natyra e procedurave, shkalla deri ku janë përfaqësuar dhe mbrojtur interesat e të pandehurit, dhe domethënia e çështjes që duhet të vendoset për apeluesin.

Për sa i përket videolidhjes, ndonëse si e tillë nuk ishte në kundërshtim me të drejtën për gjyq të drejtë, ishin marra masa që kërkuesi t'i ndiqte procedurat, që ai të dëgjohej pa pengesa teknike, dhe që ai të komunikonte me avokaten e tij në mënyrë efektive dhe konfidenciale.

Duke pasur parasysh kompleksitetin e pikave të ngritura para Gjykatës Supreme në fazën e apelit në çështjen e kërkuesit, Gjykata gjeti se asistenca e një avokati profesionist ishte thelbësore për kërkuesin. Megjithatë, ajo asistencë duhet të kishte qenë efektive e jo vetëm formale. Duke qenë se kontakti i vetëm mes kërkuesit dhe avokates së tij kishte qenë 15 minuta para fillimit të seancës, kjo nuk kishte qenë e mjaftueshme. Përveç kësaj, kërkuesi nuk ishte ndier rehat me diskutimin e çështjes së tij me anë të videolidhjes e cila ishte instaluar dhe operuar nga Shteti. Ishte në pikëpyetje nëse komunikimi me videolidhje ofronte privatësi të mjaftueshme.

Ndërkohë që Gjykata pranoi se transportimi i kërkuesit 3,000 km larg për në seancën në Moskë do të kishte qenë një operacion i gjatë dhe i kushtueshëm; mes tij dhe avokates duhet të ishte organizuar një thirrje telefonike shumë kohë para seancës, ose kërkuesit duhet t'i ishte caktuar një avokat vendas i cili do të kishte mundur ta vizitonte personalisht në burg para seancës. Gjykata doli me përfundimin se kërkuesit nuk i ishte ofruar ndihmë ligjore efektive gjatë pjesës së

dytë të procedurave të apelit në nëntor 2007.

Duke pasur parasysh sa u tha më lart, Gjykata vendosi që kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1 i marrë në lidhje me nenin 6 § 3 (c) gjatë procedurave në tërësi të cilat kishin përfunduar në nëntor 2007.

Neni 41

Gjykata vendosi që Rusia duhet t'i paguante kërkuarit 2,000 Euro në lidhje me dëme jomateriale, dhe 174 Euro për kosto dhe shpenzime.

VI. Jeta private/shqyrtimi mjekësor, trajtimi & hulumtimet

Mbyllja e pavullnetshme e kërkuesit në një spital psikiatrik ka shkelur Nenin 5, dhe vënia e tij nën trajtim për kërkime shkencore dhe lëndimet gjatë kohës aty kanë shkelur aspektin substancial të Nenit 3

VENDIMI NË ÇËSHTJEN BATALINY K. RUSISË

(Kërkesa Nr. 10060/07)

23 korrik 2015

1. Faktet kryesore

Kërkuesi i parë ishte i lindur në vitin 1977. Kërkuesit e dytë dhe të tretë ishin prindërit e tij të lindur në vitet 1937 dhe 1938, respektivisht, dhe të gjithë jetonin në Moskë. Kërkuesi i parë u diagnostikua me dystoni në vitin 2004 për çka mori trajtime të ndryshme pa sukses. Pasi kishte muaj që vuante, ai preu me dashje venat e parakrahut të tij dhe u shtrua në spital psikiatrik më 25 maj 2005, ku u diagnostikua me çrregullimin e dhimbjeve kronike dhe çrregullim personaliteti. Të nesërmen ai thirri prindërit e tij për ta marrë në shtëpi por kur ata arritën në spital iu tha nga stafi i spitalit që nuk lejohej ta merrnin atë në shtëpi dhe iu kërkua që të largoheshin.

Kërkuesi i parë pretendoi që natën e 26 majit 2005, tre infermierë e lidhën ndërkohë që dy pacientë e godisnin në fytyrë dhe në trup. Më tej ai pretendoi që ai kishte humbur ndjenjat kur ai u hodh në krevatin e tij nga njëri prej infermierëve me kaq forcë sa që goditi kokën tek komodina afër krevatit. Në fund, ai pretendoi që pasi iu kthye vetëdija pa që po i rridhte gjak dhe ishte i lidhur në krevat me gojën e lidhur. Sipas kërkuesit të parë, gjatë qëndrimit në spitalin psikiatrik ai ishte trajtuar me një ilaç antipsikotik dhe i ishin ndaluar të gjitha kontaktet me botën e jashtme për qëllime të kërkimeve shkencore. Ai qëndroi në spital deri më 9 qershor 2005.

Pas daljes nga spitali, një mjek ambulance vuri re një hematomë nën syrin e tij, si dhe mavijosje dhe shembje rreth gjoksit dhe belit të tij. Ai u dërgua menjëherë në një spitali të qytetit ku u diagnostikua me ankth depresiv krahas dëmit traumatik në tru. Ai qëndroi aty deri më 5 gusht 2005.

Në tetor 2005, kërkuesit u ankuan pranë Ombudspersonit të Federatës Ruse që kërkuesi i parë ishte mbyllur në mënyrë të paligjshme në spitalin psikiatrik, ku

gjithashtu ishte rrahur nga infermierët dhe pacientët e spitalit. Pas dy refuzimeve për ta bërë një gjë të tillë, përfundimisht nisi procedura penale në nëntor 2006. Procedura në lidhje me rrahjet e pretenduara u pezullua dhe u rihap disa herë dhe ishte në pritje në kohën e VENDIMIT nga Gjykata Evropiane. Ankesa në lidhje me mbylljen e tij në spital u bë objekt i procedurës së ndarë e cila përfundimisht u ndërpre në nëntor 2010.

Kujdesi mjekësor psikiatrik në Rusi qeverisej nga Akti i Trajtimit Psikiatrik i vitit 1992 ("Akti"). Seksionet 33-35 të Aktit lejonin që shqyrtimi gjyqësor i ligjshmërisë së mbylljes psikiatrike të një individi të paraqitej me kërkesë të spitalit.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesit u ankuan që trajtimi psikiatrik i detyruar i kërkuesit të parë në mungesë të nevojshmërisë së konstatuar mjekësore dhe për përdorim të kërkimeve shkencore, si dhe rrahjet gjatë mbylljes së tij dhe mungesa e hetimeve efektive për këto rrahje kishin shkelur Nenin 3. Më tej ata pretenduan që mbyllja e tij në spital kishte shkelur të drejtën e tij për liri dhe siguri sipas Nenit 5, për çka ai nuk kishte zgjidhje për të kontestuar ligjshmërinë e kësaj. Në fund, kërkuesit pretenduan që trajtimi psikiatrik i kërkuesit të parë kishte shkelur Nenin 2 dhe që ata nuk kishin qasje në zgjidhje efektive në kundërshtim me Nenet 13 dhe 17.

Neni 5

Qeveria njohu që mbyllja e kërkuesit të parë në spital psikiatrik mes 25 majit dhe 9 qershorit 2005 ishte e paligjshme. Gjykata nuk gjeti arsye për të vendosur ndryshe. Prandaj, ajo vendosi që kishte pasur shkelje të Nenit 5 § 1 (e).

Më tej, duke marrë në konsideratë Nenin 5 § 4, Gjykata deklaroi që kjo dispozitë ka të bëjë vetëm me disponibilitetin e zgjidhjeve që i lejonin një individi të kërkonte lirin nga paraburgimi dhe jo disponibilitetin e zgjidhjeve për të shqyrtuar ligjshmërinë e një paraburgimi që tashmë ka përfunduar. E drejta e një pacienti të mbajtur për trajtim psikiatrik për të kërkuar shqyrtim gjyqësor të mbajtjes së tij me mocion të vetë atij është garanci kyçe sipas Nenit 5 § 4. Gjykata e kishte shqyrtuar mundësinë e kërkimit të shqyrtimit gjyqësor sipas Aktit në praktikën e mëparshme gjyqësore kundër Ruisë dhe kishte dalë në përfundimin që, megjithëse Akti ofronte mbrojtje të rëndësishme kundër paraburgimit arbitrar, ai nuk i mundësonte të paraburgosurit që të kërkonte shqyrtimin gjyqësor me mocion të atij vetë. Nevojshmëria që një i paraburgosur të kishte qasje të

drejtpërdrejtë në shqyrtim gjyqësor u theksua në çështjen konkrete nga dështimi i autoriteteve të spitalit për ta kërkuar një gjë të tillë, si pasojë e së cilës kërkuesi i parë mbeti në spital për dy javë.

Qeveria argumentoi që kërkuesi i parë kishte të drejtë të ankohej për paligjshmërinë e mbylljes së tij sipas Nenit 254 të Kodit të Procedurës Penale. Megjithatë, ajo nuk kishte paraqitur shembuj ku kjo zgjidhje përdorej në kontekst të mbylljes psikiatrike para gjykatave vendase ose Gjykatës dhe prandaj kishte dështuar të vërtetonte efektivitetin e saj praktik. Rrjedhimisht, kundërshtimi i Qeverisë që kishte pasur mos-shterim të zgjidhjeve në vend u hodh poshtë. Në përfundim, Gjykata vendosi që kërkuesi i parë nuk kishte pasur të drejtë, sipas ligjeve vendase, që të kontestonte mbajtjen e tij. Prandaj, kishte pasur shkelje të Nenit 5 § 4.

Neni 3

Nënshtimi i një personi të mbajtur ndaj ndërhyrjes mjekësore kundër vullnetit të tij nuk mund, në parim, të shihet si çnjerëzor ose degradues kur gjykohet të jetë nevojshme terapeutike nga praktika e konstatuar mjekësore. Gjykata shënoi që, sipas raportit të vitit 2008 mbi ekzaminimin mjeko-ligjor psikiatrik të kërkuesit të parë, mes 27 majit dhe 9 qershorit 2005 ai nuk kishte pasur çrregullime mendore "të rënda" dhe prandaj nuk kishte nevojë për trajtim psikiatrik. Qeveria nuk paraqiti prova për të kundërtën. Prandaj, nuk ishte vërtetuar që kishte ekzistuar nevojshmëria mjekësore për ta nënshtuar atë ndaj trajtimit psikiatrik të pavullnetshëm gjatë kësaj periudhe.

Gjykata po ashtu shënoi që atij i ishte dhënë një ilaç antipsikotik për kërkime shkencore dhe atij i ishin ndaluar kontaktet me botën e jashtme. Këto rrethana ishin të tilla që shkaktonin tek ai ndjenjat e frikës, ankthit dhe inferioritetit të cilat kishin kapacitetin për ta poshtëruar dhe degraduar atë. Ishte e papranueshme të eksperimentohej me një ilaç të ri për kërkime shkencore pa pëlqimin e subjektit tek i cili bëhej kjo. Prandaj, kërkuesi i parë i ishte nënshtuar trajtimit çnjerëzor dhe poshtërues. Rrjedhimisht, Gjykata vendosi që kishte pasur shkelje të Nenit 3 për shkak të trajtimit të pavullnetshëm psikiatrik të tij.

Më tej, Gjykata shqyrtoi nëse ai ishte rrahur gjatë mbylljes së tij dhe mungesën e hetimeve efektive për këtë. Kur një person lëndohet gjatë mbajtjes nën kontrollin e autoriteteve, ka prezumime të forta që ai i është nënshtuar keqtrajtimit. Pas mbajtjes së tij natën e 26 majit 2005, kërkuesi i parë pati një hematomë nën

syryn e djathtë, si dhe mavijosje dhe shembje në gjoks dhe bel. Qeveria nuk qe në gjendje të jepte shpjegime bindëse për këto lëndime. Si rezultat, Gjykata vendosi që ai i ishte nënshtruar trajtimit çnjerëzor dhe poshtëruës dhe që kishte pasur shkelje të aspektit substancial të Nenit 3.

Provat mjekësore në mbështetje të pretendimeve të kërkuesve për rrahjen e kërkuesit të parë gjatë mbylljes së tij i jepte shkas detyrimit të autoriteteve për të zhvilluar hetime efektive mbi rrethanat e lëndimeve të tij. Megjithatë, autoritetet nuk hapën hetime penale për këtë çështje për më se një vit pasi ishin vënë në dijeni. Një vonesë e tillë duhet të ketë pasur impakt negativ në hetime dhe duhet të ketë dëmtuar aftësinë e autoriteteve për të siguruar provat e duhura.

Më tej, procedurat penale u pezulluan katër herë për shkak se nuk qe e mundur të identifikoheshin kryesit. Hetimet u rihapën pas apelit të kërkuesit në janar të vitit 2013 dhe ishin në pritje në kohën që u shpall ky gjykim. Duke pasur parasysh vonesën domethënëse në hapjen e hetimeve penale mbi bazën e pohimeve të besueshme të kërkuesve dhe faktit që procedurat ishin ende në pritje rreth 10 vjet pas ngjarjeve, autoritetet kishin dështuar në zhvillimin e hetimeve efektive për lëndimet e tij. rrjedhimisht, Gjykata vendosi që kishte pasur shkelje të aspektit procedural të Nenit 3.

Nenet 2, 13 dhe 17

Kërkuesit e dytë dhe të tretë nuk ishin viktime të shkeljeve të pretenduara dhe prandaj ankesa e tyre u refuzua si e papajtueshme me rationae personae. Më tej, nuk kishte paraqitje të shkeljes së këtyre të drejtave dhe lirive në lidhje me kërkuesin e parë. Prandaj, Gjykata vendosi që kjo pjesë e kërkesës të refuzohej si dukshëm e pabazuar.

Neni 41

Gjykata i caktoi kërkuesit të parë 26,000 Euro në lidhje me dëme jomateriale dhe 2,000 Euro për kosto dhe shpenzime.

*Vendimi për të imponuar trajtim mjekësor pa pëlqim ose pa
iu drejtuar gjykatës ka përbërë shkellje të Nenit 8*

VENDIMI NË ÇËSHTJEN GLASS k. MBRETËRISË SË BASHKUAR

(Kërkesa Nr. 61827/00)

9 mars 2004

1. Faktet kryesore

Kërkuesi i parë, David Glass, ishte lindur në vitin 1986 dhe ishte në gjendje të rëndë paaftësie mendore dhe fizike që kërkonte vëmendje 24 orë në ditë. Kërkuesja e dytë, Carol Glass, ishte nëna e Davidit dhe e autorizuar ligjore e tij.

Në korrik 1998, Davidi u shtrua në Spitalin St. Mary, një prej dy spitaleve që janë pjesë e Trustit të Shërbimit Shëndetësor Kombëtar të Spitaleve në Portsmouth ("trusti"). Pas një operacioni për çlirim të një pengese në traktin e epërm të frymëmarrjes, Davidi pati komplikacione, u sëmur në gjendje kritike, dhe u desh të vendosej në ventilator. Gjatë trajtimit të tij, Znj. Glass u informua nga stafi i spitalit që Davidi ishte duke vdekur dhe që kujdesi intensiv i mëtejshëm do të ishte pa vend. Megjithatë, gjendja e Davidit u përmirësua dhe ai që në gjendje të kthehej në shtëpi më 2 shtator 1998.

Më 8 shtator 1998, kur Davidi u shtrua sërish në spital për një infeksion të traktit të epërm të frymëmarrjes, mjekët diskutuan me Znj. Glass rreth përdorimit të mundshëm të morfinës për lehtësimin e gjendjes. Znj. Glass shprehu kundërshtimin e saj, duke iu thënë mjekëve që, po qe se zemra e Davidit ndalonte së rrahuri, ajo priste që ata të bënin ringjalljen (resuscitation) e tij duke përfshirë edhe intubimin. Dr. E. konsideroi që kjo nuk do të ishte gjëja më e mirë për Davidin, dhe deklaroi në shënimet e tij që nevojitej një "mendim i dytë", po të ishte nevoja nga gjykata. Dr. H. gjithashtu shënoi që "në rast mospajtimi të plotë do të detyrohemi të shkojmë në gjykatë".

Gjendja e Davidit u përkeqësua. Më 20 tetor 1998 mjekët që po trajtonin Davidin konsideruan që ai po vdiste dhe rekomanduan që atij t'i jepej diamorfinë për t'ia lehtësuar gjendjen. Znj. Glass nuk qe dakord që djali i saj po vdiste dhe ishte shumë e shqetësuar që administrimi i diamorfinës (më përpara ishte përmendur morfina) do të komprometonte shanset e tij për shërim. Znj. Glass i shprehu shqetësimet e saj me zë gjatë një takimi me mjekët, ku i pranishëm qe gjithashtu edhe një zyrtar policor.

Më pas ajo kërkoi ta merrte Davidin në shtëpi nëse ai ishte duke vdekur, por një zyrtar policor e këshilloi që, po të tentonte ta lëvizte djalin, ajo do të arrestohej. Davidit iu dha infuzion me diamorfinë në ora 7 pasdite më 20 tetor 1998.

Në spital shpërtheu një grindje mes familjarëve të tjerë dhe mjekëve. Familjarët besonin që Davidi po eutanizohet në mënyrë të fshehtë dhe po përpiqeshin t'i ndalonin mjekët për të hyrë në dhomën e tij. Autoritetet e spitalit thirrën stafin e sigurimit dhe kërcënuan se do t'i nxirrnin familjarët nga spitali me forcë.

Në dosjen mjekësore të kërkuesit të parë u fut një urdhër “Të Mos Ringjallet” (ang. “Do Not Resuscitate”, DNR) pa u konsultuar me Znj. Glass.

Ditën e nesërme Znj. Glass mori vesh që gjendja e djalit të saj ishte përkeqësuar në shkallë alarmante dhe u merakos se kjo ishte për shkak të efektit të diamorfinës. Familja kërkoi që të ndalej diamorfina. Dr. Ē. tha se kjo ishte e mundur vetëm nëse ata binin dakord që të mos ringjallet Davidi. Megjithatë, familja u përpoq ta ringjallte Davidin, dhe aty nisi zënka mes anëtarëve të familjes dhe mjekëve. Gjatë kohës që vazhdonte zënka, Znj. Glass arriti ta ringjallte Davidin.

Në spital u thirr policia. Dr. Ē. dhe Dr. A. dhe disa zyrtarë policorë u lënduan dhe të gjithë fëmijët e repartit, përveç njërit, u desh të evakuoheshin.

Gjendja e Davidit u përmirësua dhe ai shkoi në shtëpi më 21 tetor 1998. Një spital tjetër, rreth njëzet e pesë milje larg shtëpisë së familjes, pranoi që Davidi të shtrohej dhe të trajtohej aty po qe se do të pësonte sulm tjetër në zemër. Znj. Glass aplikoi pa sukses për shqyrtim gjyqësor dhe leje për të apeluar në Gjykatën e Apelit në lidhje me vendimet e marra nga autoriteti spitalor.

Këshilli i Përgjithshëm Mjekësor gjeti që mjekët e përfshirë nuk kishin qenë fajtorë për sjellje të pahijshme profesionale apo performancë seriozisht të metë, dhe që trajtimi për të cili bëhej ankesa kishte qenë i justifikuar. Shërbimi Prokurorial i Kurorës nuk ngriti akuza ndaj mjekëve të përfshirë për mungesë provash.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesit argumentuan që ligjet dhe praktika e Mbretërisë së Bashkuar kishin dështuar të garantonin respektin për integritetin fizik dhe moral të Davidit siç kërkohet nga Neni 8 i Konventës. Në mënyrë të veçantë, vendimet për të administruar diamorfinë tek Davidi kundër dëshirës së nënës së tij dhe për të

përfshirë notën DNR në dosjen e tij pa dijeninë e saj ndërhynte me të drejtat e atyre të dyve sipas Neni 8.

Gjithashtu, ata u shprehën se lënia e vendimit për përfshirjen e gjykatave në diskrecionin e mjekëve ishte bazë krejtësisht e papërshtatshme për të siguruar respekt efektiv për të drejtat e pacientëve të dobët.

Neni 8

Gjykata konsideroi që vendimi për të imponuar trajtimin tek Davidi duke shpërfillur kundërshtimet e nënës së tij i jepte shkas ndërhyrjes tek e drejta e tij për respekt ndaj jetës private, dhe në mënyrë të veçantë tek e drejta e tij për integritet fizik. Ajo konsideroi që asaj nuk kërkohet i të shqyrtonte nëse trajtimi në fjalë shkaktonte ndërhyrje tek e drejta e Znj. Glass për respekt ndaj jetës së saj familjare.

Ndërhyrja ishte në përputhje me ligjin. Korniza rregullatore në Mbretërinë e Bashkuar bazohej me vendosmëri mbi detyrën për të ruajtur jetën e pacientit/es, përveç rrethanave të jashtëzakonshme. E njëjta kornizë i jepte përparësi kërkimit të pëlqimit prindëror dhe, përveç situatave emergjente, kërkonte që mjekët të kërkonin ndërhyrjen e gjykatave në rast kundërshtimi nga prindërit.

Veprimet e ndërmarra nga stafi i spitalit synonin një qëllim legjitim. Qëllimi ishte, nga pikëpamja e VENDIMIT klinik, që t'i shërbehej interesave të Davidit. Gjykata refuzoi çdo sugjerim që qëllimi i njëanshëm i mjekut ishte shpejtimi i vdekjes së Davidit qoftë përmes administrimit të diamorfinës apo përmes futjes së notës DNR në dosjen e tij.

Për të vendosur nëse ndërhyrja ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike, Gjykata mori në konsideratë faktin se situata që ishte krijuar në Spitalin St. Mary mes 19 dhe 21 tetorit 1998 nuk mund të shkëputej nga diskutimet e mëhershme mes anëtarëve të stafit spitalor dhe Znj. Glass lidhur me gjendjen e Davidit. Mjekët në spital natyrisht që ishin të shqetësuar për refuzimin e Znj. Glass për të ndjekur këshillat e tyre, në mënyrë të veçantë mendimin e tyre që mund të duhej që djalit të saj t'i jepej morfinë. Si Dr. E. ashtu edhe Dr. H. kishin gjetur që mund të ishte e nevojshme që t'i drejtoheshin gjykatës.

Gjykatës nuk i ishte shpjeguar në mënyrë bindëse përse trusti nuk kishte kërkuar, në atë pikë, ndërhyrjen e Gjykatës së Lartë. Të gjithë mjekët bashkë në

atë kohë kishin një prognozë të zyrtë për kapacitetin e Davidit për t'i rezistuar krizave të mëtejshme, dhe nuk asnjë kishin dyshim që nëna e tij nuk do të ishte dakord me trajtimin e propozuar prej tyre. Në fakt, Znj. Glass mund ta kishte ngritur çështjen para Gjykatës së Lartë. Megjithatë, Gjykata konsideroi që ishte trusti ai të cilit i binte barra e marrjes së iniciativës dhe qartësisht të situatës në pritje të një emergjence të ardhshme. Gjykata pranoi që mjekët nuk mund të kishin parashikuar shkallën e konfrontimit dhe ashpërsisë që u shfaq më 18 tetor 1998. Sidoqoftë, qëndronte fakti se dështimi i trustit për të dërguar kërkesë pranë Gjykatës së Lartë në një fazë të mëhershme kishte kontribuar në këtë situatë.

Kështu, Gjykata nuk qe e bindur që trusti nuk kishte mundur të drejtonte një kërkesë emergjente në Gjykatën e Lartë kur ishte bërë e qartë se Znj. Glass ishte e vendosur në kundërshtimin e saj ndaj administrimit të diamorfinës tek Davidi. Trusti arriti të siguronte praninë e një zyrtari policor për të mbikqyrur negociatat me Znj. Glass por, çuditërisht, nuk mori në konsideratë bërjen e kërkesës në Gjykatën e Lartë edhe pse një gjë e tillë do të kishte qenë e mundur në momentin e fundit.

Gjykata konsideroi që vendimi i autoriteteve për të mos pranuar kundërshtimin e Znj. Glass ndaj trajtimit të propozuar në mungesë të autorizimit nga gjykata kishte rezultuar me shkelje të Nenit 8.

Duke marrë parasysh këtë përfundim, Gjykata nuk e konsideroi të nevojshme të shqyrtonte ndaras ankesën e kërkuësve në lidhje me përfshirjen e notës DNR në dosjen e Davidit pa pëlqimin dhe dijeninë e saj. Megjithatë, ajo theksoi se nota në fjalë ishte vetëm kundër aplikimit të masazhit të vullshëm kardiak dhe mbështetjes respiratore intensive, dhe nuk përjashtonte përdorimin e teknikave të tjera, si furnizimi me oksigjen, për të mbajtur gjallë Davidin.

Neni 41

Gjykata u caktoi kërkuësve 10,000 Euro për dëme jomateriale dhe 15,000 Euro për kosto dhe shpenzime.

Refuzimi i autoriteteve për të lejuar pacientët me kancer që të përdornin një ilaç eksperimental të paautorizuar nuk ka shkelur Konventën

VENDIMI NË ÇËSHTJEN HRISTOZOV DHE TË TJERË k. BULLGARISË

(Kërkesat Nr. 47039/11 dhe Nr. 358/12)
13 nëntor 2012

1. Faktet kryesore

Kërkuesit ishin 10 pacientë që vuanin nga kanceri të cilët u ankuan se u ishte mohuar qasja në një ilaç eksperimental të paautorizuar. Ata kishin provuar disa lloje trajtimesh konvencionale ose kishin marrë një opinion mjekësor që forma të tilla të trajtimit nuk do të funksiononin në rastet e tyre respektive kur shkuan tek një klinikë private, ku atyre iu tregua për një trajtim eksperimental kundër kancerit i cili po zhvillohej nga një kompani kanadeze. Ky trajtim nuk ishte autorizuar në asnjë vend, por ishte lejuar si "përdorim zemërdhimsur" në disa vende. Në një letër të 9 janarit 2011, kompania e informonte Ministrinë e Shëndetësisë së Bullgarisë që ajo do ta ofronte ilaçin falas për t'u përdorur nga pacientët me kancer në këmbim të të dhënave mbi efektet e trajtimit.

Kërkuesit bënë kërkesë tek autoritetet për leje për ta përdorur trajtimin. Kërkesa e tyre u refuzua nga autoritetet në disa letra mes qershorit dhe gushtit 2011 ku thuhej se e drejta bullgare lejonte vetëm përdorimin e trajtimeve që ishin të autorizuara në një vend tjetër. Ministria e Shëndetësisë së Bullgarisë e konfirmoi këtë qëndrim gjatë apelit të bërë nga kërkuesit. Tre prej kërkuesve bënë kërkesë pranë Ombudspersonit bullgar, i cili gjithashtu e konfirmoi këtë qëndrim.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesit u ankuan që refuzimi i autoriteteve për t'i lejuar ata të përdornin një ilaç eksperimental kishte shkelur Nenet 2, 3 dhe 8 të Konventës.

Veprimet dhe mosveprimet e autoriteteve në fushën e politikave të shëndetësisë mund të angazhojnë Nenin 2, dhe imponojnë detyrimin për të ngritur kornizat e duhura ligjore për të mbrojtur jetën e pacientëve brenda juridiksionit të tyre. Kërkuesit pretenduan që e drejta bullgare duhet t'u kishte ofruar atyre një përjashtim për qasjen në trajtim eksperimental të paautorizuar për shkak se

trajtimi konvencional që ata kishin marrë kishte qenë joefektiv. Gjykata shënoi që Bullgaria e kishte rregulloren që lejonte qasjen në trajtim të paautorizuar në rast se trajtimi konvencional dukej i pamjaftueshëm me kusht që trajtimi në fjalë të ishte i autorizuar në një vend/ shtet tjetër. Neni 2 nuk kërkon që qasja në trajtim të paautorizuar për pacientët me sëmundje fatale të rregullohet në ndonjë mënyrë të caktuar. Prandaj, Bullgaria nuk shkoj përtej hapësirës së vlerësimit që kishte në dispozicion. Ajo gjithashtu shënoi se, sipas të drejtës së Bashkimit Evropian, kjo çështje mbetet brenda kompetencave të shteteve anëtare. Rrjedhimisht, nuk kishte pasur shkelje të Nenit 2.

Neni 3

Si vlerë themelore e shoqërisë demokratike, ndalimi i torturës dhe trajtimit çnjerëzor ose poshtëruës është absolut. Neni 3 aplikohet më shpesh kur trajtimi në fjalë vjen prej veprimeve të qëllimshme të Shtetit ose autoriteteve të tij. Megjithatë, Gjykata konsideroi që Neni 3 gjithashtu mund të aplikohet kur vuajtja nga një sëmundje natyrale acarohet më tej nga një trajtim i diktuar nga masa për të cilat përgjegjëse janë autoritetet. Megjithatë, pragu i rreptësisë në këto raste është më i lartë meqenëse dëmi vjen prej sëmundjes e jo prej veprimeve apo mosveprimeve të autoriteteve.

Pretendimi në çështjen konkrete i jepte një konstrukt të gjerë kuptimit të "trajtimit çnjerëzor ose poshtëruës" të cilin Gjykata nuk mund ta pranonte. Autoritetet nuk ia shtuan drejtpërdrejt vuajtjen fizike kërkuesve me mohimin e qasjes ndaj një ilaçi siguria dhe efikasiteti i të cilit ishin të dyshimta, edhe nëse ilaçi ishte potencialisht jetëshpëtues. Ndërkohë që ky refuzim u kishte shkaktuar kërkuesve njëfarë vuajtje mendore, posaçërisht duke ditur që ilaçi vihej në dispozicion në raste të jashtëzakonshme në disa vende të tjera, vuajtja nuk e arrinte nivelin minimal të rreptësisë që kërkohet për të përbërë "trajtim çnjerëzor" brenda kuptimit të Nenit 3. Neni 3 nuk ua impononte Shteteve detyrimin për të eliminuar pabarazitë mes nivelit të vet të shëndetësisë dhe ato të vendeve të tjera. Në fund, një refuzim i thjeshtë nuk mund të shihej si i tillë që kishte ofenduar ose ulur kërkuesit. Prandaj, Gjykata vendosi që nuk kishte pasur shkelje të Nenit 3.

Neni 8

Ankesa e kërkuesve që korniza rregullatore e kufizonte kapacitetin e tyre për të zgjedhur trajtimin e vet mjekësor hynte brenda fushëveprimit të Nenit 8 meqenëse përfshinte çështje të autonomisë personale dhe cilësisë së jetës së tyre, të cilat

përbëjnë pjesë të jetës private të një individi. Gjykata konsideroi që nuk ishte e nevojshme të përcaktohej nëse çështja kryesore në këtë rast ishte ndërhyrja tek e drejta për respekt ndaj jetës private apo dështimi i detyrimit pozitiv të Shtetit për të siguruar respektimin e jetës së tyre private. Sidoqoftë, ajo do të shqyrtonte nëse Shteti kishte arritur ekuilibrin e drejtë mes interesave të kërkuesve dhe atyre të komunitetit në tërësi. Politikat shëndetësore janë, në parim, brenda hapësirës së vlerësimit të Shtetit meqenëse ai është në pozicionin më të mirë për të vlerësuar nevojat shoqërore, prioritetet, dhe shfrytëzimin e burimeve.

Interesi i kërkuesve ishte liria për të rrezikuar marrjen e një trajtimi të paautorizuar në përpjekje për të shpëtuar jetën e tyre. Duke pasur parasysh prognozën e tyre, ata kishin interes më të madh sesa pacientët e tjerë për të marrë një trajtim eksperimental siguria dhe efikasiteti i të cilit ishin të pakontrolluara. Interesi publik në këtë rast ishte i trefishtë. Së pari, të mbrohej jeta e kërkuesve, duke marrë parasysh gjendjen e tyre delikate, kundrejt rreziqeve potenciale të një trajtimi eksperimental, pavarësisht nga prognoza e tyre fatale. Së dyti, të sigurohej që ndalimi i përdorimit të trajtimit mjekësor të paautorizuar të mos dobësohej apo të anashkalohej. Së treti, të sigurohej që zhvillimi i trajtimeve të reja mjekësore të mos komprometohej, për shembull, nga pjesëmarrja e zvogëluar e pacientëve në prova klinike. Interesi i parë kishte relevancë të veçantë, dhe i dyti e i treti kishin relevancë më të përgjithshme, për sa u përket të drejtave të garantuara sipas Neneve 2, 3 dhe 8.

Sipas informacioneve nga e drejta krahasuese në dispozicion të Gjykatës, mes Shteteve Kontraktuese kishte një trend për të përfshirë rastet e pacientëve me sëmundje fatale si përjashtim nga rregulla që vetëm trajtimet e autorizuara mund të përdoren. Megjithatë, ai konsensus nuk bazohej tek parimet e vendosura në ligjet e tyre, as nuk përfshinte mënyrën se si do të duhej të rregullohej. Prandaj, hapësira e vlerësimit e Shtetit në këtë rast ishte e gjerë, sidomos duke pasur parasysh rregullat e hollësishme që kishin për qëllim gjetjen e ekuilibrit mes interesave publike dhe private.

Shteti kishte zgjedhur të ekuilibronte këto interesa konkurruese si vijon: kur trajtimi i autorizuar i një pacienti me sëmundje fatale dukej i pakënaqshëm, autoritetet lejonin përdorimin e trajtimit eksperimental i cili, sadoqë ishte i paautorizuar në Bullgari, ishte i autorizuar në një vend tjetër. Kjo ishte arsyeja kryesore për refuzimin nga autoritetet të trajtimit të dëshiruar të kërkuesve. Kjo zgjidhje e lëkundte ekuilibrin mes përfitimeve terapeutike potenciale dhe shmangies së rrezikut mjekësor dhe e shpinte me vendosmëri në mbështetje të

kësaj të dytës, meqenëse një trajtim që është i autorizuar në një vend tjetër me gjasë ka kaluar nëpër testime të shumta për siguri dhe efikasitet. Megjithatë, duke pasur parasysh hapësirën e gjerë të vlerësimit të Shtetit, zgjidhja nuk ishte në kundërshtim me Nenin 8. Çështja nga Neni 8 nuk ishte nëse një zgjidhje e ndryshme do të kishte mundur të vendoste një ekuilibër më të drejtë por nëse ekuilibri i vendosur e tejkalonte hapësirën e vlerësimit në dispozicion të Shtetit. Më tej, nuk ishte vetvetiu në kundërshtim me Nenin 8 nëse një Shtet rregullonte aspekte të rëndësishme të jetës private pa siguruar dispozita për peshimin e interesave konkurruese në rrethanat e secilit rast individual. Rrjedhimisht, Gjykata vendosi që nuk kishte pasur shkelje të Nenit 8.

Neni 13

Meqenëse shkeljet e pretenduara të Neneve 2, 3 dhe 8 rridhnin nga gjendja e ligjeve në Bullgari, nuk dilte asnjë çështje në lidhje me Nenin 13. Prandaj, kjo pjesë e kërkesës u refuzua si dukshëm e pabazuar.

Vendimi për të shpërndarë një komunitet fetar për të parandaluar inkurajimin e vetëvrasjes ose refuzimin e ndihmës mjekësore ka shkelur Nenin 9 të interpretuar nën dritën e Nenit 11

DËSHMITARËT E JHOVAIT DHE TË TJERË K. RUSISË

(Kërkesa Nr. 302/02)
10 qershor 2010

1. Faktet kryesore

Kërkuesit ishin komuniteti fetar i Dëshmitarëve të Jehovahit në Moskë, i vendosur në vitin 1992, dhe katër anëtarë individualë të atij komuniteti që jetonin në Moskë. Kjo degë fitoi statusin e entitetit ligjor në dhjetor të vitit 1993. Sipas besimit të tyre fetar, anëtarët e komunitetit mbanin një kartë "Jo Gjak" e cila deklaronte refuzimin e tyre për të marrë transfuzion gjaku në çfarëdo rrethanash. Megjithatë, ajo kartë deklaronte pëlqimin e tyre për të përdorur zëvendësuesit e gjakut dhe metoda të tjera trajtimi pa gjak.

Pas ankesave nga një organizatë joqeveritare të lidhur me Kishën Ortodokse Ruse, prokurori i rrethit bëri padi civile për të shpërndarë komunitetin kërkues dhe për të ndaluar aktivitetet e tij. Prokurori citoi një sërë akuzash përfshirë inkurajimin e vetëvrasjes ose refuzimin për arsye fetare të ndihmës mjekësore për personat në gjendje të atilla në të cilat u kërcënohej jeta ose shëndeti. Gjykata e rrethit fillimisht e rrëzoi procedurën, megjithatë apeli i prokurorit u mbështet në mars 2004 për shkak se komuniteti i kërkuesit inkurajonte vetëvrasjen dhe refuzimin e ndihmës mjekësore, mes të tjerash.

Në ndërkohë, ligji për Lirinë e Ndërgjegjes dhe Asociimit Fetar ("Akti Fetar") hyri në fuqi në tetor 1997, dhe ai kërkonte që të gjitha shoqatat fetare të regjistroheshin në Departamentin e Drejtësisë. Komuniteti kërkues aplikoi pa sukses për ri-regjistrim pesë herë prej tetorit 1999 deri në janar 2001. Në gusht të vitit 2002, një gjykatë rrethi gjeti që Departamenti i Drejtësisë kishte refuzuar në mënyrë të paligjshme aplikimet e komunitetit kërkues. Megjithatë, ai nuk urdhëroi ri-regjistrimin dhe theksoi që komuniteti kërkues duhet të bënte aplikim të ri.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesit pretenduan që shpërndarja nga Shteti e komunitetit të tyre fetar dhe refuzimi i tij për të ri-regjistruar organizatën e tre kishte shkelur të drejtat e tyre

sipas Neneve 9 dhe 11 të Konventës. Gjykata i shqyrtoi ankesat e tyre krahas disa justifikimeve të paraqitura nga Shteti. Megjithatë, kjo përmbledhje do të përqendrohet në pohimin e Shtetit që vendimi i tij për të shpërndarë komunitetin kërkues ishte i nevojshëm për të parandaluar inkurajimin e tij për vetëvrasje dhe refuzimin e ndihmës mjekësore. Kërkuesit gjithashtu u ankuan që kohëzgjatja e tepërt të procedurave civile për të shpërndarë komunitetin e tyre kishte shkelur Nenin 6.

Neni 9 i interpretuar nën dritën e Nenit 11 për shkak të shpërndarjes së komunitetit kërkues

Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë është një prej themeleve të një shoqërie demokratike dhe përfshin lirinë për të manifestuar fenë e secilës/secilit privatisht ose në komunitet me të tjerë. Meqenëse komunitetet fetare tradicionalisht ekzistojnë në formën e strukturave të organizuara, Neni 9 duhet të interpretohet nën dritën e Nenit 11, i cili mbron lirinë e asociimit nga ndërhyrja e pajustificuar e Shtetit. Detyra e Shtetit për paanshmëri, siç nënvizohet nga praktika gjyqësore e Gjykatës, është e papërputhshme me çfarëdo fuqie për të vlerësuar legjitimitetin e besimeve fetare. Ndërkohë që Shteti ka të drejtën të kontrollojë për t'u siguruar që qëllimet dhe aktivitetet e një shoqate janë në pajtueshmëri me rregullat e caktuara në legjislacion, ai duhet ta bëjë këtë në mënyrë të përputhshme me detyrimet e tij sipas Konventës. Përjashtimet nga liria e asociimit duhet të konceptohen rreptësisht dhe vetëm kur ka justifikim bindës dhe imponues që korrespondon me një "nevojë shoqërore urgjente".

Vendimi i gjykatës ruse për të ndaluar aktivitetet e komunitetit kërkues efektivisht e zhveshi atë nga identiteti i tij ligjor e rrjedhimisht nga e drejta e tij për të pasur në pronësi ose për të marrë me qira pronë, për të pasur llogari bankare, për të punësuar njerëz, dhe për të siguruar mbrojtjen juridike të komunitetit të vet. Prandaj vendimi ndërhynte në të drejtën e kërkuesve për të manifestuar fenë e tyre në komunitet me të tjerë dhe për të kryer praktikën e tyre fetare sipas Nenit 9 të interpretuar nën dritën e Nenit 11. Kjo ndërhyrje ishte e bazuar në dispozitat e Aktit Fetar dhe kështu ishte "e parashikuar nga ligji". Më tej, ajo synonte qëllimin legjitim të mbrojtjes së shëndetit dhe të drejtave të të tjerëve të renditura në Nenin 9 dhe 11. Më pas Gjykata shqyrtoi nëse ndërhyrja kishte qenë "e nevojshme në një shoqëri demokratike" kundrejt secilës bazë të përdorur nga Shteti. Shteti argumentoi që shpërndarja e komunitetit kërkues ishte e justifikuar për shkak se ai: (i) detyronte familjet e anëtarëve të vet që të ndaheshin; (ii) shkelte mbi të drejtat dhe liritë e shtetasve rusë; (iii) inkurajonte vetëvrasjen dhe refuzimin e ndihmës mjekësore; (iv) dëmtonte shëndetin e ndjekësve të tij; (v) joshte të miturit për të hyrë në organizatë fetare; dhe (vi) nxiste qytetarët për të refuzuar detyrat e tyre civile. Kjo përmbledhje do të përqendrohet vetëm në konstatimin e faktit nëse ishte e nevojshme

në një shoqëri demokratike që të ndaloheshin aktivitetet e komunitetit kërkues për shkak se ai inkurajonte vetëvrasjen ose refuzimin e ndihmës mjekësore.

Gjykata vërejtë që gjykatat ruse nuk elaboruan rreth akuzave për inkurajimin e vetëvrasjes. Refuzimi i transfuzionit të gjakut nuk mund të konsiderohej që përbënte vetëvrasje meqenëse kjo e fundit do të ngërthente qëllimin për të shpejtuar vdekjen përmes mos-vazhdimit të trajtimit. Në kontrast, në vend të përjashtimit të trajtimit, Dëshmitarët e Jehovahit mbanin shpresën e shërimit dhe thjesht bënin një zgjedhje në lidhje me procedurat mjekësore. Prandaj, akuza që komuniteti kërkues nxiste vetëvrasjen nuk ishte e bazuar në fakte. Rrjedhimisht, Gjykata më tej mori në shqyrtim vetëm nëse anëtarët e Dëshmitarëve të Jehovahit refuzonin ndihmën mjekësore si rezultat i presionit nga komuniteti i tyre.

Dihej që Dëshmitarët e Jehovahit besojnë se Bibla ndalon marrjen e gjakut, përfshirë me anë të transfuzionit. Ndalimi nuk lejon asnjë përjashtim; as në rastet kur gjykohet e nevojshme për të shpëtuar jetën e individit. Gjykata njohu faktin se refuzimi i trajtimit jetëshpëtues përfshinte konfliktin mes interesit të Shtetit për të mbrojtur jetën e qytetarëve dhe të drejtës së individit për autonomi fizike dhe fetare. Respekti për dinjitetin njerëzor, lirinë, nocionin e vetëvendosjes dhe autonomisë personale janë pjesë e vetë thelbit të Konventës. Liria për të zhvilluar jetën e vet sipas zgjedhjes së vet përfshin mundësinë për të vijuar aktivitete të cilat mund të jenë fizikisht të dëmshme ose të rrezikshme për secilën/secilin. Më tej, imponimi i trajtimit mjekësor pa pëlqimin e individit do të ndërhynte tek e drejta e tij/saj sipas Nenit 8, edhe nëqoftëse ishte i nevojshëm për të parandaluar vdekjen.

Gjykata shënoi që shumë juridiksione të vendosura tashmë kishin shqyrtuar çështje të ngjashme me Dëshmitarët e Jehovahit dhe kishin vendosur që, ndërkohë që interesi publik për të ruajtur jetën e pacientëve është jashtëzakonisht i fortë, ai duhet të dorëzohet para interesit më të fortë të pacientit për të drejtuar lirisht jetën e vet. Gjykata më tej theksoi se, nëse nuk ekziston nevoja për të mbrojtur palë të treta, për shembull me anë të vaksinimit në rast epidemie, Shteti duhet të abstenojë nga ndërhyrja në lirinë e individit për të zgjedhur kujdesin e vet shëndetësor. Meqenëse zgjedhja e lirë dhe vetëvendosja janë përbërës themelorë të jetës, një ndërhyrje e tillë do ta zvogëlonte në vend që ta zmadhonte vlerën e jetës së tyre.

Megjithatë, gjykatat ruse kishin gjetur që refuzimi nuk kishte qenë shprehje e vullnetit të lirë të kërkuesve por rezultat i presionit nga komuniteti i tyre. Kur rrezikohet shëndeti dhe mbase edhe jeta e një patienti, origjinaliteti i refuzimit të ndihmës mjekësore nga ana e tyre është shqetësim legjitim. Kështu, e drejta për t'u "përpjekur

për të bindur fqinjin" ishte e njohur si element legjitim i lirisë fetare. Gjykata bënte dallimin mes pozicionit të një shërbyesi që nuk mund të tërhiqej nga bisedat fetare të iniciuara nga eprorët e tij, çka mund të shihej si një formë e ngacmimit ose presionit të paduhur, dhe një bisede mes civilëve, çka mund të përshkruhej si shkëmbim i lirë dhe i pafajshëm i ideve. Në rastin konkret, nuk kishte tregues prej gjykimeve vendase që komuniteti kishte aplikuar ndonjë formë të presionit të paduhur ose ndikimi pa vend. Përkundrazi, dukej sikur shumë prej anëtarëve kishin bërë zgjedhjen e qëllimshme për të refuzuar transfuzionin e gjakut, para se të ndodheshin nën presionin e ndonjë emergjence mjekësore, duke plotësuar kartat "Jo Gjak" të cilat i mbanin me vete. Prandaj, nuk kishte bazë faktike për gjetjen e gjykatës ruse që refuzimi i transfuzionit të gjakut nuk ishte shprehje e vullnetit të vërtetë të anëtarëve.

Shteti nuk ka të drejtë sipas Konventës që të vendosë se cilat besime janë legjitime meqenëse e drejta për liri fetare e përjashton atë nga çdo diskrecion. Në përfundim, Gjykata gjeti që gjykatat ruse nuk kishin vërtetuar "nevojën shoqërore urgjente" të "arsyeve relevante dhe të mjaftueshme" për të justifikuar kufizimin e të drejtës së kërkuesve për autonomi personale në lidhje me besimet fetare dhe integritetin fizik. Në tërësi, sanksioni i shqiptuar nga gjykatat ruse ishte së tepërmi i rreptë dhe joproporcional me qëllimin legjitim të synuar. Rrjedhimisht, kishte pasur shkelje të Nenit 9 i lexuar nën dritën e Nenit 11.

Shkelje të tjera

Arsyet për refuzimet për të ri-regjistruar komunitetin kërkues nuk kishin bazë të ligjshme meqenëse nuk kishte gjetje se ai kishte shkelur ndonjë ligj vendas. Si i tillë, refuzimi i autoriteteve nuk ishte në mirëbesim dhe ato kishin neglizhuar detyrën e tyre për neutralitet dhe paanshmëri ndaj komunitetit kërkues. Prandaj, kishte pasur shkelje të Nenit 11 i lexuar nën dritën e Nenit 9.

Neni 6 imponon mbi Shtetin detyrimin për të organizuar sistemin e vet juridik në mënyrë të atillë që të mund të vendosë për çështjet brenda një kohe të arsyeshme. Kompleksiteti i çështjes në fjalë nuk mundi të shpjegonte gjatësinë e tepërt të procedurave (gjashtë vjet) për të shpërndarë komunitetin kërkues. Rrjedhimisht, Shteti kishte dështuar në detyrimin e vet dhe kishte pasur shkelje të Nenit 6 § 1.

Neni 41

Gjykata u caktoi kërkuesve 20,000 Euro në lidhje me dëme jomateriale dhe 50,000 Euro për kosto dhe shpenzime.

Mungesa e pëlqimit nga prindërit për hetime mjekësore të një nëntë-vjeçareje, që dyshohej se ishte viktimë e abuzimit seksual nga babai i saj, dhe vonesa vijuese për referimin tek dermatologu/ia ka shkëlur të drejtat e saj dhe të babit të saj sipas Nenit 8

VENDIMI NË ÇËSHTJEN E M.A.K dhe R.K. kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR

(Kërkesat Nr. 45901/05 dhe Nr. 40146/06)
23 mars 2010

1. Faktet kryesore

Në dy raste, në shtator 1997 dhe shkurt 1998, kërkuesi i parë e çoi vajzën e tij nëntë-vjeçare (kërkuesja e dytë) te mjeku i familjes për shkak të shqetësimit rreth disa shenjave që dukeshin të mavijosura në këmbët e saj. Pas kësaj, në mars 1998 një pediatër/e bëri një vizitë ku mori mostra dhe bëri fotografi të kërkueses së dytë në mungesë të prindërve dhe pavarësisht nga babai që tha se çdo lloj testimi duhet të bëhej në prani të nënës së saj, ose me pëlqimin e saj eksplicit. Pas ardhjes në spital, nëna e kërkueses së dytë dha pëlqimin për ekzaminim të mëtejshëm, dhe më pas u informua nga pediatri/ja që kishte prova të abuzimit seksual. Kërkuesja e dytë nuk u mor fare në pyetje lidhur me abuzimin e dyshuar. Kërkuesi i parë nuk u lejua atë ditë që ta vizitonte kërkuesen e dytë tërë ditën, dhe prej atij momenti vetëm nën mbikqyrje.

Megjithëse në ndërkohë nëna e kishte informuar pediatrin/en që kërkuesja e dytë ishte ankuar kohët e fundit që ishte lënduar duke ngarë biçikletën, pediatri/ja nguli këmbë që kishte pasur abuzim seksual. Pak ditë më pas, pasi nëna e kërkueses së dytë vuri re shenja në duart e saj, ajo u referua tek një dermatolog/e. Gjashtë ditë pas kësaj, kërkuesja u diagnostikua me një sëmundje të rrallë të lëkurës dhe u lëshua nga spitali. Më pas pediatri/ja shkroi një letër ku thoshte se kishte prova të pamjaftueshme që ajo ishte abuzuar.

Pas një ankesë të kërkuesve, Komisioni i Pavarur Shqyrtues gjeti që kërkuesja e dytë duhet të ishte intervistuar rreth shenjave në lëkurën e saj dhe që, ndërkohë që pediatri/ja nuk kishte faj për diagnostikimin e gabuar të mavijosjeve, duhet të ishte kërkuar me urgjencë opinioni i një dermatologu/e. Kërkuesit nuk patën sukses në procedurat për neglizhencë kundër autoritetit vendor dhe trustit të spitalit. Të dy patën ndihmë ligjore gjatë procedurës së shkallës së parë, por kërkueses së dytë iu hoq ndihma ligjore gjatë apeleve vijuese.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi i parë u ankua që ai kishte përjetuar shqetësim dhe turpërim si pasojë e akuzave kundër tij, duke shkelur të drejtat e tij sipas Nenit 3. Më tej kërkuesit u ankuan, sipas Nenit 8, për kufizimin e vizitave gjatë periudhës kur kërkuesja e dytë gjendej në spital dhe për faktin që mostra e gjakut ishte marrë dhe fotografitë ishin bërë pa pëlqimin e prindërve. Kërkuesja e dytë u ankua, sipas Nenit 6, që asaj i ishte hequr ndihma ligjore gjatë procedurës së apelit. Në fund, kërkuesi i parë u ankua sipas Nenit 13, që ai nuk mund të pretendonte kompensim për dëmin e shkaktuar nga trajtimi që autoritetit vendor i kishte bërë çështjes së vajzës së tij për shkak të gjetjes së gjykatave vendase që nuk ekzistonte e drejta zakonore për kujdesin që iu detyrohet prindërve.

Neni 3

Ndërkohë që masat për mbrojtjen e fëmijëve përgjithësisht u shkaktonin prindërve shqetësim dhe, në disa raste, turpërim nëse dyshohej se ata ishin duke dështuar në përgjegjësitë e tyre prindërore, do të ishte kundërtënëse për mbrojtjen efektive të të drejtave të fëmijëve të thuhej që autoritetet mbanin automatikisht përgjegjësi ndaj prindërve sipas kësaj dispozite kurdo që ato gabonin, me arsye ose ndryshe, gjatë kryerjes së detyrave të tyre. Rrjedhimisht duhet të kishte një faktor përveç zbatimit normal të atyre detyrave në mënyrë që një çështje të hynte brenda fushëveprimit të Nenit 3. Ndërkohë që Gjykata nuk dyshonte se shqetësimi i kërkuesit të parë për shkak të dyshimit të gabuar ndaj tij për abuzim, kjo nuk përbënte element aq të veçantë sa t'i shkaktonte atij vuajtje përtej zbatimit të qenësishëm të masave.

Prandaj, Gjykata arriti në përfundimin që ankesa sipas Nenit 3 ishte e papranueshme.

Neni 6

U shënuar që, kur procedura civile përfshin çështje të komplikuar të ligjit dhe kërkuesi/ja nuk mund të paguajë përfaqësues ligjor, mohimi i ndihmës ligjore mund të përbëjë kufizim të qasjes në gjykatë. Kur ndodh kjo, refuzimi është në përputhje me Konventën vetëm nëqoftëse është bërë për një qëllim legjitim dhe në proporcion me atë qëllim. Arsyeja për heqjen e ndihmës ligjore për kërkuesen e dytë ishte qëllimi legjitim që, në mungesë të interesit publik, paratë publike duhet t'u viheshin në dispozicion vetëm atyre kërkuesve akuzat e të cilëve me gjasë do të rezultonin

me caktimin e një kompensimi i cili do të ishte më i madh se kostoja e financimit të çështjes. Më tej u shënua që sistemi ligjor i Mbretërisë së Bashkuar ofronte garanci për të mbrojtur individët nga arbitrariteti, si mundësia për të apeluar për ndihmën e hequr para Komisionit të Pavarur për Shqyrtimin e Financimit.

Prandaj Gjykata arriti në përfundimin që, edhe sikur tërheqja e ndihmës ligjore të përbënte kufizim të së drejtës së kërkueses së dytë për qasje në gjykatë, ajo ishte legjitime dhe proporcionale, që do të thoshte se ankesa e saj sipas Nenit 6 ishte e papranueshme.

Neni 8

Në lidhje me kufizimin e vizitave të kërkuesve gjatë dhjetë ditëve që kërkuesja e dytë qe e shtruar në spital, ishte e padiskutueshme që kishte pasur shkelje të të drejtave të të dy kërkuesve për respekt të jetës së tyre familjare.

Megjithëse kufizimet synonin qëllimin legjitim të mbrojtjes së të drejtave të kërkueses së dytë, ato nuk kishin bazë ligjore atë natë kur kërkuesja e dytë u shtrua në spital, dhe prandaj Gjykata deklaroi që ai kishte shkelur të drejtat e të dy kërkuesve sipas Nenit 8. Prej aty, megjithëse kërkuesit të parë iu lejua e drejta e vizitës për pjesën e mbetur të kohës që kërkuesja e dytë kaloi në spital, kjo u bë nën mbikqyrje dhe kështu vazhdoi të përbënte ndërhyrje. Ajo ndërhyrje ishte në përputhje me ligjin dhe kishte qëllimin legjitim të mbrojtjes së të drejtave të kërkueses së dytë. Sa i përket faktit nëse ndërhyrja kishte qenë e nevojshme në një shoqëri demokratike, kishte qenë e arsyeshme, duke pasur parasysh provat në dispozicion, që pediatri/ja të dyshonte për abuzim dhe do të kontaktonte shërbimet sociale. Ndërkohë që duhet të ketë qenë irrituese për prindërit që informacioni rreth aksidentit me biçikletë me sa duket ishte injoruar, dyshimet e vazhduara të autoritetit vendor kishin qenë të justifikuar meqenëse vetë prindërit ishin të dyshuar dhe çdo shpjegim që mund të jepnin ata duhet të trajtohej me kujdes. Sidoqoftë, aksidenti me biçikletë shpjegonte vetëm një prej lëndimeve të dukshme.

Megjithatë, Gjykata qe e shqetësuar për dy prej gjetjeve të Komisionit të Pavarur Shqyrtues. Sa i përket nevojës për të intervistuar kërkuesen e dytë rreth akuzave për abuzim, Gjykata gjeti që kjo nuk kishte qenë e domosdoshme sepse, edhe sikur ajo të mohonte abuzimin, nuk kishte gjasa që abuzimi të mund të ishte përjashtuar si shkak i mundshëm i lëndimeve të saj. Edhe më shqetësuese ishte gjetja e Komisionit që opinioni i dermatologut/es duhet të ishte kërkuar

me urgjencë. Vetëm katër ditë pas shtruarjes së kërkueses së dytë në spital, kur nëna e saj pa shenjat në duart e saj, u mbajt konsulta me dermatologun/en. Kështu, ndërkohë që fillimisht kishte pasur arsye relevante dhe të mjaftueshme që autoritetet të dyshonin për abuzim, vonesa e konsultës me dermatologun/en e kishte zgjatur ndërhyrjen dhe nuk ishte proporcionale me qëllimin legjitim të mbrojtjes së kërkueses së dytë nga e keqja. Pra, kishte pasur shkelje të të drejtave të dy kërkuesve për respekt të jetës së tyre familjare.

Sa i përket testeve dhe fotografive të bëra pa pëlqimin prindëror, e drejta dhe praktika vendase qartazi kërkon pëlqimin e prindërve ose personave që mbajnë përgjegjësi ligjore para kryerjes së çdo ndërhyrjeje mjekësore. Prindërit kishin dhënë udhëzime shprehimisht që të mos kryeshin testime të mëtejshme deri sa të arrinte nëna. Duke marrë parasysh ato udhëzime, i vetmi justifikim për vendimin që të vazhdohej me testin e gjakut dhe fotografimin ishte që ato kërkoheshin me urgjencë. Megjithatë, nuk kishte prova që sugjeronin se gjendja e kërkueses së dytë ishte kritike, duke u përkeqësuar, ose me gjasa përkeqësimi, ose që ajo kishte dhimbje ose nuk ndihej mirë. As nuk kishte pasur arsye të besohej se nëna nuk do të kishte dhënë pëlqimi dhe, edhe sikur ajo ta kishte bërë këtë, spitali mund të kishte kërkuar një urdhër gjyqësor për autorizimin e testeve. Në këto kushte, nuk kishte pasur justifikim për vendimin e marrjes së testit të gjakut dhe fotografive intime në një vajze nëntë-vjeçare, kundër dëshirave të qarta të të dy prindërve të saj, gjatë kohës që ajo gjendej e vetme në spital.

Prandaj, ndërhyrja tek jeta private e kërkueses së dytë nuk ishte në përputhje me të drejtën vendase dhe kështu që Gjykata deklaroi që kishte pasur shkelje të Nenit 8.

Neni 13

Kërkuesi i parë nuk kishte pasur mundësi në dispozicion që të pretendonte se autoriteti vendas kishte qenë përgjegjës për dëmet që ai kishte pësuar dhe për marrjen e kompensimit për ato dëme. Prandaj, Gjykata njëzëri arriti në përfundimin që kishte pasur shkelje të Nenit 13.

Neni 41

Gjykata i caktoi 2,000 Euro kërkuesit të parë dhe 4,500 Euro kërkueses së dytë në lidhje me dëme jomateriale, dhe 15,000 Euro së bashku në lidhje me kosto dhe shpenzime.

Ankesa që refuzimi i autoriteteve për të kompensuar koston e plotë të një ilaçi jetëshpëtues ka shkelur Nenin 2 u deklarua e papranueshme

VENDIMI NË ÇËSHTJEN NITECKI k. POLONISË

(Kërkesa Nr. 65653/01)

21 mars 2002

1. Faktet kryesore

Kërkuesi ishte i lindur në vitin 1932 dhe jetonte në Bydgoszcz. Ai ishte diagnostikuar me sklerozë laterale amiotrofike (ALS) në vitin 1976. Në qershor të vitit 1999, atij iu dha recetë për ilaçin Rilutek, një medikament i përdorur për të trajtuar ALS. Ai i kërkoi Fondit të Sigurimeve Shëndetësore të Kujaësko-Pomorskit ("Fondi") që të kompensonte koston e plotë të ilaçit. Fondi u përgjigj me një letër të 28 qershorit 1999, duke thënë se katër prej pesë ilaçeve që merrte ai kompensoheshin plotësisht, me përjashtim të Rilutek, i cili mbulohej deri në masën 70%.

Kërkuesi bëri kërkesë pranë zyrës rajonale për ta prishur këtë vendim, duke parashtruar se ai nuk mund ta përballonte ilaçin financiarisht dhe që nuk kishte fëmijë që ta ndihmonin. Kërkuesi gjithashtu i tha Gjykatës se ai kishte paguar kontribute shoqërore për 37 vjet. Zyra rajonale e transferoi kërkesën tek shërbimet sociale të cilat e refuzuan këtë kërkesë në gusht 1999 dhe shënuan që të ardhurat e tij familjare ishin mbi pragun statusor të tyre për ndihmë të mëtejshme. Ai po ashtu mori një letër nga Ministria e Shëndetësisë dhe Shërbimeve Sociale e cila e konfirmonte vendimin e Fondit.

Në shtator të vitit 1999, gjendja e invaliditetit të kërkuesit u rrit nga shkalla e dytë në shkallën e parë. Pas apelit të tij në Gjykatën Supreme, ai u informua që nuk mund të apelohej më kundër këtyre vendimeve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Shërbimeve Sociale.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi u ankua që refuzimi i Shtetit për të kompensuar çmimin e plotë të një ilaçi jetëshpëtues shkelte të drejtën e tij për jetë sipas Nenit 2 të Konventës. Ai gjithashtu pretendoi se ky shkelte Nenin 8 dhe 14.

Neni 2

Veprimet dhe mosveprimet e autoriteteve në fushën e politikave të shëndetësisë mund të angazhojnë Nenin 2. Më tej, Neni 2 mund të jetë i aplikueshëm kur nuk është e mundur të vërtetohet se autoritetet kanë vënë në rrezik jetën e një individi përmes mohimit të kujdesit shëndetësor të cilin ato kishin marrë përsipër ta vinin në dispozicion për popullatën në përgjithësi.

Në rastin konkret, Gjykata shënoi që kërkuesi gëzonte kujdesin shëndetësor publik standard, përfshirë barna falas dhe trajtim mjekësor falë kontributeve të tij në sigurimet shoqërore. Skema standarde e kujdesit shëndetësor publik ofronte kompensim në masën 70% për Rilutek. Duke pasur parasysh trajtimin mjekësor dhe kushtet e ofruara për kërkuesin, përfshirë kompensimin me 70% për ilaçin Rilutek, Shteti nuk mund të thuhet, në rrethanat e veçanta të këtij rasti, se ka dështuar në zbatimin e detyrimeve të veta sipas Nenit 2 duke mos paguar 30 përqindshin e mbetur të çmimit të ilaçit.

Prandaj, Gjykata e refuzoi këtë pjesë të kërkesës si dukshëm e pabazuar. Neni 8 Duke marrë parasysh konkluzionin e saj sipas Nenit 2, Gjykata konsideroi që nuk dilnin çështje të tjera sipas Nenit 8.

Neni 14

Neni 14 ndalon vetëm dallimet në trajtim të cilat nuk kanë justifikim objektiv ose të arsyeshëm. Në këtë rast, kjo ishte shpërndarje e drejtë e burimeve të kufizuara publike. Më tej, nuk kishte prova të arbitraritetit në vendimin e Fondit. Prandaj, kjo pjesë e kërkesës u refuzua si dukshëm e pabazuar.

Dështimi për të vepruar në përputhje me mbrojtjet ligjore gjatë bastisjes së zyrës së një kërkuesi dhe zbulimi i të dhënave të tij psikiatrike ka shkelur Nenin 8, dhe ai nuk ka pasur qasje në zgjidhje efektive, në kundërvënien të Nenit 13

VENDIMI NË ÇËSHTJEN PANTELEYENKO K. UKRAINËS

(Kërkesa Nr. 11901/02)

29 qershor 2006

1. Faktet kryesore

Kërkuesi ishte i lindur në vitin 1960 dhe jetonte në Chernigiv. Në maj të vitit 1999, ndaj tij u hap procedura penale për abuzim të pushtetit dhe fallsifikim të dokumenteve zyrtare si noter privat. Autoritetet zunë disa prej sendeve në posedim të tij gjatë realizimit të një urdhri bastisjeje për zyrën e tij lëshuar nga Prokurori i Chernigiv. Procedura penale u ndërpre nga Gjykata e Rrethit Desniansky në gusht të vitit 2001 mbi baza jo-shfajësuese për shkak të parëndësisë së veprës. Ankesa e tij që vendimi duhet të kishte marrë mbi baza shfajësuese u refuzua nga Gjykata e Rrethit e cila theksoi se gjatë hetimeve ishin mbledhur prova të mjaftueshme për të konstatuar që ai e kishte kryer veprën. Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme e mbështetën këtë vendim.

Kërkuesi nisi procedurën për kërkimin e kompensimit nga Prokuroria për dëmet e pësuar si pasojë e bastisjes së paligjshme të zyrës së tij. Në gusht të vitit 2000, Gjykata e Rrethit Novozavodsky deklaroi se bastisja e zyrës së tij në mënyrë të paligjshme shkelte Nenin 183 dhe 186 të Kodit të Procedurës Penale duke dështuar t'i paraqiste atij urdhër-bastisjen pavarësisht nga njohja e vendndodhjes së tij dhe sekuestrimi i sendeve të tij personale të cilat nuk kishin lidhje të drejtpërdrejtë me çështjen. Megjithatë, ajo e refuzoi pretendimin për shkak se procedura penale ishte përfunduar mbi baza jo-shfajësuese. Apeli i tij u refuzua nga Gjykata e Apelit.

Në fund, në dhjetor 2001, kërkuesi nisi procedurat kundër Kolegjit Juridik të Chernigiv (Chernigiv Laë College) dhe Drejtorit të tij për shpifje në lidhje me deklaratat trilluese të bëra nga Drejtori gjatë një seance të Komisionit të Legalizimit, duke përfshirë një pikë që vinte në pyetje shëndetin e tij mendor. Gjykata e Novozavodsky kërkoi, mori, dhe zbuloi para gjykatës prova nga një spital në lidhje me shëndetin e tij mendor dhe trajtimet psikiatrike, për ta refuzuar më pas pretendimin e tij si të pavërtetuar. Në tetor të vitit 2002, Gjykata e Apelit e mbështeti këtë vendim dhe lëshoi një vendim të ndarë ku dënonte dështimin

e Gjykatës së Novozavodsky për të shfrytëzuar regjimin e posaçëm që duhet ndjekur për të dhënat psikiatrike sipas Nenit 32 të Kushtetutës dhe Neneve 32 dhe 31 për Aktin e të Dhënave të vitit 1992. Kërkuesi pa sukses kërkoi leje nga Gjykata Supreme që të apelonte sipas procedurës së kasacionit.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi u ankua që bastisja e paligjshme e zyrës së tij dhe zbulimi në një seancë gjyqësore i informatave konfidenciale në lidhje me shëndetin e tij mendor dhe trajtimin psikiatrik shkelte të drejtën e tij për respekt ndaj jetës së tij private dhe shtëpiake, respektivisht, sipas Nenit 8 të Konventës. Më tej, ai u ankua që refuzimi i autoriteteve për ta paguar atë sipas skemës vendase të kompensimit për ndjekje penale të paligjshme shkelte prezumimin e pafajësisë nga Neni 6 § 2. Në fund, ai pretendoi se kishte mungesë të zgjidhjeve efektive ndaj shkeljeve të pësuar nga Neni 8 dhe që kjo shkelte Nenin 13.

Neni 8

Gjykata së pari konstatoi që bastisja e zyrës së kërkuesit ndërhynte tek e drejta e tij për respektim të shtëpisë së tij sipas Nenit 8. Ishte e panevojshme të diskutohej nëse hapësira më e gjerë e vlerësimit që gëzon Shteti për bastisjet në ambiente të biznesit kundrejt ambienteve të banimit.

Në mënyrë që ndërhyrja të jetë e ligjshme, duhet që ajo të jetë bërë në "përputhje me ligjin". Në Kreun 16, Kodi i Procedurës Penale ofronte mbrojtje që kërkonin që urdhri i bastisjes t'i paraqitej personit që shfrytëzonte ambientet përpara bastisjes, dhe që ndalonin sekuestrimin e sendeve dhe dokumenteve të cilat nuk kishin lidhje të drejtpërdrejtë me hetimet. Gjykata shënoi që në vendimin e saj të gushtit 2000, Gjykata e Novozavodsky u shpreh se bastisja ishte e paligjshme për shkak se autoritetet kishin dështuar në respektimin e këtyre mbrojtjeve. Autoritetet nuk ia kanë paraqitur kërkuesit urdhrin e bastisjes pavarësisht se e kanë ditur ku ndodhet ai, dhe kanë sekuestruar dokumente personale të cilat qartazi nuk kishin lidhje me çështjen. Prandaj, ndërhyrja nuk ishte "në përputhje me ligjin" dhe shkelte Nenin 8. Si e tillë, ishte e panevojshme të shqyrtohej nëse ajo ishte "në synim të një qëllimi legjitim" dhe "e nevojshme në një shoqëri demokratike".

Në vazhdim, Gjykata më pas mori në konsideratë nëse zbulimi në seancë gjyqësore i informatave konfidenciale në lidhje me shëndetin e tij mendor dhe trajtimin psikiatrik ndërhynte tek e drejta e tij për respektim të jetës private nga

Neni 8. Gjykata iu përgjigj kësaj pozitivisht, meqenëse zbulimi zgjeronte grupin e personave që kishin qasje në informata konfidenciale.

Qeveria nuk e kontestoi që masa nuk ishte në përputhje me regjimin e posaçëm të zbatueshëm për mbledhjen, mbajtjen, përdorimin dhe shpërndarjen e të dhënave psikiatrike sipas Nenit 32 të Kushtetutës, dhe Neneve 23 dhe 31 të Aktit të të Dhënave të vitit 1992. Prandaj, masa ishte e paligjshme sipas Nenit 6 të Aktit të Asistencës Mjekësore Psikiatrike i vitit 2000. Meritat e pretendimit për shpifje nuk mund të ndikonin te kjo gjetje sepse të dhënat e kërkuara nuk kishin lidhje me hetimet paragjyqësore. Rrjedhimisht, Gjykata deklaroi që zbulimi nuk ishte “në përputhje me ligjin” dhe shkelte Nenin 8. Duke marrë parasysh këtë përfundim, nuk pati nevojë të shqyrtohej ndonjë justifikim i mundshëm i masës.

Neni 6 § 2

Konventa duhet të interpretohet në mënyrë të atillë që mbron të drejta të cilat janë praktike dhe efektive e jo teorike dhe iluzive. Neni 6 § 2 nuk garanton të drejtën për kompensim apo rimbursim të shpenzimeve kur ndërpriten procedurat penale. Megjithatë, praktika gjyqësore e Gjykatës ka konstatuar që prezumimi i pafajësisë shkelet kur një vendim gjyqësor gjatë procedurës penale pasqyron opinionin që i pandehuri është fajtor pa u vërtetuar fajtor nga ligji. Fushëveprimi i Nenit 6 § 2 përfshin vendimet gjyqësore të bëra pasi ndjekja penale është ndërprerë ose pas një shfajësimi.

Gjykata shënoi që gjatë procedurës së kompensimit, Gjykata e Novozavodsky dhe Gjykata e Apelit qartazi shprehën pikëpamjen që kërkuesi e kishte kryer veprën. Më tej, gjatë procedurës penale, Gjykata e Desniansky kishte theksuar që, ndërkohë që kishte pasur prova të mjaftueshme për të konstatuar se ai e kishte kryer veprën, procedura do të ndërpritej për shkak të parëndësisë së veprës. Gjuha e Gjykatës së Desniansky ishte e mjaftueshme për të shkelur prezumimin e pafajësisë meqenëse procedurës para saj i mungonin elementet bazë të një gjyqi penal. Refuzimi i kërkesës së tij për kompensim mbi bazën e këtyre gjetjeve vetëm sa e acaroi gjendjen. Në përfundim, Gjykata vendosi që arsyet e dhëna nga Gjykata e Desniansky, kombinuar me refuzimin e kërkesës së tij për kompensim mbi bazën e atyre arsyeve, dhunonin prezumimin e pafajësisë dhe shkelnin Nenin 6 § 2.

Neni 13

Gjykata shqyrtoi nëse kishte zgjidhje efektive për bastisjen e paligjshme të zyrës së kërkuesit. Ndërkohë që ai mund të kishte kërkuar një deklaram nga një

prokuror më i lartë që bastisja ishte e paligjshme, kjo zgjidhje nuk do t'i kishte ofruar atij ndonjë lehtësim. Mundësia për të kërkuar kompensim për ndjekje penale të paligjshme nuk zbatohet këtu sepse pretendimi i kërkuesit u refuzua mbi bazën e faktit që procedura penale ishte përfunduar mbi baza jo-shfajësuese. Më tej, procedura penale nuk mund të vlerësonte ligjshmërinë e bastisjes, pasi ishte përfunduar në fazën paragyqësore.

Pas kësaj, Gjykata shqyrtoi nëse kishte zgjidhje efektive për zbulimin e informacionit psikiatrik të kërkuesit. Mundësia e një seance dëgjimore in camera për çështjen nuk mund të kishte qasje të kufizuar në dosjen e lëndës e as nuk mund të kishte siguruar konfidencialitetin e informacionit të zbuluar gjatë seancave. Ishte domethënëse që Gjykata e Apelit nuk e ndërpreu zbulimin e informacionit psikiatrik konfidencial dhe as nuk caktoi kompensim për kërkuesin, pavarësisht nga gjetja që zbulimi ishte i paligjshëm.

Prandaj, ka pasur shkelje të Nenit 13 për faktin se ai nuk ka pasur zgjidhje efektive për të zbatuar të drejtën e tij për jetë private dhe shtëpiake sipas Nenit 8.

Neni 41

Gjykata e caktoi kërkuesit shumën 2,315 Euro për dëme materiale dhe shumën 3,000 Euro për dëme jomateriale.

Pretendimet që financimi i pamjaftueshëm i Shtetit për trajtimin mjekësor të kërkuësve ka shkelur Konventën deklarohen të papranueshme

VENDIMI NË ÇËSHTJEN PENTIACOVA DHE TË TJERË k. MOLDAVISË

(Kërkesa Nr. 14462/03)

4 janar 2005

1. Faktet kryesore

Kërkuësit vuanin nga dështimi renal kronik (bllokimi i veshkave) që kërkonte trajtim me hemodializë të cilin ata e morën në spitalin Chişinău ("SCR"). Të gjithë ata morën pagesë paaftësie mes 60 Leva moldave ("MDL") dhe 450 MDL (të barasvlershme me rreth 4 Euro deri në 27 Euro në atë kohë). Ata parashtruan që, para vitit 1997, trajtimi i tyre me hemodializë ishte mbuluar tërësisht nga Shteti, por që prej vitit 1997 deri në vitin 2004 vetëm trajtimi dhe mjekimet e kërkuara pa tjetër u ofruan falas. Prej 1 janarit 2004 Moldavia futi një sistem të ri të sigurimeve shëndetësore ("reforma e vitit 2004") pas të cilit kërkuësit i morën pothuajse tërë mjekimet e tyre falas.

Kërkuësit parashtruan që në Shtetet e Bashkuara, Kanada dhe vendet e Bashkimit Evropian, pacientët me dështim renal bënë tri seanca hemodialize në një total prej 9 orësh në javë. Moldavia ofronte të njëjtin nivel trajtimi para vitit 1997. Megjithatë, pas vitit 1997 pacientët moldavë bënë vetëm dy seanca hemodialize në total 8 orë në javë, dhe vetëm ata që ishin "në gjendje fizike të keqe" lejoheshin të bënin seancën e tretë të hemodializës. Më tej, ata pretenduan që pagesa e paaftësisë që merrnin ishte e pamjaftueshme për të mbuluar koston e mjekimit që ishte e nevojshme për hemodializë, dhe që për këtë arsye ata përjetonin dhimbje dhe vuajtje të padurueshme. Sipas kërkuësve, disa pacientë refuzuan të bënin trajtimin pa mjekim, dhe për pasojë vdiqën. Në fund, disa prej kërkuësve që jetonin në provinca pretenduan që nuk ishin rimbursuar për shpenzimet e udhëtimit të tyre për në Chişinău për të marrë hemodializën, pavarësisht se autoritetet vendase e praktikonin një gjë të tillë.

Në vitin 2003, tridhjetedy mjekë të repartit të hemodializës në SCR firmosën një letër drejtuar kërkuësve dhe disa gazetave të Chişinău ku deklarorin që shifrat e vdekjeve të pacientëve me dështim renal kishin rënë dhjetëfish prej vitit 1980 dhe që financimi i tyre nga Shteti ishte rritur trefish gjatë dy viteve të fundit.

Gjithashtu ata deklaruan që pacientët merrnin të njëjtin trajtim si pacientët e spitaleve të tjera të Chişinău.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesit pretenduan se dështimi i Shtetit për të financuar trajtimin me hemodializë kishte shkelur të drejtën e tyre për jetë sipas Nenit 2 të Konventës dhe u kishte shkaktuar atyre vuajtje në kundërshtim me Nenin 3. Gjithashtu ata pretenduan që shpeshherë atyre u duhej të shpenzonin paratë e familjeve për trajtimin e tyre, gjë që ndërhynte tek e drejta e tyre për jetë familjare sipas Nenit 8. Me tej, ata pretenduan se standardi i kujdesit ndaj tyre ishte më i keq se ai i pacientëve në një spital tjetër të Chişinău i financuar nga buxheti lokal dhe që pengesat administrative i ndalonin ato që nuk ishin banorë të Chişinău nga kërkimi i trajtimit aty në kundërshtim me Nenin 14 në lidhje me Nenet 2, 3 dhe 8. Në fund, ata u ankuan që nuk kishin qasje në zgjidhje efektive në kundërshtim me Nenin 13.

Neni 8

Megjithëse kërkuesit e tërhoqën ankesën pa shpjegim, Gjykata përsëriti se ishte ajo që bënte karakterizimin ligjor të fakteve në një çështje, dhe e konsideroi të nevojshme të shqyrtonte si mungesën e financimit shtetëror të hemodializës ashtu edhe dështimin e autoriteteve vendase për të mbuluar shpenzimet e udhëtimit të kërkuesve në kuadër të së drejtës së tyre për respekt ndaj jetës private.

Shtetet kanë detyrimin pozitiv për të parandaluar ndërhyrjen arbitrare tek e drejta e individëve për jetën private dhe familjare. Në fund të fundit, ato duhet të gjejnë një ekuilibër të drejtë mes interesave të individëve dhe komunitetit në tërësi. Konventa nuk garanton të drejtën për kujdes mjekësor falas. Megjithatë, Gjykata më herët kishte deklaruar që Neni 8 është i aplikueshëm në ankesat rreth financimit publik në lidhje me integritetin fizik dhe psikologjik të pacientëve të paaftë. Prandaj, ajo gjeti që Neni 8 aplikohej tek ankesat e kërkuesve rreth financimit të pamjaftueshëm të trajtimit të tyre.

Gjykata njohu vështirësitë që supozohej të kishin përjetuar kërkuesit si dhe përmirësimet shumë reale që do të sillte mbulimi i plotë i shpenzimeve për jetën e tyre private dhe familjare. Megjithatë, duke pasur parasysh që autoritetet nacionale i njihnin mirë kërkesat e sistemit të kujdesit shëndetësor dhe buxhetin publik të tij, ato ishin në pozicion më të favorshëm për të vendosur në lidhje me

shpërndarjen e fondeve të kufizuara të Shtetit. Prandaj, hapësira e vlerësimit që kanë Shtetet në këso rastesh ishte e gjerë. Megjithëse ishte e dëshirueshme që të gjithë pacientët të kishin qasje të plotë në trajtim mjekësor jetëshpëtues, burimet e kufizuara nënkuptonin që kjo nuk ishte gjithmonë e mundur, posaçërisht në rastet e trajtimeve të përhershme dhe të shtrenjta. Ajo shënoi që kërkuesve u ishte ofruar kujdesi i përshtatshëm bazik mjekësor dhe mjekimi bazik para reformës së vitit 2004 dhe pas kësaj atyre u ishte ofruar pothuajse kujdes mjekësor i plotë. Prandaj Shteti nuk kishte dështuar në gjetjen e ekuilibrit të drejtës mes interesave të tyre dhe interesave të komunitetit në tërësi. Më tej, duke marrë parasysh se situata e kërkuesve ishte përmirësuar konsiderueshëm pas reformës së vitit 2004, Shteti nuk kishte dështuar në realizimin e detyrimit të vet pozitiv sipas Nenit 8. Për këto arsye, Gjykata e refuzoi ankesën si dukshëm të pabazuar.

Neni 2

Neni 2 është relevant kur një Shtet ka marrë përsipër të ofrojë kujdes shëndetësor publik dhe mohimi i tij vë në rrezik jetën e një individi. Megjithatë, kërkuesit nuk arritën të paraqisnin prova që jeta e tyre ishte vënë në rrezik. Gjykata shënoi që dështimi renal kronik ishte sëmundje progresive e cila kishte përqindje të larta vdekshmërie në tërë botën. Prandaj, pretendimi që një numër pacientësh kishin vdekur nuk ishte i mjaftueshëm për të demonstruar dështimin në mbrojtjen e të drejtës për jetë pa prova që kjo ishte shkaktuar nga mungesa e kujdesit të duhur mjekësor. Sa u përket detyrimeve pozitive të Shtetit, Gjykata gjeti se nuk kishte arsye që të distancohej prej konkluzioneve të saj sipas Nenit 8. Për pasojë, Gjykata e refuzoi këtë pjesë të kërkesës si dukshëm e pabazuar.

Neni 3

Duke pasur parasysh gjetjet e saj nga Neni 8, Gjykata konsideroi se nuk dilte asnjë çështje e ndarë sipas Nenit 3.

Neni 13

Neni 13 garanton zgjidhje efektive në vend për t'i dhënë përgjigje një ankese të argumentueshme sipas Konventës. Kërkuesit nuk kishin ngritur ankesa të argumentueshme sipas Konventës, dhe prandaj Gjykata deklaroi që kjo pjesë e kërkesës ishte e papranueshme.

Neni 14 në lidhje me Nenin 2 dhe 3

Kërkuesit nuk kishin parashtruar prova që tregonin se spitali tjetër në Chişinău ishte i financuar më mirë dhe ofronte trajtim më të mirë. Prandaj, Gjykata deklaroi që kjo pjesë e kërkesës ishte gjithashtu e papranueshme.

Kateterizimi i detyruar i kërkuesit për të marrë prova të përfshirjes së tij në një vepër lidhur me drejtimin e automjetit nën efektin e alkolit ka shkëlur Nenin 3

VENDIMI NË ÇËSHTJEN R.S. k. HUNGARISË

(Kërkesa Nr. 65290/14)

2 korrik 2019

1. Faktet kryesore

Kërkuesi ishte i lindur në vitin 1980 dhe jetonte në Püspökladány. Më 6 mars 2010, ai u përfshi në një përlëshje jashtë një klubi nate, me gjasë nën ndikimin e drogës dhe alkolit. Më pas, ai u ndalua nga policia në makinën e tij, refuzoi të bënte testin e frymës me tubin matës të alkolit, dhe u arrestua për t'u marrë në pyetje.

Ai u dërgua në spital nga katër policë për të bërë testin e gjakut dhe të urinës. Kur arritën aty, ai i tha mjekut se nuk ishte në gjendje të urinonte. Me kërkesë të policëve, mjeku i vuri kateterin dhe bëri testin e gjakut teksa kërkuesi ishte me duar në pranga. Më pas kërkuesi u gjobit për mos-bashkëpunim me masat e ligjshme policore. Megjithatë, ai vendim u zbraps për shkak se masa policore nuk ishte e ligjshme sepse procedura ishte zhvilluar pa pëlqimin me shkrim të kërkuesit, siç kërkohet nga ligjet vendase.

Më 6 mars 2010, kërkuesi bëri ankesë penale kundër policëve. Autoritetet morën në pyetje një mjek, një infermier, një shofer dezurn në spital, kërkuesin, dhe policët. Kërkuesi deklaroi që ai nuk kishte dhënë pëlqimin e tij për procedurën, dhe pretendoi që ishin përdorur lidhëset e këmbëve. Megjithatë, policia pretendoi që ai e kishte dhënë pëlqimin dhe kishte filluar të protestonte vetëm pasi kishte nisur procedura. Të gjithë dëshmitarët qenë dakord që kërkuesi kishte qenë i intoksikuar. Autoritetet konkluduan që kërkuesi e kishte dhënë pëlqimin për vendosjen e kateterit.

Kërkuesi nisi procedurë administrative kundër atij vendimi çka u rrëzua në korrik 2014. Gjatë kësaj procedure, u komisionua një opinion eksperti mjekësor i cili deklaroi që nuk kishte qasje të qartë mjekësore për kateterizimin dhe as nuk kishte konsensus nëse ishte procedurë invazive apo jo-invazive.

Në nëntor 2011, kërkuesi u dënua për sjellje të rrëmujshme, drejtim automjeti nën ndikimin e alkolit, dhe për dhunë kundër një zyrtari policor.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi u ankua që marrja e mostrës së urinës përmes kateterizimit përbënte trajtim çnjerëzor dhe poshtëruës sipas Nenit 3 dhe ndërhynte në jetën e tij private sipas Nenit 8.

Neni 3

Për të qenë brenda fushëveprimit të Nenit 3, "keqtrajtimi" duhet të arrijë një nivel minimal rreptësie. Në këtë rast, kërkuesi ishte kufizuar fizikisht nga policia për t'iu nënshtruar një procedure mjekësore invazive. Një ndërhyrje e tillë do të kishte shkaktuar ndjenja pasigurie, ankth dhe stres për kërkuesin. Gjykata konkludoi që trajtimi e kishte arritur nivelin minimal të rreptësisë që kërkohet dhe prandaj ishte brenda fushëveprimit të Nenit 3. Si i tillë, kundërshtimi i Qeverisë për papajtueshmëri racionae materiae u rrëzua.

Neni 3 nuk e ndalon përdorimin e një procedure mjekësore që sfidon vullnetin e një të dyshuari për të marrë prova të përfshirjes së tij në një vepër penale. Megjithatë, përdorimi i ndërhyrjes mjekësore të detyruar duhet të jetë i justifikuar nga faktet e çështjes. Vendimi i autoriteteve duhet të informohet nga pesha e veprës, çdo rrezik që mund t'i kanoset shëndetit të të dyshuarit, dhe nga procedurat alternative në dispozicion.

Palët kontestuan mënyrën se si u zhvillua kateterizimi dhe nëse kërkuesi e kishte dhënë pëlqimin për të. Gjykata së pari shënoi që nuk kishte praktikë të vendosur apo ndonjë ligj vendas që qeveriste përdorimin e kateterizimit për të marrë prova të përfshirjes së një personi në një vepër. Megjithëse autoritetet kishin ndërhyrë tek personat e përfshirë, ato i dhanë preferencë versionit të ngjarjeve të ofruar nga policët. Megjithatë, Gjykata dyshonte nëse kërkuesi kishte pasur mundësi tjetër përveç nënshtrimit ndaj procedurës duke marrë parasysht që ai ishte nën kontroll të plotë të policëve. Më tej, sipas ligjeve vendase ai kishte të drejtë të tërhiqte pëlqimin e tij në çdo kohë. Ishte e qartë se ai e kishte bërë një gjë të tillë, meqenëse ai kishte rezistuar deri në momentin kur policëve u ishte dashur ta mbanin të mbërthyer për të kompletuar procedurën. Kështu, kërkuesi nuk kishte dhënë pëlqimin e lirë dhe të informuar gjatë tërë procedurës.

Ky rast mund të dallonte nga situatat kur ndërhyrja konsiderohet e rëndësishë së vogël duke marrë parasysht natyrën ndërfitëse të kateterizimit. Për më tepër, megjithëse procedura u zhvillua nga një mjek, kërkuesi i kishte pasur duart të

lidhura me pranga dhe ishte mbajtur nga policia gjatë tërë kohës. Ndërkohë që u pranua se ishte e nevojshme të përcaktohej niveli i alkolit në gjak të kërkuesit, vetë kateterizimi ishte i panevojshëm meqenëse policët kishin marrë gjithashtu edhe mostrën e gjakut.

Duke pasur parasysh raportin ekspert mjekësor të komisionuar gjatë procedurës administrative, Gjykata konsideroi që nuk ishte konstatuar që procedura nuk ngërthente ndonjë rrezik të mundshëm për shëndetin e kërkuesit. Nuk kishte prova për të vërtetuar që policët e kishin marrë në konsideratë një rrezik të tillë.

Në përfundim, autoritetet e kishin nënshtruar atë ndaj një ndërhyrjeje serioze në integritetin e tij fizik dhe mendor kundër vullnetit të tij, në mënyrë që të merrnin prova të cilat mund të merreshin po ashtu përmes mostrës së gjakut. Mënyra se si ishte zhvilluar procedura linte vend për të shkaktuar tek ai ndjenja pasigurie, ankthi, dhe stresi të cilat ishin në gjendje ta poshtëronin dhe ta ulnin atë. Prandaj, ai i ishte nënshtruar trajtimit çnjerëzor dhe poshtërues. Rrjedhimisht, Gjykata deklaroi që kishte pasur shkelje të Nenit 3.

Neni 8

Pasi konkludoi që kishte pasur shkelje të Nenit 3, Gjykata konsideroi që nuk ishte e nevojshme të shqyrtohej ndaras ankesa e bërë sipas Nenit 8.

Neni 41

Gjykata i caktoi kërkuesit 9,000 Euro në lidhje me dëme jomateriale dhe 4,080 Euro për kosto dhe shpenzime.

Vaksinimi i kërkuesit kundër dizenterisë nuk ka shkelur Nenin 8 meqenëse ishte i nevojshëm për të kontrolluar përhapjen e sëmundjes infektive dhe për të vlerësuar përshtatshmërinë e vaksinimit për të u morën masa

VENDIMI NË ÇËSHTJEN SOLOMAKHIN k. UKRAINËS

(Kërkesa Nr. 24429/03)

15 mars 2012

1. Faktet kryesore

Kërkuesi ishte shtetas ukrainas. Ai ishte i lindur në vitin 1964 dhe vdiq në shtatë 2010, kur nëna e tij vendosi të bënte kërkesën në emër të tij.

Në nëntor 1998, kërkuesi kërkoi ndihmë mjekësore nga Spitali Nr. 16 i Qytetit Donetsk, ku u diagnostikua me një sëmundje respiratore akute dhe iu dha trajtim si pacient i jashtëm. Pesë ditë më pas, ai u vaksinua kundër dizenterisë pasi nuk kishte treguar prekshmëri ndaj antigjenëve të saj. Sipas kërkuesit, vaksinimi kishte kundërrindikacione për të.

Prej dhjetorit 1998, kërkuesi kaloi më shumë se gjysmë viti në institucione të ndryshme mjekësore, duke marrë trajtim për disa sëmundje kronike përfshirë pankreatit,olecistit, hepatit dhe kolit. Në shkurt 1999, Mjeku Kryesor i Spitalit qortoi stafin mjekësor për vaksinimin e kërkuesit, duke pasur parasysh kundërshtimet e tij të mëparshme dhe faktin që ai ishte duke u trajtuar për sëmundje respiratore akute, duke sugjeruar njëkohësisht që ata kishin shkelur rregullat e vaksinimit.

Në prill 1999, kërkuesi nisi procedurën pranë Gjykatës së Rrethit Budyonovskiy kundër departamentit lokal të shëndetësisë publike, duke kërkuar kompensim për dëmet ndaj shëndetit të tij. Ai pretendoi që vaksinimi i tij kishte rezultuar me sëmundje kronike sepse i ishte dhënë gjatë kohës kur ai ishte i sëmurë. Ai gjithashtu pretendoi se vaksinimi ishte i cilësisë së dobët, i pacertifikuar, kishte skaduar, ishte ruajtur në një mënyrë të papërshtatshme, dhe pretendoi që mjekët u përpoqën të falsifikonin të dhënat e tij për të fshehur efektet negative të vaksinimit. Në qershor 2003, gjykata gjeti kundër kërkuesit, prova eksperte që nuk demonstroi lidhje shkakësore mes vaksinës dhe sëmundjeve të tij. Gjykata shënoi që situata epidemiologjike në rajonin e Donetskit kërkonte vaksinim, dhe ai nuk kishte shfaqur shenja reaksioni, nuk kishte pasur simptoma akute të ndonjë sëmundjeje

kur u vaksinua, dhe ndaj tij nuk ishte përdorur forcë fizike, ai ishte me mendje të kthjellët dhe mund ta kishte refuzuar vaksinimin. Megjithëse vaksinimi nuk ishte kryer në një dhomë të caktuar për këtë qëllim, siç kërkohet nga rregullorja, ai i kishte përmbushur të gjitha kushtet e tjera. Pretendimet kundër cilësisë së vaksinës dhe të dhënave u refuzuan si të pabazuara. Ky gjykim u mbështet nga Gjykata Supreme në gusht 2008.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi u ankua që kohëzgjatja e procedurave ishte në mospërputhje me kriterin e kohës së arsyeshme sipas Nenit 6 § 1. Më tej, ai u ankua, sipas Nenit 2, që vakina kishte rezultuar tek ai me vuajtjen e disa sëmundjeve kronike, gjë që Gjykata vendosi ta shqyrtonte sipas Nenit 8.

Neni 6 § 1

Gjykata përsëriti që arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurave duhet të vlerësohej nën dritën e rrethanave të çështjes dhe duke iu referuar kritereve në vijim: kompleksitetit të çështjes, sjelljes së kërkuesit dhe autoriteteve përkatëse. Ajo shënoi se shpeshherë kishte gjetur shkelje të Nenit 6 § 1 në çështje që ngrinin probleme të ngjashme.

Megjithëse çështja në fjalë ishte komplekse dhe kërkonte ekzaminim mjekoligjor të sëmundjeve të kërkuesit, një kompleksitet i tillë nuk mund të justifikonte kohëzgjatjen e procedurave të cilat morën mbi nëntë vjet për tri shkallë të juridiksionit, përfshirë thujtë pesë vjet para gjykatës së apelit. Duke pasur parasysh praktikën e saj gjyqësore në lidhje me këtë temë, Gjykata konsideroi që kohëzgjatja e procedurave kishte qenë e tepërt dhe kishte dështuar të përmbushte kriterin e "kohës së arsyeshme". Prandaj, ajo vendosi që kishte shkelje të Nenit 6 § 1.

Neni 8

Gjykata përsëriti që praktika e mëhershme gjyqësore kishte konstatuar që vaksinimi i detyrueshëm përbënte ndërhyrje në të drejtën për respekt ndaj jetës private sipas Nenit 8, dhe nuk kontestohet që kishte pasur ndërhyrje në jetën private të kërkuesit. Administrimi i vaksinës ishte i parashikuar qartë në ligj dhe kishte qëllimin legjitim të mbrojtjes së shëndetit. Kështu, fokusi ishte tek nevojshmëria e tij në një shoqëri demokratike.

Ajo deklaroi që ndërhyrja mund të thuhet se justifikohet nga konsideratat e shëndetit publik dhe nevoja për të kontrolluar përhapjen e sëmundjeve infektive në rajon. Më tej, sipas gjetjeve të gjykatës vendase, stafi mjekësor e kishte kontrolluar përshtatshmërinë e kërkuarit për vaksinim para se ta vaksinonin, çka sugjeronte se ishin marrë masat e nevojshme paraprake për t'u siguruar që vakcina nuk do t'i bënte dëm deri në atë masë sa të çrregullonte ekuilibrin e interesave mes integritetit të tij personal dhe interesit publik të mbrojtjes së shëndetit të popullatës. Kërkuari po ashtu dështoi të shpjegonte se çfarë e kishte penguar ta kundërshtonte vaksinimin, kur më përpara ai kishte kundërshtuar në disa raste. Gjykata konsideroi që nuk kishte prova përpara për të vërtetuar që vaksinimi në fjalë faktikisht e kishte dëmtuar shëndetin e kërkuarit.

Gjithashtu ajo shënoi që pretendimet e kërkuarit ishin shqyrtuar thellësisht nga gjykatat vendase dhe ishin gjetur të pabazuara. Ato gjetën vetëm një parregullsi të parëndësishme në procedurë: kryerja e vaksinimit jashtë dhomës së përcaktuar. Kjo, gjetën ato, nuk e prekte në asnjë mënyrë shëndetin e kërkuarit. Ato gjithashtu konstatuan, mbi bazën e shumë raporteve eksperte mjekësore, që asnjëri prej efekteve të njohura anësore të vaksinimit nuk ishin shfaqur te kërkuari. Gjetjet e gjykatave vendase u bazuan mbi një sasi të madhe të të dhënave mjekësore të mbledhura sipas mocionit të kërkuarit dhe të gjykatave. Ato dukej se ishin mbështetur mbi baza të mjaftueshme provash dhe konkluzionet e tyre nuk u konsideruan arbitrare apo dukshëm të paarsyeshme. Më tej, kërkuari nuk paraqiti prova për t'i kundërshtuar këto gjetje të autoriteteve vendase.

Prandaj Gjykata nuk gjeti shkelje të Nenit 8.

Neni 41

Gjykata i caktoi nënës së kërkuarit 2,400 Euro në lidhje me dëme jomateriale dhe 100 Euro për kosto dhe shpenzime.

Mos-shkelja e nenit 8 kur Shteti zbatoi vaksinimin e detyrueshëm për fëmijët dhe opinionin kritik rreth vaksinimit nuk përbën bindje ose besim në një shkallë të mjaftueshme serioziteti për të hyrë brenda nenit 9

VENDIMI I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN VAVŘIČKA DHE TË TJERË K. REPUBLIKËS ÇEKE

(Kërkesa Nr. 47621/13)

8 prill 2021

1. Faktet kryesore

Z. Pavel Vavřička, znj. Markéta Novotná, z. Pavel Hornych, z. Radomír Dubský, z. Adam Brožík dhe z. Prokop Roleček ("kërkuesit") ishin të gjithë shtetas çekë.

Në Republikën Çeke, Ligji për Mbrojtjen e Shëndetit Publik kërkonte që të gjithë qytetarët t'u nënshtroheshin vaksinimeve rutinore në përputhje me legjislacionin dytësor. Për fëmijët nën moshën pesëmbëdhjetë vjeç, përfaqësuesit e tyre statutorë ishin përgjegjës për përmbushjen e këtij detyrimi. Ligji për Mbrojtjen e Shëndetit Publik gjithashtu thoshte se objektet parashkollore mund të pranenin vetëm fëmijët të cilët i kishin marrë vaksinat e kërkuara ose të cilët ishin certifikuar si të përjashtuar nga vaksinat për arsye shëndetësore. Ligji për Kundërvajtje u aplikojë personave që shkelnin një ndalesë ose dështonin të vepronin në përputhje me një detyrim të vendosur për të parandaluar sëmundjet infektive, i dënueshëm me gjobë.

Z. Pavel Vavřička u gjet fajtor për një vepër sipas Ligjit për Kundërvajtje për dështimin për të vepruar në përputhje me një urdhër për t'i sjellë dy fëmijët e tij tek një qendër shëndetësore për t'i vaksinuar ato kundër poliomielitit, hepatitit B dhe tetanozit. Ai u gjobit dhe u urdhërua të paguante koston (barasvlershëm me 110 Euro). Kërkuesi e kontestoi vendimin në shkallën administrative dhe para Gjykatës Kushtetuese mbi bazën se detyrimi për t'i vaksinuar fëmijët e tij ishte në kundërshtim me të drejtat dhe liritë e tij themelore, në mënyrë të veçantë e drejta për të refuzuar ndërhyrjen mjekësore dhe e drejta për të mbajtur dhe manifestuar besimet fetare dhe filozofike. Kontestet e kërkuesit u rrëzuan, *inter alia*, mbi bazën se interesat e mbrojtjes së shëndetit publik peshonin më shumë sesa e drejta e kërkuesit për të manifestuar fenë ose besimin e vet.

Kërkuesit e tjerë ishin fëmijë, prindërit e të cilëve kishin refuzuar t'i vaksinonin ato kundër poliomielitit, hepatitit B dhe sëmundjeve të tjera. Për shkak të kësaj, pranimi i tyre në çerdhe ishte refuzuar ose ishte tërhequr në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Shëndetit Publik. Kërkuesit i kontestuan vendimet përmes gjykatave administrative dhe Gjykatës Kushtetuese. Kontestimet e tyre u rrëzuan, *inter alia*, mbi bazën se detyrimi i vaksinimit synonte qëllimin legjitim të mbrojtjes së shëndetit publik.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesit pretenduan se pasojat e ndryshme për mos-veprimin e tyre në përputhje me detyrimin statutor për vaksinim kishin qenë në mospajtueshmëri me të drejtën e tyre për respekt ndaj jetës së tyre private sipas nenit 8 të Konventës.

Neni 8

Gjykata e përmbloodhi lëndën e ankesave të kërkuesve me detyrimin për vaksinim i imponuar atyre dhe me pasojat e mos-veprimit të tyre në përputhje me të. Gjykata u mbështet tek praktika e vendosur gjyqësore për të gjetur se vaksinimi i detyrueshëm, si ndërhyrje mjekësore e pavullnetshme, përfaqëson ndërhyrje tek e drejta për respekt ndaj jetës private sipas nenit 8. Megjithatë në këtë rast kërkuesit nuk ishin vaksinuar, fakti që kërkuesit bartnin pasojat direkte të mos-veprimit në përputhje me detyrimin e vaksinimit nënkuptonte se Gjykata ishte bindur që kishte pasur ndërhyrje tek e drejta e tyre për respekt ndaj jetës private.

Më pas Gjykata shqyrtoi nëse ndërhyrja mund të justifikohet mbi bazën se ajo: së pari, ishte në përputhje me ligjin; dhe, së dyti, synonte një qëllim legjitim i cili ishte i nevojshëm në një shoqëri demokratike. Në lidhje me bazën e parë, Gjykata që e bindur se ndërhyrja ishte në përputhje me ligjin. Detyrimi i vaksinimit bazohej specifikisht në Ligjin për Mbrojtjen e Shëndetit Publik, dhe pasojat e veprimit në mospërputhje me të rridhnin nga Ligji për Kundërvajtje. Në lidhje me bazën e dytë, Gjykata njohu se qëllimi i detyrimit të vaksinimit ishte mbrojtja kundër sëmundjeve të cilat mund të përbënin rrezik serioz ndaj shëndetit, si për ata që i merrnin vaksinat, ashtu edhe për ata që nuk i merrnin. Ky objektiv përputhej me qëllimet e mbrojtjes së shëndetit dhe mbrojtjes së të drejtave të të tjerëve, që njihen nga neni 8.

Në lidhje me faktin nëse ndërhyrja ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike, Gjykata konsideroi se politikat e kujdesit shëndetësor hyjnë brenda hapësirës së vlerësimit të Shtetit. Autoritetet vendase janë në pozitën më të mirë për të vlerësuar prioritetet, shfrytëzimin e burimeve dhe nevojat e shoqërisë. Gjykata theksoi se, megjithëse detyrimi i vaksinimit mund të ketë lidhje me gëzimin efektiv nga një individ i të drejtave të tij intime, pesha e kësaj konsiderate pakësohej nga fakti që asnjë vaksinë nuk u bë kundër vullnetit të kërkuesve, dhe po ashtu ligji vendas nuk lejonte që detyrimi të imponohej me forcë. Më tej, mes Palëve Kontraktuese kishte konsensus të përgjithshëm që vaksinimi është një prej ndërhyrjeve shëndetësore më të suksesshme dhe me kosto efektive, dhe që secili Shtet duhet të synonte shkallë të larta vaksinimi në popullatën e vet.

Gjykata njohu se në mesin e Palëve Kontraktuese të Konventës nuk kishte një model të vetëm të vaksinimit të fëmijëve. Përkundrazi, eksistonte një spektër i tërë i politikave, të cilat shkonin prej atyre që bazoheshin tërësisht në rekomandime, ato që bënin një ose disa vaksinime të detyrueshme, e deri tek ato që e quanin detyrim ligjor vaksinimin e plotë të fëmijëve. Republika Çeke ishte e pozicionuar në anën më preskriptive të spektrit, një pozicion i mbështetur dhe i përfaqësuar nga tri qeveri ndërhyrëse (Franca, Polonia dhe Sllovakia). Gjykata vuri në dukje se ekzistonte një tendencë në rritje mes Shteteve Kontraktuese drejt një qasjeje më preskriptive si kundërveprim ndaj uljes së imunitetit të masës i shkaktuar nga skemat vullnetare të vaksinimit.

Gjykata pranoi se bërja e vaksinimit të fëmijëve detyrim ligjor mund të ngrinte çështje të ndjeshme morale ose etike, por që kjo ndjeshmëri nuk kufizohej me ata që nuk ishin dakord me detyrimin e vaksinimit. Ajo përfshinte vlerën e solidaritetit shoqëror për të mbrojtur shëndetin e të gjithë anëtarëve të shoqërisë, sidomos atyre që janë posaçërisht të cenueshëm. Për këto arsye, Gjykata konsideroi se Shteti kishte hapësirë të gjerë vlerësimi në lidhje me këtë çështje.

Gjykata përsëriti se Shtetet kanë detyrimin pozitiv sipas neneve 2 dhe 8 që të marrin masat e duhura për të mbrojtur jetën dhe shëndetin e personave brenda juridiksioneve të tyre. Gjykata konsideroi se detyrimi i vaksinimit përfaqëson përgjigjen e Shtetit ndaj nevojës urgjente shoqërore për të mbrojtur shëndetin individual dhe publik kundër sëmundjeve dhe për të ofruar mbrojtje kundër çdo tendence për rënie të nivelit të vaksinimit të fëmijëve. Kjo qasje e detyrueshme ndaj vaksinimit mbështetet nga arsye relevante dhe të mjaftueshme. Ekzistonte një arsyeshmëri e shkallës së lartë në aspektin e shëndetit publik, mbi të cilën mbështetet zgjedhja e politikave, kryesisht efikasiteti i vaksinimit të fëmijëve dhe

fakti se sa i sigurt ishte ai. Gjykata theksoi se detyrimi i vaksinimit kishte të bënte me nëntë sëmundje kundër të cilave vaksinimi konsiderohej efektiv dhe i sigurt nga komuniteti shkencor, dhe Qeveria Çeke vuri në dukje se detyrimi i vaksinimit ishte i bazuar mbi të dhëna që përfshinin sondazhe serologjike të cilat ishin zhvilluar qysh në vitet 1960. Më tej, Shtetet kishin detyrimin që të vinin interesat e fëmijës, dhe ato të fëmijëve si grupacion, në qendër të vendimeve lidhur me shëndetin dhe zhvillimin e tyre. Kështu, kur Shteti e sheh vaksinimin vullnetar si të pamjaftueshëm për të arritur dhe ruajtur imunitetin e masës, autoritetet vendase me arsye mund të fusin politika të vaksinimit të detyrueshëm për të arritur nivelin e duhur të mbrojtjes kundër sëmundjeve të rënda.

Në fund, Gjykata konsideroi nëse ndërhyrja tek të drejtat e kërkuesve nga neni 8 ishte proporcionale me qëllimin e synuar. Gjykata vuri në dukje se sistemi kombëtar i vaksinimit lejonte përjashtime për fëmijët që kishin kundër-indikacione të përhershme ndaj vaksinimit si dhe të drejtën për "kundërshtim laik të ndërgjegjes", që mund të përdorej për të kontestuar gjobën ose refuzimin për të pranuar një fëmijë në çerdhe. Më tej, ndërkohë që vaksinimi ishte detyrim ligjor, të vepruarit në përputhje me këtë detyrim nuk imponohej direkt, për shembull përmes administrimit me forcë. Përkundrazi, detyrimi zbatohej në mënyrë indirekte përmes sanksioneve, të cilat Gjykata i shihte si relativisht të moderuara në formën e një gjobe administrative. Në lidhje me mos-pranimin në çerdhe, Gjykata gjeti se kjo pasojë e mos-përputhjes ishte me karakter mbrojtës, e jo ndëshkues, meqenëse ajo synonte të mbronte shëndetin e fëmijëve të vegjël. Gjykata po ashtu gjeti se ekzistonin mbrojtje procedurale kuptimplote për kërkuesit, të cilat i lejonin ata që të ngrinin apele administrative dhe të kërkonin zgjidhje juridike.

Kërkuesit gjithashtu u ankuan për efektivitetin dhe sigurinë e vaksinimeve, duke shprehur shqetësim të madh rreth efekteve anësore potenciale për shëndetin. Gjykata sërish iu referua konsensusit të përgjithshëm në lidhje me rëndësinë jetike të vaksinave për mbrojtjen kundër sëmundjeve që mund të kenë efekt të rëndë mbi shëndetin individuale dhe të cilat në rastet e epidemive serioze mund të shkaktojnë çrregullime në shoqëri. Në lidhje me sigurinë, Gjykata njohu se kishte rreziqe shumë të rralla por serioze për shëndetin e individëve nga vaksinat. Megjithatë, Gjykata nuk gjeti arsye të vinte në pyetje përshtatshmërinë e sistemit vendas, i cili bënte monitorimin e vazhdueshëm të sigurisë së vaksinave që përdorëshin nga autoritetet kompetente.

Gjykata vazhdoi me shqyrtimin e intensitetit të ndërhyrjes së kontestuar tek gëzimi nga kërkuesit i të drejtës së tyre për respektim të jetës private. Gjykata

deklaroi se gjoba administrative që iu vu z. Vavříčka nuk ishte e tepruar në ato rrethana, dhe më tej nuk pati pasoja në edukimin e fëmijëve të kërkuesve. Për kërkuesit që ishin fëmijë, Gjykata gjeti se refuzimi ose tërheqja e regjistrimit në parashkollore nuk ishte joproporcionale. Megjithëse përjashtimi nga parashkollorja nënkuptonte humbjen e mundësisë për të fituar shkathtësi sociale dhe të të nxëniet, kjo humbje vinte si pasojë direkte e zgjedhjes së prindërve të tyre për të mos vepruar në përputhje me një detyrim ligjor i cili kishte për qëllim mbrojtjen e shëndetit të fëmijës. Nuk ishte joproporcionale që Shteti t'u kërkonte atyre për të cilët vaksinimi përfaqëson një rrezik të largët ndaj shëndetit që ta praninin këtë masë mbrojtëse të praktikuar universalisht si çështje e detyrimit ligjor dhe në emër të solidaritetit shoqëror, për hir të numrit të vogël të fëmijëve të cenusëshëm të cilët nuk mund të përfitojnë nga vaksinimi.

Në përmbyllje, Gjykata sqaroi se çështja relevante në këtë rast nuk ishte nëse mund të ishte ndërmarrë një politikë e ndryshme më pak preskriptive, por nëse, në arritjen e ekuilibrit, Shteti kishte qëndruar brenda hapësirës së tij të gjerë të vlerësimit. Gjykata deklaroi se Shteti nuk e tejkaloi hapësirën e tij të vlerësimit, dhe kështu që masa e kontestuar mund të shihet si "e nevojshme në një shoqëri demokratike". Rrjedhimisht, nuk pati shkelje të nenit 8.

Neni 9

Kërkuesit u ankuan se gjoba që iu vu z. Vavříčka dhe mos-pranimi në çerdhe i kërkuesve fëmijë ishte në kundërshtim me të drejtat e tyre nga neni 9. Kërkuesit u mbështetën në mbrojtjen e nenit 9 për qëndrimin e tyre kritik ndaj vaksinimit, në lidhje me lirinë e tyre të mendimit dhe ndërgjegjes. Gjykata iu referua praktikës gjyqësore të kaluar, e cila thoshte se detyrimi për t'u vaksinuar nuk ndërhynte tek liritë e mbrojtura në nenin 9, dhe përsëriti se jo të gjitha opinionet ose bindjet përbënin besime në kuptimin e mbrojtur nga neni 9.

Përveç kësaj, Gjykata theksoi se kërkuesit nuk kishin specifikuar ose vërtetuar më tej ankesat e tyre sipas nenit 9 përtej procedurave vendase, dhe gjeti që opinionin e tyre kritik ndaj vaksinimit nuk përbënte bindje ose besim me bindshmëri, seriozitet, kohezion dhe rëndësi aq të mjaftueshme sa të tërheqë garancitë e nenit 9. Prandaj, Gjykata deklaroi se ankesa ishte e papërputhshme *ratione materiae* me dispozitat e nenit 9 brenda kuptimit të nenit 35 § 3 (a) dhe ajo u refuzua në përputhje me nenin 35 § 4.

VII. Pëlqimi i informuar

Dështimi i autoriteteve për të siguruar zbatimin e duhur të skemës ligjore për mbrojtjen e të drejtës së pacientëve për jetë ka shkëlur Nenin 2

VENDIMI NË ÇËSHTJEN ALTUĞ DHE TË TJERË K. TURQISË

(Kërkesa Nr. 32086/07)

30 qershor 2015

1. Faktet kryesore

Kërkuesit ishin njëmbëdhjetë shtetas turq, të lindur mes viteve 1947 dhe 1980. Ata ishin të gjithë të afërm të Znj. Keşoğlu e cila vdiq si pasojë e reagimit alergjik ndaj penicilinës së administruar me injeksion në një spital privat në Bursa të Turqisë.

Znj. Keşoğlu u shtrua në spital privat në shkurt të vitit 2002 me dhimbje barku dhe tension të lartë gjaku. Mjekët në spital i parashkruan ampicilinë, një ilaç me bazë peniciline, i cili iu dha asaj përmes injeksionit intravenoz. Menjëherë ajo pësoi arrest kardiak dhe u dërgua në spitalin Universitar të Uludağ ku vdiq pas pak ditësh. Në mars të vitit 2002, të afërmit e Znj. Keşoğlu ngritën akuza kundër spitalit privat, mjekut të saj (S.Y.), dhe infermieres (D.G.) për vrasje pa paramendim dhe neglizhencë. Ata pretenduan se e kishin informuar ekipin mjekësor të Znj. Keşoğlu që ajo kishte alergji ndaj penicilinës dhe që, pasi ajo kishte pësuar reagim alergjik, stafi në spital kishte refuzuar t'u përgjigjej pyetjeve të tyre se çfarë përmbante injeksioni.

D.G. deklaroi që asaj i ishte thënë të administronte injeksionin e penicilinës nga S.Y., por që pas reagimit alergjik të Znj. Keşoğlu, ajo vuri re që penicilina ishte hequr me kryq nga receta e shkruar me dorë për të. D.G. pretendoi se S.Y. i kishte thënë ta mohonte që ajo kishte administruar penicilinën dhe që ai do të shtypte një recetë të ndryshuar e cila nuk përmendte penicilinën. S.Y. pranoi që ai fillimisht e kishte parashkruar penicilinën, por pastaj kishte vendosur të mos ia jepte dhe e kishte hequr nga receta, por ky ndryshim ishte injoruar nga infermierja.

Në raportin e datës 23 shtator 2002, Instituti i Mjekësisë Ligjore konkludoi që shkak i vdekjes ishte shok anafilaktik nga injektimi i penicilinës. Megjithatë, raporti thoshte që nuk mund t'ia atribuonte përgjegjësinë ekipit mjekësor duke

pasur parasysh reagimet alergjike fatale që shpesh mund të rezultojnë nga një ri-administrim i thjeshtë i një mjekimi tashmë të dhënë ose nga injektimi i një doze testuese. Ngjashëm, raporti i Këshillit Shëndetësor Kombëtar i datës 7 janar 2005 konkludoi që ekipi mjekësor kishte vepruar në përputhje me procedurat mjekësore përkatëse dhe nuk mbante përgjegjësi për vdekjen e Znj. Keşođlu. Pas dy gjykimeve liruese për të pandehurit, Gjykata e Kasacionit deklaroi që procedura penale ishte vjetëruar.

Procedurat penale të nisura nga kërkuesit në vitin 2002 u rrëzuan mbi bazën e një raporti ekspertësh të datës 25 shtator 2003 nga anëtarët e Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Stambollit. Kërkuesit apeluan pranë Gjykatës së Kasacionit pa sukses.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesit pretenduan se ekipi mjekësor nuk kishte vepruar në përputhje me detyrimet statusore për t'u konsultuar me Znj. Keşođlu dhe të afërmit e saj rreth historisë së saj mjekësore, për ta informuar atë për çdo rrezik të mundshëm të trajtimit mjekësor, dhe për të marrë pëlqimin e saj para trajtimit, në shkellje të Nenit 2 të Konventës. Ata gjithashtu pretenduan se procedurat për zgjidhje që kishin në dispozicion nuk ishin të drejta sipas Nenit 6. Gjykata mori në konsideratë të gjitha ankesat nën prizmin e Nenit 2.

Neni 2

Shteti ka për detyrim të marrë masat e nevojshme për të mbrojtur jetën e personave brenda juridiksionit të vet. Kjo përfshin detyrimin për të ngritur një sistem gjyqësor efikas dhe të pavarur me fuqinë për të vlerësuar përputhshmërinë ligjore të kujdesit të ofruar nga profesionistët mjekësorë. Të dy palët ishin dakord që në Turqi ekzistonte një skemë ligjore e cila u vinte për obligim spitaleve private dhe publike që të informonin pacientët e tyre për rreziqet e mundshme nga çdo trajtim potencial dhe të merrnin pëlqimin e tyre. Ankesa e kërkuesve kishte të bënte me përcaktimin nëse sistemi gjyqësor ishte në gjendje të siguronte zbatimin e duhur të skemës ligjore.

Gjykata vërejti që asnjë prej vendimeve gjyqësore, dhe asnjëri prej raporteve, nuk merrnin në konsideratë nëse ekipi mjekësor ishte konsultuar me Znj. Keşođlu apo me të afërmit e saj rreth alergjisë së saj, nëse e kishin informuar atë për rreziqet e mundshme të trajtimit, apo nëse ishte marrë pëlqimi i saj për këtë

trajtim. Ndërkohë që në raportin e Këshillit Shëndetësor Kombëtar thuhej se ekipi mjekësor kishte vepruar në përputhje me procedurat përkatëse mjekësore, ai nuk qartësonte mënyrën se si ai e kishte realizuar këtë. Më tej, raporti i anëtarëve të Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Stambollit nuk kishte hulumtuar mungesën e dokumentacionit që vërtetonte se mjekët ishin informuar mbi alergjinë e Znj. Keşođlu e rrjedhimisht kishte dështuar të adresonte nëse ekipi mjekësor kishte vepruar në përputhje me detyrimet e tij sipas skemës ligjore.

Gjykata deklaroi që këto pyetje ishin të rëndësishme, për të mos thënë vendimtare, për çështjen në fjalë dhe kërkonin përgjigje eksplicite prej gjykatave. Ndërkohë që nuk i takonte Gjykatës të përcaktonte përgjegjësinë e ekipit mjekësor po të merreshin në konsideratë këto pyetje, Gjykata arriti në përfundimin që, duke dështuar që të adresonin këto pyetje autoritetet kishin dështuar të siguronin zbatimin e përshtatshëm të kornizës përkatëse ligjore që mbronin të drejtën e Znj. Keşođlu për jetë.

Në fund, gjykata civile dështoi të vërtetonte rrjedhën e saktë të ngjarjeve para vdekjes së Znj. Keşođlu, pavarësisht nga fakti që S.Y. dhe D.G. dhanë deklarime të ndryshme. Kështu, vendimi i saj nuk arriti të jepte një vlerësim të qartë të çështjes duke u bazuar mbi një version të ngjarjeve i cili të ishte definitiv e plot vërtetësi. Prandaj, autoritetet nuk u ofruan kërkuessve zgjidhje efikase dhe shkelën aspektin procedural të Nenit 2.

Neni 41

Gjykata u caktoi kërkuessve shumën 20,000 Euro në lidhje me dëme jomateriale dhe 1,650 Euro për kosto dhe shpenzime.

*Terapia hormonale në spital psikiatrik, kinëse e administruar
pa pëlqimin e lirë të pacientit, nuk ka shkelur Nenin 3*

VENDIMI NË ÇSHTJEN DVOŔÁČEK K. REPUBLIKËS ÇEKE

(Kërkesa Nr. 12927/13)

6 nëntor 2014

1. Faktet kryesore

Kërkuesi ishte shtetas çek, i lindur në vitin 1971. Në vitin 1999, ai u diagnostikua me sëmundjen Ĕilson, një çrregullim gjenetik që kishte të bënte me akumulimin e bakrit në inde, ku simptomat përfshinin sëmundje të mëlçisë dhe probleme neurologjike e psikologjike. Në kohën e diagnozës, ai kishte filluar të kishte probleme me të folurit dhe lëvizjet dhe vuante nga hebefilia, një formë e pedofilisë, për çka u ndoq penalisht në disa raste.

Në vitin 2002, atij iu dha një dënim i pezulluar me burg dhe u urdhërua të hynte në trajtim mbrojtës. Në gusht të vitit 2007, Gjykata e Rrethit Olomouc e urdhëroi të hynte në trajtim seksologjik mbrojtës në një spital. Ai u dërgua në internim në spitalin psikiatrik në Šternberk prej 13 nëntorit 2007 deri më 4 nëntor 2008. Një ditë pas shtruarjes së tij në spital, mjeku kryesor shënoi që, meqenëse ai refuzonte kastrimin dhe trajtimin anti-androgjen, qëndrimi i tij do të ishte i përhershëm. Megjithatë, gjatë një ekzaminimi mjekësor më 3 dhjetor 2007, ai e pranoi trajtimin anti-androgjen për të ulur nivelin e testosteronit, të cilin më parë e kishte refuzuar. Kërkuesit iu dha një injeksion me substanca anti-androgjene në intervale të rregullta mes dhjetorit 2007 dhe korrikut 2008.

Pas marrjes së trajtimit në korrik 2008, kërkuesi shprehu pakënaqësinë e tij me trajtimin dhe deklaroi që preferonte të kalonte në trajtimin si pacient i jashtëm. Ai parashtrroi që gjendja e tij ishte përkeqësuar gjatë kohës në Šternberk dhe që ai vuante nga problemet mendore për shkak të frikës së tij në spital, kastrimit, turpërimit dhe humbjes së dinjitetit. Ai gjithashtu parashtrroi që mjekimi e pengonte në jetën e tij seksuale me të dashurën e tij, dhe që dëshironte të hynte në psikoterapi. Duke pasur parasysht këto, stafi në Šternberk i propozoi gjykatës që trajtimi i tij të ndryshonte nga qëndrimi internues në spital në trajtimin si pacient i jashtëm. Pas disa ekzaminimeve mjekësore, gjykata e pranoi këtë kërkesë.

Në vitin 2008, kërkuesi nisi disa veprime ligjore pa sukses në lidhje me kushtet e qëndrimit të tij internues në Šternberk. Ai u ankua që nuk kishte marrë psikoterapinë e përshtatshme, dhe argumentoi që ai kishte dhënë pëlqimin për trajtim anti-androgjen vetëm për shkak të frikës së tij për qëndrimin e përhershëm në spital, meqenëse nuk i ishte ofruar trajtim alternativ. Ai gjithashtu u ankua që ishte vënë nën presion psikologjik prej mjekëve për t'iu nënshtruar kastrimit. Pretendimi i tij në gjyq që kushtet e internimit kishin shkelur të drejtat e tij personale të parashikuara nga Kodi Civil i Çekisë (përfshirë, për shembull, të drejtën për respekt ndaj jetës private) u rrëzua. Më pas ai bëri ankesë në polici e cila po ashtu u rrëzua për shkak se kjo çështje tashmë ishte shqyrtuar nga tribunali, ku ishte gjetur që nuk kishte pasur keqtrajtim.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi pretendoi që kushtet e trajtimit të tij mbrojtës në Šternbeck, dështimi në akomodimin e arsyeshëm të sëmundjes së tij, dhe fakti që ai i ishte nënshtruar trajtimit të detyruar mjekësor përbënin torturë dhe trajtim poshtërues në shkelje të Nenit 3. Ai gjithashtu pretendoi që nuk kishte pasur qasje në zgjidhje efektive sipas Nenit 13. Qeveria argumentoi që pretendimi i tij për trajtim mjekësor të papërshtatshëm dhe të detyruar duhet të shqyrtohej sipas Nenit 8. Meqenëse kërkuesi qe shprehimisht kundër kësaj, Gjykata konsideroi që ajo ishte e detyruar ta shqyrtonte çështjen ekskluzivisht sipas Nenit 3.

Neni 3

Për të qenë brenda fushëveprimit të Nenit 3, keqtrajtimi duhet të ishte mjaft i rëndë. Masat e ofruara si nevojshmëri terapeutike sipas mendimit të praktikës së konstatuar mjekësore, në parim, nuk përbënin trajtim çjerëzor ose poshtërues nëse nevojshmëria vërtetohej mjaft ueshëm dhe mbrojtjet procedurale përkatëse respektoheshin kur të merrej ky vendim.

Trajtimi seksologjik mbrojtës i kërkuesit kishte për qëllim ta mbronte atë dhe prandaj nuk ishte “dënim” brenda kuptimit të Nenit 3. Gjykata më tej shqyrtoi nëse kushtet në të cilat ai ishte mbajtur në Šternbeck përbënin trajtim çnjëzor ose poshtërues. Kërkuesi pretendoi që këto kushte përfshinin: një krevat të papërshtatshëm për nevojat e tij, pamundësinë për të qëndruar në krevat gjatë ditës, pamundësinë për të marrë pjesë rregullisht në aktivitetet në ajër të pastër, mospasja e një dollapi personal, dhe detyrimi për të bërë dush me pacientët e tjerë në prani të një infermieri. Pavarësisht nga kjo, këto kushte nuk e përmbushnin

pragun e lartë që kërkohet për të shkuar deri në trajtim çnjerëzor ose poshtëruës. Duke u mbështetur, mbi të gjitha, tek opinionet mjekësore, Gjykata konsideroi që ndërkohë që kushtet i kishin shkaktuar atij mungesë rehatie, ato ishin të justifikuar nga gjendja e tij shëndetësore dhe sjellja e tij. Prandaj, kushtet në Šternbeck nuk përbënin përvojë të hidhur aq të jashtëzakonshme saqë të përbënin trajtim në kundërshtim me Nenin 3.

Gjykata gjithashtu mori në shqyrtim nëse Šternbeck kishte dështuar t'i ofronte kërkuesit psikoterapinë e duhur, nëse e kishte nënshtruar atë ndaj trajtimit të detyruar mjekësor dhe nëse kishte ushtruar presion psikologjik që ai t'i nënshtrohej kastrimit. Çështja e parë ishte nëse kërkuesi kishte dhënë pëlqimin për trajtimin anti- androgjen. U shënuar nga Gjykata, si dhe nga Ombudspersoni çek dhe nga Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit Çnjerëzor ose Poshtëruës, që baza ligjore përkatëse në Republikën e Çekisë në atë kohë ishte e mjegullt dhe e paqartë, dhe mund të interpretohej si e tillë që nënkuptonte që marrja e pëlqimit ishte e panevojshme për administrimin e trajtimit mbrojtës të urdhëruar nga gjykata.

Nuk u konstatua që kërkuesit i ishte bërë presion për t'iu nënshtruar kastrimit. Megjithatë, Gjykata njohu faktin që ai ishte përballur me një zgjidhje të vështirë mes marrjes së anti-androgjenëve të cilat do ta ulnin së tepërmi rrezikshmërinë e tij, duke i lejuar të dilte nga spitali më shpejt, dhe psikoterapisë e socioterapisë të cilat nënkuptonin qëndrim më të gjatë në spital. Ndërkohë që trajtimi anti-androgjen ishte vlerësuar si nevojshëm terapeutik, nuk u konstatua që atij i ishte bërë presion për ta pranuar. Mjekët në Šternbeck e përgatitën trajtimin duke iu përshtatur secilës prej rezervave të tij, dhe prandaj nuk dështuan në detyrimin e tyre për të mbrojtur shëndetin e tij.

Në deklaratën para Gjykatës, Šternbeck nguli këmbë që kërkuesi ishte informuar si duhej. Situata do të kishte qenë më e qartë nëse kërkuesit do t'i ishte kërkuar të firmoste një dokument ku specifikoheshin përfitimet dhe efektet anësore të trajtimit dhe e drejta e tij për të tërhequr pëlqimin e tij. Megjithatë, një dështim i tillë procedural ishte i pamjaftueshëm për të shkelur Nenin 3. Rrjedhimisht, Gjykata nuk konstatoi përtej dyshimit të arsyeshëm që ai i ishte nënshtruar trajtimit mjekësor të detyruar, dhe vendosi që nuk kishte shkelje të aspektit thelbësor të Nenit 3.

Gjykata konsideroi që pretendimet e kërkuesit në lidhje me keqtrajtimin e tij në Šternbeck ishin mjaftueshëm serioze për të kërkuar hetime efektive nga Shteti.

Megjithatë, ajo gjeti që kërkuesi e kishte pasur mundësinë që veprimet e stafit spitalor të shqyrtoheshin nga një autoritet nacional në kuadër të procedurave civile të nisura kundër Šternbeck për mbrojtjen e të drejtave të personalitetit. Prandaj, Shteti e kishte përmbushur detyrimin për të zhvilluar hetime efektive.

Në fund, policia nuk mund të qortohej për faktin që iu referua rezultateve të këtyre procedurave në refuzimin për të hapur hetime penale. Rrjedhimisht, Gjykata vendosi që nuk kishte pasur shkelje të aspektit procedural të Nenit 3. Duke pasur parasysh këtë përfundim, dhe faktin që një pretendim i suksesshëm për mbrojtjen e të drejtave të personalitetit lejonte caktimin e kompensimit, qe e panevojshme që çështja të shqyrtohej ndaras sipas Nenit 13.

Mungesa e qartësisë në ligjin që autorizon marrjen e indeve nga trupi i bashkëshortit të kërkueses pa pëlqim ka shkëlur Nenin 8, dhe ankthi i saj për pasojë ka shkëlur Nenin 3

VENDIMI NË ÇËSHTJEN ELBERTE K. LETONISË

(Kërkesa Nr. 61243/08)

13 janar 2015

1. Faktet kryesore

Kërkuesja ishte e lindur në vitin 1969 dhe jetonte në Sigulda. Më 19 maj 2001, bashkëshorti i saj gjeti vdekjen në një aksident me makinë. Autopsia u krye në Qendrën Mjekoligjore, ku eksperti mjekoligjor vuri në dukje që në pasaportën e burrit të saj nuk kishte vulë që kundërshtonte përdorimin e indeve të tij, dhe këputi një copë dura matter 10 cm me 10 cm nga trupi i tij. Trupi iu kthye kërkueses për varrim më 26 maj 2001. Kjo ishte hera e parë që ajo e pa trupin, dhe ajo vuri re që ai i kishte pasur këmbët të lidhura bashkë. Më pas trupi u varros në atë mënyrë.

Dy vjet më vonë, policia e sigurisë nisi hetime penale për heqjen e paligjshme të organeve dhe indeve nga trupat e vdekur mes viteve 1994 dhe 2003 për të furnizuar një kompani farmaceutike gjermane. Këtu kërkuesja mësoi se nga trupi i burrit të saj ishin hequr inde sipas një marrëveshjeje të miratuar nga Shteti dhe ishin dërguar në një kompani farmaceutike për të krijuar bio-implante. Megjithatë, në dhjetor 2005 prokurorët i ndërprejnë hetimet duke pranuar që Ligji letonez për Mbrojtjen e Trupave të Personave të Vdekur dhe Përdorimin e Organeve dhe Indeve Njerëzore ("Ligji") lejonte "pëlqimin e prezumuar", që do të thotë se "çdo gjë që nuk ishte e ndaluar ishte e lejuar". Hetuesit konsideruan se Ligji mbështetej në "pëlqimin e informuar" çka do të kërkonte pëlqimin e dhuruesit ose të të afërmeve. Më 13 gusht 2007, kërkuesja u informua që hetimet penale, të cilat kishin lidhje me heqjen e indeve nga burri i saj, ishin ndërprerë për shkak të skadimit të periudhës statutores pesëvjeçare të vjetërsimit të lëndës.

Autoritetet prokuroriale të larta më vonë konstatuan që ekspertët në Qendrën Mjekoligjore kishin shkëlur Ligjin sepse heqja e indeve kishte qenë e paligjshme, dhe e prishën vendimin për ndërprerjen e hetimeve. Më pas hetimet vijuese nga marsi 2008 zbuluan që në periudhën 1992 – 2002 ishin marrë inde nga 495 persona. Pavarësisht nga kjo gjetje, një vendim i 27 qershorit 2008 i ndërpreu hetimet penale duke thënë se ndërkohë që Ligji u jepte familjarëve të afërt të

drejtën për të kundërshtuar heqjen e organeve ose indeve, ai nuk u vinte detyrim ligjor ekspertëve për t'i informuar ata lidhur me atë të drejtë. Prandaj, ekspertët e Qendrës Mjekoligjore nuk mund të dënoheshin sipas Ligjit.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesja u ankua që heqja e indeve nga trupi i burrit të saj të vdekur pa pëlqimin e saj ishte në kundërshtim me të drejtën e saj për respekt ndaj jetës private dhe familjare sipas Nenit 8 të Konventës. Ajo gjithashtu u ankua që kjo heqje e kishte lënë atë në një gjendje pasigurie që i kishte shkaktuar shqetësim emocional në kundërshtim me Nenin 3. Më tej ajo pretendoi se nuk kishte qasje në zgjidhje efektive sipas Nenit 13.

Neni 8

Shteti ka detyrimin pozitiv për të marrë masa të arsyeshme për të siguruar mbrojtjen e duhur ligjore kundër ndërhyrjes arbitrare tek e drejta e një individi për respekt ndaj jetës private dhe familjare. Si familjarja më e afërt e të ndjerit, kërkuesja kishte të drejtën për të dhënë pëlqimin për heqjen e indeve. Prandaj, dështimi i autoriteteve për të krijuar kushtet praktike ligjore për t'i mundësuar asaj të shprehte pëlqimin e saj kishte ndërhyrë tek e drejta e saj për jetë private dhe familjare.

Në mënyrë që ndërhyrja të jetë e ligjshme, duhet që ajo të ketë qenë "në përputhje me ligjin", që do të thotë që legjislacioni përkatës vendas të jetë mjaftueshëm i qartë dhe të ofrojë mbrojtje të duhur kundër arbitraritetit. Mosmarrëveshja mes policisë së sigurisë dhe prokurorëve mbikqyrës sa i përket fushëveprimit të së drejtës së aplikueshme tregonte që asaj i mungonte qartësia e mjaftueshme. Deri sa policia e sigurisë arriti të pajtohej me interpretimin e prokurorëve që kërkohej "pëlqimi i informuar", mundësia për të ndërmarrë veprime penale u bë e pamundur për shkak të afateve kohore. Megjithëse ligji letonez kishte një kornizë ligjore sipas së cilës të afërmit mund të jepnin pëlqimin për marrjen e indeve, ai nuk specifikonte qartë fushëveprimin e detyrimeve korresponduese dhe diskrecionit në dispozicion të ekspertëve ose autoriteteve të tjera.

Sa i përket mbrojtjes kundër arbitraritetit, Gjykata shënoi që dokumentet përkatëse evropiane dhe ndërkombëtare në lidhje me marrjen e indeve vinin theks të veçantë mbi konstatimin e pikëpamjeve të familjarëve përmes hetimeve të arsyeshme. Duke pasur parasysh numrin e madh të personave prej të cilëve ishin marrë inde, ishte me rëndësi marrja e masave të përshtatshme për të ekuilibruar

interesat e familjarëve dhe diskrecionin e ekspertëve që kishin realizuar marrjen e indeve. Meqenëse një gjë e tillë nuk u bë, kërkuesja nuk diti se si të ushtronte të drejtën e saj të pëlqimit për marrjen e indeve nga trupi i bashkëshortit të saj. Prandaj, ndërhyrja tek e drejta e saj për respekt ndaj jetës private nuk ishte "në përputhje me ligjin". Rrjedhimisht, Gjykata deklaroi që kishte shkelje të Nenit 8.

Neni 3

Respekti për dinjitetin njerëzor është pjesë e thelbit të Konventës. Për të gjetur shkelje të ndarë të Nenit 3 në lidhje me respektin ndaj familjarëve të viktimës, duhet të ekzistojnë faktorë të veçantë që shkaktojnë vuajtje përtej hidhërimit që pason vdekjen e një anëtari të afërt të familjes.

Kërkuesja kishte vuajtur emocionalisht sepse ajo kishte mësuar rreth heqjes së indeve vetëm dy vjet pas varrimit të burrit të saj dhe fakti që veprime të tilla ishin kriminale u ekspozua plot pesë vite më vonë. Për më tepër, ajo kishte marrë vesh se cilat inde ishin marrë nga trupi i burrit të saj vetëm gjatë parashtresave të Qeverisë para Gjykatës. Kështu, ajo kishte përjetuar një periudhë të gjatë pasigurie, ankthi, dhe shqetësimi rreth arsyes përse burri i saj i kishte pasur këmbët të lidhura kur trupi i tij ishte kthyer pas autopsisë. Për t'ia shtuar shqetësimin e saj, hetimet penale kishin konstatuar që indet ishin marrë prej qindra personave gjatë një periudhe prej nëntë vitesh, ku disa prej tyre kishin ndodhur me marrëveshje të bëra nga Shteti me një kompani farmaceutike gjermane. Po ashtu, asaj i ishte mohuar çdo lloj zgjidhjeje për shkeljen e të drejtës së saj personale për të dhënë pëlqimin për marrjen e indeve nga trupi i burrit të saj. Këto ishin faktorë të veçantë që i shkaktuan vuajtje shtesë kërkueses, përveç faktit që kishte mbetur vejushë në zi.

Në fushën e transplantimit të organeve dhe indeve, njihej fakti që trupi i njeriut duhet të trajtohet me respekt edhe pas vdekjes. Në fakt, ishte objektiv i traktateve ndërkombëtare si Konventa për të Drejtat e Njeriut dhe Biomjekësinë me Protokolle Shtesë që të mbrohej dinjiteti, identiteti, dhe integriteti i "gjithkujt" që është lindur, qoftë gjallë apo vdekur. Nuk kishte dyshim që vuajtja e kërkueses për marrjen e indeve nga trupi i burrit të saj përbënte trajtim poshtëruës. Në përfundim, Gjykata deklaroi që kishte pasur shkelje të Nenit 3.

Neni 41

Gjykata i caktoi kërkueses 16,000 Euro për dëme jomateriale dhe 500 Euro për kosto dhe shpenzime.

VIII. Ruajtja e të dhënave përfshirë gjurmimin

Zbulimi i dosjeve mjekësore të Dëshmitarëve të Jehovahit pas refuzimit prej tyre të transfuzioneve të gjakut ka shkelur të drejtën e tyre për respekt ndaj jetës private, në shkelje të Nenit 8

VENDIMI NË ÇËSHTJEN AVILKINA DHE TË TJERË K. RUSISË

(Kërkesa Nr. 1585/09)
6 qershor 2013

1. Faktet kryesore

Katër kërkueset ishin: një organizatë fetare, Qendra Administrative e Dëshmitarëve të Jehovahit në Rusi me seli në Shën Peterburg, dhe tre shtetas rusë të cilët ishin Dëshmitarë të Jehovahit.

Në shtator të vitit 2004, Komiteti për Shpëtimin e Rinisë nga Kultet Destruktive ("Komiteti") i shkroi Presidentit rus, duke akuzuar organizatën kërkuese për ekstremizëm, dhe kërkoi të hapeshin hetime rreth aktiviteteve të saj. Kjo iu përcoll Prokurorisë, dhe hetimet që pasuan nuk gjetën shkelje. Komiteti më pas bëri edhe gjashtë ankesa të tjera, ku të gjitha u refuzuan pas hetimeve. Organizata kërkuese kërkoi zbulimin e rezultateve të hetimeve, por kjo u refuzua. Në qershor të vitit 2007, në lidhje me hetimin e ligjshmërisë së aktivitetit të kërkueses së parë, autoritetet prokuroriale udhëzuan të gjitha institucionet mjekësore të Shën Peterburgut që të raportnin refuzimet e transfuzioneve të gjakut prej Dëshmitarëve të Jehovahit.

Në një datë të pasaktësuar dhe prej shkurtit 2006, kërkuesja e dytë dhe kërkuesja e katërt iu nënshturuan kemoterapisë dhe trajtimit kirurgjik respektivisht. Trajtimi i të dyjave nuk përfshiu menaxhimin me gjak dhe, si më sipër, të dhënat mjekësore të tyre iu përcollën autoriteteve shtetërore.

Në mars 2007 kërkuesja e tretë u shtrua në një spital publik, ku ajo kërkoi që trajtimi i saj të mos përfshinte menaxhimin me gjak, çka spitali nuk ra dakord që t'ia ofronte. Ajo u lëshua nga spitali dhe të dhënat e saj mjekësore nuk iu përcollën autoriteteve shtetërore.

Procedurat e mëtejshme në gjykatat vendase, që kulminuan me një gjykim të 27 marsit 2008, gjetën se zbulimi i të dhënave mjekësore të kërkuesve kishte qenë i ligjshëm.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesja e dytë, e tretë dhe e katërt u ankuan që zbulimi i të dosjeve të tyre mjekësore tek autoritetet prokuroriale ruse si pasojë e refuzimit të tyre për të bërë transfuzion gjaku shkelte Nenin 8 dhe që, si pasojë, të katër kërkueset argumentuan që kërkueset individuale ishin diskriminuar sipas Nenit 14.

Neni 8

Ankesa e bërë nga kërkuesja e tretë u deklarua e papranueshme meqenëse zbulimi i të dhënave të saj mjekësore në fakt nuk kishte ndodhur, çka nuk u vu në diskutim nga palët.

Gjykata nuk kishte dyshim se zbulimi i dosjeve mjekësore të kërkueses së dytë dhe të katërt përbënte ndërhyrje tek e drejta e tyre për respekt ndaj jetës së tyre private, ku çështja ishte nëse ajo ndërhyrje ishte e justifikuar.

Ajo pranoi që masa e kundërshtuar kishte bazë në të drejtën vendase, megjithëse shënoi argumentin e kërkueseve që formulimi i përgjithshëm mund të kishte qenë i hapur ndaj interpretimit të tepruar. Ajo konsideroi që kjo, dhe çështja e një qëllimi legjitim, ishin të lidhura ngusht me çështjen më të gjerë të faktit nëse ndërhyrja ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike. Gjatë përcaktimit të kësaj, Gjykata shënoi që nga fillimi se çështja thelbësore ishte mbrojtja e të dhënave personale. Të drejtat e kërkueseve për autonomi personale në sferën e integritetit fizik dhe besimeve fetare, e shqyrtuar gjatë e gjerë në çështje të mëparshme gjyqësore, nuk ishin objekt diskutimi në këtë rast.

Gjykata përsëriti që respektimi i konfidencialitetit të të dhënave shëndetësore është thelbësor, jo vetëm për mbrojtjen e privatësisë së pacientit/es, por edhe për ruajtjen e besimit tek shërbimet shëndetësore në përgjithësi. Pa një mbrojtje të tillë, ata që kishin nevojë për ndihmë mjekësore mund të pengoheshin nga kërkimi i trajtimit të duhur, duke rrezikuar vetë shëndetin e tyre. Pavarësisht nga kjo, interesat e pacientit/es dhe komunitetit në tërësi për mbrojtjen e konfidencialitetit të të dhënave mjekësore mund të ketë më pak peshë sesa interesi i hetimeve dhe ndjekjes penale të krimit dhe publiciteti i procedurave gjyqësore, kur interesa të

tilla vërtetohen të kenë rëndësi edhe më të madhe. U njoh fakti se autoritetet nacionale kishin hapësirë të gjerë vlerësimi gjatë vendosjes së këtij ekuilibri të drejtë, megjithëse kjo ishte nën mbikqyrjen e Gjykatës.

Ajo gjeti që nuk kishte pasur nevojë urgjente shoqërore për zbulimin e informacioneve mjekësore konfidenciale të kërkueses së dytë dhe të katërt. Në mënyrë të veçantë, spitalet ku ato ishin trajtuar nuk kishin raportuar ndonjë sjellje kinëse kriminale nga asnjëra prej kërkueseve. Për më tepër, stafi mjekësor mund të kishte kërkuar autorizim gjyqësor që kërkuesja e dytë, në atë kohë dy vjeçe, të merrte transfuzion gjaku nëse do të kishin besuar se ajo ishte në gjendje rreziku për jetë; dhe, mjekët që raportuan në lidhje me kërkuesen e katërt nuk sugjeruan që refuzimi i saj për transfuzion gjaku ishte rezultat i presionit nga Dëshmitarët e tjerë të Jehovahit. Mënyrat e përdorura nga prokurori gjatë zhvillimit të hetimeve, përfshirë zbulimin e informacioneve konfidenciale pa paralajmërim paraprak ose mundësi për të kundërshtuar, nuk kanë pasur nevojë të ishin kaq despotike. Gjithashtu u shënua që kishte opsione shtesë, përveç urdhërimit të zbulimit të informacioneve mjekësore konfidenciale, që prokurori kishte në dispozicion për të hetuar ankesat e bëra pranë zyrës së tij. Në mënyrë të veçantë, ai mund të ishte përpjekur të merrte pëlqimin e kërkueseve për zbulimin dhe/ose t'i merrte ato në pyetje lidhur me çështjen.

Prandaj, autoritetet nuk kanë bërë përpjekje për të gjetur ekuilibrin e drejtë mes, nga njëra anë, të drejtës së kërkueseve për respekt ndaj jetës së tyre private dhe, nga ana tjetër, qëllimit të prokurorit për mbrojtjen e shëndetit publik. Madje ato as nuk ofruan ndonjë arsye relevante ose të mjaftueshme për të justifikuar zbulimin e informacioneve të tilla konfidenciale. Prandaj, Gjykata vendosi që kishte shkelje të Nenit 8.

Neni 14 në lidhje me Nenin 8

Duke pasur parasysh gjetjet e mësipërme, ajo konsideroi që nuk kishte nevojë të shqyrtoheshin ankesat e kërkueseve nga këndvështrimi i Nenit 14.

Neni 41

Gjykata caktoi 5,000 Euro secilës prej kërkueseve të dyta dhe të katërta në lidhje me dëme jomateriale, dhe 2,522 Euro për kërkuesen e dytë, dhe 1,880 Euro për kërkuesen e katërt për kosto dhe shpenzime.

Mungesa e saktësisë në të drejtën vendase për lejimin e zbulimit të të dhënave mjekësore të kërkujes para një autoriteti publik nuk ka qenë "në përputhje me ligjin", në shkëlqje të Nenit 8

VENDIMI NË ÇËSHTJEN L.H. kundër LETONISË

(Kërkesa Nr. 52019/07)

29 prill 2014

1. Faktet kryesore

Kërkesja ishte shtetase letoneze e lindur në vitin 1975. Në kohën relevante, Inspektorati i Kontrollit të Cilësisë për Kujdesin Mjekësor dhe Aftësinë për Punë ("MADEKKI") ishte përgjegjës për monitorimin e cilësisë së kujdesit shëndetësor që ofrohej në institucionet mjekësore.

Gjatë kohës që kërkesja po lindte fëmijën e saj në vitin 1997, u përdor prerje cezariane me pëlqimin e saj. Gjatë atij operacioni, u bë lidhja e tubave pa pëlqimin e saj, çka rezultoi me sterilizim. Pas një përpjekjeje të pasuksesshme për të arritur një marrëveshje jashtëgjyqësore, ajo nisi procedurë civile kundër spitalit në shkurt 2005, dhe në dhjetor 2006 iu caktua kompensim për sterilizim të paautorizuar.

Në ndërkohë, në shkurt të vitit 2004, MADEKKI, me kërkesë të drejtorit të spitalit të rrethit, nisi hetime administrative në lidhje me ndihmesën gjinekologjike dhe të lindjeve që i ishte ofruar kërkujes prej vitit 1996 deri në vitin 2003. Në prill 2004, një anëtar i stafit të MADEKKI-t i telefonoi kërkujes për ta informuar rreth hetimeve, dhe e ftoi të jepte mendimin e saj rreth çështjes, gjë që ajo refuzoi ta bënte. MADEKKI mori dosjet e saj mjekësore nga tre institucione të ndryshme dhe, në maj 2004, nxori një raport që përmbante hollësi delikate mjekësore rreth kërkujes. Një përmbledhje e konkluzioneve të raportit po ashtu iu dërgua drejtorit të spitalit.

Kërkesja ngriti akuza pranë gjykatave administrative, duke u ankuar që hetimet kishin qenë të paligjshme, meqenëse qëllimi kryesor i tyre kishte qenë të ndihmonin spitalin për të mbledhur prova për çështjen gjyqësore që pritej, çka ishte jashtë sferës së punës së MADEKKI-t. Gjithashtu u pretendua që MADEKKI kishte vepruar në mënyrë të paligjshme kur kishte kërkuar dhe marrë informacione rreth shëndetit të kërkujes. Kërkesja po ashtu kërkoi që raporti i MADEKKI-t të anulohet. Kërkesa e saj u refuzua nga Gjykata Administrative e Rrethit në një vendim që më pas u

mbështet nga Senati i Gjykatës Supreme ("Senati") në shkurt 2007. Senati doli me përfundimin që MADEKKI ishte i autorizuar të mblidhte dhe përpunonte të dhënat sensitive të kërkuases për të monitoruar cilësinë e kujdesit mjekësor, dhe që Ligji për Mbrojtjen e Të Dhënave Personale lejonte procesimi e të dhënave personale sensitive pa pëlqim me shkrim nga subjekti i të dhënave me qëllim të trajtimit mjekësor ose për ofrimin apo administrimin e shërbimeve të kujdesit mjekësor.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuësja u ankua që, me marrjen e të dhënave të saj personale mjekësore, MADEKKI kishte shkelur të drejtën e saj për respekt të jetës private sipas Nenet 8.

Neni 8

Nuk u vu në diskutim që të dhënat mjekësore të kërkuases përbënin pjesë të jetës së saj private, dhe që marrja e këtyre të dhënave nga MADEKKI përbente ndërhyrje tek e drejta e saj për respekt të jetës private. Çështja para Gjykatës ishte nëse ndërhyrja ishte e justifikuar si "në përputhje me ligjin", duke përsëritur që për këtë nevojitet pajtueshmëria me të drejtën vendase dhe qartësi të arsyeshme në lidhje me fushëveprimin dhe mënyrën e ushtrimit të diskrecionit përkatës nga ana e autoriteteve publike.

Gjykata pranoi që MADEKKI ishte i autorizuar për të mbledhur informacione nga institucionet mjekësore në lidhje me çështje brenda fushës së vet të kompetencës, megjithëse shënoi se normat ligjore që përshkruanin këtë kompetencë ishin shumë të përgjithshme.

Ajo gjithashtu shënoi që MADEKKI filloi të mblidhte të dhënat mjekësore të kërkuases në vitin 2004, shtatë vjet pas sterilizimit të saj dhe në një kohë kur kërkuësja ishte e përfshirë në proces civil me spitalin. Sipas mendimit të Gjykatës, kjo vonesë e gjatë ngrinte një sërë pyetjesh, kryesisht në lidhje me faktin nëse mbledhja e të dhënave në vitin 2004 mund të gjykohej të kishte qenë "e nevojshme për qëllime të trajtimit mjekësor [ose] ofrimin apo administrimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor" brenda kuptimit të seksionit përkatës të Ligjit për Mbrojtjen e Të Dhënave, nëse shërbimet mjekësore në fakt do të ishin ofruar shtatë vjet më parë. Në këtë kontekst, u shënuar që kërkuësja nuk ishte informuar asnjëherë që MADEKKI kishte mbledhur dhe procesuar të dhënat e saj personale në kuadër të një kontrolli të përgjithshëm mbi cilësinë e kujdesit shëndetësor që ofrohet nga spitali. Vetë spitalit nuk iu bë asnjë rekomandim se si të përmirësonte shërbimet që ofronte.

Senati nuk e kishte shpjeguar se cili prej funksioneve të veta kishte qenë duke zhvilluar MADEKKI ose çfarë interesi publik kishte synuar kur nxori raportin mbi ligjshmërinë e trajtimit të kërkuases. Rrjedhimisht, Senati nuk kishte shqyrtuar dhe nuk do të kishte mundur të shqyrtonte proporcionalitetin e ndërhyrjes tek e drejta e kërkuases për respekt të jetës private kundrejt çdo interesi publik, veçanërisht duke marrë parasysh që ai doli me përfundimin që një peshim i tillë tashmë ishte bërë nga ligjvënësi. Kjo kishte ndodhur në kuadër të së drejtës vendase, sipas së cilës MADEKKI nuk kishte për detyrim ligjor të merrte vendime për procesimin e të dhënave mjekësore duke marrë në konsideratë mendimin e subjektit të të dhënave lidhur me këtë, apo qoftë edhe të informonte subjektin e të dhënave që të dhënat e tij/saj do të procesoheshin para se ta bënte një gjë të tillë.

Sugjerimi i Qeverisë, që MADEKKI i kishte mbledhur informatat mbi historinë mjekësore të kërkuases në mënyrë që të përcaktonte nëse mjeku që kishte kryer lidhjen e tubave duhet të mbante përgjegjësi penale, nuk mund të pranohej. Së pari, shtatë vjet pas ngjarjes ndjekja penale sigurisht që ishte vjetërsuar me kalimin e kohës. Së dyti, as drejtori i spitalit e as MADEKKI nuk kishin autoritet ligjor për të konstatuar, qoftë edhe në mënyrë paraprake, përgjegjësinë penale të individëve privatë.

Më tej, e drejta e aplikueshme nuk kufizonte në asnjë mënyrë fushëveprimin e të dhënave personale që mund të mblidheshin nga MADEKKI. Në çështjen e tanishme, MADEKKI kishte mbledhur të dhënat mjekësore të kërkuases në lidhje me një periudhë kohore që shtrihej në shtatë vjet. Relevanca dhe mjaftueshmëria e arsyeve për mbledhjen e informatave rreth kërkuases të cilat nuk kishin lidhje të drejtpërdrejtë me procedurën e zhvilluar në spital, nuk ishin shqyrtuar në asnjë fazë të procedurës vendore.

Prandaj, ligji i aplikueshëm në Letoni nuk ishte i formuluar me saktësi të mjaftueshme dhe nuk ofronte mbrojtjen e duhur ligjore kundër arbitraritetit, dhe as nuk tregonte me qartësi të mjaftueshme se cili ishte fushëveprimi i diskrecionit dhënë autoriteteve kompetente dhe mënyra e ushtrimit të tij. Ndërhyrja tek e drejta e kërkuases për respekt të jetës së saj private pra nuk ishte “në përputhje me ligjin” brenda kuptimit të Nenit 8 § 2, në shkëlqje të Nenit 8.

Neni 41

Gjykata i caktoi 11,000 Euro kërkuases në lidhje me dëme jomateriale, dhe 2,768 Euro në lidhje me kosto dhe shpenzime.

*Zbulimi i paligjshëm i të dhënave mjekësore të kërkueses shtatzënë
tek punëdhënësi i saj pa pëlqimin e saj ka shkelur Nenin 8*

VENDIMI NË ÇËSHTJEN RADU K. REPUBLIKËS SË MOLDAVISË

(Kërkesa Nr. 50073/07)

15 prill 2014

1. Faktet kryesore

Në kohën e ngjarjeve, kërkuesja ishte tridhjetekatër vjeçe, e martuar, dhe ligjëruese në Akademinë e Policisë. Nga materialet e dosjes së lëndës dukej se marrëdhëniet mes kërkueses dhe eporëve të saj në Akademinë e Policisë ishin të tensionuara, dhe kishte pasur një sërë procedurash civile në lidhje me çështje punësimi mes tyre.

Në vitin 2003, kërkuesja mbeti shtatzënë me binjakë me anë të fekondimit artificial. Për shkak të rrezikut të madh të dështimit, një mjek në Qendrën Nr. 7 të Mjekëve Familjarë ("CFD"), spital shtetëror, urdhëroi shtruarjen e saj në spital, dhe ajo qëndroi në spital 17 ditë. U duk që mungesa e kërkueses në punë gjatë qëndrimit të saj në spital u certifikua nga një notë lajmërimi që i referohej shtatzanisë së saj dhe rrezikut të madh për dështim si arsye për mungesën e saj.

Në nëntor të vitit 2003, Kryetari i Akademisë së Policisë kërkoi më shumë informacione nga CFD në lidhje me lejen e saj mjekësore. CFD pas kësaj ofroi informacione, pa pëlqimin e kërkueses, ku përfshiheshin hollësi rreth shtatzanisë së saj, procesin e fekondimit artificial dhe procedurat mjekësore. Ata gjithashtu përfshinë edhe një kopje të dosjes së saj mjekësore.

Dy ditë pas zbulimit të informatave, kërkuesja pësoi dështim të cilin ia atribuoi stresit që i kishte shkaktuar ky zbulim. Sipas kërkueses, të dhënat ishin bërë të ditura për të gjithë ata që ishin pjesë e Akademisë së Policisë, ku si pasojë u përhapën thashetheme dhe studentët morën vesh për jetën e saj private. Bashkëshorti i saj, i cili po ashtu ishte punonjës i Akademisë së Policisë, u desh të jepte dorëheqje nga vendi i tij i punës dhe të pranonte një vend pune me pagë më të ulët.

Në janar të vitit 2004, kërkuesja nisi procedura civile kundër CFD-së dhe Akademisë së Policisë në Gjykatën e Rrethit Centru. Ato u rrëzuan për arsye, mes

të tjerash, se zbulimi i të dhënave nga klinika e fertilitetit kishte qenë i ligjshëm duke pasur parasysh hetimet në vazhdim që ishin duke u zhvilluar nga Akademia e Policisë. Kjo u mbështet nga Gjykata Supreme e Drejtësisë në maj të vitit 2007.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesja u ankua që zbulimi i të dhënave të saj mjekësore nga CFD tek punëdhënësi i saj përbente shkelje të së drejtës së saj për respekt ndaj jetës private sipas Nenit 8. Ajo gjithashtu pretendoi, sipas Nenit 6, se procedurat që ajo kishte nisur kundër CFD-së ishin të padrejta sepse gjykatat merrnin vendime arbitrare të cilat nuk i justifikonin.

Neni 8

Nuk vihej në diskutim nga palët, dhe Gjykata që dakort, se zbulimi nga CFD tek punëdhënësi i kërkueses i hollësive kaq të ndjeshme përbente ndërhyrje tek e drejta e saj për jetë private. Gjykata më pas mori në shqyrtim nëse zbulimi ishte “në përputhje me ligjin”, duke shënuar se këtu kërkohet pajtueshmëria me të drejtën vendase dhe qartësi e arsyeshme lidhur me fushëveprimin dhe mënyrën e diskrecionit përkatës që gëzonin autoritetet publike.

Në parashtresat e saj, Qeveria iu referua seksionit 8 të Ligjit 982 mbi qasjen në informacion si baza ligjore për ndërhyrjen në fjalë. Gjykata shënoi, së pari, se ishte vetëm Qeveria e jo Gjykata Supreme ajo që i referohej kësaj baze ligjore për ndërhyrjen. Në fakt, Gjykata Supreme thjesht deklaroi që CFD kishte të drejtë t’ia bënte të ditura informacionet punëdhënësit të kërkueses, pa cituar asnjë bazë ligjore për një zbulim të tillë. Së dyti, edhe nëse supozohet që Gjykata Supreme kishte pasur në mend të mbështetej në atë dispozitë, u shënuar që sipas seksionit 8 një mjek nuk do të kishte të drejtë të zbulonte informacione të natyrës personale, qoftë edhe nënës së kërkueses, pa pëlqimin e kësaj të fundit.

Më tej u shënuar që e drejta relevante vendase dhe ndërkombëtare që Gjykata kishte në dispozicion shprehimisht e ndalonte zbulimin e informatave të tilla deri aty sa që kjo përbente vepër penale. Sadoqë ka përjashtime nga rregulla e moszbulimit, asnjëri prej tyre nuk u duk i aplikueshëm në situatën e kërkueses. Pasonte që ndërhyrja nuk ishte “në përputhje me ligjin”. Rrjedhimisht, nuk kishte nevojë të shqyrtohej nëse ajo synonte ndonjë qëllim legjitim apo nëse ishte “e nevojshme në një shoqëri demokratike”.

Prandaj, Gjykata gjeti që kishte pasur shkelje të Nenit 8. Neni 6 Duke pasur parasysh përfundimin e arritur më lart, Gjykata deklaroi që nuk dilte asnjë çështje e veçantë sipas Nenit 6.

Neni 41

Gjykata vendosi që Qeveria duhet t'i paguante kërkueses 4,500 Euro në lidhje me dëme jomateriale dhe 1,440 Euro në lidhje me kosto dhe shpenzime.

Vëzhgimi arbitrar dhe abuziv i komunikimeve në telefon mobil në Rusi

VENDIMI I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN ROMAN ZAKHAROV k. RUSISË

(Kërkesa Nr. 47143/06)

4 dhjetor 2015

1. Faktet kryesore

Kërkuesi, Roman Zakharov, ishte shtetas rus, i lindur në vitim 1977, dhe kryeredaktor i një kompanie botuese. Ai ishte i abonuar në shërbimet e disa operatorëve të rrjeteve të telefonisë mobile.

Në dhjetor 2003 ai hapi procedurë gjyqësore kundër tre operatorëve të telefonisë mobile, duke u ankuar për ndërhyrje tek e drejta e tij për privatësi në komunikimet e tij telefonike. Ai pretendoi se, sipas të drejtës përkatëse vendase – më saktësisht në vijim të Urdhrit Nr. 70 të lëshuar nga Ministria e Komunikimeve – operatorët mobilë kishin instaluar pajisje që lejonin përgjimin e pakufizuar të të gjitha komunikimeve telefonike nga shërbimet e sigurimit pa autorizim gjyqësor paraprak. Ai i kërkoi Gjykatës së Rrethit përgjegjës që të hiqte pajisjet e instaluara sipas Urdhrit Nr. 70, i cili nuk ishte bërë publik asnjëherë, dhe të siguronte që qasja në telekomunikime t'u jepej vetëm personave të autorizuar. Në dhjetor 2005 Gjykata e Rrethit të Shën Peterburgut i rrëzoi pretendimet e Z. Zakharov, duke gjetur që instalimi i pajisjeve në vetvete nuk dhunonte privatësinë e komunikimeve të tij, dhe që kërkuesi kishte dështuar të vërtetonte se bisedat e tij telefonike ishin përgjuar.

Kërkuesi apeloi. Ai pretendoi se Gjykata e Rrethit kishte refuzuar të pranonte disa dokumente si prova, përfshirë urdhrat gjyqësore që autorizonin përgjimin e komunikimeve mobile të disa personave, çka, sipas mendimit të kërkuesit, vërtetonte se operatorët e rrjeteve mobile dhe agjencitë e zbatimit të ligjit teknikisht e kishin kapacitetin për të përgjuar të gjitha komunikimet telefonike pa marrë autorizim gjyqësor paraprak. Në prill 2006, Gjykata e Qytetit të Shën Peterburgut e mbështeti VENDIMIN e apeluar, duke konfirmuar vendimin e Gjykatës së Rrethit.

2. Vendimi i Gjykatës

Duke u mbështetur në Nenin 8 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Z. Zakharov u ankua rreth sistemit të përgjimit të fshehtë të komunikimeve në

telefonat mobil në Rusi, duke argumentuar se e drejta përkatëse vendase i lejonte shërbimet e sigurimit të përgjonin komunikimet e çdo njeriu pa marrë autorizim gjyqësor paraprak. Duke u mbështetur në Nenin 13, ai u ankua më tej që ai nuk kishte zgjidhje ligjore efektive në shkallë kombëtare për ta kontestuar atë legjislacion.

Neni 8

Gjykata vërejti që, megjithëse Konventa nuk parashikon institucionin e një *actio popularis*, Z. Zakharov kishte të drejtë të pretendonte që ishte viktimë e një shkeljeje të Konventës, edhe pse ai pretendonte se kishte pasur ndërhyrje tek të drejtat e tij thjesht si pasojë e ekzistencës së legjislacionit që lejonte masat sekrete të vëzhgimit, dhe nuk kishte mundësi të pretendonte që ai kishte qenë objekt i një mase konkrete të vëzhgimit. Duke pasur parasysh natyrën sekrete të masave të vëzhgimit të parashikuara nga legjislacioni, fushëveprimin e gjerë të tyre – duke ndikuar tek të gjithë përdoruesit e komunikimeve përmes telefonisë mobile – dhe mungesën e mjeteve efektive për t'i kontestuar ato në nivel kombëtar, Gjykata konsideroi që shqyrtimi i legjislacionit përkatës in abstracto ishte i justifikuar. Si më lart, Gjykata konsideroi që Z. Zakharov nuk kishte nevojë të demonstronte se rrezikonte përgjimin e komunikimeve të tij, sepse vetë ekzistenca e legjislacionit të kontestuar në vetvete përbënte ndërhyrje tek të drejtat e tij sipas Nenit 8.

Pasi u konstatua që përgjimi i komunikimeve të telefonisë mobile bazohej në të drejtën ruse – pra në OSAA, CCrP, dhe Urdhri Nr. 70 i lëshuar nga Ministria e Komunikimeve – e cila synonte qëllimin legjitim të mbrojtjes së sigurisë kombëtare dhe sigurimin e publikut, Gjykata u desh të konstatonte me siguri nëse ai ligj vendas ishte i tillë që ndaj tij kishin qasje të gjithë dhe përmblante mbrojtjet e garancitë e duhura dhe efektive.

Qasshmëria në të drejtën vendase

Gjykata gjeti se ishte për të ardhur keq që shtojcat e Urdhrit Nr. 70 nuk ishin bërë publike asnjëherë në një botim zyrtar në dispozicion për të gjithë. Megjithatë, duke pasur parasysh që ai ishte botuar në një revistë zyrtare ministrore, dhe që ajo mund të lexohej nga publiku i gjerë përmes një databaze ligjore private në internet, Gjykata nuk e pa të nevojshme ta ndiqte më tej çështjen e qasshmërisë së të drejtës vendase.

Fushëveprimi i zbatimit të masave sekrete të vëzhgimit

Gjykata konsideroi që legjislacioni rus sqaronte mjaftueshëm natyrën e veprave që mund t'i jepnin shkas një urdhri për përgjim. Njëkohësisht ajo vuri në dukje me shqetësim se ligjit i mungonte qartësia në lidhje me disa prej kategorive të njerëzve të cilëve mund t'u përgjoheshin telefonat, pra një person që mund të kishte informacione rreth një veprë, ose në lidhje me ndonjë çështje penale, ose ata që përfshiheshin në aktivitete që rrezikonin sigurinë kombëtare, ushtarake, ekonomike ose ekologjike të Ruisë. Në lidhje me atë pikë, OSAA u jepte autoriteteve një shkallë thujse të pakufishme diskrecioni për të vendosur se çfarë përbente një kërcënim të tillë, dhe nëse ai kërcënim ishte aq serioz sa që justifikonte vëzhgimin sekret.

Kohëzgjatja e masave sekrete të vëzhgimit

E drejta ruse përmbante rregulla të qarta rreth kohëzgjatjes dhe përtëritjes së përgjimeve, duke ofruar mbrojtjet e duhura kundër abuzimit. Sidoqoftë, Gjykata vuri re që kërkesa për ndërprerjen e përgjimeve kur nuk ishin më të nevojshme përmendej vetëm në CCRp, dhe jo në OSAA. Nga kjo rridhte që përgjimet në kuadër të procedurave penale kishin më shumë mbrojtje sesa ato në lidhje me aktivitete që rrezikonin sigurinë kombëtare, ushtarake, ekonomike ose ekologjike të Ruisë.

Procedurat për ruajtjen, përdorimin, komunikimin dhe asgjësimin e të dhënave të zëna

Gjykata u bind që e drejta ruse përmbante rregulla të qarta që qeverisnin ruajtjen, përdorimin dhe komunikimin e të dhënave të zëna në përgjim, duke mundësuar minimizimin e rrezikut të qasjes apo zbulimit të paautorizuar.

Sa i përket asgjësimit të këtij materiali, Gjykata gjeti që e drejta ruse nuk ishte e qartë mjaftueshëm, meqenëse ajo lejonte ruajtjen automatike për gjashtë muaj të të dhënave jorelevante në çështje ku personi në fjalë nuk ishte akuzuar për veprë penale, dhe në rastet kur personi ishte akuzuar për veprë penale nuk ishin të qarta rrethanat në të cilat do të mbahej dhe asgjësohej materiali i zënë gjatë përgjimeve në përfundim të gjyqit.

Autorizimi i përgjimeve

Gjykata vuri re që e drejta ruse përmbante një mbrojtje të rëndësishme kundër përgjimit arbitrar ose pa dallim, ku cekej se çdo përgjim duhet të ishte i autorizuar

nga një gjykatë. Agjencia ligjzbatuese që kërkonte autorizimin për përgjim duhet t'i paraqiste një gjyqtari një kërkesë të arsyetuar për këtë qëllim, dhe gjyqtari duhet të jepte arsye për vendimin e autorizimit të përgjimeve.

Sa i përket fushëveprimit të shqyrtimit, këqyrja gjyqësore ishte e kufizuar, dhe, pavarësisht nga rekomandimet e Gjykatës Kushtetuese, gjyqtarët nuk verifikonin ekzistencën e “dyshimit të arsyeshëm” kundër personit për të cilin ishte kërkuar përgjimi, e as nuk shqyrtonin nëse përgjimi ishte i nevojshëm dhe i justifikuar. Si rezultat, kërkesat për përgjim shpesh nuk shoqëroheshin me materiale mbështetëse, gjyqtarët kurrë nuk i kërkonin agjencisë përgjuese të paraqiste materiale të tilla, dhe një referencë e thjeshtë për ekzistencën e informacionit rreth veprës penale apo aktiviteteve që rrezikonin sigurinë kombëtare, ushtarake, ekonomike ose ekologjike konsiderohej e mjaftueshme për dhënien e autorizimit.

Sa i përket përmbajtjes së autorizimit të përgjimit, Gjykata vuri re se, ndryshe nga CCrP, OOSA i lejonte diskrecion shumë të gjerë autoriteteve ligjzbatuese. OOSA nuk përmbante kërkesa as në lidhje me përmbajtjen e kërkesës për përgjim, e as në lidhje me përmbajtjen e autorizimit të përgjimit, që do të thotë se gjykatat nganjëherë lëshonin autorizime për përgjime të cilat nuk përmendnin përgjimin e një personi të caktuar apo një numri telefonik të caktuar, por autorizonin përgjimin e të gjitha komunikimeve telefonike në zonën ku kinëse ishte kryer një vepër penale, dhe nganjëherë pa përmendur fare kohëzgjatjen e autorizimit të përgjimeve. Për më tepër, “procedurës urgjente” jo-gjyqësore të ofruar nga OOSA – në kuadër të së cilës ishte e mundur të përgjoheshin komunikime pa autorizim gjyqësor paraprak deri në dyzet e tetë orë – i mungonin mbrojtjet e mjaftueshme për të siguruar që ajo të përdorej vetëm në rastet e justifikuara siç duhej. Procedurat e autorizimit të parashikuara nga e drejta ruse nuk ishin në gjendje të siguronin që masat sekrete të vëzhgimit të mos urdhëroheshin kuturu, në mënyrë të parregullt ose pa u shqyrtuar tamam siç duhej.

Më tej, Gjykata konsideroi që një sistem, si ai rus, i cili i mundësonte shërbimeve sekrete dhe policisë të gjurmonin direkt komunikimet e secilit dhe çdo qytetari pa kërkuar autorizim përgjimi nga ofruesi i shërbimeve të komunikimit ishte posaçërisht i prirur për abuzime. Prandaj nevoja për mbrojtje kundër arbitraritetit dukej posaçërisht e madhe.

Mbikqyrja e zbatimit të masave të vëzhgimit sekret

Gjykata mori në shqyrtim nëse mbikqyrja e gjurmimit ishte në përputhje me kërkesat sipas Konventës që organet mbikqyrëse të ishin të pavarura, të hapura

ndaj shqyrtimit publik dhe të mveshura me fuqi dhe kompetenca të mjaftueshme për të ushtruar kontroll efektiv dhe të vazhdueshëm.

Së pari, Gjykata shënoi që ndalimi i regjistrimit apo incizimit të përgjimeve i përcaktuar në të drejtën ruse e bënte të pamundur për autoritetin mbikqyrës të zbulonte përgjimet e kryera pa autorizimin e duhur gjyqësor. Në kombinim me aftësinë teknike të autoriteteve ligjzbatuese për të përgjuar direkt të gjitha komunikimet, ky ligj bënte që çdo veprim drejt mbikqyrjes të ishte i paaftë për të pikasur përgjimet e paligjshme, e rrjedhimisht jo efektiv.

Së dyti, mbikqyrja e përgjimeve të kryera mbi bazën e autorizimeve të duhura gjyqësore i ishte besuar Presidentit, Parlamentit dhe Qeverisë, të cilëve ligji rus nuk iu jepte asnjë tregues se si mund t'i mbikqyrnin përgjimet, si dhe prokurorëve kompetentë, mënyra e emërimit dhe përzierja e funksioneve të të cilëve, ku e njëjta prokurori jepte miratimin për kërkesat për përgjime e më pas mbikqyrjen e zbatimit, mund të ngrinte dyshime lidhur me pavarësinë e tyre. Më tej, fuqitë dhe kompetencat e prokurorëve ishin shumë të kufizuara, mbikqyrja që kryhej prej tyre nuk ishte e hapur ndaj shqyrtimit publik, dhe raportet e tyre të shkurtra gjysmë-vjetore mbi masat operationale të kërkimit ishin dokumente konfidenciale, jo të publikuara ose me qasje publike të ndonjë forme tjetër.

Së fundi, Gjykata konsideroi që mbikqyrja e përgjimeve nga prokurorët nuk ishte e aftë të ofronte garancitë e duhura dhe efektive kundër abuzimeve. Në lidhje me këtë pikë, Z. Zakharov kishte paraqitur dokumente që ilustronin pamundësinë e prokurorëve për të fituar qasje në materialet e fshehta të përgjimeve, ndërsa Qeveria nuk kishte paraqitur asnjë raport inspektimi ose vendimi nga prokurorët ku urdhërohej marrja e masave për të ndalur ose për të ndrequr një shkelje të pikasur të ligjit.

Njoftimi për përgjimin e komunikimeve dhe zgjidhjet në dispozicion

Çështja e njoftimit për përgjimin e komunikimeve ishte pazgjidhshmërisht e lidhur me efektivitetin e zgjidhjeve para gjykatave. Gjykata vuri re se në Rusi njerëzit komunikimet e të cilëve përgjoheshin nuk njoftoheshin në asnjë moment për këtë fakt – përveç rasteve kur ky informacion bëhej i ditur për shkak të përdorimit të tij si provë në procedura penale eventuale – dhe që mundësia për të marrë informata rreth përgjimeve ishte veçanërisht joefektive.

Zgjidhja ishte në dispozicion vetëm për personat të cilët posedonin informacione rreth përgjimit të komunikimeve të tyre. Kështu, efektiviteti i zgjidhjes në fjalë dëmtohej nga mungesa e kriterit për njoftimin e subjektit të përgjimit, ose mundësia e përshtatshme për të kërkuar dhe marrë informata rreth përgjimeve nga autoritetet. Rrjedhimisht, e drejta ruse nuk ofronte zgjidhje gjyqësore efektive ndaj masave sekrete të vëzhgimit në rastet kur nuk niste procedura penale kundër subjektit të përgjimeve. Gjithashtu, e drejta ruse nuk i ofronte zgjidhje efektive një personi që dyshonte se ai ose ajo i ishte nënshtruar vëzhgimeve sekrete. Duke ia mohuar subjektit të përgjimeve mundësinë efektive për kontestimin e përgjimeve në mënyrë retroaktive, e drejta ruse kështu i shmangej një mbrojtjeje të rëndësishme kundër përdorimit të paduhur të masave sekrete të vëzhgimit.

Përfundim

Gjykata arriti në përfundimin që dispozitat ligjore ruse që qeverisnin përgjimin e komunikimeve nuk ofronin garancitë e përshtatshme dhe efektive kundër arbitraritetit dhe rrezikut të abuzimeve. Mangësitë në kornizën ligjore të identifikuar nga Gjykata tregonin ekzistencën e praktikave arbitrare dhe abuzive të vëzhgimit, prandaj e drejta ruse nuk e përmbushte kriterin e “cilësisë së ligjit” dhe ishte e paaftë ta mbante përgjimin e komunikimeve brenda asaj që ishte “e nevojshme në një shoqëri demokratike”. Rrjedhimisht, kishte pasur shkelje të Nenit 8 të Konventës.

Neni 13

Duke pasur parasysh gjetjet sipas Nenit 8, nuk qe e nevojshme të shqyrtohej ankesa nga Neni 13 ndaras.

Neni 41

Gjykata vendosi që gjetja e një shkeljeje në vetvete përbënte shpërblim të drejtë të mjaftueshëm për çdo dëm jomaterial të pësuar nga kërkuesi. Më tej, ajo vendosi që Rusia t'i paguante atij shumën 40,000 Euro në lidhje me kosto dhe shpenzime.

Mbajtja e gjurmëve të gishtave dhe profilit të ADN- së nga autoritetet ka përbërë shkelje të Nenit 8

VENDIMI I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN S. DHE MARPER K. MBRETËRISË SË BASHKUAR

(Kërkesat Nr. 30562/04 dhe Nr. 30566/04)
4 dhjetor 2008

1. Faktet kryesore

Kërkuesit, S. dhe Michael Marper, ishin të lindur respektivisht në vitet 1989 dhe 1963, dhe jetonin në Mbretërinë e Bashkuar.

Më 19 janar 2001, S. u arrestua dhe u akuzua për grabitje në tentativë, në moshën njëmbëdhjetëvjeçare asokohe. Atij iu morën shenjat e gishtave dhe mostra e ADN-së. Ai u lirua më 14 qershor 2001. Z. Marper u arrestua më 13 mars 2001 dhe u akuzua për ngacmim të partneres së tij. Atij iu morën shenjat e gishtave dhe mostra e ADN-së. Më 14 qershor 2001, çështja u ndërpre zyrtarisht meqenëse ai dhe partnerja e tij ishin pajtuar.

Pas përfundimit të procedurave, të dy kërkuesit kërkuan pa sukses që shenjat e gishtave të tyre, mostrat e ADN-së së tyre, dhe profilet e tyre të asgjësoheshin. Informatat ishin ruajtur mbi bazën e një ligji që autorizonte mbajtjen e tyre për një kohë të pacaktuar.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesit u ankuan sipas Neneve 8 dhe 14 të Konventës për mbajtjen nga autoritetet të shenjave të tyre të gishtave, mostrave qelizore dhe profileve të ADN-së pas lirimit të tyre nga akuzat apo lëshimit të tyre.

Neni 8

Gjykata konsideroi që mostrat qelizore dhe profilet e ADN-së, si dhe shenjat e gishtave, përmbanin informacione të ndjeshme personale dhe që mbajtja e tyre përbënte ndërhyrje tek e drejta e kërkuesve për respekt ndaj jetës së tyre private, brenda kuptimit të Nenit 8 § 1 të Konventës. Gjithashtu, Gjykata shënoi që mbajtja e shenjave të gishtave të kërkuesve, të mostrave biologjike dhe profileve

të ADN-së kishin bazë të qartë në të drejtën vendase sipas Aktit të vitit 1984, dhe që ai synonte një qëllim legjitim, pra hetimin e rrjedhimisht parandalimin e krimin.

Gjykata vuri në pah se e drejta vendase duhet të ofronte mbrojtje për të parandaluar një përdorim të tillë të të dhënave personale që mund të ishte në shpërputhje me garancitë e Nenit 8. Më tej, nevoja për mbrojtje të tilla ishte edhe më e madhe kur bëhej fjalë për mbrojtjen e të dhënave personale që kalonin në përpunim automatik, e po ashtu kur të dhëna të tilla përdorshin për qëllime të policisë.

Çështja që duhet të merrej në konsideratë nga Gjykata në këtë rast ishte nëse mbajtja e shenjave të gishtave dhe të dhënave të ADN-së së kërkuesve, si persona që kishin qenë të dyshuar, por jo të dënuar, për vepra të caktuara penale, ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike.

Gjykata mori parasysh në mënyrën e duhur parimet thelbësore të instrumenteve përkatëse të Këshillit të Evropës si dhe të drejtën dhe praktikën e Shteteve të tjera Kontraktuese, sipas të cilave mbajtja e të dhënave duhet të ishte proporcionale në relatë me qëllimin e marrjes së tyre dhe e kufizuar në kohë.

Mbretëria e Bashkuar në atë kohë dukej se ishte i vetmi juridiksion brenda Këshillit të Evropës që lejonte mbajtjen e pacaktuar të shenjave të gishtave dhe materialit të ADN-së së çdo personi të çfarëdo moshe që dyshohej për ndonjë veprë të regjistrueshme. Të dhënat në fjalë mund të mbaheshin pavarësisht nga natyra e peshës së veprës për të cilën ishte dyshuar fillimisht individit apo nga mosha e të shkelësit të dyshuar; mbajtja nuk ishte e kufizuar në kohë; dhe ekzistonin vetëm mundësi të pakta që një individ të liruar nga akuza t'i hiqeshin të dhënat nga baza e të dhënave apo t'i asgjësoheshin materialet.

Gjykata shprehu shqetësim të veçantë për rrezikun e stigmatizimit, nga fakti që personat në pozitën e kërkuesve, të cilët nuk ishin dënuar për ndonjë veprë dhe kishin të drejtën e prezumimit të pafajësisë, ishin trajtuar në të njëjtën mënyrë si personat e dënuar. Mbajtja e të dhënave të personave të padënuar mund të ishte posaçërisht e dëmshme në rastin e të miturve siç ishte kërkuesi i parë, duke pasur parasysh situatën e tyre të veçantë dhe rëndësinë e integritetit të tyre në shoqëri.

Në përfundim, Gjykata gjeti që natyra gjithëpërfshirëse dhe joveçuese e fuqisë për të mbajtur shenjat e gishtave, mostrat qelizore dhe profilet e ADN-së së personave të dyshuar por jo të dënuar për vepra, siç është rasti i kërkuesve

në fjalë, nuk arrinte të vinte një ekuilibër të drejtë mes interesave konkurruese publike dhe private, dhe që Shteti i paditur kishte tejkaluar çdo hapësirë të pranueshme vlerësimi në këtë pikë. Rrjedhimisht, mbajtja në fjalë përbënte ndërhyrje joproporcionale tek e drejta e kërkuesve për respekt ndaj jetës private dhe nuk mund të shihej si e nevojshme në një shoqëri demokratike. Gjykata arriti në përfundimin që kishte pasur shkelje të Nenit 8 në këtë rast.

Neni 14 në lidhje me Nenin 8

Duke pasur parasysh arsyetimin që shpuri drejt përfundimit të saj sipas Nenit 8 lart, nuk qe e nevojshme të shqyrtohej ndaras ankesa sipas Nenit 14.

Article 41

Gjykata konsideroi që gjetja e një shkeljeje, me pasojat që kjo mund të kishte për të ardhmen, mund të shihej si e tillë që përbënte shpërblim mjaft të drejtë në lidhje me dëmet jomateriale të pësuar nga kërkuesit. Gjykata u caktoi kërkuesve 42,000 Euro në lidhje me kostot dhe shpenzimet, minus shumën tashmë të paguar atyre në ndihmë ligjore.

Neni 46

Gjykata shënoi që, në përputhje me Nenin 46 të Konventës, do t'i takonte Shtetit të paditur të zbatonte, nën mbikqyrjen e Komitetit të Ministrave, masat e përshtatshme të përgjithshme dhe/ose individuale për të përmbushur detyrimet e tij për të siguruar të drejtën e kërkuesve dhe personave të tjerë në pozitat e tyre për respekt ndaj jetës së tyre private.

Mbledhja dhe shpërndarja e të dhënave mjekësore të kërkueses dhe fëmijëve të saj nga një autoritet publik drejt autoriteteve të tjera, pa pëlqimin e kërkueses, ka shkelur Nenin 8

VENDIMI NË ÇËSHTJEN Y.Y. k. RUSISË

(Kërkesa Nr. 40378/06)
23 shkurt 2016

1. Faktet kryesore

Kërkuesja, Znj. Y.Y., ishte shtetase ruse e lindur në vitin 1966 e cila jetonte në Shën Peterburg. Në prill të vitit 2003 ajo lindi para kohe dy binjakë në një spital të maternitetit në Shën Peterburg ("spitali i maternitetit"). Bebja vajzë vdiq nëntë orë pas lindjes, por bebja djalë mbijetoi pasi u transferua në repartin e ringjalljes dhe terapisë intensive në një spital fëmijësh njëzet orë pas lindjes. Kërkuesja ishte e mendimit që edhe vajza e saj do të kishte mbijetuar po të ishte transferuar menjëherë në repartin e ringjalljes dhe terapisë intensive.

Nga maji deri në gusht të vitit 2003, nëna e kërkueses i dërgoi tre telegrame Presidentit të Federatës Ruse. Ajo u ankua që mbesa e saj nuk kishte marrë trajtimin e duhur emergjent për shkak të listave të gjata të pritjes dhe vonesave në transferime, dhe i kërkoi qeverisë të zhvillonte hetime rreth rastit.

Këto telegrame iu përcollën Ministrisë së Shëndetësisë të Federatës Ruse ("Ministria"). Ministria i kërkoi Komitetit të Shëndetësisë në Administratën e Qytetit të Shën Peterburgut ("Komiteti") që të shqyrtonte akuzat dhe të ndërmernte veprime. Komiteti kërkoi që një komision ekspertësh të hetonte çështjen duke shfrytëzuar materialet dokumentuese të kërkueses dhe të binjakëve, të cilat u nxorën nga materniteti dhe spitalet e fëmijëve. Raporti hetimor konkludoi që bebes vajzë i ishte dhënë trajtimi i duhur për gjendjen e saj, duke pasur parasysh sa serioze ishte. Ajo shënoi që raste të tilla kishin 80% rrezik vdekjeje dhe transferimi i hershëm nuk garantonte jetën. Në shtator 2003, raporti iu dërgua Ministrisë dhe një letër me konkluzionet e raportit iu dërgua nënës së kërkueses. Në dhjetor 2003, kërkuesja mori një letër të ngjashme me atë të nënës së saj.

Në shkurt 2005, kërkuesja nisi procedurën kundër Komitetit, duke kërkuar një deklaram që ai kishte vepruar në mënyrë të paligjshme kur kishte marrë dhe shqyrtuar të dhënat e saj mjekësore dhe ato të fëmijëve të saj, dhe ia kishte

komunikuar Ministrisë pa marrë pëlqimin e saj. Kërkuesja po ashtu kërkoi që raporti të deklarohet i pavlefshëm. Në dhjetor 2005, Gjykata e Rrethit Kuybyshevskiy të Shën Peterburgut e rrëzoi kërkesën e saj, dhe, në mars 2006, Gjykata e Qytetit të Shën Peterburgut më tej rrëzoi apelin e saj.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesja u ankua që të drejtat e saj sipas Nenit 8 (e drejta për respekt ndaj jetës private dhe familjare, shtëpisë dhe korrespondencës) ishin shkelur nga Komiteti me marrjen dhe shqyrtimin e të dhënave mjekësore të saj dhe të fëmijëve të saj dhe përcjelljen e rezultateve të këtij ekzaminimi tek Ministria pa pëlqimin e saj.

Neni 8

Gjykata vërejtë që të dyja palët e pranonin që telegramet fillestare, të cilat e nxitën Komitetin për të mbledhur, hetuar dhe shpërndarë të dhënat mjekësore të kërkueses dhe fëmijëve të saj, e kishin origjinën tek nëna e kërkueses e jo tek vetë kërkuesja. Pëlqimi i kërkueses as nuk u kërkua e as nuk u dha në asnjë moment. Për më tepër, kërkuesja tha se të dhënat e saj mjekësore përmbanin informata personale dhe të ndjeshme, përfshirë numrin e shtatzanive të saj që nuk kishin rezultuar në lindje. Gjykata më herët kishte gjetur se zbulimi i të dhënave mjekësore, që përmbanin informata personale dhe të ndjeshme, pa pëlqimin e pacientes përbënin ndërhyrje tek e drejta e pacientes për respekt ndaj jetës private. Megjithëse Qeveria deklaroi që kërkuesja kishte bërë ankesa të ngjashme me ato të nënës së vet, Gjykata vërejtë që kjo nuk ishte konstatuar në procedurat civile vendase e as nuk mbështetej në ndonjë provë.

Prandaj, Gjykata deklaroi që veprimet në fjalë ishin ndërhyrje në të drejtën e kërkueses për respekt ndaj jetës private siç garantohet nga Neni 8 § 1.

Më tej Gjykata konsideroi nëse ndërhyrja ishte e justifikuar. Ajo vërejtë që për të qenë "në përputhje me ligjin", masa e kundërshtuar duhet të ketë bazën e vet në të drejtën vendase dhe të jetë e përputhshme me sundimin e ligjit. Kjo do të thotë që ligji duhet të jetë i disponueshëm dhe i parashikueshëm në mënyrë që t'u mundësojë individëve që të rregullojnë sjelljen e tyre. Gjykatat vendase gjithashtu duhet të ndërmarrin një shqyrtim kuptimplotë të veprimeve të autoriteteve që prekin të drejtat e Konventës. U përsërit që sqarimi dhe interpretimi i të drejtës vendase duhet të bëhet kryesisht nga autoritetet vendase, megjithëse ishte brenda funksionit të Gjykatës që ta shqyrtonte këtë arsyetim.

Në rastin konkret, Gjykata së pari shënoi që Komiteti nuk u mbështet në ndonjë dispozitë të ligjeve vendase gjatë zhvillimit të veprimeve në fjalë. Megjithëse e drejta vendase përmbante një listë shteruese të përjashtimeve nga rregulla e përgjithshme e mos-zbulimit, gjykatat nuk u mbështetën në asnjërin prej tyre kur bënë gjetjet e veta. Së dyti, Gjykata nuk qe dakord me pretendimin e gjykatave vendase që Komiteti kishte për detyrë t'i jepte informacione konfidenciale Ministrisë, meqenëse gjykatat nuk arritën t'i referoheshin ndonjë dispozite të së drejtës vendase mbi të cilën mund të ishte bazuar kjo gjetje. Edhe nëse supozohet se ato kishin në mend të mbështeteshin në disa dispozita që kanë të bëjnë me fuqitë e përgjithshme të Ministrisë dhe Komitetit, këto nuk përfshinë asnjë rregullë specifike lidhur me konfidencialitetin e të dhënave mjekësore. Prandaj, u konkludua që, pavarësisht nga pasja e mundësisë formale për shqyrtim juridik, kërkesja nuk kishte as shkallën minimale të mbrojtjes kundër arbitraritetit dhe veprimet e kontestuar nuk përbënin aplikim të parashikueshëm të së drejtës përkatëse ruse.

Prandaj, Gjykata deklaroi që ndërhyrja tek e drejta e kërkueses për respekt ndaj jetës private nuk ishte në përputhje me ligjin brenda kuptimit të Nenit 8 § 2, që do të thotë se nuk kërkohej të përcaktohej nëse kjo ndërhyrje synonte një qëllim legjitim. U vendos që kishte shkelje të Nenit 8.

Neni 41

Gjykata i caktoi 5,000 Euro kërkueses në lidhje me dëme jomateriale dhe 1,425 Euro për kosto ligjore dhe shpenzime.

IX. Jeta familjare

Mohimi i kontaktit mes kërkuesit dhe bijës së tij të adoptuar gjatë marrjes së saj, shtrimin të saj në spital dhe kohës që ajo kaloi në kujdestari për shkak të mungesës së pëlqimit për trajtimin e saj mjekësor ka shkelur Nenin 8, përveç periudhës kur ka qenë proporcional për shkak të karantinës së gripit

VENDIMI NË ÇËSHTJEN KUIMOV K. RUSISË

(Kërkesa Nr. 32147/04)

8 janar 2009

1. Faktet kryesore

Kërkuesi ishte shtetas rus i lindur në vitin 1958. Në maj të vitit 2000, ai dhe bashkëshortja e tij adoptuan një vajzë e cila ishte e lindur në vitin 1997.

Në tetor 2003, prindërit kontaktuan Spitalin e Fëmijëve të Rajonit Kirov ("spitali") për shkak të përkeqësimit të shikimit të bijës së tyre, zbehtësisë në fytyrë, të vjellurave, oreksit të dobët dhe ngathtësisë. Gjatë muajit në vijim, ajo u diagnostikua me encefalomieli akut dhe, pavarësisht nga rekomandimet e mjekut, kërkuesi dhe bashkëshortja e tij refuzuan të jepnin pëlqimin për shtruarjen e saj në spital. Megjithatë ajo u shtrua në spital për trajtim mjekësor dhe nëna e saj i qëndroi pranë.

Nga fundi i tetorit dhe fillimi i nëntorit 2003, spitali në mënyrë të përsëritur iu tha prindërve që fëmija duhet të dërgohej në repartin e kujdesit intensiv, gjë që ata e kundërshtuan. Kërkuesi pretendoi që në nëntor 2003, një punonjës i spitalit dhe një burrë që pretendoi se ishte psikoterapist, e morën në pyetje bashkëshorten e tij. U duk se ajo e kishte penguar stafin mjekësor nga zbatimi i masave mjekësore mbi fëmijën e saj, me mundësinë e vënies në rrezik të jetës së fëmijës së saj. Këto veprime ngritën dyshime rreth gjendjes së saj psikologjike dhe intervista u konsiderua e justifikuar për të mbrojtur jetën e fëmijës. Në të dilej me konkluzion se ajo "nuk kishte nevojë për trajtim psikiatrik".

Në nëntor 2003 menaxhmenti i spitalit i informoi prindërit për vendimin që fëmija të shtrohej në repartin e kujdesit intensiv, dhe e ndanë atë nga nëna e saj. Menaxhmenti i paralajmëroi prindërit që, nëse nëna refuzonte të largohej nga spitali, ai do të kontaktonte Agjencinë e Mbatjes dhe Kujdestarisë ("Agjencia") aty për t'i kërkuar ndihmë.

Të nesërmen e asaj dite, kërkuesi u ankua pranë Departamentit të Shëndetësisë të Rajonit Kirov për ndërhyrje në jetën e tij private dhe për vizitën e psikoterapistit. Ai gjithashtu vuri në pikëpyetje nevojshmërinë e vendosjes së vajzës së tij nën kujdes intensiv. Kjo u rrëzua afro një muaj më pas.

Më 11 dhjetor 2003, mjeku kryesor i spitalit, një zyrtar ("zyrtari") nga Agjencia, dhe një polic i kërkuan kërkuesit dhe bashkëshortes së tij që ta shtronin fëmijën e tyre në repartin e kujdesit intensiv. Kur ata refuzuan, zyrtari u paraqiti një urdhër për ta marrë fëmijën. Më pas kërkuesi nisi veprime gjyqësore kundër urdhrit, të cilat u rrëzuan nga Gjykata e Rrethit në shkurt 2004. Kërkuesi apeloj, por apeli u rrëzua në prill 2004.

U duk që, pas marrjes së fëmijës dhe gjatë tërë vitit 2004, kërkuesi dhe bashkëshortja e tij u përpoqën ta vizitonin vajzën disa herë për t'i sjellë ushqime dhe lodra, por autoritetet e spitalit dhe autoriteti vendas i refuzuan këto kontakte pa dhënë arsye. Në qershor 2004, prindërit bënë kërkesa të pasuksesshme për urdhër gjyqësor kundër spitalit dhe autoritetit vendas, për t'i ndaluar ata që të ndërhyjnë në të drejtën e tij dhe gruas së tij për të komunikuar me fëmijën dhe për të marrë pjesë në rritjen e saj.

Në nëntor 2004 Prokurori i Gjykatës së Rrethit Pervomayskiy në Kirov aplikoi me sukses në një gjykatë për tërheqjen e adoptimit të fëmijës, për çka kërkuesi apeloj. U shënua që kërkuesi kishte adoptuar tre fëmijë të tjerë, një prej të cilëve kishte vdekur nga një sëmundje e ngjashme dhe një tjetër që ishte po ashtu objekt i një urdhri për tërheqje pas refuzimit të trajtimit mjekësor. Në dhjetor 2004, Gjykata Rajonale e Kirov e prishi vendimin për tërheqjen e adoptimit por mbështeti vendimin për transferimin e mbajtjes së fëmijës tek Agjencia. Pas kësaj, rifilluan procedurat në lidhje me kontaktet. Gjykata urdhëroi administratën dhe spitalin që të mos ndërhyjnë tek e drejta e prindërve për të komunikuar me fëmijën e tyre dhe për të marrë pjesë në rritjen e saj. Apeli i të parëve u rrëzua në janar 2005.

Nga 25 janari 2005, menaxhmenti i shtëpisë kujdestare i refuzoi kërkuesit qasje tek fëmija për shkak të karantinës së gripit që ishte shpallur. Megjithatë, ata mundën të flisnin në telefon dhe ta shihnin njëri-tjetrin përmes dritares. Kur u hoq karantina më 24 mars 2005, kërkuesit menjëherë iu lejua kontakti personal rregullisht.

Më 13 tetor 2005, Gjykata e Rrethit Pervomayskiy deklaroi që fëmija mund t'i kthehej prindërve të saj, dhe ajo u kthye më 2 nëntor 2005.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi u ankua, duke u mbështetur në Nenin 8, që autoriteti i kishin mohuar atij qasje tek fëmija i vet pas marrjes së saj, gjatë qëndrimit të saj në spital, dhe gjatë kohës që ajo ishte nën kujdestari.

Neni 8

Gjykata përsëriti që gëzimi i shoqërisë së njëri-tjetrit mes prindit dhe fëmijës është element themelor i jetës familjare dhe që kjo marrëdhënie nuk përfundohet nga fakti që fëmija merret nën kujdestari. Prandaj, Gjykata gjeti që kufizimet në qasjen e kërkuesve tek fëmija i tyre mes 11 dhjetorit 2003 (kur ajo u mor për trajtim mjekësor) dhe 2 nëntor 2005 (kur ajo iu kthye kërkuesit dhe bashkëshortes së tij) kanë përbërë ndërhyrje në të drejtën e tij për respekt ndaj jetës familjare.

Pas kësaj, Gjykata iu kthye çështjes nëse masa në fjalë ka qenë "në përputhje me ligjin". Ajo përsëriti që fuqia e saj për të shqyrtuar pajtueshmërinë me të drejtën vendase është e kufizuar dhe që u takon kryesisht autoriteteve vendase të interpretojnë dhe ta zbatojnë atë të drejtë. Ajo vërejtë që kufizimet në qasjen tek fëmija janë shqyrtuar nga gjykatat vendase dhe që në gjykimet e tyre nuk kishte asnjë sugjerim që ato ishin në kundërshtim me të drejtën ruse. Ndërhyrja në fjalë, pra, ishte "në përputhje me ligjin". Për më tepër, u vu re që kufizimet në qasjen e kërkuesit tek fëmija u caktuan për qëllimin legjitim të mbrojtjes së shëndetit të saj dhe të drejtave të saj.

Më tej u konsiderua nëse masat në fjalë mund të shiheshin si "të nevojshme në një shoqëri demokratike", pra proporcionale me qëllimin legjitim të synuar. U theksua hapësira e vlerësimit e Shtetit. Gjithashtu u përsërit që një urdhër për kujdestari në parim duhet të konsiderohej si masë e përkohshme, që do të ndërpritet sapo të lejojnë rrethanat, dhe çdo masë në drejtim të zbatimit të kujdestarisë së përkohshme duhet të jetë në përputhje me qëllimin përfundimtar të ribashkimit të prindërve dhe fëmijës. Kështu, kufizimet e rrepta dhe të gjata të qasjes të cilat zgjasin shumë kishin më shumë gjasa që të ishin joproporcionale me qëllimet legjitime të synuara. Gjykata e pa me vend që të shqyrtonte ankesat e kërkuesit ndaras në lidhje me dy periudha: mes 11 dhjetorit 2003 dhe 25 janarit 2005; dhe prej 25 janarit deri më 2 nëntor 2005.

Në lidhje me të parën, Gjykata shënoi që fëmija ishte marrë nga familja e saj më 11 dhjetor 2003 dhe që, pavarësisht nga kërkesat eksplicite dhe të shumta të kërkuesit dhe gruas së tij për të parë vajzën e tyre, autoritetet ua kishin mohuar këtë mundësi për një vit një muaj e pesëmbëdhjetë ditë deri më 25 janar 2005, që është data kur gjykatat vendase i urdhëruan autoritetet të mos ndërhyjnë tek e drejta e prindërve për të komunikuar me fëmijën e tyre dhe për të marrë pjesë në rritjen e saj. U shënua që as marrja e fëmijës prej familjes që e kishte adoptuar e as transferimi nën kujdestarinë e Agjencisë më 28 dhjetor 2004 nuk e kishin privuar kërkuesin nga e drejta e tij për të komunikuar me fëmijën sipas ligjeve ruse, nëse nuk kishte pasur efekt negativ tek ajo.

Prandaj, Gjykata gjeti shkelje të Nenit 8 për shkak të kufizimeve të rrepta e të pajustificuara që ishin imponuar nga autoritetet në qasjen e kërkuesit tek fëmija mes 11 dhjetorit 2003 dhe 25 janarit 2005.

Në lidhje me mungesën e supozuar të qasjes mes 25 janarit dhe 25 marsit 2005, Gjykata e pranoi shpjegimin e Qeverisë, meqenëse nga materialet e dosjes së lëndës doli që qasja në shtëpinë e kujdestarisë vërtet ishte kufizuar për shkak të karantinës së gripit. Kjo nuk zgjati më shumë se ç'është e arsyeshme dhe, përveç saj, kërkuesi u lejua të vinte e ta shihte vajzën nga xhami i dritares çdo javë në shkurt dhe në mars 2005. Po kështu, pasi u hoq karantina e gripit më 25 mars dhe deri më 2 nëntor 2005 kur fëmija iu kthye kërkuesit dhe gruas së tij, kërkuesi u lejua ta vizitonte atë çdo javë, secilën herë nga një orë. Gjatë shumicës së këtyre takimeve kërkuesi gjithashtu pati mundësinë të shihte pediatrin e saj dhe kujdestarin e saj, si dhe t'i sillte vajzës ëmbëlsira, rroba dhe gjëra të tjera. Prandaj, Gjykata nuk gjeti shkelje të Nenit 8 tek kufizimet e vëna nga autoritetet gjatë kësaj periudhe.

Neni 41

Gjykata i caktoi kërkuesit 5,000 Euro në lidhje me dëme jomateriale dhe 5,000 Euro në lidhje me kosto dhe shpenzime.

Vendimi gjithëpërfshirës për të mos i kthyer kufomat pranë familjeve të tyre ose për të mos u treguar familjeve vendvarrimet e kryengritësve u konsiderua joproportional me qëllimet legjitime, në shkellje të Nenit 8

VENDIMI NË ÇËSHTJEN SABANCHIYEVA DHE TË TJERË k. RUSISË

(Kërkesa Nr. 38450/05)

6 qershor 2013

1. Faktet kryesore

Kërkuesit ishin 50 shtetas rusë që jetonin në Nalchnik në Republikën e Kabardino-Balaria. Ata parashtruan që ishin të afërmit e 55 kryengritësve që ishin vrarë gjatë një sulmi kundër agjencive ligjzbatuese në Nalchnik në tetor 2005. Autoritetet e pohuan që të gjithë të vdekurit e përmendur nga kërkuesit kishin qenë në mesin e të vrarëve si pasojë e sulmit.

Menjëherë pas sulmeve, disa prej kërkuesve firmosën peticione kolektive që kërkonin kthimin e trupave të të afërmeve të tyre për varrim, por pa sukses. Në fund, në një vendim të 15 majit 2006, autoritetet vendosën t'i kthenin trupat e kryengritësve, por vetëm pasi i dogjën kufomat dhe nuk iu treguan kërkuesve se ku ishte vendosur hiri. Përpjekjet fillestare të kërkuesve për të pasur shqyrtim gjyqësor të vendimit qenë të pasuksesshme meqenëse gjykatat refuzuan të shqyrtonin argumentet e tyre. Disa prej kërkuesve e kontestuan Aktin për Shtypjen e Terrorizmit dhe Dekretin e vitit 2003 para Gjykatës Kushtetuese. Në një vendim të vitit 2007, Gjykata Kushtetuese mbështeti legjislacionin duke e quajtur në pajtueshmëri me Kushtetutën. Megjithatë, ajo e interpretoi atë si të tillë që i ndalonte autoritetet nga djegia e trupave nëqoftëse një gjykatë nuk konfirmonte vendimin e autoritetit kompetent.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesit u ankuan, sipas Nenit 3, për kushtet në të cilat autoritetet i kishin mbajtur trupat e të afërmeve të tyre për identifikim. Ata pretenduan në mënyrë të veçantë se, gjatë katër ditëve të para pas sulmit, disa trupa ishin mbajtur jashtë morgut të qytetit për mungesë hapësire dhe, pas kësaj, ato ishin vendosur njëri mbi tjetrin në vagona frigoriferikë. Më tej, ata u ankuan për refuzimin e autoriteteve që t'i kthenin trupat e të afërmeve të tyre dhe pretenduan që legjislacioni kishte qenë diskriminues sepse ai

synonte vetëm ndjekësit e besimit islam, duke u mbështetur në Nenin 8, 13 dhe 14. Ata gjithashtu pretenduan që Qeveria kishte fshehur dokumente nga dosjet e tyre që ishin relevante për çështjen, duke u mbështetur në Nenin 38 § 1.

Neni 3

Gjykata theksoi se keqtrajtimi duhet të arrijë një nivel minimal rreptësie për të hyrë brenda fushëveprimit të Nenit 3. Vlerësimi i këtij minimumi është relativ në varësi të të gjitha rrethanave të çështjes, siç është kohëzgjatja e trajtimit, efektet e tij fizike dhe/ose mendore dhe, në disa raste, seksi, mosha dhe gjendja shëndetësore e viktimës. Gjykata kishte ndërmarrë një qasje të kufizuar për sa i përket ankesave rreth vuajtjeve morale të të afërmve të viktimave të pretenduara të operacioneve të sigurisë të zhvilluara nga autoritetet. Për shembull, ndërkohë që një familjar i një "personi të zhdukur" kishte pretenduar me sukses se ishte viktimë e trajtimit në kundërshtim me Nenin 3, i njëjti parim zakonisht nuk aplikohet në situata kur personi i marrë në mbajtje më vonë gjendej i vdekur. Më tej u përsërit që pretendimet për keqtrajtimit duhet të mbështeten nga provat e duhura, çka vlerësohet sipas standardit të provës "përtej dyshimit të arsyeshëm". Ajo shtoi që prova të tilla mund të rrjedhin nga bashkekzistenca e konkluzioneve të nxjerra që janë mjaftueshëm të forta, të qarta dhe të përputhshme ose të prezumimeve ngjashëm të pakundërshtuara të faktit.

U njoh fakti që kushtet e mbajtjes së trupave të të afërmve mund t'u kishin shkaktuar vuajtje kërkuesve, meqenëse Qeveria kishte pranuar që objektet lokale të mbajtjes në frigorifer kishin qenë të pamjaftueshme për të mbajtur të gjitha kufomat katër ditët e para pas sulmit dhe që, edhe pas kësaj, ato ishte dashur të vendoseshin një mbi një për t'u ruajtur në vagonat frigoriferikë. Megjithatë, këto mangësi kishin qenë rezultat i vështirësive logjistike të shkaktuara nga ngjarjet e tetorit 2005 si dhe nga numri i madh i të vrarëve. Nuk kishte pasur synim të qëllimshëm të trajtimit çnjerëzor të kërkuesve apo shkaktimit të vuajtjeve psikologjike atyre. Për më tepër, vdekjet e të afërmve nuk kishin rezultuar nga veprimet e autoriteteve në kundërvënje ndaj Nenit 2, në kundërshtim me praktikën gjyqësore të përmendur më lart, dhe nuk mund të thuhet se ata kishin vuajtur ndonjë pasiguri të gjatë sa i përket fatit të të afërmve të tyre, duke pasur parasysh pjesëmarrjen e tyre vullnetare në procesin e identifikimit. Gjykata gjeti që rrethanat e kërkuesve nuk dallonin, sa i përket emocioneve apo karakterit, nga shqetësimi emocional që mund të shihet si i tillë që pashmangshmërisht i është shkaktuar çdo anëtar i familjes së një personi të vdekur në një situatë të ngjashme. Prandaj, nuk ka pasur shkelje të Nenit 3.

Neni 8

Gjykata shënoi që, në Rusi, të afërmit e personave të vdekur që duan të organizojnë varrimin përgjithësisht gëzojnë garancinë statusore që trupat t'u kthehen menjëherë për t'u varrosur pasi të jetë konstatuar shkaku i vdekjes. Prandaj, refuzimi i autoriteteve për të kthyer trupat kishte përbërë përjashtim nga rregulla e përgjithshme. Për më tepër, kjo qartazi i kishte privuar kërkuesit nga mundësia për të organizuar dhe marrë pjesë në varrimin e të afërmeve të tyre si dhe të dinin lokacionin e varrezës për vizita potenciale. Prandaj, vendimet për të mos i kthyer trupat pranë familjeve të tyre kishin përbërë ndërhyrje në jetën private dhe familjare të kërkuesve, me përjashtim të kërkueses së nëntëmbëdhjetë e cila nuk ishte zyrtarisht e martuar me njërin prej viktimave por kishte bashkëjetuar me të qysh prej shkurtit 2005, ku vendimi u gjet se përbënte ndërhyrje vetëm në jetën e saj private.

Gjykata gjithashtu konsideroi që refuzimi i autoriteteve për t'i kthyer trupat, bazuar mbi Aktin për Shtypjen e Terrorizmit dhe Dekretin e vitit 2003, kishte bazë ligjore në të drejtën ruse. Refuzimi po ashtu kishte pasur qëllime legjitime, pra parandalimin e trazirave gjatë varrimeve, mbrojtjen e ndjenjave të të afërmeve të viktimave, dhe minimizimin e impaktit psikologjik mbi popullatën.

Gjykata më pas mori në shqyrtim nëse masa ishte "e nevojshme në një shoqëri demokratike", pra nëse ajo i përgjigjej një "nevoje shoqërore urgjente" dhe, në mënyrë të veçantë, nëse ishte proporcionale me qëllimin legjitim të synuar, dhe nëse arsyet e nxjerra nga autoritetet nacionale për ta justifikuar atë ishin "relevante dhe të mjaftueshme". U theksua që autoritetet kompetente nacionale kanë hapësirë vlerësimi e cila ndryshon varësisht nga faktorë që përfshijnë natyrën e të drejtës në fjalë, rëndësinë e saj për individin, natyrën e ndërhyrjes dhe objektivin e ndërhyrjes. Ajo përsëriti që, në rastet e dala nga kërkesat individuale, detyra e saj zakonisht nuk është të shqyrtojë legjislacionin përkatës ose ndonjë praktikë të veçantë në abstrakt. Detyra e saj është të përcaktojë efektin e ndërhyrjes tek e drejta e kërkuesve të veçantë për jetën private dhe familjare.

Gjykata vërejti që ajo ishte e vetëdijshme që Shtetet përballëshin me sfida të veçanta për shkak të terrorizmit dhe dhunës terroriste, kështu që autoritetet me arsye pritet që të ndërhyjnë me qëllim të shmangies së trazirave të mundshme apo veprimeve të paligjshme nga përkrahësit ose kundërshtarët e akvitetive të të vdekurve. Megjithatë, Gjykata e kishte të vështirë të pajtohej që qëllimet e përmendura nga Qeveria, sado legjitime, kishin qenë justifikim i mundur për

t'u mohuar kërkuesve pjesëmarjen në ceremonitë funebre, ose të paktën një lloj mundësie për të bërë homazhet e fundit. Në fakt, ndalimi i plotë i zbulimit të lokacionit të varrezave e shkëputte përfundimisht çdo lidhje mes kërkuesve dhe eshtrave të të afërmeve të tyre.

Për më tepër, duke vendosur që të mos i kthenin trupat, autoritetet nuk kishin përdorur një qasje 'sipas rastit' dhe as nuk kishin marrë në konsideratë rrethanat individuale të secilit prej të vdekurve dhe ato të familjarëve të tyre. Përkundrazi, ato vendime kishin qenë thjesht automatike, dhe kishin injoruar detyrën e autoriteteve sipas Nenit 8 për t'u siguruar që çdo ndërhyrje në të drejtën për respekt ndaj jetës private dhe familjare të ishte e justifikuar dhe proporcionale në rrethanat individuale të secilit rast. Në mungesë të një qasjeje të tillë të individualizuar, refuzimi ishte dukur të kishte kryesisht efekt ndëshkues tek kërkuesit duke transferuar barrën e pasojave të pafavorshme prej aktiviteteve të personave të vdekur tek të afërmit e tyre.

Prandaj, Gjykata konkludoi që refuzimi për t'i kthyer trupat pranë familjeve të tyre kishte përbërë shkelje të të drejtave të kërkuesve për respekt të jetës së tyre private dhe familjare, me përjashtim të kërkueses së nënëmbëdhjetë, refuzimi i së cilës u gjet se përbënte vetëm shkelje të së drejtës së saj për jetë private.

Neni 13 i marrë në lidhje me Nenin 8

U shënuar që Neni 13 garanton mundësinë e një zgjidhjeje në nivel nacional përmes së cilës bëhet ankesë për shkelje të të drejtave të Konventës. Megjithëse Shtetet kanë diskrecion, zgjidhja duhet të përfshijë një organ kompetent që trajton substancën e ankesës dhe shpërblimin e duhur. Gjykata përsëriti se fushëveprimi i këtij detyrimi dallon në varësi të natyrës së ankesës së kërkuesve, por sidoqoftë zgjidhja duhet të jetë "efektive" në praktikë dhe në ligj, posaçërisht në sensin që ushtrimi i saj nuk duhet të pengohet pa arsye nga veprimet ose mosveprimet e autoriteteve të Shtetit.

Ajo vuri në dukje mungesën e mbikqyrjes gjyqësore efektive në lidhje me vendimet e autoriteteve për të mos i kthyer trupat pranë familjeve. Megjithëse Vendimi i vitit 2007 i marrë nga Gjykata Kushtetuese e kishte përmirësuar situatën e kërkuesve, gjykatat ruse kishin vazhduar të ishin organi kompetent për të shqyrtuar vetëm ligjshmërinë formale të masave dhe jo nevojshmërinë për masën si e tillë. Prandaj, legjislacioni nuk u kishte ofruar kërkuesve mbrojtje procedurale të mjaftueshme kundër arbitraritetit. Në fakt, ata nuk kishin gëzuar mundësinë

efektive të apelimit kundër vendimit të 15 majit 2006 për shkak të refuzimit të autoriteteve për t'iu dhënë atyre një kopje të vendimit të tyre dhe kompetenca e kufizuar e gjykatave në shqyrtimin e vendimeve të tilla. Kështu pra, Gjykata konkludoi që kishte pasur shkelje të Nenit 13 i marrë së bashku me Nenin 8.

Neni 14 i marrë në lidhje me Nenin 8

Gjykata nuk gjeti tregues që i mundësonin daljen në përfundimin se legjislacioni kishte qenë i drejtuar ekskluzivisht kundër ndjekësve të besimit islam. Prandaj, Gjykata konkludoi që nuk kishte pasur shkelje të Nenit 14 i marrë në lidhje me Nenin 8.

Neni 38 § 1

Ky detyrim u kërkon Shteteve që t'i sigurojnë të gjitha ambientet e nevojshme Gjykatës për të bërë të mundur shqyrtimin e duhur dhe efektiv të kërkesave. Gjykata vërejti që Qeveria kishte paraqitur kopje të dokumenteve që kishin lehtësuar në masë të konsiderueshme shqyrtimin e çështjes, dhe prandaj konkludoi që nuk kishte pasur shkelje të Nenit 38 § 1.

Neni 41

Gjykata vendosi që gjetja e një shkeljeje përbënte shpërblim të drejtë të mjaftueshëm për dëmet jomateriale të pësuar nga kërkuesit, dhe u caktoi atyre 15,000 Euro së bashku në lidhje me kostot dhe shpenzimet.

X. Liria e shprehjes/e drejta për informacione

Dështimi i autoriteteve për të informuar popullatën lokale për rrezikun e aksidenteve nga një fabrikë kimikatesh aty afër dhe për procedurën që duhet ndjekur nëse ndodh diçka e tillë ka shkelur Nenin 8

VENDIMI I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN GUERRA DHE TË TJERË k. ITALISË

(Kërkesa Nr. 14967/89)
19 shkurt 1998

1. Faktet kryesore

Të dyzet kërkuesit jetonin të gjithë në Manfredonia, e cila ndodhet rreth një kilometër larg fabrikës së kimikateve Enichem në Monte Sant'Angelo. Fabrika prodhonte plehra kimike për fertilizim dhe kaprolaktam, dhe ishte e klasifikuar "me rrezikshmëri të lartë" në vitin 1988 me anë të Dekretit Presidential Nr. 175 ("DPR 175/88") i cili implementoi Direktivën e Këshillit të Komuniteteve Evropiane 82/501/EEC ("direktiva Seveso") në lidhje me rreziqet për aksidente madhore të aktiviteteve industriale të cilat janë të rrezikshme për mjedisin dhe popullatën lokale.

Qeveria nuk e kontestoi akuzën e kërkuesve që cikli prodhues i fabrikës emetonte sasi të mëdha gazi të djegshëm dhe trioksid arseniku. Përveç kësaj, në fabrikë tashmë kishin ndodhur aksidente të rrezikshme. Aksidenti më i rrezikshëm kishte qenë më 26 shtator 1976, kur kulla e filtrimit të gazrave të sintetizuara të amoniakut shpërtheu dhe u çliruan tonelata të tëra me solucione karbonat dhe bikarbonat kaliumi që përmbanin trioksid arseniku. Si pasojë, 150 persona përfunduan në spital me helmim akut arseniku. Më tej, në një raport të 8 dhjetorit 1988, një komision ekspertësh teknikë të emëruar nga Këshilli i Rrethit Manfredonia konstatoi që emisionet nga fabrika shpesh kanalizoheshin drejt Manfredonias. Raporti gjithashtu shënonte që fabrika kishte refuzuar të lejonte komisionin që të kryente inspeksionin e tij dhe që rezultatet e një studimi të bërë nga fabrika tregonin se pajisjet për trajtimin e emisioneve ishin të pamjaftueshme dhe që vlerësimi i impaktit në mjedis ishte i paplotë.

Nenet 11 dhe 17 të DPR 175/88 kërkonte që autoritetet të informonin popullatën lokale për rreziqet e aktivitetit industrial, masat e sigurisë, planet e emergjencës, dhe procedurat në rast aksidentesh. Në shtator 1993, Ministria e

Mjedisit dhe Ministria e Shëndetësisë miratuan konkluzionet për sigurinë në fabrikë të cilat përfshinin disa sugjerime për përmirësime dhe i dërguan Prefektit të Foggias udhëzime për planin e emergjencës.

Fabrika ndaloi së prodhuari fertilizues në vitin 1994 por vazhdoi të funksiononte si central i enërgjisë termoelektrike dhe fabrikë për trajtimin e ushqimeve dhe ujërave të përdorura. Megjithatë, në një letër të 7 dhjetorit 1995 drejtuar Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, kryebashkiaku i Sant'Angelos deklaronte se ai nuk kishte marrë asnjë dokument në lidhje me hetimet e Ministrive dhe që Këshilli i Rrethit ende ishte duke pritur udhëzimet nga Departamenti i Mbrojtjes Civile për të vendosur masat dhe procedurat e duhura të sigurisë.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesit pretenduan që dështimi i autoriteteve për t'i informuar ata rreth rrezikut të aksidenteve në fabrikë dhe si të veprohej në raste të tilla shkelte Nenet 10, 8 dhe 2 të Konventës.

Neni 10

Kërkuesit argumentuan që Neni 10 caktonte mbi Shtetet detyrimin pozitiv për të mbledhur, përpunuar, dhe shpërndarë informacione mbi çështjet mjedisore në publik, meqenëse publiku nuk kishte si të vihej në dijeni ndryshe për këto informacione. Megjithatë, Gjykata nuk e pranoi këtë pikëpamje. Ndërkohë që e drejta e publikut për të pasur informacione përfshinte të drejtën e shtypit, faktet e çështjes në fjalë dallonin qartë nga praktika gjyqësore e Gjykatës në këtë fushë sepse kërkuesit u ankuan për dështimin e sistemit të ngritur nga DPR 175/88 e miratuar në përputhje me direktivën Seveso.

Liria për të marrë informacione sipas Nenit 10 i ndalon Shtetet nga kufizimi i marrjes së informacioneve nga individët prej të tjerëve. Ajo liri nuk mund të konceptohet si e tillë që imponon detyrime pozitive mbi Shtetin për të mbledhur e shpërndarë informacione. Rrjedhimisht, Gjykata vendosi që Neni 10 nuk ishte i aplikueshëm në çështjen në fjalë.

Neni 8

Gjykata shënoi që në vitin 1976, 150 persona ishin shtruar në spital për helmim akut me arsenik pasi një shpërthim kishte shkaktuar çlirimin e disa tonelatave

karbonat dhe bikarbonat kaliumi me trioksid arseniku nga kulla e filtrimit të fabrikës. Më tej, raporti i 8 dhjetorit 1988 konkludoi që emetimet nga fabrika shpesh dërgoheshin për në Manfredonia. Prandaj Neni 8 ishte i aplikueshëm në rastin konkret meqenëse emisionet toksike kishin efekt direkt mbi të drejtën e kërkuesve për respekt ndaj jetës private dhe familjare. Nuk mund të thuhet që Italia kishte "ndërhyrë" te kjo e drejtë sepse kërkuesit ishin ankuar vetëm për dështimin e Shtetit për të vepruar. Pavarësisht nga kjo, Neni 8 gjithashtu cakton detyrimin pozitiv për të ofruar mbrojtje efektive nga ndërhyrja arbitrare tek e drejta e kërkuesve për respekt ndaj jetës private dhe familjare.

Ndotja e rëndë mjedisore mund të ndikojë në mirëqenien e individëve dhe t'i pengojë ata nga gëzimi i shtëpive të tyre në mënyrë të atillë që ndikon keq në jetën e tyre private dhe familjare. Pavarësisht nga miratimi i planit të emergjencës në shtator 1993 nga Ministria e Mjedisit dhe Ministria e Shëndetësisë, kërkuesit kishin prituri deri në vitin 1994, kur u ndërpre prodhimi i fertilizuesve, për informacione thelbësore të cilat do t'u kishin mundësuar të vlerësonin se sa e rrezikshme ishte për familjet e tyre që të vazhdonin të jetonin në Manfredonia. Prandaj, Shteti kishte dështuar në detyrimin pozitiv për të siguruar të drejtën e kërkuesve për respekt ndaj jetës së tyre private dhe familjare. Rrjedhimisht, Gjykata vendosi që kishte pasur shkelje të Nenit 8.

Neni 2

Duke pasur parasysh konkluzionet e saj nga Neni 8, Gjykata vendosi që ishte e panevojshme ta shqyrtonte çështjen sipas Nenit 2.

Neni 50 (tani Neni 41)

Gjykata u caktoi 100,000,000 ITL (afërsisht 51,688 Euro) secilit kërkues për dëme jomateriale.

Refuzimi për t'i ofruar një OJQ-je informacione mbi një çështje të interesit publik ka shkëlur të drejtën e saj për qasje ndaj informatave sipas Nenit 10

VENDIMI I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN MAGYAR HELSINKI BIZOTTSÁG k. HUNGARISË

(Kërkesa Nr. 18030/11)

8 nëntor 2016

1. Faktet kryesore

Kërkesja, Magyar Helsinki Bizottság (Komiteti i Helsinkit i Hungarisë), ishte një organizatë jo qeveritare (OJQ) e themeluar në vitin 1989. Aktivitetet e saj kryesore përfshinin monitorimin e zbatimit të standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut në Hungari dhe performancën e agjencive ligjzbatuese dhe sistemit gjyqësor në aspektin e të drejtave të njeriut.

Mes viteve 2005 dhe 2009, OJQ-ja kërkuese realizoi një sërë projektesh që shqyrtonin zbatimin efektiv të së drejtës për mbrojtje në Hungari, duke dalë me përfundimin që caktimi i avokatit mbrojtës ex officio nuk funksiononte në mënyrën e duhur. Në vitin 2009, ajo nisi një projekt të ri që synonte zëvendësimin e sistemit ekzistues të emërimeve sipas diskrecionit me një sistem gjenerimi të rastësishëm kompjuterik. Për qëllime të këtij projekti, organizata kërkoi emrat e mbrojtësve publikë të zgjedhur në vitin 2008 dhe numrin e çështjeve që i ishin caktuar secilit avokat prej gjithsej njëzet e tetë departamenteve të policisë. Këto kërkesa u bënë në përputhje me dispozitat e Ligjit për Të Dhënat në Hungari në lidhje me zbulimin e informatave të interesit publik.

Shumica e departamenteve të policisë i paraqitën informacionet e kërkuara, qoftë menjëherë ose pas një sfide të suksesshme ligjore nga OJQ-ja kërkuese. Megjithatë, dy departamente të policisë e refuzuan kërkesën duke u bazuar në faktin që emrat e avokatëve mbrojtës nuk ishin të dhëna të interesit publik e as informata që i nënshtroheshin zbulimit për hir të interesit publik sipas seksionit 19(4) të Ligjit për Të Dhënat.

Në shtator 2009, OJQ-ja kërkuese e kontestoi refuzimin e mësipërm për zbulimin e informatave të kërkuara para Gjykatës së Rrethit të Debrecen, e cila në tetor 2009 urdhëroi dy departamentet e policisë që të paraqisnin informacionet përkatëse brenda 60 ditësh. Të dy departamentet apeluan para Gjykatës Rajonale

të Krahinës Hajdú-Bihar, e cila përmbysi VENDIMIn e shkallës së parë dhe rrëzoi pretendimin e OJQ-së kërkuese në tërësi. Më pas organizata kërkoi shqyrtimin e VENDIMIT të shkallës së dytë, megjithatë kjo u rrëzua nga Gjykata Supreme në shtator 2010.

2. Vendimi i Gjykatës

OJQ-ja kërkuese u ankua që refuzimi i autoriteteve për dhënien e qasjes ndaj informatave që ajo i kishte kërkuar disa departamenteve të policisë përbënte shkelje të së drejtës së saj siç përcaktohet në Nenin 10 të Konventës.

Neni 10

Në vlerësimin e saj për zbatueshmërinë e Nenit 10 në çështjen në fjalë, Gjykata pranoi që, pavarësisht nga fakti që teksti i Nenit 10(1) nuk përfshin lirinë për të kërkuar informata, ky Nen mund të interpretohej si i tillë që përfshinte, në rrethanat e çështjes, të drejtën për qasje ndaj informatave të mbajtura nga shteti.

Në mënyrë të veçantë, duke pasur parasysh parimin e garantimit të të drejtave të Konventës në mënyrë praktike dhe efektive, Gjykata gjeti që e drejta individuale për qasje në informatat e mbajtura nga një autoritet publik, ose detyrimi i një Qeverie për t'ia ofruar këto informata individit, mund të dalë në pah në rrethana ku qasja në informatë është vendimtare për ushtrimin e të drejtës për lirinë e shprehjes së individit në fjalë, veçanërisht "liria për të marrë e dhënë informata" dhe aty ku mohimi i saj përbën ndërhyrje tek ajo e drejtë. Aty sqarohen kriteret për të vlerësuar nëse rrethanat e veçanta të një rasti hyjnë brenda fushëveprimit të një të drejte të tillë që përfshin parakushtet vijuese: qëllimi i kërkesës duhet të jetë mundësimi i ushtrimit të lirisë për të marrë informata e ide prej të tjerëve dhe për t'u dhënë informata e ide të tjerëve, kërkuesi duhet të veprojë në rolin e vet si rojtar shoqëror, dhe informata e kërkuar duhet të ketë lidhje me një çështje të interesit publik e gjithashtu të jetë e gatshme dhe në dispozicion.

Duke pasur parasysh si më lart, Gjykata deklaroi që informatat e kërkuara nga OJQ-ja kërkuese prej departamenteve përkatëse të policisë ishin të nevojshme për plotësimin e pyetësorit mbi funksionimin e skemës së mbrojtësve publikë, të cilin ajo po e zhvillonte në kapacitetin e saj si organizatë joqeveritare e të drejtave të njeriut, në mënyrë që të kontribonte në diskutimin rreth një çështjeje me interes të qartë publik. Duke ia mohuar asaj qasjen ndaj informacionit të kërkuar, i cili ishte i gatshëm dhe në dispozicion, autoritetet vendase dëmtuan ushtrimin e lirisë

së OJQ- së për të marrë e dhënë informata, në një mënyrë që godet vetë thelbin e të drejtave të saj nga Neni 10.

Pas afirmimit të zbatueshmërisë së Nenit 10 në rastin e veçantë, Gjykata vazhdoi të vlerësonte nëse ndërhyrja tek gëzimi i kësaj të drejte ishte i justifikuar. Në atë pikë, Gjykata pranoi se ndërhyrja kishte qenë e parashikuar me ligj dhe kufizimi ndaj lirisë së shprehjes së kërkueses synonte qëllimin legjitim të mbrojtjes së të drejtave të të tjerëve.

Çështja qenësore në shqetësimin e ngritur nga OJQ-ja kërkuese ishte që informatat e kërkuara karakterizoheshin nga autoritetet si të dhëna personale që nuk duhet të zbulohen, bazuar në premisën që, sipas të drejtës hungareze, koncepti i të dhënave personale ngërthente çdo informatë që mund të identifikonte një individ. Një informatë e tillë nuk i nënshtrohej zbulimit nëse kjo mundësi nuk ishte shprehimisht e parashikuar me ligj, ose nëse informata nuk kishte lidhje me performancën e funksioneve bashkiake apo qeveritare, ose nëse nuk kishte lidhje me persona të tjerë që kryenin detyra publike. Meqenëse vendimi i Gjykatës Supreme i përjashtonte mbrojtësit publikë nga kategoria e "personave të tjerë që kryejnë detyra publike", nuk kishte mundësi ligjore për OJQ-në kërkuese që të argumentonte që zbulimi i informacionit ishte i nevojshëm për kryerjen e rolit të saj si rojtare.

Informacioni i kërkuar përfshinte emrat e mbrojtësve publikë dhe numrin e herëve që ishin emëruar për të vepruar si avokatë në juridiksione të caktuara. Për Gjykatën, kërkesa për këto emra, sado që ato ishin të dhëna personale, kishte lidhje kryesisht me zhvillimin e aktiviteteve profesionale në kuadër të procedurave publike, pra të aktiviteteve jo të natyrës private. Për më tepër, informacioni i kërkuar nuk kishte të bënte me veprimet apo vendimet e mbrojtësve publikë lidhur me kryerjen e detyrave të tyre si përfaqësues ligjorë apo konsultat me klientët e tyre. Më tej, Gjykata gjeti që zbulimi i informacionit të mësipërm nuk do t'i kishte vënë mbrojtësit publikë para ekspozimit në një shkallë që shkon përtej asaj që mund të kishin qenë në gjendje të parashikonin kur janë regjistruar si mbrojtës publikë, duke pasur parasysh që informacioni i kërkuar, edhe pse jo i sistemuar në kohën e pyetësorit, mund t'i bëhej i ditur publikut përmes mënyrave të tjera.

Në këto rrethana, pra duke pasur parasysh natyrën e informacionit që lidhej me aktivitete të çështjeve publike, faktin që ai tashmë ishte në dispozicion për publikun si dhe parashikueshmërinë e zbulimit të tij, Gjykata gjeti që nuk kishte arsye që qeveria të thirrej në Nenin 8 dhe të përpiqej të vendoste ekuilibër mes të

drejtës së OJQ-së kërkuese për të marrë informata sipas Nenit 10 dhe të drejtës së avokatëve mbrojtës për respektim të jetës private sipas Nenit 8.

Gjykata theksoi se mbrojtja e interesave private të mbrojtësve publikë përbënte qëllim legjitim i cili lejonte një kufizim të lirisë së shprehjes; megjithatë, ajo gjeti që mënyrat e përdorura për t'i mbrojtur ato interesa ishin joproporcionale me qëllimin që synohej të arrihej, pra nuk kishin qenë të nevojshme në një shoqëri demokratike brenda kuptimit të Nenit 10(2) të Konventës.

Gjykata arriti në përfundimin që e drejta përkatëse hungareze, siç interpretohet nga gjykatat kompetente vendase, përjashtonte çdo vlerësim domethënës të të drejtave të kërkueses për lirinë e shprehjes sipas Nenit 10, në një situatë ku për çdo kufizim ndaj publikimit të propozuar të OJQ-së kërkuese – i cili kishte për qëllim të kontribonte në debatin mbi një çështje të interesit të përgjithshëm e cila po ashtu ishte e lidhur ngusht me një të drejtë të rëndësishme madhore, pra e drejta për seancë dëgjimore të drejtë – do të ishte lipsur këqyrje të imtësishme. Informacioni i kërkuar nuk përfshinte informata jashtë sferës publike dhe përbëhej vetëm nga informata të natyrës statistikore brenda kuadrit të skemës nacionale të ndihmës ligjore me fonde publike. Prandaj, kishte pasur shkelje të Nenit 10.

Article 41

Gjykata i caktoi kërkueses 215 Euro në lidhje me dëme materiale, dhe 8,875 Euro për kosto dhe shpenzime.

Dënimi dhënë gazetarit për shpifje pas deklarimeve të pasakta lidhur me abortin e një vajze 13-vjeçare ishte "dukshëm joproportional" nga natyra dhe rreptësia, duke shkelur Nenin 10

VENDIMI NË ÇËSHTJEN SALLUSTI k. ITALISË

(Kërkesa Nr. 22350/13)

7 mars 2019

1. Faktet kryesore

Kërkuesi ishte shtetas italian i lindur në vitin 1957. Në vitin 2007 ai ishte kryeredaktor i gazetës ditore *Libero*, e cila kishte një qarkullim rreth 125,000 kopje në ditë. Në shkurt të atij viti, *Libero* botoi dy artikuj ku thuhej se një vajzë 13-vjeçare ishte detyruar të abortonte nga prindërit e saj dhe një gjyqtar kujdestarie. Media të tjera e kishin mbuluar ngjarjen një ditë më parë por më pas kishin raportuar që ajo nuk ishte detyruar të abortonte por e kishte dashur vetë një gjë të tillë.

Në prill të vitit 2007 një gjyqtari i kujdestarisë bëri një ankesë penale për shpifje kundër kërkuesit. Ai u gjet fajtor në janar të vitit 2009 për dështim të kryeredaktorit të një gazete për të kontrolluar atë që ishte botuar në lidhje me njërin prej artikujve dhe për shpifje të rënduar në lidhje me tjetrin. Ai u gjobit, u urdhërua të paguante dëmshpërblimin dhe kostot si dhe të botonte vendimin e gjykatës.

Në apel, dënimi u rrit në qershor 2011 me një vit e dy muaj burgim dhe dëmshpërblimi u trefishua në 30,000 Euro. Gjykata e Kasacionit e mbështeti dënimin e dhënë me mbajtje në shtator 2012, megjithatë, gjykata ekzekutuese e dënimin e la atë që ta vuante dënimin në arrest shtëpiak.

Në dhjetor 2012, Presidenti i Italisë, duke iu referuar në vendimin e tij kritikave nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut për dënimet me mbajtje për gazetarët, e ktheu dënimin e kërkuesit në gjobë. Deri në atë kohë ai kishte kaluar 21 ditë në arrest shtëpiak.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi argumentoi që dënimi i tij për shpifje dhe për dështim të ushtrimit të kontrollit mbi përmbajtjen e një publikimi kishte shkelur të drejtat e tij për lirinë e shprehjes sipas Nenit 10.

Neni 10

Dënimi i kërkuesit përbëri ndërhyrje tek e drejta e tij për liri të shprehjes. Ndërhyrja u bë në vijim të Kodit Penal dhe të Aktit të Shtypit dhe prandaj ishte "e parashkruar në ligj". Aty gjithashtu pranohej që dënimi synonte të ndiqte qëllimin legjitim të mbrojtjes së reputacionit dhe të drejtave të vajzës 13-vjeçare dhe prindërve të saj, si dhe ato të gjyqtarit të kujdestarisë.

Gjykatamëtejshqyrtoinësedënimi ishte "inevojshëm në një shoqëri demokratike". Ajo u pajtua me gjetjet e gjykatës vendase që artikujt kishin keqinformuar publikun, pavarësisht nga sqarimet e dhëna para botimit dhe që kërkuesi kishte njozosur seriozisht nderin e gjyqtarit të kujdestarisë dhe të drejtën e tij për privatësi, si dhe atë të të gjitha palëve të përfshira. Më tej, ajo u pajtua që kërkuesi kishte dështuar në respektimin e etikës së gazetarisë kur e kishte botuar artikullin pa kontrolluar vërtetësinë e tij. Më tej, kreu i gazetës mbetej përgjegjës për përmbajtjen e artikujve të saj gjatë ushtrimit të kontrollit të tij. Kështu, dënimi i tij përmbushte një "nevojë urgjente shoqërore" dhe autoritetet ishin të justifikuar që e kishin vlerësuar të nevojshëm kufizimin e ushtrimit të së drejtës së tij për lirinë e shprehjes.

Më pas, Gjykata mori në konsideratë nëse dënimi ishte proporcional me qëllimin legjitim. Ndërkohë që dhënia e dënimit është çështje e gjykatave nacionale, e drejta për lirinë e shprehjes kërkonte që një dënim me mbajtje për vepra lidhur me mediat jepet vetëm në rrethana të jashtëzakonshme; pra kur dëmtohen seriozisht të drejta të tjera themelore, si në rastet e gjuhës së urrejtjes ose nxitjes së dhunës. Gjithashtu u njoh fakti se Italia kishte ndërmarrë hapa pozitive kohët e fundit, si kufizimi i përdorimit të sanksioneve peale për shpifje dhe futjen e heqjes së burgimit si sanksion për shpifje.

Sidoqoftë, kërkuesi ishte urdhëruar të paguante kompensim dhe kaloi 21 ditë në arrest shtëpiak. Gjykata konsideroi që nuk kishte justifikim për një dënim me burg në këtë rast sepse një sanksion i tillë pashmangshëm do të kishte efekt drithërues. Ky konkluzion nuk ndryshohej nga fakti që dënimi me burg ishte pezulluar, meqenëse konvertimi i dënimit me mbajtje në gjobë ishte vetëm brenda diskrecionit të Presidentit të Italisë dhe një mëshirë e tillë nuk e shuante vetë dënimin. Prandaj, sanksioni penal i vendosur ndaj kërkuesit ishte dukshëm joproporcional, si nga natyra ashtu edhe nga rreptësia, me qëllimin legjitim. Rrjedhimisht, Gjykata vendosi që kishte pasur shkelje të Nenit 10.

Neni 41

Gjykata i caktoi kërkuesit 12,000 Euro në lidhje me dëme jomateriale dhe 5,000 Euro për kosto dhe shpenzime.

Refuzimi për të lejuar hyrjen e anijes së një organizate aktiviste në ujërat territoriale portugeze për të zhvilluar fushatë për legalizimin e abortit ka shkelur Nenin 10 sepse ka qenë joproportional me qëllimin e mbrojtjes së shëndetit publik

WOMEN ON WAVES DHE TË TJERË K. PORTUGALISË

(Kërkesa Nr. 31276/05)

3 shkurt 2009

1. Faktet kryesore

Kërkueset ishin Women on Waves, një fondacion holandez, dhe dy shoqata portugeze, Clube Safo dhe Não te Privés. Të tri shoqatat synonin, mes qëllimeve të tjera, që të promovonin debatin mbi temën e të drejtave riprodhuese të grave.

Në 2004, shoqatat portugeze ftuan Women on Waves të bashkoheshin me to në fushatë për dekriminalizimin e abortit në Portugali. Këto të fundit dërguan një anije, Borndiep, për në Figueria da Foz për të mbajtur takime dhe punëtori mbi parandalimin e sëmundjeve seksualisht të transmetueshme, planifikimin familjar dhe dekriminalizimin e abortit, të cilat ishin planifikuar të zhvilloheshin në bordin e anijes Borndiep mes 30 gushtit dhe 12 shtatorit 2004.

Më 27 gusht 2004, një urdhër ministror ia ndaloi anijes Borndiep hyrjen në ujërat territoriale portugeze mbi bazën e ligjeve portugeze të marinës dhe atyre të shëndetësisë. Autoritetet gjithashtu dërguan një anije luftarake portugeze për të bllokuar hyrjen e Borndiep-it. Shoqatat kërkuese i bënë kërkesë Gjykatës Administrative të Coimbras të lëshonte një urdhër që autorizonte hyrjen e menjëhershme të Borndiep-it në ujërat portugeze. Ato argumentuan se ndalimi i hyrjes në ujëra portugeze shkelte të drejtat e tyre për lirinë e shprehjes, për asociim dhe protesta, dhe shkelte parimin e të drejtës për lirinë e lëvizjes së njerëzve. Më 6 shtator 2004, Gjykata Administrative e refuzoi kërkesën e tyre, duke deklaruar se shoqatat kishin për qëllim që t'u administronin grave portugeze hapin e abortimit RU486, i cili ishte i paligjshëm në Portugali. Kërkueset e apeluan këtë vendim pa sukses pranë Gjykatës Administrative Veriore. Gjykata Administrative Supreme ngjashëm e refuzoi kërkesën e tyre për shkak se çështja nuk kishte rëndësi të mjaftueshme ligjore apo shoqërore për të justifikuar ndërhyrjen e saj.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkueset u ankuan që refuzimi i autoriteteve për të lejuar Borndiep-in në ujërat portugeze kishte shkelur Nenet 5, 10 dhe 11 dhe Nenin 2 të Protokollit Nr. 4.

Nenet 10 dhe 11

Gjykata shënoi që liria e shprehjes ishte e vështirë për t'u ndarë prej lirisë së tubimit. Megjithatë, meqenëse ankesat e kërkueseve kishin të bënin me ndërhyrjen e autoriteteve tek e drejta e tyre për të informuar publikun rreth qëndrimit të tyre rreth të drejtave të grave dhe abortit, ishte me vend që ankesa e tyre të shqyrtohej sipas Nenit 10 vetëm, pa e shqyrtuar çështjen ndaras sipas Nenit 11.

Nuk vihej në diskutim mes palëve që ndërhyrja ishte "e parashkruar në ligj". Gjykata po ashtu pranoi që ndërhyrja synonte qëllimin legjitim të parandalimit të trazirave dhe mbrojtjen e shëndetit. Gjykata gjeti që e drejta për lirinë e shprehjes përfshinte të drejtën për të zgjedhur mënyrën më efektive për të përçuar idetë pa ndërhyrje të paarsyeshme nga ana e autoriteteve. Ajo pranoi që kufizimet mbi këtë të drejtë substancialisht mund të ndikonin thelbin e ideve dhe informacioneve relevante, posaçërisht në rastet e protestave simbolike në lidhje me të drejtat dhe liritë themelore. Ndërhyrja tek e drejta e kërkueseve për lirinë e shprehjes i ndaloi ato prej zhvillimit të fushatës së tyre në një mënyrë që ishte thelbësisht e rëndësishme për to, meqenëse fushata në bordin e anijes së tyre vlerësohej si mënyra më efektive për transmetimin e informacionit, dhe ishte në përputhje me mënyrën e zhvillimit të aktiviteteve prej Women on Waves në Shtete të tjera evropiane prej kohësh tashmë.

Çështja u dallua prej praktikës gjyqësore të kaluar kur Gjykata kishte gjetur që Shtetet nuk kishin detyrimin për të krijuar të drejtën për të hyrë në pronë private ose publike për të ushtruar të drejtën për lirinë e shprehjes kur ekzistonin mënyra alternative për ta bërë një gjë të tillë. Rasti konkret nuk përfshinte prona private ose publike por ujërat territoriale portugeze të cilat ishin hapësirë e hapur dhe publike. Nuk kishte të bënte as me detyrimin pozitiv të Shtetit për të lehtësuar shprehjen, por detyrimin e tij negativ për të mos ndërhyrë në mënyrë arbitrare tek liria e shprehjes së kërkueseve, në lidhje me të cilën hapësira e vlerësimit e Shtetit ishte më e ngushtë.

Më tej, kishte prova të pamjaftueshme për të sugjeruar që shoqatat kërkuese kishin në mend të shkelnin ligjin portugez për abortin. As nuk kishte prova për të

mbështetur gjetjen e Gjykatës Administrative të 6 shtatorit 2004 që shoqatat kërkuese kishin pasur në mend të shpërndanin medikamentet e gjetura në bord. Sidoqoftë, autoritetet mund të kishin marrë masa më pak paragjyquese për të arritur qëllimet e tyre legjitime. Për shembull, në vend të ndalimit të plotë të hyrjes dhe pozicionimit të anijes luftarake, ato mund të kishin konfiskuar hapat e abortimit RU486 para hyrjes së anijes në territorin portugez. Gjykata njohu rëndësinë që Shteti i jepte ligjit të tij për abortin, por theksoi që liria e shprehjes ishte më e vlefshme kur bëhej fjalë për paraqitjen e ideve që ofendojnë, shokojnë dhe sfidojnë rendin ekzistues.

Masat e marra u gjet se ishin kaq të rrepta sa që ato do të kishin jo vetëm efektin e zhbindjes së kërkueseve prej ushtrimit të të drejtave të tyre, por edhe efektin e dekurajimit të të tjerave prej sfidimit të rendit ekzistues. Si e tillë, ndërhyrja ishte joproporcionale me qëllimin legjitim të synuar dhe nuk ishte "e nevojshme në një shoqëri demokratike". Rrjedhimisht, kishte pasur shkelje të Nenit 10.

Nenet 5, 6 dhe Neni 2 i Protokollit Nr. 4

Duke pasur parasysh konkluzionet e saj sipas Nenit 10, Gjykata konsideroi që ishte e panevojshme të shqyrtoheshin ankesat e tjera ndaras sipas Neneve 5, 6 dhe Nenit 2 të Protokollit Nr. 4.

Neni 41

Gjykata i caktoi secilës kërkuese 2,000 Euro në lidhje me dëme jomateriale dhe 3,309.40 Euro për kosto dhe shpenzime.

Agjencia Serbe e Inteligjencës duhet të lejojë qasjen në informacionet që ka marrë përmes vëzhgimit elektronik për të mbrojtur të drejtën e lirisë së shprehjes së një OJQ-je

VENDIMI NË ÇËSHTJEN E INICIATIVËS RINORE PËR TË DREJTAT E NJERIUT K. SERBIË

(Kërkesa Nr. 48135/06)
25 qershor 2013

1. Faktet kryesore

Kërkuesja ishte një organizatë joqeveritare e ngritur në vitin 2003 me seli në Beograd. Ajo monitoronte implementimin e ligjeve tranzitore me qëllim të garantimit të sigurimit të respektit për të drejtat e njeriut, demokracinë dhe sundimin e ligjit.

Më 31 tetor 2005 kërkuesja i kërkoi agjencisë serbe të inteligjencës ta informonte se sa njerëz ishin vënë nën vëzhgim elektronik nga ajo agjenci në vitin 2005. Më 4 nëntor 2005 agjencia e refuzoi kërkesën, duke u mbështetur në seksioni 9(5) të Aktit për Lirinë e Informacionit të vitit 2004.

Kërkuesja iu ankua Komisionerit të Informacionit, një organ vendas i ngritur sipas Aktit për Lirinë e Informacionit i vitit 2004, të sigurohej që ai Akt ishte duke u respektuar.

Më 22 dhjetor 2005 Komisioneri gjeti që agjencia e inteligjencës kishte shkelur ligjin dhe urdhëroi që informacioni i kërkuar të vihej në dispozicion për kërkuesen brenda tre ditësh. Agjencia apeloj, por më 19 prill 2006 Gjykata Supreme e Serbisë vendosi që asaj i mungonte baza dhe e rrëzoi apelin e saj.

Më 23 shtator 2008, agjencia e inteligjencës informoi kërkuesen që ajo (agjencia) nuk e kishte informacionin e kërkuar.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesja u ankua, sipas Nenit 10 të Konventës, që agjencia e inteligjencës e Serbisë i kishte mohuar asaj qasje në informata të caktuara lidhur me vëzhgimet elektronike, pavarësisht nga vendimi përfundimtar dhe detyrues i Komisionerit të Informacionit në favor të kësaj të fundit.

Neni 10

Gjykata shënoi që refuzimi për t'ia dhënë informacionin e kërkuar kërkueses e cila ishte e qartë se ishte e përfshirë në mbledhjen legjitime të informatave me interes publik me qëllim të shpërndarjes së informacioneve në publik duke kontribuar në debatin publik, përbënte ndërhyrje në të drejtën e lirisë së shprehjes.

Ndërkohë që ushtrimi i lirisë së shprehjes mund t'i nënshtrohet kufizimeve, këto kufizime duhet të ishin në përputhje me ligjin. Megjithatë Gjykata gjeti që kufizimet e imponuara nga agjencia e inteligjencës në rastin konkret nuk e përmbushnin atë kriter. Organi vendas i ngritur pikërisht për të siguruar respektimin e Aktit për Lirinë e Informacionit të vitit 2004 e shqyrtoi çështjen dhe vendosi që informacioni i kërkuar duhet t'i jepej kërkueses. Ishte e vërtetë që agjencia e inteligjencës eventualisht u përgjigj që ajo nuk i kishte ato informata, por ajo përgjigje ishte jobindëse duke pasur parasysh natyrën e atyre informatave (numrin e njerëzve që kishin qenë objekt i vëzhgimeve elektronike nga ajo agjenci në vitin 2005) dhe përgjigjen fillestare të agjencisë.

Gjykata konkludoi që mosdashja kokëfortë e agjencisë së inteligjencës së Serbisë për të vepruar në përputhje me urdhrin e Komisionerit të Informacionit ishte në shkelje të së drejtës vendase dhe përbënte arbitraritet.

Neni 6

Duke pasur parasysh gjetjet e mësipërme, Gjykata konsideroi që nuk ishte e nevojshme ta shqyrtonte të njëjtën ankesë sipas Nenit 6.

Neni 46

Në parim, nuk i takonte Gjykatës të vendoste se çfarë masash për zgjidhje mund të ishin të përshtatshme pas VENDIMIT. Megjithatë, shkelja e gjetur në këtë rast, për shkak të vetë natyrës së saj, nuk i linte zgjedhje tjetër sa i përkiste masave të nevojshme për ta zgjidhur. Prandaj, mënyra më e natyrshme për të zbatuar VENDIMIN e saj në këtë çështje ishte të sigurohej që agjencia t'i jepte OJQ-së kërkuese informacionet që kjo e fundit kishte kërkuar, pra se sa njerëz i ishin nënshtuar vëzhgimit elektronik në vitin 2005.

Neni 41

Gjykata konsideroi që gjetja e një shkeljeje dhe urdhri i dhënë sipas Nenit 46 përbënin shpërblim të drejtë të mjaftueshëm për çfarëdo dëmi jomaterial që mund të kishte pësuar kërkuësja.

XI. Liria e tubimit

Evakuimi i migrantëve që kishin zaptuar një kishë nuk ka shkelur të drejtën për lirinë e grumbullimit paqësor sipas Nenit 11, ku shpërndarja u bë për të mbrojtur shëndetin e pjesëmarrësve dhe ku kushtet sanitare ishin të pamjaftueshme

VENDIMI NË ÇËSHTJEN CISSE k. FRANCËS

(Kërkesa Nr. 51346/99)

9 prill 2002

1. Faktet kryesore

Kërkuesja ishte shtetase senegaleze, si dhe anëtare dhe zëdhënëse e një grupi shtetasish të huaj pa leje qëndrimi në Francë. Grupi mori pjesë në një aksion kolektiv për ngritjen e vetëdijes rreth vështirësive të hasura për të arritur shqyrtimin e statusit të tyre si imigrantë në Francë. Nga qershori e deri në gusht të vitit 1996, kërkuesja zaptoi Kishën e Shën Bernardit ("Kisha") në Paris së bashku me rreth 200 imigrantë të tjerë të paligjshëm, që u njoh si lëvizja e "Shën Bernardit pa letra". Dhjetë zaptues hynë në grevë urie. Fushata u mbulua gjerësisht nga shtypi dhe mori mbështetje nga shumë organizata të të drejtave të njeriut.

Më 22 gusht 1996, Komisioneri i Policisë së Parisit dha urdhër për evakuimin e plotë të Kishës mbi bazën e faktit që zaptimi nuk kishte lidhje me shprehjen e besimit fetar, kushtet e këqija sanitare ishin përkeqësuar edhe më tej, daljet e Kishës ishin mbyllur me dry dhe kishte rreziqe serioze sanitare, shëndetësore, të paqes, sigurisë dhe të rendit publik. Të nesërmen në mëngjes, policia evakoi Kishën, duke ndaluar dhe marrë në pyetje të gjithë zaptuesit. Personat e bardhë u liruan menjëherë ndërsa të gjithë personat jo të bardhë, përveç atyre që ishin në grevë urie, u dërguan me autobus në një qendër paraburgimi. U urdhërua paraburgimi dhe deportimi i thuajse të gjithë personave të përfshirë, por më se njëqind veta më pas u liruan për shkak të parregullsive nga ana e policisë, përfshirë hartimin e raporteve të rreme.

Kërkuesja, e cila nuk kishte leje qëndrimi, u ngarkua me akuzën e hyrjes dhe qëndrimit të paligjshëm në Francë, dhe iu shqiptua dënim me kusht në kohëzgjatje prej një muaji. Më 23 janar 1997, Gjykata e Apelit e Parisit e mbështeti dënimin dhe shtoi një urdhër për ta përjashtuar atë nga territori francez për tre vjet. Më 4 qershor 1998, Gjykata e Kasacionit e rrëzoi apelin e kërkueses.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesja u ankua që evakuimi nga Kisha kishte shkelur të drejtën e saj për lirinë e grumbullimit paqësor së bashku me shtetas të tjerë të huaj, me qëllim të denoncimit të trajtimit të tyre, sipas Nenit 11.

Neni 11

Qeveria argumentoi që nuk bëhej fjalë për të drejtën e kërkueses për grumbullim paqësor sepse zaptimi i Kishës synonte të mbronte dhe legjitimonte një shkelje të qëllimshme të rregullave franceze të imigrimit, e prandaj ishte i paligjshëm, ngërthente shkelje të rendit publik dhe nuk mund të konsiderohej si "paqësor". Gjithashtu, zaptimi u argumentua se kishte ngushtuar pa arsye të drejtat e të tjerëve për lirinë e grumbullimit duke ua ndaluar banorëve vendas hyrjen në Kishë për ushtruar besimin e tyre. Megjithatë, Gjykata vërejti që zaptimi ishte mbështetur nga prifti dhe nga këshilli i famullisë së Kishës, dhe që të gjitha shërbesat dhe ceremonitë fetare kishin vazhduar sipas planit dhe pa incidente. Prandaj zaptimi i Kishës si pjesë e fushatës për të tërhequr vëmendjen drejt vështirësive për arritjen e shqyrtimit të statusit të imigrantit/es nga ana e pjesëmarrësve përbënte "grumbullim paqësor", dhe Gjykata gjeti që evakuimi i Kishës ishte ndërhyrje tek e drejta e kërkueses për lirinë e grumbullimit paqësor.

Gjykata gjeti që ndërhyrja në fjalë ishte e parashkruar me ligj, meqenëse sipas Ligjit të 9 dhjetorit 1905 mbi Ndarjen e Kishës dhe Shtetit, autoritetet vendase (e jo prifti i famullisë) ishin përgjegjëse për mbikqyrjen e ceremonive fetare dhe kishin fuqi për të vepruar, qoftë me kërkesë të priftit, qoftë me iniciativën e tyre.

Evakuimi u urdhërua për t'i dhënë fund zaptimit të vazhdueshëm nga individë, përfshirë kërkuesen, të cilët kishin shkelur ligjet franceze. Prandaj, Gjykata deklaroi që ndërhyrja synonte një qëllim legjitim: parandalimin e trazirave. Megjithatë, Gjykata nuk e pranoi qëndrimin e Qeverisë që statusi i kërkueses si imigrante e paligjshme justifikonte shkeljen e të drejtave të saj sipas Nenit 11. Së pari, Gjykata shënoi që të drejtat e saj tashmë ishin ushtruar për dy muaj pa ndërhyrje nga autoritetet. Së dyti, kur një person protestonte paqësisht kundër një ligji, fakti që personi ishte duke shkelur ligjin kundër të cilit po protestonte nuk ishte një prej arsyeve legjitime për të cilat mund të lejohej kufizimi i të drejtës për grumbullim paqësor sipas Nenit 11(2). Prandaj, fakti që kërkuesja kishte shkelur ligjet për fitimin e qëndrimit të ligjshëm në Francë, kundër të cilave ajo po protestonte, nuk përbënte arsye për të kufizuar të drejtën e saj për të protestuar kundër këtyre ligjeve sipas Nenit 11(2).

Sidoqoftë, Gjykata vërejti që, pavarësisht nga natyra paqësore dhe mungesa e trazirës, zaptimi eventualisht rezultoi me përkeqësimin e shëndetit të grevistëve të urisë dhe pamjaftueshmërinë e kushteve sanitare. Në këto rrethana, Gjykata pranoi që kufizimet në ushtrimin e të drejtës së kërkueses për grumbullim mund të jenë bërë të nevojshme, e megjithatë vuri në pah që metodat e përdorura nga policia shkonin përtej asaj që është e arsyeshme të pritët gjatë kufizimit të lirisë së grumbullimit. Më tej, Gjykata sidoqoftë pohoi që vlera simbolike dhe dëshmuese e zaptimit ishte toleruar mjaft gjatë, për rreth dy muaj, për të bërë që ndërhyrja të mos dukej e paarsyeshme.

Prandaj, Gjykata vendosi që nuk kishte pasur shkelje të Nenit 11 të Konventës.

Kufizimet e demonstratave dhe tubimeve publike të vëna nga qeveria zvicerane gjatë pandemisë Covid-19 kanë shkelur të drejtën e kërkueses nga neni 11 për lirinë e tubimit dhe organizimit

VENDIMI NË ÇËSHTJEN COMMUNAUTÉ GENEVOISE D'ACTION SYNDICALE (CGAS) K. ZVICRËS^[757]

(Kërkesa Nr. 21881/20)

15 mars 2022

1. Faktet kryesore

Kërkesja, Communauté genevoise d'action syndicale (CGAS), është shoqatë sipas të drejtës zvicerane me seli të regjistruar në Gjenevë, e themeluar në vitin 1962. Qëllimi i saj i deklaruar është mbrojtja e interesave të personave që punojnë dhe atyre që nuk punojnë dhe të organizatave anëtare të saj, posaçërisht në sferën e lirive demokratike dhe atyre të sindikatave. Ajo e realizon këtë qëllim, pjesërisht, duke organizuar dhe duke marrë pjesë në demonstrata të shumta çdo vit.

Si reagim ndaj pandemisë Covid-19 në vitin 2020, qeveria zvicerane mori masa për të parandaluar përhapjen e virusit. Në përputhje me Urdhëresën O.2 Covid-19, të miratuar nga Këshilli Federal më 13 mars 2020, shkollat dhe kolegjet u mbyllën dhe demonstratat me më shumë se 100 persona u ndaluan. Më 16 mars 2020, Këshilli Federal modifikoi Preambulën e Urdhëresës O.2 Covid-19, duke ndaluar të gjitha demonstratat publike dhe private. Mos-respektimi i saj ishte i dënueshëm me burg ose gjobë. Mundësia e aplikimit për autorizim për përjashtim nga ky ndalim sipas nevojës për të ushtruar të drejtat politike u hoq nga ky version i Urdhëresës.

Këshilli Federal i shtrëngoi masat mes 16 marsit dhe 29 prillit, duke ndaluar mbledhjen e më shumë se pesë personave në hapësira publike. Masat u relaksuan më 11 maj 2020 dhe rezultuan me rihapjen e hapësirave publike, përfshirë shkollat, dyqanet, restorantet, muzetë dhe bibliotekat.

[757] Kjo çështje iu referua Dhomës së Madhe më 5 shtator 2022, që do të thotë se ky vendim i seksionit të tretë të Gjykatës nuk është përfundimtar dhe një vendim i ri do të merret nga Dhoma e Madhe në lidhje me çështjen në fjalë.

Më 26 maj 2020, shoqata kërkuese bëri kërkesë në Gjykatë, duke u ankuar që, pas miratimit të Urdhërësës O.2 Covid-19, ajo ishte detyruar të anulonte një tubim të planifikuar për 1 maj 2020 dhe e kishte tërhequr kërkesën e saj për autorizim. Përgjithësisht, ajo nuk ishte lejuar të organizonte ose të merrte pjesë në mbledhi publike.

Më 27 maj 2020, Këshilli Federal vendosi hapa të mëtejshëm për të rihapur shoqërinë. Prej 30 majit 2020, ndalimi i mbledhjeve u relaksua, në mënyrë që maksimumi 30 pjesëmarrës mund të mbledheshin në të njëjtën kohë. Prej 6 qershorit 2020, ngjarjet publike me deri në 300 pjesëmarrës u lejuan përsëri, e po ashtu edhe tubimet politike. Më 20 qershor 2020, ndalimi për demonstrata publike u hoq, por mbartja e maskave vazhdoi të ishte e detyrueshme. Ngjarjet me më shumë se 1000 veta u ndaluan deri në fund të gushtit 2020.

2. Vendimi përfundimtar i Gjykatës

Kërkuesja u ankuar sipas nenit 11 (e drejta e tubimit dhe organizimit) të Konventës se ishte privuar nga e drejta për të organizuar dhe për të marrë pjesë në ngjarje publike në vijim të masave të marra nga qeveria sipas Urdhërësës O.2 Covid-19.

Pranueshmëria

Për sa i përket statusit të viktimës, Gjykata përsëriti se termi "viktimë" sipas nenit 34 të Konventës duhet të interpretohet në mënyrë të pavarur nga konceptet vendase siç janë ato të interesit dhe mundësia për të nisur procedura sipas të drejtës vendase. Pretendimet *actio popularis* nuk janë të pranueshme nga Gjykata, dhe kërkuesit nuk mund të ankohen për një dispozitë të së drejtës vendase vetëm për shkak se atyre iu duket që ka shkelur Konventën.

Për sa u përket organizatave jo-përfituese, ato nuk mund të pretendojnë të jenë vetë viktimat mbi bazën se një masë ndërhyrës tek të drejtat e anëtarëve të tyre. Megjithatë, në rastin konkret, shoqata kërkuese ishte detyruar ta përshtaste sjelljen e saj në mënyrë që t'u shmangej sanksioneve penale dhe të mos organizonte ngjarje që do të kishin kontribuar në përmbushjen e objektivit të saj. Në mënyrë të veçantë, ajo u desh të anulonte një demonstratë të cilën e kishte organizuar për datën 1 maj 2020. Prandaj, ajo mund të pretendonte se ishte "viktimë" brenda kuptimit të Konventës.

Për sa i përket shterimit të mjeteve në vend, Gjykata theksoi se sipas nenit 35 § 1, zgjidhjet vendase duhet të ekzistojnë në një shkallë të mjaftueshme të sigurisë në praktikë ashtu edhe në teori. Qeveria zvicerane argumentoi se kërkuesja mund të kishte aplikuar për leje për të zhvilluar demonstratë dhe më pas të kishte kërkuar shqyrtimin juridik të refuzimit për dhënien e kësaj lejeje. Gjykata pranoi që në kushte normale urdhëresa të tilla federale mund të ishin objekt i një vendimi paraprak në lidhje me kushtetutshmërinë nga gjykatat zvicerane. Megjithatë, Gjykata shqyrtoi shembujt e tjerë të mënyrave se si raste të ngjashme ishin trajtuar nga gjykatat vendase gjatë pandemisë dhe gjeti se nuk kishte pasur vendime në lidhje me kushtetutshmërinë e urdhëresës, e madje edhe vendimet e shkallës së parë në këto raste ishin marrë pas datës në lidhje me të cilën ishte kërkuar autorizimi për të mbajtur demonstrata. Prandaj, Gjykata gjeti se, në rrethanat shumë specifike të mbylljes brenda gjatë Covid-19, nuk do të kishte pasur shumë gjasa që gjykatat vendase zvicerane do të kishin ndërmarrë shqyrtimin e themeleve të çështjes ose pajtueshmërinë e Urdhëresës O.2 Covid-19 me Konventën, brenda një periudhe të arsyeshme (d.m.th. para datës kur synohej të mbahej demonstrata). Më tej, me përjashtim të periudhës shumë të shkurtër mes 13 dhe 16 marsit 2020, urdhëresa parashikonte që nuk ishte e mundur të aplikohesh për autorizim për të bërë derogim nga ndalimi i përgjithshëm i demonstratave me qëllim të ushtrimit të të drejtave politike. Prandaj, Gjykata gjeti që, në kohën relevante, praktikisht kërkuesja nuk kishte pasur qasje në një zgjidhje efektive e cila do t'i kishte mundësuar asaj që të ankohej për shkelje të të drejtave të saj sipas nenit 11.

Neni 11

Gjykata përsëriti se çdo ndërhyrje tek e drejta për lirinë e tubimit mund të justifikohet vetëm në qoftë se përmbushen kriteret e nenit 11 § 2. Ndërhyrja duhet të jetë e parashikuar me ligj, duhet të synojë një prej katër qëllimeve legjitime të renditura në paragraf, dhe duhet të jetë e nevojshme në një shoqëri demokratike. Gjykata shqyrtoi nëse secila prej tre kriterëve ishte plotësuar në rastin konkret.

Për sa i përket bazës ligjore, Gjykata theksoi se fjalët “e parashikuar me ligj” në Konventë kërkojnë jo vetëm që masat e kontestuara të jenë të bazuara në të drejtën vendase, por edhe që t'i referohen cilësisë së ligjit në fjalë. Megjithatë, meqenëse ajo konsideronte se masat e kontestuara ishin të tepërta duke pasur parasysh kriterin e nevojshmërisë në një shoqëri demokratike, Gjykata nuk e konsideroi veten të detyruar për të vendosur në lidhje me faktin nëse cilësia e ligjit në fjalë ishte në përputhje me kriteret e nenit 11 § 2.

Për sa i përket qëllimit legjitim, Gjykata e pranoi argumentin e Qeverisë që masat e kundërshtuara synonin dy qëllime të veçanta brenda kuptimit të nenit 11 § 2, pra mbrojtjen e shëndetit dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.

Për sa i përket nevojshmërisë së masave në një shoqëri demokratike, Gjykata i vlerësoi masat e kontestuara karshi parimeve të vendosura në praktikën e saj gjyqësore në lidhje me këtë aspekt.

Së pari, Gjykata theksoi se ndërkohë që Zvicra gëzonte njëfarë hapësire të vlerësimit në përcaktimin e kufizimeve të të drejtave dhe lirive të garantuara me Konventë, kjo hapësirë nuk ishte e pakufishme. Në rastin konkret, Gjykata njohu se kërcënimi nga Covid-19 ishte shumë serioz, njohuritë për shkallën e rreptësisë së kërcënimit nga virusi ishin të kufizuara, e rrjedhimisht Shteteve u ishte dashur të reagonin me shpejtësi në këtë periudhë. Ngjashëm, konteksti kompleks i pandemisë i kishte dhënë shkas interesave konfliktuale nga ana e Shtetit, sidomos detyrimi pozitiv për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të njerëzve brenda juridiksionit të tij.

Duke pasur parasysh këto, Gjykata përsëriti praktikën e saj gjyqësore që një ndalim i përgjithshëm i një sjelljeje të caktuar është masë radikale që kërkon justifikim të fortë dhe shqyrtim veçanërisht të thellë nga gjykatat që e kanë për detyrë një gjë të tillë. Mes 17 marsit dhe 30 majit 2020, të gjitha ngjarjet me anë të të cilave shoqata kërkuese do të kishte mundur t'i vazhdonte aktivitetet e saj dhe të arrinte qëllimet e saj iu nënshtruan ndalimit të përgjithshëm. Edhe pse ekzistonte një justifikim i fortë – konkretisht reagimi i shpejtë ndaj pandemisë Covid-19 – Gjykata theksoi se, pas shqyrtimit të shterimit të mjeteve vendase, nuk ishte e mundur që ky ndalim i përgjithshëm të shqyrtohej nga gjykatat vendase. Një tjetër faktor relevant për ushtrimin e proporcionalitetit ishte se ndalimi i përgjithshëm u vlerësua se kishte zgjatur për një periudhë të konsiderueshme kohore.

Përveç kësaj, Gjykata shënoi se Qeveria nuk e kishte justifikuar përse ishte e mundur që të vazhdohej shkuarja në vendin e punës me kusht që punonjësit të merrnin masa të caktuara mbrojtëse (edhe kur qindra njerëz punonin në vende të tilla), ndërkohë që organizimi i demonstratave në ajër të hapur vazhdoi të mbetej i ndaluar. Kjo ishte relevante për vlerësimin e proporcionalitetit, sepse sugjeronte se qëllimi legjitim i mbrojtjes së shëndetit potencialisht do të kishte mundur të përmbushej me anë të masave që ndërhyjnë në një shkallë më të vogël tek e drejta për lirinë e tubimit.

Më tej, Gjykata theksoi se cilësia e shqyrtimit parlamentar dhe gjyqësor të nevojshmërisë së masave në shkallë vendi ishte veçanërisht relevante për vlerësimin e hapësirës së vlerësimit. Nga njëra anë, ajo e pranoi se nuk mund të ishin pritur debate të thella parlamentare duke marrë parasysh urgjencën e reagimit të kërkuar në fazat e hershme të pandemisë. Megjithatë, kjo e bënte edhe më thelbësor shqyrtimin gjyqësor të pavarur dhe efektiv të masave.

Më pas, Gjykata vlerësoi natyrën dhe rreptësinë e dënimeve për shkeljet e ndalimit të demonstratave sipas Urdhëresës O.2 Covid-19. Gjykata përsëriti praktikën gjyqësore që sanksionet penale kërkojnë justifikim të veçantë dhe, në parim, demonstratat paqësore nuk do të duhej t'i nënshtroheshin kërcënimit të sanksioneve penale. Në rastin konkret, mos-respektimi ishte i dënueshëm me burgim deri në tre vjet ose me gjobë monetare. Gjykata konsideroi se natyra e këtyre dënimeve me gjasë kishte efekt pengues tek organizatorët dhe pjesëmarrësit potencialë.

Si pikë përfundimtare, Gjykata theksoi se, duke marrë parasysh pandeminë globale, Zvicra nuk e kishte shfrytëzuar nenin 15 të Konventës që lejonte Shtetin të mernte masa të caktuara duke bërë derogim nga detyrimet e parashikuara nga Konventa në rrethana të caktuara. Rrjedhimisht, ajo duhet të vepronte në pajtueshmëri të plotë me kriteret e nenit 11.

Në përfundim, Gjykata vendosi që, duke pasur parasysh rëndësinë e të drejtës për protestë paqësore në një shoqëri demokratike (dhe rëndësinë e vlerave që mbronte shoqata kërkuese), natyra gjithëpërfshirëse dhe kohëzgjatja e konsiderueshme e ndalimit, si dhe natyra dhe rreptësia e dënimeve të parashikuara, ndërhyrja tek neni 11 nuk ishte proporcionale me qëllimet e synuara. Më tej, gjykatat vendase nuk kishin ushtruar kontroll ose shqyrtim efektiv të masave pas ankesës, që do të thotë se qeveria zvicerane e kishte tejkaluar hapësirën e vlerësimit prej së cilës përfitonte në këtë kontekst.

Rrjedhimisht, kishte pasur shkelje të nenit 11.

Neni 41

Gjykata gjeti se gjetja e një shkeljeje përbënte shpërblim të drejtë të mjaftueshëm në lidhje me çdo dëm jomaterial të pësuar nga kërkuesja.

XII. Liria e lëvizjes përfshirë të drejtën për t'u larguar nga një vend dhe për të hyrë në vendin e vet

Shkelje e Nenit 2 § 2 të Protokollit Nr. 4 për shkak të dështimit për vlerësim periodik të ndalimit të kërkuesit për t'u larguar nga Polonia gjatë procedurave penale të zgjatura pa arsye

VENDIMI NË RASTIN A.E. k. POLONISË

(Kërkesa Nr. 14480/04)
31 mars 2009

1. Faktet kryesore

Kërkuesi, A.E. ishte shtetas libian i lindur në vitin 1950. Më 15 dhjetor 1999, ai u arrestua dhe u vendos në paraburgim nga Gjykata e Qarkut të Suëalkit, dhe më 27 mars 2000 ai u akuzua për mashtrim dhe falsifikim në tentativë. Më 10 prill 2000, paraburgimi i kërkuesit u vazhdua deri më 31 maj 2000. Ai apeloi, por apeli u rrëzua nga Gjykata Rajonale Piotrkóë Trybunalski mbi bazën e dyshimit të arsyeshëm që ai e kishte kryer veprën, dhe që ekzistonte rreziku i fshehjes së tij për shkak të mungesës së një adrese të përhershme në Poloni.

Më tej çështja iu përcoll dy gjykatave të ndryshme të rrethit, deri kur Prokurori i Rrethit Suëalki e liroi kërkuesin me dorëzani më 29 dhjetor 2000. Megjithatë, Prokurori ia ndaloi kërkuesit që të largohej nga Polonia, duke iu referuar nevojës për të siguruar ecurinë e duhur të hetimeve dhe dyshimit të arsyeshëm që kërkuesi i kishte kryer veprat e supozuara.

Më 13 tetor 2005, Gjykata e Rrethit Jaëorzno e dënoi kërkuesin me një vit e gjashtë muaj burgim, ku kërkuesi dhe prokurori apeluan. Kërkuesi nuk u vendos në paraburgim. Më 13 mars 2007, Gjykata Rajonale e Katoëices e prishi VENDIMIn dhe e riktheu çështjen në Gjykatën e Rrethit Jaëorzno.

Ndërkohë, më 20 korrik 2006, kërkuesi kërkoi që të hiqej ndalimi ndaj tij për t'u larguar nga Polonia, duke thënë se motra e tij kishte vdekur dhe ai donte të vizitonte nënën e tij të sëmurë në Libi. Më 23 gusht 2006, Gjykata Rajonale e Katoëices e rrëzoi këtë kërkesë, me arsyetimin se po të hiqej ndalimi do të kishte arsye serioze për të besuar se kërkuesi do të fshihej.

Në qershor 2005 dhe janar 2007, kërkuesi iu ankua Gjykatës Rajonale të Katoëices sipas Ligjit të 17 qershorit 2004 duke pohuar që ishte shkelur e drejta e tij për gjyq të drejtë brenda një kohe të arsyeshme. Të dy ankesat u rrëzuan. Në lidhje me ankesën e dytë, Gjykata Rajonale shqyrtoi kohëzgjatjen e procedurave pas 3 qershorit 2005 dhe gjeti që nuk kishte pasur mungesë aktiviteti apo vonesë të paduhur, e rrjedhimisht jo shkelje të së drejtës për gjyq të drejtë brenda një kohe të arsyeshme. Në kohën e VENDIMIT të Gjykatës Evropiane, procedurat penale kundër kërkuesit ishin ende në pritje para Gjykatës së Rrethit.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi u ankua që kohëzgjatja e tepërt e procedurave penale kishte shkelur të drejtat e tij sipas Nenit 6. Më tej, ai u ankua që ndalimi përkatës që ai të mos largohej nga Polonia për tetë vjet ishte shkelje e të drejtës së tij për liri të lëvizjes sipas Nenit 2 të Protokollit Nr. 4. Për më tepër, ai diskutoi që ky ndalim e kishte penguar atë që të vizitonte nënën e tij të sëmurë dhe të merrte pjesë në varrimin e motrës së tij, duke shkelur kështu të drejtat e tij sipas Nenit 8.

Neni 6

Periodha kohore në shqyrtim zgjati mbi nëntë vjet, duke filluar nga 15 dhjetori 1999 kur u arrestua kërkuesi, e duke vazhduar deri në datën e VENDIMIT të tanishëm. Gjykata përsëriti që fakti nëse procedurat ishin zhvilluar brenda "një kohe të arsyeshme" duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes, në mënyrë të veçantë: kompleksiteti i saj, sjellja e kërkuesit dhe autoriteteve relevante, dhe ajo çka rrezikonte të humbte kërkuesi. Gjykata deklaroi që kishte gjetur shpesh shkelje të Nenit 6 § 1 në çështje të ngjashme me çështjen në fjalë, dhe konsideroi që Qeveria nuk kishte paraqitur ndonjë material që ta bindte atë për të kundërtën.

Prandaj, Gjykata vendosi që kishte pasur shkelje të Nenit 6 § 1. Neni 2 i Protokollit Nr. 4 Gjykata përsëriti që Neni 2 i Protokollit Nr. 4 i garanton çdo personi të drejtën për lirinë e lëvizjes, përfshirë të drejtën për t'u larguar nga çdo vend drejt një vendi tjetër ku ai/ajo mund të pranohet. Çdo masë që kufizon këtë të drejtë duhet të jetë e ligjshme, me synim legjitim, dhe e tillë që të vendosë ekuilibër të drejtë mes interesit publik dhe të drejtave të individit. Në rastin konkret, Gjykata ishte e bindur, së pari, që ndërhyrja tek të drejtat e kërkuesit ishte e parashikuar nga e drejta vendase, ku ndalimi i udhëtimit ishte bazuar në Nenin 227 § 1 të Kodit të Procedurës Penale të vitit 1997. Së dyti, ajo po ashtu ishte e

bindur që ndërhyrja ishte e justifikuar për synimin legjitim të sigurimit të pranisë së kërkuarit në gjyq e rrjedhimisht ruajtjen e rendit publik.

Megjithatë, Gjykata konsideroi që shkalla e ndërhyrjes ishte joproportionale. Edhe kur fillimisht kërkohet kufizimi i lirisë së lëvizjes së një individi, vazhdimi i tij për një periudhë të gjatë kohore mund të rezultojë në bërjen e tij joproportional, duke shkelur të drejtat e individit. Gjykata deklaroi që kufizimet e gjata duhet të përfshijnë rivlerësimin periodik të justifikimit të tyre. Në rastin e kërkuarit, rivlerësimi u ndërmor nga Gjykata më 23 gusht 2006 vetëm pas kërkesës së kërkuarit të 20 korrikut 2006, ku cekejse ndalesa e udhëtimit ishte masë automatike dhe përgjithësuese me kohëzgjatje të pacaktuar. Gjykata konsideroi që kjo ishte në kundërshtim me detyrën e autoriteteve sipas Neni 2 § 2 të Protokollit Nr. 4 posaçërisht për t'u kujdesur si duhet për t'u siguruar që çdo ndërhyrje tek e drejta e kërkuarit për t'u larguar nga Polonia të mbetet e justifikuar dhe proporcionale gjatë tërë kohëzgjatjes së saj.

Prandaj, Gjykata vendosi që kishte shkelje të të drejtave të kërkuarit të garantuara nga Neni 2 § 2 i Protokollit Nr. 4.

Neni 8

Duke pasur parasysh gjetjen e mësipërme sipas Neni 2 të Protokollit Nr. 4, Gjykata e konsideroi të panevojshme të shqyrtonte nëse kishte pasur shkelje të Neni 8.

Neni 41

Gjykata caktoi shpërblimin në shumën 8,000 Euro për kërkuarin në lidhje me dëme jomateriale, dhe 150 Euro për kosto dhe shpenzime.

Kufizimi për të mos u larguar nga vendbanimi i nisur në përputhje me procedurat penale nuk ka shkelur Nenin 2 të Protokollit 4 meqenëse ka qenë relativisht i shkurtër në kohëzgjatje, dhe leja për largim është dhënë sapo është bërë kërkesa

VENDIMI NË ÇËSHTJEN ANTONENKOV DHE TË TJERË k. UKRAINËS

(Kërkesa Nr. 14183/02)
22 nëntor 2005

1. Faktet kryesore

Kërkuesit, Z. Antonenkov, Z. Stolitniy dhe Z. Diukin janë të lindur respektivisht në vitet 1967, 1959 dhe 1970, dhe jetonin në Kiev.

Më 26 qershor 1996 nisën procedurat penale kundër tyre, dhe më pas ata u arrestuan për shkak të dyshimit për mashtrim dhe vjedhje. Në prill dhe maj 1997, Gjykata e Rrethit të Shevchenkovskit në Kiev i liroi ata mbi bazën e zotimit për të mos u fshehur. Kjo nënkuptonte që kërkuesit ranë dakord që të mos largoheshin nga vendbanimi i tyre pa lejen e një hetuesi (ose gjykatësi), dhe në rast shkeljeje të zotimit me shkrim mund të merrej një masë kufizuese më e reptë.

Mes prillit 1997 dhe prillit 2002, u renditën gjithsej 77 seanca dëgjimore, shumë prej të cilave u shtynë ose u anuluan. Gjykata e rrethit e ridërgoi çështjen dy herë. Më 19 korrik 2002 gjykata e rrethit i përfundoi procedurat lidhur me akuzat për mashtrim, përvetësim dhe falsifikim. Procedurat penale për vjedhje, në kohën e VENDIMIT të Gjykatës Evropiane, ishin ende në vazhdim kundër dy prej kërkuesve.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesit u ankuan që kohëzgjatja e procedurave penale kundër tyre kishte shkelur të drejtën e tyre për gjyq të drejtë brenda një kohe të arsyeshme sipas Nenit 6 § 1, dhe që kufizimi i zgjatur i lirisë së tyre të lëvizjes si pasojë e zotimit për të mos u fshehur shkelte të drejtën e tyre për lirinë e lëvizjes sipas Nenit 2 të Protokollit 4.

Neni 6

Gjykata përsëriti që periudha që duhet marrë në konsideratë gjatë përcaktimit të kohëzgjatjes së procedurave penale kishte filluar kur personi u akuzua dhe

kishte mbaruar kur akuza u vendos përfundimisht, ose kur procedurat u ndërprejnë. Procedurat në lidhje me njërin kërkues zgjatën gjashtë vjet e një muaj, dhe ato në lidhje me dy kërkuesit e tjerë zgjatën nëntë vjet e katër muaj. Megjithatë, vetëm katër vjet e dhjetë muaj, dhe tetë vjet e një muaj prej këtyre procedurave, respektivisht, hynin nën juridiksionin e Gjykatës duke qenë se Konventa kishte hyrë në fuqi në Ukrainë vetëm më 11 shtator 1997.

Gjykata përsëriti se fakti nëse procedurat ishin zhvilluar brenda “një kohe të arsyeshme” duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes, në mënyrë të veçantë: kompleksiteti i saj, sjellja e kërkuesit dhe autoriteteve përkatëse, dhe çka rrezikonte të humbte kërkuesi.

Megjithëse Gjykata pranoi që kishte një shkallë të caktuar kompleksiteti në natyrën ekonomike të akuzave, ajo vërejti se opinionet eksperte u parashtruan në fazën parargjyqësore dhe dëshmitarët ekspertë nuk u morën në pyetje nga gjykata, dhe dyshohej që gjatësia e dosjes së lëndës në vetvete nuk e justifikonte gjatësinë e gjyqit. Gjykata pranoi që kërkuesit kishin shkaktuar disa vonesa gjatë procedurave, por këto vonesa përbënin më pak se gjashtë muaj gjithsej. Shumë prej vonesave të tjera në procedura u gjet të ishin për shkak të sjelljes së autoriteteve vendase, dhe trupi gjykues inter alia duhet të kishte vendosur një orar më të ngjeshur të seancave dëgjimore për të përshpejtuar procedurat, dhe ishte treguar e ngadalshme në vendosjen e paraqitjeve të detyrueshme të kërkuesve pasi dështimi i tyre për t’u paraqitur kishte rezultuar me shtyrje të shumta.

Prandaj, Gjykata konsideroi që kohëzgjatja e procedurave nuk e përmbushte kriterin e “kohës së arsyeshme”, dhe prandaj ishte në shkelje të Nenit 6.

Neni 2 i Protokollit 4

Gjykata deklaroi se fakti që kërkuesit i ishin nënshtruar detyrimit për të kërkuar leje nga gjykata në mënyrë që të largoheshin nga vendbanimi i tyre çdo herë që donin të shkonin diku tjetër përbënte ndërhyrje tek e drejta e tyre për liri të lëvizjes.

Për sa i përket faktit nëse kjo ndërhyrje ishte “në përputhje me ligjin”, Gjykata përsëriti që pikësëpari u takon autoriteteve vendase të zgjidhin problemet e interpretimit të legjislacionit vendas. Më tej, Gjykata përsëriti se roli i saj kufizohej me të konstatuarit nëse efektet e një interpretimi të tillë ishin në pajtueshmëri me Konventën, posaçërisht në lidhje me rregullat procedurale. Në çështjen në fjalë, kërkuesit synonin të sfidonin zbatimin e masës e jo të ligjshmërisë së saj, dhe

Gjykata nuk pa arsye që të vinte në pyetje gjetjen e gjykatës vendase që zbatimi i saj ishte në përputhje me të drejtën procedurale vendase dhe që kishte qëllime legjitime si ruajtja e rendit publik dhe parandalimi i krimit.

Në lidhje me proporcionalitetin e ndërhyrjes, Gjykata vërejti që më parë kishte gjetur kohëzgjatje joproporcionale të kufizimeve për mos-largim nga vendbanimi në disa çështje kundër Italisë⁵²⁹. Megjithatë, rrethanat e çështjes në fjalë ishin mjaftueshëm të ndryshme saqë bënë të mundur që ajo të dallonte. Së pari, Gjykata shënoi që kërkuesit ishin subjekt i procedurave penale në çështjen aktuale. Konventa u lejon Shteteve, në disa rrethana, që të zbatojnë masa për kufizimin e lirisë në mënyrë që të sigurohet zhvillimi efikas i ndjekjes penale. Gjykata përsëriti që, në raste të tilla, detyrimi për të mos u larguar nga vendbanimi është kufizim proporcional i lirisë së të akuzuarit.

Së dyti, masat parandaluese nuk zbatoheshin automatikisht përgjatë tërë kohëzgjatjes së procedurave penale kundër kërkuesve, dhe nuk kishte tregues që dy prej kërkuesve t'i ishin nënshtruar ndonjë herë masës pas korrikut 2002. Së treti, kohëzgjatja e kufizimeve në rastin e tanishëm ishte në mënyrë domethënëse më e shkurtër sesa çështjet kundër Italisë të referuara më lart: pesë vjet e tre muaj në krahasim me katërbëdhjetë vjet e tetë muaj, për shembull.

Në mënyrë që të vendoste nëse është arritur ekuilibri i drejtë mes interesit të përgjithshëm dhe zhvillimit të duhur të procedurave penale, dhe gëzimit të lirisë së lëvizjes së kërkuesve, Gjykata duhej të përcaktonte vërtetësinë e faktit nëse kërkuesit faktikisht kishin tentuar që të largoheshin nga zona e vendbanimit dhe, nëse po, nëse ishte refuzuar leja për të vepruar kështu. Qeveria parashtroi, pa u kundërshtuar nga kërkuesit, që njëri prej kërkuesve kishte bërë kërkesë dy herë për t'u larguar nga Kievi dhe në të dy rastet i ishte dhënë leje.

Prandaj Gjykata gjeti që kufizimi i lirisë së kërkuesve ishte proporcional dhe që nuk kishte shkelje të Nenit 2 të Protokollit 4.

Neni 41

Gjykata caktoi shpërblim në shumën 2,000 Euro për secilin prej dy prej kërkuesve, dhe 3,000 Euro për njërin prej kërkuesve për dëme jomateriale. Secili pranoi 1,000 Euro për kosto dhe shpenzime.

Urdhrat katërmbëdhjetë-ditëshe që i ndalonin kërkuesit, të përfshirë në aktivitete droge, nga hyrja në "zonat e emergjencës" në Amsterdam nuk ka shkelur Nenin 2 të Protokollit 4

GJYKIMET NË ÇËSHTJET (1) OLIVIEIRA k. HOLANDËS

(Kërkesa Nr. 33129/96)

-DHE-

(2) LANDVREUGD k. HOLANDËS

(Kërkesa Nr. 37331/97)

4 qershor 2002

1. Faktet kryesore

Kërkuesit, Hans Ëalter Oliveira (1) dhe Franklin Edgar Landvreugd (2), ishin të dy shtetas holandezë. Më 6 nëntor 1992 dhe 2 dhjetor 1994, respektivisht, Burgomaster i Amsterdimit mori urdhra ndalues, të cilët ua ndalonin secilit kërkues hyrjen për pesëmbëdhjetë ditë në "zonat e emergjencës" të qytetit, të quajtura kështu për shkak të shkallës së lartë të trafikimit publik dhe përdorimit të drogave të rënda. Këto urdhra u morën sepse ata [kërkuesit] ishin gjetur në këto zona të qytetit ose në posedim të drogave të rënda ose të pajisjeve të drogimit, ose duke përdorur drogë haptas. Asnjëri prej kërkuesve nuk jetonte ose punonte në zonat e ndaluara. Të dy u shpallën fajtorë dhe u dënuan për dështim të respektimit të urdhrave të ndalimit ndaj tyre, sadoqë këto procedura penale nuk qenë pjesë e çështjes para Gjykatës.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesit u ankuan që urdhrat e ndalimeve katërmbëdhjetë-ditore kishin shkelur të drejtat e tyre për lirinë e lëvizjes të cilat mbrohen nga Neni 2 i Protokollit 4.

Neni 2 i Protokollit 4

Qeveria nuk vuri në diskutim që kishte pasur kufizim të të drejtave të kërkuesve sipas Neni 2 Protokollit 4.

Atëherë Gjykata mori në shqyrtim nëse kufizimet ishin “në përputhje me ligjin”. Ajo përsëriti që kjo jo vetëm që kërkonte që masat të ishin marrë mbi bazën e të drejtës vendase, por edhe që ato të kishin qenë në dispozicion të personave në fjalë dhe efektet e tyre të parashikueshme.

Gjykata shënoi që Akti i Bashkisë, ashtu siç ishte në fuqi në periudhat përkatëse, thoshte se Burgomaster kishte pushtetin e diskrecionit për të marrë urdhra sipas nevojës për të siguruar rendin publik. Për më tepër, edhe Gjykata Supreme edhe Divizioni i Juridiksionit Administrativ të Raad van State (për kërkuesin 1) ose Këshilli i Shtetit (për kërkuesin 2) gjetën që Akti i Bashkisë përbënte bazë të mjaftueshme ligjore për kufizimet mbi lirinë e lëvizjes si ato që ishin vendosur. Më tej Gjykata theksoi se u takonte kryesisht autoriteteve nacionale, veçanërisht gjykatave, që të interpretonin dhe të zbatonin ligjet vendase. Prandaj Gjykata gjeti që urdhrat e ndalimit ishin të bazuara në të drejtën vendase.

Gjykata gjeti që kriteri i qasshmërisë ishte përmbushur sepse dispozitat e përdorura ishin të pranishme në Aktin e Bashkisë, dhe praktika gjyqësore lidhur me interpretimin e tyre ishte e publikuar në raportet ligjore vendase.

Gjykata më tej përsëriti që një rregullë është “e parashikueshme” nëqoftëse është e formuluar me saktësi të mjaftueshme sa t’i mundësojë një individ – nëse ka nevojë me këshillimin e duhur – që të rregullojë sjelljen e vet sipas saj. Megjithëse Gjykata shënoi që pjesët përkatëse të Aktit të Bashkisë ishin pak a shumë të përgjithshme, ajo njohu faktin se rrethanat në të cilat kërkohet që Burgomaster të lëshonte urdhra që vlerësoheshin të nevojshme për rendin publik ishin tepër të ndryshme për të formuluar saktësisht një ligj që do të mbulonte çdo eventualitet. Më tej Gjykata shënoi që, më herët, ndaj secilit prej të dy kërkuesve ishin lëshuar urdhra tetë-orëshe ndalimi në gjashtë raste të ndryshme, ku asnjëri prej kërkuesve nuk i kishte kontestuar ato si të paligjshme. Në vijim, të dy kërkuesve iu tha atypëraty që secilit prej tyre do t’u lëshohej një urdhër katërmbëdhjetë-ditësh ndalimi nëse ata i kryenin aktet shkelëse në të ardhmen e afërt. Vetëm pasi të dy kërkuesit e neglizhuan këtë paralajmërim dhe sërish ndaj tyre u lëshuan ndalesa tetë-orëshe, atëherë Burgomaster faktikisht urdhëroi ndalesat katërmbëdhjetë-ditëshe. Gjykata deklaroi që, sipas rrjedhës së ngjarjeve si më lart, kërkuesit ishin në gjendje të parashikonin pasojat e veprimeve të tyre dhe të rregullonin sjelljen e tyre përkatësisht përpara se të merreshin urdhrat katërmbëdhjetë-ditëshe për ndalim. Gjykata gjithashtu mori parasysh faktin që kërkuesit mundën, dhe në fakt e bënë këtë, që të nisnin procedurat kundërshtuese dhe të ngrinin apele pranë Raad van State (kërkuesi 1) ose Këshilli i Shtetit (kërkuesi 2). Rrjedhimisht, pati mbrojtje

të përshtatshme kundër abuzimit të fuqive të diskrecionit të Burgomaster-it.

Prandaj, Gjykata i konsideroi ndalesat katërbëdhjetë-ditëshe të parashikueshme, e rrjedhimisht në përputhje me ligjin.

Më pas Gjykata shqyrtoi nëse ndalesat ishin "të justifikuara nga interesi publik në një shoqëri demokratike". Urdhrat e ndalimi aplikoheshin në disa pjesë të Amsterdamit ku ekzistonin situata emergjence në lidhje me trafikimin dhe përdorimin e drogave të forta në publik, siç përcaktohej nga gjykatat nacionale. Prandaj urdhrat synonin qëllimet legjitime të ruajtjes së rendit publik dhe parandalimit të krimit. Gjykata mori parasysh: që kërkuesve tashmë u ishin dhënë urdhra tetë-orësh ndalimi, por pavarësisht prej kësaj ata çdo herë u kthyen në zonat e ndaluara për t'u përfshirë në aktivitete me droga të forta në publik; që ata u paralajmëruan se një përsëritje e mëtejshme do të rezultonte me urdhra katërbëdhjetë-ditëshe; që asnjëri prej tyre nuk jetonte ose punonte në zonat e ndaluara respektivisht; që ishin bërë përgatitje për kërkuesin 2 që të hynte në zonë pa u dënuar për të marrë pagesën e sigurimeve sociale dhe postën e tij prej një qendre bamirësie e cila i ndihmonte atij. Prandaj, Gjykata deklaroi që kufizimet ndaj lirisë së kërkuesve ishin të justifikuara dhe proporcionale.

Gjykata arriti në përfundimin që nuk kishte pasur shkelje të Nenit 2 të Protokollit 4.

Neni 8

Gjykata deklaroi që, meqenëse ankesat e kërkuesve sipas Nenit 8 kryesisht koincidonin me ato sipas Nenit 2 të Protokollit 4, nuk ngrihej asnjë çështje e ndarë sipas Nenit 8.

Ndalesa e udhëtimit ndaj një ish-të burgosuri ka shkelur Nenin 2 të Protokollit 4 dhe Nenin 13 meqenëse autoritetet nacionale kanë dështuar të marrin në konsideratë proporcionalitetin e saj dhe rrethanat individuale të kërkesit

VENDIMI NË ÇËSHTJEN MILEN KOSTOV k. BULLGARISË

(Kërkesa Nr. 40026/07)

3 shtator 2013

1. Faktet kryesore

Kërkesi ishte shtetas bullgar dhe grek. Pasi kishte vuajtur një dënim me burg dy vjet, ai u lirua në vitin 2003. Më 30 shtator 2005, Drejtoria Rajonale e Policisë në Varna ("VRPD") caktoi një ndalim-udhëtimi ndaj kërkesit për shkak të dënimit të tij të mëparshëm dhe faktit që periudha statutore e rehabilitimit ligjor nuk kishte skaduar ende. Në kohën kur u mor ky urdhër, kërkesi jetonte në Gjermani. Ai udhëtoi për në Bullgari në fillim të prillit 2006 për të rinovuar dokumentet e tij të identitetit.

Kërkesi apeloj ndaj ndalim-udhëtimit, por ky apel u rrëzua nga Gjykata Administrative Supreme ("SAC") në një gjykim të formës së prerë më 22 shkurt 2007. SAC deklaroi që rrethanat personale të kërkesit nuk duhet të ishin shqyrtuar nga gjykatat më të ulëta, meqenëse diskrecioni i VRPD-së në dhënien e urdhrat nuk i nënshtrohej kontrollit juridik. Në maj 2007, kërkesi kërkoi që ndalesa të hiqej, çka u realizua menjëherë falë rehabilitimit të tij.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkesi u ankua që ndalim-udhëtimi nuk ishte as i nevojshëm e as proporcional në ato rrethana, dhe prandaj kishte shkelur të drejtën e tij për t'u larguar nga Bullgaria, gjë që mbrohet me paragrafin 2 të Nenit 2 të Protokollit 4. Më tej ai u ankua që të drejtat e tij sipas Nenit 13 dhe Nenit 6 ishin shkelur sepse, respektivisht, ai nuk kishte pasur zgjidhje efektive në dispozicion në lidhje me ankesën e tij të parë dhe SAC kishte refuzuar të shqyrtonte proporcionalitetin.

Neni 2 i Protokollit 4

Gjykata shënoi që rrethanat e kësaj çështjeje ishin shumë të ngjashme me çështje që ishin paraqitur para saj kohëve të fundit, ku në të gjitha ajo kishte gjetur

shkelje të Nenit 2 të Protokollit 4. Ajo vuri në pah se autoritetet i referoheshin vetëm dënimit të kërkuesit dhe mungesës së rehabilitimit kur merrnin vendimin për ndalim-udhëtim.

Duke vepruar kështu, autoritetet dështonin të merrnin në konsideratë situatën individuale të kërkuesit ose proporcionalitetin e masës.

Për më tepër, Gjykata theksoi se ky dështim nuk mund të korrigjohet me anë të procedurave të shqyrtimit juridik për shkak të gjetjeve të SAC që gjykatat më të ulëta nuk mund të shqyrtonin mënyrën se si VRPD kishte ushtruar diskrecionin e vet në caktimin e ndalesës.

Gjykata përsëriti që një qasje kaq e ngurtë dhe automatike nuk mund të pajtohej me Nenin 2 të Protokollit 4 për t'u siguruar që çfarëdo ndërhyrje tek e drejta e një individi për t'u larguar nga vendi i vet, prej fillimit e gjatë tërë kohëzgjatjes, të ishte e justifikuar dhe proporcionale në rrethanat e dhëna.

Prandaj, Gjykata vendosi që kishte pasur shkelje të Nenit 2 të Protokollit 4. Neni 13 në lidhje me Nenin 2 të Protokollit 4.

Gjykata përsëriti që, aty ku ka pretendim të argumentueshëm që një veprim i autoriteteve mund të shkelë mbi të drejtën e një individi për t'u larguar nga vendi i vet, Neni 13 kërkon që sistemi ligjor nacional të mundësojë kontestimin e masës së marrë. Kështu, çështjet relevante duhen shqyrtuar me mbrojtje të mjaftueshme procedurale dhe në tërësi nga një forum i përshtatshëm vendas, duke ofruar garancitë e duhura të pavarësisë dhe paanshmërisë. Meqenëse nuk kishte dyshim që ankesa e kërkuesit sipas Nenit 2 të Protokollit 4 ishte e argumentueshme, ai kishte të drejtën për një procedurë efektive ankimi në ligjin bullgar.

Gjykata po ashtu përsëriti që një procedurë vendase e apelit nuk mund të konsiderohet efektive brenda kuptimit të Nenit 13 në qoftë se nuk ofron mundësinë për të trajtuar thelbin e një ankese të argumentueshme dhe për të dhënë zgjidhjen e duhur.

Megjithëse e drejta bullgare ofronte mundësinë për të kërkuar shqyrtim juridik, Gjykata vuri re që nuk ishte adresuar 'thelbi' i ankesës, sepse SAC ishte e interesuar vetëm për ligjshmërinë formale të ndalesës. Pasi u bind që kërkuesi ishte dënuar me burg dhe nuk ishte rehabilituar, SAC automatikisht e konfirmoi ndalim-udhëtimin, duke prishur gjetjen e gjykatës më të ulët që ndalesa nuk kishte qenë e arsyetuar

mjaftueshëm. E drejta e kërkuesit për respekt ndaj jetës së tij private dhe familjare u konsiderua jo relevante, dhe nuk u konsiderua fare proporcionaliteti, pra nëse kishte ekuilibër të drejtë mes interesit publik dhe të drejtave të kërkuesit. Për më tepër, kërkuesi nuk pati asnjë zgjidhje tjetër efektive në të drejtën bullgare.

Prandaj, Gjykata deklaroi që kishte pasur shkelje të Nenit 13 në lidhje me Nenin 2 të Protokollit 4.

Neni 6

Gjykata konsideroi që, duke marrë parasysh gjetjet e mësipërme, nuk ngriheshin çështje të ndara sipas Nenit 6.

Neni 41

Gjykata i caktoi 2000 Euro kërkuesit në lidhje me dëme jomateriale, dhe 1,146.65 Euro për kosto ligjore dhe shpenzime.

Ankesa sipas Nenit 3 të Protokollit Nr. 4 që ka të bëjë me ndalimin e përhershëm të hyrjes në territorin francez të një shtetasi francez u deklarua e papranueshme meqenëse autoritetet e kishin njohur shkeljen dhe kishin marrë masat e nevojshme

VENDIMI NË ÇËSHTJEN OUDRHIRI K. FRANCËS

(Kërkesa Nr. 19554/92)

31 mars 1993

1. Faktet kryesore

Kërkuesi ishte shtetas francez, i lindur në Marok në vitin 1953, me banim në Cercy, Francë. Atij i ishte dhënë shtetësia franceze në shkurt të vitit 1983, pas martesës me një shtetase franceze.

Në mars të vitit 1990, kërkuesi u gjet fajtor për vepra në lidhje me drogë nga Gjykata Penale e Pontoise dhe u dënua me 8 vite burgim si dhe me ndalim të përhershëm nga hyrja në tërë territorin francez. Në urdhrin e paraburgimit të lëshuar nga gjyqtari hetues deklarohet që kërkuesi kishte kombësi franceze.

Kërkuesi apeloj kundër këtij vendimi pranë Gjykatës së Apelit, e cila e mbështeti dënimin e tij, shtoi një gjobë për dënim, dhe hoqi periudhën e lirit me kusht e cila i ishte lejuar atij më herët.

Kërkuesi e apeloj vendimin për heqjen e periudhës së lirit me kusht pranë Gjykatës së Kasacionit mbi bazën e arsyeve të pamjaftueshme dhe mungesës së bazës ligjore. Gjykata e Kasacionit e refuzoi këtë apel në korrik të vitit 1991. Kërkuesi nuk e ngriti çështjen e ndalimit të përhershëm të hyrjes së tij në tërë territorin francez që i ishte imponuar atij, meqenëse ai u këshillua përmes një letre nga avokati i tij që Dhoma Penale e Gjykatës së Kasacionit nuk kishte shqyrtuar çështje të faktit, që do të thoshte se çështja e ndalimit ishte jashtë kompetencave të Gjykatës së Kasacionit.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi diskutoi që ndalimi i përhershëm i tij prej hyrjes në territor francez shkelte të drejtat e tij sipas Nenit 3 të Protokollit Nr. 4 të Konventës, ndalimi i dëbimit të shtetasve. Po ashtu, kërkuesi u ankua për arsyetim të pamjaftueshëm,

mungesë të bazës ligjore, akuza të rreme dhe ndikim të dëshmitarëve, çka Komisioni e shqyrtoi në përputhje me Nenin 6 § 1.

Neni 3 i Protokollit Nr. 4

Komisioni e njohu faktin që Qeveria e dinte se kërkuesi ishte shtetas francez. Më tej, Qeveria pranoi para Komisionit që ndalimi i një kërkuesi që është shtetas francez nga hyrja në territorin francez ishte e paligjshme sipas ligjeve franceze. Qeveria shprehu synimin e saj për t'i dhënë fund shkeljes së të drejtave të kërkuesit sipas ligjeve franceze duke anuluar ndalimin e vënë ndaj kërkuesit, dhe konfirmoi që Ministri i Drejtësisë tashmë e kishte udhëzuar Prokurorin e Përgjithshëm që të mos e vinte në zbatim ndalimin kundër kërkuesit, pasi ky i fundit të përfundonte kohën e mbajtjes në qeli.

Prandaj, Komision deklaroi që Qeveria i kishte marrë masat e nevojshme për të rregulluar shkeljen duke anuluar ndalimin dhe duke dhënë udhëzime që ai të mos ekzekutohej. Kështu, Komisioni konsideroi që kërkuesi nuk mund të pretendonte se ishte viktimë e një shkeljeje të Konventës brenda kuptimit të Nenit 25 (tani Neni 34).

Neni 6 § 1

Komisioni deklaroi që nuk paraqitej ndonjë shkelje dhe që nuk kishte kompetencën për të shqyrtuar ndonjë gabim fakti në këtë rast, dhe vendosi që kjo pjesë e kërkesës ishte dukshëm e pabazuar.

XIII. Diskriminimi

Refuzimi i lejeqëndrimit një të huaji për shkak se ishte HIV pozitiv ka qenë diskriminues, në shkelje të Nenit 14 i marrë në lidhje me Nenin 8

VENDIMI NË ÇËSHTJEN KIJUTIN k. RUSISË

(Kërkesa Nr. 2700/10)
10 mars 2011

1. Faktet kryesore

Kërkuesi ishte shtetas i Uzbekistanit i cili kishte jetuar në rajonin Oryol të Rusisë qysh prej vitit 2003. Ai ishte martuar me një shtetase ruse në korrik të vitit 2003 dhe pati një vajzë me të në vitin 2004.

Ndërkohë, në gusht të vitit 2003, kërkuesi aplikoi për lejeqëndrimi në Rusi, për çka i duhej të bënte një ekzaminim mjekësor gjatë të cilit ai rezultoi pozitiv për HIV. Aplikimi i tij për lejeqëndrimi u refuzua për shkak të një dispozite ligjore që ndalonte lëshimin e lejeqëndrimeve të huajve që ishin HIV pozitiv. Ai e kontestoi refuzimin, me argumentin që autoritetet duhet të kishin marrë parasysh gjendjen e tij të tërësishme shëndetësore dhe lidhjet familjare me Rusinë. Gjykatat vendase i refuzuan apelet e tij, duke cituar të njëjtën dispozitë.

2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi u ankua sipas Neneve 8, 13, 14 dhe 15 që refuzimi për t'i dhënë atij lejeqëndrimin kishte qenë joproportional me qëllimin legjitim të mbrojtjes së shëndetit publik dhe kishte dëmtuar jetën e tij familjare, megjithëse Gjykata vendosi ta shqyrtonte këtë sipas Nenit 14 të marrë së bashku me Nenin 8.

Neni 14 në lidhje me Nenin 8

Gjykata përsëriti që Neni 14 nuk ka ekzistencë të pavarur dhe mund të thirret vetëm në lidhje me dispozita të tjera substanciale.

Më tej ajo përsëriti që e drejta e një të huaji për të hyrë ose për t'u vendosur në një vend të caktuar nuk garantohej nga Konventa, dhe nuk kishte detyrime sipas Konventës për të respektuar zgjedhjen e vendbanimit të një çifti të martuar.

Megjithatë, koncepti i "jetës familjare" përfshin marrëdhëniet që dalin nga martesat e ligjshme dhe të sinqerta si ajo e kërkuesit, me bashkëshorten dhe vajzën e tij ruse. Prandaj, çështja hynte brenda kuadrit të Nenit 8.

Neni 14 nuk i ndalon të gjitha dallimet në trajtim por vetëm ato që bazohen mbi një karakteristikë të identifikueshme, objektive ose personale, ose një "status", përmes të cilave personat janë të dallueshëm nga njëri-tjetri. Ai përmban një listë jo-shteruese faktorësh që përbëjnë "statusin", ku përfshihet kategoria "çdo status tjetër". Kësaj i është dhënë kuptim i gjerë, për shembull Gjykata ka njohur paaftësinë fizike dhe disa sëmundje të caktuara si të tilla që hyjnë brenda fushëveprimit të tij. Ajo gjithashtu shënoi që Komisioni i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut e interpretonte "statusin tjetër" në dispozitat jodiskriminuese si i tillë që mbulonte statusin shëndetësor, përfshirë infeksionin me HIV.

Rjedhimisht, Gjykata konsideroi që një dallim mbi bazën e statusit shëndetësor, përfshirë gjendje të tilla si infeksioni me HIV, duhet të mbulohet nga termi "status tjetër" në Nenin 14. Prandaj, Neni 14 i marrë së bashku me Nenin 8 ishte i aplikueshëm për pasojë.

Gjykata ripërsëriti që diskriminimi nënkupton trajtimin e ndryshëm, pa justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, të personave në situata analoge ose përkatësisht të ngjashme. Duke qenë bashkëshorti i një shtetaseje ruse dhe babai i një fëmije rus, kërkuesi ndodhej në situatë analoge me atë të joshtetasve të tjerë që synonin të merrnin lejeqëndrimi në Rusi mbi baza familjare. Gjykata deklaroi që kërkuesi ishte trajtuar ndryshe për shkak të një dispozite ligjore e cila thoshte se aplikimet e të huajve për lejeqëndrim duhet të refuzoheshin nëse ata ishin HIV pozitiv.

Gjykata përsëriti që, meqë kërkuesi e kishte demonstruar dallimin në trajtim, i takonte Qeverisë të tregonte që ky dallim ishte i justifikuar në sensin që ai: synonte një qëllim legjitim, dhe që marrëdhënia mes mënyrave të përdorura dhe qëllimeve të synuara ishte proporcionale. Megjithëse Shtetet gëzojnë hapësirë të gjerë vlerësimi në zbatimin e këtyre kriterëve, Gjykata deklaroi që kjo ishte ngushtuar substancialisht në këtë rast. Së pari, individët që jetojnë me HIV përfaqësonin një grup të ndjeshëm i cili kishte përjetuar diskriminim të konsiderueshëm në të kaluarën. Së dyti, Gjykata theksoi se vetëm gjashtë prej dyzet e shtatë vendeve anëtare të Këshillit të Evropës e kishin kriterin e testit negativ me HIV si parakusht për dhënien e lejeqëndrimit, ndërsa pjesa tjetër nuk caktonte kufizime për hyrjen, qëndrimin apo banimin e individëve për shkak të statusit me HIV. Këto dy faktorë nënkuptonin që Qeveria duhet të paraqiste arsye me shumë peshë për kufizimet e saj.

Gjykata e pranoi që kufizimet e udhëtimit janë shumë të dobishme në mbrojtjen e shëndetit publik, por theksoi që kjo i referohej vetëm sëmundjeve shumë ngjitëse me periudha të shkurtra inkubacioni siç janë kolera, ethe e verdha, SARS dhe "gripi i shpendëve" (H5N1), meqenëse individët, thjesht për shkak të pranisë së tyre në një vend përmes kontakteve të rastësishme ose përmes grimcave fluturoese, mund t'i transmetojnë këto sëmundje. Gjykata bëri dallimin mes këtyre rasteve dhe HIV-it, duke deklaruar se vetë prania e një individi HIV pozitiv në një vend, në vetvete, nuk përbënte kërcënim ndaj shëndetit publik, meqenëse ai nuk transmetohet rastësisht por me anë të ndërveprimeve specifike, përfshirë marrëdhëniet seksuale dhe përdorimin e shiringave të njëjta. Prandaj, përjashtimi i joshtetasve HIV pozitiv nga hyrja dhe/ose banimi me qëllim të parandalimit të transmetimit të virusit HIV ishte i bazuar në presupozimin e përgjithësuar, jo të mbështetur në fakte ose rrethana individuale, që joshtetasit kishin gjasa për t'u përfshirë në sjellje të tilla të pasigurta.

Për më tepër, Gjykata shënoi që metodat e transmetimit të HIV-it mbeteshin të njëjtat pavarësisht nga kohëzgjatja e qëndrimit të individëve në Rusi ose nacionaliteti i tyre. Pavarësisht nga kjo, kufizimet e udhëtimit lidhur me HIV nuk u aplikoheshin turistëve ose vizitorëve afatshkurtër, apo shtetasve rusë që ktheheshin në Rusi. Nuk mund të konkludohej, dhe Qeveria nuk paraqiti prova, që individë të tillë kishin më shumë gjasa sesa joshtetasit afatgjatë të vendosur aty për t'u përfshirë në sjellje më të sigurtë, çka do të reduktonte rrezikun e transmetimit të virusit HIV. Gjykata gjithashtu shënoi që testet nuk identifikonin të gjithë të huajt HIV pozitiv nëse personat e sapoinfektuar testoheshin gjatë periudhës që virusi nuk ishte shfaqur.

Gjykata pranoi që, objektivisht, trajtimi i dallueshëm i të vendosurve afatgjatë që ishin HIV pozitiv karshi vizitorëve afatshkurtër mund të justifikohet nga rreziku i shtuar që të parët mund të bëheshin barrë e madhe financiare për sistemin publik të shëndetësisë. Megjithatë, kjo nuk vlente në rastin e kërkuesit sepse joshtetasit nuk kishin të drejtë për asistencë mjekësore në Rusi, përveç trajtimit emergjent.

Prandaj, Gjykata gjeti që, megjithëse mbrojtja e shëndetit publik ishte qëllim legjitim, nuk kishte justifikim bindës që kjo ishte arritur me anë të kufizimeve selektive të tilla ndaj joshtetasve që kërkonin rezidencë.

Gjykata më tej shënoi një shqetësim tjetër lidhur me natyrën e përgjithësuar dhe pa dallim të masës së kundërshtuar dhe një dispozitë të ndërlidhur ku parashikohej deportimi i joshtetasve që gjendej se ishin HIV pozitiv. Megjithëse

Gjykata Kushtetuese kishte cekur në një vendim të 12 majit 2006 që këto dispozita nuk e përjashtonin mundësinë e dhënies së lejeqëndrimit mbi baza humanitare në raste të jashtëzakonshme, nuk ishte e qartë nëse kjo u jepte autoriteteve vendase diskrecion për të shkelur masën e kundërshtuar. Në rastin e kërkesit, autoritetet nuk ia vunë veshin këtij vendimi, duke deklaruar shprehimisht që gjykatat nuk ishin të detyruara të merrnin parasysh konsideratat humanitare. Gjykata konsideroi që një refuzim kaq pa dallim për lejeqëndrim, i bazuar vetëm mbi një kriter shëndetësor, dhe pa vlerësim juridik të individualizuar, nuk mund të konsiderohej i përputhshëm me Nenin 14.

Prandaj, Gjykata arriti në përfundimin që kërkesi kishte qenë viktimë e diskriminimit për shkak të gjendjes së tij shëndetësore, në shkelje të Nenit 14 i marrë së bashku me Nenin 8.

Neni 41

Gjykata i caktoi 15,000 Euro shpërblim kërkesit në lidhje me dëme jomateriale, dhe 350 Euro për kosto dhe shpenzime.

Qendra AIRE

Qendra AIRE është organizatë jo-qeveritare e cila promovon zbatimin e te Drejtës Evropiane dhe ofron mbështetje për viktimat e shkeljes së të drejtave të njeriut. Një ekip i juristëve ndërkombëtarë ofron ekspertizë, dhe këshilla praktike në lidhje me standardet ligjore të Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës dhe ka përvojë të posaçme në çështjet gjyqësore në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg, ku ka marrë pjesë në më shumë se 150 raste.

Gjatë këtyre 20 viteve, Qendra AIRE ka ndërtuar reputacionin e saj në vendet e Ballkanit Perëndimor, duke vepruar në të gjitha nivelet sistemit të drejtësisë në rajon. Ajo punon në bashkëpunim të ngushtë me ministrinë e drejtësisë, shkollat e trajnimit të gjyqtarëve dhe gjykatat e larta dhe kushtetuese për të drejtuar, ndihmuar, mbështetur dhe ndihmuar në drejtim të zhvillimit të shtetit ligjor dhe projekteve të reformave në terma afatgjatë. Gjithashtu, Qendra AIRE bashkëpunon me sektorin e organizatave jo-qeveritare në mbarë rajonin me qëllim mbështetjen e reformave në fushën e ligjit dhe të respektimit të të drejtave të njeriut. Puna e organizatës ka qenë gjithmonë e përqendruar në garantimin që secili mundet praktikisht dhe efektivisht të gëzojë të drejtat e tij. Në praktikë kjo do të thotë promovim dhe lehtësim në zbatimin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke ndihmuar në procesin e Integritimit Evropian përmes forcimit të shtetit të së drejtës dhe garantimit të njohjes së plotë të të drejtave të njeriut, dhe inkurajimit të bashkëpunimit mes gjyqtarëve dhe profesionistëve në fushën e së drejtës në mbarë rajonin.

Civil Rights Defenders

Mbrojtësit e të Drejtave Civile është organizatë e të drejtave të njeriut e cila mbron të drejtat civile dhe politike dhe fuqizon mbrojtësit e të drejtave të njeriut që janë në rrezik. Ka mbi 30 vjet që mbështesim shoqërinë civile në vende të shtypura. Mënyra se si operojmë është unike dhe përfshin punën nga afër me aktivistë në terren, krijimin e kanaleve për komunikim dhe bashkëpunim ndërkombëtar, dhe ndërtimin e kapaciteteve të aktivistëve për të avokuar në mënyrë efektive për të drejtat e njeriut në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare. Gjatë dekadës së fundit kemi shkuar më tej, nga ofrimi i mbështetjes financiare për partnerët tek të qenit lojtarë për të drejtat e njeriut që i mbështesin partnerët duke kombinuar dialogun për strategji, mbështetjen financiare afatgjatë, mbështetjen në raste emergjencash, masat parandaluese të sigurisë, avokimin, rrjetëzimin, dhe ndërtimin e kapaciteteve me fokus tek shkathtësitë e të drejtave substanciale të njeriut. Ne mbështesim mbrojtësit e të drejtave të njeriut në Evropë, Euroazi, Afrikë Lindore, Amerikë Latine dhe në Azinë Juglindore.

